

ENVER HOXHA

VEPRA

11

PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

ENVER HOXHA

VEPRA

**DOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE
SHQIPERISE**



ENVER HOXHA

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE - LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

ENVER HOXHA

VËLLIMI

11

GUSHT 1953 – GUSHT 1954

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»
TIRANË, 1972

PARATHËNJE PËR VËLLIMIN 11

Vëllimi i 11-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përfshin shkrime të periudhës gusht 1953 — gusht 1954, ku ndër të tjera hyjnë: Fjala në Sesionin V të Kuvendit Popullor (gusht 1953), Raporti në Plenumin IX të KQ të PPSH (dhjetor 1953), Raporti në Plenumin X të KQ të PPSH (prill 1954), Raporti në Plenumin XI të KQ të PPSH (korrik 1954) si dhe letra udhëzuese, diskutime në mbledhje të Byrosë Politike e të Sekretariatit të KQ të PPSH, telegrame etj. Shumica e dokumentave të këtij vëllimi botohen për herë të parë.

Karakteristika kryesore e kësaj periudhe ishte: nga njëra anë, vazhdimi i vështirësive të jashtzakonshme që rridhnin nga prapambetja ende e madhe e vendit tonë, nga përvoja jo e mjaftueshme në planifikimin dhe drejtimin shkencor të ekonomisë, por sidomos nga blokada e imperialistëve dhe e revizionistëve jugosllavë dhe veprimtaria e tyre armiqësore në përgjithësi kundër RPSH; nga ana tjetër, lufta plot vetëmohim e Partisë dhe e masave punonjëse për kapërcimin e vështirësive dhe për plotësimin me sukses të detyrave ekonomike dhe politike të planit të parë pesëvjeçar të përcaktuara nga Kongresi II i PPSH.

Veprat e shokut Enver të kësaj kohe duke pasqy-

ruar këtë gjendje flasin për përpjekjet e mëdha të Partisë dhe të udhëheqjes së saj për të gjetur rrugët më të përshtatshme për kapërcimin e vështirësive e pengesave, për vënjen në jetë të vendimeve të Kongresit II të PPSH, që synonin shndërrimin e Shqipërisë nga një vend i prapambetur agrar në një vend agraro-industrial, rritjen e mirëqenjes materiale e të nivelit kulturalo-arësimor të punonjësve.

Në materialet e këtij vëllimi pasqyrohet puna e madhe edukative dhe politike e Partisë për t'ua bërë të qartë komunistëve e mbarë punonjësve gjendjen aktuale të vështirë dhe perspektivat e sigurta të zhvillimit socialist për t'i bërë ata të ndërgjegjshëm për detyrat e mëdha, për sakrificat që nevojiteshin, për mobilizimin e përgjithshëm të forcave në shërbim të zbatimit të detyrave të planit të parë pesëvjeçar.

Në këto materiale duket kujdesi i madh që i kush-tonte Partia në ato rrethana luftës kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm të klasës, rritjes së vazhdueshme të vigjilencës së punonjësve, ruajtjes dhe çelnikosjes së bashkimit të popullit rreth Partisë mbi bazën e aleancës së qëndrueshme të klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse, forcimit dhe përsosjes së këshillave popullore, të ushtrisë dhe të gjitha organeve të diktaturës së proletariatit.

Në të njëjtën kohë Partia tregonte vëmendje të veçantë për zhvillimin e arësimin e të kulturës në radhët e masave popullore, sepse ajo e kuptonte që pa një zhvillim të tillë s'mund të zhdukej prapambetja dhe të kryheshin transformimet e mëdha socialiste.

Një vend të posaçëm zë në këto vepra çështja e

forcimit të udhëheqjes së Partisë sidomos në çështjet ekonomike. Arritjes së këtij qëllimi do t'i ndihmonte forcimi organizativ i Partisë, përsosja e udhëheqjes kolegjiale në të gjitha hallkat e organeve udhëheqëse, rritja e aftësive të kuadrove nëpërmjet zgjerimit të përvojës së tyre dhe të studimit të marksizëm-leninizmit, si edhe nëpërmjet ngritjes ideologjike të të gjithë komunistëve.

Në shkrimet e këtij libri flitet mjaft edhe për detyrat e propagandës, të shtypit e të radios, si armë të fuqishme për edukimin ideo-politik dhe për mobilizimin e komunistëve e të masave punonjëse në veprimtarinë krijuese.

NGA FJALA NË SESIONIN V TË KUVENDIT POPULLOR

1 gusht 1953

Shokë deputetë,

Ju falemnderit për besimin dhe dashurinë e madhe që tregoni për Partinë tonë heroike të Punës duke më ngarkuar me nderin e madh për t'i paraqitur Kuvendit Popullor përbërjen e Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë.

Sikundër është në dijeninë tuaj, mbledhja e përbashkët e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, e Këshillit të Ministrave dhe e Presidiumit të Kuvendit Popullor, e mbajtur më 23 korrik 1953¹, mori një sërë vendimesh të rëndësishme, të cilat po i paraqiten Sesionit V të tanishëm të Kuvendit Popullor.

Vendimi i parë që i paraqitet Kuvendit Popullor për shqyrtim dhe aprovim konsiston në riorganizimin e administratës qendrore të shtetit tonë. Siç dihet, deri tani Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipë-

¹ Është fjala për Plenumin VIII të KQ të PPSH, të datës 23 korrik 1953.

risë, qeveria, përbëhej prej 17 ministrive dhe Komisionit të Planit të Shtetit. Duke u nisur nga fakti, që organet tona shtetërore janë zgjeruar shumë si në numër, ashtu dhe në përbërje si organikë, u studjua mundësia e thjeshtësimit të aparateve shtetërore për të krijuar kështu mundësi më të mëdha për një drejtim të pandalshëm më të shëndoshë dhe më operativ, për zhvillimin e mëtejshëm me sukses të ekonomisë së vendit dhe të kulturës popullore. Riorganizimi i ri konsiston në bashkimin e disa ministrive që kanë afrim në mes tyre dhe që, duke i përqëndruar në një ministri të vetme disa degë të ngjashme të ekonomisë dhe të kulturës popullore, është pasur për qëllim që të përmirësohet dhe të forcohet akoma më shumë drejtimi i veprimtarisë shtetërore, i ekonomisë dhe i kulturës. Thjeshtësimi i aparatit qendror të shtetit, jo vetëm që do ta bëjë atë më pak të kushtueshëm, por do ta forcojë më shumë, do ta bëjë më të aftë, për të kryer me sukses detyrat e mëdha që i janë ngarkuar nga Partia dhe nga qeveria, për realizimin me sukses të planit pesëvjeçar të shtetit, për forcimin e industrisë sonë, për zhvillimin dhe për përpërimin e bujqësisë në vendin tonë, për zhvillimin e arësimit dhe të kulturës popullore, për përmirësimin sa më të madh të mirëqenjes së punonjësve të Republikës Popullore të Shqipërisë. Masat organizative në fjalë, do të kontribuojnë për forcimin akoma më shumë të aftësisë mbrojtëse të vendit tonë, për forcimin e Ushtrisë sonë heroike Popullore, roje vigjilente dhe e pamposhtur e kufive të shenjtë të atdheut tonë, e independencës dhe e sovranitetit të Republikës Popullore të Shqipërisë, mbrojtëse besnike e interesave dhe e fitoreve të popu-

llit tonë. Riorganizimi i administratës qendrore të shtetit është plotësisht i mundshëm të kryhet shpejt me sukses dhe pa ndërprerje. Thjeshtësimi i aparatit qendror të shtetit, sjell me vete, edhe përmirësimin e punës, pse kuadrot e zgjedhur dhe me eksperiencë, plotësisht të ndërgjegjshëm për barrën e rëndësishme që u ngarkohet, do të mundin të kryejnë më mirë detyrat e tyre, me plot kompetencë dhe inisiativë, duke luftuar njëkohësisht burokratizmin, sëmundje e rrezikshme që bën fole lehtë kur aparatet janë shumë të gjera, ku ndahet përgjegjësia në shumë vetë dhe vendimet e marrura kontrollohen dobët në zbatimin e tyre në jetë.

Duke pasur këto qëllime dhe duke marrë parasysh avantazhet e mëdha që rrjedhin nga një riorganizim i tillë i organeve qendrore, për forcimin e pushtetit dhe të drejtimit shtetëror të ekonomisë dhe të kulturës në Republikën Popullore të Shqipërisë, Kuvendit Popullor i paraqitet propozimi i mëposhtëm:

Ministritë të jenë këto që vijojnë:

1. — Ministria e Punëve të Jashtme.
2. — Ministria e Punëve të Brendshme.
3. — Ministria e Mbrojtjes Popullore.
4. — Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve, që do të formohet nga bashkimi i Ministrisë së Bujqësisë, Ministrisë së Pyjeve dhe Ministrisë së Grumbullimeve.
5. — Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit, që do të formohet nga bashkimi i Ministrisë së Industrisë, Ministrisë së Minierave dhe Ministrisë së Ndërtimit.
6. — Ministria e Tregëtisë dhe e Komunikacio-

nit, që do të formohet nga bashkimi i Ministrisë së Tregëtisë, Ministrisë së Tregëtisë së Jashtme dhe Ministrisë së Komunikacionit.

7. — Ministria e Arësimit dhe e Kulturës, që do të formohet nga bashkimi i Ministrisë së Arësimit, Komitetit të Kulturës dhe Arteve, Komitetit të Radiodifuzionit dhe Drejtorisë së Poligrafisë.

8. — Ministria e Financave.

9. — Ministria e Drejtësisë.

10. — Ministria e Shëndetësisë, së cilës do t'i bashkohet edhe Komiteti i Kulturës fizike dhe i sporteve.

Pranë Këshillit të Ministrave të jenë:

1. — Komisioni i Planit të Shtetit.

2. — Komisioni i Kontrollit të Shtetit, që do të formohet mbi bazën e Ministrisë së Kontrollit të Shtetit.

Komisioni i Planit të Shtetit dhe Komisioni i Kontrollit të Shtetit të jenë në rang ministrie.

Shokë deputetë,

Duke pasur parasysh misionin që më është besuar si Kryetar i Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë, për të formuar dhe për të paraqitur përpara Kuvendit Popullor, qeverinë e re të Republikës sonë Popullore, unë po ju parashtoj juve për shqyrtim përbërjen e Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë:

— Zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave dhe ministër i punëve të brendshme: shoku Mehmet Shehu.

— Zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave dhe

ministër i bujqësisë dhe i grumbullimeve: shoku Hysni Kapo.

— Ministër i punëve të jashtme: shoku Behar Shtylla.

— Ministër i mbrojtjes popullore: shoku gjeneral-major Beqir Balluku.

— Ministër i industrisë dhe i ndërtimit: shoku Spiro Koleka.

— Ministër i tregëtisë dhe i komunikacionit: shoku Gogo Nushi.

— Ministër i arësimit dhe i kulturës: shoku Bedri Spahiu.

— Ministër i financave: shoku Tuk Jakova.

— Ministër i drejtësisë: shoku Bilbil Klosi.

— Ministër i shëndetësisë: shoku Medar Shtylla.

— Kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit: shoku Koço Theodhosi.

— Kryetar i Komisionit të Kontrollit të Shtetit: shoku Shefqet Peçi.

Shokë deputetë,

Duke i paraqitur për aprovim Kuvendit Popullor, propozimin e përbërjes së Qeverisë të Republikës Popullore të Shqipërisë e quaj për detyrë të deklaroj se qeveria që do të kem nderin të kryesoj, do të ndjekë me besnikëri, pikë për pikë dhe në mënyrë të vazhdueshme e konsekuente politikën e drejtë të ndërtuar nga Partia e Punës e Shqipërisë, si në çështjet e brendshme ashtu edhe në politikën e jashtme.

Këtë politikë të drejtë paqësore dhe ndërtimtare, Partia jonë dhe Qeveria e Republikës Popullore e kanë deklaruar në shumë raste dhe e kanë vënë me sukses në jetë. Kjo politikë është përqaftuar dhe është zbatuar me entuziazëm nga klasa punëtore, nga fshatarësia punonjëse, nga intelektualët popullorë, nga i gjithë populli shqiptar. Populli punonjës i vendit tonë sheh në politikën e drejtë të Partisë dhe të qeverisë, shprehjen më të zjarrtë të aspiratave dhe të dëshirave të tija, të realizuara me sukses në jetë. Partia e Punës e Shqipërisë, udhëheqësja e urtë e popullit shqiptar, pasi çliroi popullin nga robëria e tmerrshme e okupatorëve dhe e feudoborgjezisë tradhëtare, ndërtoi për popullin shqiptar një shtet të lirë, independent dhe sovran. Kjo ishte një fitore nga më të shkëlqyerat që korri populli ynë në saje të heroizmave të tij dhe në saje të ndihmës së Bashkimit Sovjetik.

Populli shqiptar, nën udhëheqjen e Partisë, me një punë plot vetëmohim, ndërtoi në atdheun e tij të lirë, jetën e re dhe të gëzuar; ai zhduku plagët e luftës dhe të së kaluarës së hidhur, ai ngriti pushtetin e vet popullor, ai kreu me sukses reformat e mëdha ekonomike dhe kulture dhe përmirësoi kështu jetën e tij. Në vendin tonë ndërtohen me sukses bazat e socializmit. Në saje të ndihmës së Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore, vendi ynë, ekonomia dhe kultura e tij, kanë bërë hapa të mëdhenj në rrugën e përparimit. Në fushën ekonomike në vendin tonë janë vërtetuar ndryshime rrënjësore. Minierat tona të prapambetura dhe të shkatërruara nga lufta, jo vetëm që janë rindërtuar, por janë zgjeruar, janë pajisur me ma-

teriale dhe me maqineri moderne dhe tani janë në shfrytëzim të plotë. Industria jonë, që në të kaluarën nuk ekzistonte, tani është bërë një realitet dhe një faktor i fuqishëm në jetën ekonomike të vendit. Me dhjetëra e me dhjetëra fabrika, uzina, kombinatë madhështore e nga më modernet, janë ndërtuar në të gjitha anët e Shqipërisë. Kjo industri, krenaria e popullit tonë, është fruti i punës së njerëzve të vendit tonë, i politikës së drejtë dhe tejpamëse të Partisë. Kjo industri e vënë në lëvizje dhe e drejtuar nga klasa jonë punëtore, që udhëheq fatet e vendit, prodhon me rendiment të madh për masat e gjera punonjëse.

Në fushën e bujqësisë janë bërë përpertime të mëdha nga e kaluara për arsye se regjimi popullor i dha fshatarit punonjës tokën, e ndihmon vazhdimisht me kredit agrar, me mjete të mekanizuara, me kafshë e farëra të zgjedhura duke bërë që ai të përmirësojë ekonominë, jetën dhe punën e tij dhe të shfrytëzojë më mirë tokën dhe ndihmën e shtetit për të shtuar dhe për të përmirësuar cilësinë e prodhimeve. Në fushat e atdheut tonë tani punojnë me qindra traktorë dhe maqina të tjera moderne të bujqësisë, fushat s'janë më të braktisura, por në to lulëzon gruri, misri, pambuku, panxhari e shumë bimë të tjera. Në bujqësinë tonë, me guxim dhe pa ndërprerje, po futet agroteknika e përpeluar dhe fshatari ynë përpërimtar, me zell e zbaton atë dhe i sheh përfitimet e mëdha dhe të menjëherëshme.

Në fushën e arësimit dhe të kulturës, vendi ynë në një kohë shumë të shkurtër ka bërë hapa gjigandë.

Arësimi dhe kultura janë bërë të masave të gjera të popullit, të cilat janë të etshme për arësim dhe kulturë dhe tregojnë cilësi të jashtzakonshme në të mësuar dhe në përvetësimin e shkencës, tregojnë talent të rrallë në art, në muzikë etj. Vendi ynë është mbushur me shkolla të çdo lloji, me teknikume, me institute të larta ku mësojnë me dhjetëra mijë djem punëtorësh dhe fshatarësh, të cilët do të aftësohen dhe do të bëhen drejtues të kulturuar dhe të zot.

Kujdesi i Partisë dhe i qeverisë ka qenë dhe do të jetë kurdoherë përmirësimi i vazhdueshëm i jetës së popullit. Në këtë drejtim janë korrur suksese të rëndësishme. Gjendja ekonomike e masave të popullit është përmirësuar dhe çdo ditë përmirësohet, është përmirësuar shëndeti i popullit, janë luftuar me sukses sëmundjet, i është vënë një kujdes i veçantë rritjes së shëndoshë nga çdo pikëpamje e kalamanëve dhe e rinisë sonë heroike.

Partia dhe qeveria i kanë kushtuar kujdes të veçantë edukimit dhe rritjes së klasës sonë punëtore, në mënyrë që ajo të rrojë çdo ditë më mirë dhe të kalitet në punë dhe në luftë për ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Puna është nder. Në vendin tonë nuk ekziston dhe nuk do të ekzistojë kurrë papunësia. Partia dhe qeveria u kanë kushtuar kujdes të veçantë intelektualëve tanë popullorë, artistëve, muzikantëve, skulptorëve, këngëtarëve popullorë, që jeta e tyre të bëhet çdo ditë më e gëzuar. Kjo politikë e drejtë e Partisë dhe e qeverisë ka ngjallur entuziazëm të madh në punonjësit e vendit tonë, të cilëve u është çelënikosur besimi dhe

dashuria ndaj Partisë dhe pushtetit popullor dhe të gjithë të bashkuar, si një trup rreth Partisë dhe qeverisë së tyre, i janë përveshur me vrull punës për realizimin e planit të parë pesëvjeçar të shtetit. Realizimi i planit pesëvjeçar me sukses do të thotë krijimi i mundësive akoma më të mëdha, në drejtimin e mirëqenjes së popullit tonë. Për realizimin me sukses të planit tonë pesëvjeçar do të vënë të gjitha forcat si qeveria edhe gjithë punonjësit e vendit, ashtu siç kanë bërë edhe më parë. Ne jemi të bindur se do të korrin suksese. Qeveria do ta organizojë akoma më mirë punën, do të luftojë me këmbëngulje burokratizmin, do të forcojë akoma më shumë disiplinën e planit që është ligj për të gjithë.

Qeveria e re do t'i vërë si detyrë kryesore vetes, që të marrë të gjitha masat që industria jonë të punojë dhe të prodhojë me kapacitet të plotë të parashikuar për të realizuar planin si në kualitet ashtu edhe në kuantitet, në mënyrë që furnizimi i punonjësve të qytetit dhe të fshatit të bëhet pa ndërprerje në kohën e duhur dhe në sasinë e caktuar. Këtej del një nga detyrat më kryesore që i vihet përpara klasës sonë punëtore, e cila duhet të vërë gjithë zotësinë dhe shkathtësinë e saj dhe t'i japë popullit sa më shumë prodhime të fabrikuara. Populli ynë sot furnizohet me bezen dhe pëlhurën që prodhon Kombinati i tekstileve «Stalin»; brenda vitit ai do të furnizohet dhe me stofa të lehta prej fabrikës së stofave të lehta që është në mbarim e sipër, ai furnizohet me sheqerin e vendit, ai ka këpucët që fabrikon fabrika e vendit dhe një sërë prodhimesh të tjera të çdo lloji që më parë sillleshin nga jashtë. Në industrinë tonë që po zhvillohet çdo ditë, kuadrot tanë po specializohen,

po zotërojnë më mirë teknikën dhe rendimenti në punë ngrihet. Kjo sjell me vete shtimin e prodhimeve të fabrikuar. Kështu populli do të ketë edhe më shumë beze, sheqer, çimento, lëndë ndërtimi, veshmbathje etj. Në këtë drejtim qeveria jonë do të vërë kujdesin e posaçëm që ta forcojë më shumë industrinë tonë ekzistuese, të shfrytëzojë të gjithë kapacitetin e mundshëm të saj, të shfrytëzojë të gjitha burimet e vendit dhe ndihmën e miqve, në mënyrë që popullit t'i shërbehet më mirë dhe më me shumicë.

Në lidhje me furnizimin e popullit dhe sidomos të fshatarësisë, qeveria jonë do t'i forcojë dhe do t'u krijojë mundësi më të mëdha kooperativave të artizanatit që ato të bëhen një ndihmë e mirë e industrisë. Qeveria do të vërë rregulla të forta dhe do të vendosë disiplinë në artizanat, në mënyrë që prodhimet e tij jo vetëm të ndërrojnë kualitetin, por të kushtojnë edhe më pak.

Qeveria jonë do të interesohet veçanërisht për zgjerimin dhe për forcimin e industrisë ushqimore, në mënyrë që populli të furnizohet më mirë me ushqime, me marmelatë, me peshk, me zarzavate të konservuara për stinën e dimrit. Qeveria do të marrë gjithashtu masa të veçanta për të përmirësuar akoma më shumë jetën e punëtorëve, të nëpunësve dhe të të gjithë punonjësve të vendit. Gjithashtu do të shikojë mundësitë që brenda planit të ngadalësojë punimet në ndonjë objekt jo fort të ngutshëm dhe urgjentisht të nevojshëm dhe të investojë më shumë në bujqësi, të ndërtojë më tepër apartamente për punonjësit e qyteteve, më shumë çerdhe fëmijësh, më shumë vende pushimi për punonjësit. Qeveria do t'u krijojë gjithashtu mundësitë punonjësve të

qytetit dhe të fshatit të ndreqin e të ndërtojnë shtëpi, stalla, çezma, duke u vënë në dispozicion më shumë tulla, gëlqere, lëndë druri, çimento, gozhdë etj.

Masat e mësipërme që do të marrë qeveria në favor të klasës punëtore dhe të punonjësve do të kontribuojnë në përmirësimin e mëtejshëm të jetës së tyre, që është qëllimi më i lartë i Partisë dhe i qeverisë së Republikës.

Përsa i përket fshatarësisë, qeveria jonë, e frymëzuar dhe e drejtuar nga Partia, përveç masave të tjera që ajo ka marrë çdo vit, duke e ndihmuar fshatarin me kredit agrar, me kafshë pune, me traktorë etj., duke e ndihmuar me faljen e detyrimeve të prapambetura, është duke studjuar masa të reja në favor të fshatarësisë. Qëllimi i Partisë dhe i qeverisë me masat që do të merren në favor të fshatarësisë është që ta lehtësojnë fshatarin akoma më tepër nga detyrimet, t'i krijojnë atij mundësi akoma më të mëdha, jo vetëm për të larë më lehtë detyrimet ndaj shtetit, por që t'i mbeten fshatarit akoma më tepër teprica për veten e tij dhe për të tregëtuar me kooperativat ose në treg të lirë. Masat në fjalë, do të nxitin fshatarësinë punonjëse të shtojë akoma më shumë prodhimet e saj, të shtojë bagëtinë, kafshët e punës, bletët, ullinjtë, pemët frutore etj.

Partia dhe qeveria do t'i vënë një kujdes akoma më të madh zhvillimit të bujqësisë. Përveç punimeve të mëdha ujitëse që janë kryer deri tani, kanale të tjera, të mëdha dhe të vogla, që janë në planin pesëvjeçar, do të realizohen me sukses. Kjo do të krijojë mundësi akoma më të mëdha për shtimin e drithërave të bukës

e të bimëve industriale, të zarzavateve, të perimeve, të frutave, për zgjerimin e kullotave, për rritjen dhe për shtimin e blegtorisë. Nga ana tjetër Partia dhe qeveria do të krijojnë mundësitë për shtimin e numrit të traktorëve dhe të veglave të tjera bujqësore, do të organizojnë akoma më mirë seleksionimin e farërave etj. Qeveria gjithashtu do të rishikojë uljen e çmimeve të mjaft mjeteve të punës të nevojshme për fshatarët, siç janë parmendat, lesat, kultivatorët etj.

Të gjitha këto masa, ne kemi bindjen e plotë se do ta përmirësojnë akoma më shumë jetën e fshatarësisë sonë dhe do t'i krijojnë asaj mundësi akoma më të mëdha për ta çuar edhe më tej bujqësinë tonë. Kjo do të sjellë si rezultat furnizimin akoma më të mirë dhe më të bollshëm të qyteteve, me prodhime të ndryshme bujqësore. Viti i sivjetëm bujqësor, është një vit i mirë dhe me prodhime të bollshme. Kjo i detyrohet në radhë të parë punës vetëmohuese të fshatarësisë sonë, ndihmës së vazhdueshme të pushtetit popullor dhe drejtimit të mirë të Partisë sonë. Nga ana tjetër konditat klimatike e favorizuan sivjet bujqësinë tonë. Në të gjitha prodhimet bujqësore si në drithëra, ashtu edhe në bimë industriale, parashikohet që rendimentet e planifikuara, jo vetëm të realizohen, por të tejkalohen. Kështu ngjet me blegtorinë, zarzavatet, ullinjët etj. Ky është një sukses i madh për popullin tonë, një sukses tjetër në realizimin e planit tonë pesëvjeçar.

Qeveria, populli dhe veçanërisht fshatarësia jonë, do të vënë forcat për të realizuar me sukses planin e zhvillimit të bujqësisë, planin e ndërtimit të kanaleve dhe të bonifikimeve, do të realizojnë me sukses planin

mbi zhvillimin dhe shtimin e blegtorisë, atë të ullinjve, të agrumeve, të pyllëzimeve etj.

Partia dhe qeveria do të vënë kujdesin më të madh që aleanca në mes klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse, që marrëdhënjet qytet-fshat të forcohen çdo ditë e më shumë dhe shkëmbimet e prodhimeve industriale dhe bujqësore të shtohen dhe të zgjerohen. Për këtë arsye qeveria do të marrë masa rigoroze për organizimin më të shëndoshë të rrjetit tregëtar në qytete dhe në fshatra, do të forcojë organizimin e kooperativave të shitblerjes dhe të konsumit dhe do të inkurajojë tregëtinë e vogël private. Qeveria do të marrë masa të rrepta në bazë të ligjeve në fuqi, veçanërisht kundër atyre punonjësve në sektorin e tregëtisë dhe të kooperativave që bëhen shkaktarë të një furnizimi jo të rregullt, që krijojnë konfuzion dhe burokraci, që s'tregojnë kujdes për mallrat, ose që vjedhin e sabotojnë. Gjithashtu qeveria dhe organet e saj do të godasin rëndë spekulatorët dhe matrapazët që do të tentojnë të shfrytëzojnë punonjësit. Tregëtia e vogël private do të jetë nën kontrollin rigoroz e të vazhdueshëm të shtetit për të evituar çdo abuzim dhe spekulim në dëm të popullit.

Partia dhe qeveria do të vënë si kurdoherë të gjithë kujdesin për edukimin e masave të gjera të popullit me arësim dhe me kulturë; do të perfeksionojnë akoma më shumë rrjetin e shkollave, do ta zgjerojnë akoma atë, do të kujdesen veçanërisht për perfeksionimin sa më të madh të trupit arësimor, do të zhvillojnë edhe më tej rrjetin e kinemave, të teatrove, të operës, të baletit, të muzikës, të folklorit etj.

Partia jonë dhe qeveria e Republikës do të kenë në radhë të parë si detyrë forcimin dhe çelnikosjen e mëtejshme të Ushtrisë sonë Popullore, të Armës së Sigurimit të Shtetit dhe të forcave të kufirit, që përbëjnë mbrojtjen heroike të interesave të larta të atdheut dhe të popullit, të lirisë, të independencës dhe të sovranitetit të Republikës Popullore të Shqipërisë. Ushtria jonë Popullore, që u krijua nga Partia e luftoi me heroizëm për çlirimin e popullit, do të edukohet me traditat heroike të popullit tonë dhe do të modernizohet edhe më tej me artin ushtarak të sprovuar stalinian. Ushtria jonë është dhe do të jetë kurdoherë e gatshme dhe e papërkulur për të mbrojtur në çdo moment që ta lypë nevoja, atdheun, popullin, fitoret e revolucionit popullor. Ushtria jonë, e udhëhequr nga Partia dhe qeveria, do t'i plotësojë, në çdo moment, me nder detyrat e shenjta që i ka besuar populli.

Rojet e kufirit dhe Arma e Sigurimit të Shtetit, të udhëhequra nga Partia dhe nga qeveria, janë si kurdoherë gati, për të kryer në çdo moment detyrat e tyre. Ato mbrojnë dhe do të mbrojnë me vigjilencë kufitë e atdheut, jetën e popullit dhe të shtetit, ato kanë qenë dhe do të jenë shumë vigjilente ndaj armiqve të jashtëm dhe të brendshëm dhe do të jenë të pamëshirshme kundër çdo armiku të hapët e të maskuar që do të tentojë të cënojë punën paqësore dhe interesat jetike të popullit, të atdheut dhe të pushtetit popullor.

Partia dhe qeveria do të vënë kujdesin më të madh për forcimin e mëtejshëm të ligjshmërisë; do të jemi

të pamëshirshëm kundër atyre që bëhen shkaktarë të shkeljes së të drejtave të qytetarëve, të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet në fuqi, do të jemi të rreptë kundër atyre që do të tentojnë të shtrembërojnë dhe t'u dredhojnë ligjeve, kundër atyre që do të tentojnë të interpretojnë ligjet tona revolucionare në frymën borgjeze të shtyrë nga hatëret, nga lidhjet miqësore etj.

Shokë deputetë,

Sigurisht, në punën tonë, dhe këtë gjë ne nuk e fshehim, kemi pasur të meta, gabime dhe lëshime. Jemi përpjekur dhe do të përpiqemi vazhdimisht t'i korrigjojmë dhe t'i ndreqim. Do të vazhdojmë të jemi kurdoherë të rreptë ndaj atyre që bëjnë gabime dhe që dëmtojnë kauzën e përgjithshme të popullit, ose çenojnë interesat e qytetarit. Partia që mbron me vigjilencë interesat e popullit, që ka si ligj të parë kujdesin e veçantë për mirëqenjen e njeriut, për mirëqenjen e të gjithë popullit shqiptar, na mëson vazhdimisht të jemi të zgjuar dhe vigjilentë për të mbrojtur interesat e popullit, të punojmë pa u lodhur, të jemi të thjeshtë, të urtë dhe të matur në vendime, të kryejmë me nder dhe me ndërgjegje detyrën që na ngarkohet, t'i edukojmë njerëzit me durim të madh, t'i kritikojmë dhe t'i ndreqim ata që gabojnë dhe të jemi të pamëshirshëm kundër atyre që gabojnë me qëllime të këqia kundër interesave të popullit. Për ne dhe për gjithë popullin, mësimet e Partisë janë ligje, pse në to pasqyrohet jeta e popullit, mirëqenja e tij,

mbrojtja e interesave të tij. Ne do t'i zbatojmë me përpikëri dhe me besnikërinë më të madhe direktivat e Partisë sonë që udhëheq popullin në rrugën e lavdishme të socializmit.

Politika e drejtë e Partisë e ka mbrojtur dhe e ka kalitur popullin shqiptar, e ka frymëzuar me një patriotizëm të flaktë dhe e ka bashkuar si kurrë ndonjëherë tjetër. Bashkimi i çelniktë i popullit shqiptar është një realitet i pamposhtur. Kjo gjë i detyrohet politikës së drejtë dhe të urtë të Partisë sonë të Punës. Populli shqiptar i bashkuar me mish e me shpirt me Partinë e tij heroike dhe me qeverinë e Republikës, ecën i sigurtë në rrugën e socializmit, ai korr çdo ditë fitore, ai sheh të realizohen njëra pas tjetrës dëshirat e tija.

Këto lidhje kaq të shëndosha, këto lidhje gjaku të Partisë sonë me popullin e vet, janë garancia kryesore e independencës, e lirisë, e sovranitetit të atdheut tonë, janë garancia e ndërtimit të bazave të socializmit në vendin tonë, janë garancia e sigurtë e një të ardhshmeje të lumtur dhe më të begatshme për popullin dhe për brezat e ardhshëm. Prandaj Partia do t'i thellojë dhe do t'i forcojë çdo ditë e më shumë rrënjët në popull, lidhjet me masat dhe populli ynë do ta shtojë dhe do ta çelnikosë çdo ditë e më shumë dashurinë dhe besnikërinë ndaj Partisë. Parti dhe popull në vendin tonë janë një dhe të pandarë. As Partia pa popullin dhe as populli pa Partinë s'mund të kenë jetë. Lidhjet e çelnikta të Partisë me popullin janë kyçi i të gjitha fitoreve, i të gjitha sukseseve. Prandaj populli dhe Partia do t'i ruajnë këto lidhje si sytë e ballit.

Armiqtë e popullit tonë qofshin të brendshmit, qofshin të jashtmit, janë në ankth të madh nga forcimi çdo ditë e më shumë i vendit tonë, i bashkimit të popullit, i ekonomisë popullore, i arësimit, i kulturës, i aftësisë mbrojtëse të vendit. Sukseset e mëdha dhe të vazhdueshme të popullit, u shkurtojnë armiqtë tanë jetën, u prishin çdo plan dhe çdo kala prej karte që ata përpiqen të ndërtojnë. Çdo fitore e popullit tonë është vdekje për ta dhe për t'i shpëtuar kësaj vdekjeje të sigurtë, armiku i brendshëm dhe i jashtëm, përqëndron forcat e tija që i kanë mbetur, për të goditur tërthorazi ose hapët veprën ndërtimtare të popullit tonë. Tradhëtarët shqiptarë të arratisur, që sot rrojnë jashtë si agjentë të imperialistëve amerikano-anglezë dhe të shërbëtorëve të tyre në kufitë tanë, po ëndërrojnë për pallatet e tyre, për çifliqet e mëdha që humbën; ata ëndërrojnë kohërat kur ripnin dhe zhvatnin popullin, duke i pirë gjakun. Këta bejlerë dhe feudalë tradhëtarë, këta matrapazë të lirisë së popullit dhe të atdheut, që tërë jetën e tyre kanë qenë në shërbim të imperialistëve të huaj dhe e kanë shitur atdheun për lireta dhe dollarë, po çirren për gjoja «fatin e keq të Shqipërisë». Populli ynë i njuh mirë kush janë ata katila; ja u njuh mirë të kaluarën e tyre dhe qëllimet e tyre dhe u rezervon ndëshkimin e tmerrshëm që u ka dhënë për krimet e tyre të llahtarshme që kanë bërë dhe që po tentojnë të bëjnë. Imperialistët po i përdorin këta tradhëtarë të atdheut për propagandë dhe si agjentë diversionistë dhe spiunë parashutistë kundër Republikës Popullore të Shqipërisë. Natyrisht, fati i këtyre diversionistëve dhe i spiunëve është i vendosur.

Ata po shfarozen pa mëshirë. Sa për propagandën e ndytë që ata bëjnë përkundrejt dollarëve që marrin, vetë e bëjnë, vetë e dëgjojnë, vetë ngopen me lugë të zbrazët. Populli ynë i shqelmon dhe i përbuz ato ndytësira. Vetë tradhëtarët e dinë se propaganda e tyre e ndytë s'është veçse shpifje e gënjeshtër, vetë ata nuk i besojnë ato që thonë, por përpiqen t'i mbajnë gjallë dhe t'u japin pak shpirt nga jashtë mbeturinave të reaksionit të brendshëm ku i kanë mbështetur shpresat e tyre. Por për fatin e tyre të keq, kalit që ata kanë zgjedhur, i kanë rënë patkonjt dhe i kanë ngelë koskat.

Mbeturinat e reaksionit të brendshëm, që nga ish-ministrat e fashizmit dhe deri te kulakët e fshatit, e dinë mirë sa u vlen lëkura. Këta shpresojnë dhe i luten zotit vetëm për një ndërhyrje të jashtme. Por shpresat e tyre janë të kota dhe kurrë nuk do t'u realizohen.

Megjithatë mbeturinat e reaksionit të brendshëm përpiqen me aq fuqi sa kanë të dëmtojnë interesat e popullit, të vjedhin dhe të lëshojnë vrer ndër skuta. Vigjilenca e popullit duhet të shtohet ndaj tyre dhe populli, Partia dhe organet shtetërore të jenë të pamëshirshëm kundër këtyre armiqve. Këta armiq të mos harrojnë për asnjë minutë se ç'i pret, drejtësia e popullit do të jetë e pamëshirshme ndaj tyre. Dëshirat dhe ëndrrat e tyre prej armiqsh dhe tradhëtarësh të popullit, që ata bluajnë në kokë, u venë në rrezik të madh kokën. Këtë të mos e harrojnë kurrë. Asnjë gjest o vepër e tyre nuk do t'i shpëtojë vigjilencës së madhe të masave të popullit, drejtësisë së Republikës Popullore.

Populli, Partia dhe qeveria e kanë të qartë se ndërtimi i socializmit, ndërtimi i jetës së lumtur për

popullin nuk mund të bëhet pa një luftë të ashpër klasash, pa një luftë kundër armiqve të brendshëm dhe të jashtëm, kundër vjedhësve, sabotatorëve, mashtruesve, kundër mbeturinave mikroborgjeze në ndërgegjen e njerëzve. Populli shqiptar dhe udhëheqja e tij monolite nuk harrojnë për asnjë çast, rrethimin kapitalist dhe derisa të ekzistojë ky rrethim kapitalist, imperia-listët dhe satelitët e tyre do të vazhdojnë pa ndërprerje përpjekjet e tyre, për të dërguar në vendin tonë agjentë sabotatorë dhe spiunë për të dëmtuar interesat e popullit tonë; ata do të bëjnë përpjekje të shumta, për të futur në radhët e Partisë dhe të organeve të pushtetit agjentët e tyre për të dëmtuar nga brenda.

Prandaj armët duhet të mbahen kurdoherë të mprehta. Të shumëfishohet vigjilenca e popullit, e klasës punëtore, e fshatarësisë, e intelektualëve patriotë, të goditen armiqtë e fshehtë ose të hapët pa asnjë mëshirë, të demaskohet veprimtaria e tyre armiqësore. Të ruhen të pastra radhët e Partisë dhe të organeve shtetërore, pse vetëm kështu do të mbrohen me sukses fitoret e popullit, Republika Popullore, liria dhe pavarësia e atdheut.

Këtë politikë do të zbatojë qeveria që kam nderin të kryesoj në lëmin e brendshëm dhe ne jemi më se të bindur se kjo politikë e drejtë, do të mbështetet dhe do të përkrahët me entuziazmin më të madh nga klasa jonë punëtore, nga fshatarësia punonjëse, nga intelektualët patriotë, nga i gjithë populli shqiptar.

Në lëmin e politikës së jashtme, qeveria jonë do të vazhdojë të zbatojë me përpikëri dhe me besnikërinë më të madhe vijën e përpunuar nga Partia jonë e Punës.

Populli shqiptar është i lidhur me një miqësi të ngushtë dhe të sinqertë me popujt e Bashkimit Sovjetik e të vendeve të demokracisë popullore, të cilët na ndihmojnë në ngritjen e ekonomisë sonë, në forcimin e gjithanshëm të Republikës Popullore. Populli shqiptar, Partia dhe qeveria e tij do ta forcojnë çdo ditë e më shumë këtë miqësi dhe aleancë.

Populli shqiptar bën pjesë në kampin e fuqishëm të demokracisë, të socializmit dhe të paqes, që udhëhiqet nga Bashkimi Sovjetik. Ky kamp është bërë një forcë e madhe dhe bën të dështojnë njëra pas tjetrës të gjitha tentativat e blokut luftënxitës imperialist, i cili, për të shpëtuar nga kriza e madhe që e bren përbrenda dhe për të dalë nga kontradiktat e mëdha që ata kanë në mes tyre, përpiqet të hedhë përsëri botën në zjarrin e një lufte tjetër. Imperialistët dhe shërbëtorët e tyre në ethe po përgatiten për luftë, ata bëjnë tentativa të dëshpëruara për të krijuar incidente dhe turbullira siç organizuan në Berlin, ose provokacione të vazhdueshme në kufitë e shteteve paqedashëse. Por të gjitha këto tentativa u dështojnë dhe demaskojnë fytyrën dhe qëllimet e vërteta të tyre.

Popujt e të gjithë botës e urrejnë luftën, pse ajo u sjell përfitime vetëm milionerëve dhe miliarderëve, kurse popujve u shkakton rrënime, vuajtje dhe gjakderdhje. Popujt duan paqen dhe luftojnë me të gjitha forcat për ta mbrojtur atë.

Kampi i paqes dhe i socializmit këto ditët e fundit korri një fitore të madhe. Armëpushimi në Kore u nënshkrua. Për më shumë se tre vjet luftoi me heroizëm të shquar populli i lavdishëm i Koresë, ai u sulmua

barbarisht nga imperialistët amerikanë, anglezë dhe satelitët e tyre, por shkelësit nuk mundën kurrë ta mposhtin popullin vëlla korean që luftoi dhe mbrojti aq trimërisht atdheun e tij dhe paqen në botë.

Fundi i aventurës së tmerrshme të imperialistëve amerikanë dhe shokëve të tyre në Kore, ishte i hidhur për luftënxitësit imperialistë. Këta pësuan një disfatë të turpshme, këta nuk mundën dot as me barbarizmat, as me superioritetin dërmues në armatime dhe në njerëz, të mposhtin vullnetin e një populli që do të rrojë në paqe, i lirë dhe sovran. Populli shqiptar me gjithë shpirt i uron popullit vëlla korean, fitoren e shkëlqyer, i uron rindërtimin e shpejtë të atdheut të tij dhe e siguron atë se te populli shqiptar ai ka një nga miqtë e tij më të afërt dhe më besnikë.

Populli shqiptar, i cili ka vuajtur shumë nga luftërat imperialiste, nuk mund të mos ta ndjejë thellë vlerën e madhe që ka për të paqja e drejtë dhe e vazhdueshme. Janë këto arsëyet dhe esenca e regjimit paqësor të demokracisë popullore, që e bëjnë popullin tonë ta dojë dhe ta mbrojë me të gjitha forcat e tija paqen. Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore, kanë ndjekur dhe ndjekin me vazhdimësi dhe me konsekuencë një politikë të drejtë paqësore.

Republika Popullore e Shqipërisë, në të gjithë jetën e saj 9-vjeçare, ka dhënë me mijëra prova të pjekurisë së popullit shqiptar, të vendosmërisë më të madhe për të mbrojtur vendimet e drejta dhe normat diplomatike ndërkombëtare, ka evituar dhe nuk i ka lejuar kurrë vetes të bëhet shkak për mosmarrëveshje dhe keqkuptime në lëmin ndërkombëtar, ka mbrojtur me heroizëm

dhe me sukses të gjitha të drejtat e popullit të vet dhe të popujve të tjerë, si pjesëtare e kampit të socializmit dhe të paqes. Kauza e drejtë e popullit tonë ka triumfuar kurdoherë përpara rreziqeve dhe manevrave djallëzore të shumta që i ngriheshin në rrugë Republikës Popullore të Shqipërisë. Këto rreziqe, kërcënime e provokacione, njihen prej popullit tonë dhe gjithë popujve të botës, njihen gjithashtu dhe autorët: imperialistët amerikanë, anglezë dhe satelitët e tyre. Janë të njohura gjithashtu edhe qëllimet përse bëhen këto veprime armiqësore ndaj popullit dhe vendit tonë.

Ata që nuk ja kanë dashur dhe s'ja duan kurrë të mirën popullit tonë, përpiqen që popullin shqiptar ta robërojnë si në të kaluarën, ta coptojnë si në të kaluarën atdheun tonë dhe të sjellin përsëri në fuqi gjakpirësit, feudalët dhe tradhëtarët e shitur. Natyrisht që të mundin t'i realizojnë këto qëllime të errëta, ata janë përpjekur dhe përpiqen me çdo mjet ta dëmtojnë Republikën tonë Popullore dhe kështu të krijojnë shkaqe për ta paraqitur vendin tonë sikur gjoja turbullon ujërat në Ballkan. Këto pretendime janë pa baza dhe qesharake dhe s'ka asnjëri në botë që t'i besojë. Populli shqiptar dhe qeveria e tij, kurdoherë kanë qenë dhe do të jenë shumë vigjilentë ndaj veprimeve të tilla armiqësore dhe si një mur i çelniktë, i patrembur dhe i papërkulur, i udhëhequr nga Partia e tij e Punës dhe qeveria e Republikës, ai do të vazhdojë rrugën e drejtë dhe paqësore dhe me qëndrimet e tij të drejta dhe të vendosura, do të bëjë si kurdoherë të dështojnë të gjitha veprimet e armiqve të jashtëm dhe të brendshëm.

Imperialistët amerikanë, anglezë dhe satelitët e tyre,

rreth kufive të vendit tonë, me veprimet politike në arenën ndërkombëtare dhe me provokacionet dhe qëndrimet armiqësore të panumërta ndaj vendit tonë u kanë dhënë popujve të botës mbarë, prova konkrete se nuk është Republika Popullore e Shqipërisë fajtoare. Përkundrazi asaj po i bien në qafë me qëllime të pararenduara. Por përpara dështimit të politikës së tyre të forcës, të frikësimeve dhe të provokacioneve, imperialistët amerikanë, anglezë dhe miqtë e tyre, qeveritarët e Beogradit, të Athinës dhe të Ankarasë, vërtetuan edhe një herë përpara opinionit ndërkombëtar, qëllimet e tyre agresive dhe jopaqësore, me të ashtuquajturin Traktatin e Miqësisë¹, që u nënshkrua në Ankara në mes Greqisë, Jugosllavisë dhe Turqisë. Bloku agresiv ballkanik u formua pas dështimit skandaloz të krijimit të blokut të Lindjes së Mesme. Bloku agresiv ballkanik është një pjesë e blokut famëkeq të Atlantikut, është një filiale e tij dhe ky blok natyrisht, i hap rrugën Jugosllavisë të hyjë në blokun e Atlantikut Verior. Bloku agresiv ballkanik, me gjithë kontradiktat që ekzistojnë në mes të pjesëtarëve të tij dhe Italisë, i drejton shigjetat e tija kryesore veçanërisht kundër Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të Bullgarisë. Ky «traktat miqësie» i nënshkruar në Ankara nuk përbën, pra, aspak një faktor «paqeje» në Ballkan, siç pretendojnë autorët e tij, por është një instrument luftënxitës në duart e imperialistëve amerikanë e anglezë.

Në vijim të Traktatit të Ankarasë, në fillim të muajit korrik të këtij viti u mbajt në Athinë Konferenca

¹ Ky traktat u nënshkrua më 28 shkurt 1953.

e Ministrave të Jashtëm të Jugosllavisë, të Greqisë dhe të Turqisë. Komunikata zyrtare e lëshuar nga Konferenca e Athinës, në mes të tjerave thotë se ministrat e jashtëm të Greqisë, të Jugosllavisë dhe të Turqisë,

«... arritën veçanërisht në marrëveshje se pavarësia e Shqipërisë përbën një element të rëndësishëm për paqen dhe stabilitetin në Ballkan».

Për çfarë «independence të Shqipërisë» bëjnë fjalë autorët e Konferencës së Athinës? Çfarë është kjo «independencë» që kaq shumë i preokupon këto shtete gjoja paqësore që u mbledhën në Athinë dhe diskutojnë mbi «fatin» e një shteti të lirë, independent dhe sovran?

Populli shqiptar, luftoi me heroizëm, atij ju vranë me dhjetëra mijëra nga djemtë dhe vajzat e tij më të mirë, ai u dogj e u bë shkrumb, pikërisht për të shqelmuar përgjithmonë atë farë «independence», për të cilën bëjnë fjalë autorët e Konferencës së Athinës. Dhe populli ynë e shqelmoi përgjithmonë atë farë «independence» që ishte independence për feudalët, për bejlerët dhe për borgjezinë grabitqare e gjakpirëse në shërbim të armiqve të jashtëm të atdheut dhe skllavëri, varfërim dhe mjerim për popullin shqiptar.

Populli shqiptar me gjak, me luftë e me djersë vendosi regjimin e tij popullor dhe e bëri atdheun dhe veten e tij të lirë, independent dhe sovran. S'ka propagandë shpifarake që ta gënjejë popullin tonë, s'ka forcë që ta shmangë popullin tonë nga rruga e lirisë dhe e independencës së vërtetë që ai e ka farkëtuar vetë.

Fakti është se pjesëmarrësve të kësaj konference nuk u pëlqen të shohin një Shqipëri të lirë, independente, sovrane dhe demokratike popullore, nuk u pëlqen

që populli ynë heroik të ndërtojë me sukses socializmin. Ku e kanë gjetur të drejtën këto shtete të vetëquajtura «paqësore» të ndërhyjnë në punët e brendshme të një shteti tjetër sovran? Por kjo s'do shumë mend për ta kuptuar. Ata kërkojnë të frikësojnë popullin tonë, ata përpiqen ta gënjejnë dhe në qoftë se krijojnë mundësitë, të dëmtojnë interesat e popullit dhe të Republikës sonë Popullore. Por ata që kanë këto qëllime dhe që ëndërrrojnë të tilla gjëra, gabohen rëndë. Populli shqiptar dhe Republika Popullore e Shqipërisë janë të pamposhtur, të pafrikësueshëm dhe të pacënueshëm. Republika Popullore e Shqipërisë dhe populli shqiptar, rrojnë dhe do të rrojnë në shekuj të lirë, independentë dhe sovranë. Populli shqiptar nuk ka qenë dhe nuk do të jetë kurrë i izoluar, ai është i lidhur me miqësi të madhe me popujt e Bashkimit Sovjetik, me të gjitha vendet e kampit të socializmit dhe të paqes, dhe i sigurtë në të ardhshmen e tij të lumtur, ai po ecën kryelartë në rrugën e ndritur të socializmit. Populli ynë ka parë shumë dallgë dhe furtuna në jetë dhe këto nuk e kanë frikësuar dhe përkulur kurrë, por u ka bërë ballë dhe ka dalë i fortë si çeliku. Populli shqiptar do ta shumëfishojë vigjilencën dhe kurrë nuk do të kapet në befasi, nga ata që kanë në gjak aventurat, rrenat dhe shpifjet.

Konferenca e Athinës tregon qartë jo qëllime të vërteta për «paqe» dhe «stabilitet në Ballkan» siç pretendojnë qeveritarët e Beogradit, të Athinës dhe të Ankarasë, por qëllime agresive ndaj vendit tonë, ndaj popullit bullgar dhe paqes në Ballkan dhe në botë. As

populli ynë, as bota përparimtare nuk gënjehen dot kollaj nga fjalët demagogjike të pjesëmarrësve të Konferencës së Athinës.

Populli shqiptar dhe qeveria e tij, duke ndjekur me besnikëri mësimet e Partisë së Punës të Shqipërisë, kanë genë dhe janë kurdoherë për marrëdhënje normale me të gjitha shtetet si edhe me shtetet fqinje në rast se ato respektojnë lirinë, independencën dhe sovranitetin e atdheut tonë, në rast se ato respektojnë të drejtat dhe liritë e popullit tonë, heqin dorë nga intrigat dhe pretendimet e çmendura të tyre dhe ndalojnë provokacionet e pareshtura në kufitë e atdheut tonë.

Në rast se këto marrëdhënje normale fqinjësie të dëshiruara me disa fqinj nuk ekzistojnë, gjithë bota e di se s'është për fajin e popullit shqiptar dhe të qeverisë së tij. Qeveria jonë, do të jetë e gatshme si kurdoherë, të kontribuojë me të gjitha mundësitë për normalizimin e marrëdhënjeve të fqinjësisë me cilindo shtet në rast se ky, sinqerisht dëshiron të ketë marrëdhënje të këtilla.

Ne jemi të bindur se vetëm kështu i shërbehet kauzës së paqes dhe kauzës së popullit që për t'i mbrojtur, qeveria jonë do të luftojë me të gjitha fuqitë e saja. Rruga jonë është e drejtë, me ne janë të gjithë popujt e botës. Mirëqenja e popullit, paqja, independenca dhe liria e atdheut, paprekshmëria e kufive të atdheut janë gjërat më të shenjta që mund të ketë në botë. Ky është amaneti i gjithë popullit dhe i qindra e mijëra dëshmorëve që dhanë jetën, në të kaluarën dhe në kohën e sotme për lirinë e popullit dhe për vendosjen e regjimit popullor në vendin tonë. Këtë amanet ne do ta

ruajmë si sytë e ballit, pse kështu na edukon dhe na mëson të punojmë dhe të luftojmë Partia, udhëheqëse e dashur dhe besnike e popullit shqiptar.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 184 (1510), 2 gusht 1953

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**PUNA ME KUADRIN NË USHTRI NUK ËSHTË
VETËM VENDOSJA NË DETYRA E OFICERËVE
APO E NËNOFICERËVE, POR ËSHTË NJË PUNË
E TËRË SHKENCORE**

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

7 shtator 1953

Përveç vërejtjeve që bënë shokët në diskutimet e tyre, unë mendoj të them se Drejtoria politike duhet të ndërrojë metodën e punës së vet me kuadrin dhe të tregojë një kujdes më të madh në këtë drejtim. Më duket se interesimi i saj është shumë më tepër për mbarëvajtjen e formave të edukimit ideo-politik të ushtrisë, se sa për vetë kuadrot që duhet ta marrin këtë edukatë ideo-politike. Edhe format e edukimit kanë rëndësi jashtëzakonisht të madhe për edukimin moral dhe politik të oficerëve, që ata të bëhen më të aftë, më të

¹ Në këtë mbledhje të Byrosë Politike të KQ të PPSH, u diskutua rreth raportit të paraqitur nga Ministria e Mbrojtjes Popullore «Mbi punën që zhvillohet me kuadrin oficer të ushtrisë».

zot e më të vendosur për çështjet e ushtrisë dhe të Partisë, por kjo nuk do të thotë që duke u marrë me format, të mos tregojmë kujdesin e duhur për kuadrin.

Format që ka vendosur Partia për të kontrolluar e për të ndihmuar kuadrin në punë e sipër dhe në jetën e gjallë nuk po zbatohen si duhet. Kam përshtypjen se instruktorët e Drejtorisë politike, kur shkojnë në re-parte, pak interesohen e të studiojnë në jetë, në punë e sipër e në kartotekat e Partisë karakteristikat e kuadrove, të shohin anët politike e morale, vetitë e mira apo veset e këqia të karakterit, sukseset dhe të metat në zbatimin e detyrave duke arritur, sipas rastit, edhe në punë individuale me kuadrot, për t'i këshilluar e për t'i bindur ata për mungesat që kanë, për kërkesat dhe për zgjidhjen e problemeve që shtrohen para tyre.

Raportet që më vijnë edhe mua nga ana e Drejtorisë politike, janë të përgjithshme, në to nuk trajtohet konkretisht se si punohet me kuadrin. Shokët që venë në bazë, duhet t'i njohin njerëzit jo vetëm në konferenca, po të interesohen veç e veç, një për një, e po qe nevoja me kuadrin e Partisë të rrinë disa ditë për të parë se ç'përparime ka bërë secili në punë, si ta ndihmojnë që të ecë akoma më përpara. Është e domosdoshme që një gjë të tillë ta bëjë Drejtoria politike dhe e gjithë Partia. Të mos i lëmë kuadrot që të bëjnë gabime njëri pas tjetrit dhe pastaj të vijë një ditë që t'i ndëshkojmë ose t'i shkarkojmë nga puna. Parimi është sa më pak dënime, po që të arrihet kjo, njerëzve u duhet qëndruar sa më afër. Komisionet e Partisë duhet të ngrihen në nivelin e duhur, të mësohen si të punojnë, si të sillen e si t'i këshillojnë kuadrot, si t'u heqin

vërejtjen etj. Duhet mësuar ato se si të përvetësojnë vazhdimisht e me këmbëngulje marksizëm-leninizmin.

Përveç kësaj, Drejtoria politike duhet të bashkëpunojë ngushtë me Drejtorinë e kuadrit, së cilës i dërgohen karakteristikat vjetore për çdo kuadër. Prandaj, ju, shokët e Drejtorisë së kuadrit, duhet t'i futeni një punë metodike e të studjuar dhe së bashku me Drejtorinë politike të nxirrni konkluzione për të përmirësuar punën për kalitjen politike dhe ideologjike të kuadrove, për edukimin e tyre me cilësitë komuniste. Ky studim është i domosdoshëm, pse puna me kuadrin nuk është vendosja këtu ose aty e njerëzve, por është një punë e tërë shkencore, është një veprimtari e përditshme e të gjithë Partisë, e organeve të saj, që duhet ta ndjekin çdo njeri në punë dhe ta ndihmojnë deri në fund për kryerjen e plotë të detyrave. Prandaj Drejtoria politike në bashkëpunim me Drejtorinë e kuadrit të bëjnë studime e të nxjerrin konkluzione e detyra për repartet dhe për njësitë ushtarake, për çdo kuadër veç e veç. Kjo të bëhet si në rrugë partie, ashtu dhe në rrugë shtetërore, komande. Pra, puna e kujdesshme e me shumë përgjegjësi për ngritjen e vazhdueshme të nivelit ideo-politik, psikologjik, pedagogjik, organizativ e ushtarako-profesional të kuadrit, është një detyrë themelore e organizatave të Partisë, e çdo komunisti në ushtri, e kolektivave të shtabeve e komandave eprore për kuadrin që kanë në vartësi të tyre. E gjithë kjo punë duhet të ndërtohet në përshtatje me kërkesat e zhvillimit të gjithanshëm të vendit. Për rritjen e aftësive të kuadrit, është e domosdoshme që kolektivat e shtabeve e të komandave në ushtri, të luftojnë më me

këmbëngulje për të krijuar kushte të mira pune për kuadrot dhe t'u japin atyre kurdoherë ndihmë konkrete në çdo drejtim që kanë nevojë.

Problemi i kuadrit në ushtri ka rëndësi të veçantë. Në radhët e ushtrisë ne kemi kuadro të mirë, të cilët duhet t'i ruajmë gjithmonë, kështu siç janë, të pastër. Çdo kuadër të ndjekë me besnikëri e deri në fund rrugën e Partisë, të ecë kurdoherë përpara. Presioni i armikut vazhdon të ekzistojë, prandaj përpjekjet tona duhet të jenë të tilla që asnjëri të mos shkelë në dërrasë të kalbur. Pse të vejë, për shembull një oficer i ushtrisë sonë e të martohet me një grua që rrjedh nga një familje reaksionare? Nuk është në interes të Partisë, që një njeri, i cili ka arritur të luftojë edhe kundër të afërmeve të tij me qëndrim të keq politik, të bjerë vetë në pozita të padëshiruara derisa të pajtohet me armikun e klasës. Prandaj organizatat e Partisë dhe komandat në ushtri të zhvillojnë një punë të vazhdueshme edukative me kuadrot, me qëllim që të mos njolloset figura moralo-politike e tyre.

Kur flasim për pastërtinë e kuadrove edhe në ushtri, duhet të kemi parasysh që të ruajmë edhe nga disa qëndrime ekstremiste e sektare. Nuk është e drejtë që, për ndonjë kuadër që e ka gjithë jetën e tij të shkëlqyer të flitet keq duke thënë se ai «ka kleçka» pse një xhaxha i tij ka qenë ballist. Është ndryshe kur shohim se një komunist lëkundet, pse një pjesëtar i familjes së tij ka qenë ballist, po edhe këtë ne duhet ta ndihmojmë, ta shëndoshim, ta forcojmë moralisht dhe politikisht, të punohet me të që të jetë i vendosur të vazhdojë deri në fund në rrugën e Partisë. Kjo të mos

quhet vetëm si detyrë speciale e organeve politike, po një detyrë e madhe për të gjithë Partinë. Në këtë mënyrë mund t'i shpëtojmë kuadrot nga presioni i borgjezisë, i armiqve të jashtëm dhe të brendshëm, propaganda e të cilëve është shumë e madhe dhe synon në radhë të parë në Parti, në ushtri dhe në efektivin e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Prandaj duhet të mprehet gjithnjë vigjilenca revolucionare.

Për kuadrot e rinj duhet të tregojmë kujdes shumë të madh, pse pa ata nuk mund të përparojë as ushtria dhe as shteti ynë, po kjo nuk do të thotë të nënvleftësohen kuadrot e vjetër të ushtrisë, të cilët bënë luftën dhe kanë një avantazh të madh, kanë eksperiencën e luftës, që është një gjë shumë e madhe. Në rast se nuk do ta kishim kombinuar punën e kuadrove të vjetër e të rinj, ushtria jonë nuk do që aq e fortë, sa është tani. Megjithkëtë, ne duhet t'i kërkojmë dhe do t'i kërkojmë vetes gjithnjë e më shumë për forcimin e punës si me kuadrot e vjetër ashtu dhe me ata që janë të rinj. Prandaj, të përgatiten në shkolla të larta, në radhë të parë oficerët që bënë Luftën nacional-çlirimtare. Kjo nuk do të thotë të mos dërgohen në shkolla ushtarake edhe oficerë me stazh të ri, po fjala është që të preferohen në radhë të parë oficerët që kanë dalë nga lufta, të cilëve u mungon shkolla dhe kanë nevojë të mësojnë dhe të ecin përpara, të ngrenë aftësitë politiko-ushtarake dhe të punojnë e të drejtojnë mirë. Me kthimin e tyre do të edukohen si duhet edhe oficerët e rinj, të cilët me siguri, në rast nevojë, do të jenë në gjendje të përtërijnë në një shkallë më të lartë veprën e brezit që kreu Luftën nacional-çlirimtare. Në zgjedhjen dhe

në përgatitjen e kuadrove të rinj për ushtrinë dhe për organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, të ndiqet me rigorozitet parimi i përbërjes së shëndoshë klasore, me qëllim që këto armë të diktaturës së proletariatit të jenë kurdoherë në lartësinë e detyrave të tyre për mbrojtjen dhe për konsolidimin e fitoreve të arritura nga populli ynë. Të mbahet parasysh gjithashtu furnizimi i vazhdueshëm i ushtrisë me kuadro të rinj si nga fshati e qyteti, ashtu dhe nga të gjitha krahinat e vendit tonë.

Në përfundim, unë dëshiroj të theksoj që të tregohet një kujdes i veçantë për oficerët e nxjerrë në lirim. Ata të mbahen më afër nga komandat e njësive dhe të reparteve të ushtrisë, të aktivizohen prej tyre si për edukimin ideo-politik e patriotik të efektivit të ushtrisë, ashtu dhe si mësues të popullit për çështje ushtarake. Konkretisht propozoj që Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria administrative e KQ ta paraqesin për shqyrtim këtë problem në Byronë Politike ose në Sekretariat-in e KQ të Partisë. Në raportin që do të na paraqitet, të na thuhet veçanërisht se në ç'punë janë vendosur oficerët e çmobilizuar. Të na thuhet se cilët janë në punë dhe cilët janë pa punë dhe si duhet vepruar në të ardhshmen me këta shokë, që përbëjnë një rezervë të madhe e të rëndësishme për ushtrinë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

MBI DISA TË META DHE GABIME SERIOZE TË PANAJOT PLAKUT¹

12 shtator 1953

Të kam thirrur që të të bëj disa vërejtje. Ti je anëtar i Komitetit Qendror të Partisë dhe nuk na vjen mirë të jesh i çrregullt. Por, më parë dua të dëgjoj pse nuk ecën puna në sektorin ku ti drejton, që të mund të spastrohesh nga të metat dhe nga gabimet, gjë që është në interesin e Partisë dhe të ushtrisë.

Pasi dëgjoji shokët Petrit Dume² e Sadik Bekteshi³ që ishin të pranishëm në këtë bisedë dhe pasi dëgjoji Panajot Plakun e i bëri atij disa ndërhyrje për ta ndihmuar, në fund shoku Enver Hoxha tha:

¹ Shoku Enver Hoxha, thirri në zyrat e aparatit të KQ të PPSH Panajot Plakun, për disa dobësi e të meta serioze që vëreheshin në karakterin dhe në punën e tij. Koha provoi se Panajot Plaku ishte një armik i maskuar i Partisë dhe i popullit, tradhëtar i atdheut, veprimtaria e të cilit u zbulua më vonë, kur ai u arratis në Jugosllavi.

² Atëhere ishte zëvendëseshf i Shtatmadhorisë së Ushtrisë Popullore.

³ Në atë kohë ishte drejtor i Drejtorisë politike dhe përgjegjës për punën e Partisë në Ministrinë e Mbrojtjes Popullore.

«Shumë thjesht i shpjegon çështjet ti, Panajot. Sipas mendimit tënd, e ke kryer mirë detyrën në ushtri. Kurse në fakt nuk është kështu. Të metat që vihen re në punën tënde, ti duhet t'i luftosh tërë jetën. Por, në radhë të parë, duhet të tregosh kujdes të madh që të kuptosh se cilat janë këto të meta e dobësi si dhe shkaqet që i kanë lindur ato, pse kështu do të mund të luftosh çdo ditë dhe çdo minutë kundër tyre, ndryshe nuk ecën dot përpara.

Mua më duket se shoku Petrit Dume ka të drejtë të jetë ekzigjent në kërkesat që bën për zbatimin e rregullit e të disiplinës ushtarake, të cilat ti, Panajot, jo vetëm nuk duhet t'i shkelësh, por të jesh shembull e të ndihmosh edhe të tjerët. Ti duhet që të mos jesh i çrregullt dhe anarkist, dobësi këto që i ke pasur edhe më përpara dhe për të cilat je kritikuar, por të zhvillosh kurdoherë një luftë të madhe dhe të rreptë deri në zhdukjen e mbeturinave të tyre.

Ti duhet të kesh të qartë se në ushtri urdhërat nuk diskutohen. Para se të jepet një urdhër, bisedo me shokët, jep mendimin tënd, vendosni bashkërisht sa të jetë e mundur me mendime unanime, po kur ka edhe kundërshtime, atëhere vendos eprori, ky jep urdhër për zbatimin e të cilit s'ka asnjë diskutim. Eprori është epror dhe urdhërat e tij janë ligj. Ti vërtet je drejtor, por në Ministri ka shokë me përgjegjësi më të lartë, të cilët i ka vendosur Partia, prandaj urdhërat e tyre duhen zbatuar. Ke mbaruar shkollë, por kjo nuk do të thotë që të mos bësh si të thotë ai që është në një detyrë më të lartë se ti. Të mos të të rritet mendja se ke kryer një shkollë dhe tani di gjithshka. Sa më shumë të më-

sosh, aq më tepër duhet të kërkosh për të mësuar përsëri. Shkolla që ke mbaruar duhet të të shtyjë që të zhvillohesh më tej dhe jo të jesh mendjemadh duke menduar se «unë i di të gjitha». Pikëpamje të tilla, që nuk i lufton me forcë, të bëjnë t'i harrosh këto mësimet të Partisë.

Çrregullimet në punë, mungesa e ndjenjës së rregullit ushtarak duket qartë në qëndrimet e tua të herëpashershme. Ti arrin deri atje sa të shkosh në mbledhje të oficerëve pa qenë i veshur me uniformë ushtarake sipas rregullores e, megjithëse të bëhet vërejtje dhe të jepet urdhër, kjo s'të bën aspak përshtypje. Ike gjoja për t'u veshur dhe nuk u ktheve përsëri në mbledhje. Në rast se t'u tërhoq vërejtje, ti nuk duhet të ikje i inatosur, po të shkoje menjëherë për t'u veshur si një ushtarak i rregullt e të paraqiteshe në mbledhje si gjithë të tjerët. Po ti nuk veproje kështu, përkundrazi, ike e u mbylle në zyrë dhe në këtë gjendje bluaje gjithshka në mendjen tënde. Këto nuk janë qëndrime të mira dhe, nga ana ushtarake janë të dënueshme. Në çështjet ushtarake urdhërat e eprorëve zbatohen dhe po të ketë ndonjë që s'është i drejtë, secili mund ta kërkojë këtë duke ardhur edhe te unë si Komandanti Suprem dhe unë do të them pikëpamjen time se në ushtri urdhërat duhen zbatuar me rigorozitet. Në rast se kërkon të bisedojmë në rrugë partie, atëhere unë si Sekretar i Përgjithshëm do të jap mendimin tim, për të cilin po të mos jesh dakord, mund ta diskutojmë edhe në Komitetin Qendror ku nuk ka grada dhe tituj, por të gjithë jemi barabar. Prandaj këto gjëra duhet të jenë të qarta mirë te ti dhe te të gjithë shokët e ushtrisë.

Në rast se nuk kishe kostum të rregullt ushtarak mund t'i kërkoje komandës të të ndihmonte duke të dhënë uniformën e duhur që ti të ishte i veshur si shokët. Ku është parë që në radhët e një grupi ushtarakësh, bile oficerë e kuadro me përgjegjësi, të ketë edhe një që të vishet si të dojë? Po këto gjëra ndodhin te ti, pse je një tip i çrregullt dhe as mendon ndonjëherë për rregullin, sidomos në ushtri, ku njeriu duhet të jetë kudo dhe kurdoherë i përpiktë. Ndoshta ti ke menduar «punë e madhe, vete në mbledhje edhe i veshur ndryshe nga të tjerët», po ai tjetri ka të drejtë dhe detyrë të të kërkojë llogari, pse është eprori yt dhe do që të vendoset rregulli ushtarak, ndryshe po të bëhen lëshime, atëhere ku vete ushtria jonë? Këtë ti duhet ta kuptosh mirë, kritikën ta konsiderosh ndihmë dhe jo të prekesh prej saj. S'ke të drejtë kur ankohesh se je kritikuar përpara një shoku, që s'është anëtar i Komitetit Qendror të Partisë, pse edhe ai është kuadër i lartë i ushtrisë dhe do të nxjerrë mësimë e do të mendojë se sa i fortë duhet të jetë rregulli ushtarak; ai do të mendojë gjithashtu se këtu nuk të pyesin se je gjeneral ose anëtar i KQ, por kur s'je në rregull, të kritikojnë. Ty mund të të bëhen vërejtje pavarësisht se je anëtar i Komitetit Qendror të Partisë, pse këtu ka rang ushtarak. Prandaj më duket se nuk është vepruar keq që të është bërë kritikë edhe veç, edhe në sy të shokëve, por kritikën ti nuk e ke pranuar, pse ke akoma mbeturina të theksuara, që nuk të lejojnë të zbatosh si duhet rregullin dhe disiplinën ushtarake, bile këto mbeturina të shtyjnë të biesh nga gabimi në gabim.

Ti e di se zbatimi i disiplinës ushtarake ka të bëjë

me vijën e Partisë, ti je anëtar i Komitetit Qendror dhe e di mirë se në ushtri duhet të ketë një disiplinë të hekurt, prandaj duhet të mendosh në radhë të parë si njeri partie duke zbatuar më së miri rregullat dhe disiplinën ushtarake. Qëndrimet e tua të çrregullta, duhet me i analizue mirë, të nxjerrësh mësim dhe të ndreqesh, pse je një kuadër i luftës dhe Partia kuadrot e luftës nuk i hedh poshtë, por i ndihmon deri në fund që të korrigjohen prandaj edhe ti vetë, duhet të bësh luftë dhe përpjekje që t'i zhdukësh medoemos të metat dhe dobësitë e tua.

Dua të vë në dukje edhe një çështje tjetër, e cila ka rëndësi të veçantë. Qëndrimi yt me shokët sovjetikë nuk është aspak i mirë. Fakti është se këshilltari yt ka ankesa për ty. Me sa duket ti nuk shfrytëzon në maksimum kapacitetet dhe eksperiencën e pasur të këshilltarëve sovjetikë, gjë që duhet ta bësh me thjeshtësi e me dashuri prej komunisti, me respektin e plotë që ne kemi ndaj shokëve sovjetikë, të cilët na janë dërguar me kohë që të na ndihmojnë. Shokët sovjetikë ne i respektojmë edhe në punë, edhe jashtë punës, kurse ti nuk e mban si duhet parasysh këtë. Ndaj sovjetikëve ti bën kërkesa të rrepta discipline, kurse ndaj vetes tënde je i çrregullt, anarkist. Si shpjegohet ndryshe qëndrimi yt, kur shokët sovjetikë, pas një stërvitjeje të lodhshme, të kërkojnë njëzet minuta pushim sa të pastrohen e të rregullohen, ndërsa ti jo vetëm që s'interesoresh t'u sigurosh një dhomë që të çlodhen pak, por edhe u cakton si kohë vetëm dhjetë minuta pushim?! Është e qartë se në marrëdhënje me ta, ti nuk mban parasysh se janë të huaj dhe si të tillë u duhen krijuar disa

mundësi që të lehtësohen për të punuar e për t'u çlodhur. Qëndrimet e tua me këshilltarin sovjetik janë vetëm zyrtare, ti nuk sillesh me të edhe në mënyrë shoqërore. Këshilltari sovjetik me të cilin ti bashkëpunon, ka të drejtë të mendojë se «ky gjeneral dhe anëtar i KQ nuk ka konsideracion të drejtë për ne». Unë mendoj se qëndrime të tilla e kanë burimin te çrregullimet e tua, te konfuzioni yt në punë, te një farë mbivleftësi-mi që i bën vetes, gjë që është karakteristike për mendjemëdhenjtë¹. Mua më duket se kritikrat që drejtojnë ata në adresën tënde i bëjnë haptazi dhe mendoj se ti duhet t'i kuptosh drejt, pse janë kritika konstruktive, prandaj duhet t'i analizosh mirë, të reflektosh e të mos biesh në gabime të tilla. Ata kanë të drejtë të thonë pikëpamjet e tyre dhe ne do t'i gjykojmë ato, po sidoqoftë sjelljet e tua ndaj tyre nuk janë të drejta. Këtej e tutje nuk duhet të shkasësh më në këto gabime, përkundrazi kritikrat që të janë bërë e të bëhen edhe sot, duhet të të shërbejnë që të përmirësohesh. Ti duhet të japësh prova që të tregojnë se po korrigjohesh. E them këtë pse deri sot ke ecur në mënyrë të çrregullt, tani duhet të ndryshosh patjetër. Ne do të të ndihmojmë, por edhe nga ti kërkohet që të thellohesh në kritikrat që të bëhen e të mos i marrësh përciptazi ato.

Nga të gjitha këto del se puna jote në detyrën që të është ngarkuar, nuk është e kënaqshme, këtë boshllëk duhet ta plotësosh duke i kërkuar më shumë vetes, të marrësh mirë në duart e tua drejtimin e Drejto-

¹ Këto qëndrime si duket kishin lidhje me antisovjetizmin që kamuflohej te Panajot Plaku si agjent titist.

risë operative dhe të japësh më shumë rezultate në punë.

Tani po them pak fjalë edhe për kuadrin. Në këtë çështje ti prapë ke gabuar. Në rast se për një kuadër, s'kishe pikëpamje të njëjta me shokët e Drejtorisë politike në Ministrinë e Mbrojtjes, duhet të vije në Byronë Politike ose në Sekretariat, sipas nomenklaturës, edhe me mendimin tuaj apo të shefit të Shtatmadhorisë, po edhe me mendimin e drejtorit të Drejtorisë politike, që është përgjegjësi i Partisë në ushtri. Kjo ka një rëndësi të madhe, pse politikën e kuadrit e bën Partia. Nuk duhet të ndodhemi në Sekretariat përpara faktit që të shqyrtojmë një propozim kuadri e të mos dimë mendimin e Partisë nga vjen ky propozim.

Duke përfunduar, dua të theksoj edhe një herë që ti, Panajot, të korrigjosh të metat dhe kjo të jetë hera e fundit që vjen këtu për këto çështje. Mendoj se kritikën që t'u bënë do të të ndihmojnë të përmirësohesh. Në rast se nuk je i bindur, atëhere ta shtrojmë çështjen në Komitetin Qendror ose në Byronë Politike. Sidoqoftë, unë mendoj që Byronë Politike duhet ta vë në dijeni dhe ajo po ta shohë të nevojshme, do të të thërresë. Në rast se ti je i sqaruar mund të mos jetë nevoja ta shtrojmë çështjen në Komitetin Qendror».

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbajtur në këtë
takim që gjendet në AQP*

**NGA BISEDA E ZHVILLUAR ME SHOKUN
BEXHET MEMA KRYETAR I KOMITETIT
EKZEKUTIV TË KP TË QARKUT
GJIROKASTËR**

17 shtator 1953

SHOKU ENVER: Ç'kemi nga Gjirokastra? Si shkojnë punët? Si paraqiten kulturat bujqësore?

SHOKU BEXHET MEMA: Në përgjithësi mirë, por kemi pasur edhe ca dëme nga shiu në oriz dhe misër. Ndërsa pambuku paraqitet keq, pse është mbjellë me vonesë.

SHOKU ENVER: Pambuku në Gjirokastrë ose duhet të mbillet shumë shpejt që të arrijë pjekjen me kohë mbasi në tetor fillojnë shirat, ose nuk duhet të mbillet fare. Po me furnizimin e popullit me ushqime si veni, ka qyteti apo jo? Veçanërisht për zonat e thella malore siç janë Zagoria e Pogoni, a keni marrë masa për t'i furnizuar në stinën e dimrit? Po populli, a interesohet të vërë vetë rezerva për dimër?

SHOKU BEXHET MEMA: Furnizimi i popullit nuk është dhe aq i mirë, pse edhe zarzavate nuk ka sa duhet, qumshti ka kohë që është pakësuar dhe shumë fruta janë prishur. Ne nuk kemi akoma praktikën që të vëmë

rezerva për dimër. Me popullin nuk është punuar si duhet që ta ndjejë nevojën e zarzavateve.

SHOKU ENVER: Ju mund të mos e keni këtë praktikë, por populli e ka, nuk e gjente dimri pa zahire. Prandaj duhet t'i merrni mirë në duar këto çështje, herë tjetër nuk ju lejohen justifikimet. Tani na thuaj, përse ke ardhur?

SHOKU BEXHET MEMA: Kam ardhur, shoku Enver, të bisedoj me ju për disa vështirësi që kemi pikërisht për furnizimin e popullit. Për këto probleme bisedova edhe me shokun Gogo [Nushi]. Ne kemi blegtorët që më përpara i furnizonim me bukë, ndërsa tani nuk u japim gjë. Duke u bazuar në rendimentin e të Jashtave që duhet të marrim, janë bërë llogaritë për nevojat e bukës, por në Zagori, për shembull, 12 kv. për ha. që është parashikuar, nuk mund të arrihet. Kështu që ne do të na duhet t'i japim popullit bukë nga shteti.

SHOKU ENVER: Çështja e rendimenteve ka rëndësi të madhe për shtetin, i cili duhet të dijë, për shembull, se sa grurë do të bëhet në tërë Republikën. Kështu, mbasi llogaritet sa do të marrë shteti, shikohet sa i mbetet fshatarësisë për nevojat e saja dhe sa për treg. Në këtë mënyrë vepron shteti edhe për misrin. Pra, nevojat për bukën llogariten në bazë të numrit të popullsisë dhe të rendimentit që duhet marrë në kulturat bujqësore për një vit.

Përsa i përket furnizimit me bukë, shteti mendon në radhë të parë për bukën e punëtorëve, nëpunësve dhe për të gjithë ata që furnizohen me triska e që janë në marrëdhënje pune me shtetin. Bëhen llogaritë: sa merr shteti nëpërmjet grumbullimit e sa merr nga tregu

reciprok dhe, kur sheh se fondi i drithit nuk i mjafton, atëhere pjesën tjetër mendon ta importojë. Kur sheh se ka thatësi dhe parashikohet ndonjë mungesë buke edhe në fshatarësinë, atëhere shton edhe një sasi rezerve për të furnizuar, në rast nevojë, disa krahina. Po shteti nuk është i detyruar t'u japë bukë fshatarëve, të cilët duhet ta prodhojnë vetë; megjithkëtë, shteti ka një detyrim moral, pse nuk mund ta lërë popullin pa bukë, prandaj ai hedh një sasi buke për ta shitur në pazar. Në rast se bën thatësi, në bazë të ligjeve në fuqi, ulen detyrimet e fshatarësisë, ose po të jenë caktuar koeficientet gabim, bëhen korrigjime dhe zbriten, po rendimenti nga 12 kv. grurë për ha. që është parashikuar duhet të arrihet, fshatari duhet të japë aq sa është parashikuar. Në rast se ka gabime në klasifikimin e tokave, kjo gjë duhet të shihet nga ana e komitetit ekzekutiv që të zbriten detyrimet. Ne do të shohim edhe një herë se ç'kategori do të furnizojë shteti, pse deri tani u kemi dhënë bukë edhe atyre që nuk duhej t'u jepnim. Për shembull, do t'u japim bukë burrave e grave mbi 50 vjeç, nxënësve të çdo kategorie, punëtorëve e nëpunësve, atyre që merren vetëm me blegtori. Meqenëse në vendin tonë ekziston akoma patriarkalizmi, do t'u japim në disa raste e krahina edhe grave të punëtorëve dhe nëpunësve, kurse mofrave të tyre do t'u themi të venë të punojnë, nuk do t'u japim bukë me trëskë, pse shteti ka nevojë edhe për krahë pune. Përsa u përket fshatarëve të Zagorisë nuk kemi si t'i furnizojmë me racion, po edhe pa bukë nuk mund t'i lëmë. Atëhere me ta do të bëjmë tregëti, ose do t'u themi meshkujve të venë të punojnë dhe për këtë të nën-

shkruajnë kontrata me shtetin. Ata që i nënshkruajnë këto kontrata mbi 6 muaj, shteti i furnizon me bukë familjarisht. Në rast se një punëtor, ta zëmë nga Zagoria, ka qenë në marrëdhënje pune me shtetin për 5 muaj, familjes së tij shteti duhet t'i japë medoemos sasinë e bukës që i takon, në rast se i është dhënë më pak, duhet t'i jepet diferenca, pse është e drejta e tij dhe e familjes së vet. Fshatarët duhet të furnizohen kur një pjesëtar i familjes së tyre ka shkuar të punojë për jo më pak se 6 muaj në ndërmarrjet e shtetit dhe, sa kohë që punëtori qëndron në qendrën e punës, i vazhdon furnizimi familjes së tij, por kur një fshatar pret marrëdhënjet e punës me shtetin, atëhere, atij dhe familjes së tij i pritët dhe buka. Pastaj është edhe çështja e stimulacionit. Në rast se fshatari ka çuar prodhime në depon e shtetit, ky është i detyruar t'i japë stimulacionin. Në rast se ai ka punuar dhe buka nuk i është dhënë akoma, këtë të drejtë e ka dhe duhet ta kërkojë dhe t'i jepet. Të tjera marrëdhënje me shtetin për bukë, nuk ka. Pra duhet të bëhet një propagandë në një mënyrë të tillë që njerëzit për të pasur bukë duhet të venë të punojnë. Kështu duhet të veproni edhe ju në qark dhe të keni kujdes që asnjeri të mos mbetet pa bukë. Po Gogua, a është dakord që t'u jepet bukë blegtorëve?

SHOKU BEXHET MEMA: Po, dakord është dhe dha urdhër menjëherë që blegtorët të furnizohen. Kisha dhe një problem tjetër, shoku Enver. Na paraqiten nevoja urgjente për strehim. Për shembull, në Këlcyrë nuk ka fare shtëpi për nëpunësit e emëruar me organizimin e ri. Kështu është gjendja edhe në Tepelenë. Në Gjirokastrë janë 250 shtëpi duke rënë;

mungojnë edhe ndërtesa për zyra dhe për banim. Vetë komiteti i Partisë së rrethit është në ndërtesë të papërshtatshme. Edhe për hotel është ngushtë. Prandaj, po të kishte mundësi të ndërtohet një hotel i vogël për nevojat e popullit. Po kështu, të bëhen ndërtesa edhe për nevojat e komitetit ekzekutiv dhe komitetit të Partisë të qarkut, të cilat mendojmë të ngrihen afër spitalit, pse ne si qark kemi më pak lidhje me masat dhe brenda në qytet nuk ka vend ku t'i ndërtohet. Për adoptimin e banesave që po bien, kemi bërë ca projekte. Për ndërtesa ka nevojë edhe Delvina.

SHOKU ENVER: Çështjen e vështirësive të strehimit e dimë edhe ne dhe e kemi në studim. Por, tani për tani, ti bashkë me Rrapon¹ bëni një preventiv provizor, po sa të jetë e mundur t'i parashikoni me materiale që sigurohen në vend. Çështja e fondit është më e lehtë, po kryesorja është materiali. Prandaj, aktivizoni dërrasaxhinjtë² për të mbuluar shtëpitë, le të vazhdohet të mbulohen shtëpitë me dërrasa³, mos kërkoni vetëm tull, pse në Gjirokastrë përdoret guri. Për riparimet urgjente me material vendi, i bëni kërkesa qeverisë, të cilat mund t'i marrim në shqyrtim, pse janë të domosdoshme. Edhe çështjen e godinave për forumet e qarkut në Gjirokastrë duhet ta shohim, po këto ndërtime mos i bëni larg qytetit, por në qendër të tij, që të ndryshojë pak edhe pamja e qytetit.

¹ Rrapo Dervishi, në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të qarkut Gjirokastrë.

² Kështu quheshin në Gjirokastrë punonjësit që nxirrnin rrasa guri për mbullimin e çatave.

³ Rrasa guri.

SHOKU BEXHET MEMA: Problemi i tretë që kishim është se nga plani pesëvjeçar na janë hequr dy hidrocentrale të vogla, një që ishte parashikuar në Peshkopi dhe tjetri në Klishar. Këto nuk janë gjëra të mëdha, megjithatë janë hequr me vendim të qeverisë.

SHOKU ENVER: Këto janë gjëra të mira që mund të bëhen, po jemi ngushtë për tel. Pikërisht për këtë arsye, në shumë fshatra ku janë bërë hidrocentrale, na kanë mbetur pa u vënë në funksionim. Për këtë çështje më drejtohen me letra edhe disa fshatarë, po teli na pengon jashtëzakonisht. Që të na japin tel miqtë, na kërkojnë bakër, po bakri nuk na ecën si duhet, pse nuk kemi bërë kërkimet në rregull, kështu që plani këtë vit nuk realizohet. Punon në rregull centrali i qytetit?

SHOKU BEXHET MEMA: Mirë punon, po është shumë i vjetër dhe shoku Koço [Theodhosi] na tha se do të na japin centralin e Durrësit. Po ne kemi edhe Tepelenën e Këlcyrën pa dritë.

SHOKU ENVER: Do ta shohim edhe këtë.

SHOKU BEXHET MEMA: Pastaj është edhe çështja e hidrocentralit të Hosit në Lunxhëri, që mund t'i japë dritë Gjirokastrës dhe disa fshatrave. Ne kemi mjaft leverdi për ndërtimin e kësaj vepre, vetëm se kushton 15 milion lekë.

SHOKU ENVER: Ne më parë duhet të bëjmë gjëra rentabël dhe me karakter imediat.

SHOKU BEXHET MEMA: Një nevojë tjetër që kishim është çështja e radios. Radioja dëgjohet vetëm në qytet, prandaj po të kishte mundësi të fuqizohej, me qëllim që të dëgjohet edhe më larg se qyteti.

SHOKU ENVER: Do ta shohim edhe këtë.

SHOKU BEXHET MEMA: Edhe nënkryetari i komitetit ekzekutiv të qarkut që na mungon, është mirë të na dërgohet sa më parë. Po kështu edhe për një kryetar të rrethit të Gjirokastrës. Në Tepelenë dhe Delvinë të tërë janë të ardhur, d.m.th. jo vendës, ka ca pakënaqësi në këtë drejtim, prandaj mendoj të kihet parasysh kjo çështje.

SHOKU ENVER: Çështja është që njerëzit të punojnë mirë, pa dhe të ardhur të jenë, kur punojnë mirë, e fitojnë dashurinë e popullit. Për kuadrot vendës ka një rrezik: ndonjëri prej tyre mund të shikojë më mirë krahinën e tij dhe të lërë të tjerat, kurse i ardhuri në këtë drejtim është kurdoherë më objektiv. Po e gjithë puna është te sjellja me popullin, a ja zgjidh mirë dhe shpejt problemet atij dhe, kur nuk ka mundësi, a ja shpjegon që të jetë i qartë? Kjo është e rëndësishme. Nuk duhet t'i premtohen popullit ato që nuk ka mundësi të bëhen, por t'ja themi atij haptas. Populli, kur sheh se nuk arrihet një gjë, megjithëse janë bërë të tëra përpjekjet për atë që ka kërkuar, nuk bëhet i pakënaqur. Duhet me e dëgjue dhe me e pritë mirë popullin. Kjo ka rëndësi të madhe. Të jemi shumë të durueshëm me popullin, të mos bëhemi nevrík me të. Njeriu i thjeshtë nuk e imagjinon dot ç'halle ke ti për një qark, ai sheh vetëm hallin e vet të ngushtë. Edhe t'i thuash se po mendon për hidrocentralin e qarkut, ai kërkon t'i zgjidhësh një kërkesë të tij dhe, kur kjo s'i zgjidhet, ndonjëri mund të thotë: ama ç'i bije edhe ky legenit! Prandaj t'i shikohen mirë hallet popullit, të dëgjohet me durim ai.

Gjërat që ngrite do t'i shohim dhe do të luftojmë

t'i plotësojmë, po edhe ju studjoni më mirë ç'nevoja keni, kërkoni edhe ndihmën e Rrapos, i cili është shok i mirë e anëtar i KQ, prandaj bashkëpunoni ngushtë me të, merrni këshillat e tija dhe zgjidhni në mënyrë kolegjiale çdo gjë që të keni.

Edhe në komitetin ekzekutiv gjërat kryesore parimore të rëndësishme t'i zgjidhni në mënyrë kolegjiale. Të mblidhet komiteti ekzekutiv, të shtrohen çështjet, të bëhen propozime, të merret vendimi dhe brenda kompetencave, ti si kryetar, në bazë të këtyre vendimeve dhe të vendimeve të Partisë, vepro dhe kërkoni të veprohet ashtu si ka vendosur Partia dhe komiteti ekzekutiv. Kur sheh një njeri që zbaton ndryshe vendimin, në këtë rast duhet ta urdhërosh të mos veprojë ashtu. Kur të bëhet mbledhja ai thotë që mua më ndaloj shoku kryetar ta bëja këtë gjë dhe kjo nuk më duket e drejtë, pastaj e gënjon komiteti ekzekutiv çështjen.

Gjithashtu duhet me kuptue se ti je kryetar i komitetit ekzekutiv dhe Rrapua është sekretar i parë i Partisë së qarkut. Ne e dimë se mbi të gjitha qëndron Partia, po Partia të ka ngarkuar ty me detyrën e kryetarit të komitetit ekzekutiv dhe atje ti je njeriu i Partisë. Në mbledhjen e komitetit ekzekutiv, sekretari i Partisë që është anëtar i këshillit popullor ka të drejta të njëjta si gjithë të tjerët, pavarësisht se ai është edhe anëtar i KQ.

Të gjithë duhet të kuptojnë, edhe vetë sekretari i parë, se në komitetin ekzekutiv kryetari e ka fjalën e fundit. Në rast se sekretari i Partisë sheh se fjala e fundit e kryetarit nuk është e drejtë, thotë mendimin

e tij, pastaj vendimi mbasi diskutohet merret kolegjalisht. Mundet të ketë edhe kundërshtim mendimesh goftë edhe nga ana e sekretarit të Partisë që është anëtar i komitetit ekzekutiv. Në rast se mendimi i kryetarit të komitetit ekzekutiv që ka influencuar për marrjen e vendimit nuk është i drejtë, sekretari i parë e shtron çështjen në byro të komitetit të Partisë dhe thotë që në komitetin ekzekutiv të qarkut u muar ky vendim për të cilin unë isha në kundërshtim për këto arsye. Si analizohet kjo çështje në byro, arrihet në konkluzionin se sekretari i parë ka ose jo të drejtë. Po të ketë gabuar kryetari kjo i vihet në dukje dhe në mbledhjen tjetër të komitetit ekzekutiv ai duhet të thotë se ne kemi gabuar që kemi marrë atë vendim, këtë çështje e pa edhe byroja e komitetit të Partisë dhe unë atje bëra autokritikë. Ose mund të ketë ndodhur që të ketë pasur gabim sekretari, atëhere thuhet se për atë që diskutuam radhën e kaluar gabimin e pati shoku sekretar që kundërshtoi dhe çështja u shtrua në byro e shoku sekretar bëri atje autokritikë. Kështu merr shembull i gjithë komiteti ekzekutiv nga puna e Partisë dhe nga kolegjaliteti në marrjen e vendimeve.

Partia nuk është e një njeriu ose e dy njerëzve. Ka një udhëheqje të tërë që gjykon mbi problemet e ndryshme. Prandaj duhet bashkëpunim i ngushtë me Rrapon; këshillohuni me të, po kështu edhe me anëtarët e tjerë të komitetit ekzekutiv. Byroja e komitetit të Partisë dhe komiteti ekzekutiv në qark merr vendime parimore. Kryetari i komitetit ekzekutiv që është anëtar i byrosë së komitetit të Partisë merr shënime dhe reflekton t'i zbërthejë ato vendime konkretisht. Pastaj

në mbledhje të komitetit ekzekutiv e shtron çështjen dhe thotë se komiteti i Partisë, në bazë të vendimit të KQ ngriti këto çështje, prandaj propozoj të marrim këto masa. Kështu diskutojnë të tërë dhe del një vendim me detyra për çdo sektor, pastaj ti si kryetar bën kontroll për zbatimin e këtij vendimi, po edhe kontrolli duhet të bëhet kolegjisht. Kontrolli duhet organizuar mirë sidomos nga ti, se ti je kryetar i komitetit ekzekutiv dhe duhet të bësh që të punojnë të gjithë shokët e komitetit ekzekutiv, të gjitha aparatet e tij. Por nuk mund të jetë udhëheqje ajo, kur ti të monopolizosh të tërë punën vetë, ti duhet të udhëzosh, të drejtosh dhe të kontrollosh se si zbatohen vendimet që ka marrë Partia dhe që i ka konkretizuar komiteti ekzekutiv. Të bisedohet me shokët, të këshillohesh me ta në mënyrë shoqërore, që vartësit ose shokët e tjerë të shohin te kryetari jo vetëm një njeri të rrogosit, që shkon në bazë, te populli, po të shohin edhe shokun që i ndihmon e u zgjidh çështjet. Pra, të mos lihen njerëzit të veprojnë si të duan ata vetë po ashtu sikurse është vendosur nga forumet. Nuk është nevoja të bëhen punët me të bërtitur, po kur thuhet se kjo gjë duhet bërë, pse është vendim, ajo duhet bërë patjetër, ndryshe nuk ka për të ecur puna përpara.

Mos e merr me frikë punën, tani është fillimi, por ke për t'u mësuar.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbajtur në këtë
takim që gjendet në AQP*

MBI ARËSIMIN POLITIK TË RINISË

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

5 tetor 1953

Çështjen e edukimit ideo-politik të rinisë, në radhë të parë duhet ta kuptojë mirë Partia. Këtë e them jo se Partia nuk është interesuar, por për edukimin e rinisë ajo nuk kujdeset ashtu si dhe për edukimin e anëtarëve të Partisë. Mirëpo, edukimi i rinisë luan një rol jashtëzakonisht të madh për Partinë, pse në organizatën e rinisë përgatiten kuadrot e ardhshëm të Partisë. Duke i dhënë më shumë rëndësi edukimit të rinisë, do të bëhet edhe më i lehtë edukimi ideologjik i anëtarëve të Partisë, pse të rinjtë që do të pranohen në Parti, do të jenë më të përgatitur. Prandaj, lidhur me arësimin politik të rinisë që shqyrtojmë sot duhet të theksohet

¹ Në këtë mbledhje të Byrosë Politike u diskutua rreth raportit të paraqitur nga Komiteti Qendror i BRPSH «Mbi arësimin politik të rinisë gjatë vitit mësimor 1952-53».

edhe një herë kujdesi për zgjedhjen e propagandistëve për të cilët nuk duhet bërë asnjë dallim nga propagandistët e Partisë.

Bazat e edukimit të rinisë duhet t'i hedhim të shëndosha. Komitetet e Partisë duhet të kontrollojnë punën që zhvillohet për edukimin e rinisë, të ndihmojnë propagandistët dhe ata që merren me zgjedhjen dhe pregatitjen e propagandistëve, të kontrollojnë materialet e tyre, të kontrollojnë se si jepen mësimet, të nxitin organizatat bazë të Partisë që të ndihmojnë për të rritur pjesëmarrjen e të rinjve në format e arësimit politik etj. Partia ta konsiderojë edukimin e rinisë si një detyrë shumë të rëndësishme të saj, por edhe vetë organizata e rinisë duhet t'i vërë kujdesin më të madh çështjes së edukimit të rinisë.

Më duket se ju¹ keni mundësi më të mëdha për të siguruar propagandistë vullnetarë më shumë se deri tani. Natyrisht kjo nuk bëhet duke i caktuar propagandistët nga zyra dhe t'u thoni atyre të venë e të bëjnë leksione ose seminare, po të konsultoheni me bazën e të caktohen propagandistë të tillë, të cilët do të mundet ta kryejnë këtë detyrë si në qytet, ashtu dhe në fshat. Ne kemi shkolla profesionale, ku japin mësim edhe specialistë që punojnë në dikastere e megjithatë, gjejmë vështirësi të mëdha, pse shumë herë ata janë të zënë me punë dhe mbetet nxënësi pa marrë mësim. Kur

¹ U drejtohet shokëve Todi Lubonja e Pipi Mitrojorgji, i pari organizator i parë dhe i dyti sekretar i Komitetit Qendror të ERPSH, të cilët ishin ftuar në mbledhjen e Byrosë Politike dhe marrnin pjesë në shqyrtimin e këtij problemi.

kjo ngjet kështu me këta që janë nëpunës, ka mundësi të ndodhë akoma më shumë me propagandistët, të cilët punojnë në baza vullnetare. Pastaj kjo varet edhe nga predispozicioni i njeriut, është apo jo i dhënë pas kësaj pune ai që ngarkohet. Prandaj këto gjëra duhet të bëhen të studjuara mirë, të merret mendimi i të rinjve, bile me ta të bëni edhe programin e formave të arësimit politik, pse propagandisti mund të jetë një nxënës shkolle, kështu që duhet ta ndihmoni konkretisht që ai të gjejë kohën e përshtatshme kur është i lirë që të kryejë edhe detyrën e propagandistit me të cilën do ta ngarkoni.

Çështja e letrës dhe e lapsave ka rëndësi të madhe jo vetëm për shkollat, po edhe për format e edukimit dhe duhet të rishikohen mundësitë që kenë për t'i siguruar ato, pse edhe defteret nevojiten për të mbajtur shënimet. Forma e arësimit politik të rinisë duhet t'i lidhni edhe me aktivitetin e përgjithshëm që zhvillohet në drejtim të edukimit e të mos zhvillohen ato shkëputur nga format e mjetet e tjera të edukimit. Është zor t'i futësh menjëherë të rinjtë në shkollat politike pa i aktivizuar më parë dhe pa i mbledhur në disa forma dëfrimi dhe aktivitete të tjera konkrete. Në rast se nuk luftojmë për të zhvilluar në të rinjtë dashurinë për studimin, për leximin e gazetës së rinisë në mënyrë të organizuar, të organeve të tjera të shtypit dhe të librit, do të ketë vështirësi që ata të ndjekin format e arësimit ideo-politik. Një gjë e tillë më duket se te ne lë shumë për të dëshiruar. A vete gazeta kudo? Mendoj se nuk bëhet sa duhet në këtë drejtim. Por unë kisha edhe një vërejtje për gazetën «Rinia»: ajo del shumë e rëndë për rininë. Të shumtën e herës në të gjen po

ata artikuj që dalin edhe në gazetën «Zëri i Popullit». Ajo boton të tëra vendimet e qeverisë dhe të Komitetit Qendror në vend që redaksia e saj të punojë dhe të nxjerrë esencën e këtyre vendimeve. Në gazetën «Rinia» të botohen në mënyrë të thjeshtë dhe të shkurtër këto vendime dhe lexuesit e saj të vihen në dijeni për çështjet kryesore politike dhe ekonomike; me botue në gazetën «Rinia» materiale të njëjta me «Zërin e Popullit» kjo nuk është e përshtatshme për rininë, e cila ka nevojë për materiale të tjera, që janë karakteristike për moshën e saj. Detyra e Komitetit Qendror të BRPSH është të krijojë dhe t'i japë rinisë ato që ajo ka nevojë, ta edukojë atë jo me forma pleqërishte, po me probleme e forma interesante për rininë, e cila duhet t'i përvetësojë shpejt, t'u futet thellë, të kuptojë esencën e tyre dhe detyrën e saj. Të botohen në gazetën «Rinia» edhe gjëra zbavitëse për rininë, gjë që tani nuk bëhet sa duhet. Të jepen shembuj për të rinjtë më të mirë se si punojnë, të shkruhet për inisiativën dhe përpjekjet e tyre. Pastaj çështja e lëvizjes komuniste dhe e Luftës nacional-çlirimtare të mos lihet mënjanë, po të botohen episode të thjeshta, të lehta dhe të vazhdueshme që rinia të edukohet me këtë frymë. Për këtë qëllim duhet që gazeta të vejë kudo dhe të organizohet leximi i saj. Përsa u përket romaneve, ato nuk tërhiqen sa duhet nga bibliotekat dhe nga libraritë dhe shpesh nuk lexohen deri në fund. Për të nxitur në këtë drejtim leximin e literaturës artistike, të organizohen recitime, takime me shkrimtarët si dhe mbledhje, të cilat të shoqërohen edhe me aktivitete sportive e artistike,

nëpërmjet të cilave të bëhet edhe edukim edhe argëtim sidomos në fshat. Kështu do të tërhiqen të rinjtë e të rejat edhe më mirë në format e arësimit politik.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

LIGJET DUHEN ZBATUAR PA LËSHIME

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

9 nëntor 1953

Unë jam dakord me vërejtjet e të gjithë shokëve të Byrosë Politike dhe besoj se ato e plotësojnë kuadrin e gjendjes që na u paraqit në lidhje me punën e organeve të drejtësisë². Këto organe janë institucionet qendrore të drejtësisë dhe kanë rëndësi të jashtzakonshme. Misioni i tyre që u ka ngarkuar Partia është i madh dhe u shërben interesave të gjithë popullit.

Ndjenja e së drejtës te ne duhet të jetë në gjakun dhe në shpirtin e anëtarëve të Partisë. Respekti për të drejtën është një nga karakteristikat e popullit tonë, nga gjiri i të cilit dalin anëtarët e Partisë. Ligjet tona,

¹ Në këtë mbledhje të Byrosë Politike u diskutua rreth raportit «Mbi punën e organeve të drejtësisë» paraqitur nga Ministria e Drejtësisë.

² Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme dhe Gjykata e Lartë.

që shprehin politikën e Partisë, janë konkretizim i dëshirave dhe i aspiratave të popullit tonë. Këtej del detyra që çdo komunist të luftojë deri në fund për zbatimin e ligjeve të shtetit tonë. Ligjet duhet të zbatohen drejt dhe paanësisht nga e gjithë Partia, por veçanërisht nga gjykatat e të gjitha shkallëve që janë organe shtetërore të ngritura apostafat për këtë qëllim. Me gjithë sukseset që kemi arritur në zbatimin e ligjeve, është fakt se në këtë drejtim ka edhe shumë shkelje, që vijnë për shkaqe të ndryshme siç janë: puna e armikut, mosnjohja si duhet e ligjeve, neglizhencat dhe arbitraritetet e disa drejtuesve, puna e njerëzve të pandërgjegjshëm që duket deri edhe te disa komunistë, që fshihen nën maskën e anëtarit të Partisë. Shkelësit e ligjeve duhet t'i zbulojmë dhe t'i dënojmë në frymën revolucionare të Partisë. Kryesorja është që ligjet të zbatohen një lloj për të gjithë. Ligji është një për të tërë, ai duhet zbatuar nga secili dhe veçanërisht nga ata që janë ngarkuar me këtë detyrë të rëndësishme. Punonjësit e organeve të drejtësisë duhet të jenë të rreptë dhe të drejtë në zbatimin e ligjeve, Partia duhet t'i mbështetë në plotësimin me sukses të detyrave të tyre. Asnjëri të mos rrëmbehet nga rryma e punëve të përditshme sa të mos shohë mirë çështjet në të gjitha anët e tyre. Nuk duhet të shohim vetëm një anë të çështjes dhe të harrojmë tjetrën. Kush mendon, për shembull, vetëm për të realizuar planin pa gjykuar edhe për nevojat që kanë punëtorët, atëhere ai nuk respekton Kodin e punës dhe kështu shkel ligjet. Disa anëtarë të Partisë dhe punonjës nuk mbajnë qëndrim të drejtë ndaj ligjeve. Gjoja në interes të punës shpeshherë ata

ndërhyjnë pa të drejtë në zgjidhjen e çështjeve dhe, kështu në një formë ose në një tjetër, shkelen të drejtat e qytetarëve, të cilët bëhen edhe të pakënaqur.

Në organet e drejtësisë duhet të punohet me drejtësi të madhe. Punonjësit e këtyre organeve duhet të jenë të shkathët dhe të drejtë, të jenë të ngritur sidomos nga ana ideo-politike, po dhe nga ana profesionale. Në gjykimin e çështjeve penale të interpretohen mirë rrethanat e kryerjes së krimit. Unë mendoj se nuk i është vënë rëndësia e duhur zgjedhjes së kuadrove të drejtësisë. Në këtë drejtim ka nënvleftësim. Për ndihmësgjyqtarët mendoj se ka nënvleftësim të madh, sepse zgjedhja e tyre nuk është bërë si duhet problem i komiteteve të Partisë, me qëllim që ata të dalin nga radhët e njerëzve më të ndershëm, aktivë, pak a shumë të përgatitur dhe me gjykim të shëndoshë. Në zgjedhjen e ndihmësgjyqtarëve puna është shumë e dobët dhe formale, ndihma e Partisë ka munguar. Prandaj Drejtoria administrative dhe organet e Partisë në rrethe e në bazë të përpiqen që t'u japin organeve të drejtësisë njerëzit më të mirë, ndryshe të metat që diskutojmë do të vazhdojnë. Në rast se shumica e njerëzve në bazë nuk do të kenë një ndërgjegje të lartë politike dhe njëkohësisht nuk do të mësojnë vazhdimisht nga teoria dhe nga praktika e çështjeve, Gjykata e Lartë do të ketë mijëra çështje në vit për të gjykuar dhe nuk do të dalë dot nga kjo situatë. Shokët atje punojnë, lodhen, por në duart e tyre janë grumbulluar shumë çështje për studim, gjë që i bën ata të mos thellohen sa duhet në to.

Partia do të marrë herë pas here në shqyrtim probleme të veçanta të drejtësisë, do të bëjë vërejtjet

e saja dhe do të orientojë se si duhet të zbatohet ligjshmëria. Kjo nuk e cënon aspak pavarësinë e gjykatave tona. Mua më duket se çështja e pavarësisë duhet kuptuar më mirë. Kur themi që gjykatat janë të pavarura, kjo s'do të thotë aspak që ato të jenë jashtë kontrollit të popullit që i zgjedh dhe të Partisë. Përkundrazi, kontrolli i popullit dhe i Partisë është mbi të gjithë. Në gjykata kontrolli i popullit dhe i Partisë realizohet nëpërmjet disa rrugëve: Së pari, gjykatat kontrollohen nga populli që i ka zgjedhur; kjo mbikëqyrje e popullit ka rëndësi të madhe parimore dhe praktike. Gjyqtarët duhet të japin llogari në popull, gjë që nuk bëhet sa duhet, pse ata nuk u japin raport zgjedhësve të tyre. Si rrjedhim, populli nuk mund të gjykojë se si punon për shembull kryetari i gjykatës, gjyqtari ose prokurori dhe të bëjë vërejtjet e veta për punën e tyre. Prandaj kjo çështje duhet të vihet në vend. Çështja është që kur të gjykojë një gjykatës, vendimi i tij të jetë i drejtë, i ligjshëm, i vërtetë, bindës dhe i pranueshëm nga populli. Gjykatësi në zgjidhjen e çështjes konkrete është i pavarur në kuptimin që ai doemos duhet të zbatojë ligjin dhe të vlerësojë rrethanat e çështjes sipas bindjes së tij pa u influencuar nga ndërhyrjet e padrejta, por kjo nuk do të thotë aspak se ai nuk jep llogari para popullit, që e ka zgjedhur si gjyqtar; populli ka të drejtë t'i kërkojë edhe llogari, ta kritikojë dhe ta shkarkojë në qoftë se nuk ka punuar mirë. Së dyti, gjykatat kontrollohen nga Partia; ky kontroll i Partisë nuk përbën ndonjë rrezik për pavarësinë e Gjykatës së Lartë. Ky rrezik mund të vijë më tepër nga Ministria e Drejtësisë. Cënimi i pavarësisë

së gjykatave mund të vijë edhe nga ndonjë rast, kur një komitet partie vepron në mënyrë të jashtëligjshme, por këto janë raste që mund të evitohen. Së treti, Gjykata e Lartë varet nga Presidiumi i Kuvendit Popullor.

Ne ju thërresim ju, shokë të drejtësisë, si komunistë, që ju ka ngarkuar Partia të punoni në një sektor me rëndësi të madhe për veprimtarinë e shtetit të diktaturës së proletariatit, ju thërresim t'ju kërkojmë llogari për punën që keni bërë. Po më përpara nga Komiteti Qendror këtë punë duhet ta bëjë Presidiumi i Kuvendit Popullor, ku kemi shokë të Partisë nga më të mirët. Një nga detyrat kryesore të Presidiumit është që të shohë se si zbatohen ligjet. Presidiumi tani i ka organizuar lidhjet me masat, po këto duhet t'i forcojë akoma më shumë edhe me këshillat dhe me gjykatat popullore të të gjitha instancave. Ai, herë pas here duhet të kërkojë edhe raporte nga Gjykata e Lartë, nga Prokuroria e Përgjithshme, nga gjykatat e nga prokuroritë e rretheve dhe, kur shikon se nuk vete mirë puna, të japë udhëzimet e nevojshme e të kërkojë që të dilet përpara popullit me autokritikë. Këto kompetenca Presidiumi i Kuvendit Popullor duhet t'i ushtrojë më mirë tani e tutje. Në këtë mënyrë një nga punët kryesore të shokëve të Presidiumit do të jetë edhe kontrolli mbi gjykatat për të siguruar zbatimin e përpiktë dhe pa asnjë lëshim të ligjshmërisë sonë revolucionare. Lidhjet midis organeve të drejtësisë dhe Presidiumit të jenë të ngushta dhe në këtë kuadër të kuptohet drejt, dhe jo sipas interpretimeve false të borgjezisë, parimi i pavarësisë së gjykatave.

Përshtypja ime është se në raportin që na paraqitet

mbi punën e organeve të drejtësisë nuk dalin qartë të metat që ekzistojnë në punën e Gjykatës së Lartë. Këtu nuk është çështja të bëhet «autokritikë për autokritikë», por të analizohen thellë të metat në punë, të zbulohen shkaqet e tyre dhe të përcaktojmë detyrat për të forcuar gjëndjen në të ardhshmen. Ndryshe si do të korrigjohen të metat, që mua më duket se duhen parë më mirë? Kryetari i Gjykatës së Lartë thotë se puna kolegjiale paraqitet e mirë, se çështjet për gjykim janë përgatitur konformë ligjeve, kurse shokët e tjerë të Gjykatës së Lartë thonë ndryshe. Atëhere del e qartë se midis jush nuk ka një mendim unik për këto probleme, duket sikur ka një opozicion midis kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe shokëve të tjerë të këtij organi, të cilët thonë se atje ka gabime. Kuptohet që Shuaipi¹ ka më shumë për të bërë në këtë drejtim, po ashtu edhe Siriu². Këta shokë duhet të bëjnë më tepër përpjekje për ngritjen e tyre nga ana tekniko-profesionale dhe Bilbili³ e ka për detyrë t'i ndihmojë më shumë në këtë drejtim. Përveç kësaj, edhe puna kolegjiale midis tyre të jetë më e fortë dhe e shëndoshë, pse kjo do të japë rezultate më të mira. Eksperienca në këtë fushë nuk ju mungon, megjithatë doja të thoshja që kryetari i Gjykatës së Lartë dhe prokurori i përgjithshëm të mbajnë lidhje më shumë me kolegët e tyre, të përfitojnë nga eksperienca dhe mendimet e tyre. Shuaipi, për shembull, megjithëse ka fituar një farë eksperience, mund të mësojë nga shumë

¹ Shuaip Panariti, në atë kohë kryetar i Gjykatës së Lartë.

² Siri Çarçani, në atë kohë prokuror i përgjithshëm.

³ Bilbil Klosi, në atë kohë ministër i drejtësisë.

shokë të Gjykatës së Lartë, që kanë një pregatitje teo-rike dhe përvojë të mirë praktike, prandaj ta kërkojë hapët ndihmën e tyre duke u thënë: «Kam nevojë edhe për ndihmën tuaj, hajde ta bëjmë tok këtë punë që edhe unë të fitoj një eksperiencë më të madhe». Këtu përveç së mirës nuk ka asgjë të keqe. Kuadrot rriten në punë, me përpjekjet që bëjnë vetë, si dhe me ndihmën e të tjerëve. Në këtë luftë për të punuar e për të mësuar, do të vërtetohen edhe të meta për të cilat do të bëhen kritika, që duhen pranuar hapët dhe me modesti. Nuk përjashtohet që te shoku Kiu Bozo ose te ndonjë shok në Gjykatën e Lartë të ketë mbeturina mikroborgjeze që i çojnë në nënvleftësimin e kryetarit, po këto gjëra në rast se vihen re duhen shtruar në organizatën e Partisë dhe atje të shoshiten e të sqarohen. Kritikën tona duhet të jenë të drejta dhe parimore. Kur janë të tilla dhe nuk pranohen, atëhere kemi të bëjmë me një farë mendjemadhësie e cila duhet luftuar, pse dëmton punën, kurse, atij që bën kritikë me qëllime të këqia, në mos sot, nesër do t'i dalin të palarat sheshit.

Ashtu si në gjykatat, edhe në Prokurorinë e Përgjithshme e në prokuroritë e rretheve duhet të kemi njerëz të mirë partie, të ndershëm që të mbrojnë si duhet ligjshmërinë socialiste. Prokurori, si të gjithë punonjësit e drejtësisë, nuk duhet të ketë frikë nga asnjë njeri dhe të mos u nënshtrohet ndërhyrjeve të padrejta që bëhen me qëllim të keq. Ligjet duhen zbatuar pa lëshime. Ashtu si në çdo sektor, çdo shfaqje familjariteti midis organeve të prokurorisë, që janë ngarkuar me mbrojtjen e ligjeve dhe të organeve të tjera shtetërore, si ato të hetuesisë së Ministrisë së

Punëve të Brendshme etj., është e dëmshme dhe e palejueshme. Prandaj të forcohet më tej partishmëria në punën e të gjitha organeve të diktaturës së proletariatit dhe në marrëdhënjet midis tyre.

Organet e drejtësisë kanë korrur suksese në zbatimin e detyrave të mëdha që u ka ngarkuar Partia dhe populli. Të meta në veprimtarinë e tyre natyrisht ka, po Partia i këshillon dhe i kritikon që t'i ndreqin. Ne kemi besim se të metat që dolën nga kjo analizë do të korrigjohen dhe puna e organeve të drejtësisë do të shkojë akoma më përpara.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

MBI FORCIMIN E KOOPERATIVAVE BUJQËSORE EKZISTUESE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

16 nëntor 1953

Byroja Politike ka dhënë orientimet e nevojshme për forcimin e kooperativave bujqësore ekzistuese. Këto orientime duhet të kuptohen e të zbatohen drejt nga e gjithë Partia. Në formimin e kooperativave të reja, nuk duhet as të shpejtohem, as të ndalojmë propagandën për ngritjen e tyre. Kur është fjala për ngritjen e kooperativave të reja bujqësore ne duhet të mendojmë dhjetë herë dhe të vendosim një herë, pse duhet të

¹ Në këtë mbledhje të Byrosë Politike u analizua gjendja e kooperativave bujqësore në qarqet: Berat, Durrës, Elbasan e Vlorë. Në disa kooperativa të këtyre rrethëve, të cilat nuk kishin shumë kohë që ishin ngritur, vërtetoheshin gabime serioze, që përbënin shkelje të rënda të vijës së Partisë lidhur me kolektivizimin, me parimin e vullnetarizmit, me trajtimin e fshatarëve, me vetë ekzistencën e kooperativave bujqësore.

krijojmë më parë kushtet e nevojshme. Mua më duket se aktualisht nuk kemi dhe aq mundësi të ndihmojmë plotësisht me traktorë as kooperativat ekzistuese e jo më fshatarët, që s'janë akoma në kooperativë. Nga sa del, asnjë fshatari nuk i kemi dhënë një ndihmë të tillë për punimin e tokës, pastaj merre me mend sa vështirë do të jetë po të krijojmë edhe kooperativa të tjera. Por nuk është vetëm puna e traktorëve, janë edhe qetë e punës, fara etj. Pa i krijuar këto kushte, nuk do të jetë lehtë të ngrihen kooperativa të reja.

Pregatitja politike e fshatarëve për t'u futur në kooperativat bujqësore bile edhe e vetë anëtarëve të Partisë është e nevojshme të bëhet vazhdimisht, pse ka raste që atje ku kjo punë është e dobët, disa nuk hyjnë në kooperativë, të tjerë që kanë hyrë, duan të dalin prapë, ose ka që janë kooperativistë, por nuk punojnë si duhet. Prandaj detyra jonë është që të forcojmë kooperativat ekzistuese, sidomos ato që janë më të reja. Kjo duhet të preokupojë Partinë dhe kooperativat që kemi të bëhen shembull për fshatarësinë individuale.

Këtu doli se në procesin e bindjes për t'u futur në kooperativë ka pasur edhe presion. Kjo duhet kuptuar aq sa është dhe jo me i hedhë ujë verës. Kanë ndodhur raste që në kooperativa bujqësore të jenë futur edhe njerëz jo plotësisht vullnetarë. Kjo është e dënueshme nga Partia. Para se të hyjnë fshatarët në kooperativë, duhet t'u lexohet dhe t'u shpjegohet mirë statuti, pse ka edhe kuadro që nuk e njohin si duhet atë; merre me mend se ç'ndodh me fshatarët, të cilët kanë të drejtë të mos e dinë, pse nuk është punuar me ta ashtu si

duhet¹. Prandaj këtë detyrë ta bëjmë më mirë tani e tutje. Por puna politike me fshatarët duhet të vazhdojë edhe pasi ata të pranojnë të futen në kooperativë, të shpjegohet se dalja më vonë prej saj nuk është e mirë dhe se ka rrezik që toka të mos i jepet atje ku e kishte, pse ajo u kolektivizua, por atje ku ka tokë disponibël, që kafshët e punës nuk i kthehen më etj. Për të bërë përjashtime jam dakord, po kur vjen çështja për njëzet vetë menjëherë, mua më duket se është vështirë të zbatohet rigorozisht statuti. Në këtë gjendje nuk mund të lesh njëzet vetë pa tokë, pa qe, pa kafshë pune, pse krijon një situatë të vështirë në ata dhe në farefisën e tyre. Statuti të zbatohet kur është fjala se duhet të dalë një njeri i padëshiruar nga kooperativa, atëhere atë nxirre dhe jepi tokën larg. Por në situatën kur kooperativa bujqësore nuk ecën mirë, jepi tokën jashtë kooperativës bujqësore, po jo tokë e keqe, po e tillë që fshatari të punojë dhe të rrojë me të. Në rast se nuk ka, t'u jepet edhe te qoshja e kooperativës, pastaj t'u jepet edhe kredi në bazë të statutit. Atyre duhet t'u jepet edhe një ndihmë; drejt e ka Ministria e Bujqësisë, t'u jepet bukë qoftë edhe për një vit, por kjo të bëhet për ata që janë fshatarë të mirë dhe nuk janë të bindur akoma për të qëndruar në kooperativë ku jeta e fshatarëve është më e mirë dhe prodhimet më të shumta.

Trajtimi i njerëzve para dhe pas hyrjes në kooperativë e preokupon shumë Byronë Politike dhe Komitetin

¹ Një rast i tillë që u kritikua në Byronë Politike ishte ai i fshatit Mes të Shkodrës, ku doli se fshatarët ishin të paqartë dhe nuk donin të ngrinin kooperativën, prandaj u anulua vendimi për ngritjen e saj.

Qendror. Kujdesi në këtë drejtim luan një rol të madh në mbarëvajtjen e punës për kolektivizimin e bujqësisë. Qëndrimet e ndonjë anëtari të Partisë ndaj disa fshatarëve të cilëve u bëhet presion se do t'u hiqet karta e Frontit, do të cilësohen kulakë, armiq etj., janë të huaja për Partinë dhe tregojnë sektarizëm. Në këto gabime nuk duhet të bien komunistët, të cilët duhet të tregohen të pjekur, gjakftohtë e të matur me njerëzit, kjo nuk do të thotë që të mos jemi vigjilentë ndaj armikut të klasës. Për ata anëtarë partie që nuk sillen mirë me fshatarët, të krijohet në organizatë dhe po qe nevoja edhe në popull një situatë e tillë që ata të kritikohen e të njohin gabimet e tyre dhe jo të shfrytëzojnë autoritetin e Partisë, të shkelin vijën e drejtë të saj e kjo të kalojë lehtë e lehtë. Sjelljet e këqia me njerëzit e popullit janë shumë të dëmshme për Partinë. Në rast se njerëzit e thjeshtë nuk e bëjnë kritikën ndaj fajeve të ndonjë komunisti në lartësinë e duhur, atëhere Partia do të dobësohet dhe do të mbahet me detyrim, me urdhëra dhe me kërcënime. Kjo është shumë serioze. Shokët e Beratit duhet ta shohin mirë këtë çështje në kooperativat e tyre bujqësore¹. Në qoftë se atje ka ndonjë element armik, atëhere le të merren masa kundër tij, por t'u heqësh kartat e Frontit 13 familjeve, kjo nuk është e drejtë, pse ata nuk mund të jenë të gjithë armiq. Po u veprua kështu, dëmtohet Partia. Partia jonë ka marrë përsipër të ndreqë edhe njerëzit që kanë qenë në formacionet e «Ballit Kombëtar», ajo punon me

¹ Në rrethin e Beratit, në katër kooperativa të reja bujqësore kërkuan të dalin nga kooperativa 67 familje.

kujdes që njerëzit të njohin gabimet e tyre dhe të ndjekin rrugën e drejtë të Partisë, por kjo nuk arrihet duke u hequr këtyre njerëzve kartat e Frontit. Është thënë edhe herë të tjera se kartat e Frontit duhet t'u hiqen vetëm atyre që kanë aktivitet armiqësor, por ndonjërit, që ka hedhur një parullë dhe Partia ka marrë përsipër ta sqarojë, ta edukojë e ta ndreqë, mund t'i jepet karta e Frontit, pse ajo nuk është si tesera e Partisë. Pastaj ai do të vijë edhe në konferencë ku do t'ja thotë Partia rrugën e drejtë e kështu ai nuk ka për të hedhur më parulla. Është lehtë ta hedhësh tjetrin jashtë, po kjo është lodër shumë e rrezikshme për Partinë, pse kështu mbush kontingjentin e armikut me ushtarë dhe në një moment të caktuar ata i ke kundër Partisë. Kjo nuk duhet të shpjerë në dobësimin e vigjilencës, pse në këtë proces do të ketë edhe njerëz që të fshihen prapa kartës së Frontit. Ai që është armik, duhet luftuar dhe demaskuar si i tillë. Ai që ka mundësi të shpëtohet, t'i jepet dora nga Partia; ai që nuk shpëtohet, po shkon me armikun, të demaskohet e po të vazhdojë të kryejë veprimtari armiqësore, t'i jepet gjyqit, të burgoset. Ka njerëz, të cilët nuk janë të bindur për masat që merr Partia. Prandaj detyra jonë si Parti është që t'i bindim këta njerëz. Në rast se nuk ke arritur të krijosh bindje, vazhdoje përsëri punën derisa t'ja arrish qëllimit. Në qoftë se një komunist thotë që këtij njeriu t'i hiqet karta e Frontit, ndërsa masa e popullit është në kundërshtim me të, ajo atij nuk i duhet hequr, pse Partia nuk rron me një komunist, por me popullin, nga gjiri i të cilit ka dalë. Ndryshe ku është demokracia dhe liria e popullit për të cilën flet

Partia? Mua më duket se këto gjëra nuk i shohin si duhet komitetet e Partisë.

Tani të vijmë përsëri në çështjen e kooperativave bujqësore. Gjendja në disa nga ato lë shumë për të dëshiruar. Si është e mundur që në Elbasan të ketë vetëm dy kooperativa bujqësore dhe ato të jenë gati për t'u prishur? Kjo tregon se komunistët atje nuk e kanë kuptuar si duhet vijën e Partisë. Këto janë vetëm dy kooperativa, por që përfaqësojnë të ardhshmen e kooperativizmit në fshatrat e Elbasanit dhe, po të mos arrijë Partia t'i bëjë model, vaj halli për të ngritur të tjera. Po sikur të kishte 30-40 të tilla si do të bënit? Në këtë rast do të komprometohej pa dyshim vija e Partisë për kolektivizimin. Ku bëhet fjalë në Elbasan që të ngrihen të tjera kooperativa bujqësore? Është apo jo në aktivin e Komitetit të Partisë të Elbasanit një gjë e tillë? Jo. Ose në atë të Durrësit, ku edhe atje nuk ka ndonjë numër të madh kooperativash? Përsa i përket asaj të Daut-Rikajt¹ të bëhen të gjitha përpjekjet që të forcohet, por vetëm mbi bazën e bindjes. Si mund të flasim për vullnetarizëm, kur një fshatar nuk do të qëndrojë në kooperativë pse ka hyrë i pabindur plotësisht dhe ti e mban me zor? Duhet shtuar përpjekjet për të bërë atë punë bindëse që nuk është zhvilluar më parë dhe të arrihet që të mos largohen anëtarët nga kooperativa e tyre. Po nuk u bind si duhet fshatari, do të ndodhë që kur të vejë për shembull te miku i tij,

¹ Në atë kohë kooperativa e Daut-Rikajt ishte në rrezik të shpërndahej, por me masat që u morën, duke hyrë në radhët e saja edhe anëtarë të rinj, gjendja u stabilizua.

t'i pëshpëritë në vesh: «Unë nuk dua të rri në kooperativë, po më mbajnë me zor». Pastaj bëj propagandë sa të duash, është tepër vonë. Në kooperativat bujqësore të rretheve të tjera shokët e Partisë nuk interesohen aq shumë, duket që disa prej tyre po e marrin si lehtë punën e kooperativave, si nga pikëpamja e organizimit, ashtu dhe nga ajo e përmirësimit të jetës, e shtimit të rendimentit të prodhimit, për çështje kulturele etj. Të gjitha këto duhet të ecin së toku dhe jo vetëm me u interesue sa për të bërë vetëm bukën dhe për të tjerat Partia të mos interesohet fare. Forcimi i kooperativave bujqësore duhet të bëhet i plotë, të shihen të gjitha aktivitetet e kooperativave bujqësore. Ndryshe ngjet në Korçë, ku kooperativat shkojnë mirë, shokët e Partisë ngrenë probleme të shumanshme për zhvillimin e mëtejshëm të tyre. Prandaj, organizatat bazë të Partisë në kooperativat bujqësore duhet të forcohen më shumë, të ngrihen më tepër si nga ana politike, ashtu dhe nga ana organizative. Jo vetëm të mbahet afër e të ndihmohet kryetari i kooperativës, por edhe brigadieri, shefi i llogarisë dhe të gjithë kuadrot drejtues. Sa për organizatën bazë të Partisë, ajo duhet të jetë akoma më lart nga kryetari si politikisht ashtu dhe teknikisht. Anëtarët e kooperativave bujqësore që janë komunistë duhet të luftojnë në mënyrë sistematike për të ngritur nivelin e tyre dhe të qëndrojnë në një lartësi më të madhe se ç'janë sot. Po të mbeten anëtarët e Partisë në këtë nivel, edhe kooperativat do të vazhdojnë të jenë të dobëta, prandaj për komunistët që janë në fshat duhet treguar një interesim i veçantë.

Unë jam i mendimit që statuti nuk duhet të bëhet

pengesë për përmirësimin e jetës në kooperativat bujqësore, përkundrazi ai të përdoret si një armë për të lehtësuar dhe për të përmirësuar jetën e kooperativistëve. Në rast se kryetari i kooperativës dhe sekretari i organizatës bazë të Partisë e përdorin atë për të lënë njerëzit pa bukë, ata nuk e kryejnë mirë detyrën. Ka ndonjë që nuk punon dhe kur vjen çështja t'i jepet bukë, i thuhet: «Nuk të japim, pse ke shkelur statutin». Statuti vërtet nuk duhet të shkelet, po duhet të interpretohet drejt. T'u themi anëtarëve të Partisë në kooperativa që kemi të bëjmë me fshatarë, që po t'i ofendosh dhe t'i kërcënosh, u mbetet hatëri, bëhen të pakënaqur dhe influencohen nga armiku. Edhe disa sjellje të pakontrolluara të ndonjë anëtari të Partisë e bëjnë fshatarin të lëkundet. Prandaj, në marrëdhënje me fshatarët, të kemi kujdes të vazhdueshëm. Anëtarët e Partisë atje të jenë të sjellshëm, të drejtë, të kritikojnë hapët, të mësojnë nga masa dhe ta mësojnë atë, të jenë shembull. E them këtë pse nuk janë të gjithë kështu. Disa prej tyre duan të kenë privilegje e të përfitojnë nga qenja në Parti, ose porsa marrin ndonjë pozitë, fillon t'u rritet mendja. Në këtë mënyrë këta komunistë nuk e kanë sa duhet simpatinë e masës. Prandaj këto çështje, që kanë të bëjnë me figurën e anëtarit të Partisë, të shtrohen në organizatën bazë, të diskutohen dhe të bëhet kështu edukimi i komunistëve. Një punë më të organizuar duhet të bëjnë organizatat bazë të Partisë edhe me masat në kooperativat bujqësore. Me përjashtim të disa çështjeve të brendshme organizative të Partisë, që s'kanë pse t'i dinë të tjerët, s'ka çështje që të mos e dijë kolektivi, s'ka pse të mbahen fshehtë ato

probleme që kërkojnë mobilizimin e njerëzve pa parti. Kjo është e lidhur me çështjen se sa e ka kuptuar anëtarë i Partisë autokritikën, kritikën dhe demokracinë e brendshme, t'i jepet liri kolektivit, anëtarëve të asamblesë që të thonë fjalën e vet, të marrin vendime sipas rastit, t'u bëjnë kritikën njerëzve që kanë bërë gabime cilëtdo qofshin këta, të ulin nga përgjegjësia ata që nuk punojnë mirë dhe të zgjedhin ata që do asambleja, e cila është organi më i lartë i kooperativës bujqësore. Të gjitha këto do të shpien në forcimin e kooperativave bujqësore dhe do të ketë më shumë iniciativë nga anëtarët e tyre. Edhe në Korçë, siç u vu në dukje, ka mjaft dobësi, të cilat janë të rrezikshme. Këto dobësi janë fodullëku, tarafilëku, ekzistenca e një moskënaqësie të heshtur etj. Na ndodh si me kryetarin e kooperativës së Lumalasit që ofendon rëndë fshatarët. Po sikur t'ja shtrosh popullit këtë çështje e të kritikohet hapët ky komunist, me siguri do t'i dalin atij edhe gjëra të tjera dhe mund të hiqet fare nga detyra që ka.

U ngrit këtu çështja që në kooperativat bujqësore të dërgohen njerëz nga qyteti dhe u suall si shembull BS, ku është vepruar kështu. Edhe ne kemi shokë të mirë që mund të dërgohen në fshat, kjo punë do bërë me kujdes se nuk i kemi të tepërt e nuk duhet të dobësojmë punën në sektorë të tjerë. Është e vërtetë që shefa kontabël mund të shkojnë nga qyteti në fshat, por këta do të jenë vetëm për llogarinë.

Vendimin që po merr sot Byroja Politike, duhet ta punojmë në të gjitha rrethet e të bëhet një kthesë e fortë drejt forcimit të kooperativave bujqësore. Veçanërisht të forcohen organizatat e Partisë në kooperativa

dhe të ndihmohen ato që të zbatohen normat e statutit të kooperativave bujqësore dhe demokracia e brendshme e Partisë. Në radhë të parë t'i kushtohet kujdes mbarëvajtjes së kooperativave nga ana ekonomike për përmirësimin e jetës duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë që ka kooperativa dhe shteti ynë. Përsa u përket çështjeve që ngriti Peti¹ si normat e punës, plehrat etj., ato janë të drejta dhe duhen parë në çdo qark; të mos kënaqen kooperativistët me normat që kanë, po të ngrihen ato vazhdimisht e të jenë më të larta, pse asnjëri nuk ua merr prodhimin.

Duhet të organizohet edhe dërgimi i kooperativistëve të një kooperative për të vizituar një kooperative tjetër pse fshatarët duhet t'i shohin konkretisht të mirat e kolektivizimit. Prandaj, të venë për shembull nga Lushnja ose nga ndonjë rreth tjetër në Korçë. Ne dërgojmë delegacione për të parë edhe në BRSS. Natyrisht këto delegacione duhet t'i organizojë aparati i Komitetit Qendror dhe Ministria e Bujqësisë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

¹ Peti Shamblli, në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të qarkut të Korçës.

MBI KONTROLLIN E PARTISË PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË PUNËTORËVE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

23 nëntor 1953

Unë jam i mendimit se organet e pushtetit, të Partisë dhe bashkimet profesionale nuk punojnë si duhet për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Partia duhet të kontrollojë zbatimin e ligjeve të shtetit, pse aty gjen shprehje konkrete vija e saj e drejtë. Unë kam përshtypjen se në zbatimin e këtyre ligjeve, anëtarët e Partisë nuk janë sa duhet shembull i mirë për të tjerët, shembull organizimi, kontrolli e mobilizimi. Kjo

¹ Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH rreth raportit të paraqitur nga Këshilli Qendror i Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë «Mbi zbatimin e ligjshmërisë në favor të punëtorëve». Në këtë raport trajtoheshin këto çështje kryesore: sigurimi i kushteve teknike e higjienike në punë, koha e punës, e pushimit dhe e trajtimit në punë dhe mbi furnizimin e banesat e punëtorëve.

komprometon rolin udhëheqës të Partisë duke filluar nga poshtë e deri lart.

Ne e dimë që ka gabime në planifikim, ka vështirësi në realizimin e planit, ka çështje që në perspektivë duhet të realizohen, por ka dhe çështje që, megjithëse janë mundësitë, nuk bëhen përpjekjet e duhura që ato të realizohen. Kur drejtori i një ndërmarrjeje nuk realizon angazhimet që ka marrë para punëtorëve, duhet të thirret përpara Partisë dhe t'i kërkohej llogari. Për planin e shtetit mobilizohet dhe e realizon kolektivi punonjës me anëtarët e Partisë në krye, por ka dhe një sërë problemesh që duhen zgjidhur në rrugë shtetërore nga drejtuesit e fabrikës. Këtu një rol politik ka edhe organizata e Partisë, ajo duhet të marrë vendime dhe të hedhë në aksion të gjithë njerëzit, edhe drejtuesit, e ndërmarrjeve për realizimin e tyre. Në këtë fushë, natyrisht, do të ketë vështirësi, por ato duhen kapërcyer. Të marrim çështjen e furnizimit të punëtorëve. Partia duhet të shikojë nëse po bëhet mirë ose jo ky furnizim dhe, kur konstaton mungesa, thërret drejtuesit e ndërmarrjes dhe u kërkon llogari pse kanë mbetur punëtorët pa ushqime. Këta drejtues raportojnë, japin llogari, tregojnë përpjekjet që kanë bërë, të metat që pengojnë dhe thonë që nuk kanë çfarë të bëjnë më tej. Atëhere çështjet i merr në dorë komiteti i Partisë, i cili menjëherë njofton edhe Komitetin Qendror të Partisë. Këtu thirren menjëherë ministrat ose zëvendësministrat përkatës, të cilët vihen përpara përgjegjësisë dhe porositen të marrin masat e nevojshme. Në të njëjtën kohë aparati i Komitetit Qendror kontrollon si zbatohen këto masa, i përgjigjet komitetit të Partisë se kur do të zgji-

dhen çështjet dhe, në rast se ato mbeten pa u kryer, sekretari i Komitetit Qendror i bën probleme të Byrosë Politike. Kështu me këmbëngulje, me rigorozitet e deri në fund duhet t'i ndjekim çështjet. Por më duket se në aparatin e Komitetit Qendror ka familjaritet në shtruarjen e detyrave dhe në kërkimin e llogarisë. Njerëzit duhet të vihen përpara përgjegjësisë dhe dhënjes llogari për zbatimin e tyre. Në rast se ato nuk zbatohen, puna vete deri lart në organet udhëheqëse të Partisë e të qeverisë. Masat e Partisë dhe të shtetit duhet të jenë të koordinuara me qëllim që detyrat të kryhen deri në fund. Kështu do të ngrihet edhe përgjegjësia e ndërjegjegjja e njerëzve për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, e cila varet shumë nga puna e shëndoshë e Partisë dhe e bashkimeve profesionale. Ne duhet të arrijmë që sekretari i organizatës bazë të Partisë, në qoftë se është tornitor, të punojë në torno, kurse pas punës të punojë për çështjet e organizatës bazë, të kërkojë llogari deri në fund për detyrat e vëna, sepse atë e ka zgjedhur organizata bazë e Partisë si sekretar të saj.

Bashkimet profesionale, nën udhëheqjen e Partisë duhet të punojnë më konkretisht për të mbrojtur ligjet. Në qoftë se në Kombinatin e tekstileve «Stalin» furnizimi nuk është i mirë, megjithëse për këtë ka njerëz që interesohen direkt, por zëri i tyre nuk dëgjohet, atëhere bashkimet profesionale ndërhyjnë, bisedojnë me drejtuesit e ndërmarrjes se si qëndron çështja dhe po qe se nuk zgjidhet, shkojnë në komitetin e Partisë dhe e ngrenë problemin ashtu siç porositet e mund të bëjnë edhe propozimet e tyre. Dhe organizata e Partisë duhet të jetë në lartësinë e duhur, të ketë autoritet dhe kur

kjo t'i kërkojë drejtorit të raportojë, ky të mos e ketë lehtë dhe ajo që ka rëndësi është që problemi i furnizimit të zgjidhet shpejt, ndryshe çështja t'i referohet edhe Komitetit Qendror të Partisë. Në rrugën e tyre, bashkimet profesionale njoftojnë Këshillin Qendror, i cili e ngre problemin gjithashtu në Komitetin Qendror të Partisë. Këtu pastaj zbatohet procedura që thashë më sipër, pra, në rast se dikasteri nuk kryen detyrat që i takojnë, atëhere puna shkon deri në Byronë Politike. Në këtë mënyrë, bashkimet profesionale, në qoftë se e ngrenë zërin, pavarësisht se kush është ai që neglizhon në furnizimin e punëtorëve, atëhere kanë bërë punë të mirë, kështu ngrihet edhe autoriteti i Partisë. Derisa çështja është për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, që janë caktuar me ligj, bashkimet profesionale janë të plotfuqishme për të zbatuar vendimet e Partisë e të qeverisë.

Pastaj ka edhe gjëra të vogla që influencojnë në çështjen e prodhimit. Këto, bashkimet profesionale mund t'i plotësojnë edhe pa fonde, por në këtë drejtim më duket se bëhet shumë pak. Ai që punon me bashkimet profesionale nuk duhet të ketë frikë për të ngritur zërin, kur është çështja për të mbrojtur të drejtat e punëtorëve, të cilat janë të garantuara me ligj. Inspektorët dhe instruktorët duhet të jenë më shumë të armatosur me këto parime të Partisë.

Edhe organizata e rinisë duhet të aktivizohet në këtë drejtim, ajo gjithashtu nuk duhet të ketë frikë të flasë, pse bëhet ky ose ai pushim nga puna etj. Ajo, nën udhëheqjen e Partisë duhet të luajë një rol të madh

duke propaganduar dhe duke zbatuar vijën e Partisë për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve.

Jam dakord që këto çështje të shtrohen në qeveri, por ato duhet të paraqiten konkretisht dhe për disa prej tyre, si zbatimi i kontratave kolektive, furnizimi i punëtorëve etj., të thërresim 2-3 drejtorë ndërmarrjesh që janë më të zot si dhe 2-3 të tjerë që nuk punojnë mirë për këto çështje dhe t'i vëmë para përgjegjesisë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

MBI PËRJASHTIMET NGA PARTIA

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

30 nëntor 1953

Çështja e përjashtimeve nga Partia është mjaft serioze. Masat e marrura deri në përjashtim e kanë burimin në kujdesin akoma të paktë të udhëheqjes së Partisë, në nivelin e ulët të shokëve të Partisë, në luftën e pamjaftueshme që zhvillojnë organizatat bazë të Partisë për edukimin e komunistëve nga ana teorike. Si rrjedhim, ka shfaqje të sëmura siç janë: arbitrariteti, ambiciet, meritë, sidomos në fshat ku përjashtimet nga Partia nuk bëhen si duhet në bazë të kritereve të shëndosha. Atje njerëzit kanë më shumë mbeturina mikroborgjeze, atje sekretarët e organizatave bazë të Partisë kanë marrë kompetenca që nuk u takojnë, ata janë veshur me një autoritet të tillë, saqë përpara tyre, ka komunistë që mbyllin gojën. Kjo bën që disa ko-

¹ Në këtë mbledhje të Byrosë Politike u diskutua rreth raportit «Mbi përjashtimet nga Partia dhe masat ndëshkimore».

munistë me nivel të ulët ta shohin Partinë te sekretari dhe jo në vetë organizatën bazë, në unitetin e mendimit dhe të veprimit të të gjithë anëtarëve të Partisë dhe të arrijnë të mendojnë se duhet bërë ashtu si thotë sekretari, pse «ai ka lidhje me komitetin e Partisë» e, «po të mos bëhet si thotë ai, të bën gjëmën». Të mendohet kështu është gabim, pse sekretari i organizatës bazë është një shok që bashkë me anëtarët e tjerë të byrosë, zgjidhen për të drejtuar nga njëra mbledhje në tjetrën, por ata si dhe çdo komunist, veprojnë në bazë të vendimeve që merr organizata bazë, e cila duhet ta kontrollojë sekretarin e vet.

Neve nuk na vjen mirë që shumë kandidatë partie vazhdojnë të mbeten të tillë prej 3-4 vjetësh e më në fund të mos pranohen anëtarë partie, por për ta shtrohet çështja «të pranohen në Parti apo jo», bile për disa arrihet edhe në përjashtim. Është shumë e rëndë ta përjashtosh kandidatin, të cilin Partia e pret të bëhet anëtar i denjë i saj. Kjo kërkon që ata të punojnë pa u lodhur për ta merituar titullin e lartë të anëtarit të Partisë, por për ta duhet të interesohet më tepër edhe organizata bazë e Partisë, ajo t'i ngrejë dhe t'i edukojë pastaj t'i pranojë në radhët e saja e të pranojë edhe kandidatë të tjerë dhe vetëm shumë pak të hidhen jashtë Partisë e këta në kohën e duhur. Është më mirë të pranojmë më pak kandidatë për anëtarë partie, se sa të pranojmë shumë dhe pastaj të detyrohemi t'i përjashtojmë. Përjashtimet duhet t'i shohim më kujdes dhe kur të arrijmë këtu, të mendojmë mirë.

Pranimet në Parti varen shumë edhe nga zbatimi i Statutit. Nuk di sa mbahen parasysh rregullat që për-

caktohen në Statut, për shembull përgjegjësia e atyre që japin rekomandim për anëtarët e rinj të Partisë. Kur një komunist përjashtohet, çfarë bëhet me këta njerëz që i kanë dhënë rekomandimet? Mua më duket se në këto raste rekomanduesit nuk vihen përpara përgjegjësia. Prandaj, unë mendoj të ngrihet më tepër përgjegjësia e njerëzve që rekomandojnë kandidatët dhe anëtarët e Partisë, të mos mbetet kjo si një çështje formale. Por kjo nuk është një gjë e thjeshtë, sepse këtu ka raste hatëresh, oportunizmash, miqësish familjare etj., kundër të cilave duhet bërë luftë e vazhdueshme nga organizatat bazë dhe nga komitetet e Partisë. Edukimi i komunistëve, kalitja e tyre ideologjike me parimet e Partisë, me vijën e saj marksiste-leniniste, luan një rol të madh për të mos arritur komunisti deri në përjashtim nga Partia. Ne i zgjedhim mirë njerëzit që kërkojnë të hyjnë në Parti, njohim mirë cilësitë e tyre, punojmë që t'i përgatitim, por edhe pas kësaj duhet të luftojmë që të edukohen dhe të bëhen komunistë të mirë dhe jo t'i pranojmë e pastaj t'i përjashtojmë. Prandaj, komunistët duhet të jenë të lidhur mirë me jetën dhe me veprimtarinë e përditshme të organizatave bazë, që ata të ngrihen, të rriten. Por do të ndodhë që edhe duke qenë anëtarë partie, ndonjëri mund të gabojë, pse nuk mjafton të kemi të qartë vetëm parimin, por duhet ta zbatojmë atë mirë në jetë. Prandaj përgjegjësi shumë e madhe u bie shokëve të komiteteve të Partisë dhe atyre të organizatave bazë, që të forcojnë më shumë punën për edukimin e komunistëve, kritikën e autokritikën, që komunistët në organizatën bazë ta ndjejnë veten si në shtëpinë e tyre dhe të luftojnë për

të mbrojtur vijën e Partisë, të drejtat e tyre, të cilat Partia ua ka siguruar me Statut. Po të kuptohet mirë kjo, organizata do të jetë luftarake, një shkollë e vërtetë e edukimit revolucionar. Në këtë mënyrë, organizata bazë do të luajë rolin e një kudhre, ku komunistët kaliten e gabimet do të ndreqen më me lehtësi në rrugën e Partisë dhe jo në rrugën burokratike.

Një çështje me rëndësi është edhe ajo e ish-anëtarëve të Partisë, të cilët janë përjashtuar. Partia e ka dhënë orientimin se si duhet të konsiderohen ata që janë përjashtuar, po në fakt ky orientim nuk zbatohet si duhet, pse njerëzit që përjashtohen nuk trajtohen sipas mësimeve të Partisë. Direktiva e Komitetit Qendror ka qenë që përveç atyre që janë armiq, të tjerët duhet të mbahen afër Partisë, pse ata kanë qenë në Parti dhe i dinë rregullat e saja, njohin disiplinën e Partisë, kanë nostalgjinë dhe dashurinë për Partinë. Përsëri mund të vijë koha që shumë nga këta njerëz të rehabilitohen, prandaj Partia duhet të ketë parasysh t'i futë në luftë dhe në punë e të shohë se ç'përmirësime bëjnë. Bile këta njerëz duhet të vihen në provë veçanërisht për të përmirësuar dobësitë për të cilat janë përjashtuar, sigurisht edhe për të metat e tjera. Në rast se për shembull, një komunist, i cili është përjashtuar me motivacionin: «Nuk ka qenë i sigurtë me Partinë», trajtohet keq, kjo nuk është në interesin e Partisë, por të armiqve të saj. Nuk do të ishte rrezik për Partinë në rast se elementë të tillë, të cilët janë të përjashtuar, të mbaheshin afër Partisë, të edukoheshin e të mobilizoheshin nga Partia. Sigurisht përjashtimi i tyre për gabimet që kanë bërë e ka forcuar Partinë, po një

qëndrim jo i rregullt ndaj tyre pas kësaj, e dobëson Partinë, prandaj të zbatohet direktiva e Partisë duke u dhënë dorën. Ndryshe, po të mos veprojnë Partia me ta, dikush tjetër do të punojë dhe ky do të jetë armiku, i cili do të përpiqet t'i bëjë një forcë kundër Partisë.

Jam i mendimit ashtu si të gjithë shokët, që këto çështje të shihen më mirë qysh këtu në Komitetin Qendror dhe të punojmë më seriozisht për të përmirësuar punën si për edukimin e komunistëve, ashtu dhe me ata që janë përjashtuar jo si armiq të Partisë. Në këto drejtime t'u japim një ndihmë më të organizuar edhe qarqeve e rretheve dhe të vëmë herë pas here në korrent edhe Byronë Politike.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

NË REPUBLIKËN POPULLORE TË SHQIPËRISË PO NDËRTOHEN ME SUKSES BAZAT E SOCIALIZMIT¹

Nëntor 1953

Populli shqiptar, nën udhëheqjen e Partisë së tij Komuniste, me luftën e tij heroike kundër pushtuesve fashistë italianë e gjermanë dhe tradhëtarëve të vendit, në nëntor të vitit 1944 mundi të çlirohet. Ai mundi ta fitojë lirinë edhe në saje të faktit që Ushtria e lavdishme Sovjetike kishte shpartalluar në atë kohë në një front të gjerë, që shtrihej nga Oqeani i Ngrirë deri në Detin e Zi, forcat kryesore të fashistëve gjermanë e italianë.

Që në ditët e para të okupacionit, që në vitin 1939, populli shqiptar zhvilloi një luftë të papajtueshme kundër pushtuesve. Përvoja e jetës i kishte treguar popullit tonë se, për të fituar çlirimin e vet kombëtar, ai nuk mund t'u zinte besë as peshkaqenëve imperialistë, që e trajtonin vendin e tij si një monedhë këmbimi, as feudalëve vendës e borgjezisë, që ishin të gatshëm të bëheshin vegla të shtypësve të huaj dhe kishin tradhëtuar e kishin shitur vendin e tyre.

¹ Artikull i botuar në revistën «Komunist»

Lufta e popullit shqiptar qysh në fillim mori karakter antifashist, antiimperialist, antifeudal; ajo ishte një luftë që drejtohej si kundër zaptuesve të huaj, ashtu edhe kundër feudalëve vendës, kundër borgjezisë së madhe tregëtare, nëpunësve të lartë reaksionarë, oficerëve reaksionarë. Me këtë u hap rruga dhe u përgatit terreni për vendosjen e pushtetit popullor, për krijimin e rendit të ri, demokratik popullor.

Në lëvizjen nacional-çlirimtare morën pjesë masat e gjera të udhëhequra nga elementët më revolucionarë në radhët e klasës punëtore dhe të fshatarësisë së varfër, që në kushtet e ilegalitetit të rëndë ishin bashkuar në grupet komuniste. As plumbat as trekëmbshat e as torturat nuk mundën ta ndalnin popullin tonë.

Gjatë lëvizjes nacional-çlirimtare u krijuan kushtet e nevojshme për formimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë, e cila u themelua më 8 nëntor 1941 (në nëntor 1948 Partia Komuniste e Shqipërisë u quajt Partia e Punës e Shqipërisë).

Partia Komuniste e Shqipërisë, duke mbajtur lart flamurin e leninizmit, udhëhoqi luftën heroike për lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë, për interesat jetike të popullit punonjës. Më 16 shtator 1942 në Konferencën e Pezës, të thirrur me inisiativën e Partisë Komuniste të Shqipërisë, u hodhën themelet e pushtetit të ri revolucionar, në formën e këshillave nacional-çlirimtare. Po ato ditë u krijua Fronti Nacional-Çlirimtar, një organizatë e gjerë masash, ku mund të merrnin pjesë, pavarësisht nga bindjet politike e fetare, të gjithë ata që ishin gati të luftonin kundër pushtuesve dhe shërbëtorëve të tyre.

Në organet e reja të pushtetit, punonjësit e qytetit e të fshatit shikonin pushtetin e tyre revolucionar; ata zgjodhën në këshillat nacional-çlirimtare njerëz të ndershëm e të devotshëm ndaj interesave të popullit, ndaj çështjes së çlirimit të tij. Këshillat nacional-çlirimtare u ngritën si në krahinat e çliruara, ashtu edhe në krahinat që ende ndodheshin nën thundrën e pushtuesve fashistë. Këto këshilla u bënë embrioni i pushtetit demokratik popullor. Në këshillat masat mësonin vetëqeverisjen, mësonin të zgjidhnin problemet e ndryshme ekonomike e politike ashtu si e lypnin interesat e popullit. Pushteti i ri popullor, u forcua, e zgjeroi bazën e vet, u bë një armë përherë më e fuqishme për çlirimin nga pushtimi fashist dhe për shkatërrimin e pushtetit të feudalëve e të borgjezisë.

Më 24 maj 1944 në qytetin e Përmetit u mbajt Kongresi I Antifashist Nacional-Çlirimtar. Kongresi zgjodhi Këshillin Antifashist Nacional-Çlirimtar, duke e shpallur atë si organin më të lartë legjislativ. Nga gjiri i vet ky këshill zgjodhi Komitetin Antifashist Nacional-Çlirimtar, që ishte organi ekzekutiv kryesor.

Kongresi i Përmetit adoptoi një rezolutë, në të cilën shtrohej detyra që

«Të ndërtohet Shqipëria e re demokratike popullore sipas vullnetit të popullit, që sot e shpreh solemnisht në Këshillin Antifashist Nacional-Çlirimtar, i cili është me të vërtetë një pushtet popullor, i datë nga Lufta nacional-çlirimtare që po bën populli shqiptar»¹.

¹ «Dokumenta të organeve të larta të pushtetit revolucionar nacional-çlirimtar» (1942-1944). f. 157. Tiranë 1962.

Kongresi u dha një goditje vdekjeprurëse kuislingëve; ai qe edhe një grusht për intrigat e reaksionit amerikano-anglez, që kërkonte të krijonte një «qeveri» reaksionare brenda vendit ose jashtë kufive të tij për t'ja rrëmbyer nga duart popullit shqiptar fitoret e aritura. Kongresi i Përmetit u shpreh kundër monarkisë dhe ja ndaloi hyrjen në Shqipëri veglës së feudalëve, mbretit Ahmet Zogu.

Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar mori vendim që të likuidoheshin koncesionet e huaja, si dhe të denoncoheshin marrëveshjet politike dhe ekonomike të lidhura nga qeveria e Zogut ose nga qeveritë e tjera reaksionare të Shqipërisë. U vendos të mos njihej asnjë marrëveshje ndërkombëtare që mund të përfundohej brenda vendit ose jashtë tij nga klikat reaksionare, që vepronin si «grupe politike» apo si «qeveri».

Në tetor 1944, në prakun e çlirimit të plotë të Shqipërisë mbledhja e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar, që u mbajt në Berat, mori vendim që Komiteti Antifashist Nacional-Çlirimtar të kthehej në qeveri demokratike. Kjo qeveri bëri betimin përpara përfaqësuesve të popullit dhe më 29 Nëntor 1944 mbërriti në kryeqytetin e Shqipërisë së çliruar — në qytetin e Tiranës.

Në shembullin e Shqipërisë u vërtetua plotësisht edhe një herë teza e leninizmit se proletariati, që përbën pakicën e popullsisë, mund të grumbullojë rreth tij shumicën dërmuese të popullsisë — fshatarësinë punonjëse dhe të gjithë punonjësit e tjerë — dhe ta udhëheqë popullin drejt një jete të re. Klasa punëtore shqiptare e paktë nga numri, e udhëhequr nga pararoja

e saj luftarake, Partia Komuniste, u vu në krye të luftës së popullit për vendosjen e rendit demokratik popullor, duke përfitur nga gjendja e jashtme dhe e brendshme e favorshme e krijuar me shpartallimin e fashizmit nga populli sovjetik në Luftën e dytë botërore.

Më 2 dhjetor 1945 mbi një bazë demokratike të gjerë u bënë zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese. Duke plotësuar dëshirën e popullit shqiptar Asambleja Kushtetuese më 11 janar të vitit 1946 mori vendimin mbi shpalljen e Republikës Popullore të Shqipërisë, kurse më 14 mars aprovoi kushtetutën e re, me të vërtetë demokratike. Kjo kushtetutë i sanksionoi me ligj transformimet rrënjësore politike e sociale, që u bënë si rezultat i revolucionit demokratik popullor dhe i vendosjes së rendit të ri.

Partia e Punës e Shqipërisë i ka arritur të gjitha këto fitore sepse është kujdesur pareshtur për interesat e popullit dhe të atdheut. Çdo fitore jona — ushtarake, politike dhe ekonomike — është e lidhur ngushtë me ndihmën e Bashkimit Sovjetik. Populli shqiptar ka një dashuri dhe mirënjohje të pakufishme për Bashkimin Sovjetik. Heroizmat e Ushtrisë Sovjetike e shpëtuan Shqipërinë nga intervencioni i armatosur i imperialistëve anglezë dhe amerikanë, të cilët deshën të mos e linin popullin shqiptar të merrte pushtetin në duart e veta, të mos lejonin që klasa punëtore dhe reparti i saj pararojë, Partia Komuniste, të bëheshin forca udhëheqëse e popullit.

Në prakun e çlirimit të Shqipërisë imperialistët anglezë dhe amerikanë u përpoqën të zbarkonin në brigjet e saj trupa anglezë për të zëvendësuar pushtue-

sit fashistë gjermanë dhe për të ndihmuar bandat e kuislingëve. Por nuk ja arritën dot këtij qëllimi. Pas çlirimit të vendit imperialistët e SHBA-së dhe të Anglisë i përdorën përfaqësuesit e tyre diplomatikë për të bashkuar elementët reaksionarë; ata organizuan në tokën shqiptare akte sabotimi e terrori, provokuan incidente me karakter ndërkombëtar, duke pregatitur një intervencion të armatosur për përmbysjen e pushtetit popullor. Ata hapën një fushatë kundër pjesëmarrjes së Shqipërisë në Konferencën e Paqes, mohuan të drejtat ndërkombëtare të vendit tonë.

Një rol aktiv në veprimtarinë antishqiptare të blokut amerikano-anglez u takon titistëve. Ata u përpoqën që nën maskën e «aleancës e të miqësisë» të shkatërrojnë shtetin dhe Partinë tonë, ta kthenin Shqipërinë në një koloni të vetën; ata kishin kurdisur një plan për ta pushtuar ushtarakisht vendin tonë. Në këtë politikë titistët kishin gjetur mbështetje te një grup renegatësh shqiptarë, te trockistët me Koçi Xoxen në krye.

Por të gjitha orvatjet e imperialistëve dhe të agjunkturës së tyre në Ballkan, për të penguar zhvillimin e shtetit tonë, dështuan sepse Partia jonë i ruan me vigjilencë interesat jetike të popullit tonë.

Me kalimin e viteve shteti ynë demokratik popullor u forcua. Baza e rendit demokratik në Shqipëri është aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse e krijuar që gjatë luftës. Ndër fshatarët shqiptarë është forcuar besimi se vetëm në aleancë me klasën punëtore, vetëm nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe të Partisë së saj mund të ndërtohet jeta e re, e lumtur. Pas çlirimit populli shqiptar ju përvesh me entuziazëm

të madh rimëkëmbjes së ekonomisë, duke u përpjekur t'i shëronte sa më shpejt plagët që i shkaktoi lufta, të krijonte bazën ekonomike të domosdoshme për të ecur në rrugën e socializmit. Populli ka besim të patundur në drejtësinë e vijës që ndjek Partia, duke e parë realizimin konkret të kësaj vije në ngritjen e nivelit material e kultural të jetës së masave punonjëse.

Për forcimin e shtetit tonë dëshmojnë zgjedhjet e bëra në qershor të vitit 1949 për këshillat e fshatrave, të lokaliteteve dhe rretheve, si dhe zgjedhjet për Kuvendin Popullor të 28 majit 1950 dhe zgjedhjet e organeve lokale të pushtetit popullor në shtator 1952. Në këto zgjedhje për kandidatët e Frontit Demokratik votuan përkatësisht 94,8 për qind, 99,1 për qind dhe 99,77 për qind të të gjithë votuesve.

Partia dhe gjithë populli kanë fituar një përvojë të madhe lufte kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm. Vigjilenca kundrejt imperialistëve dhe shërbëtorëve të tyre është forcuar. Partia forcon pareshtur pushtetin popullor, i cili po fiton një përvojë gjithnjë më të madhe në punën e organizimit të ekonomisë dhe në atë kulturele-edukative, forcon mbrojtjen e vendit dhe shtyp mbeturinat e reaksionit të brendshëm.

Kongresi I i Partisë Komuniste të Shqipërisë, që u mbajt në nëntor të vitit 1948, që një ngjarje e shënuar në jetën e Partisë dhe të vendit. Kongresi vendosi se në të ardhshmen zhvillimi i ekonomisë dhe i kulturës së Shqipërisë do të ndiqte rrugën e ndërtimit të bazave të socializmit.



Në regjimin antipopullor të Zogut Shqipëria ishte një vend tepër i prapambetur nga pikëpamja ekonomike dhe kulture. Pushtuesit italianë e gjermanë e shkatërruan krejt ekonominë e saj që edhe ashtu ishte në një gjendje të mjeruar: ata shkatërruan miniera e rrugë komunikacioni, dogjën shumë punishte e fabrika. Prodhimi u paralizua.

Që në ditët e para pas çlirimit filloi rimëkëmbja e ekonomisë kombëtare. Një rëndësi shumë të madhe pati shtetëzimi i ndërmarrjeve industriale me vlerë nacionale, gjë që lejoi të krijohet sektori socialist në ekonominë e Shqipërisë. Qysh në vitin 1946 pjesa e industrisë socialiste, duke përfshirë kooperativat e artizanatit, përbënte 73 për qind, ndërsa prodhimi i industrisë private — vetëm 27 për qind të prodhimit global. Më vonë sektori socialist u rrit edhe më shumë. Më 1950 prodhimi i industrisë socialiste përbënte 95 për qind, kurse pjesa e ndërmarrjeve industriale private — vetëm 5 për qind të prodhimit global. Për rritjen e shpejtë të industrisë dëshmon fakti që në fund të vitit 1950 prodhimi i industrisë kishte arritur 395 për qind në krahasim me nivelin e vitit 1938.

Në saje të kredive që na janë dhënë nga Bashkimi Sovjetik, në saje të çmimeve shumë të leverdisshme për ne të mallrave dhe të pajisjeve industriale që na shiten nga BRSS, si dhe në saje të ndihmës së madhe teknike, Shqipëria ka korrur suksese të rëndësishme në rrugën e ndërtimit të bazave të socializmit.

Industria, bujqësia, arësimi e kultura e vendit tonë po zhvillohen nga viti në vit. Në fund të vitit 1949 Kuvendi Popullor i Shqipërisë aprovoi ligjin mbi planin shtetëror dyvjeçar të zhvillimit të ekonomisë (1949-1950). Ky plan parashikonte një rritje të madhe të industrisë e të bujqësisë. Në vitin 1950 investimet kapitale për industrializimin ishin rritur 5 herë në krahasim me vitin 1946. Plani i prodhimit industrial më 1950 u realizua 105 për qind.

Duke u mbështetur në patriotizmin e lartë të popullit shqiptar, në punën e tij heroike, në ndihmën e madhe dhe pa interes të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore, Kongresi II i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Kuvendi Popullor aprovuan planin e parë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë kombëtare (për vitet 1951-1955). Realizimi i këtij plani do ta shndërrojë Shqipërinë nga një vend agrar i prapambetur në një vend agraro-industrial. Prodhimi industrial në vitin 1955 do të arrijë 339 për qind kundrejt nivelit të vitit 1950 dhe në krahasim me nivelin e paraluftës do të shtohet 12 herë. Shtimi mesatar vjetor i prodhimit do të arrijë 27,7 për qind, ndërsa në periudhën e realizimit të planit dyvjeçar ai ishte 10,5 për qind.

Një kujdes i madh tregohet për industrinë nxjerrëse. Pushtuesit fashistë i shkaktuan një dëm të madh industrisë minerare dhe për këtë arsye menjëherë pas çlirimit të vendit u morën masa të ngutshme për rindërtimin e saj. Prodhimi global i industrisë minerare më 1952 kishte një shtim prej 30 për qind në krahasim me vitin 1951 dhe prej 387 për qind në krahasim me

vitin 1938. Plani pesëvjeçar parashikon të bëhen investime të mëdha në industrinë minerare. Industria vajguore e vendit tonë do të rritet me të shpejtë. Më 1955 sasia e vajgurit të nxjerrë do të shtohet 2 herë në krahasim me vitin 1950. Po ndërtohet një rafineri e madhe vajguri, e cila do t'i plotësojë të gjitha nevojat e vendit me produkte vajguore dhe do të japë mundësi të zgjerohet eksportimi i bitumit vajguror. Fonde të mëdha janë caktuar për zhvillimin e industrisë qymyrguore. Më 1955 sasia e qymyr gurit të nxjerrë do të rritet 6 herë në krahasim me vitin 1950. Do të shtohet në mënyrë të dukshme edhe nxjerrja e bitumit natyral, e kromit, e bakrit etj.

Janë ngritur ndërmarrje që janë krenaria e popullit shqiptar. Me ndihmën e Bashkimit Sovjetik janë ndërtuar Hidrocentralet «Lenin», Kombinati i tekstileve «Stalin», Fabrika e sheqerit «8 Nëntori», që kanë pajisje nga më modernet. Gjatë vitit 1952 — viti i dytë i pesëvjeçarit — u përfunduan dhe u vunë në shfrytëzim ndërmarrje industriale të tilla si Kombinati i drurit «Nako Spiru», Fabrika e fermentimit të duhanit «Vasil Shanto», Uzina e zhveshjes së pambukut «Kajo Karafili», një fabrikë për staxhionimin e lëndës së drurit, një fabrikë për zhveshjen e orizit. Në tetor të këtij viti dha prodhimin e vet e para fabrikë tekstilësh të leshta në vendin tonë. Përfundoi ndërtimi i uzinës së ekstrakt-taninit, vazhdon ndërtimi i një fabrike të madhe çimentoje. Po ngrihet një hidrocentral mbi lumin e Matit.

Në vitin 1955 prodhimi i industrisë ushqimore do ta tejkalojë 5 herë nivelin e vitit 1950, ndërsa prodhimi

i industrisë së lehtë — gati 8 herë. Do të ndërtohen fabrika e uzina të reja për prodhimin e vajit vegjetal, të konservimit të peshkut, të frutave e të zarzavateve, për fabrikimin e litarit, të materialeve të ambalazhit etj. Do të zgjerohen uzinat e përpunimit të metaleve. Zhvillimi i industrisë do të krijojë mundësinë që të pakësohet importi i disa mallrave të konsumit të gjerë dhe i veglave të thjeshta të punës, do të përmirësojë furnizimin e popullsisë me mallra industriale dhe do të lejojë të shtohen eksportimet.

Përpara industrisë qeveria ka shtruar si një nga detyrat themelore që të punojë me kapacitet të plotë, të realizojë planin edhe si sasi edhe si cilësi, në mënyrë që t'i furnizojë pa ndërprerje punonjësit e qytetit e të fshatit me sende konsumi. Janë marrë masa për përmirësimin e punës në industrinë ekzistuese, për shfrytëzimin e të gjitha kapaciteteve të saj prodhuese dhe për mobilizimin e të gjitha burimeve të vendit.

Po forcohen kooperativat e prodhimit; po krijohen kushtet për një zhvillim sa më të gjerë të kooperativave të artizanatit me qëllim që ato të bëhen ndihmëse aktive të industrisë shtetërore në furnizimin e popullit, sidomos të fshatarësisë. Në kohën e tanishme po i kushtohet shumë vëmendje zgjerimit të industrisë ushqimore me qëllim që të furnizohet më mirë popullsia me sende ushqimore. Masa të posaçme po merren për përmirësimin e mëtejshëm të kushteve të strehimit për punonjësit e vendit nëpërmjet zgjerimit të ndërtimit të shtëpive të banimit, të çerdheve të fëmijëve etj. Qeveria u jep ndihmë punonjësve të qyteteve e të fshatrave në këtë ndërtim; për këtë qëllim popullsisë tani i shiten më

shumë lëndë ndërtimi, tulla, tjegulla, gëlqere, qereste, gozhdë, çimento etj.

Të gjitha këto masa të marrura nga qeveria u përgjigjen interesave të klasës punëtore dhe të të gjithë punonjësve dhe do të ndihmojnë në përmirësimin e mëtejshëm të jetës së tyre.

Me zhvillimin e ekonomisë kombëtare u rrit edhe klasa punëtore. Efektivi i punëtorëve më 1952 përbënte 153 për qind në krahasim me vitin 1950, kurse më 1955 do të arrijë në 180,4 për qind. Klasa punëtore është rritur jo vetëm si numër, por edhe nga pikëpamja cilësore, ajo është bërë e organizuar, e bashkuar, ka ngritur më lart nivelin kultural dhe kualifikimin e vet. Mijëra punëtorë ndjekin shkollën. Për përgatitjen e punëtorëve, përveç kurseve të ngritura në ndërmarjet, janë organizuar shkolla profesionale. Më 1952 për të parën herë në vendin tonë u hapën shkollat e rezervave të punës, të cilat i kanë frekuentuar 2 700 vetë. Janë ngritur edhe disa shkolla të mesme profesionale dhe 6 institute të larta. Gjatë këtij pesëvjeçari do të përgatiten 54 000 punëtorë të kualifikuar dhe 8 500 teknikë.

Fare pak kohë më parë punëtorët shqiptarë nuk kishin as idenë e maqinave, kurse sot drejtojnë maquina moderne të komplikuar dhe arrijnë një rendiment të lartë pune. Numri i punëtorëve pararojë të prodhimit, që janë krenaria e klasës sonë punëtore, ka arritur në 4 716 vetë. Klasa punëtore e Shqipërisë së re nuk trembet nga vështirësitë, ajo është e gatshme t'i kapërcejë ato; nuk ka dyshim se populli ynë do ta realizojë me sukses planin e vet pesëvjeçar.



Para çlirimit të vendit bujqësia, megjithëse zinte vendin kryesor në ekonominë kombëtare, gjendej në një nivel të ulët, kishte karakter primitiv. Shfrytëzimi tepër i egër i fshatarëve nga shteti feudoborgjez si dhe nga pronarët e mëdhenj të tokës — çifligarët, bejlerët e kulakët — ishte pengesa kryesore për zhvillimin e bujqësisë.

Dyzet për qind e sipërfaqes së tokës gjendej në duart e një grushti çifligarësh të mëdhenj e kulakësh, kurse 77 për qind të numrit të përgjithshëm të fshatarëve u takonte vetëm 34 për qind e sipërfaqes së tokës, 21 mijë e 500 shtëpi fshatare nuk kishin fare tokë. Fshatarët ishin të detyruar ta merrnin tokën me qira nga çifligarët, duke u dhënë atyre një të tretën, bile në shumë raste edhe gjysmën e prodhimit. Me detyrime të rënda e ngarkonin fshatarësinë çifligarët dhe shteti feudoborgjez.

Ndër reformat revolucionare të kryera në vendin tonë pas çlirimit të tij një vend shumë të rëndësishëm zë reforma agrare. Reforma agrare, që u bë në vitet 1945-1946, qe një revolucion që u bë në fshatin shqiptar. Ajo zhduku marrëdhënjet agrare shumëshekullore, që kishin shërbyer si bazë për shtypjen e fshatarëve, asgjësoi klasën e çifligarëve dhe u dha tokë të vobektëve. Fshatarëve ju ndanë më shumë se 172 mijë hektarë tokë, duke përfshirë këtu 17 500 hektarë tokë shtetërore, si dhe rreth 475 000 rrënjë ullinj.

Reforma agrare, e bërë nën drejtimin e klasës pu-

nëtoje, e forcoi edhe më shumë aleancën e klasës punëtoje me fshatarësinë që ishte formuar që gjatë luftës për çlirim. Fshatarët, që morën tokë në saje të luftës së proletariatit të udhëhequr nga Partia e Punës, u bashkuan edhe më ngushtë rreth Partisë dhe qeverisë. Reforma agrare hapi rrugën për ngritjen e gjithë ekonomisë së vendit, krijoi kushtet për zhvillimin e kooperativave tregëtare dhe të prodhimit, për forcimin e mëtejshëm të aleancës së punëtojeve me fshatarët në ndërtimin e Shqipërisë së re.

Shteti e ndihmon fshatarësinë me kredi, me maqina, me kafshë pune, me vegla bujqësore, me farë të zgjedhur etj. Partia, organizatat shoqërore dhe organet shtetërore bëjnë një punë të madhe për përhapjen e metodave të përparuara në bujqësi dhe për t'u bërë të njohur fshatarëve eksperiencën sovjetike. Në saje të kujdesit të treguar nga pushteti popullor dhe të ndihmës që na jep Bashkimi Sovjetik bujqësia jonë ka korrur suksese të mëdha. Janë zgjeruar shumë sipërfaqet e mbjella, rendimentet e kulturave bujqësore shtohen nga viti në vit. Zhvillimi i industrisë ka bërë që të zgjerohen sipërfaqet e mbjella me bimë industriale. Në krahasim me vitin 1950 prodhimi i drithërave është rritur gati tri herë, ndërsa prodhimi i pambukut ka pasur një rritje prej 951,6 për qind.

Perspektiva të shkëlqyera i hapen bujqësisë sonë. Kujdesi që tregohet nga ana e shtetit, ndihma bujare e Bashkimit Sovjetik dhe e vendeve vëllezër të demokracisë popullore, kushtet klimatike e tokësore të favorshme — të gjitha këto lejojnë të realizohen me sukses detyrat që shtroi Kongresi II i Partisë së Punës të Shqi-

përisë në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë. Këto detyra përmbliohen në atë që me anë të zgjerimit të sipërfaqeve të mbjella dhe të luftës për rendimente të larta të shtohet në mënyrë të ndieshme prodhimi i drithit dhe të prodhohen kultura industriale në sasi të tilla që jo vetëm t'i sigurohet lënda e parë industrisë sonë, por edhe të shtohen eksportimet tona.

Një vëmendje e madhe i kushtohet bonifikimit dhe ujitjes. Plani pesëvjeçar parashikon një zgjerim të sipërfaqes së tokave nën ujë nga 39 mijë në 100 mijë hektarë. Tharja e kënetës së Maliqit (në rrethin e Korçës), ndërtimi i kanalit të madh ujitës të Myzeqesë dhe i kanaleve të tjera ujitëse shpëtuan nga kapriçiot e natyrës mijëra ekonomi fshatare. Këto masa dhe përpjekjet e fshatarëve ndihmojnë në shtimin e rendimenteve të bujqësisë. Fshatarët tanë pararojë kanë marrë për hektar nga 50 kuintalë grurë, nga 85 kuintalë misër, nga 20-30 kuintalë pambuk, nga 17 kuintalë duhan etj.

Një rol njaft të madh në zhvillimin e bujqësisë sonë luan sektori socialist — fermat shtetërore dhe kooperativat bujqësore. Partia dhe qeveria po i forcojnë ekonomitë bujqësore shtetërore dhe kooperativat fshatare me qëllim që të pregatitin kushtet e nevojshme për të kaluar në të ardhshmen në një kolektivizim të gjerë sipas shembullit të Bashkimit Sovjetik.

Partia dhe qeveria tregojnë një kujdes të veçantë për zhvillimin e sektorit shtetëror në bujqësi. Sot në Shqipëri ka 21 ferma shtetërore; ato janë shembull për kooperativat dhe për ekonomitë individuale në çështjen e aplikimit të agroteknikës së përparuar dhe të shfrytëzimit të eksperiencës sovjetike.

Zbatimi i përpiktë i parimit të vullnetarizmit në çështjen e bashkimit të ekonomive të vogla individuale fshatare në kooperativa bujqësore bën që numri i këtyre kooperativave të shtohet nga viti në vit dhe baza e tyre materiale të forcohet. Sot në Shqipëri ka 128 kooperativa bujqësore me më shumë se 6 mijë ekonomi fshatare dhe që disponojnë 25 mijë hektarë tokë. Po rritet pasuria e përbashkët e kooperativave; janë ndër-tuar shtëpi të reja banimi dhe godina të nevojshme për ekonominë; vetëm gjatë viteve 1951-1955 numri i gjësë së gjallë, pronë e kooperativave, është shtuar 246,2 për qind.

Por krahas sukseseve në veprimtarinë e kooperativave ka ende të meta serioze, të cilat e pengojnë zhvillimin e shpejtë dhe të gjithanshëm të ekonomisë së tyre. Nuk janë të rralla shkeljet e statutit, ka të meta në organizimin e punës dhe në shpërblimin e saj. Partia dhe qeveria u japin një ndihmë të gjithanshme kooperativave bujqësore, kujdesen që ato të forcohen nga pikëpamja organizative dhe ekonomike dhe të bëhen shembull për të gjithë fshatarësinë punonjëse.

Rezultatet e mira ekonomike që kanë arritur kooperativat bujqësore kanë ngjallur një interes të dukshëm ndër fshatarët me ekonomi individuale, kështu që tani po shtohet dita me ditë numri i atyre që dëshirojnë të bashkohen në kooperativa. Por, të udhëhequr nga vendimet e Kongresit II të Partisë së Punës të Shqipërisë ne nuk shpejtojmë në shtimin e numrit të kooperativave. Partia dhe qeveria e respektojnë me rigorozitet parimin e vullnetarizmit në çështjen e hyrjes në kooperativë.

Një rol të rëndësishëm në bujqësinë e Shqipërisë luan blegtoria. Degët kryesore të saja janë rritja e dhenve dhe e dhive. Kopeja e dhenve dhe e dhive përbëhet nga 2 milion e 247 mijë krerë. Më 1948 u bë shtetëzimi i tufave të mëdha të pasanikëve dhe u formuan fermat blegtorale të shtetit. Partia dhe qeveria kanë marrë një sërë vendimesh të posaçme për zhvillimin e mëtejshëm të blegtorisë. Një vëmendje e posaçme i kushtohet përmirësimit të racave të vendit dhe rritjes së racave të reja të dhive e të gjedhit, zgjerimit të bazës ushqimore, e cila ende është e pamjaftueshme, organizimit të shërbimit zooveteriner dhe përhapjes së eksperiencës sovjetike. Qendra e kërkimeve zooteknike, e ngritur në vendin tonë, ka arritur rezultate të dukshme në punën e saj.

Një pasuri e madhe e vendit tonë janë pyjet. Ato mbulojnë më shumë se një të tretën e territorit të Republikës. Më parë pyjet ishin pronë private dhe prite-shin në mënyrë grabitqare nga kapitalistët e huaj dhe vendës. Me vendosjen e pushtetit popullor pyjet u shtetëzuan, u bënë pasuri e popullit. Këshilli i Ministrave dhe Komiteti Qendror i Partisë në vitin 1950 aprovuan planin pesëvjeçar të pyllëzimeve dhe të përmirësimit të pyjeve; në bazë të këtij plani në një sipërfaqe prej rreth 12 900 hektarësh do të mbillen rreth 67 milion fidane pyjore.

Kushtet klimatike të vendit tonë janë shumë të favorshme për frutikulturën. Partia dhe qeveria tregojnë një kujdes të vazhdueshëm për zhvillimin e kësaj dege të bujqësisë: vetëm në këto dy vitet e fundit fshatarësia ka marrë më shumë se një milion fidane

pemësh frutore. Plani pesëvjeçar parashikon një shtim të numrit të pemëve frutore prej 2 milion e 614 mijë në krahasim me vitin 1951. Gjatë viteve që kanë kaluar qysh prej çlirimit të vendit e këtij numri i ullinjve është shtuar 11 për qind, kurse numri i agrumeve — më shumë se dy herë. Në saje të punës shkencore serioze që bëhet për studimin dhe për përmirësimin e kulturës së agrumeve dhe në saje të ndihmës që i jepet fshatarësisë, agrumet po kultivohen tani në tërë zonën bregdetare të Shqipërisë. Qeveria ka aprovuar një plan 15-vjeçar, për zhvillimin e kulturës së ullinjve; në bazë të këtij plani do të mbillen më shumë se 5 milion rrënjë ullinj. Realizimi i këtij plani 15-vjeçar do të sigurojë jo vetëm plotësimin e të gjitha nevojave të popullit për këtë prodhim, por edhe një shtim të eksportit të ullinjve dhe të vajit të ullirit.

Por, me gjithë këto suksese, bujqësia nuk po ecën me ritmin e zhvillimit të industrisë. Për të arritur një ngritje të mëtejshme të bujqësisë, për të përmirësuar gjendjen ekonomike të fshatarësisë kooperativiste dhe individuale, për të përmirësuar në shkallë të gjerë shkëmbimin e mallrave midis qytetit dhe fshatit dhe për të përmirësuar, në saje të të gjitha këtyre, furnizimin e punonjësve me sende ushqimore dhe të industrisë me lëndë të parë, Komiteti Qendror i Partisë së Punës dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë kohët e fundit kanë marrë një sërë masash shumë të rëndësishme. Fshatarësisë ju falën borxhet që i kishte shtetit, borxhe të cilat ishin grumbulluar gjatë viteve 1949-1952. U pakësuan dorëzimet e drithit shtetit nga fshatarët që kanë toka jopjellore dhe ngastra të vogla.

Për fshatarët që kanë më pak se një hektar tokë janë ulur normat e dorëzimeve të drithit, të mishit, të leshit etj., dhe ekonomitë, që në fillim të vitit 1953 nuk kishin gjë të gjallë, shkarkohen për tre vjet nga detyrimet e mishit dhe të leshit. U ngritën çmimet e ullirit dhe të disa prodhimeve të tjera që grumbullohen nga shteti. U ulën çmimet e veglave bujqësore. Janë marrë masa për uljen e tatimeve, veçanërisht kooperativat bujqësore, anëtarët e tyre dhe ekonomitë individuale, që nuk kanë vegla pune, janë çliruar nga të gjitha borxhet e prapambetura deri në fund të vitit 1952. Krahas kësaj janë marrë masa për furnizimin sa më të mirë të fshatit me mallra industriale, për zhvillimin sa më të gjerë të artizanatit në fshat dhe për zgjerimin e tregëtisë me pakicë.

Këto masa të Partisë e të qeverisë, të cilat u pritën me gëzim nga fshatarësia dhe nga të gjithë punonjësit, e forcojnë edhe më shumë aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë. Fshatarësia e kupton se me ngritjen e nivelit të të gjithë ekonomisë kombëtare do të ngrihet shumë edhe niveli i saj i jetesës, ajo e sheh se klasa punëtore po e udhëheq fshatin drejt një jete të lumtur e të kulturar.

Kuptohet se realizimi i planit pesëvjeçar dhe zbatimi i vendimeve të fundit të Partisë e të qeverisë i rritin kërkesat që shtrohen përpara klasës punëtore, përpara fshatarësisë, përpara gjithë kuadrove të Partisë, të pushtetit e përpara organeve ekonomike. Duhet bërë përpjekje që të arrihet shtimi i prodhimit i parashikuar nga Partia e nga qeveria dhe të sigurohet kështu përmirësimi i mëtejshëm i jetës së punonjësve, duke mos

harruar asnjëherë se mbrojtja e interesave të masave të popullit është detyra më e shenjtë, detyra më e lartë e Partisë sonë.

*
* *
*

Shtypësit e huaj dhe feudalët vendës e mbajtën për shekuj popullin shqiptar në errësi të padije. Më shumë se 80 për qind e popullsisë ishte analfabete. Shkollën e ndiqnin kryesisht ata fëmijë, prindët e të cilëve u përkisnin klasave të privileguara.

Në çështjet e zhvillimit të kulturës e të arësimit në Shqipëri Partia jonë ka ndjekur rrugën e lavdishme të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. I duhej dhënë fund prapambetjes kulturele të masave të gjera popullore, duhej bërë arësimi një mjet i fuqishëm për ndërtimin e socializmit. Në vendin tonë u fut arësimi fillor e 7-vjeçar i detyrueshëm. Rrjeti i shkollave fillore u zgjerua 362 për qind në krahasim me vitin 1938, i shkollave 7-vjeçare — 2 600 për qind, i shkollave të mesme të plota — 245 për qind. Më parë ne nuk kishim asnjë shkollë të lartë, kurse sot kemi 6 institute të larta. Numri i nxënësve në krahasim me vitin 1938 është shtuar 309 për qind dhe numri i mësuesve — 351 për qind. Mijëra punëtorë e fshatarë ndjekin shkollat dhe institutet pa shpëputje nga prodhimi. Një numër i madh studentësh dërgohen çdo vit në shkollat e larta të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore.

Plani pesëvjeçar parashikon një zhvillim të mëtejshëm të arësimit. Nga fundi i këtij pesëvjeçari analfa-

betizmi në vendin tonë do të zhduket. Rrjeti i shkollave për të rriturit do të zgjerohet 6,5 herë. Numri i përgjithshëm i nxënësve në shkollat fillore, 7-vjeçare dhe të mesme të plota në krahasim me vitin 1938 do të ketë një shtim prej 370 për qind, kurse numri i studentëve në shkollat e larta — 1 482 për qind në krahasim me vitin 1950. Vendi po merr mot për mot gjithnjë më shumë kadro të kualifikuar, të domosdoshëm për ndërtimin e socializmit.

Pas çlirimit u krijuan shtëpi kulture, biblioteka, salla leximi. Një zhvillim të paparë kanë marrë botimet, përhapja e librave, e gazetave, e revistave politike, shkencore e artistike. Në kryeqytet dhe në disa qytete të tjera të mëdha janë ngritur teatro. Kudo nëpër qytetet dhe në qendrat punëtore më të rëndësishme janë hapur kinoteatro. Një kontribut të madh në zhvillimin e kulturës së Shqipërisë japin specialistët e talentuar sovjetikë, ata i ndihmojnë punonjësit tanë të teatrove e të klubeve. Ndër punonjësit shqiptarë janë zbuluar talente të shkëlqyera. Në saje të ndihmës së Bashkimit Sovjetik u ndërtua kinostudioja; për herë të parë po dalin filma shqiptarë.

Me sukses po zhvillohet letërsia shqiptare. Shkrimtarët e poetët e dalë nga radhët e punonjësve në veprat e tyre luftojnë për ideologjinë socialiste, për realizmin socialist, për pastërtinë e gjuhës. Një dashuri e madhe tregohet për letërsinë sovjetike; ajo u ndriçon rrugën shkrimtarëve tanë, i frymëzon për të krijuar vepra të reja, që pasqyrojnë patriotizmin e punonjësve, përpjekjet e tyre për realizimin e planit pesëvjeçar dhe për ndërtimin e bazave të socializmit.



Partia e Punës e Shqipërisë mobilizon masat për realizimin e planit pesëvjeçar. Ne i kemi të gjitha kushtet për ta kurorëzuar me sukses këtë vepër të madhe.

Armiqtë e popullit shqiptar shpresonin se Shqipëria do të thyhej nga blokada e organizuar prej kampit imperialist. Por sukseset e arritura nga Shqipëria demokratike popullore provojnë se sa të pathemelta ishin këto shpresa. Bashkëpunimi i ngushtë i Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet e demokracisë popullore i asgjësoi krejt makinacionet e armiqve të Shqipërisë së re. Ky bashkëpunim është garanci e ndërtimit me sukses të socializmit në vendin tonë.

Ndërtimi i bazave të socializmit bëhet në luftë të ashpër me vështirësitë, ai kërkon që të zbulohen dhe të zhduken të metat e punës sonë. E meta kryesore është organizimi i keq i punës dhe drejtimi i dobët. Partia jonë përpiqet të ngrejë dhe të edukojë nga radhët e klasës punëtore dhe të fshatarësisë punonjëse kuadro drejtues të sprovuar, që të zotërojnë marksizëm-leninizmin, artin e drejtimit të ekonomisë kombëtare e të shtetit dhe të kenë përvetësuar teknikën. Në këtë drejtim janë arritur rezultate të rëndësishme, por pregatitja e kuadrove ende nuk u përgjigjet nevojave. Ende e pakënaqshme është puna që bëhet për zgjedhjen e kuadrove.

Eksperienca e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik na ndihmon për t'i zhdukur nga rrënjët këto

të meta. Me interesim të madh lexohen në Shqipëri materialet e Kongresit XIX të PK të BS.

Partia e Punës e Shqipërisë kujdeset paseshtur për forcimin e disiplinës së Partisë dhe të disiplinës shtetërore, duke e ditur se pa këtë as që mund të mendohet realizimi i planit dhe forcimi i aparatit të shtetit e të Partisë; kuptohet se çdo dobësim i disiplinës është në dobi të elementëve armiq, i ndihmon këta të gjejnë shesh për veprimtarinë e tyre minuese. Duhet pranuar megjithatë se disiplina te ne akoma nuk është kudo në lartësinë e duhur. Disa ndërmarrje industriale nuk e realizojnë planin, rendimenti i punës është i ulët, nuk luftohet sa duhet kundër dëmtimit dhe shpërdorimit të pasurisë shtetërore, aty-këtu ka ende burokratizëm.

Një mjet i fuqishëm për zhdukjen e gabimeve dhe të metave në veprimtarinë e Partisë, të të gjitha organizatave të masave dhe në punën e aparatit shtetëror duhet të bëhet kritika e autokritika. Për këtë lufton Partia. Ajo i mëson anëtarët e saj që të mos i fshehin gabimet e të metat, por, përkundrazi, t'i kritikojnë me guxim, sepse vetëm me këtë mënyrë mund të kapërcen vështirësitë dhe të krijohen kushtet e nevojshme për të shkuar me sukses përpara.

Partia jonë i jep rëndësi të madhe forcimit të vigjilencës revolucionare në radhët e saja, në organet shtetërore, në ushtri dhe në masat e gjera të popullit. Imperialistët, armiq të popullit shqiptar, kurdisin provokacione në kufitë tanë, hedhin diversantë te ne, bëjnë të gjitha përpjekjet për të grumbulluar mbeturinat e reaksionit të brendshëm dhe për t'i përdorur për qëllimet e veta minuese. Armiqtë bëjnë çmos për t'u futur

në radhët e Partisë sonë dhe në institucionet qeveritare e për të na dhënë goditje nga brenda. Për t'i paralizuar këto orvatje të armiqve, Partia forcon vigjilencën dhe zhvillon një luftë këmbëngulëse për forcimin e aparatit shtetëror.

Gjatë zgjedhjeve të fundit për organet e pushtetit u pa qartë se në disa organe lokale ishin futur kontrabandë njerëz me një të kaluar të errët, të padenjë për besimin e popullit, elementë kulakë. Kritika që u bë gjatë zgjedhjeve ndihmoi për të zbuluar edhe komunistë që nuk i kryenin detyrat e ngarkuara nga Partia, që mbytnin kritikën e autokritikën, nuk kujdeseshin për nevojat e popullit, shkelnin ligjet e kultivonin familjaritetin. Kundrejt këtyre anëtarëve të Partisë u morën masa të rrepta, deri në përjashtimin nga Partia. Zgjedhjet e bëra vitin që shkoi ngjallën një entuziazëm të madh ndër punonjësit, forcuan vigjilencën e masave kundrejt burokratëve e dembelëve, që mbaheshin me autoritetin e Partisë e të shtetit.

Kohët e fundit me vendim të Kuvendit Popullor u bë riorganizimi i aparatit administrativ qendror të shtetit: u bashkuan disa ministri; u bë ndarja administrative e vendit në rrethe e rajone. Riorganizimi dha mundësi të shkurtohej aparati i administratave shtetërore dhe i organeve ekonomike dhe të pakësoheshin kështu shpenzimet e shtetit, ndihmoi që të forcohej lufta kundër burokratizmit. U lehtësua puna e vendosjes dhe e shpërndarjes së kuadrove. Nuk ka dyshim se të gjitha këto masa do ta forcojnë pushtetin popullor, do ta afrojnë atë edhe më shumë me masat.

Një rëndësi të veçantë Partia i jep forcimit të Ushtrisë Popullore, forcimit të organeve të Sigurimit të Shtetit dhe të reparteve të kufirit. Në repartet ushtarake Partia bën një punë intensive për edukimin marksist-leninist të luftëtarëve e të komandantëve dhe për perfeksionimin e përgatitjes ushtarake.

Partia e Punës mbështetet në eksperiencën e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik edhe në lëmin e ndërtimit të Partisë. Puna organizative, politike dhe ideologjike e Partisë sonë po forcohet çdo ditë më shumë; ajo shton radhët e veta me përfaqësuesit më të mirë të klasës punëtore, zgjeron rrjetin e organizatave të veta në fshat dhe në ndërmarrjet industriale të ngritura rishtas, lufton me këmbëngulje për përmirësimin e përbërjes së saj cilësore.

Partia i forcoi edhe më shumë radhët e veta, duke i spastruar ato nga elementët sabotatorë e tradhëtarë, konsolidoi unitetin e vet, mprehu vigjilencën revolucionare. Duke e ruajtur me kujdes pastërtinë e radhëve të veta, Partia ka denoncuar dhe ka dërmuar çdo devijim nga marksizëm-leninizmi. Një luftë të pamëshirshme ajo zhvilloi kundër trockistëve Anastas Lula me shokë gjatë lëvizjes nacional-çlirimtare. Një luftë intransigjente zhvilloi Partia kundër agjentëve titistë në radhët e veta, kundër tradhëtarit Koçi Xoxe dhe të tjerë. Një luftë intransigjente zhvilloi ajo edhe kundër deviatorëve të djathtë — Sejfulla Malëshova, Ymer Dishnica dhe të tjerë.

Partia jonë i mëson organizatat e veta që të zhvillojnë kritikën e autokritikën, sidomos kritikën nga poshtë. Partia i vë nën zjarrin e kritikës parimore ga-

bimet e atyre anëtarëve të thjeshtë të Partisë, kuadrove drejtues dhe organeve të Partisë, të cilët nuk i kryejnë si duhet detyrat e veta. Ajo bën të gjitha përpjekjet për të forcuar demokracinë e brendshme të Partisë, për të likuiduar burokratizmin dhe për afirmimin e plotë të parimeve të udhëheqjes kolegjiale. Ajo i mëson anëtarët e vet të jenë modestë, të mos lejojnë shfaqje të mendjemadhësisë dhe të vetëkënaqësisë, të jenë shërbëtorë besnikë të popullit.

Partia e Punës e Shqipërisë lufton kundër prapambetjes ideologjike në radhët e saja. Ajo bën një punë të madhe dhe intensive, duke u përpjekur që anëtarët e saj, si dhe anëtarët e organizatave të rinisë e profesionale të përvetësojnë marksizëm-leninizmin. Për këtë qëllim është krijuar rrjeti i arësimit të Partisë; te ne funksionojnë shkolla dyvjeçare e Partisë, kurse gjashtëmujore pranë Shkollës së Partisë, kurse pesëmujore, shkolla rajonale të Partisë dhe rrethe politike. Përveç kësaj shumë anëtarë partie merren me studim politik individual. Numri i komunistëve të përfshirë në format e ndryshme të arësimit të Partisë rritet nga viti në vit: në vitin shkollor 1949/50 ata ishin gjithsejt 6 246, në vitin shkollor 1950/51 — 12 264, kurse në vitin shkollor 1951/52 — 18 568. Partia jonë do të përpiqet edhe pas-këtaj me këmbëngulje për ta zotëruar doktrinën ngadhënjimtare të marksizëm-leninizmit.



Populli shqiptar është një popull paqedashës e punëdashës. Me të drejtë Republika Popullore e Shqipërisë bën pjesë në radhët e kampit të fuqishëm të paqes e të demokracisë të kryesuar nga Bashkimi Sovjetik. Populli ynë ka nevojë për paqe e jo për luftë. Ai don të ndërtojë jetën e re e të lumtur. Lufta gjithmonë u ka sjellë punonjësve të Shqipërisë mjerime e shkatërrime të panumërta, prandaj ata luftojnë me të gjitha forcat për paqen, kundër nxitësve të luftës, që duan të kurdisin një kasaphanë të re të përbotshme.

Populli shqiptar po e ndërton i sigurtë të ardhshmen e vet të lumtur, meqenëse në krye të tij marshon Partia heroike e Punës, besnike e leninizmit. Populli shqiptar dhe Partia e tij kanë një mik të madh e të sigurtë të BRSS dhe Partia Komuniste e lavdishme e Bashkimit Sovjetik. Ndjenja e miqësisë për popullin sovjetik jeton dhe do të jetojë gjithmonë në zemrat e shqiptarëve, sepse kjo miqësi është faktor vendimtar i fitoreve të popullit tonë.

*Botuar për herë të parë në
revistën «Komunist», Nr. 17,
nëntor 1953*

*Botohet sipas tekstit të revistës
«Komunist», Nr. 17,
nëntor 1953*

MBI DISA ÇËSHTJE TË PROPAGANDËS BUJQËSORE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

7 dhjetor 1953

Megjithëse në fushën e propagandës bujqësore është kryer gjithë kjo punë, unë kam përshtypjen se ç'është bërë është e pamjaftueshme, pse nuk e prek sa duhet fshatin. Kjo varet në radhë të parë nga puna e organizatave të Partisë dhe ato të rinisë në fshat, por edhe nga propaganda që bëjnë në rrugë shtetërore organet e bujqësisë, për të vënë në praktikë këshillat agroteknike, orientimet që jep Ministria e Bujqësisë, nga e cila drejtohen të gjitha organet e propagandës bujqësore. Hysni u tha mirë që propaganda të jetë sa më konkrete, të mos qëndrojë në hava, por të shkruhen artikuj, të cilët të botohen në kohën e duhur, që komu-

¹ Në këtë mbledhje të Sekretariatit të KQ të PPSH u diskutua rreth relacionit «Mbi gjendjen dhe masat për forcimin e propagandës bujqësore».

nistët dhe punonjësit të kenë kohë për t'i lexuar ata, të mësojnë prej tyre dhe të mobilizohen për t'i zbatuar.

Është e domosdoshme, që broshurat të planifikohen, të hartohen e të botohen me kohë, duke llogaritur edhe se kur do t'i venë organizatës bazë të Partisë, e cila nga ana e saj të ketë një farë kohe të studjojë materialin e të mendojë masat organizative e politike që duhet të marrë për propagandën bujqësore në masa. Kjo është e drejtë, pse në bazë, po u dërgua një artikull me vonesë, nuk vlen më, pasi i ka kaluar koha. Artikuj të tillë mund të shërbejnë vetëm për vitin e ardhshëm, por kuadrot tanë kanë nevojë të kenë material vazhdimisht. Prandaj propaganda bujqësore nëpërmjet artikujve të bëhet me kohë, duke mbajtur parasysh edhe nivelin e ulët kultural të njerëzve që drejtojnë e punojnë në bazë. Veç kësaj, artikujt që shkruhen për punonjësit e bujqësisë, duhet të kenë një karakter të theksuar vulgarizues, të jenë të thjeshtë e shumë të kuptueshëm për fshatarësinë tonë dhe të përqëndrohen në problemet aktuale që e preokupojnë atë, të mos kenë shumë probleme të mëdha të perspektivës. Pastaj duhet të kalojmë nga ky stad i nevojshëm për fshatin tonë në një stad më të lartë, duke shkruar artikuj shkencorë etj.

Propaganda e vulgarizuar kërkon që të shkruhet për probleme urgjente e konkrete të kohës, që i dalin bujqësisë sonë përpara. Mundësitë për këtë janë të gjitha, pse bujku ynë nuk është si ai punëtori që porsa ka vajtur dhe punon në torno. Fshatarët tanë kanë një eksperiencë të pasur shekullore. Në këtë tokë ata kanë mbjellë vazhdimisht, kanë vëzhguar me kalimin e kohës zhvi-

llimin e ndryshimin e saj etj. Kjo është një eksperiencë shumë e çmueshme për bujqësinë, të cilën duhet të mos e neglizhojë as Partia as rinia. Përkundrazi, me këtë eksperiencë ne duhet të shartojmë eksperiencën e re. Mua më duket se Partia dhe rinia çështjen e propagandimit të metodave të reja nuk e lidhin mirë me eksperiencën shekullore të fshatarësisë; ky është një nënvleftësim i eksperiencës së fshatarësisë. Kur zbatohet ndonjë metodë e re në fshat duket sikur ajo do të shkaktojë ndonjë revolucion brenda një dite, pa u thelluar mirë dhe pa e lidhur si duhet atë me eksperiencën shumëvjeçare të fshatarësisë sonë. Ne mendojmë dhe ashtu është, se të gjitha metodat e reja që zbatohen në bujqësi, janë në favor të fshatarësisë, por ato do të vihen me sukses në jetë, atëhere kur t'i kuptojë e gjithë fshatarësia, kur ajo t'ja përshtatë ato fshatit tonë të sotëm.

Shumë fshatarë qahen nga teknikët, nga agronomët. Unë arrij në konkluzionin se edhe agronomët, sidomos ata që janë të rinj nuk janë të lidhur si duhet me bujqësinë. Megjithëse ata kanë mësuar në shkolla, duhet ta ulin mirë kokën, të mos u rritet mendja. Eksperiencën dhe vërejtjet e fshatarësisë t'i kenë parasysh, pse disa herë del që kjo eksperiencë është në kundërshtim me sa këshillojnë teknikët e bujqësisë. Është e vërtetë se mësimet që kanë marrë në shkollë specialistët e bujqësisë janë të nxjerra nga eksperiencia më e mirë, por konditat e tokës ndryshojnë shumë nga njëri vend në tjetrin, sidomos te ne ku ka një sërë faktorësh siç është struktura e tokës, çështja e erërave etj., të cilat janë lënë të pastudjuara fare. Ndonjë nga

këta teknikë, që mund të jetë edhe shumë i zoti, në qoftë se nuk e lidh diturinë e tij me terrenin konkret të prapambetur të fshatit tonë, dhe në qoftë se do t'i imponojë fshatarit «këshilla» që zbatohen në një bujqësi shumë të përparuar, do të gabojë. Që të mos ndodhë kjo, çdo agronom ose teknik i mirë duhet të lidhë ngushtë diturinë e tij me eksperiencën e fshatarëve. Ministria e Bujqësisë dhe Partia duhet të vënë përpara realitetit të gjithë teknikët e të marrin masa që në të ardhshmen ata të bashkëpunojnë më mirë me fshatarësinë.

Dëshiroj të vë në dukje edhe çështjen e njerëzve të dalluar në bujqësi. Mundet që edhe djali i Ali Jagodinës¹ të merret me kultivimin e pambukut e të jetë bujk i dalluar, sepse ka edhe eksperiencën e të atit të tij, Aliut, mirëpo Aliu ka një eksperiencë shumë më të madhe nga djali i tij. Si ky shembull ka dhe shumë të tjerë. Prandaj, propaganda për përhapjen e eksperiencës së njerëzve të dalluar të mos bëhet «propagandë për propagandë» dhe të meta në këtë drejtim ka shumë. Eksperiencën e njerëzve të dalluar në bujqësi ne duhet ta çojmë kudo dhe nga këta ka me mijëra e me mijëra të tjerë që veprojnë për t'i marrë prodhime tokës. Bujqit e dalluar punën e tyre ja detyrojnë më tepër eksperiencës tradicionale të bujqësisë se sa propagandës që bëhet nga teknikët tanë dhe ky është një sukses. Prandaj punën e njerëzve të përparuar të bujqësisë, duhet të mos e nënvleftë-

¹ Ali Jagodina, në atë kohë bujk i dalluar nga rrethi i Elbasanit.

sojmë bile as të mos e errësojmë eksperiencën e madhe të fshatarëve, përkundrazi Partia të mobilizohet që të vihet në jetë si eksperiencia e njerëzve të dalluar, ashtu dhe ajo e gjithë punonjësve të bujqësisë. Partia të mësojë nga fshatarësia jonë, po kështu edhe teknikët, të cilët duhet të dallojnë ku është e mira dhe ku është e keqja e kësaj eksperience; kjo do të jetë një gjë e mirë dhe ne do të arrijmë suksese shumë më të mëdha. Por, për të vepruar kështu, ka edhe disa kondita, të cilat në të shumtën e herës ne nuk i plotësojmë si duhet. Kështu për shembull, eksperiencia e re kërkon edhe vegla të reja, kërkon materiale të tjera. Ne, për konditat tona metodat e reja të bujqësisë nuk i kemi shoqëruar dot me materiale dhe me vegla të reja. Kështu, puna që bëhet në këtë rast ka më tepër karakter propagandistik dhe nuk është një veprim, një aksion konkret, ku në punë e sipër të zbatohet kjo ose ajo metodë e re.

Organet e shtypit të Ministrisë së Bujqësisë duhet të sigurojnë një eksperiencë më të madhe nga baza. Korrespondentët fshatarë që kanë këto organe duhet të nxiten që të shkruajnë nga puna e gjallë, nga eksperiencia e bujqve tanë. Ata nuk duhet t'i paraqesin problemet shesh me lule, por në radhë të parë të japin eksperiencën e mirë të fshatarëve dhe mund t'i kritikojnë më shumë drejtuesit e organizatave të Partisë, organet e bujqësisë dhe vetë agronomët, teknikët dhe këshillat e tyre për zbatimin e metodave të reja që kërkojnë të futin pa menduar mirë si të aplikohen në përputhje me situatën tonë, me kushtet tona. Nga organet e shtypit përveç shtruarjes së problemeve, du-

het të ketë edhe sugjerime. Prandaj korrespondentët fshatarë duhet të ndryshojnë frymën dhe metodën e punës së tyre. Ata duhet të jenë nga njerëzit tanë më të shkathët e më të zgjuar, të zbulojnë eksperiencën më të përparuar të bujqësisë, të nxjerrin anët e mira dhe anët e dobëta të saj.

Konferencat dhe leksionet që zhvillohen në fshat janë të mira; le t'i vazhdojmë ato edhe në të ardhshmen, por këtu kisha një vërejtje: të mos kujtojmë se me konferenca, me leksione ose me një kurs agroteknik arrihet gjithshka, korren me bollëk frutet në punë. Jo, këto zgjerojnë horizontin, por me një e dy kurse nuk mbaron puna e bujqësisë. Unë jam dakord që Ministria e Bujqësisë e ka për detyrë të përmirësojë punën e propagandës, të mobilizojë më mirë teknikët dhe teknikët e ulët t'i lidhë më mirë me terrenin në fshat, po në rast se nuk mobilizohet Partia, në rast se rinia çdo muaj do të na thotë: «Nuk kanë ardhur broshurat në fshat, prandaj presim të vijmë pastaj të marrim jetën e fshatit në dorë», këto që them do të mbeten pa u zbatuar. Të kemi parasysh që edhe në rast se në një lokalitet ka apo nuk ka një teknik bujqësor apo një teknik të ulët, i cili nuk mund të vejë në të gjitha fshatrat, atje është Partia dhe rinia, që duhet të mbështeten në këshillat e tija dhe ta ndihmojnë agronomin me eksperiencën e madhe të popullit. Prandaj Partia dhe rinia të mbështeten mirë te agronomët dhe në eksperiencën e popullit, ndryshe nuk do të na venë si duhet punët në bujqësi.

Bujqësia jonë, me gjithë sukseset, është mjaft prapa dhe kjo situatë e vështirëson jashtëzakonisht

gjendjen tonë, ngritjen e nivelit të jetesës së popullit tonë, vështirëson ndërtimin e bazave të socializmit, vështirëson bilancin e import-eksportit tonë etj. Në një vend bujqësor si ky yni, që pas 10 vjet çlirimi e ka ndryshuar fare pak situatën në importimin e bukës dhe, çdo vit është në vështirësi për furnizimin e popullit me fasule, yndyrna e mish, kjo gjendje rëndon shumë mbi popullin dhe shtetin tonë. Prandaj bujqësisë duhet t'i vëmë rëndësi të jashtzakonshme. Nga një situatë e tillë nuk mund të dilet veçse me një mobilizim të madh. Partia duhet që t'i kushtojë fuqimisht rëndësi të madhe kësaj. Po të mobilizohet rinia jo vetëm me aksione propagandistike, po me punë reale e konkrete, po të mobilizohen edhe prindërit, duke u bindur nga të rinjtë për zbatimin e metodave të reja, me siguri do ta përballojmë këtë situatë të rëndë dhe të vështirë. Prandaj, të pleksim mirë propagandën bujqësore me aksione konkrete në shërbim të zhvillimit e të përparimit të bujqësisë në vendin tonë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

MBI KRITIKËN DHE AUTOKRITIKËN NË USHTRI

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

7 dhjetor 1953

Edukata politike në ushtri luan një rol të madh. Efektivi i saj duhet të ngrihet politikisht me punën e organizatës së Partisë si dhe me edukatën në jetën shoqërore dhe kjo të reflektohet në jetën e familjes, në sjellje e kudo. Edhe kritika e autokritika luan gjithashtu rol të madh në edukimin komunist të njerëzve. Zbatimi në ushtri i kësaj arme të shëndoshë ka rreziqet e saj, por ajo duhet përdorur drejt për të edukuar politikisht njerëzit dhe për t'i mobilizuar ata si duhet në zbatimin e detyrave. Por, si kudo, aq më tepër në

¹ Në këtë mbledhje të Sekretariatit të KQ të PPSH u diskutua rreth raportit të paraqitur nga Drejtoria politike e Ushtrisë Popullore «Mbi zbatimin e vendimeve të Plenumit VII të Komitetit Qendror për rritjen e Partisë dhe përmirësimin e punës së edukimit të komunistëve të rinj në organizatat e Partisë në ushtri».

ushtri, urdhëri nuk mund të kundërshtohet nga asnjëri, ai zbatohet dhe pastaj bëhet vërejtje në qoftë se është i padrejtë. Në rast se organizatat e Partisë, komisarët e komandantët në ushtri punojnë sa më mirë, edhe kritika do të bëhet për ato gjëra që duhet, dhe efektet e saj e të edukatës politike do të mund të rregullojnë shumë gjëra. Po të bisedosh hapët me anëtarët e Partisë e po të flasin ata lirisht, do të rezultojë se të shumtat e vërejtjeve në adresë të oficerëve besoj se i kanë për arrogancë, për fjalë fyese etj. Me siguri për oficerët ata nuk kanë gjëra parimore, prandaj edhe edukimi politik mund të bëhet në mënyrë intensive dhe të ketë për qëllim eliminimin e rasteve të arrogancës, të trajtimit jo të mirë të trupës etj.

Çështjen e kritikës dhe të autokritikës e kemi diskutuar vazhdimisht; ju, udhëheqësit e ushtrisë, ta shikoni këtë çështje në praktikë se si zhvillohet atje poshtë ndaj eprorëve, format, mënyrën si duhet të zhvillohet ajo dhe t'i ndihmoni shumë komunistët në ushtri si ta bëjnë kritikën. Vazhdimisht t'i mësoni organizatat bazë të Partisë në ushtri në këtë drejtim. Në organizatën bazë të shikoni, si u bë analiza, si u ngritën çështjet, si u bë kritika dhe si duhet bërë në të ardhshmen; u thoni njerëzve që të shohin anët e mira e të këqia dhe të mësohen në mënyrë të tillë që asnjë të mos i shpëtojë kritikës. Por puna është që të gjenden edhe format. Nga eksperiencia e mirë duhet mësuar dhe përgjithësuar dhe, atje ku kritika nuk bëhet mirë, duhet treguar si të zhvillohet, që edhe në ushtri të metat të mos mbulohen, të mos krijohet një situatë e kalbur në organizatën bazë.

Kisha edhe një çështje tjetër, të cilën e kemi thënë

edhe herë të tjera, atë të vendosjes në punë të grave të oficerëve. Kjo është e rëndësishme dhe ka të bëjë me përmirësimin e gjendjes ekonomike të oficerëve dhe me forcimin e me shëndoshjen e mëtejshme të familjeve të tyre. Ju, shokët e Drejtorisë politike, duhet që këtë çështje ta ngrini vazhdimisht dhe ta kontrolloni, t'i nxitni oficerët të mos i lënë gratë e tyre pa punë. Vlerësojeni këtë çështje nga ana politike, ekonomike dhe u thoni oficerëve t'i dërgojnë gratë e tyre në punë, pse ky është një faktor me rëndësi ekonomike në familje, të ardhurave të së cilës i shtohen edhe 4000-5000 lekë në muaj. Kështu, duke u zgjidhur ana ekonomike, zgjidhen edhe shumë probleme të tjera që kanë të bëjnë me emancipimin dhe me zhvillimin e vet gruas. Në rast se ndonjë oficer ka vendosur ta mbajë gruan e tij të mbyllur në të katër muret e shtëpisë, ai nuk mendon as si komunist as si qytetar shqiptar i përparuar. Gratë e oficerëve janë në shumicën e tyre nga fshati, por oficerët, si bashkëshortët e tyre që i kanë dashur dhe janë martuar me to, e kanë për detyrë t'i hedhin në prodhim, që edhe ato të sjellin ndihmën e tyre në familje dhe në këtë mënyrë të përmirësohet jeta e familjes, të përballohen më mirë nevojat e saja. Kjo është një çështje e madhe edhe në interes të shtetit, pse një pjesë e madhe grash hidhet në luftë për ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Pa bëni një llogari, shokë, merrni vetëm Tiranën! Sa gra oficerësh janë pa punë, të cilat mund të venë të punojnë në Kombinatin e tekstileve «Stalin» ose gjetkë, në vend që në këto qendra të vijnë nga rrethet e largëta dhe të vështirësojnë kështu dhe gjendjen e strehimit e të furnizimit! Prandaj të ngrihet para

oficerëve çështja e vendosjes së grave të tyre në punë duke ua shpjeguar nga të gjitha anët dhe dobinë e pjesëmarrjes së tyre në punë; ata të marrin angazhime përpara Partisë se nuk do të lejojnë që gratë e tyre të mos jenë në marrëdhënje pune me shtetin. Oficerët duhet ta kuptojnë këtë gjë se është shumë serioze. Pra, të gjitha gratë e oficerëve dhe të nënoficerëve të vendosen në punë dhe ky problem të zgjidhet një herë e mirë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

MBI ZHVILLIMIN E BLEGTORISË NË QARKUN E DURRËSIT

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

14 dhjetor 1953

Nga raporti i Durrësit konstatohet se në sektorin e blegtorisë ka mjaft dobësi, prandaj nga ana e komiteteve të Partisë në qarqe duhen marrë masa për forcimin e punës në të ardhshmen.

Një nga detyrat e rëndësishme është të rishikohet çështja e kullotave për t'i ardhur në ndihmë fshatarësisë. Kam biseduar edhe me Hysniun për këtë çështje, pse kemi mendimin që kullotat shtetërore mund të mbajnë edhe më shumë bagëti nga sa mbajnë tani, po duke qenë se janë shtetërore dhe tufat janë të shtetit, puna vete «ha të hamë si në divan të pashait». Bagëtime

¹ Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH rreth raportit «Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave dhe të Komitetit Qendror mbi përmirësimin e blegtorisë në qarkun e Durrësit».

të sektorit shtetëror duhet t'u sigurojmë vërtet bazën ushqimore, por kjo s'do të thotë që të mos mendojmë edhe si do të zgjidhet çështja e ushqimit të bagëtive që ka fshatari. E them këtë, pse normativat janë caktuar më shumë nga blegtorët që janë në marrëdhënje pune me shtetin, kërraba e të cilëve ka tërhequr më tepër nga vetja. Për caktimin e këtyre normativave, domethënë sa duhet të hajë një dele, nuk është marrë mendimi edhe i fshatarëve privatë të interesuar për kullotat, prandaj ka edhe kontradikta midis blegtorëve privatë dhe atyre të sektorit shtetëror. Por, edhe blegtorët e sektorit privat duhet të jenë në gjendje të thonë drejt se sa i duhet deles të hajë, ç'normë ushqimi është e mjaftueshme për të. Edhe komitetet ekzekutive nuk duhet të interesohen që të sigurojnë vetëm bagëtitë e sektorit shtetëror, por edhe të fshatarësisë. Unë isha në Vlorë dhe bisedova me një bari, i cili më tha se në një kullotë të Shashicës mund të hanë edhe një herë aq bagëti sa mbahen sot. Prandaj ky mund të jetë një problem edhe për ju, shokë të Komitetit të Partisë të Durrësit. Pamë gjithashtu plot kullota në krye të fshatrave, të cilat mund të përdoren më mirë. Mushahet e fshatit u janë dhënë atyre që kanë mbi 70 krerë bagëti, kurse ata që kanë nga 4-5 kokë nuk kanë ku t'i kullojnë. Pra, njerëzve që kanë ca baza u kemi dhënë edhe kullota, kurse të tjerët i kemi lënë pa bar. Prandaj duhet të bëhet një studim më i drejtë për kullotat. Ky studim duhet të jetë i tillë, që të mund t'u jepet mundësi fshatarëve të shtojnë numrin e bagëtive. Të ngushohen ata që kanë më tepër kullota që të hanë edhe bagëtitë e blegtorëve të tjerë. Kësaj t'i jepet rëndësi.

Kam biseduar me ministrin e bujqësisë për fermën e Xhafzotajt, e cila nuk ka shkuar dhe aq mirë. Ai më tha se do të marrin masa dhe do të parashikojnë që kësaj ferme t'i jepet një orientim edhe për drithëra. Këtë orientim duhet t'ua japim të gjitha fermave, me përjashtim të Kamzës, e cila duhet të sigurojë perime, fruta e qumësht për kryeqytetin dhe t'i lehtësojë fermat e tjera nga këto detyra. Mendoj se duhet parë me kujdes edhe çështja e ekonomive ndihmëse, të cilat po mbajnë toka thuajse pa punuar. Ju, shokë të komiteeve të Partisë, e keni për detyrë, që kur të vijnë këto orientime, të merren masa të menjëhershme dhe të plokta për zbatimin e tyre. Ne duhet të bëjmë disa korrigjime në planin e bujqësisë. Siç jeni në dijeni, për pambukun do t'i zvogëlojmë sipërfaqet. Atë do ta mbjellim në ato toka ku prodhohet dhe në ato ekonomi që kanë krahë dhe kafshë pune, ndërsa tokat e tjera do të punohen në radhë të parë për bukë. Rendimentet në bimë industriale po i marrim në kurriz të zgjerimit të tokave. Kështu nga shumë toka nuk kemi marrë as pambuk, po kemi humbur edhe grurin. Prandaj të mos lejohen gabime të tilla. Atë që ka mundësi të mbjellë pambuk, ta bindim, kurse ai që akoma nuk është i bindur, le të mbjellë misër dhe grurë dhe puna të vazhdojë për ta bindur. Por, duhet të mendohet për ushqimin e bagëtive, edhe në ato raste e vende ku s'ka kullota, pse kështu do të kemi fitime.

Partia çështjen e blegtorisë, sidomos shtimin dhe përmirësimin e racës, ta ketë në pikën e parë të rendit të ditës. Derisa fshatarësia tregon interesim për përmirësimin e racës, Partia të kujdeset dhe ta udhëheqë

atë. Duke parë këtë dëshirë të fshatarësisë duhet të zhvillohet një propagandë e gjerë në radhët e fshatarëve që ata të binden se raca e re është më e mirë nga e vjetra, t'u tregohet fitimi që do të kenë. Të arrihet që fshatari të kuptojë se puna nuk mbaron me kaq, por, për racën e re kërkohet një interesim dhe kujdes më i madh.

Ju, shokë të komitetit dhe të organizatës së Partisë atje në bazë, kontrolloni zbatimin e vendimeve të Komitetit Qendror për këto çështje të blegtorisë, mos humbisni kontaktet me fshatarët për asnjë minutë, mos u kënaqni vetëm duke biseduar me komunistët. Sigurisht, ju me komunistët do të bisedoni, por kurdoherë merrni kontakt edhe me fshatarët, mos e neglizhoni eksperiencën e tyre të madhe, mos u impononi atyre metodat e reja pa i bindur dhe pa pasur parasysh kushtet tona konkrete. Mbani parasysh se agroteknika e re lyp edhe një studim të mirë të tokës, të klimës dhe të erërave. Këtë anë, në shumë raste ne e kemi akoma të dobët, por ne kemi eksperiencën e fshatarëve, e cila është një ndihmë e madhe. Këtë anëtarët e Partisë nuk duhet ta neglizhojnë. Kjo nuk do të thotë me hedhë poshtë metodat agroteknike, po eksperiencia e fshatarëve të na shërbejë për t'ja përshtatur ato konditave tona dhe, kur ne nuk e kemi bërë studimin e tokës në mënyrë shkencore, të mbështetemi në eksperiencën e fshatarëve. Pra, të mësohen teknikët që t'i dëgjojnë fshatarët dhe, kur toka është e ftohtë, të mos e detyrojnë fshatarin ta mbjellë duke i thënë se «kështu na mëson agroteknika». Kur ndodhin gabime të tilla nga teknikët, Partia t'i këshillojë e t'i bindë këta, që të shkojnë e t'u thonë

fshatarëve: «Ju keni të drejtë, na falni, ne këtu kemi gabuar dhe mot do ta ndreqim këtë gabim». Nga të gjitha këto, Partia të nxjerrë konkluzione dhe ta vërë përpara përgjegjësisë komitetin ekzekutiv, të kërkojë prej tij që të merren masat e nevojshme dhe të mos ketë më neglizhenca.

Ne konstatojmë se në Durrës ka përparime nga e kaluara. Kjo ka rrjedhur se edhe viti ishte i mbarë, po edhe puna ka filluar të vihet në rrugë të mirë. Po ne besojmë se komunistëve të Durrësit nuk u rritet mendja me sukseset e arritura, pse atëhere do të bëhet përsëri prapa. Kurdoherë të kujdeseni për planin dhe gjithnjë të shihni si interesin e shtetit, ashtu dhe atë të popullit, pse shteti dhe populli te ne janë një. Kur vjen çështja e planifikimit në fshat, Partia ta nxitë popullin të flasë lirisht, pse kështu plani bëhet me baza të shëndosha dhe reale. Të mos nisemi nga dëshira e t'i bëjmë planet në mënyrë burokratike, por të tërheqim mendimin krijues të masave, të cilat dinë se ku mbillet pambuku, panxhari, breqeti etj., dhe këto i thuhet qeverisë dhe Komitetit Qendror nga ana e qarkut. Prandaj, t'u themi shokëve të dëgjojnë mirë fshatarët, të cilët nuk do ta lënë tokën pa mbjellë, pse s'kanë interes.

Fshati ynë ka forca, ka njerëz të zgjuar, vetëm duhet organizim më i mirë i punës. Të lidhen si duhet komunistët me masat e fshatit, asgjë të mos bëjnë ata pa diskutuar më parë me njerëzit e dalluar, me të cilët të shkojnë bashkë e të bisedojnë përpara gjithë fshatarëve duke u thënë: «Ne komunistët dhe bujqit e dalluar kemi menduar të bëjmë këto gjëra», pas tyre të flasin fshatarët. Kështu problemet do të shqyrtohen më mirë

dhe punët do të shkojnë shumë përpara. Pra, shtruarjen e problemeve në fshat Partia ta bëjë me pak fjalë dhe pasi njerëzit t'i kenë kuptuar ato, të punojnë me kokën e tyre. T'u thuhet fshatarëve: «Na ka ardhur ky rekomandim nga Partia, tani të mendojmë si do ta zgjidhim». Kështu të mendojë dhe të punojë fshatari, i cili tashmë është i ngritur. Partia e favorizoi dhe sivjet klima ishte e mirë, prandaj ai nuk ka frikë, por ka besim se në të ardhshmen puna në blegtori dhe në bujqësi do të vejë akoma më mbarë. Po duhet që edhe ne, nga ana jonë, të ndreqim gabimet dhe t'u japim në shumë fshatarëve sende e mjete, për të cilat ata kanë më tepër nevojë. Në vitin 1954 kemi bindje se do të kemi përmirësime. Por Partia ta kuptojë mirë situatën, pse gjendja nuk është e lehtë, ka akoma shumë vështirësi dhe ne jemi të sigurtë se ato do t'i kapërcejnë dhe do të ecim përpara. Kjo kërkon që Partia të mobilizohet akoma më shumë, pse terrenin e kemi të mirë, kemi një popull besnik, trim, punëtor, të thjeshtë, që bën mrekullira. Edhe ju, shokët e komitetit të Partisë të Durrësit, keni detyra të mëdha, prandaj të jeni në kontakt të vazhdueshëm me komunistët dhe popullin, të mos u zërë gjumi e të punoni pa pushim, duke luftuar kundër burokratizmit kudo që të shfaqet ai.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

MBI DISA ÇËSHITJE TË METODËS SË DREJTIMIT NGA ANA E PARTISË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

14 dhjetor 1953

Edhe unë kam menduar dhe mendoj vazhdimisht për forcimin e mëtejshëm të metodës së drejtimit të Partisë. Sa herë që shkojmë dhe bisedojmë me popullin dhe me komunistët në terren, vërejmë se ç'rëndësi kanë kontaktet e udhëheqjes me masën, për të zbuluar mundësitë e mëdha që ekzistojnë në drejtim të forcimit të Partisë. Mua më duket se metoda e punës së udhëheqjes së Partisë në rrethe e në qarqe me organizatat bazë dhe me popullin nuk është në lartësinë e duhur. Komunistët e bazës kanë kontakte me popullin, po nuk kanë gjetur akoma metodën e mirë se si të punojnë me të. Unë jam

¹ Në këtë mbledhje, Sekretariati i KQ të PPSH, shqyrtoi raportin «Mbi metodën e drejtimit të byrosë së Komitetit të Partisë të qarkut të Elbasanit dhe mbi organizatat bazë».

i bindur se në këtë çështje ka shumë formalizëm, kundër të cilit duhet luftuar vazhdimisht, shpeshherë ka mungesë të vetinisativës nga ana e organizatave bazë të Partisë.

Në disa fshatra që vajta këto ditë, pashë njerëz jashtëzakonisht të ngritur. Këta ishin jo vetëm komunistë, por edhe njerëz pa parti, të rinj e të reja 25-30 vjeçarë, burra e gra 40-vjeçarë. Me të gjithë biseduam, i pyesja e më pyesnin, prandaj me të tillë njerëz të vendosur dhe luftëtarë është gabim i madh të themi që fshati ynë është i dobët, problemet e tij nuk i kuptojnë njerëzit tanë që jetojnë dhe punojnë atje. Unë pyeta 20-25 vetë nëse ishin në Parti, për arsye se nga bisedimet e qartësia e tyre, m'u krijua përshtypja dhe bindja se ata duhet të ishin komunistë, pse i pashë djem të gjallë, që nuk kanë eksperiencë të vogël. Një djalë, fshatar i varfër, të cilit i shkuam në shtëpi, beu e kishte ndjekur tri-katër herë nga fshati, por tani ai kishte bërë shtëpi të re dhe kasollen e kishte lënë të paprishur, për t'ua treguar njerëzve të sotëm dhe brezave që vijnë. Ai ka blerë biçikletë, krevat, ka pajisur shtëpinë me plot orendi etj. Si ky pashë edhe të tjerë. Pashë një me tri dekorata: me të trimërisë, të kujtimit dhe të çlirimit, por megjithatë nuk ishte në Parti. Takova edhe të tjerë që duhet të ishin në Parti, por organizata bazë e atij fshati nuk i kishte pranuar, prandaj ajo përbëhej vetëm nga 8 anëtarë dhe një kandidat partie. Të tjerët, që ishin aq të mirë, qenë lënë jashtë dhe as që i aktivizonin, pra shokët atje janë një çikë sektarë.

Isha edhe në Myzeqe dhe pashë se njerëzit atje

nuk ishin më myzeqarët e dikurshëm. Me njerëz të tillë është e pamundur të mos drejtohet fshati dhe të mos zgjidhen problemet e tij. Mirëpo derisa kemi njerëz kaq të mirë e të zot, përse fshati ynë nuk po përparon me atë ritëm që kërkohet? Mua më duket se organizata bazë nuk është në lartësinë e duhur; në jetën dhe në veprimtarinë e saj ka formalizëm; komunistët nuk mendojnë si duhet me kokën e tyre dhe nuk luftojnë sa duhet bashkë me gjithë kolektivin e fshatit. Kjo situatë duhet ndryshuar. Njerëz kemi plot. Në një kooperativë bujqësore bisedova me një sekretar të rinisë, i cili ishte zjarr dhe i zgjuar. Ai më tha:

«Ja, edhe ca na kanë mbetur jashtë kooperativës, po do t'ua mbushim mendjen që të bëhen anëtarë të saj. Kemi siguruar një gramafon dhe pleq e të rinj hedhin valle, ata marrin pjesë në shkollën politike që unë drejtoj».

Si ky djalë kishte plot. Pra, ne kemi brumë të mirë në fshat, vetëm se organizatën bazë duhet ta vëmë në pozita më luftarake dhe vetëvepruese, se po e mësojmë të punojë në bazë të urdhërave, të cilat disa herë ua transmeton fshatarëve në mënyrë arbitrare. Ka organizata bazë në fshat që janë bërë transmetuese të urdhërave në mënyrë automatike. Kur vajta në ato fshatra, u hapën gojët e njerëzve të thjeshtë të popullit, që shpeshherë janë mbyllur nga disa shokë partie. Një plak më pyeti:

«A është e drejtë që një njeri, i cili s'ka as që, as krahë pune të detyrohet të mbjellë dy hektarë pambuk?»

Jo, nuk është e drejtë — ju përgjegja unë. Ndërsa sekretari i organizatës u hodh dhe tha:

«Po plani?»

«Rri ti atje, i tha plakū, se tani do të flas unë». Kjo do të thotë se shokët tanë nuk e dëgjojnë sa duhet mendimin e fshatarit. Nuk është e drejtë t'u imponojmë fshatarëve sa tokë duhet të mbjellin me pambuk në një fushë që nuk e prodhon atë. Fshatari e ka ngritur zërin dhe këtë ma thanë edhe mua 10-15 vetë, po asnjë njeri nuk ua ka vënë veshin, bile ata thanë se kanë pasur frikë të kundërshtojnë. Njëri prej tyre tha:

«Unë e dua pushtetin dhe megjithëse kundërshtova se toka ime nuk bën pambuk, më detyruan, mbolla 2 hektarë dhe mora vetëm 120 kg. kështu humbi shteti, humba dhe unë». Prandaj, komitetet e Partisë duhet të mendojnë më mirë për aktivizimin e organizatave bazë dhe të popullit në problemet ekonomike, politike e kulture. Mbledhja e organizatës bazë nuk është diçka në vetëvete, e shkëputur, jashtë aktivitetit dhe jetës së gjallë të fshatit. Prandaj, komunistët duhet t'u shkojnë fshatarëve edhe në shtëpi, që të mësojnë prej tyre e t'i mësojnë ata. Për çështje të bujqësisë, shokët të mos mendojnë se fshatarët janë injorantë. Jo, ata dinë shumë dhe me eksperiencën që kanë e me ndihmën konkrete që duhet t'u jepet, natyrisht të shoqëruar edhe materialisht, mendoj dhe jam i sigurtë se në fshat përparimet do të jenë më të shpejta e më të mëdha.

Mua më duket se me përjashtim të ndonjë problemi të vogël organizativ, nuk mund të ketë probleme të tjera që të jenë të shkëputura nga gjithë kolektivi i fshatit. Prandaj, që të zgjidhen çështjet e fshatit atje duhet të praktikojmë mbledhje të hapëta të Partisë, sidomos për ato më kryesoret, siç janë në radhë të parë

çështjet politike dhe ekonomike, për shembull çështja e mbjelljes së kulturave të ndryshme, krediti agrar, detyrimet etj. Për këto çështje fshatarët të diskutojnë dhe të shfaqin lirisht mendimet e tyre.

Në kooperativën bujqësore të Novoselës, ku unë vajta, kishte 11 komunistë, por asnjë grua. Po të isha unë atje, do të pranoja pa frikë 25 gra, të cilat e meritojnë. Si flisnin ato, çfarë zhvillimi dhe kurajë që kishin! Të tëra ato gra, me përjashtim të ndonjë plake, dinin të shkruanin e të lexonin, ishin veshur bukur, megjithëse nuk e dinin që do të shkoja unë. Kjo ndodh në një kooperativë bujqësore, e cila deri vjet ishte e dobët. Pra njerëz në fshat kemi dhe këta janë të zotët për të zbatuar si duhet vendimet e Partisë e të qeverisë. Veçem duhet që komitetet e Partisë t'u vënë rëndësi të jashtëzakonshme lidhjeve të Partisë me masat dhe këto jo me fjalë, por konkretisht me punë, t'i inkurajojmë fshatarët që të na kritikojnë, të kritikojmë edhe ne ku janë dobësitë e të zhdukim ndonjë grindje që ka aty-këtu. Hakiu më tha se në kooperativën e Novoselës kishte një farë tarafi, për arsye se parvjet ishte kryetar një njeri nga një fis i fshatit dhe tani kishte ardhur një i ri nga një fis tjetër dhe kjo bëri që atyre t'u mbetet hatri. Pyeta kryetarin e ri për këtë çështje dhe ai pranoi se kjo është e vërtetë, «por kështu e kanë fshatarët»! Jo, i thashë unë, mund të ketë ndonjë që është në kundërshtim, por mund të sqarohet, varet si punon organizata e Partisë në fshat. Por nuk janë të gjithë që bëjnë rezistencë për çështjen e zgjedhjes tënde si kryetar i ri. Dhe shkuam në një shtëpi, te një plak, i cili që kur na pa, na tha: «Mirseardhët». Unë ju drej-

tova këtij plaku duke i thënë: Erdhëm te ty, se je një plak i ndershëm, pastaj më tha edhe kryetari «të vemë se është njeri i mirë». Duke biseduar me të i thashë se kryetari është djalë i ri, i mirë, prandaj ta ndihmoni, po kur gabon dhe ta kritikoni. Pra, kur vete atje sekretari duhet të veprojë konkretisht për ta rregulluar gjendjen dhe jo të konstatojë e të largohet. Prandaj, të forcojmë lidhjet e Partisë me masat, të dëgjohet populli e të zgjidhen problemet bashkë me të dhe jo në mënyrë burokratike. Njerëzit e thjeshtë të popullit janë plotësisht të lidhur me Partinë, e kuptojnë atë dhe luftojnë kundër burokratizmit, i cili nuk është në natyrën e tyre.

Përsa i përket koordinimit të planeve të punës, ky është një problem i rëndësishëm. Edhe ne në Komitetin Qendror dhe në qeveri nuk kemi arritur akoma të kemi një metodë pune të kënaqshme. Është zor për ne t'ju themi se si të bëni, por le të rrahim mendimet, se edhe ju nuk e keni gjetur metodën e duhur të punës, pra, të përpiqemi bashkërisht që ta rregullojmë këtë çështje. Parimet i dimë, po gjatë zbatimit të tyre, në praktikë, hasim vështirësi. Duke ditur rolin udhëheqës të Partisë, këto probleme të rëndësishme natyrisht, duhet me doemos t'i koordinojmë me pushtetin. Partia duhet të vendosë dhe pushteti të zbatojë. Ju, natyrisht, në punën tuaj duhet të udhëhiqeni edhe nga vendimet e qeverisë, edhe nga ato të Komitetit Qendror. Sigurisht varet shumë edhe nga ne që metoda e punës suaj të forcohet dhe më shumë. Këtu kemi faj edhe ne, sepse edhe planet tona të Byrosë Politike nuk janë të koordinuara akoma si duhet me ato të qeverisë me qëllim që vendimet e Partisë të mund të zbatohen si duhet për ato

probleme që u takojnë organeve të pushtetit. Kështu me plane të koordinuara, shokët e bazës të kenë caktuar në kohën e duhur problemet që do të shqyrtohen në byronë e komitetit të Partisë dhe në komitetin ekzekutiv. Po, sidoqoftë, një plan pune ekziston edhe te ne, edhe te ju, veçse duhen bërë përpjekje që këto plane të jenë sa më të sakta dhe të mos ketë paralelizëm me pushtetin. Ka probleme që mund të merren në shqyrtim edhe bashkë me komitetin ekzekutiv, ka të tjera që duhet të analizohen më parë në byronë e komitetit të Partisë të qarkut, pastaj të shtrohen në komitetin ekzekutiv, po ka edhe probleme operative, që duhet t'i shqyrtojë komiteti ekzekutiv, ndërsa komiteti i Partisë të organizojë kontrollin e zbatimit të tyre. Por këtë punë nuk po e bëjmë akoma si duhet. Byroja Politike vjet pati caktuar një plan pune të tillë, të cilin deri diku e kemi ndjekur. Pra, Byroja Politike i ka marrë këto probleme në analizë, po kështu edhe qeveria. Edhe ju, kështu të punoni. Problemet kryesore t'i mbani mirë parasysh dhe të kërkonte nga komiteti ekzekutiv jo vetëm raporte e statistika, po edhe vetë kryetari të vijë dhe të raportojë për atë problem që shihet se nuk ecën si duhet, me qëllim që të merren masa. Gjithashtu juve mund t'ju dalë ndonjë problem i rëndësishëm, të cilin, megjithëse nuk është parashikuar në plan, duhet ta shqyrtoni në mbledhje të byrosë, të vendosni dhe t'i thoni komitetit ekzekutiv të marrë masa për detyrat që i takojnë. Sa për problemet ekonomike, e kemi thënë edhe herë të tjera që këto nuk duhet t'ju tërheqin dhe të arrini të bëni punën e pushtetit, por me anë të tij të zbatoni vendimet, njëkohësisht të mobilizoni Partinë

për zbatimin e detyrave, të mobilizoni organizatën e bashkimeve profesionale, punëtorët etj. Nuk duhet të veprojmë në mënyrë që të kapërcehet e të spostohej pushteti.

Edhe diçka për direktivat që jepen nga ana jonë dhe punimin e vendimeve. Kësaj detyre i duhet kush-tuar rëndësi e madhe. Ju, jo vetëm të përmirësoni metodën e punës, po nga eksperiencia e punës së Partisë në bazë të na mësoni edhe ne si duhet ta bëjmë më mirë punën. Mundet dhe duhet që të na bëni vërejtje për direktivat që japim, pse praktika, jeta dhe lufta e Partisë në bazë mjaft nga udhëzimet tona si Komitet Qendror, mundet t'i rrëzojë. Ne duam medoemos eksperiencën e bazës në këtë drejtim. Neve nuk na lejohet të flasim shumë gjatë. Me ju mundet të flasim edhe pak gjatë, po me shokët e bazës kjo nuk lejohet, për shkak të nivelit të tyre të ulët kultural dhe ideologjik. Fshatarët dhe punëtorët janë njerëz të thjeshtë, ata duan t'ua thuash çështjet me pak fjalë. Mos kërkoni që të përdorni fraza dhe shumë fjalë të mëdha me fshatarët. Instruktorët e komitetit të Partisë dhe sekretarët e organizatave bazë t'u thonë njerëzve esencën e çështjeve, duke u folur shkurt, pse ata nuk mund të na kuptojnë me fraza të mëdha. Ne kur flasim pak, mund të na duket sikur nuk kemi thënë gjë. Ky është gabim. Le t'i themi gjërat me tri fjalë, por pastaj duhet të punojë koka e secilit si të zbatohet direktiva që jepet. Të mos e heqim veten se jemi specialistë për të gjitha gjërat, por anëtarët e Partisë në detyrën konkrete që kanë në sektorët e ndryshëm janë vërtet specialistë, prandaj duhet të punojnë me kokën e tyre. Kjo do të

thotë që komunistët dhe organizatat bazë të vetëveprojnë. Gjithashtu dhe vendimet e rëndësishme të Komitetit Qendror e të Byrosë Politike, të cilat tregojnë rrugën se si duhet punuar, të shtrohen deri në organizatat bazë të Partisë.

Protokollet e Sekretariatit të Komitetit Qendror kanë rëndësi të madhe. Sekretariati është ngarkuar nga Byroja Politike të drejtojë punën e Partisë. Prandaj të gjitha vendimet që marrim ne, ju vijnë atje në formë protokolli. Aty ka çështje që duhet t'i dijë vetëm sekretari i parë; megjithkëtë ne ju rekomandojmë që protokollat të punohen në mbledhje, dhe për këtë jo të zhvillohen mbledhje speciale, por në mbledhjet që bëni, midis çështjeve të tjera, të lexohen edhe protokollat, dhe pasi të bëhet një pushim për të reflektuar ato që u thanë, të diskutohet rreth tyre; ndërkaq mund të flasë secili për sektorin e tij duke treguar edhe masat e duhura që do të marrë për zbatimin e porosive e të këshillave të Sekretariatit të Komitetit Qendror. Kjo procedurë, sa të jetë e mundur të jetë e thjeshtë, të mos vonojmë marrjen e masave.

Në qendrën e punës për shkeljen e ligjeve mund të bëhet një mbledhje e përgjithshme, ku vetëm në 10 minuta të vihet në dukje cila është direktiva e Partisë për këtë çështje, të kritikohet kush i ka shkelur ato, qoftë ky edhe drejtori dhe të merren masat përkatëse. Në raste të tilla mund të bëhet edhe mbledhja e hapët e organizatës bazë, e cila të vlejë për edukimin e gjithë kolektivit. Pastaj organizata bazë e Partisë të kontrollojë si po zbatohen detyrat që dolën nga mbledhja e saj. Të mos bëhet «mbledhje për mbledhje», po të

merret shpejt eksperiencia e mirë dhe të zbatohet ajo në mënyrë operative. Mos lini pasdore çështjet organizative të Partisë, mos ju marrin zvarrë çështjet ekonomike. Pa një parti të shëndoshë nuk mund të bëhet asgjë. Të gjitha çështjeve, që kanë të bëjnë me forcimin e Partisë si mbledhjet, disiplina etj., duhet t'u vini rëndësi të madhe dhe t'i ngrini me forcë, pse ndryshe ato nuk realizohen. Çështja e forcimit të Partisë duhet të jetë një detyrë e përditshme e çdo komunisti. Edhe për atë që u tha këtu, lidhur me sekretet e Partisë, duhet të thelloheni për të nxjerrë cili është shkaku që disiplina në disa organizata partie është e dobët. Njerëzit nuk janë të gjithë të pandërgjegjshëm dhe ata që bëjnë gabime nuk janë armiq, megjithëse mund të ketë edhe ndonjë të tillë, po shkaqet e këtyre dobësive mund t'i gjejmë te metoda e punës së organizatës, te sjellja jo e mirë e ndonjë sekretari të organizatës etj. Mundet që një komunist në fshat të mos ketë këtë muaj të japë detyrimin, por ky nuk duhet vënë në majë të dyfikut dhe të detyrohet të marrë angazhime në baza joreale. Kur ai thotë «nuk kam këtë muaj, jam shumë shtërnguar», atëherë të lihet t'i japë më vonë detyrimet, ndërsa tjetri që është në gjendje më të mirë, t'i japë ato më shpejt.

Për mospjesëmarrje të rregullt në mbledhjet e Partisë, më duket se shkaku kryesor është se problemet atje nuk shtrohen si duhet dhe njerëzit nuk dalin me auto-kritikë të shëndoshë. Kur njerëzit të preokupohen për problemet që shtrohen dhe ta ndjejnë mbledhjen e organizatës si një domosdoshmëri, pa të cilën nuk mund të zgjidhen çështjet, kur komunisti të ndjejë se ai me

shokë janë përgjegjës për punën që duhet bërë, vjen vetiu nevoja e mbledhjes së organizatës.

Po diskutimet pse bëhen formale? Në të shumtat e rasteve kjo ndodh pse problemet nuk ngrihen në atë shkallë që duhet, se po t'u dhëmbë të tërëve dhe po të preokupohet organizata bazë për atë problem që shtrohet, edhe diskutimet do të jenë shumë të zjarrrta. Populli ynë është i zgjuar dhe ka kurajë, kështu dhe akoma më shumë janë komunistët, atëhere pse të mos bëhet organizata bazë luftarake? Por ka disa arsye që e shpjegojnë këtë; në radhë të parë është çështja si shtrohen problemet në organizatën bazë, si paraqiten ato, si kuptohen, a shihen në mënyrë të tillë që anëtarët e Partisë të arrijnë t'i zgjidhin drejt ato etj.

Për lidhjen e Partisë me masat ka rëndësi edhe çështja e kartërave të Frontit. Të keni më shumë kujdes në këtë drejtim, pse ka disa pakënaqësi. Ka raste që karta e Frontit nuk i jepet edhe ndonjërit që i takon. Një njeri i tillë bëri dy ditë rrugë që të takohet me mua për të marrë kartën e Frontit, e cila nuk i qe dhënë megjithëqë ai nuk është armik. Puna ka arritur deri aty sa këtu në Tiranë ka pasur një rast që karta e Frontit nuk i është dhënë edhe punëtorit të dalluar. Kjo nuk është vija e Partisë, prandaj atje ku janë bërë gabime të tilla, duhen ndrequr.

Edhe çështja e kulakëve duhet të shihet me syrin e Partisë. Në qoftë se në një fshat nuk ka kulakë, mirë, le të mos ketë, ne nuk duhet ta ndezim artificialisht luftën e klasave, kjo nuk është në vijën e Partisë. Ai që ka kushtet politike dhe ekonomike dhe është kulak, ndaj tij të mbahet qëndrimi që ka përcaktuar Komiteti

Qendror, por ndonjë që është cilësuar padrejtësisht kullak, titulli duhet t'i hiqet menjëherë.

Përsa u përket çështjeve ekonomike, jam dakord me Manushin që ato nuk mund t'i shqyrtojmë këtu në Sekretariat, pse janë probleme të tilla, që i përkasin Byrosë Politike dhe qeverisë. Ju duhet të keni kujdes për to, pse janë çështje kryesore, siç tha edhe Josifi¹, prandaj t'i analizoni në byro të Komitetit të Partisë dhe t'i zgjidhni mirë këto çështje. Elbasani ka nga tokat më të mira dhe më pjellore, prandaj pse atje të jetë një prapambetje e tillë, kurse njerëzit si kudo, edhe atje janë të mirë? Prandaj Partia të luftojë më mirë për këto probleme, ajo të interesohet edhe për Kombinatin e drurit «Nako Spiru» dhe për sharrat e Bizës, ku duhet të shkonit më përpara për të forcuar gjendjen, pse atje ka dobësi. Partia ta marrë punën në dorë, të vërë përpara përgjegjësisë Ministrinë e Industrisë, e cila duhet të kryejë më mirë detyrat e saja, pse ka mjaft mungesa. Edhe çështja e ullirit ka rëndësi të madhe, prandaj të luftohet edhe për një kokërr ulliri, që të mos vejë dëm dhe mbledhja e tyre të bëhet një fushatë e jashtzakonshme, për Partinë, pushtetin dhe popullin. Ti, shoku Sul² ke qenë vetë kryetar i Bashkimit Qendror të Kooperativave dhe e di sa e rëndë është zgjidhja e çështjes së yndyrnave, për të cilat ne kemi aq vështirësi, saqë detyrohemi të importojmë edhe nga jashtë. Prandaj atyre që janë në gjendje të mbledhin ullinjtë dhe nuk

¹ Josif Pashko, në atë kohë sekretar i Komitetit Qendror.

² I drejtohet shokut Sul Baholli, në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të qarkut Elbasan.

shkojnë, t'u themi: Ju kërkoni vaj, po kush do ta sjellë atë, apo doni të bjerë nga qielli? Ja vaji dhe ulliri ku janë, prandaj në qoftë se doni, shkoni në punë. Pra ju duhet ta ngrini me forcë këtë çështje, në mënyrë që asnjë kokërr ulliri të mos kalbet. Të kemi nën kontroll transportimin e tij në fabrika, çështjen e rezes së vajit etj. Yndyrnat janë një nga ushqimet më me rëndësi, për atë ka mjaft nevojë populli ynë. Prandaj, të gjithë në punë për të mbledhur ullinjtë. Komunistët duhet të nxjerrin gratë, nënat dhe motrat e tyre që mund të mos jenë në punë, pse dihet që te ne puna është nder.

Më në fund kisha edhe dy fjalë për kuadrin. Disa shokë thonë se në qendër ka mjaft kuadro, sido që unë nuk jam edhe aq i bindur për këtë pse, pas riorganizimit, në shumë sektorë ka vështirësi në kryerjen e detyrave, për shkak se është bërë edhe ndonjë bashkim dikasteresh në një të vetëm ose disa degë në një drejtori, disa seksione në një degë të vetme e kështu me radhë. Megjithkëtë të shikohet se ç'mund të bëhet. Po problemi nuk zgjidhet me dhënjen e 20 a 30 kuadrove që mund të shkojnë nga dikasteret në bazë. Problemet do t'i zgjidhë lufta dhe puna e Partisë së bashku edhe me popullin. Prandaj kuadrot të kuptojnë qartë detyrat e mëdha që kanë. Ato, në luftë për zbatimin e tyre do të rriten dhe do të bëjnë më shumë se deri tani.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSII
që gjendet në AQP*

«MBI MASAT PËR NGRITJEN E MËTEJSHME TË NIVELIT TË JETESËS SË MASAVE PUNONJËSE»

Raport i mbajtur në Plenumin IX të KQ të PPSH

24 dhjetor 1953

Shokë,

Ky Plenum i Komitetit Qendror të Partisë është thirrur në mbledhje plenare, për të analizuar shkaqet e masave që Byroja Politike dhe qeveria morën këto kohët e fundit si dhe për të përcaktuar orientimin e nevojshëm për të ardhshmen, lidhur me nevojën e ngutshme për përmirësimin e nivelit të jetesës së masave punonjëse të fshatit e të qytetit.

Në qershor të këtij viti, Byroja Politike, duke analizuar situatën e vështirë ekonomike të masave punonjëse të qytetit dhe të fshatit, orientoi qeverinë për marrjen e një sërë masash të rëndësishme ekonomiko-administrative në drejtim të përmirësimit të jetës së punonjësve të qytetit dhe të fshatit.

Gjendja ekonomike e punonjësve tanë si në fshat dhe në qytet, me gjithë përmirësimet, përsëri është

mjaft e vështirë¹. Orientimi për të ndërtuar objekte të mëdha me ritme të shpejta, të kushtueshme dhe disa herë jo shumë të domosdoshme sot për sot, fryrja e aparatit administrativ dhe mosrealizimi plotësisht i planit të shtetit, kanë vështirësuar shumë përmirësimin e kushteve të jetesës së punonjësve të qytetit dhe të fshatit. Rritjes së prodhimeve bujqësore e blegtorale, të cilat janë të domosdoshme për përmirësimin e jetës

¹ Vështirësitë në gjendjen ekonomike që paraqiten në raport rridhnin nga disa faktorë: nga prapambetja ende e theksuar e vendit, nga përvoja e pamjaftueshme në drejtimin me plan të ekonomisë, nga pengesat e jashtzakonshme që shkaktonin veprimtaria e dendur armiqësore e imperialistëve amerikanë, anglezë dhe shërbëtorëve të tyre në kufitë e atdheut tonë.

Për kapërcimin e këtyre vështirësive, Partia e Punës e Shqipërisë u mbështet kryesisht në forcat e veta, në burimet njerëzore, ekonomike dhe financiare të vendit. Në të njëjtën kohë KQ i Partisë ju drejtua KQ të PK dhe qeverisë së BS që të ndihmonin në përballimin e kësaj gjendjeje. Mirëpo në marrëdhënjet midis RPSH dhe BRSS pas vdekjes së J. V. Stalinit në mars 1953 u dukën shënjat e para të ndërhyrjes në punët e brendshme dhe të presioneve të palejueshme nga ana e udhëheqjes sovjetike, u duk mungesa e një gatishmërie të plotë për të ndihmuar pa interes dhe pa kushte një vend të vogël socialist, ende i prapambetur, por sidomos i rrethuar gjeografikisht nga të gjitha anët prej armiqsh të betuar të socializmit e të pavarësisë kombëtare të Republikës sonë Popullore. Kjo gjë u manifestua në kërkesat e qeverisë sovjetike, në qershor dhe në dhjetor të vitit 1953 për të ulur ritmin e zhvillimit të industrisë në Shqipëri dhe për të hequr nga plani i ndërtimeve një numër objektesh industriale të rëndësishme e të domosdoshme për ekonominë e vendit. Qëllimi i vërtetë i këtyre kërkesave doli në shesh më vonë, kur ndërhyrja dhe presionet e udhëheqjes sovjetike morën një karakter brutal dhe të hapët.

së punonjësve, si dhe një nga mbështetjet kryesore për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të vendit, nuk i është kushtuar kujdesi i nevojshëm, mbasi mjetet dhe forcat kryesore u përqëndruan më shumë në objektet e mëdha industriale, të cilat kërkonin vazhdimisht forca të reja, mjete dhe furnizime. Një gjë e tillë ka krijuar një situatë mjaft të vështirë.

Për një përballim të mëtejshëm të nevojave të popullit është e nevojshme të analizojmë gjendjen e vështirë ekonomike të popullit në fshat e qytet. Kështu do të mund të kuptohen më mirë dhe arësyet që e shtynë Byronë Politike dhe qeverinë të marrin masa dhe të përcaktojnë detyrat e duhura për përmirësimin e gjendjes.

I. — GJENDJA EKONOMIKE E FSHATARËSISË

Pas çlirimit të vendit, me zbatimin e reformës agrare dhe me ndihmën e kujdesin e Partisë dhe të pushtetit popullor për fshatarësinë, gjendja e bujqësisë u përmirësua. Prodhimet bujqësore, në përgjithësi, janë shtuar në krahasim me paraluftën. Kështu, qysh në vitin 1946, janë prodhuar 14,8 për qind më shumë drithëra buke (grurë, misër, thekër) se më 1938. Gjithashtu çdo vit pas çlirimit sipërfaqja e punueshme është rritur në një mënyrë të kënaqshme dhe sot kemi 130 000 ha. tokë të punueshme më tepër se në vitin 1938. Tani në bujqësi janë futur kultura me rëndësi industriale si pambuku, panxhari i sheqerit, të cilat më parë nuk njiheshin, ose

mbilleshin shumë pak dhe që tashti janë zhvilluar mjaft.

Por, megjithkëtë, gjendja ekonomike e fshatarësisë sonë është akoma e ulët. Masat e marrura deri sot në drejtim të bujqësisë kanë qenë të pamjaftueshme dhe nuk e kanë bërë atë të dalë nga prapambetja dhe t'i shtojë prodhimet.

Në prodhimin e drithit, në përgjithësi, pas çlirimit ka një rritje, por përsëri ky ka qenë i paktë dhe ne nuk kemi mundur të sigurojmë në vend asnjë vit sasinë e mjaftueshme të drithit. Për të siguruar bukën për popullin ne kemi qenë të detyruar të importojmë nga jashtë, çdo vit, sasi të konsiderueshme drithi. Nga drithërat e bukës, prodhimi i misrit ka shkuar më keq dhe rendimenti i tij mesatar, pas çlirimit ka qenë shumë i ulët. Po të mirren rendimentet efektivisht të realizuara çdo vit pas çlirimit do të shohim se misri ka lëvizur nga maksimalja 12,8 kv. për ha. (viti 1947) në minimalen 8 kv. për ha. (viti 1952). Vetëm në vitin 1953 do të realizohet një rendiment prej 13,30 kv. për ha. që është pak më i lartë se ai i vitit 1938.

Arësyet kryesore janë se në Shqipërinë e paraçlirimit misri ka qenë kultura kryesore, mbillej në sipërfaqe më të vogla, në toka më të mira, një pjesë e mirë e plehut përdorej vetëm për të dhe këtij i bëhej një shërbim i veçantë për arësye se mobilizohej shumica e krahëve të punës. Veç këtyre, në mënyrë të ndieshme negative ka influencuar thatësira e viteve të pasçlirimit: 1945 e 1946 dhe 1950, 1951 e 1952. Ndërkaq sipërfaqja e mbjellë me grurë, ka ardhur duke u rritur dhe ka pasur një

stabilitet relativ në rendimentin e tij. Përsa i përket grurit dhe të lashtave, në përgjithësi, ka qenë ndryshe. Këto kultura kanë pasur disa kushte më favorizuese: Më 1949 u importuan 5 000 kv. farë gruri, që ishte kontingjenti më i mirë vjetor për farë pas çlirimit. Gjithashtu për t'i shpëtuar vrugut janë mbjellë më gjerësisht varietete gruri të hershme, janë bërë kanale kulluese, janë sistemuar një pjesë tokash, janë përhapur njohuritë agroteknike elementare (para çlirimit, duke përjashtuar qarkun e Korçës, zonat e tjera e mbillnin grurin pothuajse në toka të papunuara) dhe pushteti ka bërë propagandë të vazhdueshme që të rriten sipërfaqja e rendimenti i grurit dhe i të lashtave të tjera.

Prodhimi i drithërave është i ulët për njësi sipërfaqe edhe për shkak se në disa zona sipërfaqe të konsiderueshme të tokave më të mira u zunë me bimët e reja industriale. Kjo gjë ka qenë e nevojshme. Por, do të kishte rezultate më të mira si në prodhimin e drithërave, ashtu dhe në bimët industriale, po qe se do të ndiqnim kritere më të drejta në përhapjen e bimëve industriale.

Sipërfaqja e mbjellë me bimë industriale është shtuar rreth 36 000 ha. më tepër se para çlirimit, por nuk është studjuar thellë që përhapja e tyre të bëhej vetëm në tokat e përshtatshme dhe të përqëndrohej vëmendja në rritjen e rendimentit të tyre. Për të arritur prodhimin e nevojshëm është zgjedhur rruga e zgjerimit të sipërfaqes së mbjellë me këto kultura, duke i mbjellë edhe në toka të papërshtatshme për to e dendur, pa marrë parasysh sa duhet vullnetin dhe dëshirën e fsha-

tarit dhe krahët e punës që ai kishte dhe që kërkonin shërbimet e këtyre kulturave. Këto gabime shkaktuan zënjen e sipërfaqeve të tokave në dëm të prodhimit normal të drithërave dhe realizimin e rendimenteve minimale në vetë bimët industriale. Kështu, për vite me radhë, nuk janë realizuar parashikimet as për drithërat as për bimët industriale, duke u krijuar deficite të mëdha në to. Vetëm për vitet 1950, 1951 dhe 1952 është krijuar një deficit prej 1 840 110 kv. drithëra buke në krahasim me parashikimin dhe po gjatë këtyre viteve është krijuar një deficit në pambuk prej 15 000 ton dhe në panxhar sheqeri 41 657 ton.

Shkaqet e rendimenteve të ulëta në prodhimin e drithërave dhe të bimëve industriale janë: thatësira e madhe që ka bërë vitet e fundit, niveli i ulët agroteknik, pamjaftueshmëria e mjeteve dhe e kafshëve të punës, ndihma e pamjaftueshme e dhënë nga shteti në farëra, plehra kimike e vegla bujqësore. Përveç faktit se 83 përqind e sipërfaqeve të mbjella është e copëtuar në ekonomi individuale, prodhimi është i varur shumë nga natyra, bujqësia jonë akoma nuk ka dalë nga prapambetja dhe në të nuk zbatohet një agroteknikë e përparuar. Punimi i tokave nuk bëhet i mirë, mbillet me vonesë dhe zgjatet shumë periudha e përgatitjes dhe e mbjelljes së tokave. Dy të tretat e ekonomive bujqësore punojnë me parmenda druri në vend të plugut të hekurit, sidomos në zonat malore. Kjo vjen jo vetëm se fshatarët ngurrojnë të heqin dorë nga përdorimi i mjeteve primitive, por edhe pse shteti ka shpërndarë shumë pak plugje të përshtatshme. Kështu në 4 vitet 1949-1952 janë shitur rreth 8 500 plugje që janë baras me aq sa të

plotësojnë furnizimin me nga një plug të 5 ose 6 për qind të ekonomive bujqësore, në Republikë. Gjithashtu nuk bëhet mirë shpërndarja dhe përdorimi i lesave të hekurta dhe të kultivatorëve të tërhequr me kafshë, mjete të domosdoshme për punimin, për thërmimin e tokës dhe për ruajtjen e vlagës së saj. Nuk është organizuar mirë dhe nuk po arrihen rezultate të kënaqshme në përhapjen e metodave të përparuara në bujqësi. Gjithashtu si nga teknikët, edhe nga organet e pushtetit e të Partisë nuk mbahet shumë parasysh eksperiencia shekullore që kanë bujqit tanë, si në punimet, ashtu dhe në përdorimin e kulturave të ndryshme bujqësore.

Aty ku është pasur parasysh eksperiencia e bujqve tanë, ku është punuar mirë për përhapjen e agroteknikës, me gjithë vitet e thatësirës, rezultatet kanë qenë më të mira. Vitet 1950, 1951 dhe 1952 kanë qenë të disfavorshme për bujqësinë, megjithkëtë dëmet e thatësirës nuk kanë qenë shumë të ndieshme aty ku është punuar më mirë.

Përveç prodhimeve të pakënaqshme në drithëra e bimë industriale, ajo që ka influencuar shumë në dobësimin ekonomik të fshatarit tonë është gjendja e keqe e blegtorisë. Në vitin 1945, me përjashtim të buajve dhe të buallicave, blegtoria arriti të tejkalojë nivelin e paraluftës. Por, në vitet e mëvonshme, sidomos në vitet e thatësirës së madhe 1950, 1951 dhe 1952 kemi një rënje të dukshme. Kështu në krahasim me vitin 1938, në dhjetorin e vitit 1952 kemi njëthundrakë 100,9 për qind, gjedhe 97,7 për qind, buaj e buallica 52,4 për qind, dhen 93,8 për qind, dhi 83 për qind. Kjo rënje e blegtorisë,

jo vetëm ka pakësuar prodhimet blegtorale për fshatin dhe për qytetin, por ka influencuar direkt në dobësimin e bujqësisë, sepse pakësimi i qeve të punës dhe i kafshëve të trasha ka qenë i ndieshëm.

Pendët e punës janë pakësuar pas çlirimit, megjithëqë nevojat janë mbi 100 për qind më të mëdha, pasi sipërfaqet e mbjella dhe lloji i punimeve që kërkojnë kulturat e reja, janë shtuar. Nga regjistrimi i blegtorisë në dhjetor 1952 kemi 74 600 pendë që dhe buaj, që janë 18 300 pendë ose 20,6 për qind më pak se më 1938. Çdo pende i bie të kryejë punimet në 4,2 ha. sipërfaqe fizike afërsisht, ndërsa më 1938 çdo pende i binte 2,3 ha. sipërfaqe. Veç kësaj shpërndarja e pendëve të qeve nuk është e rregullt dhe në disa zona bujqësore të vendit gjendja është akoma më e rëndë: në rrethin e Vlorës p.sh. në çdo 100 ha. tokë të punueshme ka vetëm 19 pendë, me të cilat, është kryekëput e pamundur që të kryhen punimet e nevojshme (viti 1951). Ne kemi sot mbi një të tretën e ekonomive bujqësore individuale pa që punc. Mungesa e qeve është një nga dobësitë tona më të mëdha në bujqësi.

Gjithashtu në fshatin tonë janë rreth 33 000 ekonomi bujqësore pa bagëti të imta. Në pakësimin e qeve të punës dhe të bagëtive në përgjithësi ka influencuar në radhë të parë pakësimi i vazhdueshëm i bazës ushqimore dhe veçanërisht i kullotave në favor të tokave të bukës dhe të pyllëzimeve. Plani i pyllëzimeve dhe hapja e tokave të reja, nuk janë koordinuar asnjëherë me nevojën e kullotave për bagëti. Veç kësaj mungesa e ushqimit për kafshët është edhe si pasojë e mospërhapjes sa duhet të jonxhës dhe të bimëve të tjera foragjere. Nga

5 402 ha. të paraparë për t'u mbjellë me jonxhë në periudhën 1952-1953, u mbollën 3 305 ha. ose 61 për qind dhe kjo ndodhi për mungesë të farës. Akoma nuk është zgjidhur prodhimi i farës së jonxhës që kërkohet shumë nga fshatarët. Gjithashtu në pakësimin e bagëtime ka influencuar shumë thatësira e madhe gjatë viteve 1950, 1951 e 1952, që shkaktoi therjen dhe shitjen e bagëtime nga ana e fshatarëve për të siguruar bukën dhe për të përballuar detyrimet e ndryshme. Edhe kujdesi i paktë për strehimin e bagëtime si dhe tatimi i rëndë unik për ha. me koeficient të lartë dhe tatimi financiar kanë penguar shtimin e bagëtisë.

Veç forcave tërheqëse në fshat, në përgjithësi, kemi mungesë kralesh pune. Në mënyrë të veçantë kjo mungesë është e theksuar në zonat fushore, ku çdo ekonomi bujqësore disponon sipërfaqe toke më të madhe, ku kemi filluar të përhapim më shumë kultura intensive industriale dhe ku mjetet e mekanizuara nuk i përgjigjen kësaj nevoje. Kështu që, ndërsa nevojat për krahe pune janë rritur, ne kemi sot një deficit të ndieshëm, për shkak se shumë njerëz janë larguar për nevojat e reja në sektorët ekonomikë dhe në aparatin e shtetit (punëtorë, nëpunës, ushtarë etj.). Kështu p.sh. ndërsa në vitin 1945 kemi pasur mesatarisht 174 krahe pune për çdo 100 ha. tokë të punueshme, në vitin 1950 kemi pasur në fshat 126 krahe pune për çdo 100 ha. Ky deficit, natyrisht nuk është i njëjlojtë në çdo zonë; në Durrës dhe në Lushnjë p.sh. deficiti në krahe pune është më i lartë se sa ai për tërë Republikën. Pakësimi i forcave në fshat, duke shtuar radhët e klasës punëtore në industri, në miniera dhe në sektorët e tjerë është proces

i rregullt dhe i nevojshëm, por në konditat e zhvillimit të gjithë ekonomisë sonë dhe veçanërisht të ekonomisë bujqësore, vëllimi i madh i ndërtimeve industriale dhe sidomos ritmi shumë i shpejtuar për t'u kryer këto ndërtime në një periudhë të shkurtër, e kanë dëmtuar fshatin dhe e kanë varfëruar bujqësinë në drejtim të krahëve të punës dhe të shumë nevojave të tjera. Forca pune nga bujqësia janë tërhequr edhe në aparatet shtetëror, organikat e të cilit kanë qenë shumë të fryra.

Ndihma e shtetit me mjete të mekanizuara, për të plotësuar boshllëkun e madh që është krijuar në bujqësi, nga mungesa e krahëve të punës dhe e kafshëve tërheqëse në fshat ka qenë e paktë. Numri i traktorëve, i maqinave, i plugjeve etj., që janë vënë në dispozicion të fshatarësisë është krejt i pamjaftueshëm për punimet, mbjelljet, prashitjet, korrjet, shirjet etj. Kështu p.sh. nga gjithë sipërfaqja e punueshme në Republikë, me traktorët e SMT-ve dhe të NBSH-ve janë kryer vetëm 12,8 për qind të të gjithë punimeve; shumë i ulët është mekanizimi i korrjes, punë që tërheq shumë krahë pune të fshatarësisë. Sivjet vetëm 3,7 për qind e sipërfaqes së të lashtave janë korrur me maqina e autokombajna. Por, me gjithë numrin e paktë të maqinave bujqësore dhe të traktorëve, për dobësitë tona ata nuk mirëmbahen dhe nuk shfrytëzohen mirë. Ka dëmtime dhe avari të shumta; gjithashtu në planifikimin e punimeve me traktorë e maqina nuk janë llogaritur gjithnjë drejt mjetet e punës, që disponojnë vetë ekonomitë bujqësore e sidomos kooperativat.

Në dobësimin e ekonomisë fshatare ka influencuar

edhe sistemi i tatimit në natyrë. Sistemi i tatimit në natyrë, i vënë në veprim menjëherë pas Kongresit I të Partisë shërbeu si një nxitës për shtimin e sipërfaqeve të punueshme nga fshatarësia dhe për rritjen e rendimenteve. Por, me gjithë drejtësinë e këtij sistemi, koeficienti i dorëzimit të detyruar për ha. ka qenë i lartë. Tatimi në natyrë në vitet e thatësisër së madhe e ka rënduar më shumë fshatarin, pasi ai nuk ka realizuar rendimentet e parashikuara dhe kështu përqindja e tatimit në natyrë që ne i kemi kërkuar është rritur shumë. Kështu p.sh. në bazë të prodhimeve të realizuara në vitin 1946 ne i kemi marrë si detyrim mesatarisht 16,9 për qind të prodhimit, në vitin 1949 ne i kemi marrë 21,6 për qind, më 1950 — 22 për qind dhe në vitin 1952 i kemi marrë mesatarisht 20,1 për qind të prodhimit. Por këto shifra mesatare për Republikën nuk janë të njëjta për të gjitha zonat dhe ekonomitë bujqësore, pse dhe rendimentet e tyre kanë qenë të ndryshme, kështu që ka pasur raste që në disa zona dhe ekonomi bujqësore përqindja e tatimit e sidomos për misrin të arrijë edhe deri 40-50 për qind të prodhimit. Vetëm në vitin 1953, që ka qenë një vit i mbarë bujqësor, që ka pasur rendimente të mira dhe me uljen e koeficienteve të tatimit në natyrë ne i kemi marrë fshatarit mesatarisht 13 për qind të prodhimit. Nga mosarritja e rendimenteve të parashikuara, që ka sjellë si pasojë marrjen e një prodhimi të paktë në drithëra si dhe nga detyrimet në natyrë pak fshatarëve u kanë tepruar drithëra për në treg dhe këto në sasi të vogla; kështu në vitin 1949 fshatarësisë i kanë tepruar mesa-

tarisht 221 400 kv. për në treg, ndërsa në vitin 1950 u ul në 133 700 kv. dhe më 1952 i kanë tepruar vetëm rreth 86 000 kv. drithë për në treg. Kjo sasi minimale tepricash, që zakonisht nuk ka dalë e tëra në treg, pse dhe atyre që u ka tepruar diçka, e kanë përdorur vetë ose brenda fshatit, nuk mund t'i jepte mundësi fshatarit të blinte sendet e nevojshme për jetesën e tij. Edhe të ardhurat e tjera që duhet të ketë fshatari si nga rritja e derrave, e shpendëve, e bletëve, e frutave dhe nga aktivitetet e tjera ndihmëse, veç bujqësisë e blegtorisë, kanë qenë të pakta. Kështu megjithëse derri është shtuar pas çlirimit, në vitin 1950 rezulton se kanë pasur dosa vetëm 3,6 për qind e gjithë ekonomive bujqësore, ndërsa shpendë, në vitin 1952 kemi pasur vetëm 66,9 për qind në krahasim me paraluftën dhe këto u pakësuan shumë nga thatësira për mungesë ushqimesh si dhe nga sëmundjet epidemike, të cilat nuk janë luftuar sa duhet. Bletë, në vitin 1952 kishim 16,7 për qind më shumë se në 1938, por numri i zgjojve të bletëve më 1952 është 21,1 për qind më pak se më 1950. Mund të bëhej shumë më tepër për shtimin e numrit të bletëve dhe për shtimin e prodhimit të mjaltit, por kujdesi për to, sidomos për modernizimin e zhvillimit të tyre ka qenë i paktë. Sot kemi vetëm 30 për qind të bletëve me zgjoj modernë. Zgjojtë e prodhuar nga industria dhe nga artizanati kanë dalë me një kosto mjaft të lartë dhe me një cilësi shumë të dobët. Përsa u përket aktivitetëve ndihmëse në fshat, që luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e konditave materiale të fshatarësisë dhe që do të ndihmojnë shumë në shtimin e mallrave të konsumit të

nevojshëm për tregun, sot ato pothuajse nuk zhvillohen në fshatin tonë. Megjithëse për këtë prodhim mungojnë krejt të dhënat, pse deri sot asnjë institucion nuk e ka trajtuar, nga disa të dhëna që kemi mbledhur në disa rrethe, del e qartë gjendja e përgjithshme, nga e cila mund të nxjerrim edhe shkaqet e kësaj gjendjeje. Artizanati shtëpiak në mjaft rrethe të vendit tonë ka qenë mjaft i zhvilluar dhe prej tij fshatari nxirrte të ardhura për vete dhe ndihmonte me mjete materiale e vegla pjesën tjetër të fshatarësisë ose dhe qytetin për disa artikuj. Nga të dhënat e pakta që kemi mbledhur në rrethin e Kavajës, të Lushnjës dhe të Krujës del se në shumë fshatra të këtyre rretheve familje të tëra merreshin me prodhim qymyri, tullash, tjegullash, gëlqereje, rrogozesh, me punimin e lirit, punime qerresh etj. Punime të tilla kishte edhe në rrethet e tjera, por që tashti nga frika e tatimeve të rënda financiare, nga frika se mos i mobilizojë shteti si specialistë dhe në disa raste nga mungesa e lëndës së parë, i kanë braktisur fare këto lloje prodhimesh.

Nga sa parashtruar më lart del qartë se gjendja ekonomike e fshatarësisë është mjaft e vështirë, sepse prodhimet bujqësore dhe blegtorale janë të pamjaftueshme si për vetë fshatarësinë, ashtu dhe për punonjësit e tjerë të qyteteve dhe të qendrave të punës, nevojat e të cilëve për prodhimet bujqësore e blegtorale janë shtuar shumë në krahasim me rritjen e paktë të prodhimit bujqësor.

II. — GJENDJA EKONOMIKE E KLASËS PUNËTORE DHE E MASAVE PUNONJËSE

1. — Gjendja e furnizimit të popullatës së qyteteve, të qendrave të punës dhe të fshatit

Popullsia e qyteteve si në vitet e mëparshme ashtu edhe gjatë këtij viti, nuk është furnizuar me sasi të caktuara të artikujve ushqimorë dhe industrialë të garantuar. Normat e caktuara sipas triskave nuk i janë plotësuar popullit në të gjithë artikujt, duke u vënë kështu në dyshim nga populli vlera e triskës, e cila në fakt përbën një bazë për normalizimin e jetesës.

Planet e furnizimit të garantuar të popullatës së qyteteve në mjaft artikuj me rëndësi nuk janë realizuar pothuajse në të gjitha vitet. Më e ndieshme është kjo në artikujt si mishi, peshku, fasulet, vezët, orizi dhe djathi.

Për furnizimin e punëtorëve në qendrat e punës, me kujdesin e veçantë të Partisë e të qeverisë ka pasur një përmirësim në krahasim me të kaluarën, por megjithatë, në shumicën e rasteve nuk janë plotësuar qind për qind artikujt e garantuar ushqimorë dhe industrialë; p.sh. plani nëntëmujor i këtij viti i furnizimit me mish dhe me peshk është realizuar 85,9 për qind, me fasule e oriz 90,8 për qind, me yndyrna 95,4 për qind, me makarona 94 për qind, me të leshta 46 për qind etj.

Mosrealizimi i planeve të furnizimit të qyteteve dhe të qendrave të punës me artikuj të garantuar ush-

qimorë e industrialë, të cilët sigurojnë një minimum, ka bërë që popullit t'i vështirësohet edhe më shumë gjendja ekonomike. Është për t'u shënuar se vëllimi i mallrave të konsumit të gjerë të këtyre viteve rezulton se nuk i përgjigjet mbulimit të fuqisë blerëse të masave punonjëse të qytetit dhe të fshatit dhe veç kësaj nuk siguron një përmirësim të dukshëm të ngritjes së nivelit material të popullit. Në radhë të parë racionet e garantuara në fuqi të punëtorit nuk janë të mjaftueshme dhe nuk plotësojnë kaloritë e domosdoshme për rritjen e rendimentit në punë. Kështu p.sh. një punëtori miniere, që punon në nëntokë, i kategorisë «A» në vend të 6 mijë kalorive në ditë që ka nevojë, me racionet në fuqi, dhe kur i merr të plota, i sigurohen rreth 3 200 kalori baras me 53 për qind. Ky proporcion vërtetohet në të gjitha kategoritë e tjera të punëtorëve dhe sikurse shihet janë shumë të pakta në krahasim me nevojën. Normat e pamjaftueshme të furnizimit të punëtorëve, rritja e numrit të tyre me një ritëm të shpejtë, si dhe të metat e organeve që merren me furnizimin e punëtorëve, kanë shkaktuar që trajtimi i tyre të ketë shumë të meta, sidomos në minierat dhe në industrinë e sharrave dhe si rrjedhim këto të meta influencojnë në fluktuacionin e fuqisë punëtore si dhe në mosrealizimin e planit.

Gjithashtu mallrat e garantuara që shteti u jep punonjësve të qytetit mbulojnë vetëm një pjesë të fuqisë blerëse të tyre, ndërsa për pjesën tjetër, për të siguruar jetesën drejtohen në tregun e lirë.

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se në përgjithësi familjet e punonjësve në qytet sigurojnë me

vështirësi të mëdha nevojat e përditshme të jetesës së tyre dhe e vështirë paraqitet kjo gjendje në ato kategori punonjësish, të ardhurat e të cilëve janë nën 5 000 lekë. Këto familje një pjesë të deficitit e mbulojnë duke siguruar ndonjë të ardhur që nuk mund të llogaritet këtu.

Gjendja e tregut të lirë

Sasitë e mallrave që janë hedhur në tregun e lirë, të artikujve ushqimorë dhe industrialë, kanë qenë të pakta lidhur me nevojat që ka populli, pasi tregu i garantuar siguron një minimum të nevojave.

Gjendja e tregut të brendshëm paraqitet mjaft e dobët, dyqanet më të shumtën e kohës kanë mungesa të mëdha si në prodhimet e vendit, ashtu dhe në mallrat e importit. Fondet e mallrave në tregun e lirë shtetëror janë mjaft të kufizuara dhe të tilla që nuk sigurojnë një furnizim të mjaftueshëm të popullit në mënyrë që të bëhen faktorë rregullues të çmimeve të prodhimeve bujqësore e blegtorale që hidhen në treg nga sektori privat. Disa mallra të nevojës së parë për qytetin e fshatin janë zhdukur krejtësisht nga tregu si p.sh. veglat e imta për fshatarësinë (sqeparë, drapinj, kosa, sharra, dara, gërshërë të ndryshme, bojra leshi etj.). Veç këtyre edhe disa artikuj që ekzistojnë në treg janë fare të pamjaftueshëm. Kërkesa të mëdha paraqiten nga popullata për enë alumini, llamarinë të galvanizuar, poçeri, qelqurina, material ndërtimi, si gozhdë, xham, litar, spango etj.

Tregu privat, i cili duhej të bëhej një ndihmës i sektorit shtetëror për furnizimin me mallra konsumi, ka shkuar drejt likuidimit nga masat e ndryshme administrative që janë marrë. Këto masa administrative si urdhëresa Nr. 35 e Këshillit të Ministrave¹, tatimi i rëndë dhe tarifa e rëndë e patentës nuk pajtoheshin me ato që përcaktoi Kongresi I i PKSH, për tregëtinë private «... përforsimi i kontrollit mbi tregëtinë private, në mënyrë që kjo të bëhet një ndihmëse e sektorëve shtetërorë e kooperativistë»². Urdhëresa Nr. 35 nuk lejoi që sektori privat të bëhet një ndihmës i sektorit shtetëror dhe kooperativist, por ka luajtur një rol negativ në furnizimin e masave punonjëse. Kjo doli para kohe dhe nuk i përgjigjej situatës së vendit tonë, pasi nuk u muar parasysh se tregëtia shtetërore dhe kooperativiste nuk është akoma në gjendje të përballojë në mënyrë të plotë qarkullimin e mallrave që po vjen duke u shtuar dita-ditës në të gjithë vendin tonë.

2. — Si paraqitet furnizimi dhe konsumi me disa artikuj kryesorë

Lidhur me furnizimin e popullit është e nevojshme që të trajtojmë disa probleme të veçanta:

¹ Kjo urdhëresë e Këshillit të Ministrave doli më 29 dhjetor 1951 dhe disa nene të saj u ndryshuan me urdhëresën Nr. 9 datë 5 shtator 1953.

² «Dokumenta Kryesore të PPSH» Vëll. I, bot. i dytë, f. 565.

a) Në konsumin e bukës nga njëri vit në tjetrin kemi një rritje të shpejtë të konsumit të fondit shtetëror të drithërave. Rritja e shpërndarjes së drithërave nga ana e organeve të grumbullimit për vitet e fundit paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	Njësi matjeje				
		1948	1949	1950	1951	1953
	Gjithsejt shpërndarja e bereqetit:	kv. 608 790	705 423	757 242	1 016 891	1 081 917
	e nga kjo për bukë	» —	—	—	754 731	748 437
a)	Tregu i garantuar	» —	—	—	694 019	709 800
b)	Tregu i lirë	» —	—	—	23 148	20 203
c)	Ushqime sociale	» —	—	—	18 218	18 349
d)	Entet	» —	—	—	19 346	10 079
	Bereqeti i fshatarësisë	» —	228 000	265 700	262 160	333 480
a)	Stimulacion reciprok	» —	120 000	148 000	145 120	218 480
b)	Pa shkëmbim	» —	108 000	117 700	117 040	115 000

Shkaqet e një rritjeje kaq të madhe të konsumit të bukës kanë ardhur nga disa faktorë siç janë: rritja e madhe e popullsisë në qytetet dhe në qendrat e punës, (aktualisht shteti furnizon 350 000 frymë të garantuar

me bukë dhe me ushqime të tjera të garantuara); tërheqja e shumë punonjësve nga fshati për ndërtimet e mëdha, (shteti ka qenë i shtërnguar të furnizojë me vite edhe familjet e tyre në fshat); rritja e shpërndarjes së bereqetit për prodaktorët e bimëve industriale; furnizimi i fshatarësisë me këmbim; pamjaftueshmëria e zarzavateve sidomos e patateve; rritja e konsumit të miellit në punimet e ëmbëlsirave; mungesa e mishit, e peshkut, e orizit, e fasuleve dhe sidomos pamjaftueshmëria e yndyrnave në treg. Gjithashtu ka munguar kontrolli mbi shpërndarjen e bukës nga entet që merren me këtë detyrë. Përpara një rritjeje kaq të shpejtë në konsumin e bukës nga fondi shtetëror, burimet e brendshme për shtimin kanë qëndruar po ato dhe rruga e zgjidhjes së imponuar ka qenë importi. Në vitin 1952 kemi importuar 59 200 ton bereqet, në 9-mujorin e këtij viti 55 900 ton, sasira këto me vlerë kolosale në valutë që rëndojnë së tepërmi në bilancin e tregëtisë së jashtme duke përfaqësuar buka gati 45 për qind të eksportit. Edhe për vitin 1954 me gjithë shtërngimin e bilancit të bukës prapë në planin e importit janë 33 000 ton bereqet.

Siç shihet, çështja e bilancit të bukës mbetet për ne një problem me shumë rëndësi dhe që duhet të zgjidhet në planet tona të ardhshme të prodhimit të drithit.

b) Për vitin 1953 në kreu të Republikës llogaritet prodhimi i zarzavateve dhe i patateve së bashku në 98 200 ton. kurse ndarë: në zarzavate 74 800 ton dhe në patate 23 400 ton që i takon mesatarisht çdo fryme nga 260 gram në ditë, ndarë nga 212 gram zarzavate dhe

48 gram patate. Kjo normativë është e vogël dhe tregon përdorimin e paktë të zarzavateve dhe të patateve nga populli ynë, përhapjen e paktë të zarzavateve bazë, si lakra, spinaqi, preshi etj. Në konsumin e paktë të zarzavateve dhe të patateve ndikon dhe mungesa e konservimit të tyre. Në sezonet joprodhuese, në vendet e ndryshme të punës ku ka grumbull punëtorësh, konsumi i zarzavateve është krejt minimal për mungesën e konservimit dhe të zgjerimit të prodhimit të zarzavateve në çdo vend. Rrjeti i punishteve dhe i depove të organizatave tregëtare për konservimin e zarzavateve është i pamjaftueshëm dhe i dobët.

Prandaj Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve dhe Ministria e Tregëtisë dhe e Komunikacioneve duhet të marrin masat që të shtohet prodhimi i zarzavateve e i patateve dhe konsumi i tyre, në mënyrë që të arrihet sa më parë një furnizim i kënaqshëm me këta artikuj të nevojës së parë.

c) Sigurimi i mishit dhe i peshkut përbën një problem shumë të rëndësishëm. Mungesa e tyre është ndierë shumë në treg. Nevojat janë rritur shumë dhe burimet për mishin kanë shkuar duke u ulur, ndërsa plani i peshkimit nuk është realizuar.

Shifrat tregojnë se konsumi për frymë gjatë këtij viti është ulur në krahasim me dy vitet e mëparshme. Peshku përbën një burim të mirë në lidhje me sigurimin e ushqimit të popullit dhe zëvendëson mirë mishin, por peshkimi nuk u është përgjegjur kërkesave të popullit; edhe sasitë e realizuara në një pjesë të mirë nuk janë shpërndarë në rregull, janë konsumuar më shumë në vendet e peshkimit dhe kjo për mungesë të

mjeteve të shpejta lëvizëse dhe të bazave teknike materiale krejt të pamjaftueshme të tregëtisë, për mirëmbajtjen, për konservimin dhe për shitjen e peshkut. Burim i madh i sigurtë dhe i shpejtë në lidhje me plotësimin e nevojave me mish është rritja e derrit, e shpendëve dhe sidomos rritja e patateve dhe e gjelave të detit, të cilët janë zhvilluar shumë pak.

Për këtë është e nevojshme që të merren masa të shpejta nga Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve në bashkëpunim me Komisionin e Planit që të hartojnë një plan ku të caktohet numri (derra, pula, pata etj.), që do të rritin ndërmarrjet që varen nga Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve dhe çdo dikaster në ekonomitë ndihmëse, si dhe investimet minimale të nevojshme për këtë gjë. Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit dhe Bashkimi Qendror i Kooperativave, të marrin masa për një zhvillim të gjithanshëm të peshkimit në det, bregdet dhe në ujërat e brendshme. Të ndihmohen më tepër kooperativat e peshkatarëve dhe peshkatarët individualë me mjete dhe me materiale peshkimi si penjë, litarë etj., për një zhvillim më të gjerë të peshkimit në të gjitha ujërat.

d) Furnizimi i popullatës së qytetit me tekstile të pambukta ka pasur përmirësime që nga viti 1949 e kështu. Në fakt gjatë këtyre viteve furnizimi për frymë është realizuar si vijon:

	1949	1950	1951	1952	1953
ml. për frymë	9,76	8,10	9,78	6,23	12,21

Megjithëse shënohet një përmirësim i mirë për

furnizimin me tekstile, sasitë e furnizuara nuk kanë plotësuar nevojat e popullit.

Jo e mirë paraqitet gjendja në tekstilet e leshta, furnizimi i të cilave është krejt i pamjaftueshëm. Furnizimi për frymë paraqitet si vijon:

	1949	1950	1951	1952	1953
ml. për frymë	0,48	0,84	0,35	0,63	0,39

Shkurtimi i importimeve dhe për konsekuencë mosfurnizimi i popullit me stofa leshti ka bërë që populli të shpenzojë pothuajse të gjitha rezervat familjare, që përfaqësojnë një fond të konsiderueshëm. Mosfurnizimi me tekstile të leshta, veçanërisht në këto dy vitet e fundit, ka bërë që të ketë mungesa shumë të mëdha.

Mungesa e këpucëve në treg, sidomos gjatë këtij viti, është bërë shumë e ndieshme. Sipas planit të vitit 1953, çdo punonjësi të garantuar në qytet i përket të marrë këpucë, sandale, opinga 1,1 palë në vit, por dhe kjo sasi nuk është realizuar. Nevojat për këpucë në qendrat e punës janë veçanërisht të mëdha. Ka qytete që s'kanë marrë këpucë prej 5-6 muajsh siç janë Qyteti «Stalin», Elbasani etj. Perspektivat për sigurimin në mënyrë të kënaqshme të tekstileve të pambukta për popullin janë të mira, por duhet që Kombinati i tekstileve «Stalin» të marrë masa për përmirësimin e asortimenteve në basma, në prodhimin e dokut për veshje të punëtorëve, në një situatë ku mungesa e tekstileve të leshta është e ndieshme. Të merren masa nga organet e planifikimit dhe të industrisë për sigurimin

e këpucëve që është problem preokupant për qytetet dhe qendrat e punës.

ç) Furnizimi i popullatës me yndyrna dhe bulmetra si në tregun e garantuar ashtu dhe në tregun e lirë nga ana e organeve të tregëtisë ka qenë i dobët; ka munguar sidomos gjalpi, djathi, gjiza.

Prodhimi i vajit nuk është i mjaftueshëm që të plotësojë çdo vit nevojat e furnizimit të popullatës, pasi ka pasur vite jo të mbara për ullinj të, megjithë që prodhimi mesatar vjetor për çdo rrënjë, për disa vjet ka qenë mbi prodhimin e paraluftës. Prodhimi i vajit ka mundësi të shtohet edhe më tepër, në qoftë se do t'u sigurohet kultivuesve të ullinjve një stimul më i mirë dhe po të jepet një ndihmë e madhe në plehra kimike dhe insekticide. Gjithashtu për sigurimin e yndyrës së nevojshme për popullin duhet të rritet në tregun e lirë grumbullimi i gjalpit, i vajit, i dhjamt të dërrit.

d) Po e njëjta gjendje në mungesën e mallrave, akoma më e theksuar paraqitet në furnizimin e popullatës fshatare me artikuj industrialë. Mallrat kryesore që i kemi dhënë sivjet fshatit për frymë janë: tekstile të pambukta 4,55 m., opinga 0,31 palë, sheqer 2,5 kg., sapun 0,64 kg., vajguri 1,45 litra, enë kuzhine 0,2 kg., gozhdë 0,2 kg., litar 0,05 kg. etj. Përsa u përket veglave bujqësore si shata, lopata, plugje, sharra etj., kanë qenë në sasi të pamjaftueshme. Kështu në 4 vitet 1949-1952 janë shitur plugje aq sa të plotësojnë furnizimin me nga një plug të 5 ose 6 për qind të ekonomive bujqësore në Republikë dhe lesa e kultivatorë po brenda këtyre 4 viteve janë shpërndarë aq sa të marrin nga 1 kultivator

1,5 për qind e ekonomive bujqësore dhe nga 1 lesë 1 për qind e ekonomive. Këto sasi janë mesatare globale për të gjithë popullatën fshatare. Përsa u përket materialeve të ndërtimit si çimento, xhame, qereste etj. gati kanë munguar fare për fshatin.

Gjendja e strehimit të punonjësve

Gjendja e strehimit të punonjësve në qytete dhe veçanërisht në disa qendra të rëndësishme prodhimi është e vështirë. Kjo ndodh për arsye se ritmi i ndërtimit nuk u është përgjegjur nevojave gjithnjë më të mëdha për banesa dhe në mirëmbajtjen e ndërtesave ekzistuese ka pakujdesi të theksuara. Pas çlirimit dhe sidomos në vitet e fundit, në saje të ndryshimeve të mëdha ekonomike dhe shoqërore në vendin tonë janë rritur shumë nevojat për strehim.

Partia dhe qeveria qysh në fillim kanë marrë masa për përmirësimin e konditave të jetesës së punonjësve dhe të strehimit, kështu që gjatë këtyre 7 viteve të fundit 1947-1953 për ndërtesa banimi janë investuar 1 375 milion lekë dhe janë ndërtuar rreth 339 000 m² sipërfaqe e banueshme. Vetëm gjatë vitit 1953 nga komitetet ekzekutive për ndërtesa banimi në qytete janë investuar 180.8 milion lekë dhe parashikohen të ngrihen 40 167 m² sipërfaqe e banueshme.

Por masat e marrura janë të pamjaftueshme për të përballuar nevojat e popullatës në banesa sidomos është bërë fare pak për disa qendra të mëdha prodhimi. Cilësia e ndërtesave në mjaft qendra pune nuk ka qenë

e mirë. Përveç kësaj duhet thënë se ka ndodhur që në këto qytete edhe një pjesë e godinave të ndërtuara për banesa është përdorur për qëllime të tjera. Gjithashtu nga viti në vit një numër i konsiderueshëm banesash, nga mungesa e mirëmbajtjes dhe e mosmeremetimit të tyre kanë dalë jashtë përdorimit. Çështjes së mirëmbajtjes dhe të meremetimit të ndërtesave ekzistuese, që do të lehtësonte shumë strehimin, nuk i është kushtuar kujdes.

Në mjaft qendra pune, sidomos në minierat (Kërrabë, Memaliaj, Patos etj.) dhe në shumë qytete nuk ekziston pastërtia e duhur, mungon rregulli, ka dëmtime të pajisjeve. Drejtuesit e ndërmarrjeve, organizatat profesionale dhe organizatat e Partisë nuk kanë treguar kujdesin e duhur në këtë drejtim me qëllim që të përmirësonin konditat e trajtimit të punonjësve. Të gjitha këto e kanë vështirësuar tepër zgjidhjen e problemit të strehimit.

Urdhëresa e qeverisë mbi akordimin e huave me afat të gjatë punëtorëve dhe nëpunësve për ndërtimin e banesave individuale nuk është vënë në jetë pothuajse fare. Nuk janë krijuar mundësitë praktike nga organet shtetërore, për t'u krijuar punëtorëve dhe nëpunësve mundësitë për të shfrytëzuar favorizimet që u ka dhënë në këtë drejtim Partia dhe qeveria. Kështu gjatë këtyre 4 viteve janë tërhequr nga ana e punëtorëve dhe e nëpunësve për ndërtim banesash individuale vetëm 1.2 milion lekë kredi.

III. — ARËSYET KRYESORE QË KANË SHKAKTUAR GJENDJEN E VËSHTIRË EKONOMIKE TË FSHATARËSISË DHE TË TË GJITHË PUNONJËSVE

1. — Gabimet në ritmin dhe në proporcionet e zhvillimit të degëve të ekonomisë popullore

Nga analiza që ka bërë Byroja Politike del qartë se në planifikimin tonë ka pasur gabime serioze. Këto plane anonin mjaft nga dëshira, nuk janë shikuar sa duhet proporcionet e investimeve në mes të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë dhe në bazë të nevojave urgjente dhe të mundësive të brendshme. Kreditet që na janë akorduar nga Bashkimi Sovjetik në radhë të parë dhe nga demokracitë popullore, nga një mosstudim serioz nga ana jonë, janë kërkuar në disa raste për ngritje objektivsh industriale që në parim janë të drejta, por që mund të bënim edhe pa to për një periudhë, pse kanë qenë të kushtueshme për ne. Nga kjo del qartë interesimi ynë i pamjaftueshëm për sektorin e bujqësisë. Do të ishte më e drejtë që ne, një pjesë të konsiderueshme të kredive të akorduara t'i investonim në bujqësi dhe të zhvillohej kjo në harmoni me industrinë tonë. Kjo çështje nuk është parë drejt dhe ndërtimet e mëdha të kryera në një periudhë kohe të shkurtër kanë dobësuar fshatin dhe bujqësinë e kanë varfëruar në drejtim të krahëve të punës dhe të shumë nevojave të tjera. Ne kemi ndërtuar Kombinatin e tekstileve «Stalin», fabri-

kën e sheqerit, Hidrocentralin «Lenin», kombinatin e drurit, uzinat e zhveshjes së pambukut dhe një sërë objektesh të tjera me një rëndësi shumë të madhe dhe të domosdoshme për vendin tonë. Këto kanë dhënë frutet e para dhe e kanë shpëtuar popullin nga mungesa e këtyre prodhimeve. Por, përsa i përket një sërë fabrikash të tjera, ne kemi shpejtuar ritmin e ndërtimit të tyre dhe këtë ritëm nuk e kemi harmonizuar me zhvillimin e sektorëve të tjerë, sidomos të bujqësisë. Për një sërë fabrikash të tjera, ne mund të bënim edhe pa to për një periudhë. Prodhimet bujqësore nuk kanë mundur të plotësojnë me lëndë të parë industrinë ekzistuese dhe as nevojat me prodhime bujqësore për klasën punëtore që po shtohet si dhe për gjithë popullsinë. Ndërtimet e mëdha industriale na kanë bërë të neglizhojmë furnizimin e fshatit me shumë prodhime industriale, si lëndë druri, gozhdë, prodhime të fabrikuara etj. Ngritja e këtyre veprave industriale na ka kushtuar duke rënduar ekonominë tonë edhe për arësye të organizimit të dobët të punës dhe të llogarive jockzakte të preventiveve.

Kështu në analizën që i kemi bërë planit pesëvjeçar dalin këto gabime:

a) Investimet për zhvillimin e bujqësisë janë shumë të vogla në krahasim me ato të industrisë. Kështu nga 14 330 milion lekë që janë investuar për ndërtime, për industri-minierat investohen 5 051 milion, ndërsa për bujqësinë 2 534 milion; duhet të shtojmë se në këto investime nuk hyjnë maqineritë, kërkimet, studimet, pajisjet etj.

b) Vëllimi i ndërtimeve për t'u kryer brenda pesëvjeçarit është shumë i madh dhe faktet tregojnë se

me gjithë përpjekjet e mëdha që janë bërë brenda këtyre tri viteve, ne kemi realizuar si 3-vjeçar vetëm 88,2 për qind. Duhet të përmendim këtu se nga mungesa e projekteve, për të realizuar objektet që parashikon pesëvjeçari, nevojitet një vëllim ndërtimi edhe më i madh nga 14 miliard lekë që parashikonte pesëvjeçari. Kështu p.sh. për rafinerinë e naftës nga 680 milion lekë që ishin parashikuar, nevojiten për t'u përfunduar 900 milion, fabrika e çimentos nga 200 në 300 milion, hidrocentrali mbi lumin e Matit¹ nga 800 milion kërkon 1 miliard e 500 milion lekë etj.

c) Disa objekte që janë ngritur, pa prishur shumë punë, mund të ndërtoheshin më vonë. P.sh. në vitet 1951 dhe 1952 kemi ngritur dy fabrika për zhveshjen e pambukut me nga 10 500 ton kapacitet secila, ndërsa nevojat e sotme janë të atilla që përballohen vetëm nga njëra; ose fabrika e orizit, e cila u ndërtua në vitin 1952, mund të ngrihej më vonë, pasi fabrika ekzistuese në Durrës plotësonte nevojat e zhveshjes së orizit që ne sot grumbullojmë; kinostudioja që u ndërtua në vitin 1951 dhe që kostoi 100 milion lekë, mund të ndërtohej në një kohë të mëvonshme pa prishur shumë punë, po ashtu hekurudha e projektuar në Jug të Shqipërisë, vepër kjo që nuk është filluar së ndërtuari etj.

ç) Ritmi i caktuar për mbarimin e disa objekteve të mëdha jo vetëm ishte i papërbalueshëm në konditat tona, por dhe leverdia e shpejtimit të mbarimit të tyre nuk është e domosdoshme sot për sot. P.sh. ritmi i caktuar për mbarimin e hidrocentralit të Matit, jo vetëm

¹ Ky hidrocentral mori emrin «Karl Marks».

nuk përballohet dot me forca e mjete, por edhe leverdisshmëria e prodhimit të energjisë elektrike që do të marrim nga ai, nuk është urgjente për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë sonë, pse gati të gjitha fabrikat tona të reja, furnizohen në një mënyrë të kënaqshme me energji elektrike nga TEC-et, me të cilat ato janë pajisur etj.

d) Numri i madh i punëtorëve në një mesatare vjetore prej gati 26 000 vetë në vit për nevojat e investimeve, sasitë e mëdha të lëndës së parë për ndërtime, ushqimet dhe veshmbathjet e punëtorëve dhe të familjeve të tyre kanë pakësuar mallrat e konsumit të gjerë për tregun, është rritur gjithashtu qarkullimi i monedhës dhe janë pakësuar forcat e nevojshme për bujqësinë.

Për këto gabime serioze ka përgjegjësi Byroja Politike dhe qeveria, por duhet theksuar se organet tona të planifikimit dhe shokët që kanë drejtuar këta sektorë kanë një përgjegjësi të madhe, pse shumë pak e kanë ndihmuar Byronë Politike dhe qeverinë me studimet e nevojshme për të ndrequr me kohë gabimet.

2. — Dobësitë e punës së Partisë dhe të pushtetit, si në bujqësi, në industri dhe në të gjithë sektorët e tjerë janë të shumta

Në zbatimin e planeve dhe në drejtimin e punëve është e theksuar mungesa e disiplinës, e vigjilencës. Njerëzit nuk mobilizohen sa duhet dhe ndërgjegjja socialiste në punë lë shumë për të dëshiruar. Në bujqë-

sinë tonë lufta për një agroteknikë më të përparuar, për të dalë nga prapambetja nuk bëhet sa duhet. Nuk bëhen mirë punimet për mbjelljen e bimëve dhe sidomos çalon shumë kryerja e shërbimeve të nevojshme për rritjen e rendimenteve.

Të shumta janë dobësitë në sektorin e industrisë, të artizanatit, të minierave, të tregëtisë, të transportit dhe të kooperativave. Realizimi i planit të prodhimit në sektorin e industrisë, sidomos gjatë vitit 1951 dhe 1952, nuk ka qenë i mirë; në disa artikuj plani në sasi dhe asortiment është realizuar në përqindje të vogël. Po kështu gjatë 10 muajve të vitit 1953 plani i prodhimit në industrinë nacionale, industrinë lokale dhe në artizanat paraqitet dobët në sasi dhe në asortiment dhe sidomos më dobët paraqitet industria nacionale, ku në mjaft artikuj kryesorë dhe të nevojshëm shumë për konsumin e gjerë plani i prodhimit është realizuar në një përqindje të vogël; në industrinë ushqimore p.sh. plani në vaj ulliri është realizuar 41,1 për qind si dhjetëmujor dhe kundrejt vjetorit 20 për qind, peshku 74,9 për qind si dhjetëmujor dhe kundrejt vjetorit 57,3 për qind, sapun rrobash 87,5 për qind si dhjetëmujor kundrejt vjetorit 70,1 për qind dhe në këpucë 90 për qind si dhjetëmujor dhe kundrejt vjetorit 72,6 për qind, në tekstilet e pambukta 90 për qind si dhjetëmujor dhe kundrejt vjetorit 84 për qind. Gjithashtu dobët paraqitet realizimi i planit për industrinë e material-ndërtimit si p.sh. në çimento plani si dhjetëmujor i vitit 1953 është realizuar 66,9 për qind dhe kundrejt vjetorit 54,9 për qind, trupa 68,3 për qind si dhjetëmujor dhe kundrejt vjetorit 56 për qind dhe lënda e sharruar 88,5 për

qind si dhjetëmuor dhe kundrejt vjetorit 71,7 për qind.

Nga mosrealizimi i planit të prodhimit në sasi dhe në asortiment ka ardhur që populli të furnizohet në mënyrë të pakënaqshme duke ja dhënë ushqimet me vonesë të madhe dhe disa artikuj të konsumit të gjerë të nevojshëm, sidomos për fshatin, nuk janë prodhuar ose janë prodhuar në sasi fare të vogla.

Në disa artikuj nuk është realizuar plani i prodhimit si sheqeri, vaji i ullirit etj., për arsye se ka munguar lënda e parë, për të cilën këtu ka përgjegjësi të madhe Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve, kurse për artikuj të tjerë si makarona, peshk, çimento, lëndë e drurit etj., kryesisht nga dobësitë që ekzistojnë në punë në ndërmarrjet industriale dhe nga ndihma e kontrolli i përciptë në bazë të komiteteve të Partisë në qark dhe sidomos në Ministrinë e Industrisë e të Ndërtimit.

Përveç mosrealizimit të planit të prodhimit, në industri, në industrinë lokale dhe në artizanat, në furnizimin e keq të masave punonjëse kanë influencuar negativisht edhe disa të meta të tjera që vërehen në punën e këtyre sektorëve.

Asortimentet e cilësia e prodhimit paraqiten të pakënaqshme. Në industri paraqiten dobët cilësia dhe asortimenti i makaronave, i sapunit, i artikujve të gomës, i cigareve, i këpucëve, i peshqirëve etj. Janë prodhuar makarona me aciditet të lartë dhe si rrjedhim janë bllokuar dhjetëra ton, sapuni është prodhuar me më pak vaj dhe duke i futur edhe kretë¹ që ka dëmtuar

¹ Lloj silici.

cilësinë. Artizanati vazhdon të prodhojë me cilësi shumë të dobët veglat prej hekuri, konfeksionet e tekstilit e të tjerë artikuj sidomos për fshatin. Po kështu industria lokale prodhon me cilësi të dobët ëmbëlsirat, mobiljet e orenditë, artikujt e vegjël të konsumit të gjerë si kre-hëret, kapsat etj. Lufta për zgjerimin e asortimenteve të prodhimit nga ana e organeve prodhuese është shumë e dobët.

Burimi i kësaj dobësie është se, si në bazë ashtu edhe në qendër, luftohet më shumë për sasinë se sa për cilësinë e prodhimit.

Në mjaft raste nuk punohet sipas teknologjisë së caktuar dhe kjo shkelet që me marrjen e lëndës së parë në dorëzim. Çështja e cilësisë nuk është bërë sa duhet çështje e gjithë kolektivit. Kontrolli mbi respektimin e standardeve shtetërore nga ana e organeve qendrore ka qenë shumë i dobët. Për këtë një përgjegjësi të veçantë kanë Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit dhe Bashkimi Qendror i Kooperativave të Artizanatit, si dhe vetë komitetet ekzekutive të qarqeve, komitetet dhe organizatat bazë të Partisë, të cilat nuk i kanë kushtuar kujdesin e duhur.

Nga ana tjetër, akoma nuk i kushtohet gjithë vëmendja problemit të kostos së prodhimit dhe nuk mbahet parasysh fakti se ulja e kostos së prodhimit është burimi kryesor për uljen e çmimeve të shitjes së mallrave të konsumit të gjerë. Megjithëse në këtë drejtim ka pasur disa rezultate, përsëri mundësitë për uljen e kostos së prodhimit janë shumë të mëdha si në industri, ashtu dhe në artizanat. Akoma shumë prodhime sidomos të artizanatit dhe të industrisë lokale dalin me çmime të larta si

p.sh. prodhimi i mobiljeve e orendive, konfeksionet e tekstilit, frutat dhe barishtet e konservuara e të tjera, sepse ka dobësi të shumta në organizimin e punës, ka proccse pune të pamekanizuara, shfrytëzim joracional të lëndëve të para dhe të materialeve të tjera.

Një punë e pamjaftueshme është bërë nga ana e Ministrisë së Industrisë dhe të Ndërtimit, nga Bashkimi Qendror i Kooperativave të Artizanatit dhe nga komitetet ekzekutive të qarqeve për shfrytëzimin e kapaciteteve dhe të rezervave të brendshme të ndërmarrjeve prodhuese, me qëllim që të rritet sa më shumë prodhimi i mallrave të konsumit të gjerë. Kështu sot nuk plotësohen nevojat e popullsisë së fshatit dhe të qytetit në shumë artikuj, me mobilje e orendi, poçeri, materiale ndërtimi, enë dhe artikuj kuzhine, krevate, gozhdë patkojsh, kosa bari, drapëra, thika e gërshërë etj. Si zdrukhtaritë lokale, ashtu dhe ato të artizanatit punojnë në një përqindje të madhe porosi për ente dhe për ndërmarrje shtetërore. Kështu p.sh. prodhimi i ambalazheve për industrinë zë gati gjysmën e kapacitetit të prodhimit të zdrukhtarive lokale. Në Shkodër industria lokale prodhon vetëm 6 për qind mallra për fshatin dhe artizanati 24 për qind etj.

Me gjithë vendimet e qeverisë të vitit të kaluar, ish-Ministria e Industrisë nuk ka treguar kujdes për prodhimin e artikujve të konsumit të gjerë nga Uzina «Enver» dhe nga ofiçinat e tjera pranë ndërmarrjeve industriale, të cilat i kanë mundësitë për të prodhuar një sërë artikujsh si sqeparë, çekiçë, shata, lopata, furnella për qymyr, hekur për hekurosje, gërshërë, thika, satëre etj.

Gjithashtu Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit ka neglizhuar për shfrytëzimin e mbeturinave pranë ndërmarrjeve si në Kombinatin e drurit, në sharrat e Pukës, në Kombinatin e tekstileve etj., ku mund të ngrihen reparte të posaçme për të prodhuar artikuj të ndryshëm si arka, valixhe druri, veshje etj. sende të vlefshme për tregun. Nga ana tjetër ka akoma maqineri që qëndrojnë të pashfrytëzuara dhe që me ndonjë riparim mund të futen në funksionim, për të shtuar kapacitetin e prodhimit të artikujve të metalit dhe të drurit si nga artizanati ashtu dhe nga industria lokale.

Ne kemi kapacitete më të mëdha prodhimi në industri, të cilat sot nuk shfrytëzohen si në industrinë e sheqerit, në atë të vajit, të tekstileve, të këpucëve, në artizanat dhe në industrinë lokale. Ne nuk kemi qenë akoma në gjendje për të shfrytëzuar mundësitë dhe kapacitetet që na paraqet peshkimi në det dhe në ujërat e brendshme, i cili është sot një nga degët më të prapambetura të industrisë sonë. Ndërsa në industrinë e tekstileve të pambukta ne i kemi kapacitetet dhe lëndën e parë, por këtu duhet një punë e madhe për ngritjen e rendimentit në punë me anë të perfeksionimit të kuadrove. Në industrinë e këpucëve ne kemi kapacitet për të plotësuar nevojat tona, por mungesa e materialit të parë ka bërë që të kemi një deficit për këta artikuj.

Nga ana tjetër edhe kapaciteti i kooperativave të artizanatit, në punimin e metaleve, në prodhimin e mobiljeve e orendive, punimeve të poçerive, të materialeve të ndërtimit etj., nuk janë shfrytëzuar mirë dhe kjo për mungesat e mëdha dhe interesimin e paktë të treguar për të shfrytëzuar materialet e vendit e mbetu-

rinat e industrisë nacionale dhe mungesa e disa mallrave të domosdoshme që duhet të sigurohen nga importi, si llamarina për enë kuzhine, kallaj, plumb etj.

Lidhur me furnizimin e dobët të masave të popullit një përgjegjësi e madhe rëndon mbi organet e tregëtisë shtetërore dhe kooperativiste.

Përveç mosrealizimit të planeve të prodhimit dhe të grumbullimit të mallrave të konsumit të gjerë, një e metë tjetër ka qenë dhe shpërndarja jo e barabartë dhe në kohë e këtyre mallrave e shkaktuar në radhë të parë për dobësi të organeve të tregëtisë shtetërore dhe kooperativiste si dhe të organeve furnitore, të cilat, duke mos realizuar planet e tyre tërësisht, kanë bërë një shpërndarje jo të rregullt. Kështu p.sh. plani i prodhimit të mishit në Elbasan është realizuar 43 për qind, ndërsa në Berat — 60 për qind; plani i prodhimit të djathit dhe të gjizës në Elbasan — 63 për qind, në Berat — 76 për qind; plani i fasuleve dhe i orizit në Elbasan — 143 për qind, në Berat — 97 për qind dhe në Tiranë — 93 për qind; plani i prodhimit të të lesh-tave në Elbasan është realizuar 28,9 për qind, në Berat — 44,9 për qind dhe në Tiranë — 42,9 për qind etj.

Për efekt të furnizimit jo të rregullt, shpërndarja e ushqimeve në popull është bërë me vonesë nga njëri muaj në tjetrin.

Nga ana e organizatave tregëtare nuk studjohen mirë nevojat dhe kërkesat e popullsisë. Puna e Partisë dhe e organeve të tregëtisë për edukimin e kuadrove të tregëtisë për t'i shërbyer popullit më mirë dhe për një qëndrim të ndërgjegjshëm ndaj punës, është e pamjaftueshme. Vërtetohen raste të mosadministrimit të

mirë të mallit. Ka raste të rëndomta të suficiteve dhe të deficiteve; vërtetohen vjedhje dhe abuzime, të cilat kanë dëmtuar pronën shtetërore dhe kanë rënduar në kurriz të popullit. Ka mjaft raste të sjelljes në mënyrë jo të njerëzishme ndaj popullit, të mospritjes së mirë të popullit, nuk bëhet reklam i mirë i mallrave dhe nuk luftohet si duhet nga organet e furnizimit për sigurimin e mallrave me cilësi të mirë dhe me asortimentet e nevojshme.

Megjithëse për grumbullimet është folur vazhdimisht në vendime të ndryshme të Partisë dhe të qeverisë, akoma mund të themi se ky problem nuk është kapur si duhet nga Partia dhe nga organet shtetërore. Këtë e tregon fakti i dobësive të mëdha që konstatohen.

Organet e tregëtisë shtetërore dhe kooperativiste akoma vazhdojnë të bëjnë grumbullimin e prodhimeve ditët e pazareve dhe vazhdojnë kështu sepse kjo është rruga më e lehtë për ta dhe nuk marrin masa që të organizojnë punën për të grumbulluar në zonat e thella. Në këtë mënyrë kanë bërë që të ngrihen çmimet e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale në pazar dhe nuk kanë tërhequr prodhimet nga zonat e thella, ku një pjesë e tyre shkon dëm.

Punonjësit e kooperativave të konsumit në fshat akoma vazhdojnë të presin fshatarët që t'ua sjellin mallrat në dyqan, pa vajtur ata vetë që t'i grumbullojnë në çdo fshat e në çdo shtëpi. Gjithashtu grumbulluesit jashtë organikës nga ana e këtyre kooperativave janë të paktë në numër dhe nuk aktivizohen mirë.

3. — Të gjitha minierat tona nuk i kanë realizuar planet e prodhimit dhe kanë krijuar deficite të mëdha,

që e kanë rënduar ekonominë tonë dhe kanë zhbalancuar import-eksportin, duke krijuar deficite të konsiderueshme. Gjatë viteve të çlirimit në sektorin e minierave janë investuar shuma të konsiderueshme. Vetëm materialet dhe maqineritë e importuara gjatë dyvjeçarit dhe tri viteve të para të pesëvjeçarit kapin shumën 84 000 000 rubla. Dobësitë tona në sektorin e minierave janë të shumta, por ajo që është më e rëndësishme është se ne edhe për vitet e ardhshme do të jemi në situata të vështira, pse jemi pa rezerva të njohura. Më hollësisht gjendja e minierave paraqitet kështu:

Çështja e naftës. Në dritën e llogarive të këtyre viteve të para ajo pak naftë që ne kemi prodhuar i ka kushtuar shumë ekonomisë popullore. Në çështjen e prodhimit të naftës, si dhe në çështjet e tjera ne na ka ndihmuar Bashkimi Sovjetik. Po që se nuk do t'i kishim vënë rëndësi këtij problemi, ne do të ndodheshim pa naftë. Kreditë e dhëna nga Bashkimi Sovjetik e përmirësuan situatën në nxjerrjen e naftës. Por, prapë situata në këtë industri të rëndësishme vazhdon të qëndrojë e rëndë për ekonominë tonë. Llogaritë e bëra mbi leverdinë ekonomike të nxjerrjes së naftës tregojnë deficite shumë të mëdha çdo vit. Duke llogaritur të gjitha shpenzimet e bëra për të prodhuar naftën, deri në fabrikë (maqineri, paga punëtorësh, investime banesash, amortizime etj.) dhe duke zbritur nga kjo shumë sasinë e eksportit të naftës dhe të bitumit tonë, ne kemi një deficit prej afro 53 milion rublash prej vitit 1951 e deri në vitin 1953. Përveç këtij deficiti të madh që rëndon mbi ekonominë tonë, ne kemi qenë të detyruar të

importojmë nga jashtë brenda viteve 1948-1953 naftë të përpunuar dhe vajra lubrifikante në një shumë prej 18 milion rublash. Kjo situatë është edhe si pasojë e dobësive tona në drejtim të organizimit të punës, por më e rëndësishmja është se në këtë sektor kemi ecur dhe vazhdojmë të ecim jo të sigurtë në rezervat e naftës.

Rezervat e njohura deri sot janë minimale dhe nxjerrja e tyre mund të shterojë brenda një periudhe të shkurtër. Nga ana tjetër shpimet aktuale të kërkimit dhe të shfrytëzimit janë krejtësisht të pamjaftueshme. Debiti i puseve vazhdimisht po ulet dhe kjo jo vetëm që shkakton deficite të konsiderueshme në prodhim dhe rëndon ekonominë tonë, por shkakton zhbancime të mëdha në grafikun e eksportit tonë.

Ekspedita e studimeve gjeologjike të naftës që vazhdon punimet prej vitit 1950 dhe që këto do t'i mbarojë në vitin 1956, është optimiste në lidhje me ekzistencën e naftës në shumë pika të vendit tonë, përveç fushave ekzistuese¹. Por vërtetimi i rezervave të reja, si në fushat ekzistuese, ashtu edhe në fushat e reja, kërkon investime. Byroja Politike është e mendimit se duhet të vazhdojmë nxjerrjen dhe kërkimet në naftë, megjithëse kjo është një barrë e rëndë dhe do

¹ Më vonë specialistët sovjetikë që punonin në ekspeditat e studimeve gjeologjike, me qëllime të caktuara, sipas porosisë së udhëheqjes së tyre nxorën konkluzione të kundërta dukë e paraqitur çështjen sikur rezervat e naftës në Shqipëri tashmë kishin shteruar. E ardhshmja tregoi karakterin e rremë të këtyre konkluzioneve.

të vazhdojë të jetë edhe për një kohë për ekonominë tonë, në rast se nuk shtohet debiti i naftës. Duhet të vazhdojmë me naftën se kjo është një lëndë strategjike dhe ekonomike me rëndësi të madhe për vendin dhe për kampin tonë. Në këtë sektor kemi bërë shpenzime të mëdha, po ndërtojmë rafinerinë, këtu kemi një pjesë luftarake të klasës punëtore dhe kemi rritur kuadro naftëtarësh. Duke i pasur parasysh të gjitha këto rrethana, Byroja Politike mendon se duhet të vazhdojmë nxjerrjen e naftës dhe të bëjmë kërkime për vendburimet e reja të saj. Për këtë qëllim Byroja Politike ka menduar t'i kërkojë kredi të reja Bashkimit Sovjetik për këtë sektor.

Përsa u përket minierave të tjera, përveç kromit dhe qymyrit, në këtë situatë ato janë të paleverdisshme për ekonominë tonë¹. Kjo ndodh me bitumin natyral dhe sidomos me bakrin, pse në këto miniera rezervat janë të panjohura dhe tash jemi pa rezerva. Ekipet gjeologjike po bëjnë studime dhe për këtë arsye ne do të ngadalësojmë investimet deri në gjetjen e rezervave, por natyrisht do të ulet dhe prodhimi i tyre.

Përsa i përket kromit, nga studimet gjeologjike të deritanishme, rezulton të kemi rezerva industriale të tilla që sigurojnë prodhimin për 2-3 vitet e ardhshme. Për prodhimin e kromit, relativisht me prodhimet e tjera minerale janë dashur më pak materiale nga importi dhe shpenzime të tjera të brendshme. Shteti ynë ka siguruar nga eksporti i kromit brenda pesë

¹ Ky konkluzion është nxjerrë nga mendimet dhe nga të dhënat e gabuara të specialistëve sovjetikë.

viteve afro 30 milion rubla. Për këto arsye minerali i kromit duhet që edhe në të ardhshmen të jetë një nga pikësnyimet më të rëndësishme të eksportit tonë. Për t'ja arritur këtij qëllimi Partia dhe pushteti duhet të marrin masat e menjëhershme për të siguruar forcën punëtore dhe kuadrot e nevojshëm, të forcojnë bazën tekniko-mekanike, në mënyrë që të bëhen të mundshme zgjerimi dhe mekanizimi i punimeve të nxjerrjes dhe të evadimit të kromit.

Lidhur me prodhimin e qymyrgurit, ky, në koniditat e sotme nuk i plotëson nevojat e industrisë dhe ato të popullatës për shkak të punimeve përgatitore të pamjaftueshme që nuk kanë ecur krahas me shfrytëzimin, për të krijuar fronte të reja. Me masat që u morën nga qeveria, gjendja është përmirësuar, por nuk është zgjidhur definitivisht.

Është i nevojshëm vazhdimi i kërkimeve gjeologjike dhe intensifikimi i punimeve përgatitore në të tri minierat dhe në mënyrë të veçantë në Kërrabë dhe në Priskë për të plotësuar në radhë të parë nevojat e kryeqytetit me qymyrguri për furnizimin e industrisë dhe ngrohjen e popullatës me perspektivë që konsumi i lëndës së drurit për ngrohje të pakësohet në minimum në vitet e ardhshme.

Gjendja e vështirë e bilancit import-eksport

Lidhur me gabimet në investime është edhe përdorimi jo i drejtë i kredive të akorduara nga Bashkimi Sovjetik dhe nga demokracitë popullore. Që nga

viti 1947 qeveria sovjetike na ka akorduar një kredi që kap shumën 330 milion rubla. Kredia nga demokracitë motra është 345 milion rubla. Këto kredi janë kërkuar: 152 milion rubla për industrinë e reja, 132 milion rubla për minierat, 63 milion rubla për transport, 24 milion rubla për bujqësinë, resti për maqineri të ndryshme, për drithëra buke, mallra konsumi, lëndë të parë dhe djegëse etj. Nga këto shifra del e qartë se kredia e kërkuar për sektorin e bujqësisë, në krahasim me sektorët e tjerë, është e vogël¹. Nga gabimet që kemi pasur në investimet në përdorimin e kredisë dhe nga mosrealizimi i planeve tona, sidomos në miniera dhe në bujqësi, ka ardhur që ne sot të jemi në një situatë shumë të vështirë lidhur me shlyerjen e kredive që kemi marrë nga miqtë tanë. Duke llogaritur gjendjen e kredive, në bazë të marrëveshjeve të lidhura me vendet miq, ne detyrohemi të kthejmë plotësisht këstet dhe interesat e tyre deri në vitin 1967 dhe këto kredi me gjithë interesat rriten në shumën 770 milion rubla (675 milion kredi dhe 95 milion interesa). Disa nga këto këste kemi filluar t'i shlyejmë qysh këto vitet e fundit. Por duke filluar nga viti 1954 dhe në vitet e ardhshme, shumat e shlyerjes së ratave shënojnë një rritje të madhe. Në vitin 1958 arrinin në 103 milion rubla në vit. Duke e marrë të veçuar periudhën 1954-1959, këstet dhe interesat që duhet të shlyejmë në bazë të marrëveshjeve, arrijnë shumën prej 327 milion rubla. Mirëpo

¹ Udhëheqja sovjetike në atë kohë nuk aprovoi kërkesat tona për shtesë kredie për bujqësinë dhe sugjeroi uljen e ritmeve ose heqjen e disa objekteve industriale.

me ritmin që parashikohet të zhvillohet ekonomia jonë gjatë po kësaj periudhe (1954-1959) rezulton se fuqia jonë eksportuese do të jetë rreth 460 milion rubla, pra vetëm shlyerja e kësteve dhe e interesave të përmendura më lart kërkon 70 për qind të eksportit tonë. Parashikohet që importi ynë, gjatë periudhës së larf-përmendur për artikuj të llogaritur shumë shtërnguar dhe që ne jemi të detyruar të importojmë si pajisje maqinash, bukë, maqineri, lëndë djegëse, mallra konsumi etj. të jetë rreth 570 milion rubla, duke pasur kështu një deficit në bilancin tonë prej 110 milion rubla. Siç shihet situata jonë është e vështirë dhe kjo është shkaktuar nga mosrealizimi i planeve tona ekonomike dhe nga vështirësitë e përmendura më lart. Por mosqenja në gjendje të plotësojmë angazhimet, është shkaktuar edhe se në kohën e mbylljeve të marrëveshjeve, ana jonë ka pranuar afate shlyerje shumë të shkurtëra dhe jo të bazuara në një zhvillim real të ekonomisë sonë në të ardhshmen dhe veçanërisht në fushën e eksportit, por i ka llogaritur këto sipas dëshirës dhe duke u kufizuar me nevojat imediate që i paraqiteshin aty për aty vendit. Për të dalë nga një situatë e tillë e rëndë, Byroja Politike, ka menduar t'i kërkojë qeverisë sovjetike dhe qeverive të demokracive popullore që për disa nga objektet e investimeve, ndërtimet e tyre të shtyhen dhe disa të tjera të anulohen. Por, përveç kësaj, Byroja Politike mendon t'u kërkojë qeverisë sovjetike dhe qeverive të demokracive popullore shtyrjen e pagimit të kësteve dhe të interesave, në mënyrë që të fillojmë shlyerjen e kreditit vetëm pas vitit 1960.

Shokë!

Nga sa parashtruam më lart del se situata jonë ekonomike është mjaft e vështirë. Për këtë qëllim Byroja Politike në qershor të këtij viti orientoi qeverinë në marrjen e një sërë masash të rëndësishme ekonomike e administrative, që kanë për qëllim ndreqjen e gabimeve të lartpërmendura dhe për të siguruar një zhvillim të harmonishëm të bujqësisë, të industrisë dhe të sektorëve të tjerë të aktivitetit shtetëror, me qëllim që të krijohen të gjitha mundësitë për forcimin e ekonomisë në fshat dhe në qytet dhe për të përmirësuar furnizimin e masave punonjëse.

Masat që mori Byroja Politike dhe qeveria janë:

1. — Masa favorizuese për fshatarësinë

I falen fshatarësisë detyrimet e prapambetura në drithëra dhe në prodhime blegtorale. I ulen detyrimet në natyrë në masën 9-20 për qind. I ulen çmimet e shitjes së plugjeve, të kultivatorëve dhe të lesave të prodhuara ose të modifikuara në vend si dhe i falen pjesërisht të prapambeturat nga tatimi financiar.

Masat lehtësuese të parashikuara në këto vendime favorizojnë të gjitha zonat dhe të gjithë fshatarët që merren me bujqësi dhe me blegtori. Ja konkretisht efekti ekonomik i këtyre masave në favor të fshatarësisë për prodhimet bujqësore dhe blegtorale.

Njësia e matjes në ton, vezët në 100 kokrra, vleftha në 1 000 lekë.

Artikulli	Fondi para favoriz.	Sasitë e zbritura mbrapa favoriz.	Fondi që mbetet pas favoriz.	Përqindja e zbritjes së bërë	Vlerësimi në lekë i favoriz. me çmim treg të lirë	Vlerësimi në lekë i favoriz. me çmim të detyrueshëm	Lekë që i mbeten fshatarësisë
Drithëra							
buke	54 300	15 300	39 000	28,2	765 600	36 200	729 400
Oriz							
çeltik	2 100	600	1 500	30,1	51 400	4 000	47 400
Fasule	1 900	1 000	900	52,5	103 100	5 200	97 900
Tagji	5 800	2 000	3 800	34,7	80 800	2 900	77 900
Mish	10 800	2 800	8 000	26,2	227 800	23 500	199 300
Lesh	1 100	500	600	46,1	204 100	16 300	189 800
Veze	23 300	13 900	9 400	52,4	124 800	13 900	110 900
Ullinj	12 900	2 100	10 800	16,2	83 300	10 900	72 400
Shuma:					1 640 900	117 900	1 525 000

Nga masat favorizuese për fshatarësinë në lëmin e tatimit financiar llogaritet që shteti u ka falur fshatarëve rreth 95 milion lekë.

Sigurisht këto masa janë pritur mirë nga fshatarësia jonë dhe e kanë inkurajuar shumë atë në zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë. Por masat e Partisë dhe të qeverisë në favor të zhvillimit të bujqësisë duhet të vazhdojnë me një proporcion më të madh. Ne duhet të marrim të gjitha masat në favor të bujqësisë për të mbuluar disproporcionin e madh që ekziston midis zhvillimit të saj dhe industrisë, ne duhet ta vlerësojmë drejt dhe t'i vëmë rëndësi të madhe sektorit të bujqësisë.

2. — Rishikimi i planit në ndërtime

Plani i ndërtimeve për vitin 1953 ishte 4,2 miliard lekë. Realizimi i këtij plani që ishte 166 për qind në krahasim me realizimin e vëllimit të ndërtimeve për vitin 1952, paraqiste vështirësi shumë të mëdha për t'u zbatuar. Plani i ndërtimeve për gjashtëmujorin e parë u realizua vetëm 72 për qind. Për realizimin e këtij, në gjashtëmujorin e dytë të vitit 1953 do të duhej të angazhoheshin një numër i madh forcash punëtore si dhe një sasi e madhe materialesh të ndryshme ndërtimi si lëndë druri të sharruar, gozhdë, çimento, tulla, tjegulla etj. Byroja Politike e KQ të PPSH orientoi qeverinë për të bërë një zbritje prej rreth 1 miliard lekë në planin e ndërtimeve për gjashtëmujorin e dytë të vitit 1953. Në këtë mënyrë plani i ndërtimeve u reduktua si vijon:

Nr.	Përshkrimi	Plani 1953	Plani i reduktuar 1953		%
			Fondi	%	
1	2	3	4	5	6
	Gjithsejt ndërtime	4 185.0	3 147.4	100%	75,2%
	Nga të cilat:				
1.	Minierat	586.7	424.3	13,5%	72,3%
2.	Industria	1 124.1	643.5	20,4%	57,2%
3.	Bujqësia	772.5	645.6	20,5%	83,6%
4.	Komunikacioni	700.8	510.1	16,2%	72,8%
5.	Komunalja	382.3	381.9	12,1%	99,9%
6.	Sektorë të tjerë	618.0	542.0	17,3%	87,6%

Nga pasqyra e mësipërme del se vëllimi i ndërtimeve u zbrit 25 për qind, domethënë rreth 1,1 miliard lekë, nga i cili rreth 770 milion në minierat, në industri dhe në komunikacion, rreth 127 milion lekë në bujqësi dhe pjesa tjetër në sektorë të tjerë.

Si rezultat i reduktimit të planit të vitit 1953 u bënë këto ndryshime në objektet kryesore:

1. — U reduktua vëllimi i ndërtimeve për hidrocentralin e Matit nga 380 milion lekë në 120 milion lekë, për rafinerinë e naftës në Cërrik nga 300 milion lekë në 165 milion lekë, për fabrikën e çimentos në Vlorë nga 175 milion lekë në 130 milion lekë dhe për rrugën Ulëz-Burrel nga 65 milion lekë në 42 milion lekë.

2. — U hoqën nga plani disa objekte që nuk kishin filluar të ndërtoheshin dhe për ndërtimin e të cilave ishin parashikuar fonde në planin e investimeve të vitit 1953 si fabrika e bukës Tiranë, ofiqina automobilistike Tiranë, linjat e tensionit të lartë 110 kw. si dhe disa objekte që porsa kishin filluar: hekurudha Memaliaj-Vlorë, rruga e Dishnicës, bonifikimi i Myzeqesë, fabrika e konservimit të peshkut etj. Vlen të shënohet se për këto objekte akoma nuk disponohen projektet për ndërtimin e tyre.

Byroja Politike e KQ të PPSH orientoi që pakësimi i vëllimit të investimeve në ndërtime të mbahet parasysh edhe në hartimin e projektplaneve të ardhshme. Ulja e vëllimit të ndërtimeve për vitin 1953 si dhe për vitin e ardhshëm bën që afati i përfundimit për disa objekte të shtyhet, ndërsa disa të tjera të mos ndërtohen gjatë këtij pesëvjeçari. Kështu p.sh. përfundimi i ndërtimit të hidrocentralit të Matit nga viti 1955 që

parashikohej në planin pesëvjeçar, të përfundojë në vitin 1957-1958. Rafineria e naftës në Cërrik nga viti 1954, të shtyhet në vitin 1956-1957. Fabrika e çimentos në Vlorë, e cila duhej të përfundonte në vitin 1953, do të përfundojë në gjashtëmujorin e parë të vitit 1954. Gjithashtu që të mund të mbahet një ritëm normal dhe i realizueshëm në ndërtimet gjatë këtij pesëvjeçari nuk do të ndërtohen disa objekte të tjera si p.sh. fabrika e qelqit, e letrës, e litarit dhe e ambalazhit, fabrika e bukës, uzina e metalurgjisë së zezë, uzina e pasurimit të bakrit, gjysma e kapacitetit të instalimit të shkrirjes së bitumit dhe ofiçina automobilistike në Elbasan. Heqja e këtyre objekteve lidhet edhe me pengesat e mëdha që hasen për projektimin dhe akordimin e maqinave të disa fabrikave që kemi në marrëveshje me shtete miq dhe nga pamjaftueshmëria e kredive të akorduara për mbulimin e vleftës së maqinerive nga importi. Përveç këtyre gjatë këtij pesëvjeçari nuk do të ndërtohen objekte të tjera si hekurudha Memaliaj-Vlorë, fabrika e staxhionimit të drurit në Dishnicë, rrugët Gramsh-Lozhan, Çorovodë-Frashër, Lozhan-Voskopojë-Vithkuq, bonifikimi i Vurgut në Delvinë, bonifikimi i fushës së Mursisë, mbathja e Nartës, diga definitive e kanalit ujitës «Naum Panxhi», liqeni artificial i Tërkuzës, teatri kombëtar, Selia e KQ të PPSH, pallati i pionierëve në Tiranë si dhe disa objekte të tjera më të vogla.

Gjatë viteve 1953-1954 dhe 1955 do të ndërtohen objekte të mëdha, të cilat japin efekt të shpejtë dhe që influencojnë menjëherë në shtimin e prodhimeve bujqësore dhe industriale për konsum të gjerë si p.sh. kanali ujitës Vjosë-Fier, kanali ujitës i Myzeqesë, kanali

ujitës i Fushë-Korçës, bonifikimi i Rushkullit, sistemi-mi i lumit Gjadër, emisari i Tërbufit, fabrika e konsevimit të peshkut, të perimeve dhe të frutave në Vlorë, fabrika e konservimit të perimeve dhe të frutave në Elbasan dhe në Shkodër, fabrika e trikotazhit në Tiranë, rruga e Stravajt (për të siguruar Kombinatin e drurit «Nako Spiru» Elbasan me lëndë të sharruar), fabrika e çimentos në Vlorë, vazhdimi i punimeve në hidrocentralin e Matit, në rafinerinë e naftës Cërrik dhe vazhdimi i ndërtimeve të linjës elektrike tensioni i lartë 110 kw Qyteti «Stalin» drejtim Ulzë.

Ulja e investimeve në ndërtime për vitin 1953 pati këto efekte pozitive:

a) U zvogëluar plani i fuqisë punëtore nga 20 500, planifikuar për tremujorin e tretë në 13 800 dhe për tremujorin e katërt nga 18 300 në 14 800. Kjo ulje favorizoi fshatarësinë dhe bëri të mundshme që të kryhen më në rregull punimet bujqësore; këtë vit prodhimet bujqësore, grumbullimet dhe punimet e vjeshtës janë bërë më të mira se vitet e kaluara.

b) U krijuan mundësitë për të furnizuar popullatën me materiale ndërtimi. Menjëherë pas uljes së planit të ndërtimit u destinuan për konsum të gjerë 5 000 m³ lëndë e sharruar, 2 000 ton çimento, 60 ton gozhdë etj.

c) U hodhën në treg prodhime ushqimore me një vleftë prej 20 milion lekë mbi parashikimet e planit nga të cilat: sheqer 240 kv., yndyrna 200 kv., mish e peshk 490 kv., djathë e gjizë 160 kv., oriz e fasule 300 kv., makarona 600 kv., etj. Këto sasi e përmirësuan disi furnizimin më të rregullt të popullatës.

d) Punëtorët e ndërtimit u vunë para një detyre

më konkrete. Vëllimi që u mbetej për vitin 1953 u reduktua nga 166 për qind në 125 për qind në krahasim me realizimin e ndërtimeve për vitin 1952.

dh) U ul financimi i ndërtimeve në 1 miliard duke ndaluar kështu rritjen e qarkullimit të monedhës.

Nga ana tjetër kemi edhe këto efekte negative:

a) Nuk do të realizohen mjaft objekte të parapara në planin pesëvjeçar.

b) Do të konsumojmë sasi më të mëdha qymyrguri dhe naftë brut për termocentralet ekzistuese për shkak të shtyrjes së afatit të përfundimit të hidrocentralit të Matit.

c) Do të shpenzojmë devizë të huaj për importimin e sasive të nevojshme karburanti për efekt të shtytjes së afatit të përfundimit të rafinerisë së naftës në Cërrik.

ç) Shkuan dëm disa shpenzime të harxhuara për objekte, të cilat u pezulluan së ndërtuari si dhe u bënë shpenzime të parakohshme për disa objekte të tjera, të cilat nuk do të shfrytëzohen sipas parashikimeve.

3. — Riorganizimi i aparatit shtetëror

Aparati ynë shtetëror ishte rritur së tepërmi dhe numri i nëpunësve arrinte në 40 454, përveç ushtrisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe arësimitarëve. Me një rritje të tillë të aparatit administrativ ishte krijuar një disproporcion i madh në mes të njerëzve të prodhimit dhe personelit administrativ. Ky proporcion arrinte: një nëpunës për çdo 2,42 punëtorë ose 1 nëpunës për çdo 30 qytetarë të Republikës.

Një aparat i tillë i fryrë rëndonte jashtëzakonisht buxhetin e shtetit, e dëmtonte ekonominë popullore në mbajtjen e këtij personeli joprodhues me triskat që merrnin si dhe duke i larguar këta nga prodhimi drejt administratës. Barra e rëndë e aparatit shtetëror shkaktonte një pakënaqësi qoftë dhe të heshtur në fshatarësinë dhe në punëtorët.

Zgjerimi i madh i aparatit shtetëror i kishte lënë shteg burokracisë, konfuzionit, abuzimeve dhe sabotimit.

Lidhja e qendrës me 26 rrethe dobësonte kontrollin e qendrës mbi bazën, shkaktonte burokraci dhe e centralizonte punën në qendër, duke kufizuar kompetencat e bazës.

Vendimet e përbashkëta të Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH, të Këshillit të Ministrave dhe të Presidiumit të Kuvendit Popullor¹ përmbanin:

a) Riorganizimin e aparatit shtetëror, duke shkurtuar numrin e ministrive nga 18, në 10 ministri dhe dy komisione, ai i planit dhe ai i kontrollit.

b) Suprimimin e shumë drejtorive qendrore dhe lidhjen e ndërmarrjeve direkt me ministritë.

c) Bashkimin e disa ndërmarrjeve në një ndërmarrje të vetme dhe suprimimin krejtësisht të disa ndërmarrjeve dhe të institucioneve të panevojshme. Kështu, nga 300 ndërmarrje që kishim dhe 17 drejtori qendrore, mbeten 171 ndërmarrje.

¹ Është fjala për vendimet e Plenumit VIII të KQ të PPSH që u mblodh më 23 korrik 1953.

Për pushtetin lokal

ç) Ndarjen e re administrative¹, krijimin e 10 qarqeve, zvogëlimin e rretheve dhe shtimin e tyre nga 26 në 54 dhe suprimimin e lokaliteteve si instancë e rregullt në ndarjen administrative, lënjen e lokaliteteve vetëm në ato vende ku lidhjet e rrethit direkt me fshatin paraqiten të vështira.

Këto vendime të rëndësishme kanë filluar të zbatohen prej disa muajsh si në pushtetin qendror dhe në pushtetin lokal.

Riorganizimi i ri i aparatit shtetëror ka pasur reperkusione të favorshme si në pikëpamje organizative, ashtu edhe financiare e politike.

Kështu aparati shtetëror u thjeshtësua mjaft, u eliminuan shumë hallka ndërmjetëse, të cilat e rëndonin aparatin dhe zgjatnin zgjidhjen e problemeve, u përmirësua përbërja e aparatit, pasi në shkurtimet u vendosën në aparat kuadro kompetentë me stazh të vjetër në pushtet dhe me garanci politike, u krijuan mundësitë për një drejtim më operativ dhe me inisiativë të problemeve shtetërore, u eliminuan disa dobësi administrative që i hapnin rrugë burokratizmit dhe pushteti u afrua më afër bazës.

Në pikëpamje ekonomike riorganizimi do të sjellë

¹ Ky ndryshim në ndarjen administrative të RPSH u bë me vendim të Presidiumit të Kuvendit Popullor Nr. 1716, datë 20 gusht 1953.

si rrjedhim që buxhetit të shtetit t'i kursehen 441 milion lekë në vit pagim rrogash, plus ushqimin dhe mallrat industriale të garantuara për 11 270 nëpunës dhe familjet e tyre. Përfitimi tjetër ekonomik është se pjesa më e madhe e këtyre kuadrove do të shkojnë në prodhim, pjesërisht në fshat dhe pjesërisht në qendrat e punës. Këto masa ekonomike do të influencojnë në përmirësimin e konditave materiale të punonjësve, do të ndiqet më mirë realizimi i planit të shtetit në të gjithë sektorët, do të kemi një furnizim më të mirë të masave punonjëse, pra masat ekonomike do të kenë edhe efektin e tyre politik në forcimin e aleancës midis qytetit dhe fshatit, në forcimin e unitetit moralo-politik të popullit tonë rreth Partisë dhe qeverisë sonë.

Vendosja e kuadrit me riorganizimin e pushtetit

Në vendosjen e kuadrove në pushtet me organizimin e ri është vepruar sipas orientimit dhe udhëzimeve të dhëna nga Byroja Politike e KQ të PPSH, për të bërë një shpërndarje sa më të drejtë të kuadrit duke i forcuar organet tona shtetërore, veçanërisht ndërmarrjet ekonomike dhe pushtetin lokal me kuadro më të fortë e më me eksperiencë.

Byroja Politike porosit drejtuesit e organeve shtetërore dhe komitetet e Partisë që të tregojnë një kujdes të veçantë në studimin e kuadrit dhe sidomos në sistemin në punë të tjera të elementëve që mbeteshin jashtë kuadrit për efekt të shkurtimit të organikave.

Organizimi i ri i mbështetur mbi këtë orientim ka

përmirësuar përbërjen e administratës qendrore të shtetit dhe të pushtetit në bazë.

Në shpërndarjen e kuadrove me arësim të lartë është vepruar sipas përcaktimit që ka bërë Byroja Politike e Komitetit Qendror në mënyrë që një pjesë e mirë e tyre të kalonin në prodhim. Nga 820 kuadro të lartë që punojnë në sektorin e ekonomisë dhe të kulturës, 56 për qind janë në prodhim dhe 43 për qind në administratë. Në krahasim me të kaluarën kemi përmirësime në shpërndarjen e tyre megjithkëtë ky përpjesëtim nuk është i drejtë dhe duhet që Byroja Politike e Komitetit Qendror ta rishikojë për të dërguar edhe më shumë teknikë të lartë në prodhim.

Krahas me forcimin e aparatit në qendër është mbajtur parasysh dhe forcimi i pushtetit dhe i ndërmarrjeve ekonomike në bazë, duke u dhënë atyre rreth 735 kuadro, kryetarë dege, shefa seksioni dhe referentë. Kjo e ka forcuar pjesërisht bazën, por nevojat dhe mundësitë janë për të forcuar akoma bazën me kuadro më të zot.

Në bazë të orientimit të Komitetit Qendror për sistemimin e elementëve që mbeteshin jashtë kuadrit u tregua një kujdes i veçantë nga drejtuesit e organeve të Partisë e të organeve shtetërore, në mënyrë që të mos mbetej asnjë kuadër pa punë dhe që të mos krijoheshin pakënaqësi.

Kuadri që u shkurtua nga dikasteret u sistemua gati i gjithë. Për komitetet ekzekutive kemi këtë situatë:

Të mbetur jashtë kuadrit	2 096 vetë
Të sistemuar në administratë	853 »

Shkuar në prodhim	141	vetë
Shkuar në fshat	843	»
Mbeten për t'u sistemuar	259	»

Me riorganizimin e ndërmarrjeve numri i të pasistemuarve është shtuar akoma.

Nga të dhënat e komiteteve të Partisë, të Beratit, të Gjirokastrës, të Korçës, të Kukësit, të Shkodrës, të Peshkopisë, të Elbasanit, të Durrësit, rezulton të jenë akoma të pasistemuar në punë në këto qarqe shumë kuadro, sepse komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive në qarqe kanë punuar me javashllëk të madh dhe sepse dikasteret e kanë ndjerë veten të shkarkuar për kuadrot e ulët të lënë pa punë dhe s'janë interesuar më për ta.

Organizimi i ri na dha mundësi për një spastrim të mirë të aparatit shtetëror nga elementët armiq e të padëshiruar, mjaft nëpunës të tillë janë hequr, numri i elementëve të tillë që kanë mbetur është minimal dhe me kohë duhen spastruar edhe këta.

4. — Riorganizimi i Partisë

Ndarja e re administrative e RPSH bëri të nevojshëm riorganizimin e Partisë në bazë të qarqeve e të rretheve. Organizimi i mëparshëm i Partisë në 27 komitete partie rrethesh që lidheshin direkt me Komitetin Qendror të Partisë, aparatet e tyre të fryra shkaktonin burokraci e zvarritje në zgjidhjen e shpejtë të problemeve dhe mungesë inisiative nga poshtë.

Qëllimi i organizimit të ri të Partisë ishte që, duke krijuar qarqet dhe duke i forcuar këto me kuadro më të aftë e më me eksperiencë, qendra t'i afrohej më shumë bazës dhe të forconte lidhjet e saja me masat. Byroja Politike e Komitetit Qendror në vendimet e saj u ka lënë kompetenca më të gjera komiteteve të Partisë të qarqeve dhe kjo u jep mundësi këtyre organeve të drejtojnë më operativisht dhe të tregojnë një inisiativë më të madhe në zgjidhjen e problemeve të ndryshme që u paraqiten.

Në bazë të riorganizimit të Partisë u krijuan 10 komitete partie në qarqe dhe 52 komitete partie rrethesh. Organikat e aparatit të Komitetit Qendror u shkurtuan në 41,2 për qind, të komiteteve të Partisë në rrethe — 32 për qind dhe të organizatave të masave 13,5 për qind. U dërguan nga qendra për në qarqe e në rrethe 28 kuadro kryesorë për komitetet e Partisë dhe 45 për komitetet ekzekutive dhe Byroja Politike vendosi edhe dërgimin e tre shokëve të tjerë të Komitetit Qendror në krye të komiteteve të Partisë të qarqeve.

Përgjithësisht kuadrot që u caktuan të shkojnë nga qendra në qarqe e në rrethe e pritën mirë vendimin e Partisë dhe janë mobilizuar me tërë forcat e tyre për të kryer me sukses detyrat e ngarkuara nga Partia. Ka pasur aty-këtu raste që disa shokë nuk e kanë kuptuar drejt uljen e tyre nga përgjegjësia për efekt të riorganizimit, janë prekur dhe ndonjë e ka manifestuar edhe në punë këtë pakënaqësi. Partia duhet t'i sqarojë mirë këta shokë që ta kuptojnë mirë e drejt këtë vendim dhe të kritikojë ashpër mendjemëdhentë e karrieris-

tët. Sigurisht që në tërë këto lëvizje kuadrosh nuk përjashtohen edhe gabime, të cilat Partia duhet t'i ndreqë në punë e sipër.

Byroja Politike e Komitetit Qendror ka marrë masa për të përmirësuar metodën e punës së drejtimit si për Sekretariatit e Komitetit Qendror, ashtu edhe për komitetet e Partisë të qarqeve e të rretheve. Këto masa kanë për qëllim të forcojnë udhëheqjen kolegjiale të Partisë dhe t'i vënë komitetet e Partisë si duhet në funksionin e tyre drejtues. Duhet thënë se në punën e Partisë, veçanërisht për drejtimin e ekonomisë, paraqiten akoma të meta të rëndësishme që dëmtojnë seriozisht punën e saj. Ka akoma shumë komitete partie që jepen aq shumë pas çështjeve ekonomike saqë harrojnë çështjet e mëdha me perspektivë dhe punën politike, edukimin e komunistëve e të masave etj. Këto komitete, në vend që të mobilizojnë organet shtetërore e ekonomike për kryerjen e këtyre detyrave, mirren vetë edhe me hollësitrat më të vogla, ndërsa aparati i organeve të pushtetit ose ekonomik e humbet inisiativën dhe nuk përdoret në shkallën e duhur.

Kjo nuk do të thotë që komitetet e Partisë të largohen nga udhëheqja e çështjeve ekonomike, por që të mos lejojnë që organizatat e Partisë të zëvendësojnë rolin e të dobësojnë udhëheqjen unike të organeve ekonomike. Shoku Stalin na mëson se

«Pra, duhet të përvetësohet metoda e drejtimit bolshevik të organeve ekonomike, thelbi i së cilës është të ndihmohen vazhdimisht këto organe, të forcohen ato vazhdimisht dhe të drejtohet eko-

nomia jo jashtë këtyre organeve, por nëpërmjet tyre»¹.

Në këtë mënyrë në qoftë se një organ ekonomik ose një tjetër punon keq dhe nuk siguron plotësimin e detyrave që i vihen përpara, është e nevojshme që jo të zëvendësohet, por të forcohet me kuadro dhe t'i jepet një ndihmë e tillë, e cila të krijojë mundësinë që të drejtojë punën dhe të realizohen detyrat që i ngarkohen atij institucioni. Udhëheqja bolshevike e ekonomisë do të thotë që të zgjidhen dhe të shpërndahen drejt dhe me kujdes kuadrot, që t'u sigurohen organeve ekonomike e të pushtetit punëtorë të përgatitur mirë e të aftë. Vetë përmirësimi i punës së Partisë, çlirimi i organeve të Partisë nga vogëlsirat ekonomike, varet në radhë të parë nga forcimi i organeve ekonomike me kuadro. Sigurisht që kjo kërkon një punë serioze, durim dhe kohë, por tamam kjo është detyra kryesore e Partisë.

5. — Gjithashtu për të shtuar mallrat e konsumit për në treg dhe për të mobilizuar gjithë forcat e mundshme për këtë qëllim qeveria, e orientuar nga Byroja Politike, mori masa për inkurajimin e tregëtisë së vogël dhe të artizanatit privat. Inisiativa e vogël private do të futet në rrugën e drejtë dhe do të jetë një ndihmëse e tregëtisë shtetërore dhe kooperativiste si dhe e zhvillimit të mëtejshëm të prodhimit të vogël. Këto masa të drejta kanë filluar të ndihen që tani në tregun tonë. Në shumë tregje filluan të shiten më shumë fruta, zarzavate, bulmet e mish, kanë filluar të vihen

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 122.

nëpër dyqanet mallra industrialë, veçanërisht kinkalери, që janë rezerva të ish-tregëtarëve. Çështja qëndron tani që këto masa në drejtim të tregëtisë së vogël dhe të artizanatit privat të kuptohen drejt nga të gjithë komunistët dhe nga shokët pa parti që punojnë në organet shtetërore, të mos ngurrohet në zbatimin e tyre, pse, zbatimi sa më mirë dhe sa më shpejt i këtyre masave do të bëjë që të sillen në qendrat konsumatore prodhime bujqësore e blegtorale nga vendet prodhuese në thellësi. Prodhime të reja do të dalin në treg nga artizanati i vendit tonë, i cili ka mjeshtër të dalluar. Por Partia njëkohësisht duhet të forcojë vigjilencën dhe kontrollin e saj mbi tregëtarët privatë, që këta të mos spekulojnë mbi masat punonjëse.

Detyrat imediate për ngritjen e nivelit të jetës së punonjësve

Masat që mori Byroja Politike dhe qeveria, për të cilat folëm më lart dhe përdorimi i drejtë i investimeve në planet tona të ardhshme, do të kontribuojnë drejtpërsëdrejti në një përmirësim të gjendjes sonë ekonomike. Gjithashtu Byroja Politike mendon se për kapërcimin e vështirësive të tanishme, është e domosdoshme të kërkojmë edhe një herë ndihmën e Bashkimit Sovjetik dhe të demokracive popullore që përveç çka u thanë më lart për naftën dhe shtyrjen e kësteve, të kërkojmë kredi të reja për bujqësinë dhe për mallra konsumi. Por, për përballimin e situatës, në të gjithë punën tonë, duhet të bëhet një kthesë vendimtare, që

nga ne si drejtues, gjithë komunistët, të rinjtë popullorë dhe gjithë punonjësit duhet të vlerësojmë drejt situatën që po kalojmë, të forcojmë disiplinën në punë dhe të luftojmë në mënyrë më energjike kundër atyre që në një mënyrë ose në një tjetër pengojnë dhe çorگانizojnë prodhimin tonë socialist. Çdo punëtor i ndërgjegjshëm duhet të realizojë me vendosmëri planin e tij, të ruajë maqinerinë, të kursejë materialin dhe të nxjerrë mall me cilësi më të mirë. Tendencat që janë në shumë drejtues dhe punonjës për të prodhuar si sasi pa parë cilësinë, duhet të konsiderohen të dëmshme dhe të dënueshme. Shumë dobësi paraqiten në punën tonë: planet tona në shumë sektorë nuk po realizohen në një mënyrë të kënaqshme; cilësia e prodhimit është e dobët, maqineria dhe ndërtesat nuk mirëmbahen; kemi shpërdorime dhe dëmtime të pasurisë së popullit dhe shumë të tjera. Këto dobësi që vërtetohen pengojnë seriozisht përmirësimin e jetës dhe u lënë shteg armiqve që të na dëmtojnë. Parimi i kursimit, lufta për të shfrytëzuar në maksimum materialet e prodhuara në vend për mallra të konsumit, është shumë e paktë. Duhet t'ja bëjmë të qartë gjithë Partisë situatën reale, se mosnjohja e saj e vë atë në një vetëkënaqësi dhe e bën që të kërkojë luks dhe kërkesa të fryra. Ja p.sh. megjithëse kemi 6 muaj që po flasim për shkurtime investimesh, shokët e Gjirokastrës dhe të Tiranës kanë kërkuar për investimet lokale të vitit 1954 afër 500 000 000 lekë, që po të llogariten edhe për qarqet e tjera për ndërtime të lokaleve në këtë proporcion do të arrinin shifrën 1 miliard dhe 500 milion lekë vetëm për ndërtim lokalesh kundrejt 1 miliard e 800 milion

lekë që mendohen të jenë gjithë ndërtimet për vitin 1954. Veç kësaj shumë i mbajnë sytë nga importi. Ne e paraqitëm më lart konkretisht ndihmën e Bashkimit Sovjetik dhe të demokracive popullore dhe situatën lidhur me import-eksportin. Ne do të mbështetemi në ndihmën e Bashkimit Sovjetik e të demokracive popullore dhe ato do të na ndihmojnë, por ne nuk duhet të harrojmë kurrë burimet e mëdha të brendshme për të shtuar prodhimet. Ne sot kemi ngritur një industri mjaft të gjerë, e cila ka mundësi të sigurojë një pjesë të madhe të nevojave tona. Ne kemi artizanë mjeshtër të mirë. Shfrytëzimi i plotë i industrisë, zgjerimi i artizanatit, përmirësimi i cilësisë janë detyra të mëdha për Partinë. Njerëzit e Partisë në ndërmarrje dhe gjithë drejtuesit duhet të marrin masa organizative konkrete për zgjerimin e prodhimit, si p.sh. pranë kombinateve, fabrikave, uzinave, duhet të ngrihen sa më shpejt reparte ndihmëse për të prodhuar mallra të ndryshme konsumi me mbeturinat, me skarcot, pa dëmtuar orientimin kryesor të prodhimit. Edhe organet e planit duhet të studjojnë dhe të ndihmojnë konkretisht për këtë.

Ne duhet të shtojmë kujdesin për trajtimin e punëtorëve. Duhet të krijojmë kondita më të mira pune dhe investimet tona në të ardhshmen duhet të shtohen në këtë drejtim, por detyra e Partisë është t'i edukojë ata që t'i përdorin siç duhet frutet e këtyre investimeve dhe të mirëmbajnë godinat ekzistuese. Pastërtia nuk është aspak e mirë në qendrat e punës e në fjetoret e ndërmarrjeve; ka dëmtime të palejueshme dhe higjiena lë shumë për të dëshiruar. Organizatat e Partisë, ato të rinisë dhe bashkimet profesionale, duhet të shkunden

për të forcuar disiplinën dhe për rritjen e ndërgjegjes së punëtorëve, sepse shumë përmirësime në jetën e punonjësve varen këndeje.

Lidhur me zhvillimin e bujqësisë, veç detyrave të rëndësishme që ne kemi për ta ndihmuar me investime në planet e ardhshme, duhet të marrim dhe këto masa të menjëhershme.

a) Ne duhet të rritim prodhimin e drithërave të bukës (grurë, thekër, misër). Duhet të arrijmë sa më shpejt në sigurimin e bukës në vend. Vazhdimi i importit të sasive të mëdha drithi nga viti në vit, jo vetëm që rëndon bilancin tonë të importit, por mjaft herë na ka vënë në situata të vështira në sigurimin e bukës së popullit. Për pambukun ne duhet të orientohemi në prodhimin e sasisë së mjaftueshme për Kombinatin e tekstileve «Stalin» në radhë të parë dhe pastaj për eksport. Dhe sasinë e nevojshme të pambukut dhe të panxharit duhet ta nxjerrim duke u caktuar këtyre kulturrave toka të përshtatshme që të rritet rendimenti.

Në drejtim të rritjes së rendimentit të drithërave, ne duhet të orientojmë ndihmën tonë për fshatin si: kredi për kanale të vogla, vegla pune të prodhuara në vend dhe të sjella nga importi, farëra të zgjedhura për të cilat tashti kemi një eksperiencë më të mirë, plehra kimike në sasi të mëdha. Eksperienca shumëvjeçare e fshatarit tonë në mbjelljen e grurit, të misrit dhe të thekrës, duhet të bëhet një mbështetje e madhe për gjithë Partinë e sidomos për teknikët tanë të rinj në prodhimin e drithërave. Ata i njohin mirë tokat e tyre për prodhimin e drithërave dhe të llojeve të tyre, prandaj duhet të dëgjojmë më shumë zërin e tyre. Fermat

shtetërore dhe kooperativat bujqësore, që këto vitet e fundit kanë pasur në përgjithësi rendimente më të mira në prodhimin e drithërave e sidomos të grurit, duhet të bëhen mbështetje e madhe për gjithë fshatarësinë individuale në shtimin e prodhimit të drithit.

Përveç detyrimit në natyrë, burimi kryesor për rritjen e fondit shtetëror të drithërave duhet të jetë grumbullimi i tepricave nga fshatarësia me anën e shkëmbimit të mallrave industriale, si dhe duke i blerë nga ana e shtetit në tregun e lirë me çmime të leverdisshme për fshatarin. Të dyja këto forma grumbullimi duhet të rriten në të ardhshmen. Ne prodhuam sivjet rreth 2 902 000 kv. bereqet, sasi kjo që plotëson gati nevojat tona për bukë. Sigurisht ky ishte një vit i mbarë për bujqësinë dhe tepricat janë në duart e fshatarëve, por me një punë më të mirë në të ardhshmen, ne duhet jo vetëm ta mbajmë të qëndrueshme këtë sasi, por ta rritim.

Ne duhet të marrim masa që të kufizohet sa më tepër shpërndarja e padrejtë e bukës dhe këtë problem duhet ta studjoni shpejt organet e shpërndarjes.

b) Partinë duhet ta preokupojë më tepër gjendja jo e mirë e blegtorisë. Pakësimi i qeve të punës është katastrofal, gjithashtu e pakënaqshme është gjendja e gjithë blegtorisë. Detyra jonë imediate është të marrim masa për sigurimin e bazës ushqimore për të. Ne duhet të hapim dhe të spastrojmë kullotat, duhet të ristudjohen kullotat që disponon shteti, pse ato mund të jenë të tepërta për bagëtitë shtetërore. Ne duhet të rishikojmë dhe t'i bëjmë më të studjuara planet tona të pyllzimeve dhe atë 15-vjeçar të ullinjve që këto plane

të mos bien mbi kurriz të kullotave. Ne jemi një vend malor, populli ynë është marrë shumë me blegtori dhe kjo i ka të gjitha mundësitë që të zhvillohet, prandaj duhen inkurajuar fshatarët të shtojnë bagëtitë e tyre duke u siguruar kullota rreth fshatrave. Duhet t'u nxjerrim atyre frikën që i ka kapur se po të shtojnë bagëtinë, shteti ua merr, i taton rëndë, ose i cilëson kulakë. Ne duhet të krijojmë bindje në fshatarët individualë se me masat e marrura nga Partia ne kemi qëllim të ngremë nivelin e jetës së tyre. Ne duhet të punojmë shumë që fshatari ta kuptojë mirë se Partia dhe qeveria i kanë parasysh hallet e tyre dhe do të ndihmohen për të dalë nga vështirësitë.

c) Një kujdes të veçantë duhet të tregojnë organet e Partisë dhe ato të bujqësisë për rritjen e prodhimit të duhanit, i cili paraqet leverdi ekonomike të mëdha për eksportin tonë. Mjafton të përmendim se në vitet 1950-1952 ne kemi realizuar nga eksportimi i tij një shumë komplekse mbi 4 000 000 rubla. Mundësitë janë të tilla që eksportimi i duhanit të dyfishohet brenda 2-3 viteve të ardhshme. Është e nevojshme që për këtë të bëhet rajonizimi i tokave të duhanit, të studjohen llojet më të përshtatshme për zonat e rajonit ku rritet kjo kulturë. Të rritet kapaciteti i depove ekzistuese në mënyrë që të përballohet depozitimi.

ç) Ne duhet të shtojmë shpejt prodhimin e patateve, të fasuleve dhe të zarzavateve, që janë të domosdoshme për qytetet dhe për qendrat e punës si dhe për vetë fshatarët.

d) Për kooperativat bujqësore orientimi ynë duhet të jetë forcimi i kooperativave ekzistuese që në të

vërtetë ato të bëhen shembull dhe baza të socializmit në fshat. Byroja Politike ka vënë re se organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit akoma nuk njohin mirë problemet e kooperativave bujqësore dhe prandaj nuk japin ndihmën e duhur për forcimin e tyre. Duhet të evitohet përsëritja e gabimeve që arrin deri në shkeljen e principit të vullnetarizmit, të dënohen shfaqjet e arbitraritetit, të mospërfilljes së vërejtjeve nga anëtarët e thjeshtë dhe në përgjithësi mosrespektimi i plotë i statutit të kooperativave bujqësore, që ndodh në shumë raste. Organizatat e Partisë duhet të sigurojnë forcimin e rregullit të brendshëm, të disiplinës në punë, pjesëmarrjen aktive të anëtarëve në prodhim, forcimin e organizimit dhe të llogarisë dhe ngritjen e vazhdueshme të nivelit kultural, politik dhe profesional të anëtarëve të kooperativave bujqësore.

Në sektorin e ndërtimeve: Plani i investimeve të përgjithshme të pakësohet në krahasim me parashikimet e planit pesëvjeçar. Të caktohen për ndërtime objekte më pak të kushtueshme, që japin efekt të shpejtë dhe që influencojnë më shumë në shtimin e prodhimit bujqësor dhe industrial në mallra të konsumit të gjerë.

Në objektet e filluara që nuk janë të kësaj natyre, të ngadalësohet ritmi i punimeve duke zgjatur afatin e përfundimit të tyre. Të tregohet kujdes për meremetimin dhe për ndërtimin e banesave të punonjësve në qendra pune dhe në qytete, duke bërë ndërtime të thjeshta dhe ekonomike, duke hequr dorë një herë e mirë nga çdo ndërtim luksi.

Në sektorin e industrisë dhe të artizanatit: Detyra kryesore e Partisë dhe e organeve të pushtetit në këtë sektor duhet të jetë që të arrihet shfrytëzimi në maksimum i industrisë ekzistuese, për të prodhuar sa më shumë mallra konsumi të gjerë me cilësi të mirë, me asortimente dhe me kosto të ulët. Industria lokale dhe artizanati të shfrytëzojnë mirë lëndën e parë që prodhohet në vend dhe mbeturinat e industrisë nacionale. Të inkurajohet zgjerimi i punishteve të artizanëve privatë, veçanërisht për lëndë ndërtimi, lëndë djegëse dhe shërbime për ekonomitë fshatare. Të inkurajohen gjithë aktivitetet ndihmëse në fshat për shtimin e prodhimit.

Në industrinë e nxjerrjes së naftës, të bakrit dhe të bitumit, të zgjerohen kërkimet gjeologjike dhe në industrinë e nxjerrjes së kromit t'i jepet më shumë rëndësi shtimit të prodhimit për t'u bërë artikuj bazë për eksportin. Të vazhdoen me një ritëm më të madh si kërkimet ashtu dhe shfrytëzimi i prodhimit në qymyret, për të siguruar funksionimin pa ndërprerje të industrisë, si dhe për t'u përdorur për ngrohje.

Në sektorin e tregëtisë, të komunikacionit dhe të kooperativave: Të përmirësohet shërbimi i popullit dhe të organizohet një shpërndarje më e mirë e mallrave. Organet e tregëtisë duhet të sigurojnë në radhë të parë tregun e garantuar. Të shtohen mallrat e konsumit të gjerë dhe të merren masa urgjente për plotësimin me mallra dhe gjallërimin e tregut.

Shokë, ne analizuam në këtë raport gjendjen ekonomike të popullit tonë. Analizuam vështirësitë që po

hasim për ngritjen e mëtejshme të mirëqenjes së popullit, treguam masat që kanë marrë Byroja Politike dhe qeveria për përmirësimin e mëtejshëm të nivelit të jetesës së masave punonjëse dhe caktuam detyrat që u dalin Partisë, pushtetit dhe gjithë masave punonjëse në të ardhshmen. Detyrat që i vihen përpara Partisë në këtë situatë ekonomike janë të rëndësishme dhe të ngutshme. Ne e konsiderojmë të ngutshme shpejtimin e ngritjes së nivelit të jetës së masave punonjëse të vendit se ky është qëllimi i revolucionit tonë popullor, është ligji i socializmit. Ne e konsiderojmë si një çështje kapitale, forcimin e aleancës në mes klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse nëpërmjet këtyre masave. E gjithë puna jonë e kryer deri tani, të gjitha përpjekjet tona në fushën ekonomike kanë pasur për qëllim ngritjen e nivelit të masave punonjëse dhe forcimin e kësaj aleance. Masat që janë marrë kanë kontribuar direkt në këtë përmirësim, pse përmirësimet në jetën e popullit tonë janë të dukshme me gjithë mungesat dhe dobësitë që përmenden.

Në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë sonë, në saje të përpjekjeve të masave punonjëse, në saje të ndihmës së BS dhe të demokracive popullore, ekonomia dhe kultura kanë bërë hapa të mëdhenj në rrugën e përparimit. Udhëheqja e Partisë, në një të ardhshme të shpejtë, do të marrë në analizë të imtë realizimin e planit të vitit 1953 dhe planin e vitit 1954, por ne në këtë plenum po nxjerrim dobësitë dhe të metat, ato të meta e dobësi që janë të shumta e që na pengojnë të ecim përpara. Partia vazhdimisht na mëson të zbulojmë të metat, t'i vëmë në dukje gabimet dhe të

marrim masat për likuidimin e tyre. Ne duhet të forcojmë disiplinën në punë për realizimin e planeve tona. Duhet t'i edukojmë njerëzit dhe të ngremë ndër-gjegjen e tyre që t'u dhimset malli i popullit, të jenë shumë vigjilentë, të godasin pa mëshirë armikun e klasës në fshat e në qytet dhe të mos kursehen për asgjë kur është çështja për t'i shërbyer popullit. Vësh-tirësitë që ne po hasim në ndërtimin e socializmit me siguri do t'i kapërcejmë, se uniteti dhe disiplina jonë është shumë e fortë, se bashkimi i popullit tonë rreth Partisë është bërë sot më i fortë se kurdoherë.

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

**TELEGRAM URIMI DËRGUAR SHOKUT
MAO CE DUN ME RASTIN E 60-VJETORIT
TË DITËLINDJES**

26 dhjetor 1953

**PRESIDENTIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË
KOMUNISTE TË KINËS
KRYETARIT TË QEVERISË POPULLORE QENDRORE
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS
SHOKUT MAO CE DUN**

P e k i n

Me rastin e 60-vjetorit të ditëlindjes Suaj lutem pranoni, shoku Mao Ce Dun, urimet më të nxehta të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të miat personale.

Partia jonë dhe populli ynë përshëndetin në personin Tuaj udhëheqësin dhe mësuesin e popullit të madh kinez, themeluesin e Republikës Popullore të Kinës. Partia Komuniste Kineze ka udhëhequr popullin e madh të Kinës në fitoren e revolucionit të tij popu-

llor, i cili këputi zinxhirët e skllavërisë dhe i dha një grusht dërmues sistemit botëror të imperializmit. Duke ndjekur besnikërisht mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, Ju udhëhiqni sot Republikën Popullore të Kinës në rrugën e zhvillimit të saj demokratik dhe të ndërtimit të një jete të re, të lidhur me një miqësi luftarake me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet e demokracisë popullore.

Me rastin e 60-vjetorit të ditëlindjes Suaj, Partia jonë dhe populli ynë ju urojnë me gjithë zemër jetë të gjatë dhe shëndet të plotë, që të udhëhiqni gjithnjë me sukses Partinë Komuniste dhe popullin kinez në rrugën e ndërtimit të socializmit, për mbrojtjen dhe forcimin e paqes në botë.

Sekretari i Përgjithshëm i PPSH dhe
Kryetari i Këshillit të Ministrave të RPSH

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 310 (1636), 26 dhjetor 1953*

*Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 310 (1636),
26 dhjetor 1953*

MBI PUNËN E PARTISË NË MINIERËN E BAKRIT «1 MAJ» TË RUBIKUT

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

28 dhjetor 1953

Ti, shoku sekretar² je i ri, ke pak kohë që punon në këtë minierë, por këtej e tutje, bashkë me byronë e organizatës bazë do të kërkojmë llogari të plotë, pse ju jeni në krye të udhëheqjes së Partisë të minierës në Rubik dhe përgjigjeni që të realizohet plani i shtetit, që të mobilizohen punëtorët, komunistët, rinia dhe të zhduken të metat që kanë ekzistuar. Gjithashtu, Komiteti i Partisë i Rrëshenit, duhet të kuptojë rolin e tij; deri tani ai nuk ka punuar mirë dhe ka harruar

¹ Në këtë mbledhje të Sekretariatit të KQ të PPSH, u shqyrtua puna e organizatës së Partisë në Minierën e bakrit «1 Maj» lidhur me realizimin e planit dhe me perspektivat e minierës.

² I drejtohet Gjergj Prengës sekretar i organizatës bazë të Partisë të minierës, që merrte pjesë në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH.

që miniera është e një rëndësie të madhe. Ju, byroja e organizatës bazë, ti si sekretar, duhet të jeni në korrent të mjaft çështjeve në minierë; në punën e administratës do të ketë shfaqje të burokratizmit, prandaj organizata e Partisë duhet të luftojë me këmbëngulje kundër tyre. Ju nuk duhet të trembeni nga ata që janë teknikë, duke menduar se «ata dinë më shumë». Në rast se komunistët zotërojnë mirë situatën, do të jenë në gjendje të njohin edhe problemet që ka miniera, pra do të dinë të drejtojnë edhe nga ana teknike. Ekspierienca tregon se atje ku komunistët qëndrojnë në lartësinë e detyrave të tyre dhe të rolit pararojë, i kanë të gjitha mundësitë jo vetëm të kenë në dorë situatën, por me shembullin e tyre të udhëheqin edhe të tjerët e të kenë plotësisht besimin e tyre. Ti, si sekretar i organizatës bazë të Partisë duhet të jesh afër drejtorit, i cili sigurisht, nuk duhet të të mbulojë me diturinë e tij, por të të afrojë, të kërkojë ndihmën tënde e ti duhet të kesh respekt për ndihmën e tij, për diturinë e tij, por edhe ai të ketë respekt për detyrën tënde si sekretar i organizatës bazë. Organizata bazë e Partisë duhet t'u kërkojë llogari drejtuesve të minierës, të cilët jo vetëm të japin urdhëra, por edhe të dëgjojnë vërejtjet e sugjerimet e të tjerëve, të komunistëve dhe të punëtorëve. Nga ana tjetër ju duhet të punoni që punëtorët të jenë të ndërgjegjshëm, që ligjet si edhe rregullat e detyrat e ndërmarrjes t'i zbatojnë mirë, kurse kur shikojnë ndonjë gjë të padrejtë, ata nuk duhet të kenë frikë, por të kritikojnë me kurajë dhe të kërkojnë që të përmirësohet puna. Njerëzit kur janë në rrugë të drejtë duhet të luftojnë pa frikë.

Ne e dimë që në minierë puna është shumë e vështirë dhe në qoftë se ju nuk interesoheni për jetesën e punëtorëve, atëhere realizimi i planit nuk mund të shkojë mirë. Ti, si sekretar i organizatës bazë, duhet të jesh kudo, në mes të punëtorëve, ty duhet të të vijnë njerëzit dhe të të thonë për hallet e veta, ata duhet të shikojnë te sekretari i Partisë një njeri të dashur të tyre, që interesohet për ta. Prandaj, t'u dëgjohen e t'u zgjidhen hallet e tyre personale dhe të familjes. Punëtorët të shikojnë se në punë kërkohet disiplinë, por edhe kur ata kanë ndonjë nevojë, zëri u dëgjohet dhe kërkesa u zgjidhet shpejt e me kujdes dhe nuk mbahet mëri ndaj ndonjërit, që më parë mund të ketë bërë gabime, psc këtë nuk e lejon Partia. Pra, punëtorët ta kenë Partinë mbështetjen e tyre kryesore. Në qoftë se ndonjëri nga drejtuesit e minierës nuk e zbaton mirë këtë porosi të Partisë dhe nuk u vë veshin kërkesave të drejta që kanë punëtorët, i bën mirë të futet brenda në galeri e të punojë në kushtet e punëtorëve, që të kuptojë më mirë edhe hallet e tyre.

Ju, shokët e byrosë së organizatës bazë, jo vetëm duhet të dini planin e minierës, por dhe kur bëhet plani, sekretari duhet të jetë i pranishëm dhe mandej të kërkoni nga punëtorët e drejtori që ky plan të zbatohet. Kur plani është konkret dhe nuk realizohet, atëhere t'u kërkohet llogari drejtuesve, komunistëve e punëtorëve dhe të kritikohen ata që nuk e kryejnë mirë detyrën. Në qoftë se furnizimi nuk është në rregull, të vihet përpara përgjegjësisë ai që merret me këtë punë.

Ju duhet të aktivizoni në punën tuaj bashkimet profesionale dhe organizatën e rinisë. Rinia duhet të

bëhet atje mbështetje e madhe e organizatës së Partisë. Kur merret një vendim në byronë e organizatës së Partisë, ky t'u komunikohet bashkimeve profesionale dhe rinisë, të cilat të marrin menjëherë masat përkatëse.

Komiteti Qendror i Rinisë të dërgojë në minierë një funksionar të rinisë duke e hequr nga ndonjë vend tjetër, pa qenë nevoja të shtohet në organikë.

Ministria e Bujqësisë është ngarkuar që, në qendrat industriale të shikojë çështjen e ekonomive ndihmëse, me qëllim që ato të forcohen dhe jeta e punëtorëve të përmirësohet. Megjithkëtë, për këtë problem duhet të interesohet edhe vetë Komiteti i Partisë i qarkut të Shkodrës, prandaj ju të bëni studimet, të cilat t'ja paraqitni Ministrisë së Bujqësisë. Kjo nuk duhet bërë vetëm për Minierën e Rubikut, por për të gjitha qendrat e mëdha industriale që ka në Shkodër. Gjithashtu duhet të interesoheni për një furnizim më të mirë të minierës, pse edhe për t'i marrë makaronat duhet shkuar deri në Shkodër; pra ju duhet të interesoheni më tepër për ushqimet, veshmbathjen, për librat, kurset e kualifikimit etj. Tani do të dalë vendimi i Komitetit Qendror të Partisë, në të cilin do të thuhet që 80 për qind e orendive që do të prodhohen, do të jenë për nevojat e popullit, ndërsa vetëm 20 për qind do të jenë për zyrat; kjo është një gjë shumë e madhe dhe duhet të zbatohet me rigorozitet ashtu si të gjitha detyrat e tjera që shtron Komiteti Qendror dhe qeveria.

Ti, si sekretar i organizatës, duhet të mbështetesh mirë në komunistët dhe, me shokët e byrosë duhet të bisedosh dhe të diskutosh; të kritikoni njëri-tjetrin dhe të mos ju rritet mendja me rezultatet e arritura.

Vendimet t'i merrni të përbashkëta, udhëheqja e byrosë të jetë e fortë dhe të bëhet mbështetje për punëtorët. Kur kenë nevojë për ndihmë, shkoni deri në Shkodër te sekretarët e komitetit të Partisë të qarkut.

Njerëzit e Mirditës janë të zgjuar e të zot, prandaj miniera duhet të bëhet një qendër me rëndësi për të përhapur dritën dhe kulturën. Dhe ne kemi bindje se kështu do të bëhet.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**MBI PUNËN QË DUHET TË BËJNË
NË ORGANIZATAT E TYRE DELEGATËT
QË MARRIN PJESË NË KONFERENCAT E PARTISË**

Letër udhëzuese

4 shkurt 1954

**BYROSE PROVIZORE TË KOMITETIT TË PARTISË
TË QARKUT
DREJTORISË POLITIKE TË USHTRISË POPULLORE
DEGËS POLITIKE TË REPARTEVE TË MP TË
BRENDSHME
DEGËS POLITIKE TË POLICISË POPULLORE**

Tiranë

Shokët delegatë që morën pjesë në konferencat e Partisë të rretheve duhet të japin llogari para organizatave bazë që i kishin zgjedhur se si i shpunë në konferencën e Partisë porositë e tyre, çfarë diskutuan dhe si i trajtuan problemet, gjithashtu çfarë mësuan nga punimet e konferencës së Partisë. Të kenë parasysh, në radhë të parë, detyrat që u dalin organizatave bazë nga vendimi i Plenumit të Dhjetorit 1953 të Komitetit

Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe vendimet e konferencës së Partisë të rrethit. Vetëm në këtë mënyrë çdo delegat kryen plotësisht detyrën e ngarkuar nga organizata bazë.

Një veprim i tillë e ngre edhe më lart rolin e delegatit, nxit aktivitetin e tij në konferencën e Partisë dhe, nga ana tjetër, rrit përgjegjësinë e tij para organizatës së Partisë që e zgjodhi.

Po në këtë mbledhje të organizatës bazë duhet të orientohen delegatët, që do të shkojnë në konferencën e Partisë të qarkut, mbi çështjet që duhet të ngrenë atje. Kur nga një organizatë bazë janë tre ose më shumë delegatë, që do të marrin pjesë në konferencën e Partisë të qarkut, ata mund të merren vesh midis tyre se kush do të diskutojë dhe çfarë mendojnë të trajtojë. Ata shokë që nuk do të kenë mundësi të diskutojnë në konferencë, diskutimet e tyre t'i japin me shkrim.

Duhet të merren masa që mbledhjet e organizatave bazë për këtë qëllim të organizohen para zhvillimit të konferencave të Partisë në qarqe.

Për Komitetin Qendror të PPSH

Sekretari i Përgjithshëm

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**NGA REDAKSIA E RADIO TIRANËS KËRKOHEM
NJË ORGANIZIM DHE NJË DREJTIM
MË I MIRË I PUNËS**

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

8 shkurt 1954

Puna e Partisë nëpërmjet radios ka rëndësi të veçantë, prandaj ne bëjmë mirë që në këtë mbledhje të Sekretariatit marrim në shqyrtim disa probleme të radios të cilat na preokupojnë. Një nga këto probleme është edhe muzika. Mendoj që materialin muzikor ekzistues ta shfrytëzojmë mirë, por në këtë fushë të ruhen më drejt proporcionet në programet e muzikës popullore, që të ketë nga të gjitha anët e vendit, që nga Shkodra deri në Gjirokastër e kështu me radhë. Filarmonia e shtetit ka për detyrë t'ju ndihmojë me anë të inçizimeve të pjesëve të ndryshme, në bazë të një programi të caktuar. Për-

¹ Në këtë mbledhje, ku morën pjesë edhe disa drejtues të radios, u shqyrtua relacioni «Mbi gjendjen e Radio Tiranës dhe masat për përmirësimin e saj».

veç kësaj, ju duhet të organizoni më mirë edhe punën për të zbuluar talentin e njerëzve që këndojnë bukur, të cilët t'i regjistroni, t'i zgjidhni, që programet e radios t'i pasuronit gjithmonë me këngë të reja dhe me zëra të rinj.

Këtu dalin edhe një sërë vështirësish të karakterit teknik e financiar. Është e drejtë që radioja ka aparate, të cilat duhen vënë në funksionim në dhoma të caktuara e të përshtatshme, por sot për sot ne nuk kemi mundësi të ndërtojmë një godinë të re, prandaj, për të zgjidhur aktualisht problemin, të rregullohen ato dhoma që kemi. Edhe kërkesa për përmirësimin e rrjetit të radios gjithashtu është e drejtë, pse fshatari te ne më tepër dëgjon radion se sa lexon gazetën, por tani për tani edhe kjo është vështirë të zgjidhet. Sigurisht, në perspektivë kjo kërkesë do të plotësohet, prandaj jam i mendimit që çështjen t'ja rekomandojmë ta studjojë qeveria.

Me shkurtimet që u bënë edhe në kuadrin e aparatit të radios mbetën kuadrot më të kualifikuar, më të mirë. Tani detyra e tyre është që të ndryshojnë akoma më tepër metodën e punës, të përmirësojnë stilin në punë. Kjo, mendoj, është kryesorja për të pasur më shumë suksese. Kërkesa që u bë këtu për të shtuar disa kuadro mund të shikohet konkretisht dhe, po që nevoja, kjo të zgjidhet. Këto raste, pasi të studjohen, t'ja referojmë Byrosë Politike, pse ajo ka dhënë porosi që të mos bëhen shtesa në organikat, por megjithkëtë, kur është e nevojshme, ato mund të shikohen.

Me rëndësi të veçantë është çështja e bashkëpunëtorëve të radios. Po të zgjidhen me kujdes e të vihen në lëvizje, mendoj se ata janë një ndihmë e madhe. Njerëzit për bashkëpunëtorë të radios nuk mungojnë, puna

është që të dimë t'i tërheqim ata dhe t'i mbajmë në lidhje, t'i orientojmë, t'i mbajmë afër që ata ta kenë të qartë përse dhe si të ndihmojnë në propagandën e Partisë me anë të radios.

Ju ankoheni se nuk ka lajme, ndërsa unë mendoj se s'është ashtu, pse shfrytëzimi i shtypit të Partisë është një rezervë e madhe për radion dhe, po të organizohet mirë puna me redaksitë e gazetave, lajme ka mjaft. Sigurisht, nuk duhet mjaftuar me ato që ka shtypi, duke e marrë çdo gjë të gatshme prej tij. Është e domosdoshme që të punojnë e të krijojnë edhe vetë punonjësit e radios; kështu, për shembull, mund të bëhen reportazhe të gjalla nga puna konkrete e punëtorëve dhe e punonjësve e të jepen me anë të radios, kjo ka rëndësi të madhe. Ju duhet të përgatiteni që më parë dhe që këtu në qendër se çfarë gjërash do të kërkonin nga njerëz të dalluar e të aftë, të cilët do të ftohen në studio për të folur.

Në të gjitha këto aktivitete nuk duhet harruar fshatit, i cili ka fushata të mëdha që duhen propaganduar e që kërkojnë mobilizimin e gjerë të punonjësve të bujqësisë. Kjo duhet organizuar mirë. Për shembull, në redaksinë e radios ka një njeri i cili merret me problemet e fshatit. Tani ndodhemi para mbjelljeve të pranverës, fushatë kjo me rëndësi, për të cilën Komiteti Qendror i Partisë ka dhënë udhëzimet përkatëse. Punonjësi i radios që ka sektorin e bujqësisë, duhet të marrë vendimet e Byrosë Politike ose të Sekretariatit, t'i studjojë ato e të nxjerrë një program pune se çfarë duhet vënë në dukje këtë javë, çfarë javën tjetër e kështu me radhë. Këtej lind edhe nevoja që njerëzit, të cilët punojnë në radio,

të specializohen mirë në sektorët ku janë. Kështu do të rritet edhe cilësia e propagandës në radio, në rubrikat e ndryshme të saja.

Nga të gjitha këto del se në radio ka një rëndësi të madhe organizimi dhe drejtimi i mirë i punës. Në problemet kryesore që preokupojnë Partinë dhe popullin, ju duhet të shikoni e të kryeni detyrat tuaja, të zbërtheni e të zbatoni direktivat e Komitetit Qendror dhe të qeverisë, të shfrytëzoni mirë edhe materialet e ATSH-së dhe të shtypit tonë. Duke forcuar më shumë punën, ne kemi besim se Radio Tirana do t'i kryejë me nder detyrat e saja të mëdha.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekreta-
riatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**JO VETËM TË KËRKOJMË NGA PUNËTORËT
REALIZIMIN E PLANIT, POR TËU PLOTËSOJMË
ATYRE EDHE KUSHTET E NEVOJSHME TË PUNËS
E TË JETËS**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

16 shkurt 1954

Në mars të vitit 1953, Sekretariati i KQ të PPSH, pas analizës që i bëri punës së Partisë në Minierën e qymyrgurit të Memaliajt kishte marrë edhe një vendim. Për të kontrolluar zbatimin e këtij vendimi, u thirrën në Sekretariatit e Komitetit Qendror, sekretari i organizatës bazë dhe drejtori i minierës. Shoku Enver Hoxha, në fillim, nëpërmjet disa pyetjeve, u interesua për përmirësimin e kushteve të punës dhe të jetës së punëtorëve; për aktivizimin e personelit inxhiniero-teknik jo vetëm në fushën e prodhimit, por edhe si aktivistë shoqërorë; nëse vete ose jo shtypi i Partisë të punëtorët dhe sa le-

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit të paraqitur nga një ekip i Komitetit Qendror «Mbi punën e Partisë në Minierën e qymyrgurit në Memaliaj».

xohet ai prej tyre; si shtrohen në organizatën bazë vendimet e komitetit të Partisë të rrethit dhe a bëhen diskutime e vërejtje rreth tyre; a vihen në dijeni punëtorët për vendimet që merr organizata bazë e Partisë etj. etj.

Pasi u dhanë përgjigjet për këto çështje nga sekretari i organizatës bazë dhe pas diskutimeve që u zhvilluan nga shokët e Sekretariatit dhe shokët e tjerë të ftuar, në përfundim të mbledhjes e mori fjalën shoku Enver, i cili tha:

«Ne dëgjuam me vërejtje diskutimet që u bënë në këtë mbledhje. Dëshiroj të them edhe unë pak fjalë.

Çështja e qymyrgurit ka rëndësi mjaft të madhe për Republikën Popullore të Shqipërisë, për industrinë tonë nacionale. Megjithëse problemi i qymyrit e ka preokupuar Byronë Politike dhe qeverinë, ne prapëseprapë mund të themi se këtij sektori duhet t'i japim një ndihmë akoma më të madhe. Sektori i minierave është një nga sektorët më të nevojshëm, të rëndësishëm dhe të vështirë për ekonominë e vendit tonë.

Në radhë të parë komunistët dhe punëtorët e minierave të qymyrit, duhet të kuptojnë mirë, se nga puna e tyre varet funksionimi i rregullt i industrisë sonë kryesore. Kur ka të meta në këto miniera, çalon edhe industria. Nga qymyri varet funksionimi i hekurudhës, prodhimi i sheqerit, i çimentos e shumë e shumë gjëra të tjera, që kanë të bëjnë me përmirësimin e jetesës së popullit tonë.

Është e drejtë që ne të kërkojmë deri në fund zbatimin e detyrave nga drejtuesit e minierave, por të mos harrojmë se të meta serioze ka edhe këtu lart. Kështu,

për shembull, Byroja Politike ka shtruar çështjen e trajtimit të mirë të minatorëve, por praktikisht vendimet që janë marrë për këtë qëllim nuk po zbatohen si duhet. Trajtimi i punëtorëve është përmirësuar, por ka akoma nevoja të paplotësuara. Disa detyra në këtë fushë janë realizuar me vonesë të madhe. Prandaj, me rekomandimin e Byrosë Politike, qeveria do ta ndjekë këtë çështje në një mënyrë të veçantë, sepse punëtorëve jo vetëm duhet t'u kërkojmë realizimin e planit, por duhet t'u plotësojmë edhe kushtet e nevojshme të punës e të jetës.

Ka mjaft sektorë të industrisë që kanë edhe ata nevoja, por minierat duhet të kenë më tepër precedencë. Konkretisht për Minierën e Memaliajt, duhet të shikohet mundësia e çlodhjes së punëtorëve dhe e përmirësimit të jetesës së tyre. Përveç të tjerave, duhet parë çështja e ndërtimit të shtëpiave për punëtorët. Ne do t'i propozojmë qeverisë të studjojë që tani se ç'mundësi të tjera ka për të përmirësuar më tej trajtimin e punëtorëve në minierë.

Siç dihet, pagat e punëtorëve të minierës u ngritën, por duhet të mendohet se si do t'i harxhojnë ata të hollat që marrin. Kjo do të thotë që, në radhë të parë tani t'i jepet rëndësi furnizimit. Megjithëse qeveria ka marrë vendim që punonjësit e minierave dhe të ndërtimit, veçanërisht të minierave, të furnizohen më përpara se të gjithë, kjo nuk është vënë si duhet në zbatim për faj të dikasterit.

Puna e punëtorëve të qymyrgurit është shumë e rëndë. Punëtorët e minierave vijnë nga fshati dhe akoma nuk janë formuar si punëtorë. Ne duhet t'u krijojmë atyre kondita më të mira që ata të mund të qëndrojnë dhe

të bëhen punëtorë. Por në qoftë se ata venë në minierë dhe atje s'ka shtëpia për të fjetur, në mensë makaronat janë të prishura, çizme e veshmbathje pune s'kanë etj., atëhere si do të rrinë e të bëhen punëtorë të përhershëm të minierës?

Krahas me përmirësimin e këtyre kushteve, është e domosdoshme të bëhet edhe një punë e organizuar edukative nga ana e Partisë, pse, sikurse u tha, vazhdon të ketë dobësi. Partia jonë është një parti marksiste, por të mos harrojmë se shumica e saj sot përbëhet nga fshatarë. Po ta shohim këtë edhe në Minierën e Memaliajt, rezulton se shumica e punëtorëve janë të porsaardhur nga fshati; punëtorët e vjetër me 3-4 vjet stazh pune, numërohen me gisht. Kjo përbërje, shtron detyrën që të zhvillohet një punë më e mirë për edukimin në radhë të parë të anëtarëve të Partisë me frymën e marksizëm-leninizmit, kundër psikologjisë mikroborgjeze. Me një punë të shëndoshë edukative mund të forcohet edhe disiplina në punë.

Duhet pranuar se në edukimin ideologjik dhe politik të klasës punëtoze vihen re shumë dobësi. Derisa në Minierën e Kërrabës gazetat, për shembull, shkojnë një herë në 10 ditë, si mund të thuhet se atje bëhet një punë e mirë politike? Me punën e dobët ideo-politike që zhvillohet duhen shpjeguar raste që ka punëtorë, të cilët mendojnë si t'u ngrihet paga, si të ikin në fshat etj. Këto gjëra duhet të mbahen mirë parasysh nga organizata bazë, komiteti i Partisë i rrethit, instruktorët e Komitetit Qendror që shkojnë atje etj.

Me organizimin e mirë të punës politike detyra e Partisë nuk mbaron. Mund të flasësh për politikë sa të

duash, por kur nuk u jep njerëzve ato për të cilat kanë nevojë, atëhere detyra nuk është plotësuar, prandaj puna duhet të organizohet gjithandej. Po të veprohet mirë në këtë drejtim, jeta do të gjallërohet, puna politike dhe revolucionare do të zhvillojë më tej te punëtorët dashurinë për Partinë, të cilët do të fillojnë të bëjnë edhe kërkesa për t'u pranuar në Parti. Kjo është logjike, pse punëtori fillon të mendojë: kush m'i plotësoi mua nevojat që pa? Dhe do të përgjigjet vetë: Partia. Kjo e shtyn atë që të mos kursejë asgjë për Partinë, të dallohet në punë, në detyrat shoqërore dhe të kërkojë të pranohet në radhët e Partisë, për të luftuar si anëtar i saj, si ushtar i saj.

Organizata bazë e Partisë në minierë duhet të udhëheqë prodhimin, por drejtpërsëdrejti me atë merren drejtuesit shtetërorë, të cilët janë edhe ata njerëz të Partisë, prandaj duhet ta ndihmojnë organizatën e Partisë që ajo t'i marrë më në dorë çështjet e prodhimit. Në këtë mënyrë organizata e Partisë do të mund të ndihmojë më mirë edhe vetë drejtuesit shtetërorë të ndërmarrjes. Nuk duhet të ndodhë që çështjet e prodhimit, të shikohen thjesht nga ana shtetërore dhe nga ana teknike, por ato duhen gjykuar në radhë të parë politikisht, të arësyetohen në organizatën bazë të Partisë nga të gjitha anët, të mësohet nga të mirat dhe nga gabimet dhe të fitohet gjithmonë eksperiencë. Kështu, organizata e Partisë do të arrijë të jetë në nivelin e duhur.

Ju e dini se organizata bazë e Partisë nuk mund të udhëheqë në qoftë se vendimet e saj nuk bëhen të masës. Partia është e lidhur me popullin si mishi me thoin, ajo nuk e udhëheq masën me urdhëra, por me bindje.

Është e domosdoshme që vendimet e Partisë t'u bëhen të njohura punëtorëve. Kjo mund të realizohet nëpërmjet organizatës profesionale. Kryetari i kësaj organizate mbledh punëtorët, të cilëve u shpjegon vendimin që ka marrë organizata bazë e Partisë dhe u kërkon të thonë mendimin e tyre, të bëjnë vërejtje e propozime. Po kështu duhet të punojë edhe rinia. Këto gjëra që ju i dini, duhet të mos i lejoni që të mbeten formale. Problemet që preokupojnë organizatën e Partisë duhet të bëhen medoemos probleme të masës, ndryshe ato nuk mund të zgjidhen si duhet.

Zbatimi i detyrave që u thanë këtu, kërkon që edhe ndihma nga komiteti i Partisë i rrethit, nga komiteti i Partisë i qarkut dhe nga kryesitë e organizatave të masave në rreth e në qark, të jetë më e madhe, më e organizuar dhe më praktike. Në mënyrë të veçantë, forumet e rinisë nuk interesohen sa duhet, kjo del sa herë që marrim në shqyrtim ndonjë problem, prandaj kjo gjendje duhet të marrë fund.

Për vetë vështirësitë që ka puna në minierë edhe ne duhet ta organizojmë më mirë ndihmën nga lart. Këtë duhet ta ketë parasysh sidomos edhe Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit, nga e cila kërkohet një kontroll dhe ndihmë më e mirë për zbatimin e vendimeve që merren. Edhe ju, shokë të minierës, t'u bëni kritika vendimeve të forumeve më të larta, pse nuk mund të themi që të gjitha vendimet tona janë të drejta dhe të studjuara mirë, por në fillim ato duhet t'i zbatoni dhe në të njëjtën kohë të kritikoni.

Një kujdes i veçantë u duhet kushtuar shkollave, që punëtorët të mësojnë, të ngrenë nivelin e tyre arësor.

Mundësitë janë që çdo vit numri i punëtorëve në shkolla të jetë më i madh. Shembullin në këtë drejtim duhet ta japin në radhë të parë anëtarët e Partisë, të cilët duhet të kuptojnë rëndësinë e shkollës, të marrin kulturë dhe të nxitin edhe masën që të ndjekë shembullin e tyre. Drejtuesit e shkollave të përpiqen që mësimet të zhvillohen sa më mirë dhe punëtorët t'i kuptojnë më lehtë.

Duke përfunduar, dëshiroj të theksoj edhe një herë se çështja e realizimit të planit në Minierën e Memaliajt, është një çështje e rëndësishme. Ju, shokë drejtues të minierës, duhet ta dini mirë se po nuk u realizua plani në Memaliaj, mbetet pa prodhuar fabrika e çimentos, e sheqerit, mbetet pa u shfrytëzuar hekurudha etj. Prandaj, kjo duhet t'u bëhet mirë e njohur punëtorëve, të cilët është e domosdoshme të jenë në korrent përditë se ç'ndodh në vendin tonë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verball i mbledhjes së Sekretar-
iatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

PAK FJALË MBI DISA NGA ORGANET E SHTYPIT QË BOTOHEN NË VENDIN TONË

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

17 shkurt 1954

Organet që botohen sot te ne janë të nevojshme dhe kanë ecur përpara, po unë kam mendimin që atje punën duhet ta forcojmë akoma më shumë me qëllim që ato të lexohen e të shfrytëzohen më tepër. Kur të kemi më shumë kadro dhe kushte më të mira teknike, atëhere propagandën e Partisë me shtyp do ta zgjerojmë edhe më shumë. Sot për sot kemi disa vështirësi, të cilat na pengojnë. Kështu, revista «Ylli» nuk del për shkak se nuk ka as klishe dhe veç kësaj ka edhe mungesa të tjera teknike. Ne botojmë «Shënime për Agjitorët», që është e rëndësishme dhe u shërben shumë agjitorëve të Partisë, mirëpo nga 8 000 kopje që dalin, blihen vetëm 800 prej tyre. Të mos harrojmë se ky është një organ që e nxjerr Komiteti Qendror, prandaj duhen marrë masa që

¹ Në këtë mbledhje u shqyrtuan masat që duheshin marrë për një organizim më të mirë të shtypit.

të tërhiqet edhe më shumë. Edhe problemet që pasqyrohen në «Shënime për Agjitorët», mund të trajtohen më mirë, më konkretisht, pse nganjëherë janë të përgjithshme, bajate.

Gazeta «Bashkimi», siç theksuan edhe shokët, mendoj se herë pas here ka një paralelizëm me «Zërin e Popullit». Kjo është edhe një arësye që «Bashkimi» nuk tërhiqet sa duhet. Po të vazhdojë kështu gjendja e kësaj gazete, do të ndodhemi përpara dy rrugëve: ose «Bashkimi» duhet të shërbejë veçanërisht për fshatin dhe për organet e pushtetit, që janë probleme mjaft të rëndësishme, ose këtë gazetë duhet ta mbyllim. Unë nuk jam për rrugën e dytë, pse «Bashkimi» është një gazetë që ka dalë qysh në kohën e luftës dhe sot përfaqëson organizatën e Frontit dhe pasqyron vijën e Partisë. Pra jo ta mbyllim, por mendoj të japim orientimin që gazeta «Bashkimi» të trajtojë problemet themelore politike dhe të mos botojë për shembull një material të tërë politik që del në «Zërin e Popullit». «Bashkimi», në programin e vet të ketë çështjet e forcimit të pushtetit dhe çështjet e fshatit, të cilat kanë rëndësi të madhe. Problemet e fshatit, të zënë një ose një faqe e gjysmë daktilografie duke shkruar thjesht e shkurt për një sërë çështjesh në mënyrë agjitative dhe instruktive, me eksperiencë dhe jo me fjalë bombastike, me qëllim që fshatarit t'ja lexojë jo vetëm anëtari ose agjitori i Partisë por edhe djali i tij që ka mbaruar vetëm shkollën fillore. Po të veprohet kështu, gazeta «Bashkimi» do të vlejë jashtëzakonisht shumë dhe do të ndihmojë në zhvillimin e bujqësisë, do të ndihmojë gjithashtu edhe për forcimin e pushtetit.

Revista «Udhëheqësi i Pionierëve» nevojitet për të

ndihmuar në edukimin e brezit të ri; nuk jam me atë mendim që ajo të mos dalë më, pse ka shumë nevojë të ketë udhëzime sidomos sot, që kemi akoma pak literaturë për pionierët. Në rast se temat që trajtohen në këtë revistë mund të shkruhen në një rubrikë të veçantë të përhershme të gazetës «Pionieri», atëhere ajo mund të mos vazhdojë të botohet më, ndryshe duhet të mbetet.

«Aktivisti i Bashkimeve Profesionale» mendoj të mos botohet në të ardhshmen, me qëllim që të forcohet gazeta «Puna». Po kështu buletin «Kolkoziani Sovjetik» dhe «Punëtori Sovjetik» mendoj të mos dalin më, detyrat e tyre t'i kryejnë revistat «Miqësia» dhe «Teknika». Kjo e fundit duhet të trajtojë probleme të teknikës pararojë sovjetike. Detyra jonë është që këtë revistë ta marrin ta lexojnë e ta përdorin punëtorët tanë. Mirëpo tani në revistën «Teknika» që nxjerr Ministria e Industrisë ka raste që shtypen materiale, si fjalime etj., të cilat e largojnë këtë revistë nga profili dhe qëllimi i saj. Po të veprohet kështu atëhere si do t'ua bëjmë të njohur punëtorëve teknikën e përparuar sovjetike dhe si do të mund të na shërbejë kjo për punën tonë? Prandaj, këto dy revista të shkrihen në një dhe kjo të jetë revista «Teknika», e cila të përmbledhë materiale nga tërë sektorët e ekonomisë dhe kolegji i saj të përbëhet nga përfaqësues të të gjitha dikastereve qendrore.

Revista «Arësimi dhe Kultura» të mbetet, ndërsa revista «Çështje të Bujqësisë» s'ka pse qëndron, sepse çështjet e saja shkencore mund të rrihen në revistën që nxjerr Instituti i shkencave¹.

¹ «Buletini i Shkencave Bujqësore».

Revista «Tregëtia Popullore»¹ mendoj se ka dobësi. Si do t'i edukojmë ne punonjësit e tregëtisë, si do t'ua mësojmë atyre artin e tregëtisë? Ne duhet t'i japim një orientim të drejtë kësaj reviste. Komunistët tanë nuk dinë të bëjnë tregëti, në këtë drejtim ata duhet t'i mësojmë, por që të bëhet kjo, duhet të kemi edhe mjete, prandaj këtë çështje duhet ta mendojmë.

Përsa i përket revistës «Shkenca Mjekësore» mendoj se ajo nuk duhet mbyllur. Revista «Shëndetësia Popullore» ka një karakter tjetër, ajo trajton në mënyrë të vulgarizuar probleme të shëndetësisë për masat, ndërsa revista «Shkenca Mjekësore» ka për qëllim të ngrejë nivelin shkencor të mjekëve. Duke botuar materiale nga shkenca mjekësore sovjetike dhe ajo e përbotshme, kjo revistë do t'i ndihmojë mjaft mjekët e vendit tonë, do t'i mbajë ata në korrent me të rejat e shkencës në fuqinë e mjekësisë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

¹ Revistat «Tregëtia Popullore» dhe «Ekonomia e Planifikuar» më vonë u shkrinë në një të vetme me emrin «Ekonomia Popullore».

MBI DETYRAT E DELEGATËVE TË KONFERENCAVE TË PARTISË DHE PUNA ME MASAT

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

17 shkurt 1954

Unë kisha për të theksuar dy çështje që më duken me rëndësi dhe duhet t'i zgjidhim më mirë.

Çështja e parë është se konstatohet që të zgjedhurit për në konferencat e Partisë nuk e ndjejnë si duhet përgjegjësinë që kanë përpara zgjedhësve të tyre. Delegatin e zgjedhin një numër komunistësh që t'i përfaqësojnë në organizatën e Partisë të qarkut ose të rrethit. Pikësëpari, organizata bazë e Partisë, kur e zgjedh delegatin e saj, duhet t'i ngarkojë atij disa probleme që ajo mendon se mund t'i ngrejë në konferencë. Me të mbaruar konferenca e Partisë, delegati duhet të vejë e të japë llogari përpara komunistëve që e kanë zgjedhur, të thotë: «Unë në konferencë ngrita këto probleme dhe, përveç kësaj, atje u ngritën edhe këto probleme të

¹ Në këtë mbledhje u shqyrtuan rezultatet e zhvillimit të konferencave të Partisë në rrethe.

tjera». Një gjë e tillë nuk bëhet as kur delegatët zgjidhen nga organizatat bazë e as kur ata kthehen nga konferencat e Partisë. Delegati nuk e ndjen përgjegjësinë që ka si para zgjedhësvë, ashtu dhe para konferencës si organi më i lartë në rreth. Shpeshherë as diskuton dhe as mban shënime. Në këtë mënyrë, delegati nuk e konsideron konferencën si një shkollë të madhe ku analizohet puna e Partisë dhe ku shtrohen detyra të reja, për të cilat duhet të interesohen veçanërisht ata që patën nderin të dëgjojnë dhe t'ua shtrojnë shokëve. Puna e delegatëve pas kthimit nga konferenca ndihmon që të parapregatiten të gjitha organizatat bazë të Partisë, në të cilat do të punohet rezolucioni i konferencës së Partisë. Kështu organizata bazë është në dijeni mbi punimet e konferencës dhe kur vete rezolucioni për t'u punuar, ajo është e informuar dhe në gjendje të diskutojë si duhet rreth tij. Për rëndësinë që ka kjo çështje, ne biseduam këtu në Komitetin Qendror dhe u bëmë letër të gjitha komiteteve të Partisë të rretheve dhe të qarqeve¹ porositëm që delegatët të raportojnë në mbledhjet e organizatave bazë të Partisë mbi punimet e konferencave.

Çështja e dytë që duhet ta organizojmë dhe ta ndjekim më mirë është puna me masat. Mundet që format t'i dimë, por ajo që ka rëndësi është që ne, si Parti, kemi detyrë të punojmë me organizatat e masave dhe me njerëzit pa parti në mënyrë të organizuar dhe me agjitacion të vogël. Por një punë e tillë nuk bëhet mirë. Është e domosdoshme që komunistët ta kuptojnë si duhet se Partia është pararoja, udhëheqëse e të gjitha

¹ Shih në këtë vëllim, f. 215.

masave dhe u transmeton atyre direktivat e saja. Vendimet e organizatës bazë që kanë lidhje me prodhimin, disiplinën, mbrojtjen e atdheut etj., anëtarët e Partisë kanë për detyrë që t'ja shtrojnë popullit në dy mënyra, nëpërmjet organizatave të masave dhe agjitacionit të vogël, me qëllim që të sqarohen e të mobilizohen të gjithë njerëzit pa parti. Kështu do të zbatohen vendimet e Partisë, do të mobilizohet klasa punëtore, rinia, grupaja dhe tërë punonjësit kudo që janë. Nuk duhet të ndodhë që vendimet e Partisë të mbeten brenda radhëve të saja, në organizatën bazë, pse ka shumë çështje që shtrohen në Parti, por s'janë vetëm për komunistët, janë edhe për punëtorët, rininë, grupan, për gjithë popullin. Shumë komunistë kujtojnë se mbledhja e Partisë u bë vetëm për ata dhe puna mbaroi me kaq. Jo, kjo nuk është kështu. Puna e Partisë është një punë e madhe ideologjike dhe organizative, çdo komunist në organizatën bazë ku bën pjesë edukohet, ngrihet, sqarohet, por një punë e tillë duhet bërë edhe me masat. Vendimet e organizatës bazë mund t'i thuhën menjëherë kolektivit ose miqve të Partisë shkurtazi ose në mbledhje të organizatave të masave. Kështu do të jetojnë njerëzit me frymën e Partisë dhe do të mobilizohen për zbatimin e vijës së saj.

Këto ishin dy çështjet që doja të theksoja, të cilat në teori dihen, por duhen zbatuar më mirë edhe në praktikë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

NE KOOPERATIVE, ASAMBLEJA ESHTË AJO QE VENDOS GJITHSIKA

Nga biseda me kooperativistët e Maminasit¹

21 shkurt 1954

Shoku Enver Hoxha përshëndet kooperativistët dhe i uron ata për sukseset e arritura në rritjen e prodhimeve, në marrjen e rendimenteve të larta dhe në forcimin organizativ të kooperativës së tyre. Shoku Enver duke folur mbi të mirat e kooperativizmit tha:

«Kooperativizmi është e ardhshmja e fshatit tonë. është rruga e sigurtë e mirëqenjes dhe e bollëkut për fshatarin. Jo vetëm kaq, por bashkimi në kooperativa na bën edhe më fortë. Ju e dini nga folklori popullor historinë e atij plakut, baba i shtatë djemve, i cili u dha fëmijëve disa shkopinj për t'i provuar nëse mund t'i thyenin. Kur ua dha një e nga një ata i thyen lehtë. po kur ua dha së bashku nuk mundën t'i thyenin dot.

¹ Shoku Enver Hoxha ka shkuar në këtë kooperativë për të marrë pjesë në festën e 7-vjetorit të krijimit të saj.

Kjo do të thotë se bashkimi bën fuqinë. Kështu është edhe bashkimi në kooperativa.

Ju, kooperativistët e Maminasit, njiheni si rekordistë për prodhime të larta të pambukut të mbjellë në toka pa ujë. Kjo tregon se ju keni punuar mirë, por ju duhet që t'i rritni gjithmonë këto rendimente, duhet të përpigjeni me të gjitha forcat: me krahë, me mend e me veglat që dispononi që t'ua dilni mbanë me sukses detyrave tuaja të reja. Bimëve duhet t'u bëni shërbime sa më të mira, pse kështu do të keni një përmirësim të madh jo vetëm të bujqësisë, por edhe të veshmbathjes suaj. Sa më shumë pambuk të marrim dhe sa më e lartë të jetë cilësia e tij aq më shumë beze do të kemi dhe aq më mirë do të punohet ajo nga Kombinati i tekstileve «Stalin». Ose të marrim blegtorinë: nga kujdesi për bagëtitë nuk varet vetëm prodhimi i mishit dhe i bulmetit, por edhe sasia e cilësia e lëkurës që përdoret për të bërë këpucë. Prandaj leverdinë e një prodhimi duhet ta shikojmë nga të gjitha anët dhe jo në një drejtim të vetëm».

Kooperativistët e Maminasit i dëgjuan me vëmendje të madhe fjalët e shokut Enver edhe për forcimin organizativ të kooperativës së tyre, për të cilin ai porositi:

«Kooperativat bujqësore janë organizata masash, ku ata që bëjnë ligjin janë kooperativistët, anëtarët e saj; asambleja e kooperativës është gjithshka, ajo vendos mbi çdo gjë. Aty duhet të dëgjohet patjetër zëri i kooperativistëve. Në një kooperativë, po nuk u dëgjua zëri i asamblesë, zëri i kooperativistëve, punët do të venë keq. Rëndësi të madhe ka edhe zbatimi me përpikmëri i statutit tip të kooperativave, luftimi i shfaqjeve dhe i kon-

cepteve të huaja për kooperativën, rritja e fondit të paprekshëm të kooperativës e të tjera».

Shoku Enver duke nënvizuar rëndësinë jashtëzakonisht të madhe të masave të fundit të Partisë dhe të qeverisë për shtimin e prodhimeve industriale dhe bujqësore, për rritjen e mirëqenjes së masave punonjëse të qytetit dhe të fshatit tha:

«Partia dhe qeveria po punojnë me të gjitha forcat që klasa jonë punëtore, fshatarësia jonë, populli ynë të rrojnë më mirë. Masat e marrura do t'ju ndihmojnë më shumë për zhvillimin e bujqësisë dhe të blegtorisë, në mënyrë që vitin e ardhshëm të merrni më shumë prodhime e të kenë më shumë të ardhura».

Fjalët e ngrohta të shokut Enver Hoxha dhe porosinë e tij, të cilat u duartrokitën me entuziazëm, u dëgjuan me vëmendje të madhe nga kooperativistët e Maminasit. Ata u zotuan përpara Komitetit Qendror dhe shokut Enver se, duke pasur parasysh këto porosi, rendimentet e kulturave të ndryshme bujqësore do t'i shtojnë nga viti në vit për t'i dhënë, kështu, vendit sa më shumë prodhime bujqësore dhe blegtorale, e njëkohësisht, do të luftojnë ta forcojnë kooperativën edhe më shumë nga ana organizative.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 46 (1986), 24 shkurt 1954

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 46 (1986), 24 shkurt 1954

DETYRA JUAJ ESHTË QË EKSPERIENCËN TUAJ T'UA MËSONI EDHE TË TJERËVE

*Përgjegje letrës së Shuaip E., kultivues i dalluar
i duhanit në Shtërmen të Elbasanit*

22 shkurt 1954

E mora letrën tuaj. U gëzova shumë për sukseset që keni arritur në prodhimin e duhanit dhe për zotimin e ri që merrni.

Letra juaj flet për një problem shumë të rëndësishëm: për arritjen e rendimenteve të larta në kulturën e duhanit.

Fshatarësia jonë punonjëse, e çliruar përgjithmonë nga shfrytëzimi dhe shtypja e bejlerëve, e agallarëve dhe e ndihmuar vazhdimisht nga Partia e pushtetit popullor, po merr gjithnjë rendimente më të larta në të gjitha kulturat bujqësore, duke e përmirësuar kështu dita-ditës jetesën e saj. Radhët e fshatarëve përparimtarë, të atyre që zbatojnë agroteknikën e re, që punojnë sipas shembullit të bujqësisë së përparuar në botë e të bujqësisë sovjetike po rriten nga viti në vit. Dhe ju bëni pjesë në radhët e atyre fshatarëve, nga të cilët

duhet të marrë shembull gjithë fshatarësia jonë punonjëse.

Këto përpjekje për të marrë rendimente më të larta, kujdesi dhe vrulli në punë për ta çuar bujqësinë përpara, janë një garanci e shëndoshë për përparimin e ekonomisë sonë popullore, për përmirësimin e jetesës së gjithë punonjësve. Shumë fshatarë si ju, duke zbatuar rregullat agroteknike, kanë marrë prodhime të shkëlqyera në kulturën e duhanit dhe kanë përmirësuar ekonominë e tyre, si në Buzujë të Shkodrës, ku kanë marrë 28 kv. për ha. në 22 dynym tokë, ose në katundin Aliaj të Shkodrës ku u morën 25 kv. duhan në një ha., ndërsa në Kuqan të Elbasanit janë marrë 17 kv. për ha. e të tjera.

Partia dhe qeveria u kushtojnë një rëndësi të madhe rritjes së mëtejshme të rendimenteve dhe zgjerimit të sipërfaqeve të mbjella me duhan. Vendimet e Plenumit të fundit të Komitetit Qendror të Partisë, të cilat përcaktojnë masat për përmirësimin e mëtejshëm të konditave të jetesës së masave punonjëse, shtrojnë si detyrë që prodhimi i duhanit të shtohet në mënyrë të atillë që të bëhet një nga artikujt e radhës së parë dhe brenda 3-4 vjetëve të ardhshëm prodhimi tij të dyfishohet.

Partia dhe qeveria kanë marrë vendime të veçanta për të ndihmuar kultivuesit e duhanit duke u dhënë kredi për blerje plugjesh e plehrash kimike, për të ndërtuar kanale dhe hauze për mbajtjen e ujit për ujitje, për të ndërtuar hangare dhe për të përdorur sa më shumë SMT-të dhe teknikët bujqësorë. Kultivuesit e duhanit duhet të përfitojnë në maksimum nga ndihma e Partisë

dhe e qeverisë dhe të tregojnë një kujdes të veçantë për rritjen e bimës. Dhe ky kujdes fillon që tani, me mbjelljen e shpejtë e të mirë të farishteve, me sigurimin e bimëve të caktuara për çdo dynym, me prashitjen e bimëve e deri në vjeljen me kohë, në tharjen dhe manipulimin e duhanit sipas rregullave agroteknike. Të gjitha këto janë kusht i domosdoshëm për të marrë rendimente të larta.

Ju keni një eksperiencë të gjatë në kultivimin e duhanit. Detyra juaj është që këtë eksperiencë t'ua mësoni edhe fshatarëve të tjerë dhe njëkohësisht të bëni të gjitha përpjekjet për ta shtuar edhe më tepër prodhimin.

Ju thoni se nuk e ndani punën e familjes me atë të shtetit dhe të Partisë. Kjo është shprehje e zjarrtë e ndjenjave të të gjithë patriotëve të vendit, kjo është shumë e rëndësishme. Puna juaj si bujk përparimtar është e lidhur ngushtë me ngritjen e ekonomisë popullore në përgjithësi dhe forcimin e Republikës Popullore. Partia dhe qeveria kanë për qëllim dhe përpiqen që jeta e popullit të përmirësohet, të përmirësohet jeta e fshatarit, që ai të ndërtojë shtëpi të re, në shtëpinë e tij të ketë çdo gjë që i nevojitet për të bërë një jetë të këndshme dhe të gëzuar.

Të gjitha këto do të arrihen me punë të palodhur dhe garanci e madhe është Partia jonë që na udhëheq. është patriotizmi i flaktë i të gjithë punonjësve të Shqipërisë së re, që janë të lidhur si mishi me thoin me pushtetin popullor, me Partinë e tyre të dashur, me Bashkimin e madh Sovjetik dhe me kampin e socializmit e të paqes.

Ju uroj shëndet, ta plotësoni me nder angazhimin tuaj dhe të arrini suksese gjithnjë më të mëdha!

Të fala, juve dhe familjes suaj!

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

STUDIMET TË LIDHEN NGUSHTË ME PROBLEMET QË NA SHQETËSOJNË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

24 shkurt 1954

Megjithëqë unë nuk jam si duhet në korrent të organizimit aktual të institutit, mendoj se organizimi në bazë të eksperiencës sovjetike është i drejtë. Vetëm se dua të them që instituti s'duhet t'i nxjerrë këmbët jashtë jorganit dhe të ketë pretendime të mëdha qysh tani në fillim.

Mendoj që instituti të ketë ato seksione dhe degë të cilat në situatën tonë janë të mundshme dhe të domosdoshme. Me rritjen e kuadrove dhe të nevojave tona, natyrisht do të zgjerohemi dhe do të forcohemi edhe më shumë. Por aktualisht duhet t'i vëmë rëndësi krijimit ose forcimit të atyre seksioneve dhe degëve, të

¹ Në këtë mbledhje u mruar në analizë puna e Institutit në shkencave.

cilat të studjojnë problemet urgjente të kohës dhe të një perspektive pak a shumë më të largët.

Në radhë të parë për ne janë urgjente problemet e bujqësisë, të blegtorisë, të frutikuturës, të bimëve industriale dhe mjekësore, problemet e industrisë e të minierave dhe mjaft probleme sociale.

Instituti ynë i shkencave është i ri, ashtu si çdo gjë në vendin tonë. Në të do të punojnë kuadrot tanë të rinj që kanë mësuar në Bashkimin Sovjetik e në vendet e demokracisë popullore si dhe njerëzit tanë më të mirë të shkencës, të literaturës, të arteve etj. Atje duhet të punojnë shkencëtarë përparimtarë dhe të hiqen prej andej elementët e padëshiruar e që s'kanë asnjë lidhje me shkencën e re, e që bile mbajnë qëndrim armiqësor ndaj pushtetit tonë. Unë mendoj se dituria e tyre nuk na vlen për në institut, i cili ka qëllime të mëdha; atë dituri të tyre, në qoftë se ka mundësi, ta shfrytëzojmë akoma gjetkë, por jo në një institut të tillë.

Kryesisht Instituti ynë i shkencave duhet të përbëhet nga njerëzit tanë të rinj, të cilët me kohë do të fitojnë eksperiencë. Në fakt ata janë sot që drejtojnë fatet e vendit tonë. Prandaj të caktohen kuadro të rinj në bazë të orientimit e të punës që i kërkohet institutit dhe seksioneve të tij. Kuadrot atje duhet të jenë të mirë e të zgjedhur. Kjo çështje të mos nënvleftësohet siç është bërë deri tash.

Instituti në fakt ka punuar në mënyrë të shkëputur, i izoluar, më vete, pavarësisht se atij i është caktuar një farë orientimi nga Komiteti Qendror i Partisë. Kjo s'do të thotë se instituti nuk ka punuar fare, por duhej dhe duhet të punojë më mirë. Kjo ka ndodhur për fajin e

drejtuesve të tij dhe për fajin tonë në radhë të parë. Kuadrot që janë caktuar në institut, kam përshtypjen se konsiderohen në fakt si «të humbur», ose si «kuadro që s'kemi ç'i bëjmë, prandaj hajde t'i caktojmë në institut». Në këtë konkluzion arrij për shkak se studimeve të institutit, ashtu si janë, të mira ose të gabuara, nuk u kemi vënë rëndësinë e duhur, sidomos në sektorët më të rëndësishëm, në bujqësi, në industri, në miniera etj. Në qoftë se ne do ta kishim kuptuar si duhet rëndësinë e madhe që ka Instituti i shkencave, mënyrën e punës së tij në problemet që ai duhej të studjonte, kontrollin e rezultateve të këtyre studimeve dhe vënjen e tyre në jetë, atëhere ne duhej të kishim dërguar në institut nga njerëzit tanë më të mirë të shkencës dhe të kulturës. Kjo mund të ishte e vështirë në fillim, kur ne s'kishim kuadro të lartë, por mjerisht vazhdohet dhe tash që ne kemi me qindra kuadro të përgatitur teorikisht dhe të armatosur me shkencën e lartë të pararojës. Preferojmë të dërgojmë me dhjetëra e me qindra kuadro të tillë në terren dhe hezitojmë të dërgojmë një ose dy në Institutin e shkencave. Këtë gjë e bëjmë se nuk e kemi të qartë detyrën e institutit dhe ndihmën e madhe që ai do t'i japë vendit.

Vëmendja përqëndrohet vetëm në punën e anëtarëve të institutit, ndërsa punës së korrespondentëve dhe të ndihmësve të tyre nuk i vihet asnjë rëndësi. Vetë këta e quajnë këtë titull si krejtësisht formal. Këta korrespondentë dhe bashkëpunëtorë nuk janë caktuar në bazë të kritereve të shëndosha dhe nuk është punuar për t'i lidhur ata konkretisht me punën e institutit, që është një pjesë e rëndësishme e punës së tyre të përditshme.

Pjesëmarrja e rregullt e tyre në punimet e institutit ndihmon në shpejtimin e një sërë studimesh të domosdoshme që kanë ata vetë për ministritë përkatëse e posaçërisht për sektorin e tyre. Pra, këta korrespondentë, bashkëpunëtorë dhe udhëheqësit e tyre nuk kanë arritur akoma të kuptojnë si duhet dhe sa duhet se instituti me studimet që do të kryejë, do të bëjë të zgjidhen një sërë problemesh, të cilat praktikisht është e pamundur t'i zgjidhë vetë dikasteri ose ata në mënyrë individuale. Prandaj duhet të zgjidhen me kujdesin më të madh korrespondentët dhe bashkëpunëtorët e institutit, në bazë të punës së tyre, të problemeve që kërkohen për t'u studjuar nga instituti dhe të shikohet gjithashtu trajtimi i tyre. Po kështu, të studjohen të gjitha nevojat minimale të institutit për të kryer detyrat e tija. Të studjohet, në rast se duhet bërë, edhe ndonjë ndryshim në strukturën e tij organizative etj. Asgjë të mos jetë e tepërt në institut. Atij t'i jepet çdo gjë e nevojshme dhe e domosdoshme për kryerjen e detyrave. Asnjë kuadër që do të punojë atje të mos jetë formal. Instituti të jetë një vend i madh pune dhe të gjithë të jenë të ndërgjegjshëm për detyrat që u ngarkon Partia. Puna atje të jetë njëkohësisht një nder i madh për ta.

Përveç sa thashë më lart, dëshiroj të theksoj edhe disa detyra të tjera për institutin, që më duken se kanë një rëndësi shumë të madhe. Nuk di me saktësi se deri në ç'skallë këto detyra i ka mbajtur parasysh dhe i ka zbatuar instituti, por sidoqoftë, kam përshtypjen se nuk u është vënë rëndësia e duhur.

Rëndësi ka edhe çështja e propagandës shkencore në masat e gjera punonjëse. Kjo është një detyrë e ma-

dhe e Institutit të shkencave, punimet e të cilit në këtë drejtim do të lehtësojnë punën e agjitorëve e të propagandistëve të Partisë dhe të organizatave të masave, do të lehtësojnë punonjësit e çfarëdo kategorie, të atyre që punojnë në fabrika e miniera si edhe të punonjësve të fshatit. Një propagandë e tillë shkencore për masat që janë në një nivel më të ulët, tani për tani, zhvillohet nga disa mësues dhe profesorë në mënyrë shumë të zbehtë, për të mos thënë se nuk bëhet fare. Por nuk mund të lihet gjithë ky problem i rëndësishëm jashtë planit të punës dhe ndihmës së Institutit të shkencave. Instituti i shkencave të ketë parasysh se propaganda shkencore duhet t'i përshtatet nivelit kulturalo-arësimor të masave, të shkruhet në gjuhë të thjeshtë, të lidhet me aktualitetin dhe me problemet e ditës e të planit. Të evitohen në këtë drejtim fantazirat e kota, kuriozitetet e panevojshme dhe trajtimet shkencore të rënda. Lidhur me këtë, unë e quaj të nevojshme që Komiteti Qendror dhe qeveria, nëpërmjet dikastereve, t'i përcaktojnë institutit drejtimet kryesore të punës së tij duke i dhënë orientime të qarta për problemet që do të studjohë dhe propagandën shkencore që do të zhvillojë me masat.

Bashkëpunimi dhe lidhjet e ngushta me universitarët, me kuadrot që mbarojnë shkollat teknike dhe ato të mesme etj. duhet të forcohen më shumë. Pritja që diçka të thuhet për këtë problem të rëndësishëm nga ana e kryetarit të Institutit të shkencave, por kjo nuk u prek fare, prandaj unë kam të drejtë të arrij në konkluzionin, që lidhjet e institutit me universitarët e me kuadro të tjerë janë të dobëta. Njerëzit që mbarojnë institutet e larta ose shkollat e mesme industriale sigu-

risht kanë marrë dituri dhe njohuri shkencore, por kjo është e pamjaftueshme. Ata duke punuar duhet të zhvillojnë njohuritë e tyre më tej. Faktet e përditshme na tregojnë, se puna praktike ata i rrëmben dhe pak mendojnë ose preokupohen të zgjerojnë njohuritë e tyre, të thellohen edhe më tej në çështjet e shkencës. Studimi i mëtejshëm individual, natyrisht, është detyrë e rëndësishme e këtyre kuadrove, por mua më duket se kjo detyrë s'po kryhet si duhet. Atyre u mungon metoda e punës, u mungojnë shumë herë mjetet, librat, u mungon një drejtim dhe një organizim nga lart. Unë mendoj se Instituti i shkencave e ka për detyrë që kuadrot tanë të rinj e të mësuar t'i marrë nën kujdesin e veçantë të tij dhe me një punë të organizuar shumë mirë, të bëjë që këta të zhvillohen më tej dhe të pajisen vazhdimisht me dituri më të gjera nga ato që kanë mësuar në shkolla. Duke menduar pra, për metodat e punës, për lidhjet e institutit me ta, për planet dhe programet e punës, për detyrat që këta duhet të zgjidhin, për materialet dhe librat ku këta do të mbështeten, Instituti i shkencave duhet të mendojë për specializimin e tyre, për përgatitjen e tyre të mëtejshme, për marrjen e titujve e të gradave shkencore etj. Këto detyra, më duket mua, nuk mundet dhe nuk duhet të lihen pa zot, në vetë inisiativën individuale të çdo personi, pa një plan dhe pa një orientim të caktuar nga Komiteti Qendror dhe qeveria duke u zbatuar nga instituti, në bazë të konditave, në bazë të nevojave që i dalin vendit dhe ndërtimit të ekonomisë sonë popullore.

Kuptohet vetëvetiu se këto detyra të rëndësishme Instituti i shkencave nuk mund t'i kryejë dot me 5-6

kuadro. Tani situatat kanë ndryshuar krejtësisht. Në rast se instituti e organizon punën siç po diskutojmë këtu në Byronë Politike, jo vetëm që këto detyra do t'i kryejë me sukses, por do të mësojë njëkohësisht një numër të pakufizuar kuadrosh të shëndoshë. Të gjithë këta kuadro të rinj me arësim të lartë e të mesëm, duhet të zhvillojnë një aktivitet të madh krijues, duhet të aftësohen në maksimum në mënyrë të organizuar. Ata presin, ata janë të gatshëm. Ne akoma s'kemi ditur t'i aktivizojmë. Kjo nuk duhet të përsëritet më. A e marrim pak me mend, ç'rezultate të shkëlqyeshme mund të korrin ne, po të dimë ta organizojmë mirë punën në vend që të merremi me Sejfulla Malëshovën me shokë¹?

Lidhjet e Institutit tonë të shkencave me institucionet shkencore të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore të jenë më frutdhënëse. Nuk e di mirë sa janë këto lidhje dhe sa ka përfituar instituti ynë prej tyre, por kam mendimin se këto lidhje janë të dobëta dhe përfitimet tona janë të pakta. Gjëja kryesore është që ne duhet të dimë të kërkojmë ndihmë në radhë të parë nga institucionet shkencore të Bashkimit Sovjetik. Këtu s'është fjala të vejë një njeri atje të shohë organizimin dhe me kaq mbaroi puna. Kjo më duket mua është gjëja më e vogël. Por çështja kryesore është bashkëpunimi i vazhdueshëm, i rregullt, parashtrimi i problemeve, kërkimi i ndihmës konkrete.

¹ Në këtë kohë S. Malëshova punonte në institut dhe megjithëse Partia e kishte goditur rëndë, ai u mundua që edhe këtu të vepronte për realizimin e mendimeve të tij oportuniste e borgjeze.

Natyrisht një ndihmë e tillë është e zorshme të na jepet, po nuk u mendua edhe për ndihmën që duhet kërkuar. Ç'na pengon ne që ta marrim këtë ndihmë sa më parë? Mua më duket se s'ka asnjë pengesë përveç se mungesa e organizimit të punës nga ana e institutit. Unë këtë çështje e shtroj jo vetëm nga ana parimore, por kërkoj nga shokët e Institutit të shkencave, që të organizojnë mirë në praktikë kërkesën e ndihmës së vazhdueshme nga institucionet shkencore të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore.

Duke marrë parasysh detyrat e mëdha që i ngarkojmë Institutit të shkencave, duhet patjetër që atij t'i plotësojmë edhe nevojat materiale të domosdoshme. Këtu nuk është çështja që Instituti ynë i shkencave të ketë brenda një ose dy vjetësh çdo gjë që kanë institucionet shkencore të Bashkimit Sovjetik si biblioteka të mëdha, laboratorë ultra modernë etj., por ne duhet të bëjmë çmos që gjërat imediate dhe të nevojshme të fillojmë t'ja japim. Të tilla janë forcimi i bibliotekave, i laboratorëve, disa përkthyes për gjuhët e huaja etj.

Të përmirësohet metoda e punës së institutit dhe të organizohet mirë bashkëpunimi i tij me Komitetin Qendror të PPSH dhe me dikasteret. Të caktohet programi i punës dhe i studimeve në bazë të orientimit të Komitetit Qendror, në bazë të problemeve dikasteriale, në bazë të planit pesëvjeçar dhe këto lidhur ngushtë me problemet ekonomike, politike dhe kulturele të vendit. Asnjë studim nuk duhet t'i shpëtojë këtij orientimi. Duhet të ruhen proporcionet dhe të ndahen forcat sipas rëndësisë së sektorëve dhe urgjencës së studimeve. Studimet e kërkuara nga instituti duhet të paraqiten me

kohë. Studimet nga instituti do të bëhen në bazë të kërkesave të Komitetit Qendror, të qeverisë, të ministrive përkatëse ose të vetë institutit.

Studimet duhet të kenë një qëllim të caktuar imediat dhe perspektiv, lidhur ngushtësisht me problemet që na preokupojnë. Nga dikasteri dhe instituti të caktohen data. Asnjë formalizëm nuk duhet të lejohet. Të ushtrohet mbikëqyrje e vazhdueshme dhe rigoroze nga Komiteti Qendror, nga qeveria, nga ministrinë për problemet e tyre dhe nga vetë instituti mbi punonjësit e vet për zbatimin me kohë dhe si duhet të detyrave.

Qëllimi dhe zbatimi i mëvonshëm i studimit duhet të jetë i qartë nga dikasteri e nga instituti dhe jo të bëhen studime për studime për të qëndruar në raftë. Gjatë studimit të problemit duhet të ekzistojë bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet institutit dhe dikasterit, inxhinierëve, korrespondentëve dhe bashkëpunëtorëve të institutit që janë funksionarë në dikastere, punëtorëve të pararojës, novatorëve, drejtorëve, bile të gjithë të nxiten dhe të kontrollohen nga ministria për bashkëpunimin me institutin. Instituti të ndihmohet gjithashtu materialisht nga dikasteret duke vënë mjete ose ofiçina etj. në dispozicion të tij për të kryer studimet.

Kur studimi mbaron, duhet t'i dorëzohet Komitetit Qendror, qeverisë ose dikasterit përkatës dhe këta janë të detyruar të marrin sa më parë masa për vënjen e tij në zbatim. Në qoftë se studimi është me rëndësi dhe kërkon pëlqimin e qeverisë apo të dikasterit, të shqyrtohet pa humbur kohë, po kështu edhe nga Komiteti Qendror me anë të aparatit të tij. Dikasteri nuk duhet të lejojë që të bëhen studime paralele për një problem

dhe as që të rikthehen në studime e në studime. Kjo do të evitohet në rast se do të ketë bashkëpunim të ngushtë ndërmjet institutit dhe dikastereve.

Institutit duhet të interesohet për fatin e studimeve të veta. Ai duhet të sigurojë në bazë ndihmën e atyre që kanë bërë studimin gjatë zbatimit të tij në jetë. Këtu del nevoja për një bashkëpunim konkret të anëtarëve të Institutit të shkencave me njerëzit e prodhimit.

Byroja Politike, qeveria dhe kolegji i ministri-ve t'i propozojnë institutit studime dhe jo vetëm të ndjekin kryerjen në kohë, por dhe të marrin masa që studimet t'u përgjigjen nevojave të vendit dhe të vihen në jetë. Në mbledhje të këtyre organeve, sipas rastit, duhet të thirret kryetari i institutit, autorët e studimeve në fjalë si edhe disa nga zbatuesit kryesorë të tyre.

Dikasteri duhet ta konsiderojë institutin si një nga ndihmësit e vet më kryesorë, i cili i përgatit atij probleme nga më të rëndësishmet, i lehtëson punën, i hap rrugën dhe perspektivat. Në këtë drejtim pra, ndihma e shumanshme e dikasterit ndaj institutit duhet të jetë e madhe. Ca më tepër ndihma dhe konsiderata e vazhdueshme e Komitetit Qendror dhe e qeverisë për institutin duhet të jenë më të mëdha se deri tani.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TË FORCOJMË MË TEJ PUNËN PËR PREGATITJEN IDEOLOGJIKE TË KUADROVE NË KURSET E PARTISË

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

24 shkurt 1954

Mendoj se duhet t'u vëmë në dukje shokëve të komiteteve të Partisë të qarqeve që të tregojnë një kujdes më të madh për kurset e Partisë, për pregatitjen ideologjike të kuadrove, prandaj njerëzit që marrin pjesë në këto kurse të zgjidhen mirë dhe temat që zhvillohen atje të jenë me cilësi të lartë. Direktivat e Komitetit Qendror për kurset e Partisë të zbatohen rigorozisht dhe të mos lejohet shkelja e tyre.

Këto direktiva, kur venë në bazë, duhet të zërthehen dhe të zbatohen në përputhje me kushtet e terrenit ku vepron organizata e Partisë. Kështu duhet t'i gjykojmë edhe temat që zhvillohen në kurset, ato

¹ Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti «Mbi kurset 2 dhe 5-mujore të Partisë të qarqeve Durrës e Shkodër».

duhet të jenë vërtet teorike dhe të trajtojnë probleme aktuale, por të lidhen si duhet me praktikën, me detyrat. Këto tema të koordinohen e të rrihen në seksionin e agjitacionit e të propagandës dhe në kursin e Partisë. Mundet që vitin tjetër të referojnë po ata shokë që i kanë bërë këto tema ose edhe të tjerë. Në qoftë se janë të njëjtët referues, atëhere këto tema u jepen për t'i përmirësuar, duke pasur parasysh vërejtjet që u janë bërë prej kursantëve. Ose mund të jetë edhe ndonjë tjetër, që nuk ka mbajtur referat vitin e kaluar, në këtë rast atij i jepet tema për t'u orientuar e ndihmuar, pse ai do ta përgatitë këtë sipas mundësive dhe mënyrës së tij, sigurisht të lidhur me çështjet aktuale. Natyrisht kur ka tema të reja këto duhet të bëhen rishtazi. Ashtu sikurse u tha, referatet në kurse duhet të bëhen në kohën e caktuar.

Një çështje tjetër, që duhet t'u themi shokëve të komiteteve të Partisë, është që këta të mbajnë kontakt me drejtuesit e kurseve e t'i ndihmojnë ata në punën e tyre. Sekretari i parë i komitetit të Partisë mund të mos vejë çdo ditë në kurs, por do të bënte mirë sikur të shkonte të paktën një herë në muaj ose dy herë në tre muaj, pse këtu janë kuadrot me të cilët ai do të zgjidhë nesër çështje të rëndësishme që i dalin Partisë.

Juve që drejtoni kurset e Partisë, dëshiroj t'ju jap disa këshilla. Në radhë të parë mendoj të ndjeni përgjegjësinë e madhe që ju është besuar, pavarësisht nëse drejtuesit e Partisë në qarqe e rrethe nuk interesohen si duhet. Ju ju ka caktuar Partia me një detyrë të rëndësishme. Ju duhet të përpiqeni që shokët, të cilët dër-

gohen në kurs, të përvetësojnë mirë lëndën, pasi ata nesër do të shkojnë në organizatën bazë si gjak i ri dhe kështu do të forcohet Partia. Detyra që keni kërkohet që ju të ngreni vazhdimisht nivelin tuaj, të zgjeroni gjithmonë horizontin tuaj, pse po të mos jesh i pregatitur mirë, nuk do të jesh në gjendje t'u përgjigjesh pyetjeve të ndryshme që bëjnë kursantët. Prandaj, ju duhet të studjoni teorinë marksiste-leniniste, por të mos leni pasdore edhe kulturën e përgjithshme. Shokët që mbarojnë kursin duhet të ndahen nga ju me përshtypjet më të mira dhe, atje në fshat, ata ta kujtojnë kursin, të interesohen për të. Po edhe ju duhet të interesoheni për ata që kryejnë kursin, të mbani lidhje me ta, ata t'ju pyesin se si është kjo gjë, t'ju kërkohet, se kanë dëshirë, të venë në shkollën dyvjeçare të Partisë etj. Ajo që ka rëndësi të madhe është se ju duhet të jeni në dijeni të vendimeve të Partisë dhe të qeverisë. Sekretari i komitetit të Partisë, shefi i organizimit dhe ai i agjitacionit e i propagandës duhet t'ju mbajnë në korrent për vendimet që merren. Kjo është e domosdoshme, pse kursantët që mbarojnë duhet të jenë të armatosur jo vetëm me teori, por edhe me vendimet e Partisë e të qeverisë. Por nga ana tjetër edhe ju duhet të jeni këmbëngulës në kërkesat për të drejtat që ju ka dhënë Partia si drejtues të kurseve. Po t'i dini vendimet e Komitetit Qendror, atëhere kur ndonjëri prej tyre nuk zbatohet, do të keni mundësi që të shkoni në komitetin e Partisë e të thoni: «këtu nuk po zbatohet vendimi, në qoftë se ju nuk do të merrni masa do të njoftoj Komitetin Qendror». Në këto çështje duhet me qenë ekzigjentë. Në Parti çështjet duhet të ngrihen me forcë dhe të kërkohet llogari deri

lart, të mos mbeten formale fjalët që anëtari i Partisë ka të drejtë të drejtohet deri në Komitetin Qendror.

Për ata që vijnë në kurs duhet të organizohen disa aktivitete praktike, ku të përfitohet eksperiencë. Ata që janë sekretarë organizatash bazë, herë pas here duhet të shkojnë për të asistuar në mbledhjet e disa organizatave bazë sipas sektorëve ku kanë punuar. Duhet organizuar puna që këta të dërgohen për të marrë pjesë në ato organizata bazë, mbledhjet e të cilave janë me të vërtetë luftarake. Përpara se të shkohet lajmërohet komiteti i Partisë dhe merret autorizim prej tij. Edhe ata të fshatit mund të dërgohen disa herë nëpër organizata partie të fabrikave. Kjo gjë është e domosdoshme të bëhet. Prandaj, përgjegjësi i kursit duhet të jetë në kontakt me shokët e organizimit e të agjitacionit e propagandës. Kështu ka edhe aktivitete të tjera që mund të organizohen me qëllim që të përfitohet eksperiencia e mirë.

Në këto kurse të mësojnë edhe nga pastërtia e nga rregulli dhe në këtë drejtim duhet me qenë të rreptë. Po kështu, duhet interesim edhe për argëtimin e tyre, prandaj të dërgohen në kinema, në teatër, të organizohen lojna sportive etj. Gjatë kohës që shokët janë në kurs të interesoheni edhe për çështjen e shëndetit të tyre.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**LETËR E HAPUR DREJTUAR KOMISIONEVE
ELEKTORALE TË QARQEVE ME TË CILËN
I NJOFTON SE KANDIDATURËN PËR ANËTAR
TË KËSHILLIT POPULLOR TË QARKUT
DO TA VËRË NË ZONËN ELEKTORALE
NR. 11 TË TIRANËS**

2 mars 1954

Kam marrë njoftim me anë telegramesh nga mbledhjet e Frontit të zonave të ndryshme elektorale, se më kanë propozuar si kandidat për anëtar të këshillave popullore të qarqeve të ndryshme.

Unë u shpreh të gjithë zgjedhësve që kanë përkrahur kandidaturën time mirënjohje dhe falenderime për besimin e tyre ndaj meje, gjë që shpreh dashurinë e madhe që ushqen populli ynë për Partinë tonë të Punës dhe Frontin Demokratik të Shqipërisë.

Meqenëse në bazë të ligjit mbi zgjedhjet e këshillave popullore, çdo kandidat mund të paraqitë kandidaturën vetëm në një zonë elektorale, në bazë të udhëzimeve të marrura nga Komiteti Qendror i PPSH njoftoj se tërheq kandidaturën nga zonat e tjera elektorale dhe mbaj vetëm kandidaturën për në zonën elektorale Nr. 11 të qarkut të Tiranës.

Lutem që komisionet elektorale përkatëse të marrin shënim për këtë deklaratë dhe ta konsiderojnë si dokument të vlefshëm për regjistrimin tim si kandidat për anëtar të këshillit popullor të qarkut të Tiranës.

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 51 (1691), 2 mars 1954

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 51 (1691), 2 mars 1954

TE MERREN MASA QË KRIPA TË MOS MUNGOJË

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH*

6 mars 1954

Që të jenë më të qartë shokët, po flas edhe unë pak për çështjen e kripës. Plani nuk është realizuar dhe, përveç kësaj, 3 000 ton na i dëmtoi shiu. Por shiu nuk është i vetmi shkak, ka edhe shkaqe të tjera që kanë të bëjnë me organizimin e punës.

Na thanë se nuk ka kripë. Për ta vërtetuar këtë ne dërguam njerëz për kontroll dhe doli se kripa ishte peshuar gabim. Përveç kësaj, në qeveri dolëm me një sasi më të madhe nga sa ishte parashikuar për rezervë. Më vonë na doli përpara edhe firua. Ne kishim vendosur që kripën ta hiqim nga stimulacioni dhe ta linim të shitej lirisht, por gjendja në fshat është e tillë që tani për tani ajo s'mund të bëhet. Prandaj ne duhet të marrim disa masa që popullin të mos e lëmë pa kripë.

Kur pamë këtë gjendje ne u alarmuam dhe menjëherë urdhëruam që kripa të racionohet. Kështu racioni i saj u bë 250 gram në muaj për frymë, sasi kjo që

është shumë e paktë; u krijua kështu një situatë e vështirë për kripë. Por të mos harrojmë se edhe transportimi i kripës nuk është bërë në rregull. Si rrjedhim, janë në depo 1 400 ton. Ç'duhet bërë?

Në bazë të planit Ministria e Tregëtisë ka çuar në Veri një sasi rezervë, kështu që kripa disponibël është shpërndarë. Në malësi mund të ketë edhe sasi të tjera kripe, sa janë ato mund të shihen, por mund të bëhen edhe disa lëvizje. Gjithashtu Ministria e Tregëtisë do të transportojë kripë në të katër anët e vendit. Ajo dha urdhër që çdo fshatar që ka bono në xhep të marrë deri në 5 kg. kripë. Ata që nuk kanë bono do të çojnë, si deri tani, në dyqan vezë, lëkurë dhe do t'u jepet edhe atyre po kaq kripë. Të gjithë fshatarëve të malësisë që nuk kanë bono, u sigurohet një racion kripe prej 600 gram në muaj për frymë. Pra Veriu e ka kripën që i duhet dhe gjithë pjesa tjetër e Shqipërisë do të marrë gjithashtu kripë.

Me masat që janë marrë tani së fundi, fshatari do të furnizohet me kripë në sasinë që i është dhënë edhe më parë. Deri në fund të muajit ne do të përballojmë situatën e rëndë që është krijuar për kripë, mbasi importi i saj është i vështirë. Mendoj që në qoftë se janë ekzakte llogaritë që na jepen, se fshatari do të marrë kripë aq sa ka marrë edhe vitin e kaluar, atëhere nuk është nevoja të importojmë kripë. Ndryshe të merren masa që të importojmë brenda prillit 2 000 ton kripë. Të kontrollohen masat që janë marrë dhe të na raportohet zbatimi i tyre.

Byroja Politike dhe qeveria interesohen kaq shumë për çështjen e kripës, pse pa të s'mund të bëhet. Ka

probleme te ne që nuk zgjidhen si duhet, ky është fakt, po për çështjen e kripës nuk mund të bëhen lëshime, prandaj kemi përgjegjësi të madhe po ta lëmë popullin pa kripë. Në këtë situatë të vështirë kur kripa mungon, komitetet ekzekutive të kontrollojnë mirë kooperativat e shitblerjes, pse mund të na bëhen edhe shpërdorime, vjedhje e spekulime. Ky kontroll të shoqërohet edhe me punë politike nga Partia dhe nga levat e saja.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

MBI DISA ÇËSHTJE TË ADMINISTRIMIT TË DOKUMENTAVE TË PARTISË NË KORÇË

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

22 mars 1954

Në vija të përgjithshme jam dakord me projektvendimin që na është paraqitur. Juve, shokë të Korçës, ju hiqet vëmendja që nuk keni treguar kujdes për administrimin e Partisë, që është një çështje e rëndësishme nga e cila ne duhet të nxjerrim mësimë për të gjithë Partinë.

Administrimi i Partisë nuk duhet konsideruar si një çështje thjesht teknike. Instruksionet që janë ndër-tuar për këtë qëllim janë të domosdoshme të zbatohen, në qoftë se duam një parti të tipit të ri. Nga ana tjetër këto i shërbejnë udhëheqjes së Partisë në bazë dhe në qendër për të parë situatën dhe për të nxjerrë

¹ Në këtë mbledhje, ku merrnin pjesë edhe drejtues të Partisë në Korçë, u diskutua rreth relacionit «Mbi gjendjen jo të kënaqshme të administrimit të Partisë në qarkun e Korçës», paraqitur nga një ekip i Komitetit Qendror të PPSH.

konkluzionet përkatëse lidhur me forcimin e Partisë. Mënyra si plotësohen, si mbahen dhe si pasurohen dokumentat e Partisë, kartoteka e tyre, mbushja, përpunimi dhe shfrytëzimi i formularëve apo i raporteve statistikore, korrespondenca etj., që përbëjnë administrimin e Partisë duhet të vlerësohen me seriozitet të plotë nga komitetet e Partisë, personalisht nga sekretari i parë.

Sekretari i dytë i komitetit të Partisë, që ka çështjet organizative, duhet të merret kryesisht me administrimin e Partisë. Veç kësaj në këtë sektor duhet të jenë njerëz të mirë, të pastër politikisht e moralisht dhe të mos lëvizin shpesh, por të perfeksionohen e të kualifikohen gjithnjë e më shumë. Sa më i vjetër të jetë shoku që merret me tesër-evidencën, aq më mirë është. Rregullat e administrimit duhet t'i njohin edhe sekretarët e tjerë të komitetit të Partisë, me qëllim që të dinë të punojnë e të japin mendime deri në nivelin shkencor.

Shokët e Drejtorisë së organizimit të Komitetit Qendror duhet të jenë mjaft ekzigjentë në çështjet e administrimit të Partisë, të mos lejojnë gjëra të firmosura me laps dhe, për çështje të rëndësishme, të mos veprohet pa marrë aprovimin e byrosë së komitetit të Partisë ose pa dijeninë e sekretarit të parë. Çështja e firmës mund të duket e thjeshtë, por kjo ka rëndësi. Nuk mund t'i dërgohet Komitetit Qendror një shkresë ose dokument i firmosur pa kujdes dhe me kalem të kuq, siç ka ndodhur. Po të veprohet pa rregull atëhere çfarë administrimi është ky? Sekretari i dytë, nën kontrollin e byrosë së komitetit të Partisë, duhet të mbajë kontakt me komunistët, ky të jetë një kontakt

i gjallë nga i cili të informohet Partia, të dilet me propozime konkrete dhe jo të mbushen raporte e statistika formale dhe burokratike sa për t'ja dërguar Komitetit Qendror. Komiteti Qendror do që ato materiale që i dërgohen, jo vetëm të jenë në rregull, por të jenë të studjuara mirë dhe t'i shërbejnë përmirësimit të punës së Partisë. Mund të ketë edhe ndonjë kërkesë të tepërt që bën Komiteti Qendror, por pasi të plotësohet, le të bëhet kritikë. Ajo që kërkohet nuk duhet të votohet, po të jepet në afatin e caktuar.

Çështjet administrative të Partisë duhet t'i konsiderojmë nga çështjet më të rëndësishme të punës sonë. Për to duhet të interesohet jo vetëm sekretari i dytë, por edhe vetë sekretari i parë, megjithëse është i ngarkuar me mjaft punë dhe duhet të jetë në krye të të gjitha detyrave. Sekretari i parë duhet ta presë me shumë interesim korrespondencën e Komitetit Qendror. Kjo nuk do të thotë se ai është zbatuesi praktik i çdo gjëje. Pasi e studjon korrespondencën, ja kalon për veprim sekretarit të dytë ose shokëve të tjerë sipas rasteve dhe kontrollon e ndihmon që punët të kryhen në kohën e caktuar. Nga ana tjetër duhet që edhe aparati i Komitetit Qendror të japë shembullin në marrëdhënjet me komitetet e Partisë, duke zbatuar të gjitha rregullat e caktuara dhe duke u përgjegjur në kohë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

GRUAJA T'I FITOJË VETË TË DREJTAT, ME LUFTËN E SAJ E ME NDIHMËN E PARTISË

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

22 mars 1954

Çështja e emancipimit të gruas në rrethin e Kavajës është mjaft serioze. Gjendja që na u raportua këtu duhet ta bëjë Komitetin e Partisë të qarkut të Durrësit dhe atë të rrethit të Kavajës që të marrin një sërë masash për të forcuar punën edukative me njerëzit për përparimin e gruas me hapa më të shpejtë në atë rreth. Edhe në rrethin e Kavajës ka një patriotizëm të madh, por ekzistojnë prapambetja dhe pengesat që gruaja të mos e gëzojë lirinë e vërtetë, siç kërkon Partia.

Është e vërtetë se çështja e fanatizmit në këtë rreth nuk paraqitet si në Shkodër, ku ka një propagandë fetare të organizuar nga ana e klerit katolik e të

¹ Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti «Mbi punën e Partisë me gruan në rrethin e Kavajës», paraqitur nga një ekip i Komitetit Qendror të PPSH.

drejtuar sistematikisht kundër organizatës së Partisë. Megjithatë, edhe kleri musliman në Kavajë mbështetet në mbeturinat e së kaluarës dhe mundohet të pengojë zhvillimin dhe emancipimin e gruas në këtë rreth. Partia duhet të vigjilojë dhe të luftojë kundër elementëve, të cilët e përdorin fenë për të penguar ecjen përpara të gruas. Kur shikojmë që njëri bën nuska, menjëherë të marrim masa për t'u shpjeguar njerëzve kotësinë e këtij veprimi dhe arësyet pse nuk i duhet besuar. Kur një njeri thotë se gruaja nuk duhet të dalë pa perçe, Partia të përpiqet ta sqarojë dhe po që nevoja edhe ta demaskojë atë që i nxit këto. Përpara do të na dalë propaganda e fesë muslimane sipas së cilës «gruaja muslimane nuk duhet të dalë me kokë përjashta», prandaj ne duhet ta forcojmë propagandën tonë dhe ta godasim atë me argumenta se në Shqipëri nuk është muslimane vetëm Kavaja dhe të luftojmë konceptin se ato që s'kanë perçe janë gra të shndershme. E them këtë se armiku, me qëllim që të bëjë punën e tij, kapet shumë nga nderi. Propaganda jonë t'u kundërvihet si punës armiqësore, ashtu dhe koncepteve të huaja në çdo formë që shfaqen ato. Siç thashë, në Kavajë nuk ka ndonjë punë të organizuar nga ana e klerit, por janë të theksuara mbeturinat e fanatizmit dhe në këtë drejtim duhet të zhvillohet puna e Partisë. Forca e zakonit prapanik duhet të thyhet dhe këtë duhet ta thyejnë në radhë të parë komunistët.

Mua më duket se në Kavajë puna e Partisë nuk është në lartësinë e duhur, pse në mjaft fshatra të saj s'ka asnjë komunist. Nuk janë në rrugën e Partisë disa shfaqje që vihen re në atë rreth: ka gra që dalin në

ara z bathur, shumë gra e ndjejnë veten inferiore para burrit, në shumë raste ato konsiderohen si shërbëtore etj. Kundër këtyre mbeturinave të feudalizmit, Partia nuk ka punuar si duhet që ta bindë gruan se është e barabartë me burrin dhe se ajo punon më shumë se burri. Të drejtat që ka fituar gruaja te ne me ligj duhet të realizohen edhe në jetë.

Lufta e klasave në Kavajë nuk duhet të bëhet formale, por në tërë gjerësinë dhe thellësinë e saj. Luftën e klasave nuk duhet ta kuptojmë vetëm kundër kulakëve, armiqve, por edhe kundër mbeturinave të vjetra e koncepteve të huaja që na pengojnë në rrugën tonë. Këto mbeturina janë edhe në ndërgjegjen e njerëzve të popullit, të fshatarëve të thjeshtë, prandaj lufta e klasave zhvillohet edhe në gjirin tonë. Këtë duhet ta kuptojmë mirë pse ndryshe nuk mund të luftohet kundër mbeturinave të vjetra në ndërgjegjen e njerëzve. Kjo luftë ideologjike, duhet shoqëruar edhe me masa organizative. Për shembull, nuk mund të kemi suksese në çështjen e përparimit të gruas pa pjesëmarrjen e saj në prodhim, pse çlirimi ekonomik i gruas është vendimtar në rrugën e emancipimit të saj. Në fshat gruaja merr pjesë më shumë në punë, por duhet vepruar më mirë me gratë në qytet që edhe ato të marrin pjesë në prodhim.

Çështja tjetër është lufta për edukimin politik të masave të grave, që zhvillohet nëpërmjet shumë formave e mjeteve siç janë konferencat, kurset, shtypi etj. Të gjitha këto kanë rëndësi të madhe për ngritjen e nivelit të gruas, që ato të kuptojnë rolin e madh që kanë në shoqëri dhe detyrat e tyre.

Në punën edukative-politike me gratë, Partia të aktivizojë sa të jetë e mundur më shumë mësueset, të cilat të mbahen afër dhe të bëhen mbështetje e organizatës së Partisë. Prandaj, krijoni në fshat disa aktive me mësuese dhe aktiviste të tjera dhe këto aktive t'i udhëheqë organizata e Partisë. Mbledhjet e gruas mendoj se nuk është mirë që të bëhen natën, atje ku ka mundësi që ato të zhvillohen ditën.

Të vijmë përsëri te çështja e gruas në fshat. Do të lejojmë ne që në organizatat e Partisë të fshatit të mos ketë gra komuniste? Jo, nuk do ta lejojmë. Partia duhet të punojë që të pranojë në radhët e saja edhe gra, me aq sa dinë shkrim e këndim, pastaj ato t'i edukojë, t'i ngrejë e t'i bëjë luftëtare. Komunistët e fshatit duhet ta shikojnë këtë çështje dhe ta zgjidhin gradualisht duke luftuar çdo shfaqje të konservatorizmit.

Një problem i rëndësishëm është barazia midis gruas dhe burrit në familje. Partia jep direktivën që gratë të marrin pjesë në prodhim dhe ato punojnë e dallohen, prandaj të propozohen edhe për t'u dekoruar. Kjo do të bëjë që të kuptohet mirë e drejta e barabartë që ka gruaja me burrin. Nuk duhet të nisemi nga mendimi i gabuar që burri t'i japë të drejtën gruas, por nga parimi që gruaja duhet t'i fitojë vetë këto të drejta, me luftën e saj, me ndihmën e Partisë. Një komunist që vazhdon të sillet me gruan si në kohën e feudalizmit, duhet të përgjigjet para Partisë në qoftë se ai i përdor gruan dhe kalamanët si shërbëtorë të tij. Kjo nuk mund të lejohet në asnjë mënyrë. Çështje të tilla duhet të ngrihen me forcë në organizatën e Partisë. Ata që i

kuptojnë këto gjëra siç kërkon Partia, kanë për detyrë që të luftojnë deri në fund që këto t'i kuptojnë edhe të tjerët. Të jesh komunist është nder i madh, por ky titull është i papajtuar me mbeturinat e së kaluarës, prandaj Partia duhet të luftojë që t'i bëjë komunistët të ndërgjegjshëm për detyrat e mëdha që kanë si njerëz të pararojës dhe si shembull i lartë në çdo drejtim.

Kryesorja është që çështjen e gruas ta marrë mirë në dorë Partia. Veç kësaj, organizata e gruas duhet të ndihmohet më tepër edhe nga organizata e rinisë. Kemi disa konstatime se në fshatra ka raste që të rinjtë s'mblidhen as për vete, kurse Partia kërkon që organizata e rinisë jo vetëm të jetë vetë në rregull, por të ndihmojë edhe për forcimin e organizatës së gruas. Rinia duhet të jetë një forcë e madhe revolucionare në familje dhe nuk duhet të ndodhë që të rejaq porsa të mbarojnë shkollën të mbulohen me perçe. Ato duhet t'u thonë prindërve të tyre: «dale se tani puna ka ndryshuar, unë do të punoj dhe do të ndihmoj familjen». Si ky problem ka dhe të tjerë, për zgjidhjen e të cilëve mendoj që organizata e gruas dhe ajo e rinisë të marrin masa të përbashkëta.

Unë jam dakord që të zhvillohet aktiviteti i Partisë në Kavajë për çështjen e gruas, bile të organizohet mirë, të marrin pjesë komunistë, gra dhe aktiviste të gruas. Por duhet kuptuar mirë se puna e Partisë me gruan nuk zgjidhet me një aktiv. Çështja e gruas është një çështje e madhe botëkuptimi, që kërkon një luftë të vazhdueshme ideologjike, kundër sjelljeve dhe koncepteve të vjetra që i kanë skllavëruar masat e grave shekuj të tjerë. Komunistëve t'u vihet si detyrë që të

jenë shembull në marrëdhënjet me gratë e tyre, të cilat të dalin lirisht në punë e jo të mbyllen nën perçe ose në katër muret e shtëpisë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekreta-
riatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

FJALA E MBAJTUR NË KONFERENCEN I KOMBËTARE TË PUNONJËSVE TË NBSH DHE SMT

27 mars 1954

Të dashur shokë dhe shoqe,

Ju përshëndes në emër të Komitetit Qendror dhe të qeverisë dhe ju falenderoj për dashurinë e besnikërinë e madhe që tregoni karshi Partisë dhe qeverisë.

Ne të gjithë ndoqëm me vëmendje të madhe Konferencën I Kombëtare të punonjësve të ndërmarrjeve bujqësore dhe të stacioneve të maqinave dhe të traktorëve, që zhvilloi punimet brenda këtyre ditëve. Kjo konferencë qe një shkollë e madhe për të gjithë pa përjashtim, për ju dhe për udhëheqjen e Partisë e të shtetit. Me siguri mund të themi se konferenca ja arriti qëllimit të saj dhe rrjedhimet e mira shpejt do të duken në bujqësinë tonë.

Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, përveç masave të shumta që kanë marrë dhe do të marrin për një zhvillim akoma më të madh të sektorit të rëndësishëm të bujqësisë, caktuan gjithashtu si detyrë organizimin e konferencave me karakter nacional dhe lokal. Ju e dini se edhe pu-

nonjësit e dalluar të kulturës së pambukut u mblodhën në konferencë, diskutuan problemet e tyre dhe morën vendime të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të kësaj kulture. U zhvilluan gjithashtu konferenca me karakter lokal, për zhvillimin e kulturave të pambukut dhe të duhanit, në të gjitha qarqet ku mbillen këto kultura. Suksesi i këtyre konferencave ka qenë jashtëzakonisht i madh dhe përfitimet do të jenë të pallogaritshme. Zotërit e tokës, të maqinave dhe të traktorëve, blegtorët tanë të pajisur me eksperiencën shekullore të gjyshërve dhe të stërgjyshërve tanë, gjithë fshatarësia jonë heroike, që Partia jonë e lavdishme e nxori përgjithmonë në dritë, janë hedhur me një hov të madh në punë për të korrur suksese të mëdha në bujqësi dhe në blegtori. Kudo zien puna në fushat tona ku gjelbëron gruri.

Punonjësit e bujqësisë në këtë konferencë u armatosën për beteja të reja, dhe kur përgatitet mirë beteja dhe sulmi, kur ekziston ky entuziazëm dhe guxim i madh, kur ekzistojnë vendosmëria dhe siguria në jetën dhe në të ardhshmen, siç ekzistojnë te populli ynë, fitoret janë të sigurta. Ne do të korrin fitore, ne do të marrim drithëra më shumë se vitin tjetër që ka qenë një vit i mbarë bujqësor dhe jeta e popullit tonë do të përmirësohet akoma më shumë.

Mirëqenja e popullit, ngritja e nivelit të jetesës së tij duhet të jenë qëllimi ynë kryesor, i të gjithë punonjësve dhe i udhëheqjes. Në konferencën e punonjësve të dalluar të duhanit, që u mbajt në Elbasan, një fshatar, që para çlirimit ka qenë si mos më keq, i rjepur dhe i shtypur nga bejlerët dhe feudalët, që s'kishte asnjë

pëllëmbë tokë, që s'kishte të sigurtë as jetën e tij, as të kalamanëve, u ngrit dhe tha:

«Dëgjoni, or burra, mrekullina kanë ngjarë në jetën time që mat ditë që na shpëtoi Partia. Pushteti popullor më dha tokë. Merreni me mend sa i uritur isha për atë tokë dhe kur e mora, sido që ajo ishte e braktisur, me gjemba e me ujë i thashë: tokë, moj tokë e bukur, tash e ke gjetur zotin tënd dhe do të të rregulloj sipas qejfit. Dhe ju futa punës. Kush e kishte parë më përpara atë tokë, tash nuk mund ta njohë, dora ime atë e ndryshoi. Ajo tash është një kopësht. Tetë vjet me radhë, pavarësisht nga moti, çdo sene, unë kam marrë vazhdimisht 35 kuintalë grurë për hektar. Barkun dhe hambarët i kam pasë plot, kam kryer plotësisht detyrat karshi klasës sonë punëtoare që na udhëheq në socializëm; shtëpi s'kisha, shtëpi bëra; asnjë filxhan s'kisha, sot kam mobilje dhe krevate; kalamanët i kisha zbathur e pa brekë, sot i kam me shkollë, i kam trima, i kam shtylla për atdheun. A e dini, or burra e gra, si e lulëzova unë jetën time që ma mbron Partia ime e dashur? Me punë, vetëm me punë. Puna të nxjerr në selamet, puna është çdo gjë, puna është nder dhe prandaj Partia jonë është e nderuar».

Kështu foli fshatari nga Elbasani. Ne këtu dëgjua me emocion të madh fjalimin e mëmës plakë heroike nga Delvina që është rritëse shpendësh në ndërmarrjen bujqësore, që mban emrin e datës më të shënuar të historisë së popullit, «8 Nëntorin», datëlindjen e Partisë. Historia e jetës së kësaj nëne i ngjet, pikë për pikë, jetës së fshatarit të Elbasanit dhe jetës së çdo punonjësi të Republikës sonë Popullore.

Traktoristi nga Kavaja Shyqri Kanapari që foli këtu tha:

«Traktori që më ka dhënë Partia është imi, atë do ta ruaj si sytë e ballit, atë do ta mbroj si gjënë time më të shtrenjtë, atë do ta vë në shërbim të fshatarësisë dhe s'do të jetë nevoja që fshatari të kontrollojë punën time, pse do ta kryej punën në mënyrë të përsosur, sipas agrorregullores».

Me gojën e këtij traktoristi hero, flet klasa jonë punëtore e lavdishme, e ndërgjegjshme për rolin e saj udhëheqës të fateve të popullit, flet populli ynë dhe thotë: «Jam zot i fateve të mia dhe jetën vetë do ta zbukuroj, ashtu si na ka mësuar Lenini i madh, ashtu si na ka mësuar vazhduesi i madh i veprës së Leninit, Stalini, ashtu si na mëson Partia jonë, që ndjek me guxim dhe me besnikëri mësimet e Partisë Komuniste të BS».

Një tjetër shok punëtor nga ndërmarrjet bujqësore shtetërore, me një modesti dhe zjarr që janë karakteristika të popullit tonë, u shpreh dhe tha: «Partia dhe shteti na i kanë krijuar të gjitha mundësitë të punojmë dhe të prodhojmë sa më shumë për popullin, t'i përdorim armët tona të bujqësisë për të prodhuar, ashtu siç i përdorin armët rojet heroike të kufirit që mbrojnë natë e ditë atdheun tonë të dashur, jetën tonë, fitoret tona, paqen në botë».

Unë vura në dukje thelbin e disa diskutimeve ndër-mjet dhjetëra e dhjetëra të tjerave të po kësaj natyre, të shprehura po me këtë forcë, po me këtë entuziazëm, për të treguar hovin e madh revolucionar që karakterizon punonjësit e bujqësisë sonë dhe mundësitë e mëdha

që ekzistojnë për të zgjidhur më së miri problemin e bujqësisë në vendin tonë. Prandaj mund të themi që këto konferenca kanë qenë shkolla për të gjithë dhe eksperiencia e fituar këtu duhet të përhapet dhe të përvetësohet nga të gjithë.

Ju, punonjës të dalluar të SMT-ve, të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore, kooperativistë dhe bujq të dalluar duhet të jeni pionierët e kësaj lëvizjeje të madhe bujqësore, lëvizje që duhet të shkojë çdo ditë duke u zgjeruar. Vetëm kështu bujqësia jonë do të shpëtojë nga prapambetja. Kini kurdoherë parasysh fjalën e popullit që thotë se me një lule s'vjen behari. Është i bukur behari se gjelbërojnë kopshtiet dhe arat, se gruri si flori piqet në ara, se pambuku i bardhë si bora zbukuron fushat dhe si ka thënë poeti ynë i madh Naimi «sa bukuri ka tufa, sa gaz bie bagëtia, vijnë mu si bletë e plotë...». Jeta e njerëzve në Shqipërinë e re duhet të bëhet një behar i përhershëm dhe mjeshtri i mrekullueshëm i këtij transformimi është vetë populli dhe Partia e Punës që përfaqëson dëshirat dhe aspiratat e popullit tonë, që i konkretizon këto dëshira me vepra të çmueshme. Leninizmi na mëson se gjëja më e çmueshme në botë është njeriu. Prandaj njeriut duhet t'i kushtojmë kujdesin dhe vëmendjen më të madhe. Dora dhe mendja e njeriut transformojnë natyrën, prandaj duhet të gëzojë shëndet të mrekullueshëm dhe të pajiset me dituri. Këto dy detyra të shenjta, nga më të shenjtat, ja ka vënë vetes Partia, jua ka vënë juve, bijve dhe bijave më të mirë të popullit dhe të Partisë. Të jemi të ndër-gjegjshëm, t'i kryejmë me nder këto detyra, të udhëheqim popullin me shembullin tonë, me punën tonë plot

sakrifica dhe vetëmohim, për të krijuar bollëkun për popullin, për të përhapur diturinë, shkencën e përparuar sovjetike në popullin tonë. Ne kurrë nuk duhet të kënaqemi me sukseset që kemi arritur dhe me çka kemi mësuar deri tash. Këto janë një hap i madh në jetën e popullit tonë, por kjo s'është kurrë e mjaftueshme, ne jemi akoma shumë prapa. Të mos dehem i dhe të mos na rritet mendja nga sukseset, kjo jo vetëm që s'është e mirë, por është dhe shumë e dëmshme. Populli nuk i do njerëzit që u rritet mendja. Populli ynë, i thjeshtë dhe heroik, është i etur për dituri, për metoda të reja, për eksperiencë të re, por këto të jenë stoli të çmueshme dhe të frutshme për njeriun e ri të Shqipërisë së re dhe të vihen në shërbim të interesit të përgjithshëm. E kam fjalën, shokë të mi, në çështjen që punonjësit e dalluar kudo që janë, ata të klasës punëtore, të fshatarësisë punonjëse, të inteligjencies, të mos kënaqen kurrë me ato që kanë mësuar, detyra e tyre është që çdo ditë të bëjnë përpjekje, të perfeksionojnë njohuritë e tyre dhe çka është shumë e rëndësishme këto njohuri, t'i përhapin në masat e gjera të popullit, të jenë të palodhur në këtë drejtim, të jenë të durueshëm dhe të guximshëm.

Në të gjitha konferencat që janë bërë për bujqësinë kam konstatuar me kënaqësi të madhe një interesim të jashtëzakonshëm nga ana e fshatarësisë, për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë, për teknikën e përparuar, për metodat e përparuara agroteknike sovjetike, për të cilat flasim me admirim fshatarët. Ndryshime të mëdha janë bërë në bujqësi. Të kemi parasysh se ka perënduar koha kur fshatarët me zor kontraktin me SMT-në, pse

gjoja traktori ua ngjishte tokën, ose nuk e merrnin plehun kimik se u «digjte bimët», ose me zor i pranonin këshillat e teknikëve të ndryshëm të bujqësisë etj. Fshatari tani kërkon shumë e më shumë traktorë, maqina të tjera bujqësore, plehra kimike, ai kërkon më shumë teknikë të çfarëdollojshëm, ai ka një dashuri dhe admirim të veçantë për teknikët tanë të rinj. që bëjnë një punë shumë të vlefshme për zhvillimin e bujqësisë dhe të blegtorisë. Fshatari kërkon me të drejtë dhe ne duhet t'i japim e do t'i japim. Ne kemi mundësi të mëdha të brendshme, të cilat duhet t'i shfrytëzojmë në kulm dhe t'i vëmë në lëvizje. Ne çdo vit kemi ndihmën e popullit sovjetik, veçanërisht për sektorin e bujqësisë. Ne nuk do të ecim më si qorrat në bujqësi. Por ne duhet të dimë të përfitojmë sa më shumë dhe sa më mirë nga eksperiencia e madhe që na jepet nga Bashkimi Sovjetik dhe nga vendet e demokracisë popullore. Ne duhet ta organizojmë punën në atë mënyrë, që populli të ketë sa më shumë prodhime bujqësore dhe blegtorale, sa më shumë prodhime të fabrikuara, popullit t'i japim më shumë banesa, shkolla, spitale, kinema, teatro, çerdhe etj.

Ky duhet të jetë preokupacioni ynë kryesor, ky duhet të jetë qëllimi ynë i lartë dhe në këtë drejtim duhet të punojmë seriozisht me të gjitha forcat e zemrës, të mendjes dhe të trupit tonë. Shihni shokë sa mundësi të mëdha kemi! Këtu folën traktoristë heronj, traktoristi shkodran Budo Isufi që punon për vitin 1957 dhe në dhjetorin e vitit 1954, do të plotësojë planin e vitit 1958. Traktoristë të tjerë thanë se i kanë kursyer

shtetit me dhjetëra mijë kuintalë karburant, të tjerë thanë se traktorët nuk u janë prishur, se luftojnë dhe kanë arritur suksese të mëdha në ekonomizimin e veçglave të ndërrimit. Si këta ka me dhjetëra në Shqipëri. Duhet të jenë me qindra.

Lexoni, shokë punëtorë të stacioneve të maqinave dhe të traktorëve, parullën që kemi atje në mur e cila thotë: «SMT-ja të bëhet një levë e fuqishme për ndërtimin e socializmit në fshat». Sa nder i madh për ju, sa besim të madh ka Partia te ju! Mendoni ç'pret fshatarësia nga ju, nga djemtë dhe bijat nga më të mirët e klasës punëtore që ajo ka dërguar në fshat për të ndërtuar socializmin. SMT-ja është leva e fuqishme e ndërtimit të socializmit në fshat. Të ndërtosh socializmin në fshat, veçanërisht te ne, që jemi një vend bujqësor, është nder dhe lavdi. Të ndërtosh socializmin në fshatin shqiptar, do të thotë ta kthesh bujqësinë nga një gjendje e prapambetur në një bujqësi socialiste, të ecësh me sukses drejt kolektivizimit, do të thotë të krijosh bollëkun në vendin tonë, të krijosh mirëqenjen. Mos harrojë kurrë klasa jonë e re punëtore se në fshat ka vështirësi, lodhje dhe ekzistojnë akoma mentalitete të vjetra mikroborgjeze. A mund t'u trembet klasa jonë punëtore këtyre vështirësive? Në asnjë mënyrë jo! Ajo i ka dhënë provat edhe përpara vështirësive shumë më të mëdha dhe ka fituar. Klasa jonë punëtore dhe ju punëtorët e SMT-ve, pjesë luftëtare e kësaj klase, e dini fare mirë se «s'ka kala që s'mund ta marrin komunistët», kështu ju mëson Partia juaj. Por kalatë merren me organizim të shëndoshë, me punë të palodhur dhe duke qenë të armatosur. Armët t'i ka dhënë në do-

rë Partia, mbaji mirë dhe përdori mirë. Bëhu shembull disipline, ashtu si e kërkon disiplinën klasa punëtore dhe pararoja e saj Partia, armatosu me dijeni dhe mos e konsidero veten një traktorist të thjeshtë. Ti duhet të jesh njëkohësisht një organizator i shquar në punë, që të marrë shembull fshatari nga ti, duhet të pajisesh me metodat e reja të agroteknikës që ta kryesh mirë detyrën dhe këto t'ja mësosh fshatarit, ta organizosh punën e tij në këtë drejtim, ta ndihmosh dhe ta kontrollosh. Fshatari të marrë shembull nga ti për punën vetëmohuese, të shohë si e lidh ngushtë interesin tënd personal me interesin e përgjithshëm. Kur të shohë fshatari që ty nuk të zë gjumi për t'ja punuar mirë tokën, ai do të thotë se «ne jemi një familje e madhe, të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin», ose «kur isha vetëm mbillja, por korrja pak», dhe lehtë do të gjejë arësyeën e lulëzimit të ekonomisë së tij. Kur ti të ruash mirë traktorin, kur ti të kursesh karburantin, fshatari do të thotë, «ja njeriu i ri që rrit dhe edukon Partia, ai e ruan mallin e popullit si gjënë e tij më të shtrenjtë». Të jesh shembull disipline, ndershmërie, patriotizmi, karakteristika të larta të klasës sonë punëtore dhe të popullit tonë. Mendohu, shoku traktorist, se po t'i kryesh me nder këto detyra të shenjta, ti në fshat ke çuar frymën e madhe të revolucionit popullor, ti ke çuar leninizmin, ti ke ndihmuar në ndërtimin e socializmit në fshat, ti i ke përgatitur fshatarët materialisht dhe shpirtërisht për kolektivizim. Partia jonë dhe Komiteti i saj Qendror janë të bindur se këtë detyrë të madhe ju, punëtorët e stacioneve të maqinave dhe të traktorëve, do ta kryeni me nder. Organizoni mirë punën, shfrytëzoni

si duhet traktorët, i ruani ata si gjënë tuaj më të shtrenjtë, të jetë traktori për ju një simbol nderi dhe lavdie dhe jo vetëm një mjet i thjeshtë dhe pa shpirt; perfeksionohuni çdo ditë në punën tuaj, ndihmoni shokët tuaj të mësojnë, formoni kuadro të rinj traktoristë se çdo vit ne do t'i shtojmë traktorët. Qeveria ka marrë një sërë vendimesh në lidhje me trajtimin tuaj. Unë jam në dijeni se, nga burokratizmi që ekziston për fat të keq në aparatet tona, shumë gjëra nuk ju plotësohen me kohë. Një gjendje e tillë duhet të marrë fund jo vetëm në sektorin tuaj, por në të gjithë sektorët. Kemi marrë dhe do të marrim masa kundër të gjithë atyre burokratëve të pashërueshëm që pengojnë ecjen përpara.

Shikoni sa mundësi të mëdha kemi ne po ta organizojmë punën si duhet; po të dimë t'i shfrytëzojmë si duhet këto mundësi ne do t'i shtojmë pa masë prodhimet tona. Po t'u hedhim një sy fermave tona shtetërore, do të shohim se në to janë arritur rezultate të kënaqshme; brenda për brenda këtyre fermave dhe në sektorë të ndryshëm të tyre ne shohim të arrihen rendimente të larta si në drithëra, në bimë industriale, në rritjen e kafshëve dhe të shpendëve. Pse ngjet kjo? Kjo ngjet se punonjësit e sektorëve, ku janë arritur këto rendimente, punojnë mirë, s'i zë gjumi, janë organizatorë të mirë, u dhimbset gjëja e shtetit dhe e popullit. Ja si u shpreh një rritës i derrave në Elbasan: «Përpara kam qenë fanatik, por tash derrat i kam në shpirt sidomos për gicat e vegjël kujdesem shumë».

Është e natyrshme që një dosë t'i japë atij 20 gica. Ky punëtor shembullor e ka kuptuar mirë se si duhet të luftojë për interesin e popullit dhe të kolekti-

vit. Por a ka mundësi që në fermat tona shtetërore të ndryshohet krejtësisht gjendja dhe atje të mos ketë më sektorë të prapambetur? Ka mundësi, por vetëm duke korrigjuar të prapambeturit, duke luftuar neglizhencën dhe burokracinë e mjaft drejtorëve fermash dhe të disa teknikëve që po myken, duke mprehur në kulm vigjilencën e punonjësve kundër këtyre burokratëve dhe dembelëve që nuk kryejnë detyrën dhe hanë bukën e popullit kot. Gjithashtu edhe nga Ministria e Bujqësisë duhet të organizohet ndihma më mirë jo vetëm për fermat shtetërore, për sektorin privat të bujqësisë e për atë socialist, deri te stallat e viçave e te zgjojtë e bletës. Ministria e Bujqësisë duhet të kujdeset më shumë për ngritjen e kuadrove të bujqësisë dhe në radhë të parë për jetën e punonjësve të bujqësisë në SMT, në ferma e gjetkë, të organizojë përhapjen e eksperiencës sovjetike dhe të njerëzve të dalluar të bujqësisë sonë.

Pra punonjësit e fermave bujqësore shtetërore duhet të luftojnë pareshtur me gabimet dhe me vështirësitë dhe të mos harrojnë se shteti pret prej tyre jo vetëm të realizojnë dhe të tejkalojnë planet në të gjitha kulturat, me kualitet të mirë dhe në kohën e duhur, por njëkohësisht kërkon prej tyre që të bëhen shembull dhe ndihmës të çmueshëm për sektorin kooperativist dhe privat të bujqësisë.

Në kooperativat bujqësore ka një përparim të dukshëm, ato shumë herë ja kanë kaluar edhe fermave në rendimentet e kulturave. Një mobilizim dhe një entuziazëm i madh ekziston në gjirin e kooperativistëve. Jeta e kooperativistëve tanë është përmirësuar.

Le të çirren radiot e armiqve të vendit tonë dhe të paqes, duke pretenduar se «dështoi kooperativizmi në Shqipëri». Kooperativistët tanë tallen me këto shpifje dhe thonë «na marrshin të keqen dhe le të pëlcasin armiqtë». Por kooperativistët tanë nuk duhet të kënaqen me këto suksese që kanë arritur. Ata duhet të luftojnë që çdo vit të shtojnë prodhimet, të shtojnë rendimentin në të gjitha kulturat, të shtojnë bagëtitë dhe kafshët e punës, të shtojnë shpendët. Kooperativat tona duhet të luftojnë kundër vetëkënaqësisë dhe kundër shfaqjeve të huaja të disa drejtuesve, të cilëve u rritet mendja dhe harrojnë statutin, rregullat e tij dhe asamblenë e kooperativës. Kooperativistët të luftojnë kundër burokracisë në aparatet e kryesive të tyre, të forcojnë disiplinën financiare, të forcojnë organizimin. Partia në kooperativa duhet të forcohet e të drejtojë më mirë dhe të mos harrojë për asnjë çast se kooperativat duhet të bëhen shembull për fshatarësinë punonjëse individuale. Kooperativizmi në vendin tonë do të përparojë në baza të shëndosha vullnetarizmi, ne as nuk do të shpejtohem, po as nuk do të qëndrojmë në vend dhe çdo ditë, çdo vit Partia do ta forcojë situatën në këtë drejtim, do t'i krijojë kurdoherë e më shumë konditat për të ecur përpara.

Mundësitë e një zhvillimi shumë të madh të bujqësisë në sektorin privat janë gjithashtu shumë të mëdha. Jeta dhe puna e kanë treguar këtë dhe kjo u pasqyrua shkëlqimisht në konferencat e ndryshme që u mbajtën për bujqësinë ku u tregua se me qindra bujq privatë të dalluar kanë arritur të marrin në kultura të ndryshme rendimente të tilla që të habitin. Në Konferencën e

kultivuesve të dalluar të duhanit në Elbasan, nuk luftohej për një rendiment në duhan prej 6 ose 7 kuintalë për hektar. Jo, atje luftohej për 15, 18, 25 dhe 26 kuintalë duhan për hektar. Sekretari i këshillit të fshatit Mëliz, njeri energjik, që kishte mbaruar ushtrinë e që mbronte me zjarr interesat e popullit të fshatit të tij, u ankua që komiteti ekzekutiv i qarkut «nuk kishte marrë parasysh kërkesën e fshatit të tij dhe kishte caktuar për duhan toka që nuk e prodhonin duhanin». Më në fund ai doli me konkluzionin se tokat e fshatit të tij «nuk bënin për duhan», se mund të merrej një rendiment vetëm prej 11 kuintalë për hektar. Ai s'ishte i kënaqur për këtë gjë, por megjithkëtë padrejtësi që bëhet nga komiteti «ne do të luftojmë — tha ai — që të marrim 16 kuintalë për hektar». Të tilla gjëra ngjajnë për pambukun, për grurin, për misrin etj. Shikoni pra, ç'mundësi të mëdha ka, të cilat ne duhet t'i shfrytëzojmë. Mendoni pak sikur këta bujq të dalluar të mos jenë me qindra ose me mijëra, siç janë sot, por të bëhen me dhjetëra mijë, ç'bollëk do të krijojmë ne për popullin tonë. Ne patjetër do ta bëjmë këtë gjë, do të forcojmë punën tonë organizative, politike dhe teknike, ashtu siç na mëson Partia jonë dhe siç na ka vënë detyrë Komiteti Qendror i Partisë dhe qeveria.

Qeveria jonë dhe Komiteti Qendror, siç e dini, morën një sërë masash verën e kaluar për bujqësinë dhe fshatarësinë dhe këto masa të favorshme dhanë efektin e tyre. Kthesa vendimtare në zhvillimin më me vrull të sektorit të bujqësisë, organizimi më i mirë i punës së Partisë dhe i organeve shtetërore në këtë drejtim dhe konditat klimaterike të favorshme të vitit të kaluar, bënë

që vjet ne të kishim një vit bujqësor të mbarë, pas tre vjetësh thatësire. Populli vitin e kaluar u furnizua më mirë me prodhime bujqësore dhe blegtorale. Rendimentet në kulturat e drithërave dhe të bimëve industriale u ngritën dhe disa herë edhe u tejkaluan nga plani i caktuar. Por ne jemi akoma shumë prapa, ne duhet të bëjmë përpjekje të mëdha në këtë drejtim, pse kemi shumë gabime dhe të meta që nga lart deri poshtë. Gabimet dhe të metat duhet t'i njohim, t'i godasim dhe të mos i përsëritim, pse vetëm kështu do të ecim përpara, pavarësisht se armiqtë e popullit tonë do të përpiqen ta shfrytëzojnë autokritikën tonë. Aq punë na prish, ata le të lehin, le të çirren «Zëri i Amerikës», për atë punë paguhet nga gjakpirësit e Uoll Stritit. Tymi ynë të shkojë drejt. Ne nuk kemi frikë as nga armiqtë, as nga të çjerrat e tyre dhe as nga njohja e gabimeve tona.

Për vitin në vazhdim, të mobilizohen gjithë punonjësit e vendit tonë me klasën punëtore në krye për të realizuar me sukses detyrat e planit që na ka shtruar përpara Partia dhe qeveria. Klasa punëtore, në fabrika, në miniera, në ndërtim është mobilizuar me të madhe për të realizuar planin dhe t'i japë popullit tonë, fshatarësisë punonjëse më shumë se vitin e kaluar stofra të pambukta dhe të leshta, më shumë sheqer, më shumë plugje e të tjera prodhime të konsumit të gjerë. Në lëmin e bujqësisë të gjithë punonjësit të mobilizohen fuqimisht që të arrijnë rendimente të larta në të gjitha kulturat, të shtohet prodhimi i drithërave, i bimëve industriale, i perimeve, i frutave, të shtohet bagëtia, e cila sipas statistikës së vitit të kaluar ka shtesë dhe për-

parime, të shtohen shpendët, të shtohen bletët etj. Shteti do të mobilizojë të gjitha forcat për të kryer me kohë të gjitha veprat e ujitjeve, kanalizimeve, bonifikimeve etj., që janë në plan. Qeveria me udhëzimin e Komitetit Qendror rishikon një sërë çështjesh në lidhje me tatimet, me stimulacionet, në mënyrë që të krijojë leverdisshmëri më të madhe për fshatarësinë punonjëse dhe ajo të prodhojë më shumë, të ketë më shumë prodhime për vete dhe për të gjithë punonjësit e Republikës sonë Popullore. Për këtë arsye të madhe Partia dhe të gjithë punonjësit vihen përpara detyrave të mëdha, të organizojnë mirë çdo punë, sepse organizimi i mirë i punës, luan rolin vendimtar në realizimin e planeve ekonomike. Të bëhet një luftë e ashpër dhe e pandërprerë kundër gabimeve, lëshimeve dhe mungesës së kontrollit të vendimeve. Çdo punë të ndiqet me kujdesin më të madh që nga fillimi deri në mbarim, të luftojmë kundër spontaneitetit ose si me thanë «lëre punën të ecë në fatin e vet». Kjo është shumë e dëmshme. Populli thotë: punës duhet t'i qëndrosh kurdoherë mbi kokë. T'u bëhet një luftë e pamëshirshme vjedhësve, prishësve të pasurisë së popullit, dembelëve dhe sabotuesve. Punonjësit t'i kenë vazhdimisht sytë hapur se armiku përpiqet të na dëmtojë në sektorin ekonomik ashtu siç përpiqet edhe në çdo fushë tjetër. Vigjilenca e punonjësve dhe goditja e ashpër kundër çdo vepre armiqësore do të bëjnë të dështojë çdo përpjekje e armikut. Siç e dini me Bashkimin Sovjetik dhe me një sërë vendesh të demokracisë popullore ne vendosëm, si çdo vit, marrëveshje tregëtare. Bashkimi Sovjetik edhe këtë vit me bujari plotësoi kërkesat tona

në mallra të ndryshme, për industrinë, për bujqësinë, për mallrat e konsumit të gjerë etj. Populli ynë i është shumë mirënjohës Bashkimit Sovjetik, Partisë dhe qeverisë sovjetike të cilët pa kursyer, e ndihmojnë të zhvillohet, të ndërtojë jetën e tij më të mirë dhe më të begatshme. Populli ynë i bashkuar fort rreth Partisë dhe qeverisë së tij, i lidhur me një miqësi dhe aleancë të çelniktë me Bashkimin Sovjetik, me vendet e demokracisë popullore dhe me të gjithë popujt paqedashës, ecën përpara drejt të ardhshmes së tij të lumtur.

Pra, shokë, përpara, të hidhemi me të gjitha forcat për të realizuar dhe tejkalluar planin tonë ekonomik. Dita e 10-vjetorit të çlirimit të atdheut tonë nga barbarët fashistë dhe tradhëtarët e vendit, ta gjejë popullin tonë me duar plot, me prodhime të bollshme. Përpara, të korrim fitore!

Rroftë Partia jonë e dashur dhe Komiteti i saj Qendror!

Të forcohet çdo ditë e më shumë aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse, baza e regjimit tonë të demokracisë popullore!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 74 (1714), 28 mars 1954

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**LETËR DËRGUAR NXËNËSVE DHE MËSUESVE
TË SHKOLLËS SË MESME «ASIM ZENELI»
TË GJIROKASTRËS ME RASTIN E 31-VJETORIT TË
THEMELIMIT TË SHKOLLËS DHE TË 12-VJETORIT
TË DEMOSTRATËS SË SAJ KUNDËR FASHIZMIT**

3 prill 1954

**NXËNËSVE DHE MËSUESVE TË SHKOLLËS SË MESME
«ASIM ZENELI»**

Gjirokastrë

Ju përshëndes dhe ju uroj nxehtësisht festën e shkollës suaj!

Me keqardhje ju them se punët e Partisë dhe ato shtetërore më penguan të vija, por ju siguroj se sot zemra ime është atje, te ju, ajo është e gëzuar, pse ju jeni të gëzuar dhe të lumtur.

Shkolla juaj më është shumë e dashur, pse tridhjetë e një vjet më parë atje kam mësuar edhe unë dhe ruaj shtrenjtë në kujtesë momentet e gëzuara dhe të hidhura të vegjëlisë sime.

Me respekt kujtoj sot mësuesit e mi të vjetër pa-

triotë, të cilët afro 40 vjet më parë, kur atdheu dhe populli lëngonin nën zgjedhën e imperialistëve barbarë, na mësonin me guxim të shkruanim dhe të këndonim gjuhën tonë të ëmbël amëtare, na mësonin historinë e lashtë heroike të popullit, na mësonin të urrenim dhe të luftonim okupatorët dhe tradhëtarët e vendit tonë.

Sot ju, shoqe dhe shokë të mi të dashur të rinisë, jetoni të gëzuar në atdheun tonë të lirë, kur populli, pas Luftës legjendare nacional-çlirimtare që bëri kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve, ndërton me sukses bazat e socializmit. Partia jonë heroike e Punës, që e udhëhoqi popullin në fitoren më të shkëlqyer të historisë së tij, drejton me guxim dhe urtësi të madhe fatet e vendit. Jeta e popullit tonë çdo vit po bëhet më e bukur. Ditë akoma më të lumtura do të shohë populli dhe rinia heroike e vendit tonë, pse e gjithë puna dhe preokupacioni i Partisë dhe i qeverisë sonë kanë këtë qëllim.

Mësoni me të gjitha forcat tuaja, pse atdheu ka nevojë shumë për njerëz të mësuar. Me mijëra shkolla të kategorive të ndryshme dhe institute të larta ka hapur për ju pushteti i popullit. Dyert e universiteteve të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore janë të çelura për ju.

Shokë arësimitarë dhe të rinj! Populli i ka sytë te ju, kujdesi i veçantë i Partisë është për ju dhe ju e meritoni plotësisht këtë dashuri dhe besim të madh që ushqejnë populli dhe Partia, pse keni qenë heronjtë e çlirimit të atdheut dhe do të jeni heronjtë e ndërtimit të bazave të socializmit.

Në çdo moment dhe në çdo punë tuajën të men-

doni dhe të punoni për të mirën e popullit. Çdo gjë tuajën e lidhni me interesin e përgjithshëm. Shtoni dhe çelnikosni në zemrat tuaja dashurinë dhe besnikërinë ndaj atdheut, ndaj popullit, ndaj Partisë. Të doni me të gjitha forcat e zemrës suaj Bashkimin e madh Sovjetik!

Të doni shkollën dhe mësuesit tuaj. Mësoni në mënyrë të tillë që jo vetëm të mos ngelet asnjë në klasë, por nota 5 të jetë e vetmja notë për ju!

Ju uroj nxehëtësisht shëndet dhe suksese në mësimet dhe në provime, detyrë e madhe patriotike për nxënësit dhe mësuesit!

Rroftë rinia heroike dhe studjoze e vendit tonë!
Rrofshin mësuesit dhe profesorët patriotë!

J u a j i

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Rinisë», Nr. 30 (654), 14 prill 1954

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**«MBI TË METAT DHE DETYRAT NË DREJTIMIN E
ÇËSHTJEVE EKONOMIKE E SHITËTËRORE DHE MBI
ZHVILLIMIN E DEGËVE KRYESORE TË EKONOMISË
PËR PERIUDHËN 1954-1957»**

Raport i mbajtur në Plenumin X të KQ të PPSH

16 prill 1954.

I

MBI REALIZIMIN E PLANIT PËR VITET 1951-1953

Në një mënyrë përmbledhëse do të përpiqemi t'ju vëmë në korrent mbi realizimin e planit, mbi të metat që vihen re dhe detyrat që na dalin për të ardhshmen.

Gjatë viteve 1951-1953 të planit të parë pesëvjeçar është rritur dhe është forcuar ekonomia jonë popullore në krahasim me të kaluarën. Gjatë këtyre viteve janë arritur suksese të rëndësishme në industrializimin e vendit, duke u hedhur kështu bazat kryesore të industrisë së lehtë.

Në fund të vitit 1953 prodhimi industrial arriti në 8 miliard e 241 milion lekë që është barazi me 9,5 herë kundrejt paraluftës ose 2,6 herë në krahasim me vitin 1950. Plan i vitit 1953 është realizuar në total 101,8 për qind kundrejt parashikimit të pesëvjeçarit dhe kjo për efekt të tejkalimit në realizimin e planit nga sektori i artizanatit, i cili ka prodhuar 33 për qind më shumë kundrejt pesëvjeçarit, nga industria lokale që ka prodhuar 63 për qind më shumë nga pesëvjeçari dhe të prodhimeve të Ministrisë së Tregëtisë e të Komunikacionit, që tejkalojnë pesëvjeçarin me 68 për qind më tepër.

Gjatë vitit 1953 në disa degë kryesore të industrisë janë arritur rezultate të rëndësishme në rritjen e prodhimit. Është një sukses i madh që për herën e parë industria jonë e sheqerit ka prodhuar në sezonin 1953-1954 një sasi prej 9 240 ton sheqer; po ashtu industria tekstile ka shënuar një rritje të dukshme të prodhimit duke arritur një prodhim prej 13,6 milion metra linear tekstile të pambukta d.m.th. 11 herë më shumë se në vitin 1950. Rezultate të rëndësishme janë arritur edhe në prodhimin e artikujve të tjerë industrialë: janë prodhuar 41 400 ton naftë më shumë se në vitin 1938 ose 113 për qind kundrejt vitit 1950, qymyrguri 104 300 m³ më shumë se prodhimi i paraluftës ose 254 për qind në krahasim me vitin 1950. Gjithashtu kundrejt vitit 1950 janë prodhuar më shumë 20 milion kilovat-orë energji elektrike, — 9 000 hl. birrë, — 4 000 ton makarona, — 75 000 palë këpucë, — 25 000 m³ lëndë

druri e sharruar, — 100 milion lekë mobilje dhe orendi druri etj.

Edhe bujqësia e ka tejkaluar në mënyrë të dukshme nivelin e paraluftës qoftë përsa i përket sipërfaqes së punueshme, qoftë edhe në rritjen e rendimentit. Sipërfaqja e tokës së punueshme është rritur 64 për qind dhe prodhimi i drithërave të bukës 58 për qind më shumë se në vitin 1938. Gjithashtu kundrejt pesëvjeçarit, në vitin 1953 sipërfaqja e punueshme është realizuar 102,1 për qind dhe prodhimi i drithërave të bukës 101,4 për qind. Gjatë këtyre tre vjetëve në bujqësi janë zgjeruar kulturat e reja me rëndësi industriale si pambuku, panxhari duke u zhvilluar mjaft. Këto rezultate në zhvillimin e bujqësisë, veçanërisht prodhimet e mira të vitit 1953, kanë ndihmuar në përmirësimin e furnizimit të popullit dhe u krijuan mundësi për shtimin e eksportimeve, sidomos në duhan.

. Si rrjedhim i zhvillimit të të gjithë sektorëve të ekonomisë është rritur vëllimi i punës së transporteve duke u tejkaluar shumë niveli i vitit 1950. Transporti automobilistik i mallrave ka kryer një vëllim pune 199 për qind në krahasim me vitin 1950, transporti hekurudhor — 198 për qind dhe të krahasuar me pesëvjeçarin respektivisht 79 dhe 74 për qind. Është përmirësuar mirëqenja materiale e punonjësve si rezultat i rritjes së pandërprerë të prodhimit. Në vitin 1953 xhiroja e tregëtisë ka arritur gjithsejt 165 për qind në krahasim me vitin 1950 ose 105,8 për qind e krahasuar me pesëvjeçarin, nga e cila xhiroja e tregëtisë në fshat është rritur 188 për qind. Është rritur furnizimi i punonjësve

me mallra ushqimore dhe të konsumit të gjerë për çdo frymë në mënyrën që vijon:

	1953 kund- drejt 1950	me 5 vjeçarin
Sheqer	152 për qind	99,5 për qind
Sapun rrobesh	170 »	83,6 »
Tekstile të pambukta	174 »	103,7 »
Këpucë	155 »	96,8 »
Opinga	150 »	83,3 »

Si rezultat i rritjes së qarkullimit të mallrave ndërmjet qytetit dhe fshatit dhe të masave favorizuese për fshataresinë, është rritur dhe zhvilluar klasa punëtore si dhe është forcuar aleanca ndërmjet kësaj të fundit me fshataresinë punonjëse. Numri i punëtorëve në vitin 1953 është rritur mbi 70 për qind në krahasim me vitin 1950 dhe fondi i pagave është rritur mbi 80 për qind më tepër se në vitin 1950. Për të tre vjetët janë investuar gjithsej një miliard e 58 milion lekë për banesa dhe objekte të tjera për përmirësimin e konditave të jetesës së punonjësve.

Suksese të reja janë arritur në sektorin e arësimit dhe të kulturës si dhe në ruajtjen e shëndetit të popullit. Është rritur numri i shkollave dhe numri i nxënësve në to ka arritur në 184 500 ose 106 për qind në krahasim me vitin 1950 dhe 97,3 për qind krahasuar me pesëvjeçarin. Numri i shtretërve në institutet shëndetësore ka arritur në 123 për qind në krahasim me vitin 1950 dhe 104,2 për qind kundrejt pesëvjeçarit duke u luftuar me sukses sëmundjet parazitare dhe epidemiologjike, gjë që ka përmirësuar gjendjen shëndetësore të popullit.

Sukseset e arritura në shtimin e prodhimit gjatë këtyre tre vjetëve kanë sjellë si rezultat rritjen edhe

më shumë të fuqisë mbrojtëse të vendit si dhe forcimin më të madh të Republikës sonë Popullore.

Por me gjithë sukseset e arritura gjatë viteve 1951-1953 rezultatet e realizimit të planit nuk kanë qenë të kënaqshme dhe gjendja ekonomike nuk është përmirësuar sa duhet. Gjatë këtyre viteve planet e prodhimit nga disa sektorë të ekonomisë nuk janë realizuar dhe janë lejuar deficite vit për vit.

Në sektorin e minierave prodhimi kompleksiv për të tre vjetët e parashikuar në planin pesëvjeçar është realizuar 83 për qind d.m.th. me një deficit në vlerë prej 321 milion lekë. Deficiti sipas degëve dhe në krahasim me tre vjetët e pesëvjeçarit paraqitet:

Për industrinë:

Industria e naftës	deficit	43 000 ton	realizuar	90,7	për qind
Bitum i pastruar	»	33 000	»	»	73,5
Qymyrguri	»	24 000	»	»	90,9
Krom	»	35 000	»	»	82
Bakër blister	»	1 600	»	»	61,4
Industria e veshmbathjes		80 milion lek	realizuar	96,5	për qind
Industria e material ndërtimit	»	57	»	»	94,4
Industria ushqimore (nacionale)		120	»	»	91,8

Për prodhimet bujqësore:

Misër	deficit	35 000 ton	realizuar	91,4	për qind
Pambuk	»	10 000	»	»	74,9
Panxhar sheqeri	»	61 700	»	»	75,6
Duhan	»	1 200	»	»	87,6
Patate	»	33 100	»	»	60,3
Fasule	»	10 000	»	»	62,3

Si rrjedhim, këto mosrealizime në prodhim dhe deficitet e krijuara kanë influencuar:

a) Në mungesat e theksuara të furnizimit të popullit për të tre vjetët e kaluar, si përsa u përket artikujve industrialë, ashtu edhe për ata bujqësorë.

b) Në eksportet tona, duke mos mbajtur detyrimet karshi shteteve miq, me një mosrealizim total prej 32,6 milion rubla.

Shkaqet e mosrealizimit të planeve në këta tre vjetë të pesëvjeçarit duhet t'i gjejmë në dobësitë tona për të cilat do të flas më poshtë.

Tremujori i parë i planit të sivjetëm është realizuar gjithsejt 92,4 për qind dhe në 202 500 000 lekë ndaj 219 869 000. Këtë deficit që ne duhet medoemos ta plotësojmë në tremujorin e dytë, e kanë krijuar nafta që është realizuar 97,1 për qind dhe derivatet e saj, kromi me 50,7 për qind, alkooli me 77 për qind dhe lënda e drurit me të gjitha derivatet e saj prej 49,9 për qind.

Gati në të gjitha zërat e tjerë plani është realizuar e tejkaluar: bitumi 104 për qind, bakri 119,7 për qind, qymyret 102,2 për qind, makaronat 101,7 për qind, vaji 188 për qind, sapuni 107 për qind, birra 102,8 për qind, peshku 100 për qind, cigaret 100 për qind, tekstilet e pambukta 100,7 për qind, të leshtat 116 për qind, këpuçët 109 për qind, çimento 118,9 për qind, energjia elektrike 112 për qind.

Prodhimi i veglave të bujqësisë ka shkuar mirë: plugjet 150 për qind, kultivatorët 170 për qind, lesat 135,1 për qind, plorët 117 për qind.

Katër ndërmarrjet e mëdha të ndërtimit: NSHN-Ndërtesa, «Perlat Rexhepi», Rruga-Ura dhe Hidroelek-

tro e kanë tejkaluar planin. Vetëm NSHN-ja e Bonifikimeve është prapa me 53 për qind dhe «21 Dhjetori» me 90,6 për qind.

Dimri i madh i sivjetëm na ka penguar shumë, sidomos për lëndën e drurit dhe deri diku për kromin. Siç shihet, me gjithë disa pengesa serioze që do të përmend më poshtë, me një mobilizim më të madh dhe duke shfrytëzuar mundësitë tona të brendshme, ne arritëm të realizojmë dhe të tejkalojmë planin në shumë sektorë. Këto përpjekje duhet të jenë të vazhdueshme dhe çdo ditë më të mëdha, që të arrijmë qëllimin e realizimit të planit plotësisht. Disa çështje serioze objektive nuk duhen lënë pa i numëruar dhe duhet të mendohemi thellë dhe t'u gjejmë zgjidhje.

Shteti ynë ecën akoma pa pasur rezervën e duhur në asnjë sektor. Kjo është shumë e rëndë për ne. Në çdo gjë është llogaritur si me thënë me lak në grykë. Një fatkeqësi atmosferike të ngjasë, siç ka ngjarë tre vjet me radhë në bujqësi, ose një mosrealizim, goftë i vogël, në industri-miniera, të gjitha planet tona të furnizimit të popullit dhe eksportet çrregullohen rëndë. Por mund të ngrihet pyetja: pse nuk planifikojmë rezerva? Kemi tentuar në disa zëra, por në disa, si drithërat etj. ka qenë e pamundur. Por këto rezerva s'ka qenë e mundur të krijoheshin për arësyen e mosrealizimit të planeve. Deficiti zinte deficitin dhe as mund të flitej për rezerva. Por ka edhe arsye të tjera. Në hartimin e planeve tona kemi tendenca të dëmshme: planifikojmë shumë maqineri dhe s'mendojmë të planifikojmë pjesët e këmbimit të domosdoshme, ose i planifikojmë këto, por pa llogaritur pamundësitë në kredi, në klering

ose në valutë të lirë dhe, kur vjen krasitja, më të shumtat e këtyre hiqen, në vend që të lihen veglat e këmbimit dhe të hiqet një pjesë e maqinerisë. P.sh. në vend që të hiqen disa traktorë dhe të sillen pjesët e këmbimit, preferohet të sillen traktorë pa pjesë këmbimi. Kështu ndodh për automjetet, kështu për motorët elektrikë etj. Ose bëhen lista shumë të fryra nga specialistë të pandërgjegjshëm, sillen këto dhe ngelin pa u shfrytëzuar. Kjo është një plagë e madhe në planifikimin tonë që duhen marrë masa urgjente për ta shëruar.

Këtu natyrisht nuk ekskludohen edhe mosinteresi mi i madh dhe i vazhdueshëm i Ministrisë së Tregëtisë për t'i sjellë me kohë këto materiale, por edhe vështirësia e transportimit influencon gjithashtu. Mallrat e importit që luajnë një rol shumë të rëndësishëm për planin tonë zakonisht na vijnë pas muajit prill, d.m.th. katër muajt e parë të vitit ekonomik ne vuajmë jashtëzakonisht për shumë gjëra që kondicionojnë planin tonë. Një e metë e tillë serioze zgjidhet duke pasur rezerva dhe këtë problem ne duhet ta ngremë në miqtë tanë.

Veçanërisht problem i madh është për ne çështja e mallrave të konsumit të gjerë. Ne duhet të vëmë dhe po vëmë të gjitha forcat tona për të shfrytëzuar si duhet industrinë tonë nacionale dhe lokale, artizanatin etj., për t'i dhënë popullit sa më shumë mallra të konsumit të gjerë. Ne kemi shumë mundësi të brendshme që duhet t'i shfrytëzojmë. Duhet shumë e më shumë të mobilizohemi në këtë drejtim, por nevojat e mëdha të popullit do të jetë e pamundur t'i plotësojmë, në rast se s'kemi një ndihmë të mirë nga miqtë në këtë drejtim. Shumë gjëra të nevojës së popullit ne nuk i prodhojmë

dot. Me mijëra janë artikujt që ne jemi të detyruar t'i importojmë. Disa qytete kanë mbetur në errësirë pse s'ka poçe llambash e si këto ka me qindra e me mijëra artikuj.

Detyra jonë konsiston në vënjen si duhet në lëvizje të gjithë industrisë sonë, ta shfrytëzojmë atë në maksimum, të shfrytëzojmë të gjitha mundësitë tona të brendshme, të realizojmë dhe të tejkalojmë planet që kështu të mundim të furnizojmë popullin në rregull, të krijojmë rezervat e vogla të para, të mbajmë detyrimet me miqtë. Këto detyra ne duhet t'i kryejmë dhe do t'i kryejmë. Gjithashtu ne t'ua shtrojmë edhe këto çështje miqve tanë dhe të kërkojmë ndihmën e tyre.

Siç dihet, kohët e fundit Partia dhe qeveria morën një sërë masash në drejtim të bujqësisë dhe një nga qëllimet kryesore të masave të marrura, ishte të favorizohej më shumë zhvillimi i bujqësisë dhe të lehtësohej fshatari nga detyrimet dhe tatimet. Ne mendojmë se në këtë drejtim kemi korrur disa rezultate të mira. U dukën menjëherë përmirësimet e para në jetën e fshatit dhe si konsekuencë në jetën e punonjësve të qytetit. Fshatarësia mori kurajë në punë, ju ngjall një dëshirë e madhe dhe një hov për bujqësinë. Politikisht fshatarësia u lidh më ngushtë me Partinë. Fakt është se plani i mbjelljeve të vjeshtës 1953 megjithëse ishte 12,4 për qind më i madh në sipërfaqe se sa ai i vitit 1952 u realizua 101,3 për qind. Nga regjistrimi i blegtorisë për vitin 1953 doli se në përgjithësi është ndaluar rënja dhe ka një shtesë të mirë nga vitet e kaluara. Rritja më shumë se vitet e kaluara është: gjedhe 1,7 për qind, njëthundrakë 1,1 për qind, dhen 7,6 për qind, dhi 11,7 për qind, derra 47,6 për qind, shpendë 50 për qind.

Jo vetëm që nuk vërtetohen braktisje tokash si vitet e kaluara, por kërkohen përsëri tokat nga fshatarët që i kanë braktisur. Malësorët pa tokë ose me pak tokë, me dhjetëra familje së toku, kërkojnë toka në fusha. Efekti i uljes së detyrimeve ka bërë që planet e grumbullimeve të jenë më reale dhe për fshatarin më lehtë t'i japë. Për vitin 1953 plan-detyrimet e grumbullimit të prodhimeve të bujqësisë dhe të blegtorisë janë realizuar më mirë se në vitin 1952 dhe konkretisht: drithëra buke 97 për qind, tagji 119,6 për qind, mish 85 për qind. Gjithashtu në vitin 1953 u grumbulluan teprica drithi 272 për qind më shumë se në vitin 1952 dhe 605 për qind më shumë se në vitin 1951. Çmimi i shitjes së drithit në tregun fshatar ka qenë shumë më i lirë se në çdo vit tjetër dhe ka tendenca për ulje çmimi, në lidhje me grurin e mirë të sivjetëm.

Një tjetër tregues që vërteton përmirësimet në gjendjen ekonomike të fshatarëve është se në gjashtëmujorin e dytë të vitit 1953, janë blerë më shumë vegla bujqësore ose dy herë më shumë se në po të njëjtën periudhë të vitit 1952. U shtuan shumë kërkesat e fshatarëve për punimin e tokave me traktorë, për farëra më të zgjedhura, për plehra kimike etj. Tregu u furnizua më mirë me prodhime bujqësore dhe blegtorale nga ana e fshatarësisë, me përjashtim të mishit, të cilin ai tani nuk e therr më si më parë, por e ruan ta shtojë. Kjo është gjithashtu një shenjë e mirë.

Të gjitha këto masa favorizuese, vendimet e plenumit të dhjetorit, organizimi i një sërë konferencash nacionale dhe lokale për kultivuesit e pambukut, të duhanit, të panxhar sheqerit, për punonjësit e SMT-ve, të

fermave shtetërore dhe në përgjithësi aktivizimi më i madh i Partisë, i punonjësve të bujqësisë dhe i udhëheqjes së Partisë e qeverisë për sektorin e bujqësisë kanë ngjallur një interesim dhe entuziazëm të dukshëm në fshatarët, për rritjen sa më shumë të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale.

Nga ana tjetër, reduktimi ose shtyrja e një sërë objektesh të ndërtimit industrial, bëri që këto fonde të investohen në bujqësi, të ulet numri i punonjësve të garantuar në 12 000 vetë dhe shumica e atyre kaluan në prodhimin bujqësor. Nga kjo pati përfitime bujqësia, furnizimi i qyteteve u lehtësua dhe punonjësit e qendrave të punës e të prodhimit u furnizuan më mirë. U hodh gjithashtu një sasi material ndërtimi në treg. Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 1953 u hodhën mbi planin 5 000 kv. çimento, — 600 m³ lëndë druri, — 600 kv. gozhde etj.

Inkurajimi i tregëtisë së vogël dhe i artizanatit privat ka bërë që të gjallërohet dhe të shtohet rrjeti tregëtar dhe artizanal. Kështu deri në 1 mars 1954 kanë marrë leje për të ushtruar profesionin 760 artizanë të ndryshëm dhe janë hapur 930 dyqane për tregëti të vogël private nga të cilat: ushqimore 510, industriale 170 dhe për ushqime sociale 250. Në treg janë shtuar disa lloje artikujsh të përditshëm, sidomos pemë, perime, mish, bulmetra dhe artikuj industrialë.

Duhet të theksojmë gjithashtu se ne kemi pasur sukses në riorganizimin e pushtetit qendror dhe të bazës, në thjeshtësimin e aparateve të fryra dhe burokratike, duke përjashtuar nga aparatet një pjesë të madhe të parazitëve, të dembelëve dhe të armiqve. U organizua Partia në baza të reja, konform me ndarjen e re admi-

nistrative dhe mund të themi se ky riorganizim, në përgjithësi, e ka forcuar Partinë, pavarësisht se disa kuadro të rretheve janë akoma mjaft të dobët. Ata me një ndihmë të organizuar shpejt do ta marrin veten. Të gjitha këto masa ekonomike, organizative dhe politike, nuk mund të konsiderohen si një punë e thjeshtë dhe e vogël që ka kryer Partia dhe megjithëse ka gabime, shumë mungesa dhe të meta, kjo mund të konsiderohet si një sukses i rëndësishëm që ka korrur Partia. Ekonomikisht, politikisht dhe organizativisht është forcuar situata në vendin tonë. Të gjitha këto veprime që ndërmori Partia u kurorëzuan me sukses të shkëlqyer në zgjedhjet e pushtetit popullor. I tërë populli, gjë që s'ishte parë asnjëherë, shkoi në votime dhe votoi në mënyrë dërmuese për Partinë dhe Frontin. Kjo tregoi edhe një herë se populli aprovon, gati unanimitisht, vijën e Partisë dhe masat që mori Partia.

Masat që përmendëm më lart mund të konsiderohen si etapa e parë në përmirësimin e situatës sonë të vështrë ekonomike dhe organizative që na paraqitej. Natyrisht, kjo s'ishte e gjitha dhe ne kishim dhe kemi akoma shumë për të bërë, për ta ndryshuar krejtësisht situatën në favorin e përmirësimit të gjendjes së popullit tonë. Në forcimin organizativ të aparateve tona të pushtetit dhe të Partisë, në përmirësimin dhe forcimin e drejtimin të ekonomisë dhe të shtetit dhe në çelnikosjen e mëtejshme të situatës politike. Në vijim të këtyre masave, ne duhej të vazhdonim të analizonim çështjet më thellë dhe të nxirrnim detyra të reja për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë, të merrnim masa të tjera më efikase për të realizuar planet ekonomike të vitit 1953

dhe të përgatiteshim për t'u hedhur më me hov në realizimin e planit të vitit të katërt të pesëvjeçarit.

Për këtë qëllim Byroja Politike dhe qeveria me porosi të plenumit të fundit, morën disa masa të menjëhershme si shtimin e prodhimit të mallrave të konsumit prej 120 milion lekë mbi planin e vitit 1954. U bënë shtesa në planin e naftës për eksport, gjithashtu dhe për bitumin dhe prodhime bujqësore të tjera. U morën vendime të veçanta në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të artizanatit të kooperuar, vendime për shpërblime më të mira për punonjësit e fermave dhe të SMT-ve, për punonjësit e sharrave dhe të peshkimit. U morën masa nga qeveria për zbritjen e tatimeve të ekonomive bujqësore për afro 140 milion. U rishqyrtuan stimulacionet e duhanit, të pambukut dhe të panxhar sheqerit. U ngrit çmimi i duhanit dhe i panxharit në favor të fshatarësisë dhe u shtuan stimulacionet, kështu që u krijua leverdisshmëri më e madhe ekonomike për fshatarët dhe nxitje për zhvillimin e këtyre kulturave të rëndësishme.

Në këtë raport ne i paraqitim Plenumit të Komitetit Qendror, mundësitë tona të mëdha të brendshme, rezervat që ekzistojnë te ne dhe që ne duhet t'i vlerësojmë dhe t'i shfrytëzojmë më mirë si dhe sasinë dhe natyrën e ndihmës që ne propozojmë t'i kërkojmë qeverisë sovjetike.

Përveç detyrave të tjera të shumta që i vihen Partisë dhe punonjësve të vendit tonë për realizimin e planeve ekonomike, në këto studime përcaktojmë detyra të tjera të reja, të cilat do të mobilizojnë Partinë dhe punonjësit akoma më mirë, do të shkundojnë udhëheqjen e Partisë dhe të shtetit nga rutina dhe spontaneiteti në

çështjen e studimit dhe të drejtimit të problemeve ekonomike dhe shtetërore dhe do të arrihet me siguri të ketë rezultate të mira në gjithë punën tonë. Patjetër që t'ja arrijmë këtij qëllimi të madh ne duhet më parë se të hyjmë në problemet konkrete ekonomike, të analizojmë të metat dhe gabimet që janë vërtetuar në lëmin ekonomik e shtetëror gjatë këtyre tre vjetëve të parë të pesëvjeçarit, të gjejmë arësyet pse janë bërë këto gabime dhe të nxjerrim mësimë për të ndrequr këto gabime.

II

**MBI TË METAT NË DREJTIMIN E ÇËSHTJEVE
EKONOMIKE E SHTETËRORE****TË STUDJOHEN MË THELLË E NË PERSPEKTIVË
DEGËT KRYESORE TË EKONOMISË**

Për të analizuar më thellë gabimet dhe për të marrë masat e përshtatshme në kohë, e mira do të ishte që Komiteti Qendror të kishte vendosur dhe të ishte përgatitur me kohë për një rishikim të gjithanshëm të realizimeve të tre vjetëve të parë të planit tonë pesëvjeçar. Këtë gjë nuk e bëmë dhe nuk u parashikua që të përgatiteshim në këtë drejtim. Megjithëse ne kemi analizuar çdo vit realizimin e planit dhe kemi analizuar realizimin e dy viteve të para të planit tonë pesëvjeçar, këto analiza nuk kanë qenë të mjaftueshme dhe të plota.

Do të jetë gabim të mendohet se punimet që po paraqitim e plotësojnë këtë boshllëk në punën tonë, por sidoqoftë, ne po u bëjmë një analizë të përgjithshme gabimeve tona kryesore në drejtimin e ekonomisë dhe të shtetit, ne paraqitim shifrat kryesore që duhet medoemos të arrijmë në dy vitet e fundit të planit tonë pesëvjeçar, duke u mbështetur në planin e vendosur të vitit 1954 dhe 1955. Gjithashtu duke u mbështetur në të gjitha realizimet e planit tonë të parë pesëvjeçar, po paraqitim shifrat kryesore të të dy viteve të para të planit të dytë pesëvjeçar, shifra këto që duhet të mos konsiderohen definitive, por orientuese. Komiteti Qendror, natyrisht do të rikthehet në këtë çështje kur të hartojë direktivat e planit të dytë pesëvjeçar.

Faktet kanë treguar se çdo vit ne nuk kemi mundur të realizonim plotësisht planet tona ekonomike, ne kemi dalë me boshllëqe të ndieshme dhe veçanërisht në sektorët jetikë të ekonomisë. Kjo ka pasur reperkusione të rënda në jetën e popullit dhe të punonjësve. Përse planet tona ekonomike nuk realizohen plotësisht? Nga analizat që kemi bërë, kanë dalë një sërë arsyesh, një sërë gabimesh të rëndësishme në hartimin e vetë planeve, në drejtimin jo si duhet nga ana e Komitetit Qendror të çështjeve ekonomike dhe shtetërore dhe nga shkakut i një sërë gabimesh të tjera që rrjedhin prej këtyre kryesoreve.

Ne hartuam dhe vendosëm planin tonë pesëvjeçar. Ky ishte një eveniment historik në jetën e vendit tonë. Në hartimin e planit është e vërtetë të thuhet se ne nuk kemi pasur eksperiencën e duhur. Problemet kyçe të ekonomisë sonë ishin larg studimeve në thellësinë

dhe kompleksin e tyre. Tre vjet luftë për realizimin e planeve na kanë pajisur me një farë eksperience, e cila na lejon të themi pa u gabuar, se në situatat që kemi qenë para tre vjetësh ishin të paevitueshme llogaritë e gabuara që mund të ishin bërë në hartimin e planit tonë të parë pesëvjeçar. Dhe llogari të gabuara janë bërë. Këtë e dëshmojnë faktet. Një sërë problemesh të rëndësishme për ekonominë, siç janë ato të bujqësisë, të industrisë, të minierave, të tregëtisë dhe të financës, duhej jo vetëm të ishin në një përqindje të madhe më të qarta që kur ne vendosëm planin tonë të parë pesëvjeçar, por ato akoma nuk kanë gjetur zgjidhjen e plotë edhe tani. Megjithatë plani ynë pesëvjeçar ishte ligj për ne, ishte i mundshëm të realizohej me përpjekje dhe me luftë të madhe, me një drejtim më të shëndoshë nga ana e Komitetit Qendror, me një organizim pune shumë më të madh se ai që është vërtetuar dhe me një disiplinë të hekurt. Një punë e tillë, një drejtim i tillë, jo vetëm që do të sqaronte një sërë problemesh kyçe të ekonomisë sonë që kërkonin zgjidhje urgjente dhe të drejtë, por do të na vinin në dukje më qartë gabimet që mund të ishin bërë në hartimin e planit tonë, do të na jepnin mundësi më të mëdha të merrnim masa që më parë për t'i korigjuar me kohë këto gabime dhe të mos linim të trasheshin. Ne, duke qenë plotësisht të ndërgjegjshëm për barrën e rëndë që kemi mbi supet tona, duke qenë gjithashtu të ndërgjegjshëm se na mungojnë dijenitë dhe eksperiencia e duhur për drejtimin si duhet të ekonomisë shtetërore dhe të çështjeve të tjera të shtetit, nuk kemi bërë sa duhet përpjekje për t'u ngritur, për të mësuar, për të përvetësuar eks-

periencën e gjerë sovjetike që na jepet, nuk kemi organizuar punën në mënyrë të atillë, që nga eksperiencia sovjetike, nga praktika e gjërave dhe eksperiencia e përditshme të nxirrnim konkluzionet e nevojshme për një drejtim më të mirë. Ne i kemi pasur mundësitë që ta bënim këtë më mirë.

Komiteti Qendror i Partisë ka përgjegjësinë kryesore në këto çështje dhe ai nuk e ka drejtuar si duhet ekonominë dhe ka lejuar të bëhen gabime serioze ekonomike dhe të tjera. Komiteti Qendror është udhëheqja e vendit, jemi ne. dhe kur themi se Komiteti Qendror është përgjegjës për këto çështje, jemi ne përgjegjës. Komiteti Qendror nuk ka drejtuar si duhet për fajin e Byrosë Politike dhe të aparatit të Komitetit Qendror. për fajin e qeverisë dhe të organeve të saj. Është e vërtetë se ka gabime poshtë, se Partia dhe pushteti duhet të mobilizohen më shumë, por organet e larta dhe njerëzit përgjegjës kryesorë, kanë përgjegjësinë më të madhe.

Ne nuk kemi drejtuar si duhet me Komitetin Qendror. Ky është një nga parimet më të rëndësishme leniniste të Partisë. Në fakt këtë gabim serioz e kemi vënë në dukje shumë herë, kemi bërë përpjekje ta ndreqim, ka përmirësime në këtë drejtim, por këto janë të pamjaftueshme. Nuk është çështja te numri i plenumeve që mund të bëhen në një vit, por rëndësi ka çfarë probleme të rëndësishme kyçe duhet t'i shtrohen Plenumit të Komitetit Qendror. Këto probleme duhet të jenë shumë mirë të studjuara, të jenë studime bazë, me vendime të qarta dhe të peshuara mirë, me vendime e ligje për të gjithë. Problemet që duhet të marrë në shqyrtim Komiteti Qendror dhe vendimet të përfshijnë

sektorët më të rëndësishëm të vendit. Për Partinë, për pushtetin, për punonjësit dhe për popullin, këto vendime të hapin perspektiva të gjera dhe të qarta. Mbi këto të bazohen planet e punës në të gjithë jetën e vendit. Për realizimin e të gjitha këtyre vendimeve duhet të jenë përgjegjës në radhë të parë shokët e Komitetit Qendror, pa përjashtim, në sektorët e tyre; duhet të japin llogari seriozisht për punën e tyre, duhet të marrin masa shembullore për ata që nuk i zbatojnë dhe nuk i arrijnë objektivat e caktuara në vendimet e Komitetit Qendror. Rreth këtyre vendimeve duhet të organizohet puna, të vendoset disiplina e hekurt që nga lart dhe deri poshtë. Për realizimin e këtyre vendimeve duhet të organizohet kontrolli i zbatimit të detyrave që rrjedhin për secilindo punonjës. Eksperienca e punës së Partisë sonë na tregon se është e zorshme që Plenumi i Komitetit Qendror të thirret në mbledhje plenare të zakonshme në dy muaj një herë. Kemi vendosur një praktikë të tillë vjet, por s'ka qenë e mundur të realizohet. Por 4 ose 5 mbledhje plenare të Komitetit Qendror në vit janë më se të mjaftueshme në rast se në këto mbledhje shtrohen probleme kyçe, të studjuara mirë dhe të shërbejnë si program pune për tërë vitin. Komiteti Qendror, atëhere ne mund të themi se i kryen ashtu si duhet detyrat e tija, si udhëheqësi kryesor i Partisë dhe i shtetit tonë, ka në dorë si duhet situatën, drejton dhe kontrollon si duhet gjithë jetën e vendit. Pra, nga numri i mbledhjeve plenare të Komitetit Qendror s'kemi pasqyruar, por serioze është dobësia në përcaktimin e problemeve që u shtrohen plenumeve të Komitetit Qendror dhe sidomos e dobët ka qenë përgatitja dhe paraqitja

e këtyre problemeve përpara plenumit. Kjo është një arësye serioze që bën që Komiteti Qendror të mos jetë si duhet në krye të detyrës. Ne duhet të luftojmë seriozisht që ta zhdukim këtë gabim të rëndë. Udhëheqja e dobët e Komitetit Qendror në drejtim të ekonomisë dhe të shtetit, pasqyrohet në gabimet që janë bërë në krijimin e disproporcioneve të palejueshme në drejtimin e zhvillimit të bujqësisë dhe të industrisë, në moszhvillimin e harmonishëm të të gjithë sektorëve të jetës së vendit në bazë të mundësive reale dhe prioritetit të nevojave urgjente të kondicionuara nga situata ekonomike, politike dhe kulturele. Drejtimi i dobët pasqyrohet në mosstudimin si duhet në kohë dhe thellësisht të problemeve kyçe që kondicionojnë zhvillimin e ekonomisë sonë, në marrjen dobët të masave konkrete për realizimin e detyrave të planit, në mosvendosjen e një regjimi të rreptë disipline dhe kontrolli në punë dhe në zbatimin e vendimeve etj.

Del e qartë nga analizat që kemi bërë se e kemi nënvleftësuar sektorin e rëndësishëm të bujqësisë dhe ka ekzistuar një disproporcion i dukshëm në mes të zhvillimit të bujqësisë dhe të industrisë. Ritmi i zhvillimit të këtyre sektorëve nuk ka qenë i drejtë dhe proporcional. Kjo ka ngjarë jo se ne në teori e nënvleftësojmë rolin e madh të bujqësisë në ekonominë tonë, porse në realitet problemet e ekonomisë sonë nuk u studjuan mirë dhe shumë gjëra vazhdojnë të jenë të errëta akoma për ne.

Të marrim sektorin e bujqësisë. Akoma edhe sot pas 10 vjet çlirim Komiteti Qendror nuk ka një pasqyrë të qartë dhe të gjithanshme të gjendjes së bujqësisë sonë:

si zhvillohet jeta në fshat, si zhvillohet lufta e klasave, ç'ndryshime ka sjellë reforma agrare, lëvizja e shtresave fshatare, gjendja ekonomike, politike, kulturele dhe shëndetësore e fshatarësisë si tërësi. Një studim të tillë mbi baza shkencore, të nxjerrë nga të dhënat konkrete që ekzistojnë, po që nuk shfrytëzohen racionalisht, nuk e ka Komiteti Qendror, pse atë s'e ka as Byroja Politike as qeveria. Si mundet në këtë mënyrë Komiteti Qendror të marrë masa plotësisht të realizueshme, të bëjë një politikë konsekuente në fshat? Me njohjen e një situatë të vërtetë, mund të merren edhe vendime të peshuara dhe të drejta. Vetëm të tilla vendime mund të jenë plotësisht të realizueshme. Prej dy vjetësh kanë qenë krijuar komisione, të cilat kanë mbaruar studimin mbi fshatarësinë. Gjithë ky material i vlefshëm ka mbetur në dosje. As Ministria e Bujqësisë, as organet e Komitetit Qendror nuk vënë dorë mbi të, megjithëse po luftojmë çdo orë dhe çdo minutë me vështirësitë në fshat. Çdo vit Komisioni i Planit ka me barrë statistika në lidhje me bujqësinë, me kulturat e ndryshme, me blegtorinë, me tatimet bujqësore, me tatimet e tjera, stimulacionet, me leverdisshmërinë e fshatarësisë, por as Byroja Politike, as qeveria, nuk kanë një studim të vërtetë dhe shkencor të këtyre problemeve shumë serioze. Komisioni i Planit kënaqet që i dërgon qeverisë çdo tre muaj një statistikë të thjeshtë ku i numëron në disa kolona se si u realizua plani në këtë sektor dhe në atë sektor dhe arësyet pse s'u realizua ky plan dhe ai plan konsistokan vetëm se «s'kish disiplinë», «s'u vajti lënda e parë» etj. Por arësyet s'janë vetëm këto. Ka arsye shumë më të thella, të cilat duhen njohur medoemos se përndryshe

do të ketë vazhdimisht thyerje disipline, mungesë punëtorësh etj. Pra një situatë të qartë të fshatit ne akoma nuk e kemi. Kjo është një e metë shumë serioze që duhet ta riparojmë se përndryshe nuk do të dimë mirë ku shkojmë, nuk do të dimë ç'kërkojmë dhe ç'masa duhet të marrim. Ne bëme reformën agrare, por çështjet e tokës vazhdojnë dhe do të vazhdojnë të jenë deri në kolektivizim një problem shumë serioz që lyp një kujdes dhe një mbikëqyrje të vazhdueshme. Jo vetëm që ne duhet të studjojmë natyrën e tokës, pjellshmërinë e saj, të bëjmë si duhet rajonizimin e kulturave, të njohim konditat klimaterike, por duhet në këto baza të përmirësojmë strukturën e tokës, të ndjekim me kujdes lëvizjet në pronësinë e tokës që është në duart e fshatarit privat. Nuk mund të themi se këto probleme s'i kemi prekur, diçka është bërë dhe po bëhet çdo ditë e më mirë, por kjo s'është e kënaqshme. Shumë nga këto probleme kyçe të bujqësisë bëhen në mënyrë spontane, disa lihen përgjysmë, disa janë harruar fare ose janë lënë në fatin e tyre. Në fakt vazhdoen korigjimet e tokave në mënyrë të shthurur, ka qarje të vazhdueshme për fondet e tokave, plani i mbjelljeve nuk përputhet me planin e vërtetë të tokave të punueshme. Kjo sjell konsekuenca të rënda në planifikimin e rendimenteve, në grumbullimet, në të ardhurat e fshatarëve. Nuk mund të themi se s'janë marrë masa për ndreqjen e këtyre gabimeve, por masat janë të çala, sporadike dhe të pa-studjuara, pa plan perspektiv. Këto na bëjnë që të mos e kemi situatën si duhet në dorë, të mos jemi të sigurtë për prodhimin, për grumbullimin, të mos dimë ç'i mbetet dhe ç'nevoja ka fshatari. Ne kemi bërë dhe

vazhdojmë të bëjmë plane nga lart për bujqësinë. Merrni me mend sa të drejta mund të jenë këto plane, kur ne jo vetëm nuk zotërojmë situatën më të gjithë kompleksin e saj, por nuk bëjmë edhe përpjekjet e duhura për të sqaruar këtë situatë. Para tre-katër vjetësh ne nga lart planifikonim për pambukun një rendiment prej 8-9 kv. për hektar. Për ne, para tre-katër vjetësh, të pretendojë 5 kv. për hektar ishte disfatiste. I bënim këto gjëra se nuk dinim se ç'punë duhej për pambukun, që më të shumtët e fshatarëve as që e njihnin fare këtë kulturë dhe s'donin ta mbillnin. Fshatarit i mungonin qetë, i mungonin parmendat e hekurta, ai s'kishte traktorë, ai s'kishte krahë pune, shumë herë toka e tij ishte e papërshtatshme për pambuk dhe ne kërkonim që rendimenti të ishte 9 kv. për hektar. Ç'rezultoi nga këto gjëra? Plani asnjëherë nuk u realizua në pambuk, fshatari u varfërua, në eksportin tonë u shtuan deficitet. Këtë fat patën edhe bimë të tjera industriale. Ne i futeshim një pune kaq të rëndësishme pa i marrë masat e nevojshme, por vendosnim planet dhe i linim të realizoheshin «me frymën e shenjtë».

Të marrim çështjen e blegtorisë. Ajo ka rënë vazhdimisht për dy arsye kryesore: për mungesë ushqimi dhe për strehime jo të përshtatshme bagëtitsh. Ne kemi folur dhe kemi dhënë shumë këshilla, ne kemi vendosur dhe një plan të mirë të zhvillimit të blegtorisë. Por ky zhvillim i blegtorisë është lënë në fatin e vet. Jo vetëm që nuk i kemi siguruar konditat për zbatimin e atij plani që kemi vendosur, por nga ana tjetër e kemi penguar me planet e tjera. Jo vetëm blegtorisë që nuk i kemi sigu-

ruar ushqim, por i kemi pakësuar kullotat dhe vazhdojmë t'ja pakësojmë. Po flasim për bimë shumëvjeçare, por ato nuk mbillen: jo s'ka farë jonxhe — thuhet, jo duhet ta sjellim nga jashtë, jo jashtë s'na e japin etj. Në fakt, kullota s'ka, jonxhë s'mbillet, fshatarëve s'u japim as trarë, as gozhdë, as dërrasa për të meremetuar shtëpitë e tyre, pa le për stallat e bagëtisë dhe nga ana tjetër u themi «shto bagëtinë». Përveç kësaj ne kemi ndryshuar kushedi sa herë tatimin e mishit që ka qenë i dëmshëm për zhvillimin e bagëtive. Këto gjëra të rëndësishme bëheshin dhe vazhdojnë të bëhen të shkëputura njëra nga tjetra, kur sillet njëra për studim dhe vendim, nuk sillet tjetra. Njëra arësyetohet nën presionin e çastit, për një muaj del bishti nga ana tjetër dhe, o burra, merret një vendim tjetër në kundërshtim me të parin. Nga ana tjetër ndërtimet e mëdha industriale tërhoqën investime të mëdha nga ana e tyre, tërhoqën krahë pune shumë nga fshati, u braktisën tokat; detyrimet e larta, politika e stimulacioneve jo e drejtë dhe jo e studjuar mirë, furnizimet e pakta për fshatin me mallra të konsumit, krijuan situatën e rëndë në bujqësinë tonë. Jo vetëm që investimet tona në bujqësi kanë qenë të pakta, por edhe sikur më shumë të kishin qenë, ne nuk do të dilnim mirë me të gjitha këto të meta që kishim dhe kemi në punën tonë.

Tani që ne kemi filluar t'i shohim pak më mirë problemet e bujqësisë, të shohim më realisht zhvillimin e kulturave të drithërave në drejtimin e sigurimit të bukës në vend, të shohim planifikimin e mbjelljes së bimëve industriale më drejt, të shohim më drejt çmimet dhe stimulimet e tyre, të shohim më drejt shtimin e

blegtorisë, të ullinjve, të shpendëve, të bletëve, të perimeve, të rishikojmë tatimet financiare të ekonomive fshatare etj., konstatojmë se nuk dalin hesapet aq lehtë. Ne kemi nevojë për një ndihmë të konsiderueshme nga miqtë për të filluar që ta vëmë në rrugë të drejtë këtë sektor të madh e të rëndësishëm të ekonomisë sonë. Nuk mund të themi tani se në lëmin e bujqësisë jemi si dy-tre vjet më parë. Njerëzit tanë në bujqësi janë ngritur, kanë fituar eksperiencë, kemi krijuar kuadro të lartë dhe të mesëm dhe vazhdojmë të krijojmë. Specialistët sovjetikë po na ndihmojnë me eksperiencën e tyre. Ne kemi një sërë studimesh të vlefshme në dorë për tokën, për klimën, për pambukun, për duhanin, për ullirin, për agrumet, për barërat shumëvjeçare etj. SMT-të dhe feramat shtetërore i kemi pajisur me rregullore dhe vendime të qarta që rregullojnë punën dhe trajtimin e punonjësve. Ne kemi vendosur qarkullimin bujqësor në feramat, po punojmë për ta vendosur atë edhe në kooperativat. Ne kemi bërë një farë rajonizimi të kulturave të ndryshme në shkallë republike, kemi krijuar qendrën eksperimentale të farërave, Institutin e kërkimeve bujqësore dhe shumë gjëra të tjera. Siç shihet, pra, ne kemi shumë mundësi të ecim përpara tash vetëm se në të gjitha këto drejtime duhet të merret puna në dorë, të zhvillohet puna, të përmirësohet dhe jo të lihet në spontaneitet. Të nxirren në çdo kohë konkluzione të vlefshme dhe të drejta.

Është e domosdoshme, pra, nga ana e Ministrisë së Bujqësisë në radhë të parë të bëhet një analizë e thellë e të gjitha këtyre të metave dhe gabimeve që janë vërtetuar në sektorët e ndryshëm të bujqësisë, të studjohet

çdo problem me imtësi, të rishikohen me seriozitet vendimet e marrura, të bëhen korigjimet e gabimeve, të harmonizohet në mënyrë të planifikuar i gjithë zhvillimi i sektorit të bujqësisë në mënyrë që një sektor të mos pengojë tjetrin, por ta mbështetë zhvillimin e tij. Një zhvillim i tillë i sektorëve të bujqësisë dhe të pyjeve, të harmonizohet me sektorët e tjerë të shtetit dhe jo të vendosen gjërat të shkëputura. Duhet të luftojmë me prapambetjen në bujqësi, me moskokëçarjen, me rutinën e vjetër dhe të gabuar, me spontaneitetin në këtë sektor, ku predominon prona private dhe spontaneiteti në punë. Vetëm po t'i shohim mirë këto gabime ne do të mundim t'i luftojmë. Por nuk mjafton që Ministria e Bujqësisë t'i shohë këto gabime, ato duhet t'i shohë edhe qeveria edhe Byroja Politike që të mundet kështu t'i bëhen të qarta edhe Komitetit Qendror. Varet shumë nga Ministria e Bujqësisë që Byroja Politike dhe qeveria të jenë si duhet në dijeni të problemeve të bujqësisë, të njohin situatën reale të bujqësisë, të njohin nevojat që kështu të vendosin masat e duhura dhe të kontrollojnë si duhet zbatimin e vendimeve të marrura. Ne mund të themi se tani po i vihet një kujdes i veçantë sektorit të bujqësisë; këtu ka filluar një punë më e organizuar, me perspektivë dhe duket që po bëjmë përmirësime. Çështja shumë e rëndësishme e prodhimit të bukës në vend sikundër do ta shihni më poshtë është marrë seriozisht. Në ndërmarrjet shtetërore të bujqësisë në vitin 1955 do të arrijmë të marrim 100 000 kv. grurë, do të shtohet prodhimi i drithërave në kooperativat dhe në sektorin privat dhe në këtë mënyrë bëhet e mundur heqja e triskave të bukës nga viti 1956.

Përsa u përket kulturave industriale, zhvillimit të tyre i është vënë më kujdes. Eksperienca e hidhur e viteve të kaluara na shërbeu. Detajimi për çdo ekonomi i mbjelljes së pambukut dhe panxharit, duke marrë parasysh pjellshmërinë e tokës, fuqinë punëtorë, veglat e punës, do të sjellin një përmirësim të dukshëm. Pambuku do të punohet më mirë, prodhimi do të jetë më i madh dhe më i sigurtë, fshatari do të jetë i kënaqur dhe shteti do të jetë shumë i sigurtë për fondin e grumbullimit të tij. Në duhan është proceduar po në të njëjtën mënyrë. Përveç asaj, çështjet e këtyre kulturave të rëndësishme, nuk lihen në një zhvillim spontan. Janë marrë masa që tokat e mbjella me këto kultura, në shumicë të punohen me traktorë, është dhënë plehu kimik që disponojmë, ka më interes për farërat dhe rasetet, janë dhënë urdhëra të prerë që të jenë në gatishmëri të plotë kanalet ujitëse, janë marrë masa të ndërtohen hauze dhe kanale për ujitjen e duhanit në Shkodër dhe në Elbasan. Përsa i përket kulturës së panxhar sheqerit në Korçë, përveç detajimit ekonomi për ekonomi, u ngrit çmimi në interes të fshatarëve, u shtuan stimulacionet, sikundërqë u bë edhe për të gjitha kulturat industriale. Veçanërisht në fermën e Maliqit janë duke u ngritur ndërtesat e caktuara në planin e këtij viti, të destinuara për vendosjen e punëtorëve të fermës. Për pajisjen e fshatarëve me vegla bujqësore në vend, po bëhen përpjekje shumë më të mëdha se çdo herë tjetër dhe ka filluar një prodhim më i gjerë dhe më i përfeksionuar i parmendave prej hekuri, i plugjeve, i kultivatorëve, i lesave. Ujitjet, bonifikimet dhe sistemimi agrar, po vihen në rrugë të mbarë. Këto i përmenda për

të treguar se ne kemi hyrë në një rrugë të shëndoshë pune, por kjo s'do të thotë se i kemi mbaruar të gjitha punët. Çështja është të vazhdojmë në këtë drejtim me një vrull të pareshtur, t'i thellojmë më shumë problemet, të ndjekim me kujdes dhe rigorozitet zbatimin e vendimeve të plenumeve, të mos qëndrojmë në vend dhe të kënaqemi, por të arrijmë qëllimet e caktuara me sukses dhe mbi këtë sukses të mos flemë, por të mbështetemi për të kryer detyrat e mëtejshme dhe për të korrur suksesin tjetër.

Në sektorin industri-miniera dhe në artizanatin e kooperuar janë vërtetuar gjithashtu gabime serioze. Ne kemi analizuar më parë çështjen e proporcioneve në investimet në këtë sektor jashtë kapacitetit të ekonomisë sonë dhe vitin e kaluar morëm një sërë masash shkurtimi të këtyre investimeve. Siç dihet ne kemi ndërtuar një industri të re, të pajisur me teknikën më moderne dhe këtë industri duhet ta vëmë në eficiencë të plotë, pse nevojat e vendit tonë për prodhimet industriale janë jashtëzakonisht të mëdha. Duhet të na shërbejnë si një mësim i madh gabimet e së kaluarës. Ne nuk i përqëndruam dhe nuk i organizuam mirë forcat tona të ndërtimit për t'i mbaruar në afatet e caktuara këto fabrika dhe kombinatet. Ndërtimi i këtyre kombinatëve, me kohë, do t'i fuste më shpejt në prodhim dhe nuk do të rëndohej ekonomia jonë siç është rënduar nga kjo çështje. Ne kemi akoma maqineri që na qëndrojnë në vend, pa u montuar dhe pa u ndërtuar, për arsye se nuk i përballojmë dot ndërtimet. I tillë është aneksi i kombinatit të drurit, për të mos përsëritur objektet e

tjera me rëndësi që mund të liheshin për një periudhë të mëvonshme. Ngritja e industrisë sonë na ka gjetur jo të pregatitur teknikisht dhe materialisht. Vështirësi të mëdha kemi hasur në nxjerrjen e fuqisë punëtore, në furnizimin e saj dhe në kualifikimin e saj. Lënda e parë e nevojshme për ndërtim është siguruar me zor dhe me hope. Por përveç asaj kjo industri duhej të vihej në lëvizje menjëherë dhe të parashikohej që të bëhej me kohë pregatitja e kuadrit. Këtu ne jemi zvarritur shumë. Nuk është e kënaqshme çështja e pregatitjes teknike të kuadrit dhe me gjithë përmirësimet e mëdha që kemi në këtë drejtim, prapëseprapë çështja e edukimit të kuadrove të rinj dhe e kualifikimit si duhet të kuadrove të pregatitur vazhdon të bëhet me hope dhe jo në mënyrë të plotë. Një situatë e tillë është shumë serioze dhe ndikon në prodhim, në realizimin e planit me kohë, në cilësi dhe në sasi, ndikon në racionalizimin e punës, në rendimentet e ulëta, në kursimet e lëndës së parë dhe në shfrytëzimin e maqinave. Teknika shumë moderne kërkon njerëz të kualifikuar mirë dhe ne jemi shumë prapa për ta shfrytëzuar plotësisht këtë industri. Pra Ministria e Industrisë duhet t'i vërë një rëndësi shumë të madhe edukimit dhe specializimit të kuadrove të industrisë dhe një kujdes jashtëzakonisht të veçantë maqinerisë. Këtu, sigurisht, është një proces i tërë punësh dhe metodash, pse po s'u përvetësuan si duhet nga klasa punëtore dhe po s'u aplikuan me rigo-rozitet të madh këto metoda, ne do të na dalë doresh para kohe tërë kjo maqineri dhe popullit nuk do t'i japim sa duhet me kohë ato çka pret nga industria jonë. Ministria e Industrisë mendojmë se nuk i është futur

si duhet kësaj çështjeje dhe në punën e saj ka të meta serioze, ka burokraci, ka lëshime të dënueshme, ka punë me hope, pa plan dhe pa perspektiva të qarta. Lënda e parë nuk është e mjaftueshme dhe nuk shkon me kohë në këto industri. Nga mungesa e qymyrit ndërpritet shumë herë kombinati i tekstileve, rrezikohet TEC-i, ndalojnë fabrika e çimentos dhe shumë ndërmarrje të tjera. Veglat e këmbimit nuk parashikohen me kohë dhe nuk bëhen përpjekjet e duhura të vijnë në sasi të mjaftueshme dhe me kohë. Nuk merren këto masa me kohë e t'i sigurohet lënda e parë kombinatit të drurit i cili që kur është ndërtuar e deri tash është shumë larg të shfrytëzohet plotësisht dhe të realizojë planin dhe në një kohë kur lënda është në vend; kjo lëndë që do të përpunohet është jashtëzakonisht e nevojshme. Në industrinë ushqimore po këto gabime dhe lëshime serioze, të cilat, me një kujdes më të madh, mundet fare lehtë të evitohen. Jo vetëm që planet nuk realizohen, jo vetëm që prodhimet nuk dalin me kosto të lirë, por kualiteti i më të shumtave të prodhimeve të fabrikuara, qoftë nga industria, qoftë nga artizanati është i dobët. Nuk tregohet interesimi i duhur dhe i posaçëm për klasën punëtore, për edukimin e saj teknikisht dhe politikisht. Nuk tregohet kujdesi i duhur për jetën dhe argëtimin e punëtorëve.

Industria dhe minierat i kanë shkaktuar dhe i shkaktjnë kokëçarje të mëdha ekonomisë sonë, pse vazhdimisht në këta sektorë, në përgjithësi planet nuk realizohen dhe na nxjerrin pengesa serioze, jo vetëm në furnizimin e popullit, por pengojnë edhe shumë sektorë të tjerë të ekonomisë. Përveç kësaj, Ministria e

Industriisë dhe e Ndërtimit si edhe gjithë dikasteret e tjera ekonomike nuk shfrytëzojnë racionalisht të gjithë kapacitetin e maqinerisë së tyre, nuk shfrytëzojnë racionalisht lëndën e parë. Në Ministrinë e Industriisë dhe të Ndërtimit, veçanërisht, nuk inkurajohet inisiativa krijuese e punëtorëve dhe e specialistëve.

Siç është në dijeni Komiteti Qendror, plani në miniera, qoftë në naftë, në qymyr, në bitum dhe në krom, vazhdimisht nuk realizohet dhe vazhdon po në këtë rrugë, me gjithë masat që janë marrë. Kjo është shumë serioze. Janë të paevitueshme këto deficite në rast se nuk marrim masa urgjente për t'i ndrequr gabimet serioze në këtë drejtim. Për ne akoma edhe tash çështja gjeologjike nuk është e qartë. Kërkimet gjeologjike janë filluar vonë dhe nuk janë organizuar si duhet nga ministria. Te ne punojnë ekipe të rëndësishme sovjetike, të cilat kanë bërë një punë të mirë, punojnë ekipe poloneze dhe çeke. Por, për fat të keq, ministria nuk i ka pasur në dorë kërkimet, as t'i kontrollojë, as t'i udhëzojë, për arsye se nuk ka ekzistuar një organ i veçantë për këtë problem kaq të rëndësishëm për ekonominë tonë. Punimet e ekipeve gjeologjike, mund të thuhet pa frikë, se lexoheshin përciptas si material i thjeshtë informacioni. Nuk ekzistonte në ministri një drejtori e fuqishme gjeologjike, ku të grumbulloheshin gjeologët tanë dhe ata sovjetikë dhe të merrej si duhej në dorë ky sektor me rëndësi të madhe, ku ne kemi investuar dhe investojmë shumë dhe këto investime tash për tash rëndojnë pa masë në ekonominë e vendit. Kjo mungesë drejtimi ka luajtur një rol negativ në shfrytëzimin e minierave, prandaj Komiteti Qendror duhet t'i vërë si detyrë ur-

gjente Ministrisë së Industrisë dhe të Ndërtimit ta organizojë sa më parë këtë drejtori dhe të interesohet shumë për çështjen e minierave.

Për arsye kërkimesh, që ne jemi prapa, tash në shumë nga minierat tona jemi pa rezerva industriale dhe planet tona nuk janë të sigurta. Kështu ndodh me bakrin. Këtu ne jo vetëm që për disa vjet do të pezullojmë metalurgjinë, por mineralin e pasur të Rubikut, të cilin duhet ta përdorim në perspektivë për ta përzier me mineralin më pak të pasur të Dervenit, ne e hëngrëm me kohë dhe tash jemi në situata të atilla që metalurgjia e bakrit do të varet nga gjetja e mineralit me një përqindje të pasur. Ky ka qenë një gabim i rëndë i ministrisë, përveç të tjerave.

Me scrën e Selenicës, po kjo gjendje. Ne atje nuk kemi rezerva dhe kërkimet vazhdojnë. Këtu përsëri janë bërë gabime dhe janë neglizhuar kërkimet, kështu që është vështirësuar situata. Edhe me naftën është po kjo situatë e rëndë dhe vetëm masat që do të marrim mund të na nxjerrin nga kjo situatë preokupante për ne. Kuptohet, pra, sa urgjente është për ne që Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit të marrë në dorë çështjen e minierave, çështjen e tyre gjeologjike, ta çojë këtë përpara dhe me sukses ta shfrytëzojë në maksimum ndihmën e specialistëve sovjetikë. Unë prek vetëm çështjet kryesore për të mos rënduar raportin, por në sektorin e minierave dhe në ndërmarrjet e saja ka gabime dhe të meta të mëdha të tjera, të cilat duhet medoemos të zhduken dhe për këtë lypset të shkundet i gjithë aparati i ministrisë së këtij sektori; të shkunden ndërmarrjet e minierave, të shkundet e gjithë Partia në këtë sektor.

Partia duhet të shikojë me imtësi të gjitha çështjet në miniera, të marrë masa konkrete përmirësimi, edukimi, specializimi; për punëtorët atje të vendosë disiplinë të hekurit, të vendosë dhe të zbatojë me rigorozitet metodat e reja sovjetike në punë, të bëjë që maqineritë të mirëmbahen dhe të shfrytëzohen si duhet racionalisht. Veçanërisht kombinati i naftës është bërë një depozitë kolosale motorësh elektrikë që nuk funksionojnë. Sipas të dhënave atje ekzistoka fuqi elektrike, dy herë më shumë sa ajo që do të prodhojë hidrocentrali që do të ndërtojmë mbi lumin e Matit dhe shumica e këtyre motorëve, nuk punojnë nga pakujdesia, nga prishje kriminale, nga mungesa e veglave të këmbimit etj. A mund të lejojë Komiteti Qendror që të vazhdojë një situatë e tillë e rëndë? Këto janë gabime serioze dhe duhet likuiduar kjo situatë e rrezikshme për ekonominë e vendit tonë.

Një problem tjetër shumë serioz që preokupon jo vetëm industrinë dhe minierat, por edhe gjithë sektorët e tjerë është *çështja e sigurimit, e trajtimit dhe e vendosjes së fuqisë punëtore*. Fuqia punëtore në sektorët kryesorë të prodhimit nuk është realizuar asnjëherë gjatë këtyre tre vjetëve. Masat e marrura për ta siguruar këtë kanë qenë larg për të qenë të mjaftueshme. Çdo herë këtë problem kaq të rëndësishëm e kemi ngritur me forcë, por mendojmë se masat e marrura nuk kanë qenë të plota, të studjuara dhe vendimet nuk janë kontrolluar. Ne mund të themi se hallka kryesore nga ku ne duhej të kapeshim për zgjidhjen e këtij problemi, stabilizimi i fuqisë punëtore, është lënë pasdore dhe nuk i është vënë rëndësia që meriton. Në sektorët kryesorë të prodhimit ekziston një lëvizje shumë e madhe e

fuqisë punëtore. Gjatë vitit 1951 në industri dhe bujqësi kanë hyrë 16 800 punëtorë dhe kanë dalë 13 200. Në vitin 1952 kanë hyrë 23 100, kanë dalë 24 700 dhe në vitin 1953 kanë hyrë 24 800 dhe kanë dalë 22 400. Një lëvizje e tillë është shumë e dëmshme për ekonominë tonë; ndërmarrjet janë në hall, ato kanë të bëjnë vazhdimisht me punëtorë të rinj dhe s'u mbetet kohë për t'i kualifikuar. Kështu rendimentet e planifikuara kurrë nuk arrihen. Është e kuptueshme, pra, sa serioze është stabilizimi i fuqisë punëtore. Dihet se fuqia punëtore në përqindjen dërmuese del nga fshati. Në vitet që kaluan gjendja e fshatit ka qenë e vështirë dhe punëtorët dilnin më tepër, por këtej e tutje, kur po merr një hov të madh bujqësia, çështja e fuqisë punëtore do të bëhet problem. Ju e dini sa vështirë kemi qenë sivjet me qymyrit për të marrë vetëm këtë sektor kaq të rëndësishëm për ekonominë tonë. Mosnxjerrja e qymyrit ka pasë blokuar TEC-et, industrinë, hekurudhat dhe shumë ndërmarrje të tjera. Dhe faktori kryesor këtu ka qenë fuqia punëtore. Plani ynë i qymyreve, po ngrihet, do të ngrihet shumë në vitet e ardhshme dhe në rast se nuk marrim masat e shpejta, që kemi vendosur në plan, për të stabilizuar fuqinë punëtore në miniera, në rast se nuk e përmirësojmë seriozisht gjendjen ekonomike të minatorëve të qymyrit, me siguri ne do të kemi konsekuenca shumë të dëmshme. Pra, për të zgjidhur problemin e fuqisë punëtore, ka vetëm dy rrugë, të cilat duhet të ndiqen: rruga e zhdukjes së fluktacionit të klasës punëtore, duke e stabilizuar këtë, duke ndër-tuar banesa për të, duke përmirësuar jetën e tyre, në mënyrë të atillë që fshatari i varfër pa tokë ose me pak

tokë, të shohë se ka më leverdi dhe është më mirë për të në qendrat e punës se në fshatin e tij dhe rruga tjetër, që ne duhet të ndjekim paralelisht me të parën, është të zhvillojmë mekanizimin e punimeve, duke shfrytëzuar si duhet ato maqineri që kemi dhe kemi mjaft për një periudhë të parë, të mendojmë gjithashtu për të ardhshmen, me mekanizue edhe më shumë procese të tjera pune, për të mos varfëruar kështu bujqësinë. Komisioni i Planit duhet të ecë me sy hapët në këtë drejtim, të caktojë norma shfrytëzimi të drejta të të gjithë materialeve të mekanizimit të proceseve, që nga traktorët e deri te betoniera në e thjeshtë.

Shumë i vështirë paraqitet strehimi i punëtorëve në të gjithë sektorët. Për të stabilizuar fuqinë punëtore është e nevojshme të sigurojmë apartamente familjare për 70-75 për qind të punëtorëve, sepse gjendja në fund të vitit 1953 në qendrat kryesore paraqitet në këtë mënyrë: në industrinë e naftës 47 për qind, në Selenicë 37 për qind, në Bulqizë 13 për qind, në Memaliaj 37,5 për qind, në Kërrabë 20 për qind, në fermat 29 për qind, në SMT-të 40 për qind dhe në Kombinatin e tekstileve «Stalin» 41,2 për qind. Veç kësaj investimet e caktuara në ndërtimin e banesave nuk janë realizuar asnjëherë gjatë këtyre viteve. Në sektorin e minierave, të industrisë dhe të bujqësisë p.sh. investimet janë realizuar në ndërtesa në këtë mënyrë: në vitin 1951, 89,2 për qind, në 1952, 86,5 për qind dhe në 1953, 57,4 për qind.

Në lidhje me furnizimin e qendrave të punës me ushqime dhe me mallra të garantuara si dhe në tregun komercial ka qenë i pamjaftueshëm. Kështu p.sh. gjatë nëntë-mujorit të vitit 1953 plani i furnizimit në qendrat mine-

rale është realizuar në mish-peshk 86 për qind, në yndyrna — 95 për qind, në vezë — 72 për qind, në stofra të lesh-ta — 47 për qind. Me sende të tjera ushqimore dhe industriale jo vetëm që nuk janë furnizuar plotësisht, por janë furnizuar me hope, me periudha dhe me kualitet të dobët. Me një gjendje të tillë të strehimit dhe me një furnizim të tillë të punëtorëve, për ne do të jetë e zorshme të pretendojmë rritjen e rendimentit dhe zhdukjen e fluktuacionit në punë. Prandaj duhet medoemos të marrim masa dhe të përmirësojmë rrënjësisht këtë situatë.

Në planin e vitit 1954 parashikohen një sërë masash të rëndësishme për përmirësimin e konditave të jetesës në përgjithësi dhe veçanërisht për përmirësimin e gjendjes së strehimit. Do të ndërtojmë gjatë këtij viti në minierat 17 300 m² sipërfaqe të banueshme, në bujqësi 32 800 m² dhe në Kombinatin e tekstileve «Stalin» 8 100 m². Realizimi i këtyre masave do ta përmirësojë gjendjen e strehimit të punëtorëve sidomos në fermat. Por, për përmirësimin e problemit të stabilizimit të fuqisë punëtore, është e nevojshme që të marrim një sërë masash si vijon:

1. — Të ndërtohen gjatë viteve të ardhshme 1954-1957 në qendrat kryesore të punës banesa me një sipërfaqe prej 238 000 m². Në sektorin e minierave të sigurohen me familje 60 për qind e punëtorëve dhe për këtë të ndërtohen 38 000 m² banesa; në Kombinatin e naftës «Stalin» të sigurohen me familje 62 për qind e punëtorëve dhe për këtë të ndërtohen 26 000 m² banesa, në sektorin e bujqësisë të sigurohen 69 për qind e punëtorëve me familje dhe për këtë të ndërtohen 142 000 m² banesa. Në Kombinatin e tekstileve «Stalin» të siguro-

rohen me banesa familjare 67,5 për qind e punëtorëve dhe për këtë të ndërtohen 32 000 m² banesa.

2. — Plenumi i Komitetit Qendror t'i rekomandojë qeverisë që brenda këtij tremujori të studjojë dhe të marrë masa për një përmirësim rrënjësor të furnizimit të punonjësve në sektorët: miniera, ndërtim, sharra, peshkim dhe në transportin detar. Gjithashtu të merren masa për të përmirësuar jetën kulturele në qendrat e punës.

Mbi sigurimin me kohë të disa materialeve nga importi. Në shumë raste siguri i prodhimit të planifikuar gjatë një viti ka qenë lidhur ngushtë me importin e disa lëndëve të para, materialeve ose pjesëve të këmbimit po në të njëjtin vit. Mirëpo nga vonesa e lidhjes së kontratave dhe nga mosardhja në kohën e duhur e tyre, është penguar realizimi i prodhimit. Kështu p.sh. Kombinati i tekstileve «Stalin» vazhdimisht është penguar në realizimin e planit në prodhimin e asortimenteve të kërkuara për mosardhjen me kohë të kimikateve dhe të veglave të këmbimit. Po kështu e kanë penguar realizimin e planeve mosardhja e motorëve të peshkimit, pjesët e këmbimit për traktorët e bujqësisë, për motorët e naftës etj. Për mosardhjen me kohë të materialeve të ndryshme nga importi kanë influencuar shumë dobësitë në punë të organeve të tregëtisë së jashtme, por ka munguar preokupimi për studimin e marrjen e disa masave të nevojshme për të mos penguar prodhimin. Në këtë drejtim është e nevojshme që organet shtetërore të kenë parasysh që në planet e viteve të ardhshme të importit, të krijohen më shumë rezerva për t'u përdorur në muajt e parë të vitit.

Një çështje tjetër e rëndësishme që ka lejuar të bëhen gabime dhe të rëndohet më shumë ekonomia jonë me shuma të mëdha të hollash dhe materialesh është *çështja e projekteve dhe e preventiveve*. Çdo vit nga mungesa e projekteve dhe e preventiveve ka ndodhur që vëllimi i ndërtimeve të rritet shumë në krahasim me parashikimet duke sjellë çrregullime në realizimin e objekteve të planifikuara. Ky problem akoma nuk është zgjidhur dhe po na kushton shumë. Është folur disa herë në mbledhje të Komitetit Qendror dhe të qeverisë për këtë problem, por masa për zgjidhjen definitive nuk janë marrë. Prandaj është e domosdoshme që në të ardhshmen të mos përfshihen në planin e shtetit objektet pa studim të hollësishëm e të gjithanshëm ku të dalë qartë nevoja dhe leverdia ekonomike e investimit. Duke filluar që nga viti 1955, ashtu siç e përcaktoi Kongresi II i Partisë, në planet operative vjetore të mos përfshihet asnjë objekt ndërtimi pa pasur projekt dhe preventiv.

Përveç këtyre gabimeve dhe të metave serioze ka sigurisht edhe shumë të tjera që lidhen me sektorë të ndryshëm të ekonomisë, të arësimit, të kulturës, të shëndetësisë, të tregëtisë shtetërore të jashtme dhe të brendshme.

TË PËRSOSET MË TEJ METODA E DREJTIMIT NGA ORGANET SHTETËRORE

Gabimet që përmenden më lart në drejtim të ekonomisë dhe të shtetit kanë pasur reperkusione të ndieshme në zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë së vendit

dhe reperkusione në dobësimin e disiplinës në punë dhe në aparatet lokale të Partisë dhe të pushtetit. Këto çështje serioze ne duhet t'i shohim dhe t'i analizojmë për t'i ndrequr rrënjësisht dhe jo sa për të shkuar radhën. Përgjegjësia jonë është shumë e madhe para Partisë dhe popullit. Çdo gjë duhet ta mendojmë thellë, ta studjojmë mirë, ta vendosim mirë dhe ta zbatojmë mirë.

Këto gabime serioze që janë bërë, këto të meta dhe lëshime që ekzistojnë në punën tonë dhe që janë shumë preokupuese, sigurisht e kanë diku burimin dhe këtë ne duhet të përpiqemi ta gjejmë. Ne mendojmë se burimi i këtyre gjërave qëndron në drejtimin e dobët të çështjeve ekonomike dhe shtetërore nga ana jonë. A vjen kjo dobësi pse shokët tanë udhëheqës dhe gjithë punonjësit tanë në përgjithësi nuk punojnë dhe nuk përpiqen të ngrihen? Kjo nuk mund të thuhet. Bile mund të thuhet e kundërta. Shokët udhëheqës lodhen jashtëzakonisht shumë sa që çështja e shëndetit të tyre bëhet preokupante dhe Komiteti Qendror duhet të marrë vendime rigoroze për çështjen e kujdesit të shëndetit të udhëheqësve. Udhëheqësit punojnë me orar e pa orar dhe lodhen shumë, ata nuk ushqehen mirë, çështja e pushimeve të tyre vjetore gati nuk ekziston fare, mjaft prej tyre janë të sëmurë dhe as interesohen të mjekohen. Kjo gjendje do të bëhet çdo ditë e më serioze, prandaj duhet të ndryshojë. Po përse u përket përpjekjeve që bëjnë shokët e udhëheqjes për t'u mësuar, për t'u edukuar, kjo mund të themi se nuk është shumë e kënaqshme. Shokët kanë fituar dhe fitojnë çdo ditë një eksperiencë të madhe, shumë të vlefshme, ata çdo ditë ngrihen, rriten. Kjo është e padiskutueshme. Por

edukimi i tyre nuk bëhet i sistemuar, i organizuar me një kombinim të harmonishëm të teorisë me praktikën. Praktika predominon në shokët tanë, dhe ata me ngurrim dhe me zor të madh u futen çështjeve për t'i thelluar nga ana shkencore dhe teorike. Si rrjedhim studimi i tyre nga ana teorike dhe shkencore bëhet i zbetë, i shkëputur, i rastit. Është e zorshme për shumë shokë udhëheqës të mendohet që tash të futen në universitetet dhe të kryejnë studimet e larta, por nuk është e zorshme për ta, me një punë më këmbëngulëse t'i futen studimit të teorisë marksiste-leniniste dhe anën shkencore e teknike të çështjeve ata mund ta studjojnë në të gjitha problemet ekonomike dhe shtetërore që na dalin pa pushim përpara, në rast se studimi i këtyre problemeve bëhet si duhet, thellohet deri në fund. Ne kemi pasur avantazh eksperiencën e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të ndërtimit të socializmit dhe të komunizmit në atdheun sovjetik. Është e domosdoshme për vendin tonë që ne ta përvetësojmë këtë eksperiencë, ta zbatojmë në mënyrë krijuese dhe jomekanike, ta përhapim këtë eksperiencë në të gjitha fushat, ekonomike, kulturele etj., por në mënyrë të gjallë dhe krijuese dhe jo në mënyrë shablone dhe mekanike. Ka ardhur koha që kuadrot tanë të kthejnë vendosmërisht fytyrën nga studimi i thellë i problemeve ekonomike dhe teknike. Problemet jetike të vendit nuk zgjidhen më me fraza e me deklamacione. Këtë problem kaq të rëndësishëm të ngritjes së tyre, shokët e udhëheqjes duhet ta shikojnë seriozisht pse është një nga kyçet kryesore që do të forcojë drejtimin e Partisë dhe të shtetit, do t'i zgjidhë problemet më drejt dhe më lehtë dhe rezultatet

në punë do të jenë më të mëdha. Jo vetëm kjo, por shokët me nivel më të ulët se ne kërkojnë një rrugëdalje nga një situatë e tillë e rëndë dhe ne duhet të jemi shembull metode pune, disipline dhe vullneti në të mësuar. Pra kjo është një nga arësyet kryesore që punët tona nuk kanë ecur me atë ritmin që duhet, që problemet nuk janë zgjidhur si duhet dhe që janë vërtetuar gabime. Duhet, pra, që Komiteti Qendror të kërkojë llogari nga shokët udhëheqës, jo vetëm në ndjekjen e kurseve dhe të seminareve të teorisë marksiste-leniniste, por të mos pranojë nga shokët udhëheqës të Partisë ose të shtetit asnjë problem me rëndësi, pa qenë ai thellësisht i studjuar nga ana teorike, shkencore, teknike dhe nga ana e zbatimit praktik të tij. Kjo do të jetë një masë e rëndësishme jo vetëm në drejtimin e përmirësimit të punës në përgjithësi, por një obligim i organizuar për udhëheqësin që të bëjë përpjekje në mësimin individual, lidhur ngushtësisht me detyrat që i ka ngarkuar Partia. Paraqitja e studjuar e një problemi nga një udhëheqës është njëkohësisht një kontroll efikas që do të tregojë sa janë përpjekjet e tija për t'u ngritur.

Prakticizmi, rutina dhe burokratizmi i theksuar në punën tonë na pengojnë shumë të gjejmë metodën e vërtetë dhe të drejtë të punës.

Ne, qoftë në forume, qoftë si individë, punojmë pa një plan të vendosur dhe të studjuar mirë, punojmë pa metodë të shëndoshë. Kjo na dëmton pa masë. Kjo dobëson drejtimin dhe është një nga shkaqet e gabimeve, e mungesës së kontrollit dhe të disiplinës në punë. Si në të gjitha punët tona, ashtu edhe këtu ka spontaneitet. Metodën e mirë në punë e vendosin nje-

rëzit, e përmirësojnë njerëzit që i kanë të qarta detyrat, funksionet, kompetencat, qoftë si pjesëtarë të një forumi udhëheqës, qoftë si udhëheqës të një sektori të veçantë. Çdo forum i Partisë ose i pushtetit dhe çdo individ funksionar, jo vetëm duhet të njohë fill e përpe kompetencat dhe detyrat e tija, por duhet të ndjejë përgjegjësinë e plotë dhe të japë llogari. Duhet nga ana jonë të shtohet ndihma, por edhe të luftohet liberalizmi në marrjen e masave. Kjo çështje nuk është vendosur si duhet te ne. Në kartë, mund të themi se shumë gjëra janë, sido që duhet të rishqyrtohen edhe në kartë, pse ka gabime, por me ekzistues në kartë, s'vlen gjë në rast se kjo nuk bëhet një jetë e veçantë në punën tonë. Në këtë drejtim duhet të zhvillojmë një luftë të madhe, luftë për të përmirësuar metodën e punës. për të rritur përgjegjësinë e njerëzve në punë, për të luftuar burokratizmin dhe spontaneitetin. Duhet që nga funksionari më i thjeshtë dhe deri te ai më i larti, të kryejnë mirë detyrat e tyre, çdo gjë ta kenë të qartë në kokën e tyre, në dokumentat zyrtare dhe këto dokumenta, të përpunuara thellësisht, të azhurnuara, të qarta, të pasqyrojnë gjendjen reale të sektorit ku ai punon dhe drejton. Një punë e tillë e tyre, s'duhet të jetë një punë mekanike, po një punë e gjallë dhe plot jetë. Funksionari që nga më i vogli e deri te më i madhi duhet të ketë inisiativë vepruese brenda kompetencave të tija, atij duhet t'i pjellë mendja, të jetë njeri me perspektivë krijuese dhe jo një person i struktur në zyrë dhe i mbytur në letra. Ai duhet të vërtetojë, pa humbur kohë, me realitetin çdo material që i vjen, të marrë masa të shpejta, të propozojë masa, të kontrollojë zbatimin e

këtyre masave dhe të luftojë me këmbëngulje për të korrur rezultatet. A punohet kështu në aparatet tona shtetërore dhe të Partisë, a kanë aparatet tona një metodë pune të shëndoshë? Jo, jemi shumë larg. Le ta fillojmë nga ministritë, të dalim te Këshilli i Ministrave dhe të ndalojmë në Byronë Politike dhe në aparatet e Komitetit Qendror.

Pikësëpari shumë nga ministrat tanë, që janë anëtarë të Komitetit Qendror dhe udhëheqës kryesorë në ministritë e ndryshme, nuk bëjnë përpjekje sa duhet që të vendosin një metodë pune të shëndoshë në aparatet e tyre. Në radhë të parë, ministri vetë, nuk ka ditur akoma si duhet t'u japë kompetencat e vërteta në praktikë ndihmësve të tij kryesorë dhe t'i mësojë këta të ecin si duhet me kokën dhe me këmbët e tyre. Në shumë raste si p.sh. në Ministrinë e Industrisë dhe të Minierave u lidhen duart ndihmësministrave. Ministri merret me gjëra jashtëzakonisht të vogla dhe këto e bëjnë të harrojë problemet e mëdha që kërkojnë zgjidhje prej tij. Ministri harron se Këshilli i Ministrave, Byroja Politike dhe Komiteti Qendror kërkojnë prej tij zgjidhjen rrënjësore të problemeve kyçe. Jo vetëm që ministri merret me gjëra shumë të vogla, po në këtë ingranazh të rrezikshëm shumë herë tenton të futë dhe Këshillin e Ministrave. Do t'ju jap një shembull tipik. Si ky ka me qindra në mjaft sektorë. Shoku Bedri Spahiu, anëtar i Komitetit Qendror dhe ministër i arësimit, sjell në mbledhjen e Këshillit të Ministrave çështjen që t'ja zgjidhë ky forum nga më të lartët e shtetit, blerjen e një kali për një ndërmarrje të shpërndarjes së botimeve. Kjo çështje që duhet të zgjidhet nga llogaritari më i

humbur i asaj ndërmarrjeje, ka ardhur, sigurisht, në Drejtorinë e botimeve të Ministrisë së Arësimit, atje do të jetë diskutuar ndonjë ditë, se pak punë të tjera kanë! Ata s'e zgjidhën dot, patjetër ajo ka vajtur te ndihmësministri dhe ai s'e zgjidhi dhe ja çoi ministrit dhe shoku Bedri s'ngurroi t'ja shtronte Këshillit të Ministrave. A nuk e kuptojnë shokët ministra një situatë të tillë të rrezikshme? E kuptojnë. Atëhere pse vazhdojnë në këtë rrugë? Në qoftë se mendojnë se të gjitha çështjet duhet të zgjidhen prej tyre, ata gabojnë. Shteti dhe Partia jonë u kanë dhënë të gjithëve, sipas rangut kompetencat e tyre të plota. Ministri të kontrollojë zbatimin e drejtë të detyrave të këtyre kompetencave prej vartësve dhe të kërkojë rezultatet. Ministri duhet të mendojë seriozisht se është në pamundësi që të gjitha çështjet t'i zgjidhë ai vetë, kjo gjë nuk mund të jetë as në vijën e Partisë sonë. Ministri duhet të ketë besim të madh në të gjithë njerëzit që punojnë nën vartësinë e tij dhe njëkohësisht t'i ndihmojë dhe t'i kontrollojë.

Mundet që të gjitha këto që thamë më lart të mos jenë plotësisht kështu, por atëhere pse ministri merret me gjëra kaq të vogla që e tërheqin nga problemet kryesore? Mund të jetë arsyeja se ministri nuk punon si duhet me shtabin e tij kryesor, nuk punon si duhet dhe nuk e përdor si duhet kolegjiimin e ministrisë. Ky është një fakt i padiskutueshëm. Kolegjiimi, që është një shkollë e madhe për kuadrot drejtues të ministrisë, nuk i kryen funksionet e vërteta që ai ka. Në kolegjiimet e ministrive tona, në më të shumtat e rasteve studjohen gjëra të vogla, të cilat duhet t'i zgjidhin vetë ndihmësministrat, drejtorët, shefat e degëve dhe ata:

s'kanë pse vijnë në kolegjiun. Kolegjiunet s'kanë plan pune të shëndoshë, atje nuk rrihen problemet kryesore të ministrisë. Ato pak probleme që i çohen janë të përçipta, të pathelluara, pa masa, pa vendime, ato paraqiten në më të shumtën e herës si punë e një personi që ka cikërisur andej-këtej një shifër të çalë dhe të pakontrolluar. Studimet s'janë serioze dhe dilet nga mbledhja e kolegjiunit si «rruar qethur». Në mbledhjen e kolegjiunit nuk përcaktohen studimet kryesore që duhet t'i paraqiten ministrisë dhe qeverisë. Këto studime duhet të parashikohen me kohë, të jepet orientimi, të hartohet plani i punës, të krijohen komisione të veçanta për çdo problem nga shokët përgjegjës dhe specialistë, të cilët të shfrytëzojnë rrënjësisht të gjitha të dhënat, statistikat, vërtetimet në praktikë, ta studjojnë problemin nga të gjitha aspektet, ta studjojnë të lidhur me të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë, të studjojnë anën financiare të tyre. Dhe më në fund studimi komplet të diskutohet në kolegjiun, të rrihet mirë, të aprovohet me vendime dhe me masa dhe t'i paraqitet Këshillit të Ministrave ose të zbatohet menjëherë në rast se është në kompetencën e vetë ministrisë. Kështu çështjet nuk bëhen. Ministrat nuk mendojnë seriozisht për këtë çështje, nuk bashkëpunojnë si duhet me ndihmësit kryesorë, nuk punojnë si duhet në mënyrë kolegjiale, nuk parashikojnë me kohë studimin e problemeve kyçe, po çdo gjë e studjojnë në çast, të shpejtuar, vendimet merren të çala, ndihma zbatuese nuk u jepet si duhet, pse shumë të papritura dalin rrugës, kontrolli bëhet i çalë dhe problemi kurrë nuk zgjidhet si duhet pse është krijuar një lëmsh që zor t'i gjendet filli.

Këto janë rreziqe të mëdha në drejtimin e punës sonë në rast se ne nuk shkarkohemi nga çikërrimat, në rast se vartësve nuk u japim kompetenca të plota dhe të forcojmë në ta ndjenjën e përgjegjësisë dhe të kurajës në punë, në rast se ne kolegjalisht nuk përmirësojmë punën. Një frymë e tillë e shëndoshë me metodën e punës në udhëheqje ka kaluar në mënyrë të rrezikshme poshtë në ndërmarrjet e ndryshme. Ato janë në hozrashot, por shtabi udhëheqës i tyre nuk është në krye të detyrës, pavarësisht se ata janë njerëz të mirë, punëtorë dhe të palodhur. Ministrinë nuk i kanë bërë ata si duhet luftëtarë të vendosur kundër vështirësive, nuk i kanë mësuar dhe inkurajuar si duhet të mendojnë dhe të ecin vetë, të ndjehen zotër të fuqishëm të ndërmarrjeve të tyre, të ngjallin si duhet ndjenjën e përgjegjësisë dhe të disiplinës së hekurt në punë. Shumë gjëra poshtë, nuk i kanë të qarta, pavarësisht se u venë me mijëra e më mijëra shkresa në muaj, pavarësisht se andej kalojnë me qindra e me qindra të deleguar e inspektorë. Këta në mjaft raste i ngatërrojnë edhe më shumë, se venë të papregatitur, shesin mend, fryhen si gjela dhe japin urdhëra të pamatur. Mjaft prej këtyre tërhiqen zvarrë për të marrë dietat. Para disa javësh shkova në Kërrabë, vizitova minatorët. Me qindra njerëz kanë vajtur atje, kanë shitur mend, kanë ngrënë dieta, por atje prej 10 vjetësh me radhë s'ka asnjë doktor, s'ka asnjë këpucar, asnjë rrobaqepës, asnjë berber, shtresa dhe mbulesa nuk u venin, bile ministria kishte dhënë urdhër që dhe leckat që u kishte dhënë si shtresa dhe mbulesa, t'ua merrte pse qenkëshin «pronë e ndërmarrjes», punëtorët s'merrnin gaze-

tën, s'kishin një zyrë të vogël poste dhe telegrafi, ushqimet s'u venin në rregull etj. etj. Dhe minatorët atje, në këto kondita, punojnë si heronj. Po ju them se, për të fshehur emocionin që ndjeja kur m'i thoshin punëtorët këto gjëra, bëja sikur dielli më vriste sytë. Për të gjitha këto gjëra dhashë urdhëra dhe brenda dy ditëve të gjitha ç'kërkonin punëtorët u plotësuan. Këtë gjë e përmenda jo për t'i thënë Komitetit Qendror se bëra ndonjë punë të madhe, por për t'i thënë se s'është e drejtë që vetëm me urdhërin tim u plotësuan këto gjëra, të cilat kanë qenë plotësisht të realizueshme sikundërqë u realizuan. Kjo s'është e drejtë edhe nga një anë tjetër parimore, nga ana që punëtorët të arrijnë në konkluzionin dhe të thonë: «Asnjëri nuk na i ndreqi punët, përveç Enver Hoxhës». Punët nuk i ndreq Enver Hoxha, por i ndreq Partia, i ndreq udhëheqja e Partisë dhe e shtetit dhe Partia dhe udhëheqja s'është vetëm Enver Hoxha, por jemi të gjithë ne, janë me mijëra e me mijëra që luftojnë ashtu si luftojmë dhe punojmë ne, në mos më mirë.

E rëndë është t'i kërkojë dikasterit të të paraqitë një studim ose të bëjë një raport për një problem të caktuar, pse e gjithë puna e dikasterit blokohet, me dhjetëra punonjës nga më kryesorët mobilizohen jo për një ditë, por me javë, për të mos thënë më shumë dhe më në fund me një vonesë të madhe të paraqitet studimi ose raporti në fjalë, i pastudjuar, i çalë. Kërkesa bie si një bombë dhe shkatërron «harmoninë» e rutinës dhe të shthurjes. Pse ngjet kjo? Pse nuk është gjithsecili në krye të detyrës së tij, pse nuk i ka gjithsecili punët e tija të qarta, të azhurnuara, të kontrolluara dhe të gat-

shme që në çdo moment t'i përgjigjet kërkesave që i bëhen. Kur i kërkojnë, ai zgjohet nga gjumi i rëndë, vërtitet nga të katër anët dhe, natyrisht, paraqit kashtë në raportin që i kërkojnë. Kjo ngjet se njerëzit nuk mbahen në çdo moment të ngrehur, nuk ndihmohen si duhet, nuk kontrollohen vazhdimisht. Po të praktikohet një punë e tillë, një herë do ta gjesh në gjumë punonjës të tonë. Do të jetë e ekzagjeruar që ne të kërkojmë nga aparatet tona të punojnë si një sahat precizioni, ne ndonjëherë mund t'ua falim edhe 2-3 minuta vonesë, por jo sahati të bjerë si kumborë.

Ne mendojmë se ekzistojnë të gjitha mundësitë që kuadrot tanë me një kujdes të posaçëm, me një ndihmë më të madhe që duhet t'u jepet të jenë në gjendje të kryejnë një punë dhjetë herë më të pastër dhe më të frutshme se ajo që kryejnë sot. Këto gabime dhe të meta që ekzistojnë te ne, të mos na trembin, t'i njohim dhe t'i korrigjojmë dhe punët do të ecin më mirë me siguri matematike. Në të gjitha këto drejtime nuk është ngelur pa marrë masa dhe ne mund të themi se ka mjaft përmirësime nga e kaluara. E vërtetë është të thuhet se kuadrot janë rritur, janë pjekur në punë, kanë fituar eksperiencë, po këto përparime janë të pamjaftueshme, shumë ferra kemi akoma nëpër këmbë, të cilat duhet t'i qërojmë.

Në organet kryesore të udhëheqjes, në Byronë Politike dhe në qeveri që kanë një përgjegjësi të madhe për zhdukjen me kohë të këtyre gabimeve, për vendosjen e një metode pune më të mirë, për kërkimin e llogarisë nga ministrat dhe nga gjithë vartësit e tyre, mund të themi se me të gjitha përpjekjet dhe përmirë-

simet, ka akoma shumë të meta dhe dobësi në çështje të drejtimit dhe të kërkimit të llogarisë.

Megjithëse në Byronë Politike metoda e punës është përmirësuar, përsëri ndjekja e zbatimit të vendimeve të marrura bëhet shumë e dobët. Problemet që merren për t'u studjuar dhe për t'u vendosur përgatiten dobët, nuk paraqiten me kohë dhe nga shkëlja e afateve u lihet shokëve pak kohë për t'i studjuar rrënjësisht çështjet. Shumë probleme kthehen përsëri, sepse drejtoritë e aparatit të Komitetit Qendror akoma nuk e kanë gjetur metodën e shëndoshë të punës dhe në to ndihet mjaft nevoja për kuadër të ngritur e me eksperiencë për të studjuar thellë problemet e mëdha që i paraqiten Byrosë. Çështja e kuadrit të ngritur, me eksperiencë, është një pikë shumë e dobët për drejtoritë e aparatit të Komitetit Qendror. Është e drejtë të thuhet që shokët tanë që punojnë në aparate janë nga shokët më të mirë, kanë fituar shumë eksperiencë nga praktika, janë vigjilentë të diktojnë si duhet gabimet në vijën e Partisë, të marrin masa, të instruktojnë shokët për çështje praktike të punës, por kur vjen çështja të studiojnë dhe të japin mendimin e tyre për problemet kyçe që duhet t'i paraqiten Byrosë atje pengohemi seriozisht. Shokët që punojnë në aparatet, që nga sekretarët, duhet njohur se bëjnë një punë të palodhshme, studiojnë, ndjekin shkollat dhe shpejt do të vijë koha që në aparatit tonë të Komitetit Qendror do të kemi shokë që të kenë mbaruar shkollat e mesme, por shokë që të kenë kryer studime të larta ka jashtëzakonisht pak. Këta numërohen me gisht. Për të tillë kuadro, që të jenë njëkohësisht kuadro partie e specialistë kanë nevojë drejtoritë

e aparatit të Komitetit Qendror. Kjo është e domosdoshme, këtë gjë e kemi nënvleftësuar duke shkuar nga parimi për të mos ua marrë sektorëve të tjerë të pushtetit. Një situatë e tillë jo vetëm që sjell një dobësim në gjithë punën e udhëheqjes në qendër, por shkakton që të ulet edhe autoriteti i Komitetit Qendror në bazë, pse instruktorët ose drejtorët nuk janë në lartësinë e duhur për të kontrolluar, për të drejtuar dhe për të ndihmuar si duhet bazën në problemet e vështira që duhet të zgjidhë dhe ku tash ne kemi edhe drejtues të mësuar me universitete e me institute të larta. Në më të shumtat e herës shokët e qendrës, që punojnë në aparatit e Komitetit Qendror gjenden në bisht të situatës dhe të çarmatosur përpara drejtuesve të ndërmarrjeve, përpara inxhinierëve, agronomëve si dhe specialistëve të tjerë. Këtë situatë duhet medoemos ta ndryshojmë.

Metoda e punës në Këshillin e Ministrave dhe në aparatit e tij dhe veçanërisht në Komisionin e Planit lë shumë për të dëshiruar dhe duhet që Komiteti Qendror dhe vetë qeveria të marrin një sërë masash për t'i zhdukur këto dobësi të theksuara. Çështja qëndron se Këshilli i Ministrave nuk është si duhet në krye të punës dhe të drejtimit, me gjithë përmirësimet që janë bërë në këtë drejtim. Pikësëpari nuk ndjehet si duhet dora dhe kontrolli i vërtetë i Këshillit të Ministrave, jo vetëm mbi dikasteret po edhe mbi aparatet e pushtetit në bazë, sidomos. Këshilli i Ministrave e ka organizuar punën në mënyrë që kërkon kolegjisht llogari nga cilido ministër për punën e dikasterit të tij, bën analiza mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore të realizimit të planit,

ka, në këto mbledhje, kritikë dhe autokritikë, merren dhe masa për të përmirësuar situatën, thirren herë pas here në raport ndërmarrje ekonomike, bëhen studime të ndryshme të problemeve, por megjithatë ka akoma shumë dobësi. Dobësitë konsistojnë kryesisht në këto çështje: Vetë aparati i Kryeministrisë është mjaft i dobët dhe nuk është në gjendje t'i përgatitë si duhet punimet Këshillit të Ministrave dhe të ndjekë operativisht dhe me autoritet zbatimin e vendimeve të qeverisë. Aparati i Kryeministrisë shërben gati për punët e kancelarisë, që është një punë burokratike e saj. Sektorët në Kryeministri janë në bisht të situatës për mungesë kuadrosh të kualifikuar dhe me autoritet. Këtë situatë duhet ta ndreqim duke sjellë kuadro specialistësh në këta sektorë.

Çështja tjetër është se Këshilli i Ministrave ka një punë jashtëzakonisht të rënduar për arsye se megjithëse janë caktuar kompetencat e tija dhe të çdo dikasteri, megjithëse caktohen afate për paraqitjen e problemeve që duhet të studjohë dhe të vendosë qeveria, këto më të shumtat e herës, shkelen nga dikasteret. Jo vetëm që shkelen afatet, jo vetëm që s'ruhen kompetencat nga ministrat, disa prej të cilëve kanë tendencë që çështjet që janë në kompetencat e tyre, preferojnë t'ja kalojnë qeverisë, por e keqja më e madhe është se punimet që i paraqiten Këshillit të Ministrave nga ministritë dhe nga Komisioni i Planit, janë të papërgatitura mirë, me plot të meta serioze. Kjo është arsyeja kryesore që punët në Këshillin e Ministrave nuk shkojnë si duhet përpara. Ai humbet një kohë të madhe në diskutime të pafund, për arsye të munge-

sës së kohës dhe se problemet nuk janë të studjuara. Natyrisht, kjo gjë sjell që këto probleme shumë herë të mos parashikohen drejt, të mos jenë të koordinuara me të gjithë sektorët, të mos dalin të pajisura me masa dhe me vendime konkrete, detyrat nuk përcaktohen drejt dhe zbatimi në jetë vështirësohet. Ministritë kanë faje të rënda në këtë drejtim. Këto i përmenda edhe më lart, por njëkohësisht Komisioni i Planit të Shtetit nuk është si duhet në krye të detyrës dhe s'është bërë akoma një nga organet kryesore, në mos më kryesori i Këshillit të Ministrave në çështjet ekonomike të vendit. Puna në Komisionin e Planit paraqitet me shumë dobësi. Komisioni i Planit nuk e ka ndihmuar dhe vazhdon të mos e ndihmojë si duhet qeverinë dhe Byronë Politike në zgjidhjen e një tok problemesh shumë të rëndësishme ekonomike dhe shtetërore. Shumë rrallë i janë paraqitur qeverisë dhe Byrosë Politike studime ekonomike të thelluara nga Komisioni i Planit; ai nuk nxjerr si duhet konkluzione nga puna e tij e përditshme dhe t'i sugjerojë udhëheqjes masa konkrete për çdo problem dhe jo vetëm masa të çastit dhe të shpejtuara. Komisioni i Planit nuk di të shfrytëzojë si duhet të dhënat që ka në duar, po mendon se puna e tij konsiston vetëm të ndjekë me anë statistikash kryesisht realizimin e planit të shtetit dhe t'i komunikojë rezultatet qeverisë. Arësytimet, që në çdo kohë i jep Komisioni i Planit qeverisë për mosrealizimin e planeve, janë sempliste. Ato janë të drejta dhe të vërteta, por si ta zhdukim burimin kryesor të këtyre të metave, pikërisht këtu nuk hyn thellë Komisioni i Planit dhe ka tendenca të mos hyjë. Kjo është një e metë serioze;

detyrat e Komisionit të Planit duhet të jenë ngushtësisht të lidhura me detyrat që i dalin vendit përpara, dhe i gjithë aktiviteti i tij duhet të lidhet me forcimin e ekonomisë dhe të shtetit dhe t'u nënshtrohet këtyre problemeve kapitale. Është për këtë arsye që Komisioni i Planit nuk duhet që të futet në gjërat e vogla dhe të lërë të mëdhatë. Komisioni i Planit nuk duhet vetëm të studjojë këto çështje që ka tash përpara, por të parashikojë dhe zhvillimin në perspektivë. Nga ana tjetër Komisioni i Planit bën kryesisht një punë zyre dhe burokratike, që s'është e rekomandueshme sipas mendimit tonë. Nën pretekstin se janë shumë të ngarkuar me punë, njerëzit e Komisionit të Planit pak shkojnë në bazë, të shohin konkretisht si realizohet plani dhe të vërtetojnë në realitet sa të drejta janë shifrat e planit, sa të sakta janë statistikat që ata marrin dhe ku bazohen, të ç'natyre janë vështirësitë që hasen në rrugë, sa të drejta dhe të bazuara janë kërkesat e bazës dhe të ministrive dhe shumë gjëra të tjera që ne mendojmë se janë një nga detyrat kryesore të planit. Komisioni i Planit jo vetëm që para përgatitjes dhe paraqitjes së planit qeverisë duhet të ketë vërtetuar mirë llogaritë që ai bën, por pasi hartohet dhe pranohet plani nga qeveria fillon për planin një punë jashtëzakonisht e madhe, ndihma dhe kontrolli i zbatimit të këtyre detyrave. Këto funksione të rëndësishme Komisioni i Planit nuk i kryen si duhet. Si çdo dikaster tjetër edhe Komisioni i Planit ka organet e veta të planifikimit në qark dhe në rreth. Dikasteret e tjera, natyrisht, me të meta, përmbështeten fuqimisht në to, i udhëzojnë, i mësojnë, i kontrollojnë. Komisioni i Planit këtë gjë e ka nënvlehtë-

suar dhe tash nuk e bën si duhet. Komisioni i Planit duhet të ketë kurdoherë parasysh se pa i ndihmuar e pa i kontrolluar këto seksione të planifikimit në bazë, ne nuk do të kemi kurrësi plane shtetërore reale. Këtej rrjedh që propozimet e bazës, në drejtimin e ekonomisë nuk merren parasysh si duhet dhe planet vendosen qesisim nga lart, qoftë nga Komisioni i Planit, qoftë nga dikasteret dhe i paraqiten qeverisë më të shumtat e herës të pabazuara. Komisioni i Planit në zgjidhjen e problemeve të mëdha shtetërore dhe në përgatitjen e tyre nuk punon me komisione ekspertësh dhe specialistësh të ndryshëm të Republikës, nuk është përpjekur të përfitojë sa duhet nga dituria dhe eksperiencia e madhe e tyre, por është mjaftuar me njerëzit e tij dhe me ç'i ka dhënë ministria si material dhe si ekspert. Na duket se Komisioni i Planit nuk ka vetëm për detyrë të ngjitë njërën pas tjetrës projektet e qeverisë dhe të koordinojë matematikisht shifrat, por ka për detyrë të veçantë të thellojë shumë çdo gjë dhe t'i dalë qeverisë me mendimin e vet dhe me propozimet e veta, të argumentuara dhe të studjuara mirë. Këtë Komisioni i Planit nuk e bën sa duhet. Duhet gjithashtu të merren masa për të forcuar Komisionin e Planit edhe me disa kuadro të tjerë specialistë, por të mos harrohet nga Komisioni i Planit detyra që të përdorë një shumicë kuadrosh nga sektorët e tjerë për ta ndihmuar në studimin e veçantë të problemeve, për të cilat ne vuajmë shumë. Zhdukja e këtyre gabimeve dhe të metave serioze nga Komisioni i Planit do të jetë një ndihmë e jashtzakonshme për udhëheqjen dhe për ministrinë për të përmirësuar çështjen e drejtimit të ekonomisë.

Një çështje tjetër që shkakton dobësi në udhëheqjen shtetërore është mungesa e nënkryeministrave të lirë në drejtimin e sektorëve ekonomikë, si edhe çështja e disa ministrive që janë shumë të rënduara. Në realitet, Kryeministri nuk është në gjendje të drejtojë vetë të gjithë sektorët ekonomikë, të koordinojë të gjitha punët e shtetit, të kontrollojë me anë të aparatit të Kryeministrisë zbatimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave dhe sidomos në një kohë kur Kryeministri interesohet edhe për anën e Partisë, të aparatit të Komitetit Qendror, të Sekretariatit, të Byrosë etj. Prandaj propozojmë që Komiteti Qendror të ngarkojë Byronë Politike dhe qeverinë të studjojnë çështjen për të përmirësuar punën e aparatit shtetëror, për ta bërë drejtimin më operativ nga Këshilli i Ministrave dhe për të përmirësuar punën e ministrive në të, të mendojnë thellë mbi mundësitë për të marrë disa masa organizative në këtë drejtim.

Ne mendojmë se me këto ndryshime organizative dhe me ndreqjen e gabimeve që përmendëm më lart do ta përmirësojmë shumë çështjen e drejtimit të ekonomisë dhe të shtetit. Përveç sa thamë më lart, ne i theksojmë Komitetit Qendror që megjithëse punët në Ministrinë e Financave kanë gjetur një rrugë më të mirë dhe atje ka përparime të dukshme, duhet që Ministria e Financave të bëjë njëkohësisht përpjekje të mëdha për t'i nxjerrë udhëheqjes studime më shumë dhe ta ndihmojë kështu këtë, pse Ministria e Financave, si një ministri kontrolli me rëndësi, ka të dhënat e duhura për ta bërë këtë punë të nevojshme dhe të çmueshme për udhëheqjen. Një e metë serioze në punën tonë financiare është se anën financiare të të gjitha çështjeve, leverdisshmë-

rinë e tyre ekonomike nuk e shohim si duhet dhe llogaritë vazhdimisht nuk na dalin në kut. Edhe kur bëhet kjo gjë, bëhet e çalë. Kësaj i shtohet një pakujdesi e çuditshme dhe shumë herë kriminale në drejtimin e kontrollit financiar të zbatimit. Çdo dikaster mendon në radhë të parë objektin dhe anën financiare e le krejtësisht pasdore ose e nënvleftëson aq shumë, sa s'bëhet merak, por pa gjë të keqe kërkon shtesa fondi, të cilat shumë herë s'kanë nga dalin ose nxirren duke lënë pa bërë objekte të tjera po aq të nevojshme.

TË FORCOHET MË SHUMË PUNA POLITIKE DHE ORGANIZATIVE E PARTISË PËR ÇËSHTJET EKONOMIKE

Me riorganizimin e ri të Partisë udhëheqja ju afrua më tepër bazës dhe një gjë e tillë qysh tani ka dhënë rezultatet e para. Por duhet pranuar se baza nuk e ka ndier sa duhet këtë afrim të udhëheqjes, sepse pak është ndihmuar konkretisht. Kjo është një nga arësyet më të forta që puna organizative dhe politike e Partisë nuk i përgjigjet si duhet zgjidhjes me kohë dhe me sukses të detyrave ekonomike që na dalin sot përpara.

Në metodën e drejtimit të komiteteve të Partisë të qarqeve vërtetohen të meta të mëdha. Byrotë e komiteteve të Partisë të qarqeve e kanë përqëndruar punën e tyre më tepër në marrjen e vendimeve, në mbledhje mbi mbledhje duke u angazhuar kështu në një punë burokratike dhe duke lënë mënjanë punën e gjallë për të ndihmuar bazën. Organizimi i kontrollit të zbatimit të vendimeve është jashtëzakonisht i dobët. Pregatitjes së

vendimeve nuk u jepet rëndësia e duhur dhe konsiderohet si një gjë e dorës së dytë, merren vendime të përgjithshme, pa detyra konkrete dhe një gjë e tillë e vështirëson shumë zbatimin e kontrollit të tyre. Por e keqja më e madhe qëndron në faktin se edhe mbasi është marrë një vendim qoftë edhe me detyra konkrete, kujtohet se puna e udhëheqjes mbaron me kaq, kurse me udhëheqë do të thotë, në radhë të parë, të kontrollosh zbatimin e vendimeve të marrura.

Në drejtimin e ekonomisë ka gabime të rëndësishme: shkëputja e punës politike dhe organizative të Partisë nga puna ekonomike, problemet ekonomike shpeshherë shqyrtohen thjesht nga ana shtetërore dhe ka tendenca për t'i zëvendësuar organet e pushtetit dhe ato ekonomike. Komitetet e Partisë në vend që t'u sigurojnë këtyre një ndihmë konkrete dhe sistematike, t'i forcojnë me kuadro të aftë dhe t'i bëjnë që t'i kryejnë me sukses detyrat që u janë ngarkuar, shpeshherë i zëvendësojnë. Shfaqje të tilla në mënyrë më të theksuar janë vërtetuar në Gjirokastrë e Korçë dhe më pak në Shkodër. Komitetet e Partisë mbajnë përgjegjësi për ekonominë. Partia e gjykon punën e kësaj ose asaj organizate të Partisë në bazë të rezultateve reale që janë arritur në lëmin e ekonomisë, të kulturës dhe të përmirësimit të vazhdueshëm të jetesës së masave punonjëse. Organizatat e Partisë kanë mundësi që të ushtrojnë kontrollin e duhur mbi zhvillimin e ndërtimit ekonomik, mbi veprimtarinë e organeve të pushtetit dhe atyre ekonomike pa i zëvendësuar. Kjo është rruga e drejtë dhe e sprovuar.

Udhëheqja kolegjiale në byrotë e komiteteve të Partisë të qarqeve nuk ka qenë në lartësinë e duhur. Jo të

gjithë anëtarët e byrove kanë marrë pjesë gjallërisht në studimin, shqyrtimin dhe ndjekjen e problemeve. Kujdes i veçantë duhet të tregohet tani që u zgjodhën plenumet e komiteteve të Partisë, të cilat duhet të marrin plotësisht në dorë drejtimin e tërë jetës së qarkut si organe kolektive të Partisë më të larta në qark. Jo normale paraqitet edhe mbështetja e punës së Partisë në aktivin e Partisë dhe në aktivin pa parti. Komitetet e Partisë duhet të kenë parasysh orë e çast këtë problem dhe ta vënë në rrugë të drejtë, ndryshe nuk mund të sigurohet zbatimi me sukses i vijës së Partisë në problemet politike dhe ekonomike në ndërtimin socialist të vendit.

Këto të meta që janë vërtetuar në punën e drejtimin nga ana e komiteteve të Partisë të qarqeve kanë pasur refleksat e tyre negative edhe në punën e komiteteve të Partisë të rretheve dhe të organizatave bazë. Mjaft komitete partie në rrethe nuk e kanë marrë akoma në dorë si duhet drejtimin e punës së Partisë. Ka prerje të inisiativës së rretheve, por sidomos të organizatave bazë, të cilat janë inonduar me vendime nga lart. Ka raste akoma të kapërcimit të rrethit nga qarku. Nuk është punuar për të rritur inisiativën e organizatave bazë, përkundrazi dërgimi i shumë vendimeve dhe i të deleguarve ka pasur si rrjedhim mbytjen e inisiativës dhe të vetëveprimit të tyre. Detyra jonë është të bëjmë që çdo organizatë bazë e Partisë të ecë me këmbët e veta, të ketë inisiativë dhe të bëhet zot i sektorit ku punon.

Zhvillimi i mbledhjeve për dhënje llogari dhe zgjedhje ka shënuar një hap të rëndësishëm përpara në forcimin e organizatave të Partisë. Prgatitja dhe zhvillimi

i tyre është bërë në një nivel më të lartë se në të kaluarën, por u vërtetuan edhe disa të meta të rëndësishme si mungesa të paarësyeshme që tregojnë dobësi në disiplinën e Partisë, ngurrime në autokritikë dhe fshehje të të metave nga disa organe drejtuese të Partisë, gjithashtu delegatët e zgjedhur nga baza akoma nuk e ndjejnë si duhet përgjegjësinë që kanë.

Ne sot kemi nevojë për një udhëheqje partie të kualifikuar, konkrete dhe operative, e aftë që të sigurojë zbatimin e përpiktë dhe në kohën e duhur të vendimeve të marrura nga Partia. Prandaj na del detyrë urgjente që të zhdukim metodat e përcipta burokratike, formaliste që ekzistojnë në punën tonë, sepse vetëm kështu mund të ngrihet niveli i udhëheqjes së Partisë. Tani që lufta për realizimin e vendimeve të Plenumit të Dhjetorit të vitit 1953 të Komitetit Qendror të PPSH për përmirësimin e mëtejshëm të mirëqenjes së masave punonjëse është në valën e saj, është veçanërisht e nevojshme që të gjitha organet e Partisë, nga lart-poshtë, të perfeksionojnë vazhdimisht format dhe metodat e udhëheqjes së tyre, të shkojnë në çdo rreth, fshat, kooperativë, SMT, fermë, minierë dhe ndërmarrje industriale, të shqyrtojnë mirë nevojat dhe kërkesat e tyre duke u dhënë një ndihmë reale dhe efikase në rregullimin e gjithë punës.

Gjithashtu një detyrë me rëndësi e dorës së parë është zgjidhja e drejtë e problemit të kuadrit dhe e edukimit të tij. Me riorganizimin e organeve të Partisë crdhën mjaft shokë të rinj dhe pa eksperiencë në punët e Partisë, por edukimi i tyre si dhe i sekretarëve të organizatave bazë ka shkuar mjaft dobët. Komitetet e Par-

tisë në qarqe nuk e kanë pasur në qendrën e vëmendjes së tyre edukimin e kuadrit. Shumë u kërkohej kuadrove që të japin në vendet që ata kanë zënë, por pak mendohet për t'i ndihmuar dhe edukuar. Është e nevojshme që të forcohen aparatet e Partisë në rrethe e në qarqe dhe veçanërisht aparati i Komitetit Qendror me kuadro me një nivel të lartë ideo-politik dhe profesional.

Shpërndarja e drejtë e forcave të Partisë është një kusht i domosdoshëm për realizimin e vijës politike të Partisë. Por organizatat e Partisë nuk e drejtojnë si duhet këtë problem. Nga nënvleftësimi që u bëhet çështjeve të administrimit në Parti nga komitetet e Partisë, nuk bëhen studime të thella për të drejtuar dhe për të forcuar Partinë në çdo sektor pune, mungon studimi i thellë i evidencës së forcës së Partisë dhe kujdesi për një shpërndarje sa më të drejtë të tyre. Sot që Partia i jep veçanërisht një rëndësi të madhe forcimit të disa sektorëve të ekonomisë, ky problem bëhet edhe më preokupant.

Në terren, më 1 janar 1954, kemi pasur 64,2 për qind të efektivit të Partisë (me përjashtim të komunistëve që punojnë në organet e Sigurimit të Shtetit, të policisë, në shkollat jashtë shtetit dhe në aparatet e Komitetit Qendror). Këto forca ndahen në këtë mënyrë: Në sektorët ekonomikë (miniera, industri, transport, ndërtim, tregëti, kooperativa artizanati) 28,5 për qind; në sektorët socialistë të bujqësisë (ferma, SMT, kooperativa bujqësore) 9,4 për qind; në sektorin privat të bujqësisë 36 për qind; në sektorët administrativë 26 për qind. Në krahasim me 1 janarin 1953 forcat e Partisë janë rritur në sektorët ekonomikë 2,4 për qind, në sektorët

socialistë të bujqësisë — 3,4 për qind, në sektorin privat të bujqësisë — 0,3 për qind dhe në sektorët administrativë ka një ulje prej 6,3 për qind. Por Partia ka akoma shumë forca në sektorët administrativë duke marrë parasysh edhe faktin se 1 675 komunistë janë nëpunës të thjeshtë.

Në sektorët ekonomikë përgjithësisht (me përjashtim të sektorit kooperativist dhe atij privat në fshat), këtë vit kemi 8,2 për qind komunistë në krahasim me numrin e punëtorëve, ndërsa vitin e kaluar kishim 7,8 për qind, kurse në administratën e këtyre sektorëve kemi 34,1 për qind komunistë në krahasim me numrin e nëpunësve, ndërsa vitin e kaluar kishim 29,6 për qind. Po të marrim sektorët ekonomikë veç e veç, në krahasim me vitin e kaluar rezulton: numri i komunistëve në prodhim në krahasim me punëtorët është rritur në transport 2,1 për qind, në ndërtim 1,5 për qind, në kooperativat e artizanatit 1,5 për qind, sepse në këta sektorë është ulur mjaft edhe numri i punëtorëve; në ferma është rritur si numri i punëtorëve por edhe i komunistëve në 1,4 për qind; ndërsa në miniera, industri, tregëti dhe SMT, ku është rritur mjaft numri i punëtorëve, numri i komunistëve është ulur në krahasim me vitin e kaluar: në miniera 1,1 për qind, në industri 3,2 për qind, në tregëti 0,3 për qind, në SMT 3,2 për qind. Kurse numri i komunistëve në administratë, në krahasim me nëpunësit, është rritur mjaft në këta sektorë me përjashtim të fermave. P.sh. në miniera 49,2 për qind të nëpunësve janë komunistë, në industri — 43,2 për qind, në SMT-të — 38,1 për qind. Pra edhe brenda çdo sektori ekonomik forcat e Partisë nuk janë shpërndarë edhe aq drejt. Për t'u përmendur është se në sektorët e rëndësi-

shëm si në miniera, industri dhe SMT forcat komuniste në prodhim janë më të pakta në krahasim me numrin e punëtorëve, kurse në administratën e tyre ndodh e kundërta.

Edhe vendet që zënë komunistët në prodhim nuk studjohen nga organizatat e Partisë. Faktet tregojnë se në të tilla raste vende të rëndësishme në prodhim si mjeshtrë, traktoristë etj. nuk zotërohen si duhet nga komunistët. Edukimi për ngritjen teknike të komunistëve ecën ngadalë. Është e nevojshme që organizatat e Partisë të luftojnë vazhdimisht për një shpërndarje të drejtë të forcave komuniste pa u nxituar duke pasur parasysh gjendjen politike dhe ekonomike të rrethit, të qendrës së punës dhe të fshatit si dhe të posteve me rëndësi në prodhim.

Gjithashtu duhet t'i kushtohet më tepër kujdes edukimit profesional të komunistëve dhe forcimit të disiplinës së Partisë, sepse kur e lypin interesat e punës, një komunist duhet të shkojë në atë sektor që Partia do ta forcojë, detyra e anëtarit të Partisë është të zbatojë vullnetin e Partisë.

III

MBI ZHVILLIMIN E DEGËVE KRYESORE TË EKONOMISË PËR PERIUDHËN 1954-1957

Më poshtë ne po ju parashtrojmë pikërisht studimet e një sërë çështjesh ekonomike të sektorëve më të rëndësishëm të ekonomisë sonë, ku pasqyrohen detyrat dhe përpjekjet që ne do të bëjmë për të realizuar me sukses.

planin tonë ekonomik të pesëvjeçarit të parë dhe atë perspektiv si edhe ndihmat që ne duhet të kërkojmë nga Bashkimi Sovjetik. Komiteti Qendror të arësyetojë, të gjykojë dhe të vendosë për këto probleme nga më të rëndësishmet të Partisë dhe të shtetit tonë.

INDUSTRIA

Minierat. Zhvillimi i mëtejshëm i prodhimit të industrisë minerare për vendin tonë ka një rëndësi të madhe në sigurimin e zhvillimit të vazhdueshëm të të gjithë industrisë si dhe të sektorëve të tjerë ekonomikë. Prodhimet minerale zënë vendin më të rëndësishëm në vëllimin e eksportimeve tona dhe bëjnë të mundshme në këtë mënyrë sigurimin e një pjese të mirë të nevojave të ekonomisë sonë me maqinери dhe mjete të tjera prodhimi nga importi. Përveç kësaj, industria, transporti dhe ndërtimet kërkojnë lëndë djegëse të mjaftueshme nga minierat për të siguruar zhvillimin e tyre të mëtejshëm. Prandaj në lidhje me zhvillimin e industrisë minerare, në katër vitet e ardhshme 1954-1957 janë pasur parasysh, në radhë të parë, nevojat e rritjes së vëllimit të eksportimeve tona me prodhime minerale të tilla si krom, bitum dhe naftë, sigurimin e nevojave të industrisë, të transporteve dhe të ndërtimeve në qymyrguri si dhe plotësimin në një masë më të madhe në krahasim me të kaluarën të karburanteve nga vendi.

Industria e naftës. Gjatë viteve të fundit 1951-1953 plani i prodhimit të naftës brut nuk është realizuar.

Mosrealizimi i detyrave të planit në industrinë e naftës ka shkaktuar vështirësi të mëdha lidhur me mbajtjen e angazhimeve që ka pasur vendi ynë me shtetet miq, ka bërë që kostoja të ngrihet dhe prodhimi i naftës të jetë më pak rentabël. Deficiti i prodhimit të naftës nga viti 1951 deri në vitin 1953, në krahasim me parashikimet e planit pesëvjeçar arrin në 43 000 ton. Mungesa e një organizimi më të mirë të punës, çrregullimet dhe konfuzioni që kanë ekzistuar në kombinatin e naftës, së bashku me vëllimin e pamjaftueshëm të shpim-shfrytëzimeve, mungesa e traktorëve dhe e pjesëve të këmbimit për ta, në përgjithësi janë faktorët kryesorë të mosrealizimit të planit në këtë sektor. Gjithashtu ritmi i ngadalshëm i punimeve të kërkimeve ka bërë që akoma sot të mos njihen shtrirja e fushës ekzistuese naftëmbajtëse të Qytetit «Stalin» dhe Patos si edhe rezervat e përgjithshme në naftë të këtyre zonave. .

Duke u bazuar në rezervat industriale të njohura, zhvillimi i industrisë së naftës në katër vitet e ardhshme parashikohet të jetë si vijon (në mijë ton):

	Realiz.				
	1953	1954	1955	1956	1957
Prodhim gjithsejt	149,5	175	190	210	230

Parashikohet që në vitin 1957 veç distilerve ekzistuese në Qytetin «Stalin», të vihet në shfrytëzim edhe Uzina e përpunimit të naftës në Cërrik, duke trajtuar në këtë vit 100 000 ton naftë ose 2/3 e kapacitetit të saj të plotë. Me gjithë vënjen në shfrytëzim të Uzinës së

përpunimit të naftës në Cërrik edhe duke e shfrytëzuar atë me kapacitet të plotë në vitin 1959, nuk do të arrihet të plotësohen nevojat e vendit me karburante. Kjo ndodh për shkak se nafta jonë është me përmbajtje të pakta në karburante. Në të ardhshmen do të jetë i mundshëm plotësimi i nevojave tona me gjetjen e zonave të reja vajguore me përmbajtje më të madhe karburantesh. Përveç nevojave të brendshme në naftë brut, na teprojnë për të eksportuar nga industria e naftës prodhime me një vleftë prej 11 milion rublash në vitin 1954, — 11,2 milion rubla në vitin 1955, — 12 milion rubla në vitin 1956 dhe 13,3 milion rubla në vitin 1957.

Për të siguruar zhvillimin e industrisë së naftës në nivelin e përmendur më lart, për njohjen e rezervave industriale në fushat ekzistuese të Qytetit «Stalin» dhe Patos si dhe për gjetjen e zonave të reja vajguore si në Frakull, Ardenicë, Pekisht, etj. është i nevojshëm të kryhet një vëllim i konsiderueshëm shpimesh dhe shfrytëzimi si më poshtë:

(në mijë metra linear)

	1953	1954	1955	1956	1957
Shpim-kërkim	9,9	20	34	30	25
Shpim-shfrytëzim	37,6	32,5	41,4	55	55

Zhvillimi i fushave të reja vajguore me prodhimtari më të lartë dhe me përmbajtje më të madhe karburantesh ka një rëndësi të madhe për ekonominë tonë, sepse do ta bëjë më të leverdisshëm prodhimin e naftës

dhe do të bëjë të mundur plotësimin e nevojave të vendit me karburante.

Realizimi i detyrave për zhvillimin e mëtejshëm të industrisë së naftës kërkon përmirësimin e organizimit të punës për shfrytëzimin e të gjitha rezervave të brendshme që ekzistojnë në këtë industri. Duhet të shfrytëzohet më mirë maqinaria, të forcohet baza mekanike për të përballuar mirëmbajtjen dhe revizionimin e maqinerve të shumta të naftës si sondat, traktorët etj., të caktohet regjimi i prodhimit të çdo pusi dhe të zbatohet ky me përpikmëri, të kryhen sipas grafikëve të përcaktuar të gjitha shërbimet e nevojshme për çdo pus, në mënyrë që të japin sa më shumë prodhime nafte si dhe të forcohet disiplina dhe kontrolli i zbatimit të detyrave.

Por që të realizohen detyrat që parashikohen për industrinë e naftës, për periudhën 1954-1957 është e nevojshme të importojmë maqineri dhe materiale të nevojshme si tuba, traktorë, asta, sonda, motorë sondash, pjesë këmbimi etj., me një vlef të kompleksive prej 54 milion rublash. Ekonomia jonë nuk është në gjendje të përballojë këto shpenzime, prandaj është e nevojshme kërkimi i një kredie të posaçme për naftën nga qeveria e Bashkimit Sovjetik prej 45 milion rublash për periudhën 1954-1956.

Prodhimet e tjera minerale. Sikurse përmendëm më lart, në asnjë nga prodhimet minerale nuk është realizuar prodhimi kompleksiv për të tre vjetët e kaluar.

Mosrealizimi i planit në krom, bitum natyral dhe bakër blister ka bërë që qeveria jonë të mos plotësojë angazhimet e marrura ndaj shteteve miq, ndërsa mos-

realizimi i planit në qymyrguri ka krijuar vështirësi të mëdha dhe të pakapërcyeshme në prodhimin e materialit të ndërtimit, efekti negativ i të cilave është ndier shumë gjatë viteve 1951-1953 si dhe këtë vit në punën e ndërtimeve.

Mosnjohja e rezervave industriale dhe marrja në studim me vonesë për zgjidhjen e këtij problemi të madh, nënvleftësimi i bërë punimeve të kërkimeve, si nga ndërmarrjet ashtu edhe nga organet qendrore, mungesa e fuqisë punëtore si edhe fluktuacioni i madh në miniera, shkaktuar për interesim të pamjaftueshëm lidhur me trajtimin dhe stabilizimin e fuqisë punëtore si dhe mungesa të tjera organizativo-teknike, janë shkaqet kryesore, të cilat kanë bërë që plani në prodhimet minerale të mos realizohet.

Rritja e prodhimeve minerale në katër vitet e ardhshme 1954-1957, parashikohet të jetë si vijon (në mijë ton):

	Realiz.				
	1953	1954	1955	1956	1957
Minerale kromi	47,4	100	130	150	175
Bitum natyral	37	45	50	55	60
Nga kjo					
i pastruar	25,3	29	32	35	38
Qymyrguri					
në mijë m ³	108	170	225	225	265

Prodhimet e mësipërme bazohen në rezervat indus-

triale dhe gjeologjike të njohura deri sot në këtë mënyrë: prodhimi i qymyrgurit është mbështetur në rezerva industriale të mjaftueshme për një periudhë tej vitit 1957; rezervat industriale të kromit sigurojnë prodhimin vetëm për periudhën 1954-1957; bitumi natyral nuk është bazuar në rezerva industriale, por në rezerva gjeologjike, të cilat nuk janë baza për planifikimin e prodhimit. Ndërsa për vitet 1955-1957 nuk është paraparë prodhimi i mineralit bakër dhe bakër blister, për shkak se për këtë mineral nuk ka asnjë të dhënë mbi gjendjen e rezervave qoftë edhe gjeologjike. Mendohet se me punimet e kërkimit që do të bëhen gjatë vitit 1954 në Rubik mund të gjenden 48 000 ton rezerva minerale të bakrit të kategorisë C₂. Duke u bazuar në këto të dhëna, në planin e vitit 1954 është parashikuar prodhimi i 18 000 ton mineral bakri dhe 500 ton bakër blister.

Nga sa u përmend më sipër del se në minierat tona gjendja e sotme e rezervave industriale është e pamjaftueshme dhe nuk i përgjigjet ritmeve të prodhimit të caktuar për periudhën 1954-1957 me përjashtim të qymyrit dhe të kromit. Por mosnjohja e rezervave industriale jo vetëm që i bën të paqarta perspektivat e minierave tona, por edhe dëmton rëndë ekonominë tonë, sepse për të bërë të mundshme realizimin e ritmeve të parashikuara për vitet 1954-1957 detyrohemi të investojmë shuma të mëdha për ndërtime industriale, ndërtesa banimi etj., pa ditur jetën e minierave. Del e qartë, pra, se detyra kryesore dhe urgjente në minierat është intensifikimi dhe kujdesi i pandërprerë që duhet t'i jepet punës së kërkimeve, në mënyrë që brenda vitit 1954 dhe 1955 të sqarohet gjendja e rezervave

industriale në qendrat ekzistuese të minierave si në Bulqizë, Selenicë, Rubik, Derven etj. Po kështu është e domosdoshme që deri në vitin 1955 të bëhen studime gjeologjike për zbulimin e zonave të reja për krom.

Përveç problemit të njohjes së rezervave industriale për realizimin e planit të prodhimit në miniera është e nevojshme të kryhen punime përgatitore dhe kërkime për përgatitjen e fronteve të shfrytëzimit si edhe për ngritjen e rezervave gjeologjike në rezerva industriale.

Sigurimi i fuqisë punëtore është një tjetër problem i rëndësishëm që kondicionon realizimin e planit të minierave. Lidhur me këtë, gjatë viteve 1954-1957 duhet të merren masa për të krijuar kondita të mira jetese për punëtorët e minierave duke ndërtuar 25 000 m² banesa në minierat e qymyrgurit, 7 000 m² banesa në Bulqizë dhe 6 000 m² në Selenicë si edhe duke ndërtuar objekte të tjera si klube, mensa e dyqane për të siguruar furnizim të mjaftueshëm dhe të pandërprerë me artikuj ushqimorë dhe veshmbathje në mënyrë që të krijohen mundësitë e stabilizimit të fuqisë punëtore.

Marrja e masave që u përmendën më sipër, si dhe masat e tjera që duhet të merren për organizimin e mirë të punës dhe për shfrytëzimin racional të maqinerisë do të sigurojnë realizimin e prodhimit të minierave si edhe njohjen e perspektivës së mëtejshme të tyre lidhur me përcaktimin e rezervave industriale.

Industria e lehtë (nacionale dhe lokale), artizanati dhe kooperativat e konsumit. Prodhimi i industrisë së lehtë, i kooperativave të artizanatit dhe të konsumit si vëllim global për të tre vjetët, 1951-1953 (së bashku)

është realizuar 105,7 për qind në krahasim me parashikimet e planit pesëvjeçar. Megjithkëtë, plani nuk është realizuar në disa artikuj industrialë të rëndësishëm, të cilët u përmendën më lart. Mosplotësimi i detyrave të caktuara në planin pesëvjeçar për periudhën 1951-1953 ka penguar furnizimin e rregullt të popullit me mallra industriale si edhe nuk ka lejuar krijimin e rezervave minimale të domosdoshme për heqjen e triskave në disa prodhime industriale.

Zhvillimi i industrisë së lehtë (nacionale dhe lokale) si dhe i artizanatit për periudhën 1954-1957 synon në radhë të parë në plotësimin më të mirë të nevojave të popullit me mallra të konsumit të gjerë si dhe në shtimin e eksportimeve tona në disa prodhime industriale.

Vëllimi global i prodhimeve industriale për sektorët e lartpërmendur parashikohet të arrijë në vitin 1955 në 100,7 për qind, krahasuar me pesëvjeçarin, ndërsa në vitin 1957 rritet 158,5 për qind në krahasim me vitin 1953 dhe për industrinë nacionale — 160,4 për qind, industrinë lokale — 157,5 për qind, artizanatin — 175 për qind dhe kooperativat e konsumit — 133,2 për qind. Për disa artikuj kryesorë, prodhimi rritet si vijon:

(në 1957 në krahasim me 1953 në %)

1) Sheqer	157,5
2) Peshk i njomë	200
3) Djathë	173,1
4) Gjalpë	169
5) Tekstile të pambukta	150,7
6) Këpucë e sandale	295,8

7) Çimento	431,8
8) Lëndë e sharruar	156
9) Mobilje e orendi	161,1
10) Plugje	882,4
11) Kultivatorë	406,2

Për sektorin e industrisë (nacionale dhe lokale) dhe të artizanatit dalin një sërë detyrash, zbatimi i të cilave siguron realizimin e planit sipas parashikimeve të bëra më sipër.

1. — Në radhë të parë duhet të sigurohet furnizimi i pandërprerë i industrisë me lëndë të parë, qofshin këto të vendit apo të importit. Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit duhet të përmirësojë punën për grumbullimin e prodhimeve bujqësore si pambuk, panxhar, ullinj dhe duhan. Ministria e Tregëtisë dhe e Komunikacionit duhet të marrë masa në mënyrë që të vijjnë në sasi dhe në kohën e duhur lënda e parë dhe pajisjet nga importi siç janë alumini, llamarina e zezë dhe e xinguar, yndyrnat për sapun, shollë, solet, kopertona automobili, fletë metalike dhe çelique për vegla bujqësore, motorë për barkat e peshkimit, rrjeta për peshkim, plumb dhe kallaj për poçeritë, pjesë këmbimi e kimikate për industrinë tekstile etj.

2. — Kombinati i tekstileve «Stalin» në vitin 1957 të shfrytëzohet në kapacitetin e plotë me tri turne, fabrika e tekstil-leshit me dy turne dhe ajo e filaturës së pambukut me 86 për qind të kapacitetit. Fabrika e taniut të shfrytëzohet me kapacitet të plotë në vitin 1957 dhe Fabrika e çimentos në Vlorë të shfrytëzohet me kapacitet të plotë në vitin 1956. Lidhur me këtë Ministria

e Industrisë dhe e Ndërtimit duhet të marrë masa të shpejta për përgatitjen dhe kualifikimin e kuadrove në mënyrë që këta të arrijnë dhe të përvetësojnë në një periudhë sa më të shkurtër teknikën e prodhimit.

3. — Të merren masa për stabilizimin e fuqisë punëtore në sharrat dhe, sidomos, në Kombinatin e tekstileve «Stalin». Për këtë qëllim brenda periudhës 1954-1957 vetëm për Kombinatin e tekstileve «Stalin» do të ndërtohen 32 000 m² ndërtesa banimi. Po kështu duhet të sigurohet furnizimi i pandërprerë dhe i plotë me artikuj ushqimorë dhe të veshmbathjes në qendrat e mëdha industriale dhe sidomos në sharrat.

4. — Me qëllim që të lehtësohet puna për prerjen dhe transportimin deri në rrugët automobilistike të trupave të nevojshëm për lëndë të sharruar, kompensato, rimeso, lëndë e imprenjuar etj. si dhe për të reduktuar nevojën në fuqi punëtore, Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit të marrë masa për mekanizimin dhe për organizimin më të mirë të punës për transportimin dhe prerjen e trupave. Gjithashtu Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit duhet të studjojë mënyrën e transportimit të trupave me anë të lumenjve sidomos në lumin Drin.

5. — Për realizimin e planit në degën e drurit të ndërtohet në vitin 1955 rruga e Bishnicës dhe të ngrihet fabrika e staxhionimit me kapacitet 6 000 m³ në vit. Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit të studjojë vendin e ngritjes së kësaj fabrike. Gjithashtu gjatë vitit 1956 dhe 1957 të ndërtohen rrugë të tjera pyjore.

6. — Për realizimin e planit në lëkurët e punuara, përveç sasive të lëkurëve të punuara të trasha, që do të sigurojë Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve,

është e nevojshme që të sigurohen nga jashtë edhe 125 ton lëkurë të trasha të papunuara për vitin 1955, — 160 ton për vitin 1956 dhe 200 ton për vitin 1957. Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit duhet të marrë masa urgjente dhe të studjojë mundësinë e zëvendësimit të sole-tës me materiale të tjera.

7. — Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit dhe Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit, në bashkëpunim me Institutin e shkencave të studjojnë zonat ku gjendet peshku për të bërë të mundshëm realizimin e planit të peshkut për vitet 1954-1957 sipas parashikimeve.

8. — Industria lokale dhe artizanati të shtrihen akoma më shumë, të shtojnë asortimentin e prodhimit dhe të shfrytëzojnë të gjitha mundësitë për mekanizimin e disa proceseve të punës. T'i kushtojnë vëmendje të posaçme shfrytëzimit në maksimum të lëndëve të para lokale si dhe të mbeturinave të industrisë. Prodhimi i industrisë lokale dhe i artizanatit të orientohet nga kërkesat e popullit në mënyrë që të kënaqin sa më shumë guston dhe nevojat e popullit.

Realizimi me sukses i detyrave të industrisë (nacionale dhe lokale) dhe të kooperativave të artizanatit dhe të konsumit kërkon gjithashtu marrjen e një sërë masash të tjera për organizimin më të mirë të punës, për shfrytëzimin në maksimum të rezervave të brendshme të tyre, për mirëmbajtjen dhe revizionimin e maqinerive sipas rregullave teknike dhe për shfrytëzimin më të mirë të maqinerisë. Gjithashtu punonjësve të industrisë (nacionale dhe lokale) dhe të kooperativave të artizanatit e të konsumit u dalin detyra të rëndësishme lidhur me masat

që duhet të marrin ata për përmirësimin e cilësisë, shtimin e asortimenteve të prodhimit dhe për uljen e mëtejshme të kostos.

B U J Q Ë S I A

Bujqësia në vendin tonë zë një vend me rëndësi në ekonominë popullore. Partia dhe qeveria sot, më tepër se kurrë, kanë ngritur me forcë zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë. Plenumi i Komitetit Qendror i Dhjetorit të vitit 1953 theksoi edhe një herë se detyra kryesore për çdo punonjës të Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë është zhvillimi i gjithanshëm i bujqësisë dhe i blegtorisë, sigurimi i bukës në vend, rritja e prodhimeve bujqësore e blegtorale për ushqimin e popullsisë dhe rritja e prodhimit të bimëve industriale për sigurimin e lëndës së parë për industrinë dhe për shtimin e eksportimeve.

Për ta ngritur sa më shpejt bujqësinë tonë çdo vit do të shtohen investimet. Në planin e vitit 1954 investimet për bujqësinë zënë një vend me rëndësi në investimet nacionale. Këtë vit do të shpenzohen për bujqësinë rreth 776 milion lekë, baras me 122,8 për qind në krahasim me realizimin e vitit 1953. Kryesisht këto fonde do të përdoren për bonifikime dhe ujitje, për shtimin e mekanizimit të bujqësisë, për të furnizuar fshatarësinë me farëra të zgjedhura, kredit agrar dhe me vegla të shumta bujqësore.

Shtimi i prodhimeve bujqësore e blegtorale do të bëhet kryesisht duke rritur rendimentet dhe në një masë të kufizuar nga zgjerimi i sipërfaqes së mbjellë si dhe

duke shtuar numrin e krerëve të bagëtisë. Por detyra kryesore për shtimin e prodhimeve bujqësore është rritja e rendimenteve të kulturave bujqësore dhe shtimi i prodhueshmërisë së gjësë së gjallë.

Për vitet 1954-1957 parashikohet të vihet nën kulturë një sipërfaqe prej 385 700 hektarësh, domethënë 116,6 për qind më tepër se në vitin 1950.

Shtesa prej 15 000 hektarësh e sipërfaqes së tokave të reja parashikuar për vitet 1955-1957 vjen 43 për qind nga bonifikimet, 37 për qind nga prishje pyjesh të pavlefshme dhe 20 për qind nga kullotat.

Tokat e reja që do të çelen, do t'i jepen kryesisht sektorit shtetëror të bujqësisë. Ky sektor do të ketë në fund të vitit 1957 rreth 10 500 hektarë më shumë se sot dhe arrijnë në 7.3 për qind të të gjitha tokave të Republikës që vihen nën kulturë.

Duke rritur rendimentet, sipërfaqja e drithërave të bukës në 1957 zbret 0,5 për qind në krahasim me atë të 1954-s, ndërsa sipërfaqja e bimëve industriale rritet 12,7 për qind, ajo e foragjereve — 41,4 për qind dhe e perimeve — 0,5 për qind.

Me gjithë rritjen që parashikohet për rendimentet, prodhimet e disa kulturave bujqësore gjatë 1954-1955 në krahasim me planin pesëvjeçar për këtë periudhë do të jenë më të ulëta respektivisht: 38,2 për qind dhe 33,2 për qind në pambuk, 15,5 për qind dhe 26,2 për qind në patate dhe 22,4 për qind e 32,4 për qind në jonxhë. Kjo ndodh *së pari*, sepse në projektin e ri është synuar të sigurojmë sa më shpejt bukën në vend dhe të shtojmë prodhimin e duhanit dhe të perimeve (në fakt drithërat e bukës rriten respektivisht; gruri 19,3 për qind dhe 18

për qind, thekra 23,6 për qind dhe 23,5 për qind, misri 2 për qind dhe 4 për qind, duhani 13,8 për qind dhe 11,4 për qind, kurse perimet 30,6 për qind dhe 20,4 për qind); së dyti, sepse sipërfaqja e pambukut ulet për shkak të tokave jo të përshtatshme dhe se në zonat e pambukut ekonomitë kanë qenë shumë të ngarkuara dhe në pamundësi për të kryer shërbimet e nevojshme kulturele.

Gjatë viteve 1954-1955, në krahasim me këto vite të planit pesëvjeçar, do të prodhohen më tepër për popullin 55 554 ton drithëra buke, — 49 000 ton perime dhe 1 250 ton duhan më tepër, ndërsa prodhimi i pambukut në krahasim me të dy vitet e pesëvjeçarit është 15 780 ton më pak dhe panxhar sheqeri 24 375 ton më pak. Gjithashtu gjatë viteve 1954-1955 do të shtohet eksporti i duhanit 200 ton, i pambukut në 100 ton, ndërsa pakësohet importimi i drithërave në 10 000 ton nga sasia e parashikuar.

Zgjidhja e problemit të bukës do të thotë jo vetëm plotësimi i nevojave për ushqimin e popullsisë, por edhe zhvillimi i mëtejshëm i blegtorisë dhe shtimi i prodhimit të bimëve industriale.

Për prodhimin e bukës në vend detyra të posaçme i shtrohen sektorit socialist të bujqësisë. Ndërmarrjet shtetërore bujqësore në vitin 1955 duhet t'i japin shtetit 100 000 kv. grurë, domethënë 45 000 kv. më shumë mbi detyrën që u shtroi Plenumi VI. Gjithashtu do të shtohet prodhimi i drithërave në kooperativat bujqësore. Por, duke marrë parasysh peshën specifike që zënë ekonomitë bujqësore individuale, do t'i kushtohet një kujdes i veçantë sektorit privat në bujqësi duke shtuar ndihmat nga ana e shtetit për këto ekonomi. Por për rritjen e

rendimentit të drithërave të bukës, është e domosdoshme të forcojmë akoma më tepër punën për ngritjen e nivelit agroteknik të masës së fshatarëve deri në nivelin e punonjësve të përparuar të bujqësisë, të përmirësohet puna e organeve të bujqësisë e të pushtetit dhe të shtohet ndihma e shtetit në favor të fshatarësisë për ngritjen e ekonomisë së tyre.

Për të plotësuar nevojat e bujqësisë me bukë, në vitin 1957 do të mbillen: 120 000 hektarë grurë, 15 000 hektarë thekër, 113 000 hektarë misër, 24 000 hektarë misër pas të lashtave dhe 4 200 hektarë oriz.

Gjithashtu rendimentet e drithërave në vitin 1957 do të rriten në krahasim me vitin 1954 si vijon: gruri nga 11 kv. për hektar në 13,5 kv. për hektar, thekra nga 8,8 kv. në 9,1 kv. për hektar, misri nga 12 kv. në 14 kv. për hektar dhe misri me hamullore nga 8 kv. në 8,3 kv. për hektar, orizi nga 23 kv. në 25 kv. për hektar.

Duke u vënë nën kulturë me drithëra sipërfaqet e mësipërme dhe duke realizuar rendimentet çdo vit, në fund të vitit 1957 do të prodhohen 3 546 000 kv. drithëra buke, d.m.th. 592 800 kv. më shumë se në vitin 1954.

Bilanci i bukës. —

Bimët industriale. — Furnizimi i lëndës së parë për industrinë me prodhimet e bimëve industriale nuk ka qenë i kënaqshëm. Plani i prodhimeve dhe i grumbullimit nuk është realizuar nga viti në vit edhe në vitin 1953 që qe një vit i mirë bujqësor plani i prodhimit të pambukut u realizua 68,5 për qind dhe i panxharit 78.1 për qind.

Për shtimin e prodhimeve të bimëve industriale dhe me qëllim që jo vetëm të sigurohen nevojat e industrisë, por të shtohet edhe baza e eksportit, sidomos në duhan, është e domosdoshme të luftohet për rritjen e rendimentit të panxharit dhe të pambukut dhe të zgjerohet sipërfaqja e të rritet rendimenti për kulturën e duhanit. Për këtë qëllim në vitin 1957 të vihen nën kulturë: 10 500 hektarë duhan me një rendiment prej 7 kv./ha. dhe të prodhohen 7 350 ton duhan. Të mbillen 23 000 ha. pambuk me një rendiment prej 8 kv./ha. dhe të prodhohen 18 400 ton pambuk, d.m.th. 153,3 për qind në krahasim me vitin 1954. Sipërfaqja e mbjellë me panxhar sheqeri rritet në 5 000 ha. me një rendiment mesatar prej 220 kv./ha. duke prodhuar 110 000 ton ose 132,5 për qind në krahasim me 1954-n. Të prodhohen 1 923 ton li dhe 927 ton kërp, d.m.th. 106,8 për qind dhe 185,4 për qind në krahasim me 1954-n.

Për arritjen e këtyre prodhimeve, përveç ndihmës që duhet t'u sigurohet nga ana e shtetit kultivuesve të bimëve industriale si forcimi i mekanizimit të punimeve, ndihma me maqineri, ndërtime veprash bonifikimi dhe ujitje dhe ndihma me anë të teknikëve dhe specialistëve, duhet të merren këto masa:

a) Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve dhe Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit të japin udhëzime mbi mënyrën e vjeljes dhe të manipulimit të duhanit nga ekonomitë fshatare si dhe mbi klasifikimin e drejtë të prodhimit nga agjentët e grumbullimit. Gjithashtu të merren masa që të sigurohen në kohë materialet e nevojshme për ndërtimin e puseve, hauzeve dhe hangareve si dhe spango, thasë etj.

b) Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve brenda vitit 1954 të studjojë mundësinë e mbjelljes së duhanit mbas grurit dhe të planifikojë, në rast rezultatesh pozitive, mbjelljen e duhanit pas të lashtave si prodhim të dytë.

c) Të përqëndrohet kultura e pambukut në zonat më të përshtatshme dhe të ujitshme. Brenda vitit 1954 të studjohet nga Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve struktura e tokave që do të destinohen për pambuk.

ç) Për të përmirësuar kualitetin e fijes dhe për të ngritur rendimentin të sigurohet importimi nga Bashkimi Sovjetik i një lloji tjetër pambuku fijegjatë.

d) Për sigurimin e prodhimit të parashikuar dhe rritjen e rendimentit të merren masa që të bëhet ujitja dhe prashitja e rregullt e pambukut, të kryhet çekanka qind për qind dhe të luftohet për vjelje të prodhimit pa firo dhe me kualitet; këto masa dhe lufta kundër humbjeve të konsiderohen si detyra shumë të rëndësishme për kultivuesit e pambukut nga organet e pushtetit dhe të Partisë.

dh) Për të shtuar përqindjen e sheqerit, të sillen nga Bashkimi Sovjetik lloje farërash panxhar sheqeri më të mira, të cilat mbasi të provohen, të mbillen në shkallë të gjerë.

Për zhvillimin e frutikulturës dhe të perimeve. Këtij sektori të ekonomisë bujqësore, që luan një rol të rëndësishëm në plotësimin e nevojave të popullit, akoma nuk i kushtohet kujdesi i duhur. Zhvillimi i frutikulturës deri sot është bërë i pastudjuar, masat e marrura nga

ana e shtetit kanë qenë të pamjaftueshme gjë që ka bërë të përhapen sëmundje që kanë dëmtuar prodhimin dhe vetë drurët frutorë.

Duke marrë parasysh kushtet e favorshme klimatike dhe vlerën ekonomike që kanë ulliri, agrumet, pemët frutore e vreshtat dhe të mbështetur në direktivat e Komitetit Qendror është e nevojshme të merren masa rrënjësore për përmirësimin e gjendjes së frutikulturës.

1. — Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve, komitetet ekzekutive dhe organizatat e Partisë në qarqe e rrethe dhe organizatat e rinisë, të zbatojnë me kujdes detyrat që përcakton vendimi i Këshillit të Ministrave mbi planin 15-vjeçar të ullaive duke pasur kurdoherë parasysh vendimet e Plenumit të Dhjetorit të vitit 1953 të Komitetit Qendror për mosdëmtimin e kullotave në favor të realizimit të planit 15-vjeçar të ullirit.

2. — Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve të përgatitë dhe t'i paraqitë qeverisë projektplanin për zhvillimin e agrumeve për një periudhë 7-vjeçare. Gjithashtu duke marrë parasysh mundësitë dhe vlerën e madhe që ka dafina për eksport, të studjohen dhe të merren masa për zhvillimin e saj të mëtejshëm në të ardhshmen.

3. — Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve brenda muajit shtator 1954 t'i paraqitë qeverisë projektin përkatës për zhvillimin e frutikulturës dhe të viti-kulturës.

4. — Për shtimin e prodhimit të perimeve dhe të patateve, të synohet më tepër në rritjen e rendimenteve, duke siguruar në vitin 1957 një prodhim prej 167 400 ton perimesh e patatesh. Për këtë qëllim brenda vitit 1955

të krijohet një bazë për prodhimin e farërave të perimeve, sipas metodës sovjetike për të prodhuar perime të hershme. Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve të planifikojë çdo vit sipërfaqet e perimeve që duhet të mbillen në fole katrore në ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe në kooperativat bujqësore.

DISA MASA PËR ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË BUJQËSISË

Për realizimin me sukses dhe brenda një kohe sa më të shkurtër të detyrave themelore që ka caktuar Plenumi i Dhjetorit i vitit 1953 i Komitetit Qendror të PPSH, duhet që në sektorin e bujqësisë të zgjidhen disa probleme kyçe, nga të cilat në radhë të parë shtimi i prodhimeve bujqësore dhe blegtorale. Për këtë të merren këto masa sipas sektorëve:

1. Shtimi i fuqisë tërheqëse

Gjendja e kafshëve të punës dhe masat që duhen marrë. Sipas të dhënave të regjistrimit, numri i pendëve si Republikë për vitin 1954, duke llogaritur përveç qeve dhe kuajve, lopët dhe buallicat që përdoren për lëvrin, arrin në 76 000, nga këto në zonat malore — 29 000, në zonat fushore — 47 000. Kjo fuqi tërheqëse është krejtësisht e pamjaftueshme për të vënë nën kulturë 385 700 ha deri në vitin 1957. Nëse do të kryejmë punimet bujqësore sipas agroteknikës, duke përfshirë edhe mekani-

kën bujqësore, ngelet një sipërfaqe prej 90 000 ha. deficit. Kjo sipërfaqe edhe sot punohet, po në vendin tonë punimet bujqësore nuk kryhen në kohë dhe me cilësi të mirë. Ky deficit do të zgjidhet duke marrë masa për shtimin e kafshëve të punës, duke shfrytëzuar më mirë parqet ekzistuese të traktorëve dhe duke importuar traktorë të rinj.

Përsa i përket shtimit të pendëve të qeve ky ecën ngadalë. Çdo vit mund të kemi një shtesë prej 1 500-2 000 pendë. Prandaj plotësimi i nevojave për fuqi tërheqëse varet kryesisht nga shfrytëzimi i mirë i traktorëve ekzistues dhe nga shtimi i parkut të maqinave dhe traktorëve.

Për të siguruar shtesën prej rreth 2 000 pendë në vit, përveç masave që janë marrë vitin e kaluar, është e nevojshme që të shihet ulja e detyrimit financiar për ato ekonomi që kanë pendë të dyta, t'u jepen kredi fshatarëve të blejnë pendë në treg, kur nuk disponon ndërmarrja e grumbullimit dhe të kufizohet më tepër therrja e vëçave të përshtatshëm për që pune.

Gjendja e fuqisë motorike dhe masat që duhen marrë. Për vitin 1954 në SMT-të dhe NBSH-të kemi në shfrytëzim 554 traktorë fizikë, të cilët kryejnë punime në 74 000 ha. tokë.

Për plotësimin e deficitit në fuqi tërheqëse gjatë viteve 1954-1957, parashikojmë të importohen: 620 traktorë fizikë d.m.th. në fund të vitit 1957 do të kemi 1 174 copë traktorë fizikë.

Me sigurimin e kësaj fuqie motorike shkalla e mekanizimit të punimeve për vitin 1957 do të arrijë si Repu-

blikë 35 për qind dhe për zonat fushore — 69 për qind, në fermat shtetërore, ekonomitë ndihmëse — 85 për qind dhe në kooperativat bujqësore ekzistuese — 80 për qind.

Me gjithë masat e marrura nga Partia dhe qeveria për përmirësimin e punës në SMT-të dhe me gjithë rezultatet e mira që kanë arritur ato gjatë vitit 1953 duhet të themi se mekanika bujqësore shfrytëzohet akoma dobët, ka të meta në drejtimin e punës, në mirëmbajtjen e maqinerisë, në kryerjen e punës me cilësi të dobët, në mosrespektimin e kontratave me fshatarësinë, stacionet e maqinave e të traktorëve nuk përdoren për të kryer shumë procese punimi si mbjellje, prashitje, korrije etj.

Për të përmirësuar punën e SMT-ve dhe me qëllim që ato të kontribuojnë më shumë në forcimin e kooperativave dhe në ngritjen ekonomike të ekonomive socialiste dhe individuale dhe të bëhen me të vërtetë një levë e fuqishme për ndërtimin e socializmit në fshat, duhet të merren këto masa:

1. — Të forcohet organizimi i punës si konditë vendimtare për realizimin e planit, të shfrytëzohet plotësisht dhe drejt maqineria duke treguar kujdes të veçantë në mirëmbajtjen e saj dhe në kursimin e karburantit.

2. — Të forcohet baza e riparimeve të traktorëve dhe të maqinerive bujqësore, duke pajisur ofiçinat ekzistuese dhe ofiçinat e reja me mjetet dhe veglat e nevojshme. Të sigurohen në kohë pjesët e këmbimit dhe materiali tjetër i importit.

Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve të pregtitë një plan perspektiv për ndërtimet në SMT-të gjatë periudhës 1954-1957 dhe t'ja paraqitë qeverisë për aprovim jo më vonë se në shtator të 1954-s. Gjithashtu Mi-

nistria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve, Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit dhe Komisioni i Planit të marrin masa për elektrifikimin brenda vitit 1955 të SMT-ve në Shijak, Ura Vajgurore, Fushë-Krujë, Fier dhe Elbasan.

3. — Të sigurohen kadro teknikë, të lartë dhe të mesëm sipas vendimit Nr. 24 datë 10 shkurt 1954 për SMT-të dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve të marrë masa për stabilizimin e traktoristëve në SMT-të.

4. — Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve të studjojë mënyrën e shpërblimit për inkurajimin e punonjësve që mirëmbajnë maqinerinë dhe kursejnë karburantin si dhe shpërblimin kundrejt punës që marrin SMT-të nga kooperativat bujqësore dhe ekonomitë private. Propozimi t'i paraqitet qeverisë brenda muajit nëntor 1954.

II. Mbi masat për plotësimin e nevojave të fshatarësisë me vegla bujqësore

Sasia e veglave dhe e pajisjeve bujqësore që disponon deri sot fshatarësia është krejtësisht e pamjaftueshme për të plotësuar nevojat e 76 000 pendëve që që punojnë. Është e domosdoshme që brenda vitit 1957 të pajisen me plugje të gjitha ekonomitë që kanë pendë dhe ekonomitë e zonave të bimëve industriale me kultivatorë, maqina mbjellëse e lesa. Për këtë qëllim është paraparë të prodhohen në vend dhe pjesërisht të importohen 50 000 plugje, — 24 300 kultivatorë, — 2 800 maqina mbjellëse dhe 47 500 lesa zizgaje.

Plotësimi i nevojave të bujqësisë me vegla hekuri do të influencojë rrënjësisht në rritjen e prodhimit bujqësor.

Për importimin e traktorëve, të maqinave mbjellëse, insekticideve, plehrave kimike, pjesëve të këmbimit dhe të pajisjeve të ofiçinave nevojitet një fond prej 40 milion rublash. Në bazë të këtyre nevojave mbështetet kredia e veçantë për bujqësinë që qeveria jonë do të kërkojë nga Bashkimi Sovjetik.

III. Mbi ujitjen, bonifikimet dhe sistemimin agrar

Me investimet që janë bërë për ndërtimin e veprave ujitëse, sipërfaqja e ujitshme këtë vit arrin 72 000 ha. e mbjellë, d.m.th. 17 050 ha. më shumë se në vitin 1953. Me veprat që janë kryer dhe ato që do të ndërtohen gjatë viteve 1955-1957, me një shfrytëzim më të mirë të kanaleve ekzistuese, sipërfaqja që do të ujitet në vitin 1957 arrin 107 000 ha. që është baras me 1/4 e gjithë sipërfaqes së punueshme. Përpara organeve të bujqësisë, të pushtetit dhe të Partisë shtrohet detyra për shfrytëzimin më të mirë të ujit, për administrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve ujitëse, për përgatitjen e kuadrit dhe vendosjen e një kontrolli të fortë në përdorimin e ujit për ujitje. Për këtë qëllim është e nevojshme që të krijohen ndërmarrje lokale të bonifikimeve në qarqet kryesore dhe të studjohet vendosja e tatimit mbi shfrytëzimin e ujit. Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve duhet t'i paraqitë qeverisë brenda muajit maj 1954 propozimet përkatëse mbi administrimin e ujrave. Gjithashtu brenda muajit gusht 1954 të studjohen nga një

komision shtetëror materialet e ekspeditës sovjetike me qëllim që të përfundohet një plan konkret mbi veprat ujitëse që duhet të kryhen brenda tre-katër vjetëve të ardhshëm; për rritjen e sipërfaqeve të ujitshme veçanërisht, t'i kushtohet kujdes ndërtimit të një rrjeti të gjerë hanzesh, barazhesh dhe lerash, të cilat ndërtohen shpejt dhe me pak shpenzime.

Krahas me masat për zgjerimin e sipërfaqeve të ujitshme është e domosdoshme marrja e masave për bonifikimin dhe sistemimin e fushave. Nga veprat e mëdha të bonifikimit që janë kryer deri sot janë përfituar dhe vënë nën kulturë 6 105 ha. tokë dhe janë përmirësuar 41 428 ha. Për vitin në vazhdim do të investohen 318 760 000 lekë për bonifikime dhe ujitje dhe deri në vitin 1957 do të përfitohen nga bonifikimi i Tërbufit, plotësimi i punimit në kompleksin e Levanit dhe bonifikimi i Vurgut të Delvinës dhe Zadrima 6 500 ha. tokë dhe do të përmirësohen 30 820 ha. të tjerë.

Për bujqësinë tonë qëndron si një problem me rëndësi sistemimi agrar. Për zgjidhjen e këtij problemi duhet të preokupohen plotësisht Partia dhe organet shtetërore. Sistemimi agrar do të shtojë sipërfaqet e puneshme, do të krijohen konditat e favorshme për shfrytëzimin më të mirë të mekanikës bujqësore dhe të ujit për ujitje, do të zhduken foletë e barërave të këqia dhe të sëmundjeve të bimëve si rrjedhim do të rritet rendimenti i kulturave bujqësore.

Puna që është bërë deri sot është akoma e pamjaftueshme, megjithëse në vitin 1953 u kryen gërmime dheu prej 1 186 000 m³, u çelën 1 165 km. kanale dhe u prishën mjaft gjerdhe, plani nuk u realizua dhe puna

në këtë drejtim shkon ngadalë. Është e domosdoshme që për vitet 1954-1957 të bëhet një vëllim pune prej 2 691 200 m³ duke çelur 3 700 km. kanale dhe të pastrohen rrënjësisht ferrat, drizat në gjerdhet e kanalet e panevojshme, veçanërisht në fushat e Korçës, të Beratit, Lushnjës, Fierit, Vlorës, Durrësit, Elbasanit, Shkodrës dhe Lezhës, ku kalojnë kanale ujitëse nacionale. Përsa i përket fushës së Delvinës, të Tiranës dhe të Krujës duhet të bëhet në radhë të parë prishja e gjerdheve dhe mbushja e kanaleve të panevojshme.

Për të bërë sistemimin agrar në zonat fushore të mësipërme duhet:

1. — Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve dhe Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit të përgatitin dhe t'u dërgojnë qarqeve jo më vonë se në shtator të çdo viti planin e projektet përkatëse të sistemimeve agrare.

2. — Komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të qarqeve dhe të rretheve ta konsiderojnë zgjidhjen e këtij problemi si një nga detyrat kryesore për bujqësinë dhe t'i mobilizojnë masat në periudhën dhjetor-mars për të kryer këto punime. Të bëhet një punë sqaruese nga ana e Partisë për të bindur fshatarët që bashkë me sistemimin agrar të bëhet edhe sistemimi i pronësisë.

IV. Problemi i farërave

Zgjidhja e problemit të farërave është një detyrë kryesore për bujqësinë. Sot kemi një numër të madh varietete farërash për çdo kulturë në krahasim me sipërfaqet që zënë. Përveç kësaj ato nuk janë të pastra dhe

Influencojnë seriozisht në uljen e rendimenteve, akoma ky problem nuk ka gjetur zgjidhjen e duhur. Detyrat e caktuara nga Plenumi VI i Komitetit Qendror nuk janë realizuar në mënyrë të kënaqshme. Farërat e prodhuara nuk kanë qenë të një cilësie të lartë, pse pak kujdes tregohet në përcaktimin e parcelave të farës dhe në aprovimin e tyre. Kjo gjendje bën që realizimi i rendimenteve të kulturave kryesore shkon ngadalë. Fara e orizit të vendit nuk është zëvendësuar qind për qind me varietetet e mira sovjetike, bullgare etj. si «Uzros», «Kenzo», «Santaeski», si dhe «Vialone nero». Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve megjithëse ka një organizim të veçantë, nuk ka marrë masa rigoroze për përmirësimin e punës në prodhimin e farërave. Për këtë problem komitetet ekzekutive dhe organizatat e Partisë pak preokupohen për të mos thënë hiç.

Për të siguruar farëra të zgjedhura duhet të merren këto masa:

1. — Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve të caktojë dhe t'u japë udhëzime organeve të saj vartëse mbi varietetet e farërave që duhet të zgjidhen kalli për kalli. Ndërmarrjet shtetërore bujqësore dhe kooperativat bujqësore, duke filluar nga viti 1954 të sigurojnë, duke zgjedhur kalli për kalli, farën e grurit, të orizit dhe të misrit për parcelat e farës dhe më 1957 të mbjellim të gjitha sipërfaqet me farë të zgjedhur. Sektori shtetëror gjatë viteve 1954-1957 t'i dorëzojë ndërmarrjes së farërave 20 000 kv. farë gruri për t'ja shpërndarë sektorit privat.

2. — Me qëllim që të sigurohet sasia e farës e llojit «Tevere», i cili ka dhënë rezultate të mira në vendin

tonë, pse piqet shpejt, nuk shkoqet, jep bukë të mirë, të importohet 1 000 kv. grurë, farë e llojit «Tevere», për ta mbjellë në vitin 1955 si dhe farëra të tjera të domosdoshme për bujqësinë.

3. — Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve brenda muajit maj 1954 të studiojë dhe t'i paraqitë qeverisë projektin mbi masat favorizuese për ekonominë e prodhimit të farërave dhe për organizimin e shërbimit të farërave, gjithashtu në muajin shtator të këtij viti të bëhet një konferencë me punonjësit e ekonomive të prodhimit të farërave.

Duke marrë parasysh rëndësinë dhe urgjencën e sigurimit të farërave të zgjedhura, Komiteti Qendror porositi Ministrinë e Bujqësisë dhe të Grumbullimeve, komitetet ekzekutive dhe komitetet e Partisë në qarqe e rrethe t'i kushtojnë kujdes të posaçëm këtij problemi.

V. Të merren masa serioze për mbrojtjen e bimëve dhe të pemëve frutore

Kushtet klimaterike të disfavorshme, niveli i ulët agroteknik në bujqësinë tonë dhe mungesa e një shërbimi të organizuar për luftimin e sëmundjeve të bimëve, kanë favorizuar zhvillimin dhe shumëzimin në masë të dëmtesve të ndryshëm të kulturave bujqësore duke ulur prodhimin e duke dëmtuar kualitetin.

Praktika ka vërtetuar se janë të gjitha mundësitë për të shpëtuar prodhimin nga dëmtuesit. Luftimi i mizës së ullirit që u organizua vitin e kaluar në rrethin e Vlorës, të Fierit, të Beratit dhe të Elbasanit uli për-

qindjen e infektimit nga 50-60 për qind në 1-2 për qind duke përfitur rreth 25 000 kv. ullinj, përveç përmirësimit të madh të kualitetit.

Për të evituar humbjet e mëdha nga dëmtuesit e bimëve është e nevojshme:

1. — Të luftojmë me të gjitha mënyrat barishtet e këqia dhe të organizohet luftimi sistematik i dëmtuesve të farës së drithërave, i krimbit të kuq të pambukut, kuskuta që dëmton jonxhën, i dëmtuesve të panxhar sheqerit dhe të patates, krimbi i misrit, miza e ullirit, vrugu dhe hiri në vreshta, koçinilet e fiqve dhe të agrumeve si dhe minjtë e arave. Për këtë qëllim të parashikohet importimi në çdo vit i materialeve që nuk prodhohen në vend.

2. — Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve të marrë masa për zbulimin e foleve të dëmtuesve në tokat dhe në kulturat frutore dhe të përcaktojë dëmtuesit e rrezikshëm me karakter karantinor të jashtëm e të brendshëm. Të bëhet organizimi i shërbimit të mbrojtjes së bimëve dhe i karantinës bujqësore në qendër, në qarqe dhe në rrethe. Riorganizimi i këtij shërbimi t'i parqitet qeverisë jo më vonë se më 30 qershor 1954.

VI. Plehërimi i tokave me plehra organike

Megjithëse plehrat përbëjnë një nga mjetet më të rëndësishme për shtimin e prodhimit në bujqësi, në vendin tonë nënvleftësohet përdorimi i plehrave organike. Ne humbasim sasi të konsiderueshme plehu organik që

llogaritet rreth 70 për qind e prodhimit global. Kjo ndodh se te ne praktikohet sistemi i mbajtjes përjashta të bagëtive dhe se sasia prej 840 000 ton pleh që llogaritet të sigurohet në stalla nuk grumbullohet dhe nuk përdoret me kujdes. Në konditat tona nuk mund të lejohet në asnjë mënyrë të kërkohen sasi të mëdha plehrash kimike, kur plehrat organike në pjesën më të madhe venë dëm. Ne duhet të organizojmë punën që të grumbullohen dhe të përdoren për bujqësinë të gjitha llojet e plehrave organike, hiri, mbeturinat e industrisë etj.

Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve të planifikojë çdo vit sasinë e plehut që duhet të sigurojnë ndërmarrjet bujqësore shtetërore, kooperativat bujqësore nga plehrat e vendit; ajo duhet të japë udhëzime mbi mënyrën e ruajtjes së plehut dhe grumbullimin e mbeturinave të ndryshme që formojnë pleh (plehrat e qyteteve, hiri, gjethet e pemëve, zarzavatet dhe prodhimet e ndryshme të prishura etj.). Problemi i shfrytëzimit dhe i përdorimit racional i të gjitha plehrave të vendit të konsiderohet detyrë e rëndësishme për organet e pushtetit, Partisë dhe të gjithë punonjësve të bujqësisë.

Përsa u përket plehrave kimike, megjithëse nevojat janë të mëdha përdorimi i tyre duhet të kufizohet vetëm me një pjesë të duhanit, të pambukut, të panxhar sheqerit dhe për parcelat e farës. Komisioni i Planit të vërë në planin e importimeve çdo vit 10 000 ton pleh kimik. Ministria e Bujqësisë duhet të planifikojë drejt përdorimin e këtyre plehrave dhe të marrë masa që të evitohen me çdo kusht humbjet e mëdha që janë vërtetuar deri sot në transportimin dhe përdorimin e tij.

VII. Mbi zhvillimin e blegtorisë

Viti i mirë bujqësor ka influencuar në mënyrë të dukshme në rritjen e blegtorisë. Por po të krahasohet gjendja e vitit 1953 me planin e vitit 1953 të pesëvjeçarit del se plani është realizuar: në njëhundredraka 90,9 për qind, në gjedhe 87,6 për qind, në buaj 66,1 për qind, në dhen 88,3 për qind, në derra 72,7 për qind, në shpendë 85 për qind dhe në bletë 81 për qind. Vetëm në dhi kemi një tejkalim prej 3 për qind.

Sikurse shihet deficitet janë të mëdha që vënë në vështirësi realizimin e planit pesëvjeçar në kuaj, buaj, gjedhe, derra e dhen. Por duhet theksuar se për këtë sektor kaq me rëndësi të ekonomisë popullore masat e marrura deri sot kanë qenë të pamjaftueshme. Organet e Partisë dhe të pushtetit akoma nuk e kanë marrë në dorë problemin e blegtorisë, ndërsa për problemet e bujqësisë ato e kanë shtuar kujdesin, blegtorja nuk u tërheq vëmendjen, nuk marrin në studim problemet e veçanta të blegtorisë dhe t'u japin zgjidhje. Baza ushqimore qëndron gjithnjë mbrapa dhe vazhdon të jetë akoma pengesë kryesore në zhvillimin e blegtorisë. Sot blegtorja ka një deficit ushqimesh prej afro 26 për qind. Kullotat, që janë bazë më me rëndësi për blegtorinë, po pastrohen me ngadalë. Nga 12 000 ha. tokë që ishin paraparë në 1953, u pastruan vetëm 2 400 ha. Nga 5 442 ha. u mbollën vetëm 3 305 ha. jonxhë për shkak se si nga Ministria e Bujqësisë, ashtu dhe nga organet poshtë pak kujdes tregohet. Stacionet e ndërimit, që tani për tani, përbëjnë bazën e përmirësimit të gjedheve, të kuajve dhe të dhive

«Saana», nuk janë në gjendje të mirë dhe në mjaft zona nuk njihet rëndësia e tyre.

Gjendja e keqe e bazës ushqimore, kujdesi i paktë për blegtorinë, ritmi i ngadalshëm i përmirësimit të racës, kanë bërë që prodhueshmëria e gjësë së gjallë të jetë mjaft e ulët, veçanërisht në sektorin kooperativist dhe privat.

Duke pasur parasysh pamjaftueshmërinë e bazës ushqimore, gjatë periudhës 1954-1957 parashikohet një shtesë krerësh prej: 6 420 njëhundra, 31 500 gjedhe, 980 buaj e buallica, 114 200 dhen, 179 000 dhi, 44 000 derra dhe 433 000 shpendë. Këto shtesa do të vijnë kryesisht nga shtimi i bagëtisë në ekonominë fshatare që kanë pak ose s'kanë bagëti.

Nga këto shtesa në vitin 1957 në krahasim me 1954 do të kemi më shumë qumësht 8,9 për qind, mish — 13,6 për qind, lesh — 5 për qind, vezë dhe mjaltë — 31,4 për qind.

Përveç masave që duhet të merren për shtimin e blegtorisë, një kujdes i veçantë duhet të tregohet për përmirësimin e racës dhe shtimin e prodhueshmërisë së blegtorisë. Për të realizuar shtesën e parashikuar deri më 1957 dhe për të përmirësuar racën e blegtorisë duhet:

1. — Të vihen nën kulturë 24 380 ha. jonxhë.

2. — Të merren masa rrënjësore për përmirësimin e kullotave; për këtë qëllim të parashikohen në buxhetet e qarqeve çdo vit shpenzimet për përmirësimin e kullotave, duke pastruar çdo qark jo më pak se 1 000 ha. kullotë. Brenda 1954-s të ngrihen ndërmarrjet lokale për përmirësimin dhe administrimin e kullotave në zonat më me rëndësi të vendit.

3. — Ministria e Bujqësisë të marrë masa për rritjen dhe shpërndarjen e damazëve dhe veçanërisht për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave mbi favorizimin e kalit. Komisioni i Planit të Shtetit të planifikojë çdo vit sasinë e koncentratos për ekonomitë që rritin kuaj dhe për damazët e stacioneve të ndërzimit.

4. — Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit të marrë masa që brenda vitit 1955 fara e pambukut të bëhet e shfrytëzueshme nga kafshët (pastë pambuku).

5. — Të merren masa për forcimin e kuadrit zooveterinar. Për këtë qëllim në bazë të kuadrit që do të pregtitet, të shtohet në organikë për çdo qark dhe për rrethet në drejtim të blegtorisë nga një zooteknik.

6. — Organet e Partisë dhe të pushtetit si dhe organizatat e masave të forcojnë punën në drejtimin e blegtorisë dhe të marrin të gjitha masat organizative e propagandistike për të vlerësuar më shumë këtë sektor. Puna e komiteteve të Partisë dhe e komiteteve ekzekutive të qarqeve dhe të rretheve të vlerësohet duke marrë parasysh dhe rezultatet që do të arrijnë në zhvillimin dhe përmirësimin e blegtorisë.

VIII. Mbi sektorin socialist të bujqësisë

Spektori socialist i bujqësisë nga vili në vit është zgjeruar, ai përbën sot 14,5 për qind të sipërfaqes së tokës së punueshme në Republikë. Megjithëse në krahasim me ekonominë bujqësore individuale sektori socialist i bujqësisë zë një vend të vogël, ai luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë.

Ky sektor përbëhet nga ndërmarrjet shtetërore bujqësore e blegtorale dhe nga kooperativat bujqësore.

Gjendja e ndërmarrjeve bujqësore dhe blegtorale dhe masat që duhen marrë për të ardhshmen. Mbas vendimeve të Plenumit VI ndërmarrjet bujqësore shtetërore kanë përmirësime të dukshme; ato, në krahasim me vitin 1952, kë.ë vit kanë zgjeruar sipërfaqen e punueshme në 7 180 ha. më tepër, kanë shtuar prodhimet bujqësore dhe blegtorale, kanë shtuar krerët e blegtorisë, është forcuar organizimi i punës dhe janë pajisur më mirë me mjete të mekanizuara.

Por me gjithë përmirësimet, që janë bërë në këto ndërmarrje, ekzistojnë akoma të meta dhe dobësi të mëdha. Ka akoma shumë ndërmarrje, që nuk janë bërë shembull përpara ekonomive bujqësore kooperativiste dhe individuale, ato nuk realizojnë planet e prodhimit, rendimentet janë akoma të ulëta, kostoja e prodhimit është e lartë dhe nga pakujdesia e drejtuesve ka dëmtime të shumta, abuzime e vjedhje të pasurisë shtetërore.

Mungesa e fuqisë punëtore të përhershme, shkalla e mekanizimit akoma e pamjaftueshme, cënimi i drejtimin ekonomik kryesor, i qarkullimeve bujqësore, mungesa e studimeve që kanë të bëjnë me harmonizimin e zhvillimit të degëve të ndryshme të prodhimit, drejtimi i dobët nga vetë drejtorja e përgjithshme e këtyre ndërmarrjeve, kontrolli dhe ndihma e pamjaftueshme e Ministrisë së Bujqësisë dhe mosinteresimi sa duhet i organeve të pushtetit dhe të Partisë në qarqe për këto ndërmarrje, kanë influencuar negativisht në gjendjen e ndërmarrjeve bujqësore shtetërore.

Për t'i bërë ndërmarrjet bujqësore shtetërore të afta të kryejnë rolin dhe detyrat që u janë ngarkuar, përveç masave që janë marrë deri sot është e nevojshme që:

1. — Të caktohet në mënyrë definitive, drejtimi ekonomik kryesor dhe degët ndihmëse të prodhimit për secilën ndërmarrje. Ministria e Bujqësisë t'i paraqitë qeverisë brenda vitit 1954 studimin mbi drejtimin kryesor të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore dhe mbas aprovimit të këtij studimi, të përpunojë qarkullimet bujqësore. Deri në vitin 1958 në të gjitha ndërmarrjet të zbatohet qarkullimi bujqësor i plotë.

2. — Për ngritjen e rendimentit të kulturave bujqësore të përhapet në shkallë të gjerë mekanizimi deri në procese të reja të komplikuar, që sot kërkojnë shumë krahe pune. Kujdes i veçantë t'i kushtohet elektrifikimit. Ndërmarrjet bujqësore që marrin energji elektrike nga Hidrocentrali «Lenin» ose nga TEC-i brenda vitit 1955, të zëvendësojnë kudo punën e motorëve stacionerë me energji elektrike.

T'u sigurohen ndërmarrjeve bujqësore mjete transporti të mjaftueshme. Gjatë periudhës së vjeljes së të lashtave, të patateve dhe të panxharit, t'u vihen në dispozicion nga Ministria e Tregëtisë dhe e Komunikacionit dhe ministritë e tjera, mjete transporti suplementare sipas nevojave.

3. — Ministria e Bujqësisë, komitetet ekzekutive e të Partisë dhe drejtoritë e ndërmarrjeve bujqësore ta konsiderojnë sigurimin e minimumit të punëtorëve të përhershëm me familjet si detyrën më të rëndësishme që kondicionon rritjen e vazhdueshme të prodhimeve bujqësore e blegtorale. Ministria e Bujqësisë dhe ajo e

Industriisë dhe e Ndërtimeve të marrin masa në mënyrë që të realizohet medoemos plani i ndërtimit të banesave dhe komitetet ekzekutive të qarqeve të sigurojnë sa më parë familjet bujqësore. Lidhur me kompleksin e ndërtimeve Ministria e Bujqësisë brenda vitit 1954, të studjojë me kujdes ndërtimet ekzistuese dhe, duke mbajtur parasysh nivelin e lartë të mekanizimit dhe të zhvillimit të degëve të ndryshme të prodhimit për të ardhshmen, të hartojë një plan perspektiv mbi nevojën për ndërtime dhe për familjet bujqësore.

Ndërmarrjet bujqësore dhe blegtorale brenda vitit 1957 të vënë nën kulturë 22 600 ha. tokë, ose 137 për qind në krahasim me 1954-n, të prodhojnë jo më pak se 147 000 kv. grurë dhe t'i dorëzojnë shtetit, mbasi të kenë hequr farën e nevojshme, 122 500 kv. d.m.th. 201,2 për qind në krahasim me planin e vitit 1954. T'i dorëzojnë shtetit në vitin 1957, 198 750 kv. panxhar, — 1 120 kv. duhan, — 127 650 kv. perime dhe patate. Të shtojnë numrin e gjedheve në 16 për qind, të njëhundrakëve — 17 për qind, të derrave — 155 për qind, të dheneve — 4,7 për qind dhe të shpendëve — 30 për qind në krahasim me 1954-n. Të prodhojnë 57 500 kv. qumësht ose 123 për qind në krahasim me 1954-n, duke ngritur rendimentin për një lopë nga 1 750 litra në 1 900 litra, të prodhojnë 2 352 kv. lesh, — 13 946 kv. mish, — 1 275 000 vezë dhe 300 kv. mjaltë.

Mbi kooperativat bujqësore. Për zhvillimin e kooperativave bujqësore është mbajtur kurdoherë parasysh detyra kryesore që ka përcaktuar Kongresi II i PPSH:

«Forcimi i kooperativave ekzistuese dhe forcimi i

propagandës për dobinë e kolektivizimit është sot detyra kryesore në çështjen e kooperativave bujqësore»¹.

Megjithëse Komiteti Qendror ka porositur dhe porosit vazhdimisht se në punën e kolektivizimit të bujqësisë duhet të ruhet me rigorozitet parimi leninist i hyrjes vullnetare të fshatarëve në kooperativa, në përgjithësi, ky parim është mbajtur parasysh, por ka pasur raste gjatë vitit 1953 në mjaft rrethe si në Elbasan, Berat, Durrës etj. që ky parim është shkelur rëndë dhe si pasojë, në disa kooperativa të reja, që u organizuan gjatë vitit 1953 në këto rrethe, disa fshatarë kërkuan të dilnin nga kooperativa. Në këtë situatë Byroja Politike e shqyrtoi çështjen dhe mori masat e nevojshme.

Kooperativat bujqësore, megjithëse të reja dhe pa kuadro të përgatitur, kanë pasur rezultate të mira në organizimin e prodhimit të madh kolektiv dhe në forcimin e ekonomisë së tyre. Në vendin tonë sot kemi 128 kooperativa me 7 902 familje anëtare dhe me 29 140 ha. tokë të punueshme që respektivisht përfaqësojnë 4,9 për qind të ekonomive fshatare dhe 7,7 për qind të tokës së punueshme të Republikës. Prodhimi i përgjithshëm i bujqësisë në kooperativat është rritur nga viti në vit. Vetëm 2 kooperativa gjatë vitit 1953 nuk mundën të sigurojnë dot bukën. Prodhimi i drithërave për bukë në vitin 1953 përfaqëson 7,4 për qind të prodhimit të Republikës, i panxhar sheqerit 51,6 për qind dhe i pambukut 23 për qind. Kooperativat kanë arritur rendimente të larta në krahasim me ekonomitë fshatare individuale. Por, ndërsa prodhimet bujqësore çdo vit janë shtuar,

¹ «Dokumenta Kryesore të PPSH». Vëll. II, bot. I dytë, f. 280.

numri i gjësë së gjallë në kooperativa nuk është shtuar si duhet dhe prodhimet blegtorale janë akoma të pakta. Si rezultat i shtimit të prodhimeve janë shtuar të ardhurat në kooperativa. Në vitin 1953 kanë realizuar 292 266 000 lekë të ardhura ose 69,6 për qind më shumë se në vitin 1952. Ato kanë sot një fond të paprekshëm prej 263 018 504 lekë. Vetëm gjatë vitit 1953 u derdhën në fondin e paprekshëm 43 009 274 lekë që përfaqësojnë 14,7 për qind të të ardhurave në të holla. Është rritur vlefata e ditës së punës. Çdo kooperativist për vitin 1953 ka marrë mesatarisht 3,916 kg. drithë dhe 28,7 lekë për një ditë pune.

Me gjithë sukseset ekonomike që kanë arritur kooperativat bujqësore, ato janë akoma të dobëta nga ana e organizimit dhe e ngritjes së nivelit politik, kultural dhe agroteknik të anëtarëve.

Për forcimin e mëtejshëm organizativo-ekonomik të kooperativave bujqësore është e nevojshme që kooperativave bujqësore t'u kushtohet kujdes i veçantë dhe t'u jepet çdo ndihmë dhe përkrahje nga ana e shtetit:

1. — Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve dhe organet e saj vartëse, komitetet ekzekutive dhe komitetet e Partisë në qarqe e rrethe t'u japin kooperativave bujqësore çdo ndihmë për forcimin e ekonomisë kolektive, për organizimin e brendshëm, për të arritur rendimente të larta në bujqësi, për zhvillimin e blegtorisë kolektive dhe për përmirësimin e racës së gjësë së gjallë. Të marrë masa për të përgatitur përmes kurseve dhe shkollave teknike e specialistë për kooperativat bujqësore.

Me qëllim që kooperativat të zhvillojnë blegtorinë kolektive, t'u jepen atyre nga sektori shtetëror damazë

dhe kafshë race. Banka e Shtetit t'u akordojë kooperativave bujqësore kredi për blerjen e gjëse së gjallë në treg të lirë, kur nuk ka në sektorin shtetëror dhe të vendoset që kooperativave t'u akordohet kredi me afat skadimi vjetor.

2. — Komitetet e Partisë të forcojnë dhe të ngrenë në një nivel më të lartë punën e udhëheqjes së organizatave bazë në kooperativa, të forcojnë punën politike me kooperativistët dhe të mos lejojnë që të paraqiten gabime që dëmtojnë vijën e Partisë dhe çështjen e kolektivizimit. Funkionarët dhe punëtorët e aparateve të Partisë të përvetësojnë sa më shumë çështjen e ndërtimit të ekonomisë dhe të strukturës së brendshme të kooperativave dhe të ndihmojnë organizatat bazë të Partisë në kooperativa që të luftojnë për zbatimin e përpiktë të statutit, për forcimin e disiplinës në punë, për zhvillimin e demokracisë kooperativiste, të ngrenë dhe të forcojnë autoritetin e asamblesë si organ më i lartë dhe të kujdesen që të mbahet qëndrim i drejtë dhe të krijohen marrëdhënje të mira me fshatarët jashtë kooperativës.

3. — Komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të qarqeve dhe të rretheve të organizojnë punën propagandistike sqaruese me fshatarësinë individuale mbi kolektivizimin. Duhet të merret seriozisht nga Partia dhe pushteti çështja e organizimit vullnetar të fshatarësisë në format e thjeshta të punës kolektive. Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve si dhe Drejtoria e bujqësisë pranë Komitetit Qendror të Partisë, brenda muajit gusht të studjojnë mënyrat e organizimit praktik të kolektivave bujqësore dhe të ndihmës reciproke mi-

dis fshatarëve dhe të përpunojnë udhëzime konkrete për këtë qëllim.

IX. Problemi i kuadrit specialist në bujqësi

Kuadri, që punon sot në bujqësi, nuk u përgjigjet nevojave të mëdha që ka bujqësia jonë. Përbërja e tij si nga ana profesionale dhe politike, nuk është plotësisht e kënaqshme. Në funksione drejtuese të bujqësisë poshtë janë caktuar elementë të paaftë që nuk kanë arësim bujqësor ose bazë shkollore të shëndoshë. Si nga Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve, ashtu edhe nga komitetet ekzekutive dhe të Partisë poshtë, pak kujdes është treguar për konditat e punës dhe të jetesës së kuadrit të bujqësisë. Nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Grumbullimeve pak punë bëhet për arësimin profesional të tyre, detyrë kjo që na ngarkon Plenumi VI i KQ të PPSH për plotësimin me nxënës sipas planit për shkollat bujqësore dhe asnjë vit nuk e kanë realizuar kontingjentin e nxënësve të planifikuar; vetëm për vitin 1953 janë mangut 182 nxënës nga numri i caktuar.

Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve pak kujdes ka treguar në kontrollin e planeve, programeve mësimore dhe të teksteve. Ajo nuk i ka orientuar drejt shkollat bujqësore përsa i përket lidhjes së teorisë me praktikën dhe ka hezituuar në caktimin e instruktorëve të kualifikuar për dhënjen e mësimave në shkollat. Në bazë të normave të aprovuara, për t'i ardhur në ndihmë më mirë bujqësisë me kuadro, është e nevojshme që brenda vitit 1957 të pregatiten në shkollat dhe në Insti-

tutin e lartë bujqësor dhe po qe nevoja në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e demokracisë popullore 194 kuadro të lartë, agronomë, zooteknikë dhe veterinerë si dhe 446 kuadro të mesëm, të pregatiten 1 300 traktoristë dhe kombajnierë, përveç kuadrit inxhinier dhe gjeometër për nevojat e mekanikës bujqësore, të kadastrës dhe të bonifikimeve, të cilët duhet të pregatiten nga shkollat në vartësi të Ministrisë së Arësimit.

Për të përmirësuar gjendjen e kuadrit dhe përgatitjen e tij të merren këto masa:

1. — Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve, komitetet ekzekutive dhe të Partisë të tregojnë kujdes për kuadrin; ato të organizojnë punën për edukimin individual dhe në shkollë pa shkëputje nga prodhimi si të kuadrove drejtues ashtu edhe të specialistëve të ndryshëm. Zgjedhja dhe vendosja e kuadrit bujqësor të bëhet e studjuar, lidhur me perspektivën e zhvillimit të bujqësisë.

2. — Të shqyrtohen planet dhe programet e teknikumeve për t'i bërë ato të një profili të gjerë. Praktikës mësimore dhe asaj të prodhimit t'i kushtohet kujdes i veçantë në mënyrë që kuadrot të dalin sa më të aftë në punë. Për këtë qëllim shkollat bujqësore të kenë ekonomi didaktike eksperimentale dhe të organizohet mësimi dhe puna në praktikë si dhe të luftohen të metat që ekzistojnë.

3. — Qysh prej vitit shkollor 1955-1956 Instituti i lartë bujqësor të pranojë çdo vit 120 nxënës të rinj, të cilët të ndahen në këto degë: 60 për agronomë (nga të cilët 30 të specializohen për pyje), 30 për zootekni dhe 30 për veterinari. Në teknikumet e Ministrisë së Bujqë-

sisë dhe të Grumbullimeve të hyjnë çdo vit 330 nxënës të rinj, të cilët të ndahen në këto degë: 150 për agronomi, 90 për zootekni, 60 për veterinari dhe 30 për pyje.

4. — Ministria e Arësimit dhe e Kulturës të marrë masa që të plotësojë nevojat për inxhinierë bonifikimi dhe kadastre, inxhinierë mekanikë dhe për kuadro të mesëm për bonifikimet, kadastrën dhe mekanikën.

5. — Brenda vitit 1954 Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve të studjojë gjendjen e Institutit të lartë bujqësor, të teknikumeve, të Institutit të kërkimeve shkencore bujqësore dhe të Qendrës së studimit zooteknik në Shkodër dhe t'ja parashtojë çështjen për shqyrtim qeverisë.

X. Mbi propagandën bujqësore

Propaganda bujqësore është akoma në nivel të ulët, ajo nuk i plotëson kërkesat e mëdha të punonjësve të bujqësisë për t'i ndihmuar ata në njohjen e shkencës agronomike sovjetike, të eksperiencës sovjetike dhe të agroteknikës së përparuar.

Zgjidhja e detyrave të mëdha që janë shtruar për bujqësinë në kohën e tanishme kërkon të forcojmë akoma më shumë propagandën bujqësore. Është e domosdoshme që puna e propagandës bujqësore të merret në dorë nga organet e shtypit dhe të propagandës pranë Komitetit Qendror të Partisë. Shtypi ynë të ngrejë vazhdimisht problemet e bujqësisë për përhapjen e njohurive agroteknike, të metodave sovjetike dhe të eksperiencës së punonjësve të dalluar të vendit tonë. T'i jepet precedencë shtypjes së literaturës bujqësore.

Organet e Partisë dhe të pushtetit në qarqe dhe në rrethe të organizojnë kurse agrozooteknike me punonjësit e bujqësisë dhe të blegtorisë ku të sigurohet pjesëmarrja e gjerë e tyre, të organizojnë ekskursione për shkëmbim eksperience dhe të shfrytëzojnë më mirë ekspozitat bujqësore, të cilat duhet të bëhen shkolla të vërteta për fshatarësinë tonë. Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve dhe komitetet ekzekutive e të Partisë ta konsiderojnë si detyrë me rëndësi të madhe politike shpërndarjen e urdhërave dhe medaljeve në punonjësit e bujqësisë dhe veçanërisht të vënë në dukje meritat e gruas në vendin tonë dhe ndihmën e madhe që ajo i jep bujqësisë. Të dekorohen sa më shumë gra.

Drejtorja e propagandës pranë Komitetit Qendror dhe Ministria e Arësimit dhe e Kulturës t'i japin precedencë shtypjes së literaturës bujqësore dhe bashkë me Ministrinë e Bujqësisë dhe të Grumbullimeve të marrin masa për shtypjen sa më shumë të librave me përmbajtje bujqësore dhe blegtorale.

Të gjitha sa u përmendën më lart përbëjnë problemet dhe detyrat kryesore që duhet të zgjidhim sa më parë për të bërë që bujqësia të zhvillohet me një ritëm më të shpejtë se deri sot dhe të mund të përballojë nevojat e shtetit dhe të popullit me prodhime bujqësore e blegtorale si dhe industrinë me lëndë të parë. Realizimi i këtyre detyrave kërkon mobilizimin e gjithë Partisë, të organeve të shtypit e të ekonomisë, të gjithë punonjësve të bujqësisë.

Por detyra aktuale është detyra për realizimin e planit të vitit 1954 dhe ajo më imediatja është realizi-

mi me sukses i mbjelljeve dhe i punimeve të tjera bujqësore të pranverës. Gjendja e krijuar nga konditat klimaterike, nga mosorganizimi i mirë i punës në mjaft raste për mobilizimin e punonjësve dhe shfrytëzimin racional të mjeteve, nuk është e mirë. Jemi mbrapa me punimet fushore dhe akoma në mjaft zona nuk janë realizuar plotësisht detyrat në lidhje me masat përgatitore për mbjelljet. Shirat e shumta që kanë rënë do të influencojnë në rritjen e barërave të këqia, në të lashtat dhe në bimët prashitëse.

Shtrohet, pra, si detyrë që të merren masa urgjente për kryerjen e mbjelljeve pranverore në afate sa më të shkurtëra dhe në kondita të mira agroteknike si dhe për prashitjen e bimëve të pambukut, duhanit, panxhar sheqerit, misrit, për të bërë një luftë të organizuar kundër barërave të këqia.

Kryerja me kohë e punimeve bujqësore dhe organizimi i mirë i korrjeve dhe i vjeljeve të shpejta e pa firo të të lashtave dhe sigurimi i ushqimit për blegtorinë, janë garanci për realizimin e planit bujqësor dhe blegtoral për vitin 1954, ato përbëjnë bazën e realizimit të rendimenteve të larta në prodhimet bujqësore dhe blegtorale.

TRANSPORTET

Rritja e prodhimit të minierave, të industrisë dhe të bujqësisë kërkon dhe zhvillimin e transportit në masë të atillë për të përballuar qarkullimin e mallrave. Vëllimi i punës për transportin automobilistik (nacional), i cili në vendin tonë zë vendin kryesor, në vitin 1957

rritet 170,4 për qind në krahasim me realizimin e vitit 1953.

Për të siguruar këtë vëllim pune është e nevojshme rritja e parkut të mjeteve nga 4 727 ton në vitin 1954, në 6 600 ton në vitin 1957, kështu që duke përfshirë dhe amortizimin do të nevojitet të importohen gjatë kësaj periudhe 2 400 ton mjete.

Gjithashtu edhe vëllimi i transportit hekurudhor rritet 165,5 për qind në krahasim me realizimin e vitit 1953 dhe i transportit detar 161,5 për qind.

Detyra e rëndësishme për sigurimin e transportit është në radhë të parë gatishmëria teknike e mjeteve dhe për këtë duhen siguruar pjesët e këmbimit të domosdoshme duke zgjeruar prodhimin e tyre në vend dhe nga importi, duke forcuar ofiçinat e riparimit dhe duke ngritur kualifikimin e punëtorëve, si të ofiçinave dhe të shoferëve. Për pajisjen e ofiçinave të komunikacionit dhe zgjerimin e repartit të prodhimit të pjesëve të këmbimit të Uzinës «Enver» janë siguruar 4 milion rubla nga kreditë ekzistuese, për t'u përdorur për këtë qëllim.

Për transportin detar vlen të studjohet në të ardhshmen pajisja me ndonjë mjet me kapacitet të madh për distanca të gjata nga portet tona deri në Detin e Zi.

TREGËTIA

Zhvillimi organizativ i tregëtisë shtetërore dhe kooperativiste. Gjatë tre vjetëve të planit të parë pesëvjeçar rrjeti i tregëtisë shtetërore është rritur 117 për qind

dhe ai i kooperativave tregëtare 45 për qind. Kjo rritje në krahasim me planin e tre vjetëve të pesëvjeçarit është 103,6 për qind për tregëtinë dhe 101 për qind për kooperativat.

Por në punën e tregëtisë ka shumë dobësi si nga ana e sigurimit të bazës materiale të nevojshme për sigurimin e zhvillimit të një tregëtie të kulturuar, ashtu edhe në shpërndarjen e mallrave dhe në shërbimin e popullit. Pak është bërë në këtë sektor për sigurimin e depove të përshtatshme me pajisjet e nevojshme për vendosjen dhe konservimin e mallrave dhe për t'i siguruar këto nga dëmtimet e shumta që shkaktohen.

Shërbimi i popullit nuk bëhet i mirë. Në shumë raste tregëtia bëhet me ndërprerje, që vjen nga mungesa e mallrave dhe nga dobësitë në shpërndarjen e tyre. Gjendja higjieno-sanitare në dyqanet dhe në punonjësit e tregëtisë nuk paraqitet e mirë, ka mungesa të mëdha në ambalazhet, gjë që shkakton jo vetëm dëmtimin e mallrave, por edhe mënyra e shitjes së tyre bëhet e papërshtatshme. Duke mos pasur letër dhe enë për ambalazhim dhe paketim të mallrave të ndryshme si turshi, ullinj, djathë, gjalpë, pa bërë fjalë për artikuj të tjerë, ato u jepen blerësve në duar ose në enët e tyre.

Ndërgjegjja e mjaft punonjësve të rrjetit të tregëtisë është e ulët. Aty ka favorizime, neglizhenca, dëmtime, vjedhje e prishje të mallrave. Mjafton të përmendim se gjatë vitit 1953 janë vërtetuar vjedhje dhe dëmtime mallrash në sektorin e tregëtisë shtetërore për më se 18 milion lekë dhe në sektorin kooperativist për më shumë se 14.5 milion lekë.

Në kooperativat e konsumit organet e zgjedhura si

asamblëtë dhe këshillat administrative nuk funksionojnë mirë. Aktiviteti i këtyre organeve nuk mbështetet në masën e anëtarëve, të cilëve nuk u ndahen në rregull fitimet e realizuara dhe nuk kanë prioritet në furnizim. Këto dobësi nuk kanë lejuar forcimin e lidhjeve të anëtarëve me organizatën e tyre, në mënyrë që kooperativat të luanin më mirë rolin e tyre si një hallkë më rëndësi për forcimin e aleancës midis fshatit dhe qytetit.

Për këtë sektor të rëndësishëm Partia dhe qeveria duhet të tregojnë një kujdes të veçantë. Ne nuk do të zgjatemi në këtë raport, por mendojmë që Byroja Politike dhe qeveria të marrin në studim të veçantë çështjen e tregëtisë.

Mbi furnizimin e popullatës. Duke u bazuar në prodhimet, grumbullimet dhe importin e parashikuar, furnizimi i popullatës do të ketë një përmirësim të ndieshëm në artikujt kryesorë ushqimorë dhe industrialë. Rritja e disa artikujve për furnizimin e popullatës nga tregëtia shtetërore e kooperativiste në vitin 1957, në krahasim me realizimin e vitit 1953 do të jetë si vijon: bukë 120 për qind, sheqer 173 për qind, yndyrna 143 për qind, mish e peshk 259 për qind, fasule dhe oriz 204 për qind, djathë e gjizë 188 për qind, të pambukta 155 për qind, të leshta e kadife 545 për qind, këpucë e opinga 190 për qind.

Furnizimi i popullsisë së Republikës për çdo frymë në vit me disa artikuj të konsumit të gjerë nga sektori shtetëror dhe kooperativist është parashikuar të rritet si më poshtë:

Furnizimi i popullsisë së qytetit:

Artikujt	në vitin 1957 duke e krahasuar me 1953
Sheqer	119 për qind
Yndyrna	124 »
Mish e peshk	237 »
Fasule e oriz	170 »
Djathë e gjizë	163 »
Ullinj të konservuar	274 »
Patate	216 »
Të pambukta	104 »
Të leshta e kadife	292 »
Këpucë e opinga	125 »

Furnizimi i popullsisë së fshatit:

Sheqer	220 për qind
Sapun	170 »
Të pambukta	177 »
Të leshta e kadife	12 herë
Këpucë e opinga	225 për qind

Gjithashtu do të shtohet me një ritëm më të madh shitja e materialeve të ndërtimit, e mobiljeve dhe e orendive, e llamarinës dhe e aluminit, prodhime poçerie etj. që kanë natyrën e konsumit më tepër për fshatin.

Në përcaktimin e kontingjenteve për furnizim është pasur parasysh dhe rritja e popullatës sipas të dhënave të viteve të kaluara. Nga përlllogaritjet që janë bërë rezulton se popullsia e qyteteve rritet me një ritëm më të madh se popullsia e fshatit, mbasi për qytetin përveç

rritjes natyrale është parashikuar edhe lëvizja nga fshati në qytet duke u bazuar në shtimin e nevojave për fuqinë punëtore që do të ketë qyteti dhe qendrat e punës. Sipas këtyre llogaritjeve rritja e popullsisë do të jetë si më poshtë:

	1954	1955	1956	1957
Popullsia e qytetit	357 000	372 000	390 000	410 000
Popullsia e fshatit	982 500	997 000	1 010 000	1 021 000
Gjithsejt	1 339 500	1 369 000	1 400 000	1 431 000

Në bazë të llogaritjeve aproksimative, nga rritja e të ardhurave të popullatës, fuqia blerëse në vitin 1957 do të rritet 137 për qind në krahasim me vitin 1954 dhe po në të njëjtin proporcion rritet xhiroja e tregëtisë.

Në konditat e një prodhimi të mirë bujqësor për vitet 1954 dhe 1955, parashikojmë që në gjysmën e dytë të vitit 1955 do të jetë e mundur të hiqet sistemi i triskëtimit pjesërisht për disa mallra konsumi si për sheqerin, të pambuktat, kripën e të tjera dhe në vitin 1956 mund të hiqet krejt sistemi i triskëtimit. Me shtimin e prodhimeve dhe të grumbullimeve me një ritëm më të madh se shtimi i fuqisë blerëse të popullatës në vitet e ardhshme do të kemi mundësi të bëjmë nga një ulje çmimesh të mallrave të konsumit të gjerë me rreth 400-500 milion lekë për çdo vit. Në këtë mënyrë fuqia blerëse e popullatës do të rritet 152 për qind në vitin 1957 në krahasim me vitin 1954, jo vetëm për efekt të

shtimit të të ardhurave, por edhe nga shtimi i pagesave reale për llogari të uljes së çmimeve nga shitjet e tregëtisë shtetërore dhe kooperativiste, përveç që këto do të influencojnë dhe në uljen e çmimeve në tregun fshatar dhe privat.

Nga shifrat e mësipërme del se në vitet e ardhshme do të ketë një përmirësim në furnizimin e popullit. Ky përmirësim do të sigurohet me realizimin e plotë të prodhimit në të gjithë sektorët. Prandaj është e domosdoshme që dikasteret furnitore, sidomos për disa artikuj ushqimorë siç janë peshku, mishi, fasulet, orizi dhe bulmetrat që nuk kanë shkuar mirë, duhet të marrin masë serioze për të siguruar realizimin e prodhimit.

Duhet shënuar se sikurse del edhe nga shifrat e mësipërme për disa artikuj siç janë yndyrnat, këpucët dhe opingat, plotësimi i nevojave duhej të ishte më i madh mbasi për opinga e këpucë në fshat, për shembull, në vitin 1957 nuk arrihet nga një palë për frymë, ose për yndyrna, po ta llogarisim në krahasim me vitin 1952 shtohet vetëm 110 për qind.

Mbi bilancin e eksport-importit. a) *Eksporti:* Vëllimi i eksportit tonë, i mbështetur në zhvillimin e minierave, të bujqësisë dhe të industrisë do të ketë një rritje mesatare prej 15 për qind duke arritur në vitin 1957 dyfishin e eksportit fakt të vitit 1953. Në krahasim me kuotën e pesëvjeçarit eksporti i vitit 1955 do të jetë 22,5 për qind më i ulët. Në këtë ulje influencojnë disa artikuj eksporti si bakri, bitumi, tekstilet e pambukta, farë pambuku, vaj ulliri, të cilët tani janë parashikuar më pak ose figurojnë në eksportin tonë.

Për artikujt kryesorë eksporti paraqitet si vijon:
(në milion rubla)

	1953	1954	1955	1956	1957	1957 në krahësim me 1953 në %
Naftë brut, bitum fluksat	11	11	11,2	12	14,5	131,8
Bitum i pastër	2,6	2,9	3,1	3,5	3,8	146,1
Mineral kromi	9,8	15,5	20,1	23,2	27,1	276,5
Duhan gjeth	3,2	13,2	16,5	19,3	20,9	653,1
Të tjera	17,5	14,4	17,4	19,7	23,4	133,7
Gjithsejt	44,1	57	68,3	77,7	89,7	203,4

b) *Importi*: Për sigurimin e prodhimit të minierave, të industrisë, të bujqësisë dhe të furnizimit të popullatës sipas parashikimeve të mësipërme, paraqitet e nevojshme të kemi një import vjetor nga 90 deri në 100 milion rubla.

Në këtë import mallrat e konsumit të gjerë arrijnë 11 milion rubla mesatarisht çdo vit kundrejt 5 milion rubla në vitin 1953. Lënda e parë për mallra konsumi nga 4 milion rubla në vitin 1954 arrin në vitin 1957 në 6 milion rubla. Drithëra për bukë në vitin 1954 dhe në 1955 kemi parashikuar të importojmë rreth 30 000 ton, ndërsa në vitin 1956 mund të hiqen fare nga importi.

Duke marrë parasysh eksportin, importin, kreditë e akorduara dhe kreditë që kërkojmë për bujqësinë dhe industrinë e naftës, bilanci i eksport-importit paraqitet si vijon:

	1954	1955	1956	1957
Gjithsejt të hyra	115	128	108	103
Gjithsejt të dala	111	101	89	91
Diferenca (1-2)	+4	+27	+19	+12

Shtojmë se kreditë e akorduara për hidrocentralin, rafinerinë, fabrikën e konservave të peshkut, për tri punishtet e perimeve, pajisjet për prodhim çorapesh. pajisjet për ofiçinat mekanike, për minierat dhe për transportin hekurudhor e detar nuk figurojnë në këtë bilanc.

Sipas këtij bilanci del se nga viti 1955 mund të jemi në gjendje të fillojmë shlyerjen pjesërisht të ratave. Mirëpo në studimin e sipërm të bilanci të eksport-importit për vitet 1954-1957 është marrë parasysh një prodhim normal bujqësor me të cilin mund të sigurojmë prodhimin e drithërave në vend duke filluar nga viti 1956. Nëse në fakt gjatë këtyre viteve do të kemi një vit të keq bujqësor, do të detyrohemi të rritim importin e drithërave të bukës në 40 000 ton ose 17 milion rubla.

Nga ana tjetër duke marrë parasysh se gjatë viteve 1955-1956 parashikojmë të heqim triskat dhe se importimi i mallrave të konsumit është parashikuar sipas normave disi të kufizuara, pa lejuar të kemi ndonjë rezervë më të madhe me rastin e heqjes së triskave, është e nevojshme të marrim parasysh një shtim të mallrave dhe materialeve të importit për periudhën 1955-1957 në masën rreth 7 milion rubla në vit. . .

Shokë,

U munduam që në këtë raport t'i paraqitim plenumit në një analizë kritike dobësitë tona të drejtimit të ekonomisë dhe të aparatit shtetëror. Gjithashtu paraqitëm studimet që kanë bërë Byroja Politike dhe organet shtetërore për zhvillimin e sektorëve kryesorë të ekono-

misë deri në vitin 1957. Ne mendojmë se kjo analizë e dobësive tona dhe këto studime do ta vënë Komitetin Qendror të Partisë në gjendje që të kryejë më mirë detyrën e madhe që i ka ngarkuar Partia dhe populli, për të udhëhequr gjithë aktivitetin e shtetit.

Ne duhet të përmirësojmë metodën e punës të udhëheqjes së ekonomisë nga ana e Komitetit Qendror dhe e qeverisë, duke forcuar kolegjalitetin në drejtimin e punëve, duke organizuar më mirë studimin e problemeve ekonomike dhe shtetërore, duke organizuar më mirë zbatimin e vendimeve dhe duke forcuar kontrollin për zbatimin në afat të tyre.

Nga studimet që paraqitëm më lart, del qartë, se para nesh vihen detyra shumë të mëdha, realizimi i të cilave kërkon një punë intensive që nga udhëheqja deri në organet më të ulëta, kërkon që t'i jepet fund çdo metode burokratike-formale të udhëheqjes, përndryshe pasojat do të jenë shumë të hidhura. Ne duhet të arrijmë me çdo kusht realizimin e detyrave që përcaktohen në këto studime për sektorët kryesorë të ekonomisë, duhet të rritim prodhimin në sasi të caktuara, se vetëm kështu do të sigurojmë ngritjen e nivelit të jetesës së punonjësve, do të forcohet ekonomia jonë dhe do të jemi në rregull karshi miqve tanë.

Shokët që drejtojnë dikasteret ekonomike, ku ekzistojnë dobësi të mëdha në drejtimin e punëve, duhet të marrin masa serioze për t'u shkëputur një herë e mirë nga vogëlsirat dhe punët që nuk u takojnë, të aktivizojnë dhe të ngarkojnë me përgjegjësi vartësit, të forcojnë disiplinën në punë dhe të ushtrojnë një kontroll më të gjerë dhe të organizuar.

Realizimi i planit të vitit 1954 do të jetë garancia më e madhe e sukseseve tona në zhvillimin e ekonomisë mbas masave të rëndësishme që kemi marrë, por duhet ta deklarojmë para plenumit se fillimi i këtij viti, d.m.th. tre muajt e parë, nuk kanë shkuar aspak mirë në disa sektorë të rëndësishëm të industrisë, të minierave dhe të ndërtimit dhe kjo ka ardhur për dobësi serioze që ekzistojnë atje. Shokët e Ministrisë së Industrisë dhe të Ndërtimit, që nga ministri dhe të tjerët, duhet të dalin sa më parë nga kjo gjendje dhe të marrin të gjitha masat për të mbuluar sa më parë deficitet e krijuara dhe për realizimin e plotë të planit të vitit 1954.

Nuk ka dyshim, shokë se ne do t'i kapërcejmë të gjitha vështirësitë që na dalin përpara. Garanci për këtë është forca e Partisë sonë dhe e gjithë popullit. Është Partia dhe punonjësit tanë që kurdoherë kanë dalë ngadhjmtarë në luftë me gjithë armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm dhe kanë kapërcyer të gjitha vështirësitë në punë. Populli dhe Partia jonë kanë bërë një punë kolosale dhe rezultatet e arritura në të gjithë sektorët e dëshmojnë këtë. Pa dyshim, sikundër që e pamë, te ne ka pasë dhe ka gabime, detyra jonë do të jetë si kurdoherë, siç na mëson leninizmi, të mos i mbulojmë gabimet, por t'i njohim dhe t'i zhdukim. Forca e Partisë sonë qëndron pikërisht në atë që ne i shohim gabimet dhe luftojmë kundër tyre. Me analizën që po bëjmë, ne jemi të sigurtë se Partinë dhe Komitetin Qendror e forcojmë shumë e më shumë. Vërtet te ne janë vërtetuar gabime, por fakti që ne po i zbulojmë dhe luftojmë për t'i ndrequr, është një anë shumë pozitive për Komitetin Qendror. Nuk duhet të harrojmë edhe faktin se na

ka munguar eksperienca, kuadrot janë akoma më të shumtët të rinj, por ata rriten. Konditat e ndërtimit të socializmit në vendin tonë, konditat brenda atdheut tonë dhe rreth kufive tanë, kërkojnë nga udhëheqja që të bëjë më shumë sa ç'ka bërë deri tash. Ne duhet të ecim përpara dhe do të ecim përpara pse i kemi të gjitha konditat.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

FJALA E MBYLLJES NË PLENUMIN X TË KOMITETIT QENDROR TË PPSII

18 prill 1954

Të gjithë e kuptojnë se përpara nesh dalin detyra shumë të rëndësishme. Për ne perspektivat janë të qarta, mundësitë janë të mëdha dhe, po të dimë ta organizojmë mirë punën e të mobilizohemi të gjithë si duhet, do ta përmirësojmë situatën tonë ekonomike shumë më tepër nga gjendja e sotme. Sikurse doli edhe nga të gjitha diskutimet që u bënë këtu, mendoj se është e drejtë të them që ky plenum është një nga më të rëndësishmit që ka bërë Komiteti ynë Qendror për këto çështje.

Do të flas pak në lidhje me disa konkluzione të tjera që dalin nga ky plenum që janë të dukshme e shumë të rëndësishme.

Çështja e parë është se plenumi ynë u zhvillua në një frymë mjaft të lartë. Këtu u shfaq uniteti i plotë i mendimit dhe i veprimit i udhëheqjes së Partisë sonë. Kjo ka një rëndësi të jashtzakonshme. Ky unitet ka ekzistuar kurdoherë, por shumë pozitive është se çdo ditë e më tepër ai çelënikoset për arsye se shokët udhëheqës po ngrihen dita-ditës. Kjo është përsëri evidente dhe këtë nuk e them për të kënaqur veten, por se është reali-

tet. Pra ngritja e shokëve po ecën përpara. Si këtu dhe në punë duket që ka ngritje në udhëheqje, gjë që është një anë shumë pozitive për Partinë tonë.

Çështja tjetër është se të gjithë shokët e Komitetit Qendror kanë arritur në një shkallë të atillë ngritjeje sa të bëjnë hapur e pa drojtje kritikë dhe autokritikë si për punën e tyre ashtu dhe për punën e të tjerëve. Edhe kjo është një çështje shumë pozitive.

Del qartë se 1 gjithë plenumi është dakord me raportin e Byrosë Politike dhe me shifrat që paraqiten si përsa u përket dy viteve të fundit të pesëvjeçarit të parë, ashtu dhe me shifrat orientuese të dy viteve të para të pesëvjeçarit të dytë. Këto shifra, siç thuhet në raport, (ato të 1956-s dhe të 1957-s) janë orientuese, ato do të përpunohen dhe sigurisht do të kenë ndryshime. Varet shumë nga puna e Partisë dhe e pushtetit, nga udhëheqja jonë e drejtë, nga zhdukja e gabimeve që janë vërtetuar dhe vërtetohen në punën tonë të përditshme që ne të realizojmë shifrat, d.m.th. planin e këtyre dy viteve. Pra, na vihet detyrë t'i realizojmë shifrat e planit të 1954-s dhe të 1955-s ashtu sikundër i ka aprovuar Komiteti Qendror. Ato janë mbështetur në planin tonë të vendosur më parë për 1954-n me ndryshimet që janë bërë në shtimin e prodhimeve që janë të mundshme dhe Komiteti Qendror i pranon se janë mundësitë të realizohen. Pra, si detyrë kryesore na vihet që, duke marrë të gjitha këto masa, të realizojmë planin. Realizimi i tij jo vetëm që duhet bërë i mundshëm, por duhet të punojmë në një mënyrë të tillë që shifrat të tejkalohen. Kjo varet nga realizimi i detyrave të këtyre dy viteve.

Këtu u ngrit edhe çështja e rendimenteve në bujqësi. I tërë plenumi është i mendimit që ne të arrijmë rendimentet që ka parashikuar në raport Byroja Politike. Kjo kërkon që ne të organizojmë mirë punën, t'i kryejmë mirë të gjitha detyrat që i vihen bujqësisë dhe mundësisht t'i tejkalojmë. Unë mendoj, pra, dhe kështu besoj mendon i gjithë plenumi, që ne t'i arrijmë këto rendimente.

Një problem tjetër, përsa i përket bujqësisë, është ai i bukës. Këtë duhet ta vendosim dhe ta përcaktojmë. Propozoj që ne të mos jemi aq kategorikë përsa i përket heqjes së triskave të bukës në 1956, por të themi që duhet të krijojmë kondita më të mira për të lejuar heqjen e triskave në 1956, pse kështu do të jetë më e drejtë...

Unë, duke marrë parasysh rëndësinë e këtij plenumi, në emër të Byrosë Politike propozoj që në vend të këtij projektvendimi, që është paraqitur, të bëhet një rezolucion, i cili të jetë në lartësinë e nivelit të plenumit dhe të korrespondojë me rëndësinë dhe detyrat e mëdha që shtron plenumi për gjithë Partinë dhe punonjësit. Prandaj propozoj që projektvendimi të ripunohet. Në rast se shokët kanë propozime të tjera orientuese për çështjet kryesore, le t'i japin. Për të hartuar rezolucionin në bazë të raportit dhe të të gjitha propozimeve dhe sugjerimeve që u bënë në plenum, propozoj të ngarkojmë një komision. Për hartimin e tij të japim një javë afat dhe ta mbledhim Komitetin Qendror të hënën tjetër, më 26 prill. Ne do t'ua dërgojmë shokëve që të shtunën projektrezolucionin e përgatitur dhe të hënën të bëjmë mbledhjen ku do të jepen vërejtjet që do të ketë secili.

Të gjithë e kuptojmë rëndësinë e këtij plenumi. Këtu u theksua çështja e metodës së punës. Tani pa humbur kohë, ne duhet të punojmë për zbërthimin e të gjitha detyrave që shtroi Plenumi i Komitetit Qendror. Në radhë të parë këtë punë duhet ta bëjmë me forumet drejtuese, pastaj secili pjesëtar i forumit si përgjegjës për sektorin që drejton ta punojë me vartësit e tij që ata të jenë të pregatitur kur të dalë rezolucioni dhe të vendoset punimi i tij në të gjithë Partinë. E kam fjalën që drejtoritë e aparatit të Komitetit Qendror të mos mendojnë se u bë plenumi dhe mbaroi puna e tyre, por ta sistemojnë punën e të mobilizohen që të gjithë. Nga protokollit që u mbajt në plenum, nga projektvendimi dhe raporti të nxirren të gjitha problemet kryesore që kërkojnë zgjidhje dhe unë i propozoj Komitetit Qendror që çështjet, të cilat u ngritën këtu për studim, t'i ngarkohen Byrosë Politike, Sekretariatit dhe qeverisë, që, me porosi të Komitetit Qendror, këto studime të bëhen sa më parë. Për realizimin e çështjeve që janë vendosur në plenum duhet të shumëfishohet mobilizimi. Që nesër drejtoritë e aparatit ta marrin këtë punë në dorë. Kjo nuk do të thotë që të tëra punët e aparatit tonë të blokohen vetëm me këto probleme, por këto çështje të na vijnë sa më parë. Për to mund të caktojmë edhe afatet.

Unë mendoj se edhe planin e punës, që kemi propozuar për Byronë Politike, duhet ta rishikojmë në frymën e detyrave të këtij plenumi. Edhe qeverisë t'i thuhet ta rishikojë planin e punës së vet duke pasur parasysh këto probleme që do të zgjidhen dhe që i ka vendosur Komiteti Qendror.

Tani ne si udhëheqës e bashkë me ne të gjithë kua-

drot kryesorë si dhe shtabet e çdo dikasteri, që e dinë se u bë Plenumi i Komitetit Qendror, si në qendër dhe poshtë, në komitetet e Partisë, mbasi të dalë edhe një komunikatë, duhet të bëjmë mbledhje të shkurtëra ku të vihen shokët në korrent. Prandaj gjithsecili nga ne, ministra apo sekretarë, duhet që një ose dy ditë të punojë me këto probleme. Shokët, për problemet që u shtruan dhe u diskutuan këtu, duhet të reflektojnë mirë, të mbledhin shokët kryesorë të sektorëve që drejtojnë dhe të shtrojnë në esencë vendimet dhe detyrat që dalin nga plenumi. Nuk duhet të nxirren shifrat, por masat që nxori plenumi, kritika që ai i bëri punës dhe kjo, lidhur me sektorët përkatës. Shokëve t'u jepet orientimi, po të mos bëhen mbledhje me ditë të tëra, por 1-2 orë. Pastaj shokët tuaj përsëri, edhe ata, duhet t'i përpunojnë këto detyra, t'i tretin mirë dhe në shkallën e tyre të thërresin, edhe ata, drejtorët, shefat etj. Në këtë mënyrë të merren sa më parë masa dhe të ndreqen gabimet. Pra të mobilizohet Partia 20-25 ditë më përpara, të marrë hov puna pse kështu njerëzit që do të vijnë në aktivet e Partisë do të jenë shumë më të mobilizuar. Prandaj propozoj të praktikohet kjo që thashë, d.m.th. që zëvendësministrat të mblidhen në kolegjiun dhe t'u thuhet se në mbledhjen e Komitetit Qendror kemi bërë këto dhe këto, se ai na kritikoi për këto dhe këto të meta e dobësi. Kjo është një gjë shumë pozitive dhe tani këto masa t'i marrim me rekomandim të Komitetit Qendror.

Pastaj është çështja e zbatimit të vendimeve. Të gjitha vendimet duhet të zbatohen, fryma e rutinës këtu duhet luftuar, sepse është vënë re që një sektor e

bën një detyrë, një tjetër nuk e bën. Nuk ka sinjalizime nga anëtarët e Komitetit Qendror pranë Byrosë Politike ose Sekretariatit që të thuhet se ky vendim që është marrë nga Komiteti Qendror në këtë dhe këtë pikë nuk po ecën, se «gjejmë pengesa këtu dhe këtu». Mua më duket se këto sinjalizime duhet të bëhen pa prituri që Byroja Politike të mblidhet, që të merren masa me kohë, d.m.th. të gjithë shokët të kontrollojnë si po zbatohen detyrat jo vetëm në sektorët e tyre, por edhe atje ku drejtojnë shokët e tjerë.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

FJALA NË MITINGUN E ORGANIZUAR NE TIRANË ME RASTIN E INAUGURIMIT TË MONUMENTIT TË V. I. LENINIT

22 prill 1954

Shokë dhe shoqe,

Sot është përvjetori i tetëdhjetekatër i lindjes së V.I.Leninit, gjeniut të madh të Revolucionit, themeluesit të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të shtetit sovjetik. Për mësuesin dhe udhëheqësin e madh të të gjithë punonjësve të mbarë botës, mësimet e të cilit janë në bazë të të gjitha fitoreve të shkëlqyera të popullit tonë, për Vladimir Iliçin, në shenjë dashurie për të dhe besnikërie të pafund ndaj leninizmit, populli ynë ngre sot, në një nga parqet më të bukura të kryeqytetit, këtë monument.

Një ditë pas vdekjes së Leninit, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Bolshevike të Bashkimit Sovjetik, në mesazhin që i drejtonte partisë dhe të gjithë punonjësve, në mes të të tjerave shkruante:

«Kurrë, që nga Marksi, historia e lëvizjes së madhe të çlirimit të proletariatit nuk ka lindur një figurë kaq gjigande sa udhëheqësin tonë, edukatorin dhe mi-

kun që humbëm. Çdo gjë madhështore dhe heroike që ekziston te proletariati, shpirti i guximshëm, vullneti i hekurt, i papërkulshëm kurrë, këmbëngulës dhe triumfues, urrejtja e shenjtë, urrejtja e tmerrshme kundër skllavërisë dhe shtypjes, pasioni revolucionar që trondit malet, besimi i pakufishëm në forcat krijuese të masave, gjeni i madh i organizimit, të gjitha këto kanë gjetur shprehjen e shkëlqyer te Lenini, emri i të cilit është bërë simbol i botës së re që nga perëndimi e deri në lindje, që nga veriu e deri në jug».

I tillë ishte Lenini i madh që themeloi Partinë e madhe Komuniste të Bashkimit Sovjetik, atë parti që ai e quante «... mendjen, nderin dhe ndërgjegjen e epokës sonë»¹. I tillë ishte Lenini i madh që kaliti Partinë Bolshevike, e edukoi dhe e udhëhoqi në Revolucionin e madh të Tetorit, që tronditi nga themelet sistemin kapitalist dhe çliroi një të gjashtën e botës nga thonjtë e tij të përgjakshëm.

Lenini e filloi luftën e tij madhështore në arenën revolucionare të klasës punëtore, në momente kritike të historisë së njerëzimit, në momentet kur kapitalizmi kishte hyrë në fazën e tij të fundit, në fazën e kalbëzimit, në fazën e imperializmit. Si vazhdues gjenial i Marksit dhe i Engelsit, Lenini e zhvilloi marksizmin në konditat e reja historike dhe ju desh që në fillim të aktivitetit të tij revolucionar të zhvillonte një luftë titanike për organizimin e proletariatit rus dhe ndërkombëtar, për edukimin e tij dhe për përgatitjen e tij për revolu-

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 25, f. 303.

cion. Borgjezia kapitaliste dhe shërbëtorët e saj, renegatë të klasës punëtore, të tmerruar nga forca e pamposhtur e marksizmit që po frymëzonte proletariatin në luftë kundër shtypjes kapitaliste, bënë çmos, jo vetëm duke shtypur në gjak çdo lëvizje punëtorësh, por me çdo mënyrë ata përpiqeshin të deformonin marksizmin. Lenini u tregua i pamëshirshëm kundër deviatorëve dhe tradhëtarëve të marksizmit dhe organizoi në një mënyrë të përsosur forcat e proletariatit në luftë kundër shtypjes dhe skllavërisë.

Lenini zbuloi në mënyrë shkencore se kapitalizmi monopolist shkon drejt greminës me katastrofa të vazhdueshme, me kriza dhe me luftëra të përgjakshme, për të grabitur, për të pasuruar një grusht miliardësh dhe për të hedhur në kasaphana të përgjakshme popujt. Lenini demaskoi pa mëshirë përpara njerëzimit mjerimet dhe tmerret e papërshkrueshme që shkaktonte imperializmi me krizat dhe luftërat e tija. Në mënyrë shkencore ai tregoi arsëyet e këtyre krizave dhe luftërave, përcaktoi metodat dhe masat që duhej të merrte proletariati dhe gjithë masat joproletare, të shtypura e të skllavëruara, për të shkëputur përgjithmonë prangat e robërisë kapitaliste.

Vladimir Iliç Lenini, zbuloi ligjin që triumfi i socializmit është i mundshëm në një numër vendesh ose edhe në një vend kapitalist të vetëm.

Ashtu si e parashikonte Lenini ngjau. Idetë gjeniale të Leninit u realizuan shkëlqimisht nga proletariati i Rusisë i cili, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste Bolshevike të Bashkimit Sovjetik, me Leninin në krye, triumfoi mbi carizmin e egër, mbi borgjezinë kapitaliste,

mbi intervencionistët dhe vendosi në një të gjashtën e botës diktaturën e proletariatit.

Fitorja e Revolucionit të madh socialist të Tetorit hapi për njerëzimin një epokë të re, epokën e shkatërrimit të kapitalizmit dhe të triumfit të socializmit e të komunizmit. Lenini themeloi shtetin e parë socialist në botë, shtetin e punëtorëve dhe të fshatarëve, Bashkimin e lavdishëm Sovjetik, i cili u bë kështjella e pamposhtur e paqes, e demokracisë dhe e socializmit. Lenini zbuloi pushtetin e Sovjetëve si formë politike të diktaturës së proletariatit dhe tezën se diktatura e proletariatit është një formë specifike e aleancës së klasës punëtore me masat e tjera joproletare, ku drejtimin në këtë aleancë e ka klasa punëtore.

Lenini i madh, pas triumfit të Revolucionit të madh të Tetorit, përcaktoi rrugën dhe përpunoi planin konkret të ndërtimit të socializmit në Bashkimin Sovjetik. Ai zbuloi rrugët e kalimit të Bashkimit Sovjetik për në komunizëm. Lenini ndërtoi programin shkencor të transformimit ekonomik të Rusisë së prapambetur në një shtet të fuqishëm socialist. Ai përcaktoi rrugët e industrializimit socialist, të elektrifikimit, të kooperativizmit dhe të revolucionit të madh kultural. Lenini thoshte se vetëm kalimi në regjimin socialist mund t'i shpëtojë punëtorët dhe gjithë punonjësit nga mizerja dhe nga vuajtjet dhe vetëm regjimi socialist krijon për ata të gjitha mundësitë për të ndërtuar jetën e re, të lirë dhe të begatshme. Gjithë jetën e tij V.I.Lenini ja kushtoi kauzës së çlirimit të punonjësve prej shtypjes dhe shfrytëzimit.

Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, nën udhë-

heqjen e Komitetit Qendror me J.V.Stalinin në krye. vazhduesin e madh të veprës së Leninit, udhëhoqi popullin sovjetik në fitoren e socializmit dhe realizoi programin e madh të ngritjes së vazhdueshme të mirëqenjes materiale dhe kulturele të punonjësve. Uniteti moralo-politik, miqësia e madhe e popujve që formojnë Bashkimin Sovjetik, patriotizmi i zjarrtë sovjetik, u rezistuan si shkëmb graniti stuhive të tmerrshme dhe sot më shumë se kurdoherë tjetër forcat e pamposhtura të paqes dhe të socializmit po shtohen dhe forcohen çdo ditë. Bashkimi Sovjetik dërmoi pa nishan hordhitë hitleriane dhe çliroi botën nga fashizmi. Shkatërrimi i fashizmit ishte triumfi i forcave socialiste dhe dobësimi i imperializmit ndërkombëtar.

Duke ndjekur me besnikëri porositë e Leninit Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe qeveria sovjetike, po forcojnë gjithnjë më shumë shtetin sovjetik, aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë kolkoziane, unitetin moralo-politik të shoqërisë sovjetike. miqësinë midis popujve të Bashkimit Sovjetik, ato kujdesen vazhdimisht për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe të kulturës, për ngritjen gjithnjë më tepër të mirëqenjes së masave punonjëse.

Nën udhëheqjen e Partisë Komuniste dhe të qeverisë sovjetike, populli sovjetik, plot forca krijuese, po lufton për zbatimin e programit të madh të ndërtimit të komunizmit në Bashkimin Sovjetik.

Që të nesërmen e fitores së Revolucionit të madh socialist të Tetorit, V.I.Lenini shpalli dekretin e paqes midis popujve, politikë kjo që përbën bazën e regjimit socialist dhe atë të politikës konsekuente paqësore të

jashtme të qeverisë sovjetike. Lenini thoshte vazhdimisht se Bashkimi Sovjetik që lufton për paqen e gjen të mundshme bashkëjetesën paqësore të të dy sistemeve socialiste dhe kapitaliste.

Leninizmi, pra, ka qenë, është dhe do të jetë kurdoherë flamuri i madh i luftës së popujve për një paqe të drejtë dhe të vazhdueshme.

Idetë e Leninit janë bërë drita e popujve që po ndërtojnë jetën e re, ato u ndriçojnë gjithë popujve të botës rrugën e luftës për paqen, demokracinë dhe socializmin.

Borgjezia dhe shërbëtorët e imperializmit lehin çdo ditë, duke thënë se marksizëm-leninizmi është «një çështje e përkohshme», se «i ka kaluar koha». Por nga të tilla profka pak njerëz gënjehen. Leninizmi po përhapet në të gjithë botën. Idetë e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit janë të pamposhtura, ato do të triumfojnë në të gjithë botën, pse janë shprehja më e zjarrtë e dëshirave, aspiratave dhe e ndjenjave më të pastra të njerëzve të thjeshtë që përbëjnë pjesën dërmuese të njerëzimit.

Partitë komuniste dhe punëtore në të gjithë botën janë bërë forcat ngadhënjimtare që udhëheqin popujt në rrugën e paqes, të demokracisë dhe të socializmit. Lenini thoshte se e ardhshmeja u përket komunistëve.

Idetë e Leninit, idetë e Revolucionit të Tetorit i ndriçuan rrugën edhe popullit tonë për të hequr qafe shtypjen dhe shfrytëzimin e klasave feudalo-borgjeze. Populli ynë pa te shteti sovjetik mikun e tij më të madh, besnik dhe të fortë.

Në të gjithë veprimtarinë e saj Partia jonë është

mbështetur në mësimet e Leninit të madh. E armatosur me këto mësimë, ajo u vu në krye të të gjitha masave punonjëse dhe i udhëhoqi këto në fitore të plotë mbi zaptuesit fashistë dhe tradhëtarët e vendit për çlirimin e atdheut dhe për vendosjen e pushtetit popullor.

Mësimet e Leninit e kanë ndriçuar dhe do ta ndriçojnë gjithmonë Partinë e Punës në rrugën e saj të lavdishme për ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Duke luftuar në krye të masave punonjëse, Partia jonë ka zhvilluar me ritme të shpejta industrinë, ka arritur suksese të dukshme në bujqësi dhe në sektorët e tjerë të ekonomisë popullore, ka zhvilluar kulturën dhe si rezultat i të gjitha këtyre sukseseve është përmirësuar jetesa e popullit, është ngritur niveli kultural i masave punonjëse, është forcuar Republika jonë Popullore.

E ndriçuar nga mësimet e Leninit, Partia jonë punon vazhdimisht për forcimin e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse që përbën bazën e regjimit tonë të demokracisë popullore.

Partia jonë, duke u bazuar në mësimet e Leninit, forcon gjithnjë më tepër lidhjet e saja me popullin. Uniteti i Partisë dhe i popullit është kyçi i të gjitha fitoreve tona. Këtë unitet të çelniktë e treguan më së miri zgjedhjet e këshillave popullore dhe do ta tregojnë edhe një herë akoma zgjedhjet e deputetëve për në Kuvendin Popullor, ku populli ynë do të përkrahë njëzëri kandidatët e Frontit Demokratik.

Të gjitha fitoret që ka korrur populli ynë ja detyron forcës jetëdhënëse të ideve të leninizmit.

Populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë së Punës, do

t'i zhvillojë edhe më tej këto fitore duke ecur me vendosmëri në rrugën e socializmit, duke luftuar me të gjitha forcat e tija për ruajtjen dhe forcimin e paqes në botë. Duke u ndriçuar nga idetë ngadhënjimtare të Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinit dhe duke pasur ndihmën e Bashkimit Sovjetik në radhë të parë dhe të vendeve të demokracisë popullore, populli ynë do të triumfojë kurdoherë mbi armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm të vendit tonë, do të ndërtojë jetën e tij të re e të lumtur, do të vazhdojë ta përmirësojë çdo ditë e më tepër jetën e të gjitha masave punonjëse.

Populli shqiptar, duke ndjekur me besnikëri mësimet e Leninit do t'i shtërngojë radhët rreth Partisë së Punës dhe qeverisë, do të ruajë si sytë e ballit Partinë e tij, do të forcojë Republikën Popullore dhe do të jetë kurdoherë vigjilent ndaj armiqve që kërcënojnë atdheun, paqen, demokracinë dhe socializmin.

Emri i Leninit do të rrojë gjatë shekujve në zemrat e popullit tonë. Populli ynë do të ruajë të gjallë, brez pas brezi, kujtimin e të madhit Vladimir Iliç Lenin dhe do t'i jetë mirënjohës në shekuj.

Lavdi kujtimit të Leninit të madh!

Lavdi leninizmit!

Rroftë miqësia e pathyeshme dhe e përjetshme që lidh popullin shqiptar me popujt vëllezër të Bashkimit Sovjetik!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 96 (1736), 23 prill 1954

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

MBI DISA DETYRA PËR FORCIMIN E PUNËS NË KOMBINATIN E TEKSTILEVE «STALIN»

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

3 maj 1954

Jam dakord me gjithshka që u tha këtu nga shokët e tjerë të Byrosë. Është e vërtetë se ne për herë të parë po e shqyrtojmë në Byronë Politike punën e Kombinatit të tekstileve «Stalin», por ky kombinat, siç dihet, ka qenë preokupacioni ynë i vazhdueshëm dhe ne hallet e tij i dinim edhe më përpara se të merrnim këtë raport. Megjithkëtë, mendimi im është se Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit duhet të preokupohej më tepër dhe në mënyrë shumë më aktive për nevojat që ka pasur kombinati i tekstileve, pavarësisht se ai duhej të mobilizohej edhe vetë akoma më shumë, veçanërisht për të pasur mirë në evidencë se cilat vegla të ndërrimit mungojnë dhe si duhet luftuar për t'i siguruar ato. Pi-

¹ Në këtë mbledhje u analizua puna dhe gjendja e Kombinatit të tekstileve «Stalin» në tremujorin e parë të vitit 1954.

kërisht për sigurimin e këtij materiali të nevojshëm për kombinatin si dhe për perspektivat e zhvillimit dhe për-mirësimit të prodhimit të tij duhet të interesohej më mirë Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit. Në këto dy çështje ajo nuk duhej t'i lejonte vetes neglizhenca.

Po të shikojmë mirë mungesat e materialeve nuk gabojmë të themi se ka shumë prej tyre që mund të prodhohen këtu dhe, në fakt, një pjesë e veglave të shkëmbimit po bëhen, ndërsa një pjesë tjetër po zvarriten. Mendimet se çdo gjë duhet ta sjellim nga jashtë, nuk janë të drejta. Atë që mund ta prodhojmë në vend, pse duhet ta importojmë? Përkundrazi, të çajmë rrugën, me kokë dhe me këmbë dhe ta sigurojmë këtu. Të marrim si shembull çështjen e kadifesë. Mua më duket se kjo mund të bëhet shumë mirë te ne. Edhe sovajkat mund të bëhen këtu dhe s'jam dakord me mendimin se «për prodhimin e tyre duhen bërë edhe 5 vjet eksperimente»! Sigurisht kjo nuk bëhet si deri tani duke marrë ahun nga stiva, po duke bërë përpjekje, jo në teori, po në praktikë, në luftë. Edhe në Uzinën «Enver» ka filluar të bëhet diçka, por ndonjë interesim të veçantë nga Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit për këto çështje s'ka pasur, prandaj kjo ministri po kritikohet vazhdimisht për këto çështje. Këto kritika që janë plotësisht të drejta bëhen jo vetëm nga Komiteti Qendror, nga Byroja Politike por ato u bënë edhe nga Konferenca ekonomike. Janë të gjitha mundësitë që, me një interesim më të madh të Ministrisë së Industrisë dhe duke u aktivizuar më mirë punëtorët dhe personeli inxhiniero-tek-nik i kombinatit të tekstileve, mund të prodhohen në vend mjaft materiale nga ato që kërkohen të importohen.

Çështja e perspektivës së kombinatit ka rëndësi të madhe. Ne nuk mund të qëndrojmë këtu ku jemi sot. Në rast se themi «nuk bëhet kjo ose nuk bëhet ajo», se «duhen aq ose kaq maqineri» etj., bëjmë gabim të madh. Le t'i sjellim ato që duhen, të cilat janë jashtë mundësive tona, puna është që të mendojmë edhe si mund të bëjmë vetë, pse kështu do t'i sigurojmë popullit bashkë me ngritjen e tij ekonomike dhe kulturele, edhe stofra sipas gustos dhe dëshirës së tij, ndryshe do të na mbetet prodhimi pa shitur dhe pas tre vjetësh do të themi pse nuk morëm masa më përpara. Prandaj duhet të luftojmë kundër ngurrimit që shfaqet në këtë drejtim dhe të bëjmë që kombinati të përparojë. Atje duhet të punojmë për edukimin dhe perfeksionimin e kuadrit, për ngritjen e shkollës, që njerëzit të përvetësojnë mirë teknikën. Këto janë problemet kryesore, se me të vërtetë do të sjellim vegla, po duhen edhe njerëz që t'i përdorin ato. Për këtë arsye nuk duhet të qëndrojmë në vend. Stofi është artikulli bazë për popullin. Kombinati ka marrë e po merr inisiativa për zgjidhjen e problemeve, prandaj është e domosdoshme që ministria t'u përgjigjet më mirë këtyre inisiativave, t'i inkurajojë punëtorët dhe të shkojë në mbledhje të qeverisë me kërkesa të drejta.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

FJALA PARA ZGJEDHËSVE TË ZONËS ELEKTORALE NR. 107 TË TIRANËS

12 maj 1954

Të dashur shokë dhe shoqe,

Ju falenderoj nga zemra për nderin e madh që më bëtë dhe besimin që treguat ndaj meje duke më propozuar si kandidat për deputet në Kuvendin Popullor. S'ka asnjë dyshim se ky besim i madh, i juaji, është për Partinë e lavdishme të Punës, udhëheqësen e urtë dhe heroike të popullit tonë, farkëtare e të gjitha fitoreve që kanë korrur masat e gjera punonjëse të vendit tonë.

Unë ju siguroj se do të shkrij deri në fund të gjitha energjitë e mia për ta merituar këtë besim dhe këtë nder të madh që më bëhet. Si bir i Partisë dhe i popullit, do të luftoj me të gjitha forcat e mia për triumfin e kauzës së madhe të Partisë që është kauza e shenjtë e popullit, do të luftoj deri në fund për begatinë e popullit dhe të atdheut tonë të lirë dhe të bukur, do të luftoj për socializmin nën flamurin ngadhënjimtar të marksizëm-leninizmit.

Kanë kaluar katër vjet që nga zgjedhjet e legjislaturës së dytë. Gjatë këtyre viteve janë zhvilluar ngjar-

je me rëndësi dhe janë arritur suksese të mëdha. Gjatë kësaj kohe një nga vendimet historike me rëndësi ka qenë aprovimi, nga Kuvendi Popullor, i planit të parë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës. Të gjithë punonjësit e vendit tonë po luftojnë sot për realizimin dhe tejkalimin e planit të vitit të katërt të pesëvjeçarit.

Jemi para 10-vjetorit të çlirimit të atdheut nga robëria fashiste. Populli ynë do ta festojë këtë ditë me krenari dhe me suksese të shumta që ai ka korrur gjatë kësaj periudhe të shkurtër, por të lavdishme. Fitoret e mëdha që populli korri nën udhëheqjen e Partisë së tij heroike gjatë Luftës nacional-çlirimtare, i çelnikosi dhe i zhvilloi edhe më tej gjatë kësaj periudhe. Atdheu ynë ka përparuar dhe ka ndryshuar pamje. Ekonomia jonë është forcuar shumë në krahasim me të kaluarën. Janë arritur suksese të rëndësishme në industrializimin e vendit, janë hedhur bazat e shëndosha të industrisë sonë të lehtë, ka përparuar bujqësia, janë zhvilluar në një shkallë të gjerë, që s'është parë ndonjëherë, arësimi dhe kultura dhe këto janë bërë të masave të gjera punonjëse. Këto suksese u arritën pse Partia me programin e saj të qartë dhe tejpamës diti të mobilizojë masat e popullit dhe t'i frymëzojë ato me besim dhe me entuziazëm të papërshekruar në forcat e pashtershme të popullit, diti të zhvillojë dhe të drejtojë iniciativën e madhe të masave punonjëse, të vlerësojë si duhet cilësitë e njerëzve dhe krijimet e tyre, diti të frymëzojë punonjësit me një patriotizëm të shkëlqyer ndaj atdheut, ndaj vlerave kombëtare, ndaj leninizmit, bazës ideologjike të pushtetit tonë popullor. Partia me vijën e saj

politike të drejtë çelnikosi unitetin e popullit dhe kjo u pasqyrua edhe një herë tjetër në mënyrë të shkëlqyer në votimet e fundit për pushtetin popullor, çelnikosi aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse, bazë e pushtetit të demokracisë popullore. Në këtë mënyrë vendi ynë nga një vend i prapambetur, i përbuzur, i shtypur, filloi të lulëzojë, të marrë vendin e tij të merituar në arenën ndërkombëtare, të respektohet dhe të nderohet nga shtetet përparimtare dhe të gëzojë simpatinë dhe përkrahjen e të gjithë popujve të botës. Këto janë fitore të shkëlqyera që s'ka forcë në botë që mund t'i errësojë me shpifje dhe gënjeshtër. Populli shqiptar, si të gjithë popujt e botës, pati fatin e madh të kishte përkrah tij një mik të madh, Bashkimin Sovjetik. Ne ndërtojmë bazat e socializmit në vendin tonë dhe në këtë rrugë të lavdishme ne kemi pasur e kemi ndihmën e Bashkimit Sovjetik në radhë të parë dhe të vendeve të demokracisë popullore.

Periodha prej dhjetë vjetësh s'është një kohë e gjatë në jetën e një populli, por brenda kësaj periudhe të shkurtër po t'u hedhim një sy fluturimthi realizimeve, do të shohim se ato janë aq të konsiderueshme saqë kanë çarmatosur skeptikët dhe kanë tronditur edhe mbeeturinat e atyre që nuk ja duan të mirën popullit tonë. Faktet tregojnë vetë dhe faktet janë kryeneçe. Në vendin tonë nuk ka pasë ekzistuar fare industria, kurse tash janë ngritur Kombinati i tekstileve «Stalin», fabrika e sheqerit, kombinati i drurit, fabrikat e zhveshjes së pambukut, fabrika çimentoje, uzina të ndryshme mekanike, fabrika e fermentimit të duhanit, fabrika e këpucëve, fabrika e tekstileve të leshta, fabrika cigaresh,

fabrika lëkurësh, fabrika makaronash, fabrika për përpunimin e frutave e shumë të tjera. Janë ndërtuar fabrika për lëndë ndërtimi, një numër i madh sharrash, zdrucktari të shumta për mobilje dhe orendi shtëpiake, fabrika tullash, fabrika oksigjeni e shumë ndërmarrje të tjera që është e tepërt t'i numërojmë këtu.

Në sektorin e minierave janë bërë përpertime të mëdha. Kantieret e naftës janë zgjeruar, zmadhuar, pajisur me mjete moderne dhe po bëhen kërkime për zgjerime akoma më të mëdha. Te ne nxirret qymyr, bakër, krom, bitum. Kërkimet gjeologjike kanë zbuluar sasi të mëdha mineral hekuri.

Në fushën e elektrifikimit është ecur shumë përpara. Qytetet e mëdha dhe të vogla sot ndriçohen me elektrik, i cili përhapet edhe në mjaft fshatra që deri dje kanë përdorë për ndriçim pishën dhe gazin. Industria jonë gati e gjitha vihet në lëvizje me anën e korrentit; është ndërtuar Hidrocentrali «Lenin», po ndërtohet hidrocentrali i madh mbi lumin e Matit, janë ndërtuar termocentrale të fuqishme dhe të gjitha këto së bashku në pjesën më të madhe të vendit janë lidhur dhe do të lidhen me një rrjet të gjerë elektrifikimi.

Në lëmin e transportit janë bërë hapa përpara, një numër i konsiderueshëm automjeteve të çdo lloji dhe të tonazheve të ndryshme përshkojnë rrugët e vendit tonë; janë ngritur dhe zgjeruar shërbimet urbane dhe interurbane dhe janë vënë në shërbim të popullit automjete të shumta e moderne. Te ne janë ndërtuar vija hekurudhore që lidhin qytete dhe kantiere të ndryshme.

Mendoni pak, shokë dhe shoqe, në ç'mizerje ndodhej populli ynë në regjimet shtypëse të së kaluarës,

kur të gjitha këto që numërova ai nuk i kishte. Populli në të kaluarën kishte vetëm kërbacin në kokë, litarin në fyt, fajdexhinjtë në kurriz, tregëtarët spekulatorë e okupatorët e huaj që e ripnin dhe mizerjen, urinë, sëmundjet, errësirën në vatër e në shpirt dhe në trupin e tij plot plagë. Të gjitha këto mjerime populli ynë i flaku tej me pushkë në dorë. Ai propozoi të kaluarën dhe i futi në varr të gjithë ata që kërkonin t'i bënin varrin. Ja ç'i dha Partia heroike e Punës e Shqipërisë, ja ç'i dha leninizmi popullit heroik shqiptar. E gjithë kjo pasuri tash është e popullit.

Suksesi ynë nuk ka konsistuar vetëm në ndërtimin e kësaj industrie, por edhe në shfrytëzimin e saj në interes të popullit. Në fund të vitit 1953 prodhimi industrial arriti në gati tetë miliard e gjysmë lekë që është baras me 9 herë e gjysmë kundrejt paraluftës ose 2,6 herë në krahasim me vitin 1950. Në degët e ndryshme të industrisë prodhimi është shtuar dhe në krahasim me vitin 1950, viti 1953 ka shënuar këto shifra: në minierat 114 për qind, në industrinë ushqimore 401,3 për qind, në industrinë e veshmbathjes 546,3 për qind, në industrinë e materialeve të ndërtimit 246,7 për qind, në industrinë mekanike 238,9 për qind, në industrinë lokale 538,9 për qind dhe në kooperativat e artizanatit 436 për qind. Është një sukses i madh që vitin e kaluar u prodhua në vend: sheqer më tepër se 90 000 kuintalë, tekstile më tepër se 13 milion e gjysmë metra linear e kështu me radhë. Është rritur për çdo frymë në vitin 1953 në krahasim me vitin 1950 furnizimi i punonjësve me mallra të konsumit të gjerë, si më poshtë: sheqer 152 për qind, tekstile të pambukta 174 për qind, këpucë 155

për qind, opinga 150 për qind, sapun 170 për qind etj. Numri i punëtorëve në vitin 1953 është rritur mbi 70 për qind në krahasim me vitin 1950 dhe fondi i pagave është rritur mbi 80 për qind më tepër se në vitin 1950. Që prej vitit 1950 dhe deri në fillim të vitit 1954, janë investuar vetëm për banesa dhe objekte të tjera, për përmirësimin e konditave të jetesës së punonjësve, një miliard e 58 milion lekë. Këto rezultate, natyrisht, kanë përmirësuar mirëqenjen materiale dhe kulturele të punonjësve të vendit tonë.

Në sektorin e bujqësisë, megjithëse ka akoma prapambetje, ne kemi përparime të dukshme që s'kanë krahasim me të kaluarën. Këto suksese u arritën në saje të reformës agrare që e bëri fshatarin punonjës zot të tokës, në saje të përpjekjeve dhe të punës së palodhshme të fshatarësisë sonë patriotike, në saje të politikës së drejtë të Partisë dhe të qeverisë dhe në saje të ndihmës së gjithanshme që shteti u jep fshatarëve për ngritjen e bujqësisë. Bujqësia jonë e ka tejkaluar në mënyrë të dukshme nivelin e paraluftës, qoftë përsa i përket sipërfaqes së punueshme, qoftë rritjes së rendimenteve në kultura. Sipërfaqja e tokës së punueshme është rritur 64 për qind dhe prodhimi i drithërave të bukës 58 për qind më shumë se në vitin 1938. Gjatë tre vjetëve të parë të planit pesëvjeçar janë zgjeruar kulturat e reja industriale siç janë pambuku dhe panxhar sheqeri dhe furnizojmë rregullisht me lëndë të parë industrinë tonë. Në vendin tonë, ku nuk njihej mekanika bujqësore, sot punojnë me qindra traktorë, maqina shirëse, kombajna, numri i të cilave shtohet çdo vit e më shumë. Me investimet që janë bërë për ndërtimin e

veprave ujitëse sipërfaqja e ujitshme arrin në 72.000 hektarë tokë e mbjellë që do të thotë 17.000 hektarë më shumë se në vitin 1953. Me veprat që janë kryer deri sot dhe me ato që do të kryhen deri në vitin 1957 sipërfaqja që do të ujitet do të arrijë në 107.000 hektarë që do të thotë 1/4 e gjithë sipërfaqes së punueshme të vendit tonë. Nga veprat e mëdha të bonifikimit që janë kryer deri sot janë përfutuar dhe janë vënë nën kulturë 6.105 ha. tokë dhe janë përmirësuar 41.428 ha. të tjerë. Për sivjet do të investohen afro 319.000.000 lekë për bonifikime dhe ujitje. Shteti do t'i vërë rëndësi të madhe çështjes që fshatarësia në vitet e ardhshme të plotësojë nevojat e veta me vegla hekuri të cilat do të influencojnë akoma më shumë në rritjen e prodhimit agrar. Partia dhe qeveria jonë sot, më tepër se kurrë, kanë ngritur me forcë zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë. Edhe Plenumi i Komitetit Qendror i dhjetorit të vitit të kaluar dhe ai i prillit të këtij viti, e ngritën me forcë këtë dhe vunë detyra për çdo punonjës të bujqësisë dhe të ekonomisë. Plenumet e lartpërmendura të Komitetit Qendror theksuan se një nga detyrat më kryesore është zhvillimi i gjithanshëm i bujqësisë dhe i blegtorisë, sigurimi i bukës në vend, rritja e vazhdueshme e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale për ushqimet e popullsisë dhe rritja e prodhimeve të bimëve industriale për të siguruar lëndën e parë për industrinë tonë dhe për eksportin.

Sektori socialist i bujqësisë nga viti në vit është zgjeruar dhe, megjithëse i vogël në krahasim me ekonominë bujqësore individuale, ai luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë. Koopera-

tivat bujqësore, me gjithë të metat organizative që kanë, janë bërë shembull i mirë për fshatarësinë punonjëse, ato janë forcuar dhe kanë shtuar të ardhurat. Ato kanë pasur suksese në organizimin kolektiv të prodhimit, kanë arritur rendimente të larta në të gjitha kulturat dhe janë bërë baza të shëndosha për zhvillimin e mëtejshëm të kolektivizimit në vendin tonë. Gjatë viteve që na ndajnë nga votimet e kaluara për deputetët në Kuvendin Popullor, prodhimet bujqësore në vitin 1953 në krahasim me vitin 1950 janë rritur si më poshtë: gruri 143,3 për qind, misri 145,5 për qind, thekra 168,7 për qind, orizi 226,7 për qind, pambuku 160 për qind, duhani 225 për qind, panxhari i sheqerit 1 217 për qind dhe perimet 138,7 për qind. Në blegtori janë arritur suksese në ndalimin e rënjes së numrit të bagëtive dhe janë shënduar ngritje dhe shtesa në krahasim me vitet e mëparshme. Dihen prej të gjithëve masat që mori qeveria vjet dhe sivjet në favor të fshatarësisë. Ulja e detyrimeve, ulja e tatimeve bujqësore. Shtimi i stimujve dhe ngritja e çmimeve të disa kulturave industriale në favor të fshatarësisë e kanë entuziazmuar shumë fshatarësinë tonë dhe ajo po hidhet më me hov në punët bujqësore. Fshatari e shikon shumë qartë kujdesin e madh që tregon Partia dhe qeveria për të dhe ai i është përveshur punës për të prodhuar sa më shumë për vete dhe për të gjithë punonjësit e vendit. Me gjithë dimrin e ashpër të sivjetshëm dhe shirat e vazhdueshme, fshatarësia jonë është mobilizuar për të korrur më shumë grurë e misër, më shumë pambuk, panxhar sheqeri dhe duhan, më shumë fruta dhe pe-

rime, në mënyrë që populli ynë të furnizohet më me bollëk se vitin e kaluar.

Arësimit dhe kulturës Partia dhe qeveria i kanë vënë dhe do t'i vënë vazhdimisht një kujdes të madh. Duhet të luftojmë me çdo kusht prapambetjen, injorancën, errësirën ku e kishin mbajtur popullin tonë regjimet shtypëse. Populli ynë, një popull përparimtar, është i etur për dituri dhe në mënyrë të çuditshme ai e përvetëson atë. Me mijëra e me mijëra numërohen kuadrot që kanë mësuar në vendin tonë gjatë periudhës së shkurtër prej dhjetë vjetësh. Drejtimi i shtetit, drejtimi i qindra ndërmarrjeve, drejtimi i kombinateve, i maqinerive nga më modernet, bëhet nga bijtë dhe bijat e thjeshta të popullit, që dhjetë vjet më parë dinin shumë pak për të mos thënë aspak dhe tash janë bërë njerëz me kulturë, me zotësi. As ka të krahasuar numri i shkollave që ka hapur pushteti popullor me numrin e shkollave në të kaluarën. Në vitin 1938 në vendin tonë kishte vetëm 643 shkolla fillore me 52 000 nxënës, kurse në vitin 1953, numri i shkollave fillore arriti në 2 118 me 138 000 nxënës. Në vitin 1938 ka pasur shkolla shtatëvjeçare dhe të mesme vetëm 11, kurse më 1953 numri i tyre ka arritur në 333. Në vendin tonë tash ka pesë institute të larta ku mësojnë mbi 800 studentë, pa marrë parasysh me qindra studentë që kanë mbaruar universitetet e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore dhe ata studentë që shkojnë vazhdimisht po në këto vende për t'u pajisur me shkencë dhe me arësim të lartë.

Vendi ynë sot ka një rrjet të gjerë bibliotekash, teatros, kinemash; po zhvillohet me sukses të madh

teatri dramatik, muzika, opera, baleti, estrada; sporti është bërë i masave të gjera punonjëse. Talente të mrekullueshme po dalin nga gjiri i popullit në të gjitha aktivitetet ekonomike, shoqërore dhe kulturele të vendit.

Partia dhe qeveria i kanë vënë dhe do t'i vënë një kujdes të madh dhe të pareshtur forcimit të shëndetit të popullit duke luftuar sëmundjet. Për këtë gjë në të katër anët e vendit janë ngritur spitale, sanatoriume, ambulanca dhe një numër i konsiderueshëm shtëpish pushimi për punonjësit.

Të gjitha këto gjëra, të arritura në saje të udhëheqjes së klasës punëtore dhe të Partisë së Punës të Shqipërisë, kanë sjellë një përmirësim të dukshëm në jetën e të gjithë punonjësve të vendit tonë. Këto suksese kanë shkaktuar që të ardhurat e përgjithshme të popullsisë të rriten dhe kjo ka influencuar në përmirësimin e jetesës së punonjësve. Furnizimi i popullit me mallra ushqimore dhe me mallra të konsumit të gjerë çdo vit është shtuar. Partia dhe qeveria i kanë shtruar si detyrë urgjente dhe të domosdoshme vetes dhe të gjithë punonjësve që sivjet të shtohen në mënyrë të konsiderueshme mallrat e konsumit të gjerë për popullin. Për këtë gjë janë marrë masat me kohë. Klasa jonë punëtore me entuziazëm të madh mori angazhime për prodhimin e këtyre mallrave mbi planin e caktuar. Dhe ka filluar prodhimi i tyre. Gjithashtu janë marrë masat që të importohen sasi të konsiderueshme mallrash të konsumit të gjerë. Kështu sivjet populli ynë do të furnizohet më shumë edhe më mirë se çdo vit tjetër me mallra ushqimore dhe me mallra të konsumit të gjerë.

Populli ynë i udhëhequr nga Partia dhe qeveria e

tij ka besim të madh në të ardhshmen dhe është kryelartë për këto suksese që ka arritur. Ai do të vërë të gjitha forcat që vazhdimisht të korrë suksese të reja.

Por krahas këtyre sukseseve të pamohueshme, ne kemi në punën tonë edhe mjaft gabime e të meta serioze, që duhet t'i shohim në sy, t'i njohim dhe t'i korrigjojmë sa më parë. Të mos trembemi aspak për të njohur gabimet, pse po t'i mbulosh gabimet, ato trashen dhe dëmtojnë, kurse po t'i hapësh, t'i zbulosh dhe t'i luftosh, puna ecën më me vrull përpara. Të mos kemi frikë nga armiku, pse ai do ta përdorë për një kohë auto-kritikën tonë për të llomotitur se gjoja punët tona nuk shkojnë mirë. Aq punë na prish kjo; ata lusin që ne t'i fshehim gabimet, që kështu të prishen punët dhe armiku të gjejë fushë të përshtatshme për të na minuar. Ne, në mjaft sektorë të ekonomisë dhe në mjaft ndërmarrje kemi pasur shumë mundësi që planin ta realizonim më mirë. Këtë nuk e kemi bërë si duhet dhe kjo ka rënduar mbi ekonominë tonë e na ka krijuar deficite që kanë shkaktuar në mjaft raste furnizimin jo të mirë dhe të rregullt të punonjësve. Në shumë raste drejtuesit e ndërmarrjeve ekonomike nuk kanë qenë si duhet në krye të detyrës dhe s'kanë ditur si duhet të organizojnë dhe të kontrollojnë detyrat që u vireshin përpara. Kjo ka shkaktuar jo vetëm që planet në disa sektorë të mos realizohen, por edhe mallrat që janë prodhuar të mos kenë kualitetin e caktuar nga standardet shtetërore. Ne kemi rezerva të konsiderueshme brenda në vend, të cilat shumë herë për fajin tonë lart dhe për fajin e ndërmarrjeve ekonomike poshtë nuk shfrytëzohen si duhet. Shfrytë-

zimi total dhe në mënyrë racionale i rezervave të brendshme është një konditë e domosdoshme për ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Këto mundësi konsistojnë në shfrytëzimin sa më racional të maqinerisë sonë të re dhe të vjetër dhe të lëndëve të para, të përdorimit racional të fuqisë punëtore, të rritjes së vazhdueshme të rendimentit në punë, të uljes së pandërprerë të kostos etj. Të gjithë punonjësit e vendit tonë duhet ta kenë të qartë se kondita kryesore për përparimin e gjithanshëm të ekonomisë kombëtare është rritja në maksimum e rendimentit në punë në të gjithë sektorët e ekonomisë. Mirëqenja e popullit dhe krijimi i bollëkut varen nga rritja e vazhdueshme e rendimentit tonë në punë.

S'ka asnjë dyshim se, për të gjithë ne punonjësit e Shqipërisë së re, është detyrë urgjente që të vendosim një regjim pune të shëndoshë, t'i studjojmë thellësisht problemet që na dalin përpara për të zgjidhur, të organizojmë punën si duhet, të kontrollojmë zbatimin e vendimeve shumë më mirë se ç'e kemi bërë deri tash. pse vetëm kështu ne do të korrim rezultatet që dëshirojmë. Kudo ne duhet të forcojmë disiplinën në punë, e cila lë mjaft për të dëshiruar dhe kjo është burimi i shumë të këqiave, duhet të vendosim një kontroll të rreptë nga poshtë-lart dhe nga lart-poshtë. Nuk duhet në asnjë mënyrë të kënaqemi me rezultatet e arritura në përgatitjen dhe perfeksionimin e kuadrove në të gjithë sektorët. Duke marrë parasysh zgjerimin e sektorit ekonomik dhe kultural të vendit tonë, duke marrë parasysh zhvillimin e madh që ka marrë dhe do të marrë bujqësia, kuadrot e tashëm mund t'i cilësojmë si shumë të pamjaftueshëm dhe akoma të nivelit të

ulët. Prandaj në këtë drejtim duhet të bëhen përpjekje kolosale, si nga ana e Partisë dhe e pushtetit, ashtu edhe nga të gjithë punonjësit. Detyra e të gjithë punonjësve të vendit tonë, në të gjithë sektorët ku ata punojnë, është të mësojnë, të mësojnë me vullnet të madh e pareshtur. Punonjësve të industrisë nacionale dhe lokale si edhe artizanëve të vendit tonë u vihet si detyrë të forcojnë organizimin e punës, të shfrytëzojnë mirë të gjitha maqineritë dhe lëndën e parë, të nxjerrin në dritë dhe të planifikojnë drejt të gjitha mundësitë e brendshme dhe të japin sa më shumë prodhime dhe mallra të konsumit të gjerë, me kosto të lirë dhe me kualitet të mirë, pse në këtë drejtim ne jemi akoma shumë prapa. Punonjësve të transportit u vihet si detyrë të shfrytëzojnë si duhet dhe të mirëmbajnë maqineritë, lokomotivat, trenat, të jenë të përpiktë në detyrat e tyre dhe t'i shërbejnë sa më mirë popullit dhe ekonomisë kombëtare. Punonjësve të tregëtisë u bie barra e madhe të bëjnë një tregëti më të kulturuar, pse ajo është shumë prapa, të mirëmbajnë mallrat dhe t'i shërbejnë si duhet popullit, të ruajnë pasurinë e popullit dhe të shtetit nga dëmtimet, nga prishjet dhe nga vjedhësit. Mësuesit, profesorët, shkencëtarët, në të cilët Partia, qeveria dhe mbarë populli kanë besim të madh pse atyre u kanë besuar edukimin e brezit të ri dhe zhvillimin e diturisë e të shkencës në vendin tonë, të mësojnë çdo ditë e më shumë në shkencën përparimtare sovjetike dhe atë botërore, të perfeksionojnë dituritë e tyre dhe këto t'i vënë në shërbim të popullit e të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës në vendin tonë.

Me gjithë luftën që i është shpallur burokratizmit,

në aparatet tona të qendrës edhe poshtë, prapëseprapë, vihen re shumë shfaqje burokratike kundër të cilave vazhdimisht, çdo orë, çdo ditë duhet të bëjmë një luftë të ashpër mbasi burokratizmi dhe burokratët janë shkaktarë të shumë të këqiave.

Duhet të shumëfishojmë vigjilencën në sektorin ekonomik pse ajo akoma lë për të dëshiruar. Armiku, me të gjitha forcat, përpiqet të na pengojë në ecjen tonë përpara, ai me çdo mjet përpiqet të na dëmtojë ekonominë, të na shkatërrojë punën, maqinat, të na vjedhë dhe të dëmtojë pasurinë e shtetit. Këtyre armiqve duhet t'ua bëjmë veprimtarinë të pamundur, t'i godasim pa asnjë pikë mëshire dhe t'i eliminojmë sa më parë nga punët tona. Populli që është në fuqi dhe është zot i fateve të veta, duhet të hapë sytë mbi çdo gjë dhe të forcojë shumë e më shumë kontrollin e tij. Partia, organet shtetërore dhe gjithë punonjësit duhet të lidhen ngushtë me popullin, të bashkëpunojnë ngushtësisht, të dëgjoet me kujdesin më të madh zëri i masave, vërejtjet, kritikën dhe të ndreqen sa më parë gabimet që vërtetohen. Aparatet e Partisë dhe të shtetit duhet të perfeksionojnë metodën e tyre të punës dhe të mbajnë kontakte të ngushta dhe të përditshme me punonjësit, të dëgjojnë kërkesat, sugjerimet, këshillat e tyre dhe t'i vënë ato në jetë.

Ne, të gjithë punonjësit e Shqipërisë, që luftojmë për një qëllim të shenjtë, për begatinë e popullit, për lulëzimin e atdheut dhe për forcimin e tij, jemi plotësisht të bindur dhe të vendosur, se të gjitha këto të meta do t'i zhdukim me luftë dhe me punë të frutshme, jemi të bindur dhe të vendosur ta çojmë punën tonë

përpara, kurdoherë përpara. Ne do të ndërtojmë me sukses socializmin, jetën e begatshme për popullin tonë heroik, paqedashës dhe punëtor. Garanci e këtyre fitoreve të sigurt është Partia jonë e dashur që na udhëheq, është klasa jonë punëtore heroike, është aleanca e ngushtë e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse, është vetë populli që drejton në këtë vend kreshnik siç është Shqipëria jonë e re.

Shokë e shoqe,

Populli ynë është i ndërgjegjshëm se bën përpjekje të mëdha për të ndërtuar një jetë të lumtur dhe paqësore për vete dhe për brezat e ardhshëm, në një kohë plot rreziqe për njerëzimin dhe për paqen në botë. Ekzistojnë, siç dihet, grupe dhe klasa njerëzish në botë, që luftojnë kundër lirisë dhe mirëqenjes së popujve. Këta janë të dënuar të zhduken nga historia e zhvillimit njerëzor, pikërisht pse janë bërë pengesë e madhe e këtij zhvillimi, pse kërkojnë të kthejnë prapa rrotën e historisë dhe kjo rrotë do t'i zërë nën vete e do t'i shtypë. Këta janë miliarderët e egër të Uoll Stritit dhe të vendeve të tjera kapitaliste, janë borgjezia kapitaliste, klasa feudalo-borgjeze, kolonizatorët e ndryshëm gjakpirës dhe të gjitha mbeturinat e klasave shtypëse. Imperializmi ndërkombëtar, me atë amerikan në krye, bën përpjekjet e tija të fundit, për t'i grumbulluar dhe organizuar këto forca të hurit e të litarit dhe për t'i hedhur në një luftë të re të përgjakshme si kundër popujve të lirë, ashtu edhe kundër atyre që aspirojnë dhe luftojnë për t'u çliruar nga zgjedha kapitaliste. Këta

barbarë përpiqen me mjetin e tyre të përhershëm, me luftën, të përjetësojnë regjimin e shtypjes, të shfrytëzimit dhe të terrorit mbi popujt e botës.

Ekzistojnë, pra, dy kampe në botë: kampi i luftës, i udhëhequr nga imperializmi amerikan dhe kampi i paqes, i udhëhequr nga Bashkimi i lavdishëm Sovjetik. I pari ka kundër tij gjithë popujt e botës, gjithë njerëzit e thjeshtë e përparimtarë dhe i dyti grumbullon në gjirin e tij të fuqishëm të gjithë popujt e globit që luftojnë për një jetë të lirë, të gëzuar, plot dinjitet, të gjithë njerëzit me vullnet të mirë, që kanë një ide të lartë të dinjitetit njerëzor, që duan të mbrojnë kulturën e njerëzimit, të mbrojnë dhe të zhvillojnë për të mirën e njerëzve shkencën, artin, pasuritë e tokës dhe të nëntokës dhe të krijojnë kështu begatinë për njerëzit, të zhdukin urinë dhe mjerimet në botë. Vetëm një jetë paqësore i lejon njerëzit përparimtarë të ndërtojnë lumturinë e tyre, kurse lufta do të thotë gjak, rrënime, mjerime dhe zhdukje të vlerave njerëzore. Në këtë tmerr e kanë hedhur vazhdimisht njerëzimin imperialistët me ata amerikanë në krye, në këtë skëterrë kërkojnë përsëri, këta kanibalë, ta kthejnë botën. S'ka pra njeri të ndershëm në botë, pavarësisht nga pikëpamjet e tija politike ose besimet fetare, që të mos jetë kundër luftënxitësve imperialistë, të mos jetë kundër luftës grabitçare dhe për paqen e të luftojë me të gjitha forcat e tija për ta mbrojtur paqen. Imperializmi amerikan dhe satelitët e tij janë futur në garë për t'u armatosur sa më shumë, për të krijuar baza ushtarake rreth vendeve socialiste për të ringjallur dhe riarmatosur kështu imperializmin gjerman dhe militarizmin japonez. Natyrisht

buxhetet e Shteteve të Bashkuara dhe të vendeve të Evropës Perëndimore që janë nën thundrën e tyre, janë buxhete lufte. Atje popujt vuajnë nën shtypjen e terrorit, të urisë e të papunësisë. Imperializmi amerikan me anën e propagandës, radios, shtypit, librit, përpigjet të helmojë shpirtërat dhe të hutojë mendjet e njerëzve për t'i tërhequr këta në rrugën e greminës. Politika e forcës dhe e shantazhit është në rendin e ditës në politikën e drejtuesve të Shteteve të Bashkuara të cilët bëjnë ç'është e mundur, me anë të gënjeshtërisë dhe të shpifjes, për të mbajtur të ngritur tensionin ndërkombëtar, luftën e tyre të ftohtë dhe mitin që ata vetë kanë krijuar mbi gjoja qëllimet agresive të Bashkimit Sovjetik. Me paktet e tyre agresive si ai i Atlantikut Verior, traktati i Bonit dhe i Parisit, traktati i Athinës etj., si këta, që kanë kurdisur imperialistët amerikanë e anglezë dhe satelitët e tyre, tregojnë hapur qëllimet e tyre agresive kundër socializmit dhe paqes. Imperialistët amerikanë dhe shërbëtorët e tyre provokuan luftën në Kore, por me gjithë barbarizmat e pashembullta që kryen ndaj popullit heroik korean, ata hëngrën një dackë të fortë. Po të njëjtën gjë ata kanë më tepër se shtatë vjet që po bëjnë në Vietnam, në Malezi, në Kenia etj., por edhe këtu imperialistët dhe kolonizatorët e tjerë do të kenë të njëjtin fat si ai që u rezervoi populli heroik dhe paqedashës i Koresë. Kampi i luftënxitësve me imperialistët amerikanë në krye bën shumë zhurmë dhe kërcënon botën me bombën atomike dhe atë me hidrogjen, por edhe këtu gjelave u kanë rënë pendët dhe e dinë fare mirë që, në rast se bëjnë marrëzira, ka kush t'ua hedhë zinxhirët, dhe tmerret e këtyre armë-

ve shkatërruese do t'i shohin në mënyrë të rrufeshme mbi kryet e tyre. Me britmat e tyre historike imperialistët kërkojnë të gënjejnë se gjoja kampi i tyre është i fortë dhe i bashkuar. Por çdo gjë dëshmon të kundërtën. Kontradiktat në mes tyre janë shumë të mëdha dhe të çarat po zmadhohen derisa do të shkaktojnë shembjen e sistemit të tyre.

Krejt e kundërta ngjet në Bashkimin Sovjetik, në Kinën Popullore dhe në vendet e demokracisë popullore. Në këto vende popujt, të udhëhequr nga partitë e tyre marksiste-leniniste, luftojnë me vetëmohim për mbrojtjen e paqes, për të siguruar lumturinë dhe begatinë, për të ngritur çdo vit e më shumë nivelin e tyre material dhe kultural, për të forcuar fuqinë mbrojtëse të atdheut të tyre. Politika që ndjek Bashkimi Sovjetik, Kina e madhe Popullore dhe vendet e demokracisë popullore është një politikë konsekuente për paqen dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Të gjithë popujt e vendeve të demokracisë popullore janë lidhur me një miqësi të shëndoshë e të sinqertë me Bashkimin Sovjetik dhe çdo vit ata korrin suksese të mëdha në të gjitha lëmet e aktivitetit ekonomik dhe kultural. Industria në këto vende po përparon çdo ditë, ajo zgjerohet, forcohet, pajiset me mjetet më moderne. Bujqësia përparon, modernizohet, mekanizohet, kolektivizohet në mënyrë graduale, në mënyrë të pareshtur dhe në bazë të vullnetarizmit. Jeta e popujve tanë përmirësohet çdo ditë e më tepër dhe kujdesi më i madh i partive tona komuniste e punëtoresh dhe i qeverive tona është ngritja e nivelit të jetesës së masave të gjera punonjëse, mbrojtja e tyre nga sëmundjet dhe pajisja e tyre me dituri

dhe me shkencën e përparuar. Në të gjitha këto drejttime popujt tanë vazhdimisht korrin dhe do të korrin suksese.

Kampit të socializmit i nevojitet paqja e vazhdueshme dhe drejt këtij qëllimi të shenjtë synojnë të gjitha forcat e Bashkimit Sovjetik, e vendeve të demokracisë popullore dhe e të gjithë njerëzve përparimtarë të botës. Në saje të politikës paqësore të qeverisë sovjetike, janë arritur rezultatet e para në uljen e tensionit ndërkombëtar. Por ulja e këtij tensioni në marrëdhënjet ndërkombëtare nuk duhet të na vërë në gjumë, pse këto nuk janë veçse hapat e parë të një pune dhe të një lufte të madhe që duhet të zhvillohet më intensivisht kundër planeve agresive të imperialistëve amerikanë dhe satelitëve të tyre. Detyra e popujve është t'i shumëfishojnë përpjekjet për t'i shkatërruar këto plane agresive të luftënxitësve.

Imperializmi amerikan gjendet në një rrugë pa krye jo vetëm përpara rezistencës së fuqishme dhe të vendosur të popujve, por edhe përpara partnerëve të tij të cilët duke parë se po mbytet vapori, bëjnë përpjekje t'i shpëtojnë furtunës që kërkon t'i mbytë pa nishan.

Një disfatë tjetër të madhe pësoi politika e forcës, e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe e të gjithë kolonizatorëve në Konferencën e Gjenevës ku diskutohet paqja në Kore dhe në Vietnam. Më kot u përpoq Foster Dalles¹ të pengonte pjesëmarrjen e Kinës së madhe Popullore në këtë konferencë, si një nga të pesë

¹ Xh. F. Dalles (1888-1959), Sekretar shteti i SHBA-së nga 1953 deri 1959, njëri prej organizatorëve të bllokut agresiv të NATO-s.

fuqitë e mëdha që është. Më kot Shtetet e Bashkuara të Amerikës përpiqen me të gjitha forcat e tyre të bëjnë izolimin e Republikës Popullore të Kinës dhe të preगतin agresione kundër saj, më kot ata dhe kolonizatorët e tjerë francezë dhe anglezë përpiqen të përjetësojnë kolonializmin. Popujt e Azisë tashmë janë zgjuar dhe luftojnë me vendosmëri për ta hequr qafe zgjedhën që u ka rënduar shekuj me radhë. Me popujt e Azisë, që luftojnë për çlirimin e tyre dhe kundër skllavëruesve imperialistë janë gjithë popujt e botës, gjithë njerëzit e ndershëm dhe të thjeshtë të botës.

Si të gjitha vendeve të kampit socialist edhe vendit tonë i duhet paqja dhe për këtë populli ynë lufton me vetëmohim. Ne nuk duam të na vriten njerëzit tanë, të na bombardohen qytetet tona që i ndërtoam dhe i zbuluam, nuk duam të na digjen fshatrat, të na shfaroset bagëtia sikundër na ka ngjarë vazhdimisht shekuj me radhë. Populli ynë në saje të luftës së tij legjendare, fitoi përgjithmonë lirinë dhe pavarësinë e sot ndërton bazat e socializmit, jetën e tij të re dhe të bukur. Populli shqiptar dhe qeveria e tij përkrahin në mënyrë aktive dhe me vendosmërinë më të madhe politikën paqësore të Bashkimit Sovjetik.

Natyrisht krokodilëve kapitalistë dhe të gjithë peshkagënëve të tjerë, armiq të jashtëm dhe të brendshëm të vendit tonë, nuk u pëlqen kjo vendosmëri e madhe e popullit tonë për të mbrojtur paqen, lirinë dhe pavarësinë e tij. Ata dëshironin ta kishin Shqipërinë nën vete dhe popullin tonë ta mbanin nën zgjedhë për ta shfrytëzuar dhe «mjelë» siç kanë pas bërë vazhdimisht në kohët e kaluara. Mirëpo përënduan ato kohë dhe

s'kthehen më. Veçse ata nuk heqin dorë nga të këqiat, me gjithë disfatat e njëpasnjëshme që kanë pësuar. Dhjetë vjet me radhë, që nga dita e çlirimit të vendit tonë nga okupatorët fashistë, imperialistët amerikanë dhe satelitët e tyre, duke përdorur tradhëtarët e vendit tonë që jetojnë në emigracion, duke vënë në shërbimin e tyre plehrat e shoqërisë sonë të brendshme, janë përpjekur me të gjitha mënyrat për ta rrëzuar pushtetin popullor. Çfarë nuk kanë bërë ata që nga provokacionet me stil ndërkombëtar dhe deri në komplete e vrasje, por pa asnjë sukses, sepse ata kanë ngrënë grushte të njëpasnjëshme dhe kanë pësuar dhe do të pësojnë vazhdimisht disfata. Këto fitore janë korrur pse populli ynë, i udhëhequr nga Partia dhe qeveria e tij, ka qenë dhe do të jetë kurdoherë vigjilent, ka mbrojtur dhe do të mbrojë me vendosmërinë më të madhe lirinë, independencën dhe sovranitetin e atdheut kundër lakmive të imperialistëve dhe shërbëtorëve të tyre.

Asnjëherë armiqtë e popullit tonë, të jashtëm dhe të brendshëm, nuk do të na gjejnë në gjumë dhe pa mëshirë do të shtypim çdo tentativë të tyre. Të gjithë ata që do të tentojnë sado pak të prekin ose të dëmtojnë fitoret e popullit, e kanë të qartë se çfarë i pret. Le t'i shfletojnë me kujdes defteret e disfatave të tyre dhe le të jenë të bindur se lufta e popullit tonë kundër tyre është mprehur e do të mprehet akoma më shumë, se grushti i drejtësisë së popullit do të jetë akoma më i ashpër se ç'ka qenë. Populli ynë e ka pasur dhe e ka të qartë fytyrën e egër dhe të përgjakur të imperializmit amerikan e të sejmenëve të tij. «Liria», «pavarësia», mënyra e jetesës, mënyra e të menduarit dhe e të ve-

pruarit e imperialistëve amerikanë, përmbledhen në simbolin e Hamit Matjanit¹, «patriotit të kulluar» siç e quajnë amerikanët dhe spiunët e tyre shqiptarë në mërgim këtë bandit dhe kriminel. Përfytyroni për një sekondë, atdheun tonë të bukur nën sundimin e Hamit Matjanëve dhe kjo do t'ju japë qartë idenë se ç'do të thotë «qytetërimi», «liria», mënyra e jetesës amerikane, që ata i predikojnë çdo natë popullit shqiptar me anë të radios së tyre «Zëri i Amerikës» dhe «Shqipëria e lirë». Shpifjet, gënjeshttrat, profkat e amerikanëve dhe të tradhëtarëve të vendit, janë aq pa kripë sa e bëjnë të qeshë popullin tonë.

Populli ynë nën udhëheqjen e Partisë dhe të qeverisë së tij do të ecë kurdoherë përpara, do të shkojë nga fitorja në fitore, do të ndërtojë me sukses socializmin në vendin e tij, do të forcojë çdo ditë e më shumë aftësinë mbrojtëse të atdheut të tij dhe do të jetë kurdoherë, vazhdimisht vigjilent kundër armiqve të jashtëm dhe të brendshëm, do t'i godasë këta me ashpërsinë më të madhe dhe nuk do të lejojë për asnjë çast të preken të drejtat dhe fitoret e tija që i kushtuan gjak e djersë.

Populli shqiptar dëshiron të mos preket nga kurrkush dhe të ndërtojë jetën e tij paqësore; populli shqiptar nuk përzihet në punët e të tjerëve, gjithashtu ai dëshiron që edhe në punët e tija të mos futin hundët të tjerët. Populli shqiptar dhe qeveria e tij janë dhe luftojnë në mënyrë konsekuente për forcimin e paqes së drejtë dhe të vazhdueshme në botë, janë për uljen

¹ Kriminel lufte, në prill 1954 u dënua nga gjyqi i popullit.

e tensionit ndërkombëtar. Populli shqiptar dhe qeveria e tij e kanë shprehur vazhdimisht dhe e shprehin edhe një herë se janë për vendosjen e marrëdhënjeve normale me të gjitha shtetet dhe veçanërisht me vendet fqinje. Populli ynë dëshiron të rrojë në fqinjësi të mirë me popujt jugosllavë, italian dhe grek. Vullneti i mirë i qeverisë sonë për të vendosur marrëdhënje normale me fqinjët nuk ka munguar asnjëherë. Që prej disa vjetësh, ndërmjet shtetit tonë dhe Italisë ekzistojnë marrëdhënje diplomatike normale dhe qeveria jonë i ka propozuar qeverisë italiane shkëmbime mallrash tregëtie në bazë të interesit reciprok. Me Jugosllavinë qeveria jonë vendosi marrëdhënje diplomatike normale, dhe në rast se me fqinjën tonë të Jugut, Greqinë, nuk ekzistojnë akoma marrëdhënjet diplomatike, kjo është për fajin e tyre.

Shokë dhe shoqe,

Partia dhe qeveria jonë që kanë përkrahjen dhe besimin e plotë të popullit, u kanë kushtuar dhe do t'ua kushtojnë deri në fund të gjitha forcat dhe kujdesin e tyre të madh forcimit dhe lulëzimit të atdheut tonë, ngritjes së vazhdueshme të mirëqenjes së popullit, plotësimit sa më shumë dhe më mirë të nevojave të tija.

Partia jonë e lavdishme e Punës që udhëheq me urtësi dhe me sukses fatet e vendit, është garancia e madhe e fitoreve kurdoherë më të mëdha të popullit tonë. Ajo është pjella më e lavdishme e popullit punonjës, ajo përfaqëson çdo gjë që ka më të shtrenjtë dhe më të shenjtë populli ynë. Dhe për këtë arsye populli

shqiptar e do me gjithë shpirt Partinë e tij heroike, të papërkulur kurrë përpara vështirësive dhe fitimtare në çdo betejë. Për këtë arsye populli ynë e ruan dhe e mbron Partinë e tij si gjënë më të shtrenjtë dhe e ndjek me besim të pakufishëm në rrugën e saj të ndritur të socializmit. Këta janë faktorët vendimtarë që e bëjnë Partinë tonë të fortë. Partia jonë është e lidhur ngushtë përjetë me popullin e vet. Populli shqiptar me të drejtë është kryelartë për Partinë e tij të dashur, e cila lufton me heroizëm vetëm për interesat e popullit dhe të atdheut. Nën udhëheqjen e Partisë sonë ne ndërtojmë bazat e socializmit. populli ynë ka korrur suksese të mëdha dhe ai ecën drejt fitoreve të tjera. Brez pas brezi në shekuj njerëzit e Shqipërisë do t'i thurin lavdi Partisë së Punës të Shqipërisë që i hapi këtë rrugë të madhe dhe të lavdishme popullit tonë.

Të gjithë ne punonjësit e Shqipërisë të ndjekim me besnikëri dhe të zbatojmë me vendosmëri të madhe mësimet dhe direktivat e Partisë e të Komitetit të saj Qendror, të derdhim të gjitha energjitë tona për lumturinë e popullit dhe të atdheut tonë të dashur. Çdo punonjës të jetë i ndërgjegjshëm për përgjegjësinë e madhe që ka ndaj popullit e shoqërisë sonë dhe të kryejë me nder detyrat që i takojnë. Për asnjë moment dhe asnjëri nuk duhet të ndajë interesat vetjake me ato të popullit dhe të shoqërisë, por ato duhet të harmonizohen në mënyrë të atillë që puna e gjithsecilit të kontribuojë që të gjithë shtetasit shqiptarë të rrojnë më mirë, të ngrihet niveli i jetesës, të zhvillohet kultura e të gjitha masave punonjëse. Kjo do të sjellë begatinë e popullit tonë, këtu do të gjendet gëzimi dhe kënaqësia e njerëzve dhe të

gjithë ata që do të ecin në këtë rrugë të drejtë do të gëzojnë besimin, respektin dhe dashurinë e popullit.

Më 30 maj populli shqiptar do të votojë për përfaqësuesit e vet në Kuvendin Popullor dhe ashtu si kurdoherë ai do të tregojë bashkimin e tij të çelniktë në Frontin Demokratik të udhëhequr nga Partia, do të tregojë patriotizmin e tij të zjarrtë dhe vendosmërinë për të ruajtur dhe forcuar fitoret e tija që i ka korrur me luftë dhe me punë të palodhur.

Populli shqiptar, më shumë se kurdoherë, i bashkuar si një trup i vetëm rreth Partisë së tij të dashur që e udhëheq në rrugën e socializmit, e shikon të ardhshmen e tij me optimizëm, me kurajë dhe me besim të patundur. Populli shqiptar nën udhëheqjen e Partisë dhe të qeverisë së tij do të ecë vazhdimisht përpara, kurdoherë përpara dhe kurdoherë do të korrë fitore.

Rroftë populli ynë heroik!

Rroftë Partia jonë e lavdishme e Punës, frymëzuesja dhe organizatorja e të gjitha fitoreve të popullit tonë!

Rroftë dhe u forcoftë Republika jonë Popullore!

Rroftë dhe u forcoftë miqësia e madhe dhe e përgjetshme në mes të popullit shqiptar dhe popujve të Bashkimit Sovjetik e të vendeve të demokracisë popullore!

Rroftë dhe u forcoftë paqja në botë!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 113 (1753), 13 maj 1954

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

«**MBI DISA ÇËSHTJE ORGANIZATIVE TË PARTISË**»

Raport i mbajtur në Plenumin XI të KQ të PPSH

12 korrik 1954

Shokë,

Në emër të Byrosë Politike i paraqis plenumit për diskutim dhe aprovim disa çështje organizative të Partisë. Qëllimi i këtyre çështjeve organizative që do të parashtrihen në këtë raport është forcimi i mëtejshëm i Partisë sonë dhe i udhëheqjes së saj, ngritja në një shkallë më të lartë e punës kolegjiale në Komitetin Qendror dhe në të gjitha instancat e Partisë, forcimi i mëtejshëm i unitetit të Partisë dhe i lidhjeve të ngushta të saja me masat punonjëse të vendit tonë.

Partia e Punës e Shqipërisë, parti e tipit leninist, luan rolin e saj vendimtar e historik në udhëheqjen e fateve të vendit. Ajo dje udhëhoqi Luftën nacional-çlirimtare, çliroi popullin nga robëria imperialiste dhe e feudoborgjezisë së vendit, vendosi pushtetin popullor dhe regjimin e demokracisë popullore, rindërtoi atdheun

e shkatërruar nga lufta, bëri reformat e mëdha me karakter ekonomik dhe shoqëror dhe sot po e çon vendin tonë me zotësi dhe me urtësi në rrugën e socializmit. Të gjitha fitoret e arritura në vendin tonë i detyrohen Partisë, vijës së saj marksiste-leniniste, kompaktësisë e unitetit të saj të çelniktë, besnikërisë së saj ndaj parimeve marksiste-leniniste; i detyrohen popullit tonë trim e punëtor, patriotizmit të zjarrtë e vrullit të tij revolucionar.

Detyra jonë e parë, si kurdoherë, është të mbrojmë Partinë si sytë e ballit, të ruajmë pastërtinë e radhëve të saja, të çelnikosim unitetin, të ngremë aftësitë e saja ideopolitiko-organizative dhe ekonomike, të zbatojmë kudo në Parti normat leniniste dhe të forcojmë kurdoherë e më shumë rolin drejtues dhe kontrollues të Partisë në të gjitha fushat e aktivitetit politik, ekonomik dhe kultural të vendit.

Për të kryer me sukses këto detyra të mëdha ne duhet të mobilizojmë të gjitha forcat e Partisë. pse do të ishte gabim që të kënaqemi me sukseset që kemi arritur, qoftë në drejtim të forcimit të Partisë, qoftë në lëmin ekonomik dhe duhet të kemi parasysh se në punët tona, të Partisë dhe të shtetit, kemi akoma shumë të meta dhe vështirësi. Partia dhe Komiteti i saj Qendror, kurdoherë na mësojnë që t'i çmojmë situatat ashtu si janë në realitet, t'i ggykojmë gjërat me sy kritik, të zbulojmë dhe të zhdukim të metat pse vetëm kështu ne do t'u çelim rrugën sukseseve të reja e më të mëdha në të ardhshmen. Duhet ta kemi të qartë se ecja e Partisë sonë përpara bëhet me një luftë këmbëngulëse kundra mbeturinave mikroborgjeze dhe kapitaliste në ndërgje-

gjen e njerëzve dhe do të neglizhojmë parimet marksiste-leniniste në rast se ne harrojmë rrethimin kapitalist të vendit tonë.

Qëllimi kryesor i armiqve të marksizëm-leninizmit ka qenë dhe mbetet kurdoherë shkatërrimi i partive komuniste dhe punëtorë, shkallmimi i normave leniniste të partive komuniste, shndërrimi i partive komuniste në parti borgjeze dhe fashiste. Armiqtë e popullit dhe të Partisë sonë, në radhë të parë, i kanë drejtuar forcat e tyre kundër Partisë sonë dhe shpresojnë se duke goditur Partinë dhe organet e saj drejtuese ata do të dobësojnë shtetin tonë. Prandaj teoricienët reaksionarë dhe deviatorët e marksizëm-leninizmit u bëjnë një luftë të ashpër principeve marksiste-leniniste dhe partive leniniste. Një nga pikat më nevralgjike, ku armiqtë e marksizëm-leninizmit synojnë me goditjet e tyre, është truri kolektiv i Partisë, është udhëheqja kolektive e saj, është urtësia kolektive e Komitetit Qendror të Partisë. Ata përpiqen ta godasin Partinë në pikën nevralgjike për arsye se Komiteti i saj Qendror dhe instancat e tjera udhëheqëse të Partisë përfaqësojnë pjekurinë dhe urtësinë e masave, përfaqësojnë shpirtin revolucionar dhe inisiativën krijuese të kuadrove të Partisë, të klasës punëtorë, të mbarë popullit punonjës.

Forca e madhe udhëheqëse dhe drejtuese e popullit tonë në luftën për ndërtimin e bazave të socializmit është Partia, për të cilën dashuria e popullit shqiptar është shumë e madhe, pse ajo përfaqëson dëshirat, aspiratat dhe të ardhshmen e tij të lumtur. Me një fjalë populli ja ka besuar drejtimin e vet Partisë, e cila me besnikëri të madhe e mbron popullin nga çdo rrezik,

mbron fitoret e tija dhe e udhëheq atë drejt socializmit.

Për të kryer me sukses detyrën historike që ka Partia ne duhet t'i vëmë një rëndësi shumë të madhe forcimit të gjithanshëm të saj dhe të përqëndrojmë të gjitha forcat që ky rol drejtues dhe vendimtar i Partisë të bëhet një realitet i çelniktë në të gjithë jetën e vendit. Forca e regjimit në vendin tonë, siç na mëson marksizëm-leninizmi qëndron në forcën e Partisë dhe në sigurimin e plotë të rolit udhëheqës dhe kontrollues të saj në të gjitha çështjet, në çështjet ekonomike, në çështjet shtetërore, në edukimin e punëtorëve, të fshatarëve dhe të intelektualëve. Shteti, organet qendrore dhe lokale të pushtetit, organizatat e masave, drejtohen, edukohen dhe kontrollohen nga Partia dhe nga Komiteti Qendror. Vendimet e Partisë, të Komitetit të saj Qendror dhe të Byrosë Politike duhet të vihen menjëherë në jetë nga të gjitha organet shtetërore dhe organizatat e masave; Partia duhet të vendosë kontrollin rigoroz mbi tërë veprimtarinë e këtyre organizatave dhe enteve, mbi punën e të gjithë kuadrove, pavarësisht nga vendi që zë secili në Parti ose në shtet. Vetëm kështu kryhen me sukses detyrat që cakton Partia, pse ajo është një organizatë luftarake dhe është e fortë nga vetëdija e lartë dhe nga veprimtaria aktive e anëtarëve të saj.

Është e qartë se në vendin tonë nuk duhet të drejtojmë vetëm nëpërmjet organeve shtetërore, nëpërmjet formave të ndryshme, po në radhë të parë duke edukuar dhe bindur masat dhe këtë punë duhet ta bëjë dhe do ta bëjë Partia dhe vetëm ajo. Është e domosdoshme që puna jonë të drejtohet në mënyrë të tillë që kudo të ndihet autoriteti i Partisë, i Komitetit Qendror dhe i

Byrosë Politike, pse nuk mund të ketë problem të rëndësishëm shtetëror ose partie që të vihet në jetë pa u vendosur më parë në Komitetin Qendror ose në Byronë Politike.

Partia jonë, e dalë nga lufta dhe e kalitur në luftë kundër okupatorëve, kundër trockistëve dhe oportunistëve, e ka forcuar dhe e ka çelnikosur kompaktësinë dhe unitetin e saj, por detyra jonë, e çdo komunisti është ta ngremë në kulm vigjilencën revolucionare të anëtarëve të Partisë dhe të të gjithë punonjësve, të ruajmë pas-tërtinë e radhëve të saja dhe çdo ditë e më shumë të çelnikosim unitetin në Parti dhe në udhëheqje, pse armiqtë vazhdimisht do të synojnë në goditjen e këtij realiteti që përbën forcën e madhe të Partisë sonë. Partia jonë është një parti e re dhe niveli i saj ideologjik dhe kultural është akoma i ulët. Prandaj na vihet si detyrë nga më të rëndësishmet, të ngremë nivelin ideologjik dhe kultural të Partisë dhe të masave punonjëse, t'i armatosim ato me teorinë marksiste-leniniste, armën e fuqishme dhe kyçin e të gjitha fitoreve të Partisë dhe të popullit tonë. Në mënyrë rigoroze duhet të perfeksionojmë punën organizative të Partisë, të forcojmë demokracinë e brendshme të saj, kritikën dhe autokritikën e sidomos kritikën nga poshtë, t'i mësojmë dhe vazhdimisht t'i mësojmë anëtarët e Partisë që të jenë të zgjuar dhe të zbulojnë të metat dhe gabimet, t'i kritikojnë ashpër ato, pa marrë parasysh se kush i bën këto gabime, qoftë forum ose person, në çdo detyrë qoftë, në Parti ose në pushtet. Ne duhet të perfeksionojmë dhe të forcojmë edhe më tej punën e Partisë në zgjedhjen dhe vendosjen e kuadrove sipas karakteristikave të tyre politike dhe

aftësive në punë. Në punët e Partisë dhe të shtetit tonë ka shfaqje të burokratizmit, i cili pengon mbarëvajtjen në punë, prandaj kuadrot duhet t'i edukojmë dhe t'i mësojmë si të luftojnë kundër burokratizmit, kudo që manifestohet ai.

Partia jonë është e lidhur me gjak me popullin, pse ajo përfaqëson pjesën më të mirë të popullit, pjesën e tij pararojë. Në lidhjet e saja me masat qëndron forca e Partisë sonë, prandaj këto lidhje, jo vetëm që duhet t'i ruajmë si sytë e ballit, por Partia me punën e saj të palodhshme, guximtare, të urtë, duhet t'i forcojë ato çdo ditë e më shumë.

Detyra jonë qëndron, si kurdoherë, të forcojmë në mënyrë të pareshtur udhëheqjen e Partisë dhe të aparateve shtetërore. Për këtë qëllim, një nga çështjet kryesore për të gjitha organet e Partisë është që të respektohen rigorozisht parimet e kolegjalitetit në udhëheqje dhe të mos bëhet asnjë shkelje në këtë drejtim. Çështjet duhet të zgjidhen në mënyrë kolegjinale dhe jo me dispozita individuale, që sjellin uljen e rolit të Partisë. Në asnjë mënyrë nuk duhet të lejojmë në të ardhshmen, siç nuk kemi lejuar deri tani, që të zvogëlohet rëndësia dhe roli vendimtar i Partisë dhe i Komitetit Qendror por, duke mos mohuar aspak aftësitë, vetitë dhe rolin e individit që rrjedhin nga vetë karakteri i jetës shoqërore, pa e ngatërruar këtë rol me kultin e individit që është një praktikë antimarksiste dhe e dëmshme, pse ajo krijon fetishizimin e personit, dobëson rolin vendimtar të kolektivit dhe të masave në zhvillimin dialektik dhe materialist të shoqërisë, dobëson besimin e masave popullore në forcat e tyre krijuese. Kultit i individit të çon

në uljen e rolit të Partisë si detashment pararojë i klasës punëtore dhe të udhëheqjes së saj, Komitetit Qendror. Duhet të kemi parasysh tezën e Marksit mbi kultin e individit. Marksi ka shkruar:

«Nga urrejtja për çdo kult të individit, unë gjatë ekzistencës së Internacionales nuk e kam lejuar kurrë botimin e mesazheve të shumta në të cilat flitej për meritat e mia dhe të cilat më vinin nga vende të ndryshme. Unë bile as u jam përgjigjur ndonjëherë, me përjashtim të ndonjë rasti, kur kam qortuar autorët e tyre. Engelsi dhe unë kemi hyrë për të parën herë në shoqërinë e fshehtë të komunistëve, duke vënë si kusht të domosdoshëm që të hiqej nga statuti çdo gjë që ndihmonte në përluljen e verbër përpara autoriteteve»¹.

Zhvillimi i kultit të individit është i dëmshëm në një parti marksiste-leniniste pse jo vetëm dobëson rolin drejtues të partisë dhe të Komitetit të saj Qendror, pengon forcimin e shpirtit të drejtimit kolegjial në udhëheqjen e partisë që është e vetmja garanci e urtësisë dhe e drejtësisë së vijës së partisë, por pengon kritikën ndaj gabimeve, lëshimeve, të metave që shfaqen në punën e partisë dhe të njerëzve, dobëson autokritikën, zhvillon mendjemadhësinë në njerëzit dhe kënaqësinë në vetëvete, paralizon inisiativën në punë.

Në Komitetin Qendror dhe në instancat e tjera udhë-

¹ K. Marks e F. Engels. Veprat, vëll. 34, bot. II, rus., f. 241.

heqëse të Partisë sonë ka ekzistuar shpirti i kolegjalitetit dhe është luftuar vazhdimisht që puna kolegjiale të forcohet çdo ditë. Shokët e Byrosë Politike kanë rastin t'i thonë Komitetit Qendror se për shumë herë rresht përpara Byrosë Politike dhe shokëve të tjerë të udhëheqjes, Sekretari i Përgjithshëm e ka shtruar kurdoherë drejt çështjen e dëmeve që sjell kulti i individit dhe ka kërkuar që t'u jepej fund një herë e përgjithmonë disa manifestimeve të tepruara që janë shfaqur në praktikën e jashtme nga masat e popullit ndaj personit të tij, siç janë thirrjet me skandencë të emrit të tij, ngritja e busteve nëpër qytete, vënja pa rast dhe pa arsye e fotografive të tija në gazeta dhe revista dhe ndonjë shfaqje tjetër e këtij lloji. Po e vërteta është të thuhet se këto çështje që ai i shtronte në bazë të parimeve leniniste në mjaft raste janë marrë si shfaqje të thjeshtësisë së karakterit të tij. Tani është e nevojshme që Komiteti Qendror të orientojë Partinë në radhë të parë, që t'i japë fund një praktike të tillë.

Partia dhe populli e kuptojnë fare mirë se dashuria e thellë, e pastër, e singertë dhe respekti i tyre ndaj një udhëheqësi nuk ka asnjë lidhje me manifestimet e tepruara, mburrjet, lajkat etj. Udhëheqësit e Partisë nuk mund të rrojnë dot pa dashurinë e thellë, të pastër dhe të singertë të popullit dhe të Partisë dhe ne udhëheqësit duhet të kemi respektin më të madh kundrejt kësaj dashurie, që është shprehje e gjallë e besimit nga ana e anëtarëve të Partisë dhe e të gjithë punonjësve. Dashuria e vërtetë e popullit dhe e anëtarëve të Partisë për udhëheqësit duhet të meritohet prej këtyre të fundit me punë dhe me luftë të vazhdueshme për kauzën e Partisë dhe

të popullit. Tjetër dashuri, simpati dhe besim jashtë këtyre normave nuk mund të quhet dashuri dhe respekt i vërtetë.

Qëllimet e larta të politikës së Partisë së Punës të Shqipërisë qëndrojnë në luftën e vendosur që bën ajo për të mbrojtur dhe për ta siguruar atdheun tonë nga çdo rrezik, për të ndërtuar jetën e begatshme, socializmin në vendin tonë, për të mbrojtur e zhvilluar edhe më tej fitoret dhe interesat e popullit; politika e vazhdueshme e Partisë konsiston në ngritjen e mirëqenjes materiale dhe të zhvillimit kultural të njerëzve të atdheut tonë, të kënaqë në mënyrë maksimale nevojat materiale dhe kulturele të punonjësve dhe të luftojë për mbrojtjen e paqes.

Duke marrë parasysh të gjitha sa thamë më lart, me qëllim që Partia jonë të forcohet çdo ditë e më shumë, të forcohet roli drejtues, organizues dhe kontrollues i Partisë dhe i Komitetit Qendror, Byroja Politike i propozon Komitetit Qendror të marrë masat e mëposhtme organizative:

1. — Të pranohet propozimi i shokut Enver Hoxha që të lirohet nga funksionet shtetërore si Kryetar i Këshillit të Ministrave dhe t'ja kushtojë të gjithë aktivitetin e tij drejtimit të Komitetit Qendror për forcimin e mëtejshëm të Partisë. Grumbullimi i shumë funksioneve në një person, në periudhat e para të çlirimit të atdheut, ishte i nevojshëm dhe i drejtë, pse situatat ishin të vështira, Partia dhe shteti ynë ishin të rinj, sapo kishin dalë nga lufta dhe kishin nevojë për forcim, për organizim. Por tash që Partia jonë dhe shteti ynë janë forcuar dhe punët janë zgjeruar shumë, grumbullimi

i disa funksioneve në një person, bëhet një vështirësi dhe pengon zhvillimin e mëtejshëm të punëve. Nga ana tjetër bashkimi në një person i të dy funksioneve, Sekretar i Përgjithshëm ose Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë dhe Kryeministër, mund të krijojë një situatë që të dobësohet drejtimi dhe kontrolli vendimtar i Partisë dhe i Komitetit Qendror mbi të gjithë aktivitetin e vendit dhe mbi levat e saja, një nga të cilat është edhe pushteti qendror.

2. — Të suprimohet funksioni i Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë si jo i domosdoshëm dhe i panevojshëm dhe të krijohet funksioni i Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror, i cili drejton punët e Komitetit Qendror, të Byrosë Politike dhe të Sekretariatit.

3. — Të zgjedhë shokun Enver Hoxha Sekretar të Parë të Komitetit Qendror.

4. — Të zgjedhë shokun Gogo Nushi si sekretar të Komitetit Qendror.

5. — Të shkarkojë shokun Manush Myftiu dhe shokun Josif Pashko nga funksioni si sekretarë të Komitetit Qendror dhe t'i emërojë ata në funksione të tjera të rëndësishme shtetërore¹.

6. — ...

Politika e Partisë sonë është e drejtë. Këtë e provon në mënyrë të shkëlqyer jeta, e provon ndërtimi me sukses i bazave të socializmit në vendin tonë. Partia jonë i qëndron përjetë besnike doktrinës ngadhënjimtare të

¹ Shokët Manush Myftiu dhe Josif Pashko u emëruan, i pari zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave të RPSH dhe i dyti ministër i ndërtimit.

Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, i qëndron besnike deri në fund marksizëm-leninizmit dhe Bashkimit të madh Sovjetik.

Komiteti Qendror i Partisë sonë është i bashkuar si një trup i vetëm prej graniti dhe e udhëheq Partinë me urtësi e guxim në rrugën e lavdishme të socializmit e komunizmit. Uniteti i Partisë është si një blok çeliku që s'do të ketë forcë armike, qoftë e brendshme, qoftë e jashtme që ta dëmtojë. Mendjet e sëmura dhe armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm të Partisë, kur t'i marrin vesh këto masa organizative të drejta dhe të domosdoshme që po merr Komiteti Qendror i Partisë për forcimin e Partisë dhe të fitoreve të popullit, do të përpiqen t'i shfrytëzojnë në dëm të shoqërisë sonë socialiste, në dëm të interesave të popullit. Këto mendje të sëmura dhe këta armiq do të përpiqen të shpifin, të trillojnë gjëra të paqena, do të lehin si qen për një kohë, po shpejt dhe me siguri do të dështojnë. Partia, si kurdoherë, të shtojë vigjilencën kundër armiqtë të brendshëm dhe të jashtëm të Partisë dhe të popullit dhe t'i godasë këta armiq pa pikë mëshire. Partia të bëjë të gjithë përpjekjet që mendjet e sëmura që mund të shërohen, t'i shërojë. Çdo gjë bëhet për të mirën e Partisë dhe të popullit, prandaj të ecim si kurdoherë përpara për fitore të reja.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PA MËSUAR MIRË MARKSIZËM-LENINIZMIN, DETYRAT NUK MUND TË KRYHEN SI DUHET

*Diskutim në mbledhjen me kuadrot kryesorë të aparatit
të KQ të PPSH¹*

12 korrik 1954

Siç e dini, sot u zhvillua mbledhja e Plenumit të Komitetit Qendror, i cili shqyrtoi dhe aprovoi raportin e Byrosë Politike «Mbi disa çështje organizative të Partisë» dhe mori vendimet përkatëse. Ne u mbledhëm si aparat i Komitetit Qendror që t'i lexojmë këto materiale, të kuptojmë rëndësinë e tyre dhe të armatosemi për të ndihmuar bazën. Nesër do të zhvillohen aktivet e Partisë dhe brenda datës 17 do të përfundojë punimi i materialeve të Plenumit të Komitetit Qendror në të gjitha organizatat bazë të Partisë.

¹ Në këtë mbledhje shoku Enver, i ngarkuar nga Komiteti Qendror, lexoi dhe komentoi raportin dhe vendimet e Plenumit XI të KQ të PPSH, «Mbi disa çështje organizative të Partisë» dhe u ndal në nevojën e madhe të mësimit të marksizëm-leninizmit, veçanërisht nga kuadrot.

Puna e parë është që ju, shokë të aparatit, të thoni mendimin tuaj për këto vendime të Komitetit Qendror; për ju këto çështje janë të qarta, por sidoqoftë është e nevojshme të theksoj disa prej tyre.

Vendimet e Komitetit Qendror kanë për qëllim të forcojnë gjithë Partinë, të forcojnë udhëheqjen e saj, Komitetin Qendror, Byronë Politike, Sekretariatit dhe të gjitha organet e Partisë. Duke marrë parasysh se Partia udhëheq gjithë jetën e vendit tonë, udhëheqja e Partisë në të gjitha instancat duhet të ngrihet në një nivel akoma më të lartë që të mos mbetet asnjë vend pa drejtimin dhe kontrollin e Partisë. Në rast se ajo i ka në dorë dhe kontrollon zbatimin e të gjitha vendimeve të Byrosë Politike e të Komitetit Qendror, atëhere gjithë puna do të ecë përpara. Për të arritur atë që thotë Lenini, se «partia është forca luftarake», atëhere është e domosdoshme që Partisë të mos i kalojë asgjë jashtë kontrollit të saj që nga baza e deri në qendër etj. Duhet ta dimë se të meta kemi plot, si në organizatat e Partisë, ashtu dhe në organet e pushtetit dhe shumë gjëra nuk mund të zgjidhen me dekrete. Të marrim për shembull çështjen e burokratizmit, i cili nuk mund të zhduket vetëm me vendime të qeverisë; në qoftë se këtë çështje nuk e merr në dorë Partia, në qoftë se udhëheqja e saj nuk mobilizon të gjithë komunistët dhe masat pa parti e t'i mësojë se si duhet të luftojnë kundër burokratizmit, ky nuk mund të zhduket nga aparati ynë.

Në rast se Komiteti Qendror nuk mëson bazën, nuk kontrollon zbatimin e vendimeve që Partia ka lëshuar, asgjë nuk mund të dalë me sukses, sepse duhet të dimë që në çdo aktivitet udhëheqin komunistët. Nga çështja e for-

cimit të brendshëm të organizatave bazë varët në një shkallë të madhe puna e Partisë, sa më të forta që të jenë këto, aq më mirë do të zbatohen vendimet e Partisë dhe, sa më të dobëta që të jenë organizatat bazë, aq më dobët do të zbatohen këto vendime. Në qoftë se organizatat bazë dhe komunistët e kanë kuptuar këtë, që roli i Partisë është roli udhëheqës, atëhere në punën tonë do të kemi suksese. Prandaj, të forcohet kritika dhe autokritika, të ndihmohen ata që gabojnë, por në qoftë se ndonjëri prej tyre nuk i ndreq gabimet, atëhere Partia, pasi e ka bërë tërë punën e saj, do të marrë masat e duhura sipas rastit. Asnjë influencë nuk mund të godasë Partinë, vijën organizative dhe politike të saj, në qoftë se do të forcohet ndërgjegjja e komunistëve për të dalë gjithnjë fitues. Çdo fjalë që thuhet këtu ka një kuptim të gjerë. Udhëheqja e Partisë duhet të ngrihet ideologjikisht në një nivel më të lartë, ajo duhet të përvetësojë më mirë problemet ekonomike dhe të jetë e qartë në problemet shoqërore, pse ndryshe kjo udhëheqje nuk mund të jetë udhëheqje e vërtetë dhe masat që do të merren do të jenë të çala, do të na mbulojë praktikizmi, prandaj Partisë duhet t'i hapen perspektivat; për këtë ne kemi për detyrë që Partinë ta edukojmë nga lart, por që t'ja arrijmë kësaj, duhet të edukohemi në radhë të parë ne vetë, prandaj nuk duhet të na zërë gjumi, por të mësojmë gjithmonë marksizëm-leninizmin.

Sikundër e dini, në të ardhshmen ne kemi shumë për të bërë. Të mos harrojmë se në Partinë tonë shumica janë fshatarë, janë nëpunës dhe punëtorët në Parti janë akoma të paktë si numër, se në Partinë tonë ekzistojnë mbeturina mikroborgjeze, të cilat duhet të lufto-

llohet zbatimi i tyre. Por në përgatitjen e materialeve për udhëheqjen aparati i Komitetit Qendror duhet të ketë mirë parasysh që të konsultohet si duhet me bazën, pse atje poshtë, në fshat, në minierë e kudo është jeta e gjallë, eksperiencia e pasur e Partisë, prandaj me qëllim që çdo gjë të studjohet mirë, ne duhet të kërkojmë ndihmën e Partisë dhe të njerëzve pa parti. Këtë konsultim me komunistët dhe masat pa parti, është e domosdoshme ta bëjmë më mirë në të ardhshmen dhe, kur një studim ose vendim t'ja paraqitim Komitetit Qendror dhe Byrosë Politike ai të jetë me një nivel dhe cilësi të lartë. Për të gjitha vendimet e Komitetit Qendror duhet të japë orientimin sekretari i Komitetit Qendror, por edhe ju, shokë të aparatit, mendoj se duhet të jeni më shumë kërkuës ndaj vetes, më tepër krijues në punë, pse vetëm kështu mund të jemi sa më të armatosur kur vemë poshtë në bazë e, kur shokët kthehen nga baza, do ta kenë më lehtë të flasin për masat që janë marrë dhe për ndihmën që është dhënë. Nga kjo do të gjykohet se si punon njëri dhe si punon tjetri. Komiteti Qendror do të përgëzojë kur puna vete mirë dhe, natyrisht, do të kritikojë kur puna në një vend nuk shkon mirë.

Ne do të luftojmë që të gjithë shokët e aparatit të ngrenë kurdoherë më lart nivelin e punës së tyre; mundësitë janë dhe secili ka fituar nga eksperiencia e Partisë, por nga ne pritet akoma më shumë. Ne duhet të luftojmë që vajtja e një instruktori në bazë të krijojë një situatë të tillë që të ndihet dora e Komitetit Qendror. Nuk duhet vetëm me dhënë urdhëra, por duhen udhëzuar e armatosur njerëzit, prandaj të mësoni pse

kështu do të ngrihet edhe më tepër autoriteti i Komitetit Qendror.

Unë këto kisha, në qoftë se keni ndonjë gjë për të pyetur që nuk e keni të qartë, mund të pyesni. Në qoftë se nuk ka pyetje, na thoni se çfarë mendoni ju. Këto gjëra do të ngrihen pastaj edhe në organizatën bazë.

*Botohet për herë të parë sipas
procesverbalit të mbledhjes me
kuadrot kryesorë të aparatit
të KQ të PPSH që gjendet
në AQP*

**DIREKTIVAT ZBËRTHEHEN DHE ZBATOHEN
DREJT VETËM ATËHERE KUR ATO
KUPTOHEN DREJT**

Diskutim në mbledhjen e aktivitet të Partisë të Tiranës¹

13 korrik 1954

Shokë, jam i ngarkuar nga Komiteti Qendror i Partisë t'ju lexoj dhe komentoj raportin e Byrosë Politike, mbajtur në Plenumin e KQ të PPSH, i cili vendosi që ky raport të jetë direktivë për të gjithë Partinë (*lexon raportin e Byrosë Politike të aprovuar nga KQ*).

Tani më lejoni që të lexoj edhe të gjitha vendimet e Byrosë Politike që u pranuan unanimitisht nga ana e Komitetit Qendror (*lexon vendimet e Byrosë Politike të aprovuara nga KQ*).

Siç e shihni, në vendimet që lexuam nuk është shënuar çështja e lirimit tim nga funksioni i Kryetarit të

¹ Në këtë mbledhje shoku Enver, duke komentuar raportin dhe vendimet e Plenumit të KQ, u ndal mjaft në çështjen e kuptimit dhe të zbatimit drejt të direktivave që jep Partia dhe Komiteti i saj Qendror.

Këshillit të Ministrave, për arsye se kjo do të vendoset së shpejti në mbledhjen e Kuvendit Popullor. Për këtë çështje e gjithë Partia do të marrë dijeni me anë të raportit, ndërsa populli do të informohet nëpërmjet komunikatës që do të botohet në shtyp më 17 korrik.

Duke u bazuar në direktivat që dha Plenumi XI i Komitetit Qendror, i cili u zhvillua dje, do të përpiqem të theksoj disa gjëra të rëndësishme që Partia t'i ketë kurdoherë parasysh.

Qëllimi kryesor i këtij aktivi është që të mësojmë sa të jetë e mundur më shumë nga direktivat e Komitetit Qendror dhe t'i vëmë ato plotësisht në jetë mbasi janë direktiva vendimtare për forcimin e Partisë. Partia na mëson që të mirat t'i vëmë në dukje, se ato janë thesari i Partisë, djersa dhe gjaku i saj e i popullit tonë dhe se mbi ato mbështetemi për të ecur kurdoherë përpara. Por edhe të metat duhet të mos i mbulojmë, t'i vëmë mirë në dukje, se, po nuk i pamë me sy kritik, puna jonë do të dobësohet. Prandaj në diskutimin tim do të them edhe të mirat, edhe dobësitë.

Gjatë këtij diskutimi, mund të mos them fraza të bukura, jo se jam kundër tyre, por nuk jam për atë që të themi fraza për fraza. Puna është që shokët komunistë të kuptojnë mirë problemet që shtrohen. Këtë e them se ka me mijëra anëtarë partie që kanë ide të mrekullueshme, që kanë mendime të pjekura, por druhen t'i thonë ato, pse «nuk flasim dot me fraza të bukura», se «nuk i lidhin dot si duhet mendimet», mbasi niveli i tyre kulturor është akoma i ulët. Por Partia ka shumë nevojë për mendimet e këtyre shokëve, pavarësisht se ata nuk shprehen me fraza të bukura.

Gjithashtu, unë nuk do të flas këtu as për rëndësinë që kanë aktivet e Partisë, pse këtë e dinë mirë të gjithë shokët. Partia ju ka dërguar ju, shokë përfaqësues të organizatave bazë dhe të dhjetëra mijë punonjësve të këtij qarku, që të dëgjoni zërin e saj në këtë aktiv, zërin e udhëheqjes së Partisë dhe ta çoni atë në organizatat bazë ku bëni pjesë. Prandaj kur komunistët vijnë në aktive, konferenca, kongrese ose në mbledhjet e organizatave bazë, në konferencat shkencore apo kulturore, është mirë që të mbajnë shënime pse është e zorshme të kujtohen të gjitha ato që thuhet. Duke dëgjuar mirë e duke mbajtur shënime, secili pastaj ka më shumë mundësi që kur të kthehet në organizatën bazë, t'u flasë shokëve dhe shoqeve gjithshka që dëgjoi dhe mësoi këtu.

Një nga direktivat kryesore të Plenumit të fundit të Komitetit Qendror është që ta ngremë vazhdimisht rolin udhëheqës dhe drejtues të Partisë në një nivel shumë më të lartë. Por që të arrihet kjo duhet vendosmëri nga të gjithë dhe shpirt revolucionar. Komunistët, që nga më i thjeshti e deri te udhëheqësi, duhet të armatosen me marksizëm-leninizmin, me kulturën e përgjithshme. Të gjithë të mbajmë parasysh çdo minutë se përgjegjësia e secilit përpara popullit është jashtëzakonisht e madhe, pse komunistët janë udhëheqësit e masave. Çdo fjalë dhe vepër e tyre ndihmon për të mirë ose për të keq në fatin e popullit, në mbarëvajtjen dhe në mirëqenjen e jetës së tij, në mbrojtjen e atdheut, të pavarësisë dhe të fitoreve të tija. Është gjë e lavdishme të jesh komunist, por nuk është e lehtë, sepse ka detyra të rënda. Mirëpo jo të gjithë komunistët i kuptojnë dhe i kryejnë si duhet detyrat që u ngarkon Partia. Forca e

komunistëve qëndron në atë që për ta nuk mund të ketë vështirësi dhe pengesa të pakapërcyeshme. Pra duke i pasur parasysh këto, duhet që Partinë ta ngremë në atë shkallë që na mëson marksizëm-leninizmi.

Shokë, ju e dini se pa udhëheqjen e Partisë asgjë nuk mund të shkojë mirë. Kudo që të jetë komunisti, në zyrë, në fabrikë, në fushë, në shtëpi e në jetën private, në rast se atje nuk hyn fjala e Partisë, në rast se atje nuk është syri i Partisë dhe ndihma e saj konkrete, atëhere nuk ka përparim, nuk ka suksese, por ecet prapa dhe nga kjo përfiton armiku i popullit e i Partisë. Mund të marrim shumë shembuj, po le të mjaftohemi me këtë: ne kemi mjaft suksese në industrinë tonë po të bëjmë krahasime me të kaluarën, përparimet janë të mëdha, ndryshimet janë kolosale, si nata me ditën dhe ato janë arritur në saxe të udhëheqjes së drejtë të Partisë.

Në industrinë tonë po rritet një klasë punëtore e ndërgjegjshme për rolin e saj pararojë, e gatshme dhe e sakrificës; atje janë vendosur rregulla dhe disiplina shtetërore. Por, në këtë zhvillim të industrisë, ne kemi akoma shumë të meta, kemi mjaft gabime dhe lëshime, të cilat duhet t'i shohim konkretisht. Në industrinë e lehtë shumë detyra që i janë vënë Partisë dhe punonjësve nuk janë realizuar, po kështu edhe në artizanat shumë detyra nuk janë kryer dhe të gjitha këto kanë lidhje me përmirësimin e jetesës së popullit. Në rast se Partia, organizata bazë, byroja e saj dhe komitetet e Partisë nuk u qëndrojnë mbi kokë të gjitha vendimeve të Partisë e të qeverisë, në rast se ato nuk kontrollojnë zbatimin e këtyre vendimeve që janë udhëzime të dala nga Komiteti Qendror i Partisë dhe nga Byroja Politike, në rast se

nuk edukojmë punëtorët me parti dhe pa parti që të bëhen të ndërgjegjshëm për rolin e tyre pararojë, nëse nuk edukohen ata me një disiplinë të hekurt për të kritikuar haptas ata që shkelin rregullat e Partisë dhe të shtetit, kjo industri nuk mund të ecë përpara. Punët nuk mund të ecin dhe të zgjidhen vetëm me masa administrative dhe shtetërore, gabimet e të metat nuk mund të ndreqen vetëm me dekrete, me dënime. Bile, atje ku merren shumë nga këto masa, duket qartë se puna e Partisë për të edukuar njerëzit nuk është aq e fortë.

Në pushtetin tonë qoftë qendror, qoftë lokal ka burokratizëm kundër të cilit Partia duhet të luftojë. Kur anëtarët e Partisë të një organizate mobilizohen si duhet, kur atyre u vihen mirë në dukje detyrat dhe secili merr përsipër që gjithë punonjësit pa parti të edukohen, vetëm atëhere punët venë mirë.

Në fshat ka përparime të mëdha. Fshatari ynë është i zgjuar, patriot, ai ecën përpara. Po ne nuk duhet të kënaqemi me sukseset që ka arritur fshati, ai duhet të kishte ecur akoma më përpara. Po pse nuk është bërë kjo? Kjo nuk është bërë se komunistët në fshat janë akoma me nivel të ulët, nuk i kanë marrë punët akoma si duhet në dorë dhe të ndjejnë si duhet përgjegjësinë që kanë. Është e domosdoshme që ata të mendojnë se që të shkojë mirë çdo gjë në fshat, duhet të përpiqen të kryejnë plotësisht detyrat që u ka ngarkuar Partia. Të jesh komunist nuk do të thotë të marrësh pjesë vetëm në mbledhje. Komunistin nuk duhet ta zërë gjumi kur fshatari nuk e ka çuar plehun në arë, kur pesë fëmijë nga të fshatit të tij janë të sëmurë, kur shkolla e fshatit të tij nuk po ecën si duhet përpara se mësuesi nuk intere-

sohet, ose kur në fshatin e tij nuk është ndërtuar akoma çesma e ujit etj. Duke menduar e punuar kështu Partia në fshat do të mund ta bindë fshatarin se ai lufton për të mirën e fshatit prandaj të shohë kurdoherë përpara. Në shembullin e anëtarit të Partisë duhet të punojë edhe fshatari, i cili e sheh se ç'të mirë ka nga puna e vet dhe ç'situatë do t'i krijohet në të ardhshmen familjes së tij nga puna që do të bëjë ai, ashtu si e këshillojnë anëtarët e Partisë.

Komunisti duhet t'i hapë perspektiva fshatarit që ky të shohë të ardhshmen, të shohë se bleta që do të mbajë në shtëpinë e tij do t'i japë mjaltin, se ulliri që duhet mbjellë në Sauk, i cili deri tani duhej të ishte bërë pyll, do t'u sjellë një mirëqenje shumë të mirë kalamanëve etj. A duhet të kënaqen komunistët me një situatë të tillë siç është akoma sot në fshat? A mund të lejohet që në Partinë tonë të ketë komunistë analfabetë? Jo, kjo nuk mund të lejohet, pse nuk pajtohet me Partinë tonë. Ne kemi në Parti shumë komunistë që akoma nuk e kanë mbaruar shkollën fillore. Po a mund të ecet kështu? Jo. Komunisti është udhëheqës, pararojë, prandaj duhet të bëjë të gjitha përpjekjet të fitojë kulturë, ndryshe nuk zgjidhen punët e Partisë dhe hallet e popullit. Komiteti Qendror u vë detyrë të gjithë komunistëve që të forcohet roli drejtues dhe kontrollues i Partisë në të gjitha punët, por kjo do të bëhet vetëm kur komunistët ta kuptojnë si duhet rolin udhëheqës të Partisë dhe rolin e tyre si njerëz pararojë dhe të mësojnë vazhdimisht që punën e ngarkuar nga Partia ta kryejnë mirë, shpejt dhe pa gabime si vetë ata, ashtu dhe masa që i rrethon.

Çështja tjetër që ka rëndësi në këto direktiva të Komitetit Qendror është forcimi i mëtejshëm i demokracisë së brendshme të Partisë. Këto çështje janë thënë vazhdimisht dhe vazhdimisht do të përsëriten. Anëtarët e Partisë ta kuptojnë një herë e përgjithmonë se në organizatat bazë ku militojnë, ata janë si në shtëpinë e tyre. Në organizatën bazë janë të tërë me të drejta të barabarta dhe të ngarkuar me detyra si komunistë të vendosur e me qëllime të larta, që nuk i vënë kurrë interesat vetjake mbi interesat e Partisë, që punojnë e luftojnë deri në fund për të vënë gjithmonë interesin e përgjithshëm mbi gjithshka. E tillë është organizata bazë e Partisë. Prandaj me këtë frymë duhet të diskutojnë atje anëtarët e Partisë për problemet kyçe e të domosdoshme që kërkojnë zgjidhje, për vendosjen e formave të drejta organizative, për të vendosur kontrollin mbi zbatimin e vendimeve që merren, duke kritikuar ata shokë që nuk i zbatojnë si duhet detyrat. Ndryshe mund të flasim për demokracinë e brendshme, për kritikën dhe autokritikën sa të duam. Partia nuk lejon slogane, ato që vendosen duhet të zbatohen. Vetëm kështu zhvillohet demokracia e brendshme e Partisë. Në rast se veprojmë kështu, dhe do të zbatojmë me përpikmëri direktivat e Komitetit Qendror, sukseset tona do të dhjetëfishohen. Prandaj Komiteti Qendror e ngre me të madhe çështjen që të vëmë të gjitha forcat dhe t'i bëjmë organizatat bazë dhe komitetet e Partisë organe luftarake, të paepura kundër të gjithë deviatorëve, oportunistëve dhe trockistëve, që përpiqen të dëmtojnë vijën e Partisë dhe të na pengojnë në rrugën e drejtë të socializmit.

Të mos harrojmë rrethimin kapitalist, siç thotë Ko-

miteti Qendror dhe faktin se Partia ecën përpara me këmbëngulje duke luftuar mbeturinat mikroborgjeze në ndërgjegjen e njerëzve. Këtë e themi gjithnjë, duke marrë parasysh se Partia jonë është e re, me nivel kulturor e ideologjik akoma të ulët. Megjithëse komunistët e vendit tonë nuk dinë shumë, është pozitive se ata janë besnikë të marksizëm-leninizmit, besnikë të popullit. Por Komiteti Qendror u thotë shokëve komunistë që secili të bëjë një studim në veten e tij, t'i dallojë mbeturinat e vjetra të së kaluarës dhe t'i luftojë duke kërkuar edhe ndihmën e organizatës bazë, sidomos kur këto mbeturina bëhen të rrezikshme. Po kur këto janë të vogla, anëtarët e Partisë duhet të luftojë edhe vetë për t'i zhdukur ato.

Duhet marrë situata ashtu siç është: në Partinë tonë ka pak punëtorë dhe shumë komunistë vijnë nga radhët e fshatarësisë e të nëpunësve dhe sjellin mbeturina, të cilat është e domosdoshme t'i njohim e t'i shkullim nga rrënjët. Të marrim një shembull. Ç'po ngjet në Tiranë? Ka mungesa të fuqisë punëtore dhe e vërta është se shumë nga ata që qahen për punë i mbajnë gratë në shtëpi. Ka nga gratë e këtyre shokëve që janë fshatare, që kanë punuar edhe me parmendë dhe punë të tjera, por sot që ato i kanë burrat oficerë, rrinë brenda në shtëpi, kënaqen me rrogën që marrin burrat. Kush e lë gruan pa punë, nuk mendon se Kombinati i tekstilëve «Stalin» nuk po ecën si duhet për shkak se nuk ka punëtorë. Nga 800 vetë që duhet të kenë shkollat profesionale dhe të rezervave të punës kanë vetëm 200. Po ç'janë këto? Këto janë mbeturina të vjetra mikroborgjeze të familjes patriarkale që po vazhdon akoma.

Në këto familje akoma komunistët nuk i edukojnë dhe nuk i bindin gratë dhe nënat e tyre, motrat, kur këto janë në gjendje të punojnë e t'u thonë se e drejta e tyre është të jenë të lira dhe të punojnë që të mos i bëhen barrë njëri-tjetrit. Një gjendje e tillë e çelnikos më shumë dashurinë në familje.

Thuhet aty-këtu se jeta është e shtrenjtë. Partia punon që të ngrihet vazhdimisht mirëqenja e popullit, po bëhen përpjekje që nëpërmjet rrugës së uljes së çmimeve të lirohen mallrat e konsumit të gjerë. Por në rast se ti, nënën, motrën ose gruan tënde nuk i çon në punë, edhe sikur 10 000 lekë në muaj rrogë të marrësh, nuk mund t'i përballosh dot të gjitha nevojat e jetesës. Prandaj në mes të shumë gjërave të tjera ka edhe shfaqje të atilla, që anëtarët e Partisë duhet t'i luftojnë. Duhet të dalësh përpara masës së madhe të popullit që pret fjalën dhe shembullin tënd e t'u thuash: «hajde, ç'janë gjithë këta që rrinë kot nëpër klube dhe nëpër shtëpi, të gjithë të vemi në punë», atëhere do të zgjidhen shumë probleme dhe puna e Partisë do të ecë më mirë.

Nuk po ndërtohen e asfaltohen bulevardet, në lagje ka nevojë për më shumë çesme uji etj., po kush do t'i bëjë këto? Po nuk u kryen këto punë, atëhere ku është roli i Partisë, ku është roli i saj udhëheqës, ku është roli i organizatës bazë, ku është roli i organizatës së Frontit Demokratik që pothuajse e kemi harruar fare? Komunistët duhet të mendojnë e të veprojnë për këto gjëra, prandaj janë komunistë, për këtë kanë rëndësi të jashtzakonshme këto direktiva të Komitetit Qendror, ata duhet të mendojnë që ta forcojnë Partinë, të bëhen motori udhëheqës i të gjithë aktivitetit të popullit tonë.

Në tregëti kemi plot komunistë dhe njerëz të tjerë të ndershëm që punojnë mirë, por ka dhe nga ata që nuk janë të tillë. Po të vesh në pazar do të shohësh se spinaqi në dyqanet e shtetit vërtet shitet më lirë, por populli preferon më mirë ta blejë më shtrenjt te privati, sepse spinaqi në dyqanin e shtetit nuk mbahet mirë dhe kjo vjen se shitësi i pandërgjegjshëm në fund të çdo muaji rrogën e ka të siguruar dhe nuk çan kokën të punojë si duhet e ta mirëmbajë mallin që i është besuar. Po ku është Partia këtu atëhere? Shokët e Partisë në raste të tilla nuk duhet t'i zërë gjumi. Komunistët të mos kënaqen me 8 orë punë që bëjnë, kur mbarojnë 8-orëshin të mos flenë të qetë po derisa të vejë ora e gjumit të mendojnë mbi këto probleme, të shohin për shembull se në lagje ka papastërti të madhe, prandaj të organizojnë mbledhje me banorët e lagjes nga ana e Frontit dhe të shpjegojnë herë pas here edhe rëndësinë e pastërtisë etj.

Këto direktiva të Komitetit Qendror të luftojmë dhe me këmbëngulje t'i vëmë në jetë, t'i zhvillojmë e t'i pasurojmë me eksperiencën e jetës sonë. Po puna e Partisë për këtë çështje duhet të bëhet e organizuar dhe bashkë me masat çdo komunist duhet të ketë rreth vetes së tij një numër të madh njerëzish. Pse thotë Partia që të mbahen lidhje të gjalla me bashkimet profesionale, me gruan, rininë, Frontin? Sepse vetëm në këtë mënyrë, kur që nga lart e deri në bazë, anëtarët e Partisë do t'i zbatojnë vendimet e organizatës bazë së bashku me popullin, punët do të ecin përpara, atëhere do të zhduken burokratizmi, vjedhjet, abuzimet dhe njerëzit do të edukohen. Asnjë nuk ka lindur i mësuar.

Njerëzit nuk janë të përsosur, Partia i edukon ata me ideologjinë e saj dhe në rast se ndonjëri nuk ndreqet vetëm atëhere e flak mënjanë.

Dua të them edhe disa fjalë në lidhje me kolegjalitetin në udhëheqjen e Partisë sonë. Ju e dini fare mirë se në Partinë tonë nuk ka udhëheqje individuale, që një njeri të firmosë e të vulosë vetë. Udhëheqja në Partinë tonë është udhëheqje kolegjiale. Atje shtrohen problemet, diskutohen dhe fiton mendimi i shumicës, i cili pastaj është i detyrueshëm të zbatohet nga të gjithë. Pra udhëheqja kolegjiale ka ekzistuar, por ka pasur e ka edhe të meta. Në shumë instanca të Partisë disa herë janë krijuar edhe situata jo të rregullta. Për shembull, ka raste që ç'thotë sekretari i organizatës bazë, ajo bëhet, ose kur flet ai, të tjerët duhet të heshtin duke shkuar me mendimin e gabuar se «ai është Partia» etj. Disa anëtarë partie e kuptojnë si ligj fjalën e sekretarit dhe mendojnë se ai bën protokollin e organizatës dhe, po të dojë, mund të të përjashtojë nga Partia. Këta shokë që mendojnë kështu, nuk e kuptojnë mirë se ç'është Partia, prandaj, edhe kur e shikojnë që sekretari nuk vepron drejt, nuk flasin. Sekretari i organizatës bazë, sekretari i parë i komitetit të Partisë të rrethit ose të qarkut nuk kanë të drejtë më shumë nga ç'kanë sekretarët e tjerë ose anëtarët e tjerë të Partisë, vetëm se ata kanë të drejtë dhe detyrë të organizojnë udhëheqjen e organizatës bazë, të komitetit të Partisë të rrethit ose të qarkut. Në organizatën bazë është mbledhja ajo që vendos dhe vendim i saj ka rëndësi të madhe e është i detyrueshëm për të gjithë. Sekretari i saj mund të jetë dakord ose jo për

diçka, po kur vendos organizata bazë atëhere mbaron puna, s'ka më diskutime, vendimi duhet zbatuar. Kështu duhet të ndodhë edhe në udhëheqjen e komitetit të Partisë. Këto janë normat e Partisë dhe kundër atyre që tentojnë t'i thyejnë ato për të dobësuar kështu udhëheqjen kolegjiale, Partia duhet të bëjë një luftë të ashpër. Të luftohet kundër atyre që u rritet mendja si domos kur ndonjëri bën diçka e ka sukses dhe, ndër-sa populli e përgëzon për punën e tij të mirë e qorton kur i rritet mendja e nuk shikon të metat në punë. Njerëz të tillë Partia t'i sjellë në realitet që t'i kenë këmbët në tokë, të shikojnë poshtë e të mos e mbajnë kokën lart, t'u vihet mirë në dukje se mendjemadhësia e fodullëku janë të dëmshëm dhe gjëra të tilla Partia nuk i lejon. Marksist i vërtetë është ai që me punën e tij fiton dashurinë e popullit dhe të Partisë, ai duhet ta ndjejë besimin e popullit dhe të komunistëve.

Udhëheqja kolegjiale s'ka asgjë të përbashkët me kultin e individit, i cili është i huaj për të. Po ç'është kulti i individit dhe si duhet kuptuar ai? Më lejoni ta shpjegoj pak, pse këtu ka edhe shokë të thjeshtë, punëtorë e fshatarë që ndoshta nuk e kuptojnë si duhet këtë çështje. Kulti i individit do të thotë: të lëvdosh një njeri, t'i thurësh atij lëvdata, sikur ai e bën kohën të mirë dhe të keqe, sikur ai bën çdo gjë. Të zhvillosh kultin e individit, do të thotë të veprosh kundër marksizmit. Marksizmi nuk e ul rolin e individit në shoqëri, përkundrazi, ai këtë rol e vë si duhet në dukje. Përsone në shoqëri luan rolin e vet, por të plotfuqishëm janë Partia, është kolektivi, janë masat. Individu mëson nga Partia, nga kolektivi, edukohet, ngrihet, përfiton

nga gjenia krijuese e popullit dhe pastaj, edhe ai vetë, në qoftë se nuk bie në kundërshtim me interesat e këtyre masave, por mbështetet në eksperiencën dhe dashurinë e tyre, atëhere ndihmon në mbarëvajtjen e zhvillimin e shoqërisë. Pra, marksizmi nuk lejon që individi të vihet mbi kolektivin, mbi masën. Por, në praktikën e punëve tona është dukur ndonjë shfaqje jo e mirë. Kështu disa herë brohoritet aq shumë për personin tim, sa kjo më pengon të bisedoj lirisht me shokët e Partisë, me punëtorët e fshatarët. Është e vërtetë se brohoritjet janë shprehje e dashurisë që ka populli ynë për udhëheqësit e tij, të cilët përfaqësojnë udhëheqjen e Partisë, por kur teprohet, kur s'del në radhë të parë Partia, Komiteti i saj Qendror, atëhere s'jemi në rrugën e drejtë marksiste-leniniste. Populli ynë e ai mirë kush është ky dhe kush është ai. Ai di të çmojë cilindo. Unë të dua, thotë ai, se punon mirë dhe të përgëzoj për këtë, ndryshe të tregoj vendin. Prandaj të tilla gjëra që nuk janë as në karakterin e popullit duhet të zhduken.

«Ujët lart buron i kulluar, po poshtë turbullohet» na thuhet nga mjaft njerëz që u drejtohen shokëve të udhëheqjes. Shumë anëtarë partie kujtojnë se bëjnë mirë duke menduar kështu, por një shprehje e tillë nuk është e drejtë, sepse ul rolin e kolektivit, të Partisë në bazë, pa të cilët udhëheqja as që mund të rrojë. Shihni pra se ku të çon, me dashje ose pa dashje kjo çështje. Si mund të durohet pikëpamja që «ujët lart buron i kulluar, po turbullohet poshtë»? Kjo vjen edhe se disa njerëzve akoma të papjekur u rritet mendja se janë në Parti, në pushtet, në sigurim ose në ushtri. Jo,

secili të bëjë detyrën me thjeshtësi prej komunisti dhe marksisti dhe të dijë se përmbi të është Partia. Partia drejton, kontrollon, ndihmon dhe lëvdon kur njerëzit punojnë mirë, por kritikon edhe ata që s'punojnë mirë dhe u tregojnë vendin atyre që shkelin vijën e Partisë dhe interesat e popullit.

Por shokë, duke dashur të luftojmë kundër rrezikut të kultit të individit, i cili është i dëmshëm dhe duhet luftuar kurdoherë, duhet të keni parasysh që të mos shkohet në anën tjetër, në ekstrem duke mos duartrokatur për udhëheqësit, të cilët janë bij të dalë nga gjiri i popullit dhe përfaqësojnë interesat e tij. Vija e drejtë në këtë çështje është që në radhë të parë të vihet në dukje kurdoherë Partia, Komiteti Qendror, Byroja Politike. Të gjithë dashurinë që kanë komunistët e populli për Partinë dhe për Komitetin Qendror duhet ta shfaqin. Por edhe kur vjen, për shembull, një udhëheqës në qytet ose në fshat, masa e popullit dhe Partia mbledhen dhe duartrokin, se duke bërë këtë për shokun udhëheqës ata duartrokin për Komitetin Qendror të Partisë, për udhëheqjen e saj. Udhëheqësit duhet ta meritojnë plotësisht këtë dashuri me punë të palodhur për popullin dhe Partinë.

Partia duhet të ketë kujdes se armiqtë do të përpiqen t'i shfrytëzojnë këto gjëra për qëllimet e tyre. Prandaj të gjithë komunistët t'i kuptojnë mirë këto çështje dhe çdo gjë ta shohin dhe ta zgjidhin vetëm në interesin e Partisë. Armiku le të lehtë, Partia dhe populli ynë shkojnë përpara pa u ndalur. Por Partia dhe njerëzit që janë rreth saj, në të njëjtën kohë nuk harrojnë të jenë vigjilentë dhe t'i bien armikut kurdoherë në kokë

sa herë që ai do të guxojë të veprojë kundër Partisë dhe popullit tonë.

Këto direktiva duhet ta mobilizojnë Partinë për të kryer detyrat që na vihen përpara në realizimin e planit. Këtu nuk flas vetëm për Tiranën, po për të gjithë vendin tonë. Direktiva kryesore e Plenumit të Komitetit Qendror të muajit prill ka qenë që të ndiqet deri në fund zbatimi i të gjitha vendimeve të marrura për përmirësimin e konditave të jetesës së popullit. Në këtë drejtim ka shembuj të mirë, që flasin për një punë të kujdesshme, energjike, me inisiativë. Të marrim Uzinën «Enver», ajo ka bërë plugje shumë të mira për të cilat përgjërohet fshatarësia. Ky është një sukses i madh, që i detyrohet punës së palodhur të kolektivit punonjës të kësaj uzine, drejtorisë, organizatës bazë dhe komitetit të Partisë, që i kanë mësuar komunistët t'i kryejnë mirë detyrat. Prandaj organizatat bazë të Partisë kudo që veprojnë, me rastin e këtyre direktivave, të mobilizohen me të gjitha forcat për t'i kryer më së miri detyrat që u janë vënë përpara për të realizuar planin e shtetit.

Fshati tani ndodhet përpara problemeve të mëdha, atje njerëzit janë në zjarrin e punës së korrjeve, shirjeve, grumbullimeve, prashitjes së misrit dhe të pambukut e të tjera detyra me rëndësi të madhe për të gjithë Partinë. Shokët udhëheqës, ata që merren direkt si dhe ata që merren indirekt me problemin e bujqësisë, është koha që tani të gjithë të venë në fushë, është koha të lihen letrat dhe të ndihmojnë fshatarët në vend me këshilla dhe me organizim, që këto detyra të kryhen dhe të mos humbasë gruri, që të rritet rendimenti i misrit, i duhanit dhe i pambukut. Viti bujqësor sivjet paraqitet

i mbarë. Gruri është rritur mirë, po kështu edhe misri. Për pambukun duhet akoma shumë punë sidomos për prashitjen dhe një forcë e madhe për grumbullimin e tij me kohë. Këto detyra do të realizohen duke mobilizuar të gjithë fshatarësinë, duke e organizuar atë në punë. Këtë detyrë do ta bëjë Partia, organizata bazë, e cila ditë dhe natë duhet të mendojë, të gjykojë dhe të organizojë zbatimin e vendimeve, të ketë parasysh interesin e kolektivit dhe jo vetëm interesin e ngushtë të fshatarësisë, të zhvishet nga këto dhe të hidhet në punë. Po korrëm suksese në bujqësi, situata jonë ekonomike do të ndryshojë.

Në luftë e sipër për të zbatuar vendimet do të kahlitet Partia, ajo do të forcohet edhe më shumë duke ruajtur normat leniniste të saj. Komiteti Qendror mori këto vendime që lexova dhe ai është i bindur se të gjitha masat që merren janë në interesin e Partisë dhe do të na sigurojnë suksese më të mëdha në kryerjen e detyrave historike që na ka ngarkuar Partia dhe populli.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

FJALA NË SESIONIN I TË LEGJISLATURËS SË TRETË TË KUVENDIT POPULLOR

20 korrik 1954

Shokë deputetë,

Para katër vjetësh, me propozimin e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, u ngarkova nga Kuvendi Popullor të formoja Qeverinë e Republikës Popullore të Shqipërisë. Me lejoni që në bazë të Kushtetutës t'i paraqit sot Kuvendit Popullor dorëheqjen e qeverisë.

Qeveria jonë vuri të gjitha forcat e veta në punë për kryerjen me sukses të detyrave që i kishte ngarkuar populli, Partia dhe Kuvendi Popullor. Në kryerjen e detyrave të saja qeveria e Republikës sonë u udhëhoq dhe zbatoi me besnikëri politikën e Partisë së Punës dhe të Komitetit të saj Qendror.

Politika e Partisë sonë të Punës konsiston në ngritjen e mirëqenjes së vazhdueshme të popullit, e plotësimin maksimal të nevojave materiale dhe kulturore të masave punonjëse, në forcimin e pushtetit popullor dhe të aftësisë mbrojtëse të atdheut tonë, në sigurimin e fitoreve të popullit dhe në zgjerimin e tyre, në mbrojtjen e independencës, të lirisë, të sovranitetit të atdheut

dhe të paqes në botë. Këtë program madhështor, të qartë dhe tej pamës të Partisë, për ndërtimin e bazave të socializmit, ka zbatuar Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë. Partia jonë, me urtësinë dhe guximin që e karakterizon, e kryen me nder rolin e saj historik dhe për këtë ajo ka fituar dashurinë e pakufishme të popullit. Populli ynë heroik ja ka besuar fatet e veta Partisë së tij dhe kjo i qëndron besnike popullit, e drejton atë me sukses në rrugën e lumturisë. Politika e Partisë së Punës të Shqipërisë përqafohet totalisht nga i gjithë populli ynë, për arsye se kjo politikë shpreh dëshirat dhe aspiratat e masave punonjëse dhe se i vë në jetë, i konkretizon, i realizon këto dëshira.

Sukseset e korrura nga populli ynë kanë qenë shumë të mëdha dhe të papara ndonjëherë në historinë e vendit tonë. Një nga sukseset vendimtare të politikës tej pamëse të Partisë është se ajo e solli popullin në fuqi dhe e bëri zot të fateve të veta. Populli shqiptar, për herë të parë në historinë e tij shekullore, mori në duart e veta pushtetin që i takonte, vendosi regjimin e tij të demokracisë popullore. Pushteti popullor, që është fitorja e shkëlqyer historike e popullit tonë, ka shkuar çdo ditë duke u forcuar, duke u modernizuar. Në pushtet marrin pjesë njerëzit më të mirë të popullit, të zgjedhur prej popullit me forma nga më demokratiket. Populli e ruan dhe e forcon çdo ditë pushtetin e tij.

Një fitore tjetër kolosale dhe historike e politikës leniniste të Partisë sonë është krijimi, zmadhimi dhe forcimi i klasës sonë heroike punëtore nacionale. Klasa jonë punëtore po rritet në numër, po kalitet në punë, po ngrihet vazhdimisht nga ana teknike, kulturele dhe

rol i saj vendimtar po shtohet në jetën e popullit tonë, ajo është bërë forca drejtuese e regjimit të demokracisë popullore si formë e diktaturës së proletariatit.

Te ne është ngritur një industri e rëndësishme, që çdo ditë forcohet dhe prodhon për të plotësuar sa më mirë dhe sa më shumë nevojat e popullit. Është rritur kështu furnizimi i popullit me mallra të konsumit të gjerë, të cilat prodhohen në vend nga fabrikat tona të reja që janë pronë e popullit dhe që drejtohen me zotësi nga bijtë dhe bijat më të mirë të popullit, nga klasa jonë punëtore. S'ka asnjë dyshim se industria jonë do të forcohet e do të perfeksionohet më shumë dhe çdo vit populli do të ketë më shumë veshmbathje, këpucë, sheqer, vajra e sende ushqimore të freskëta dhe të konservuara, do të ketë më shumë vegla bujqësore, lëndë ndërtimi, vegla dhe sende të nevojshme për punët e përditshme të shtëpisë etj. Krahas me industrinë tonë të lehtë nacionale dhe lokale e me artizanatin, që është bërë një ndihmës i mirë i industrisë, po zhvillohen minierat tona dhe sigurisht ato do të marrin në të ardhshmen një hov më të madh në bazë të kërkimeve që bën pushteti ynë.

Politika e Partisë në lëmin e bujqësisë ka bërë që kjo të dalë nga prapambetja e madhe e së kaluarës dhe të ecë me sukses në rrugën e një bujqësie të përparuar. Investimet e shtetit në bujqësi, veprat e mëdha dhe të vogla në të katër anët e vendit për bonifikime tokash, kanalet ujitëse dhe kulluese, traktorët dhe veglat e ndryshme të bujqësisë, që na kanë ardhur nga Bashkimi Sovjetik, farërat e zgjedhura, eksperiencia e lavdishme e agroteknikës moderne sovjetike, kuadrot e

shumtë me arësim të lartë e të mesëm që kanë mësuar në Bashkimin Sovjetik, në vendet e demokracisë popullore dhe në vendin tonë, kanë bërë që në sektorin e bujqësisë ne të kemi suksese që nuk njiheshin fare në të kaluarën. Partia jonë, që udhëhiqet në punën e saj nga doktrina e Marksit-Engelsit-Leninist dhe Stalinit, me masat e saja të drejta në dobi të bujqësisë dhe të fshatarësisë, me favorizimet që ajo u ka bërë fshatarëve, me stimulin dhe leverdisshmërinë që ajo ka krijuar për mbarëvajtjen e bujqësisë, ka bërë që kujdesi për bujqësinë të shtohet çdo ditë dhe më shumë. Ky kujdes i veçantë e i madh i Partisë dhe i qeverisë për bujqësinë do të rritet çdo vit në mënyrë që të shtohen prodhimet bujqësore dhe populli të ketë më me bollëk çdo gjë, të forcohen kurdoherë më shumë lidhjet në mes të qytetit dhe të fshatit.

Politika e Partisë në lëmin e arësimit e të kulturës ka korrur suksese shumë të rëndësishme. Në qendrën e vëmendjes dhe të kujdesit të qeverisë ka qenë dhe do të jetë pajisja e masave të popullit me arësim dhe kulturë. Zhvillimi arësimesor dhe kultural për njerëzit është për Partinë tonë po aq i domosdoshëm sa edhe përpjekjet e saja për t'u siguruar masave të gjera konditat materiale të jetesës së mirë.

Politika e drejtë e Partisë ka ngjallur në ndërgjegjen e njerëzve të Shqipërisë së re një besim të patundur në të ardhshmen e begatshme të popullit, një besim të madh në masat e popullit për forcën e tyre të madhe krijuese, ka ngjallur në to entuziazmin, ka zhvilluar më tej dhe ka çelënikosur patriotizmin dhe vigjilencën revolucionare për të mbrojtur atdheun, popullin, push-

tetin nga lakmitë dhe intrigat e armiqve imperialistë të jashtëm dhe nga armiqtë e brendshëm, të cilët përpiqen me çdo mjet të dëmtojnë fitoret e mëdha të popullit. Populli, ushtria dhe armët e tjera të sigurimit e të mbrojtjes së shtetit, të udhëhequra dhe të edukuara nga Partia qëndrojnë kurdoherë vigjilente dhe do të godasin pa mëshirë të gjithë ata që do të guxojnë të prekin atdheun tonë dhe interesat e popullit.

Këtë politikë të drejtë dhe kurdoherë fitimtare të Partisë së Punës të Shqipërisë ka ndjekur dhe ka zbatuar qeveria jonë dorëheqëse. Këtë politikë do të ndjekë dhe qeveria e re që do të zgjedhë Kuvendi Popullor. Si qeveria dorëheqëse dhe qeveria e re do t'i zbatojë me sukses detyrat për arsye se në punë ajo drejtohet, ndihmohet dhe kontrollohet vazhdimisht nga Partia dhe nga Komiteti i saj Qendror.

Populli shqiptar i korr të gjitha këto fitore dhe është i sigurtë në të ardhshmen e tij të lumtur, pse ka edhe ndihmën e përkrahjen e Bashkimit Sovjetik dhe të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Vendi tonë nuk guxon ta prekë kurrkush në të drejtat e tija, pse kaloi ajo kohë kur popujt e vegjël, si ky yni, shtypeshin dhe merreshin nëpër këmbë. Këtë fatlumturi për popujt dhe veçanërisht për popullin tonë e solli Revolucioni i madh socialist i Tetorit. Populli shqiptar ka fituar të drejtat e tija legjitime në arenën ndërkombëtare dhe ky nuk është më një milion e treqind mijë vetë, por mbi 800 milion. Armiqtë e paqes dhe të popujve duhet t'i bëjnë mirë llogaritë me forcën kolosale të kampit socialist. Kjo forcë e madhe solidariteti, kjo miqësi e madhe dhe bujare që e lidh popullin tonë me

popujt e Bashkimit Sovjetik dhe me vendet e demokracisë popullore e bën popullin tonë akoma më të fortë, më të guximshëm në rrugën e tij paqësore të ndërtimit të socializmit.

Politika e Partisë dhe e qeverisë sonë ka qenë dhe do të mbetet një politikë për mbrojtjen e paqes në botë, për marrëdhënje normale e të drejta me fqinjët e vendit tonë dhe me cilindo shtet që respekton lirinë, independencën dhe sovranitetin e vendit tonë. Në këtë drejtim qeveria jonë ka normalizuar marrëdhënjet me fqinjët jugosllavë dhe italianë.

Forca e regjimit të demokracisë popullore në vendin tonë qëndron në forcën dhe në drejtësinë e vijës së Partisë së Punës të Shqipërisë. Sa më e fortë të jetë Partia jonë aq më të sigurt dhe më të mëdha do të jenë fitoret e vendit tonë. Prandaj Partinë ne duhet ta ruajmë si sytë e ballit dhe të vëmë të gjitha forcat për ta çelnikosur atë çdo ditë e më shumë. Armiqtë e popullit tonë të cilët i kanë mprehur armët, përpigën me të gjitha mjetet, por pa sukses, që të godasin Partinë pse ata e dinë se te Partia, te uniteti i saj i çelniktë, te politika e saj e drejtë e bazuar në principet marksist-leniniste qëndron forca e popullit tonë, atje e kanë burimin të gjitha fitoret e tija, atje qëndron garancia e sigurtë e lirisë së popullit dhe e pavarësisë së atdheut tonë. Komiteti Qendror i Partisë, që është truri kolektiv drejtues i Partisë, në plenumin e tij që mbajti në muajin korrik të këtij viti mori vendime të rëndësishme organizative, të cilat kanë për qëllim forcimin e mëtejshëm të Partisë dhe të udhëheqjes së saj. Forcën e madhe drejtuese dhe udhëheqëse të popullit tonë, Par-

tinë, në luftën për ndërtimin e bazave të socializmit ne duhet ta forcojmë çdo ditë e më shumë, të ngremë akoma më lart aftësitë e saja organizative, ekonomike dhe politike, të ngremë nivelin e saj ideologjik dhe kultural. Marksizëm-leninizmi na mëson se forca e rendit tonë socialist qëndron në sigurimin e plotë të rolit drejtues dhe kontrollues të Partisë në të gjitha çështjet, në ato ekonomike dhe shtetërore, në edukimin e punëtorëve, të fshatarëve dhe të intelektualëve. Për ta forcuar pra akoma më shumë këtë rol vendimtar të Partisë, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë në mbledhjen e tij plenare mori një sërë masash organizative. Unë kërkoja nga Komiteti Qendror, dhe ai e gjeti të drejtë kërkesën time, që të më lironte nga funksionet e mia si Kryetar i Këshillit të Ministrave dhe të më jepte mundësinë të përqëndroja të gjitha forcat e mia në drejtimin e punës së Partisë e të forcimit të saj dhe tok me shokët e mi të Komitetit Qendror të forcojmë akoma më shumë Partinë e ta kalitim atë. Komiteti Qendror e pranoi kërkesën time dhe unë do të shkrij të gjitha forcat e mia në shërbim të Partisë sonë heroike dhe të popullit tonë të dashur. Komiteti Qendror duke e marrë këtë masë organizative, në ndarjen e funksioneve të Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror me atë të Kryeministrit, ka pasur për qëllim gjithashtu që drejtimi, ndihma dhe kontrolli i Partisë dhe i Komitetit të saj Qendror karshi enteve shtetërore dhe ekonomike të jetë i plotë e vendimtar, pse nga ky drejtim dhe nga kjo ndihmë varet forcimi i pushtetit tonë popullor, varet forcimi i organeve tona qendrore dhe lokale të pushtetit,

varet kryerja me sukses e detyrave që i vihen përpara Partisë dhe qeverisë sonë.

Komiteti Qendror më ka ngarkuar t'i propozoj Kuvendit Popullor që ky të ngarkojë për formimin e Qeverisë së re të Republikës Popullore të Shqipërisë, anëtarin e Byrosë Politike, shokun Mehmet Shchu, shok me eksperiencë drejtimi, bir besnik i Partisë dhe i popullit.

Më lejoni të falenderoj nga zemra me mirënjohje të pafund Partinë tonë dhe Kuvendin Popullor për nderin e madh dhe besimin që ata treguan ndaj meje duke më ngarkuar për më tepër se 11 vjet me funksionin e rëndësishëm të Kryetarit të Këshillit të Ministrave, të falenderoj shokët e mi ministra dhe të gjithë funksionarët e shtetit tonë për punën e tyre plot vetëmohim për kauzën e shenjtë të popullit dhe të Partisë.

Nën udhëheqjen e Partisë dhe të Komitetit të saj Qendror, Qeveria e re e Republikës Popullore të Shqipërisë do të kryejë me nder detyrat e saja të shenjta dhe do të ndjekë me besnikëri politikën e drejtë dhe shpëtimtare të Partisë sonë, që e udhëheq popullin shqiptar në fitore të reja, në fitoren e socializmit.

Rroftë populli ynë heroik!

Rroftë Partia jonë heroike dhe Komiteti i saj Qendror!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 172 (1812), 21 korrik 1954

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TE ORGANIZOJMË MË MIRË PUNËN E PARTISË NË FSHAT

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

26 korrik 1954

Ekipe të shkojnë për kontroll e ndihmë në bazë, duhen porositur që, kur bëjnë raportin e punës, të shënojnë në të edhe si funksionon organizata bazë e Partisë në fshat, si e udhëheq ajo këshillin popullor të fshatit etj. E them këtë, pse më duket që ne duhet të bëjmë një kthesë më të madhe në punët e Partisë në fshat. Dëgjohet herë pas here ndonjë ankesë se komunistët në fshat nuk aktivizohen të gjithë. Pse ndodh kjo? Një nga arësyet që ndodh kjo është edhe fakti se puna në organizatën bazë atje nuk është organizuar mirë, detyrat midis komunistëve nuk janë ndarë si duhet dhe, duhet të dimë se atje ku nuk ka ndarje pune, nuk

¹ Ky diskutim u zhvillua në mbledhjen që shqyrtoi planin e punës të Sekretariatit dhe të drejtorive të aparatit të Komitetit Qendror për tremujorin e 3-të të vitit 1954.

mund të ketë përgjegjësi. Por ndarja e punës nuk është gjithshka. Kontrolli dhe ndihma për të zbatuar detyrat kanë rëndësi të madhe, pa këto ekziston rreziku që detyrat të mbeten në letër.

Të marrim për shembull një fshat që ka 4-5 komunistë. Sekretari i organizatës bazë përveç detyrave të tjera për mbarëvajtjen e punës në fshat, mund të ndjekë direkt çështjet ekonomike¹. Për këtë ai duhet të ketë edhe 2-3 anëtarë partie si ndihmës. Njëri nga këta duhet të jetë kryetari i këshillit popullor të fshatit, qoftë ose jo anëtar partie. Sekretari i organizatës bazë dhe kryetari i këshillit popullor janë dy figurat kryesore në fshat dhe duhet të punojnë me një perspektivë të tillë që të arrihet bashkimi vullnetar i fshatarëve në kooperativë bujqësore. Një komunist duhet të caktohet për çështjet e agjitacionit e të propagandës; kur ndonjë mësues është anëtar partie, përgjegjës i agjitacionit e i propagandës duhet të jetë ai, kur nuk ka të tillë, me këtë detyrë mund të caktohet një anëtar partie që ka një përgatitje ideo-politike. Njëri duhet të jetë përgjegjës i rinisë; në rast se ai nuk është anëtar partie atëherë sekretari i organizatës bazë të Partisë duhet të bashkëpunojë ngushtë me të, një tjetër me organizatën e gruas etj. Në këtë mënyrë arrihet në një mobilizim më të madh të njerëzve. Po të organizohet puna kështu, shokët e sektorit të agjitacionit e të propagandës të rrethit për problemet e tyre t'i drejtohen atij që është i

¹ Kjo ka të bëjë me detyrën themelore të revolucionit socialist në atë kohë, kur në plan të parë dalin çështjet ekonomike.

ngarkuar me të njëjtin sektor nga organizata bazë. Nuk duhet të thirret për të gjitha problemet, sikurse bëhet sot, sekretari i organizatës bazë dhe të përplasen te ai të gjitha gjërat, por punonjësit e aparatit të komitetit të Partisë të lidhen përkatësisht me shokët e organizatës bazë sipas ndarjes së punës.

Çështja e pushtetit ka rëndësi të madhe, prandaj duhet të na preokupojë shumë forcimi i këshillave popullore të fshatit. I ngarkuari me detyrën e pushtetit duhet të jetë njeriu më i mirë. Këtu lart në dikastere ka ndihmësministra, bile kërkohet të shtohen dhe të tjerë, pra sektorët e punës ndahen, po pse s'bëhet kjo edhe në bazë, në këshillat popullore, ku të ketë edhe atje një ndarje pune? Ne e dimë se në fshat, me gjithë punën e madhe që bëhet, ka mjaft shfaqje mikroborgjeze, për zhdukjen e të cilave nuk mjafton vetëm kritika dhe autokritika, por duhet një punë e gjerë dhe e thellë politike, ideologjike, ekonomike, organizative, administrative. Partia do të bëjë punën e saj, por në këtë fushë ka mjaft detyra edhe pushteti. Prandaj të gjithë duhet të mendojmë se si ta forcojmë punën e Partisë në fshat.

Të marrim një çështje: a i ka organizata bazë vendimet e Komitetit Qendror? Jo, nuk i ka. Mirëpo ato duhen lexuar gjithnjë dhe mbi bazën e tyre duhet punuar. Kjo situatë duhet ndrequr. Po kështu komiteti i Partisë i rrethit duhet të jetë si një koshere bletësh, ku sekretarët e organizatës bazë, ata që merren me çështjet e agjitacionit e të propagandës dhe të tjerë, të venë dhe të vijnë vazhdimisht e jo vetëm me raste fushatash. Sekretari i komitetit të Partisë të qarkut du-

het të njohë gjithë sekretarët e komitetit të Partisë të rretheve dhe këta të fundit, duhet të njohin sekretarët e organizatave bazë të Partisë. Sekretarët e organizatave bazë t'i nxitim që të shkojnë për të biseduar e të ngrenë probleme te sekretari i parë dhe i dytë i komitetit të Partisë. Po të forcohet më tepër Partia dhe këshilli popullor i fshatit, po të organizohet më mirë puna, atëhere shumë gjëra nuk do të zgjidhen nga lart, por nga vetë baza. Në qoftë se organizata bazë zhvillon një punë të mirë ideo-politike për edukimin e komunistëve dhe të masave, ajo mund të zgjidhë mjaft çështje. Organizata bazë e Partisë në fshat duhet të mendojë qysh sot, se nesër fshatarësia do të jetë në kooperativë, e cila do të kërkojë organizim më të mirë dhe disiplinë më të fortë, ndryshe nuk mund të kuptohet kolektivizimi i bujqësisë, prandaj është e domosdoshme që hapat e parë të organizimit më të mirë të punës në fshat t'i hedhim që tani, me qëllim që të jemi më të përgatitur si organizatorë, si udhëheqës të punëve më të mëdha që na presin në të ardhshmen.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

L E N D A

PARATHËNJE PËR VËLLIMIN 11 V—VII

1953

NGA FJALA NË SESIONIN V TË KUVENDIT POPULLOR (1 gusht 1953) 1—27

PUNA ME KUADRIN NË USHTRI NUK ËSHTË VETËM VENDOSJA NË DETYRA E OFICERËVE APO E NËNOFICERËVE, POR ËSHTË NJË PUNË E TËRË SHKENCORE — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (7 shtator 1953) 28—33

MBI DISA TË META DHE GABIME SERIOZE TË PANAJOT PLAKUT (12 shtator 1953) 34—40

NGA BISEDË E ZHVILLUAR ME SHOKUN BEXHET NEMA KRYETAR I KOMITETIT EKZEKUTIV TË KP TË QARKUT GJIROKASTËR (17 shtator 1953) .. 41—50

MBI ARËSIMIN POLITIK TË RINISË — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (5 tetor 1953). 51—55

LIGJET DUHEN ZBATUAR PA LËSHIME — Disku-

tim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (9 nëntor 1953)	56—63
MBI FORCIMIN E KOOPERATIVAVE BUJQËSORE EKZISTUESE — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (16 nëntor 1953)	64—73
MBI KONTROLLIN E PARTISË PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË PUNËTORËVE — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (23 nëntor 1953)	74—78
MBI PËRJASHTIMET NGA PARTIA — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (30 nëntor 1953)	79—83
NË REPUBLIKËN POPULLORE TË SHQIPËRISË PO NDËRTOHEN ME SUKSES BAZAT E SOCIALIZMIT (Nëntor 1953)	84—110
MBI DISA ÇËSHTJE TË PROPAGANDËS BUJQË- SORE — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (7 dhjetor 1953)	111—117
MBI KRITIKËN DHE AUTOKRITIKËN NË USHTRI — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (7 dhjetor 1953)	118—121
MBI ZHVILLIMIN E BLEGTORISË NË QARKUN E DURRËSIT — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekreta- riatit të KQ të PPSH (14 dhjetor 1953)	122—127
MBI DISA ÇËSHTJE TË METODËS SË DREJTIMIT NGA ANA E PARTISË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (14 dhjetor 1953)	128—140
«MBI MASAT PËR NGRITJEN E MËTEJSHME TË	

NIVELIT TË JETESËS SË MASAVE PUNONJËSE— — Raport i mbajtur në Plenumin IX të KQ të PPSH (24 dhjetor 1953)	141—207
I. GJENDJA EKONOMIKE E FSHATARËSISË	143—153
II. GJENDJA EKONOMIKE E KLASËS PUNË- TORE DHE E MASAVE PUNONJËSE	154—165
1. Gjendja e furnizimit të popullatës së qy- teteve, të qendrave të punës dhe të fshatit.	154
2. Si paraqitet furnizimi dhe konsumi me disa artikuj kryesorë.	157
III. ARËSYET KRYESORE QË KANË SHKAK- TUAR GJENDJEN E VËSHTIRË EKONO- MIKE TË FSHATARËSISË DHE TË TË GJITHË PUNONJËSVE	166—207
1. Gabimet në ritmin dhe në proporcionet e zhvillimit të degëve të ekonomisë popullore	166
2. Dobësitë e punës së Partisë dhe të pushtetit, si në bujqësi, në industri dhe në të gjithë sektorët e tjerë janë të shumta	169
DETYRAT IMEDIATE PËR NGRITJEN E NIVELIT TË JETËS SË PUNONJËSVE	193
TELEGRAM URIMI DËRGUAR SHOKUT MAO CE DUN ME RASTIN E 60-VJETORIT TË DITËLINDJES (26 dhjetor 1953)	208—209
MBI PUNËN E PARTISË NË MINIERËN E BAKRIT «1 MAJ» TË RUBIKUT — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (28 dhjetor 1953).	210—214

1954

- MBI PUNËN QË DUHET TË BËJNË NË ORGANIZATAT E TYRE DELEGATËT QË MARRIN PJESË NË KONFERENCAT E PARTISË — Letër udhëzuese (4 shkurt 1954)** 215—216
- NGA REDAKSIA E RADIO TIRANËS KËRKOHET NJË ORGANIZIM DHE NJË DREJTIM MË I MIRË I PUNËS — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (8 shkurt 1954)** 217—220
- JO VETËM TË KËRKOJMË NGA PUNËTORËT REALIZIMIN E PLANIT, POR T'U PLOTËSOJMË ATYRE EDHE KUSHTET E NEVOJSHME TË PUNËS E TË JETËS — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (16 shkurt 1954)** 221—227
- PAK FJALË MBI DISA NGA ORGANET E SHTYPIT QË BOTOHEN NË VENDIN TONË — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (17 shkurt 1954)** 228—231
- MBI DETYRAT E DELEGATËVE TË KONFERENCAVE TË PARTISË DHE PUNA ME MASAT — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (17 shkurt 1954)** 232—234
- NË KOOPERATIVË, ASAMBLEJA ËSHTË AJO QË VENDOS GJITHSHKA — Nga biseda me kooperativistët e Maminasit (21 shkurt 1954)** 235—237
- DETYRA JUAJ ËSHTË QË EKSPERIENCËN TUAJ T'UA MËSONI EDHE TË TJERËVE — Përgjegje letrës së Shuaip E., kultivues i dalluar i duhanit në Shtërmen të Elbasanit (22 shkurt 1954)** 238—241
- STUDIMET TË LIDHEN NGUSHTË ME PROBLEMET**

QË NA SHQETËSOJNË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (24 shkurt 1954)	242—251
TË FORCOJMË MË TEJ PUNËN PËR PREGATITJEN IDEOLOGJIKE TË KUADROVE NË KURSET E PARTISË — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (24 shkurt 1954)	252—255
LETËR E HAPUR DREJTUAR KOMISIONEVE ELEKTORALE TË QARQEVE ME TË CILËN I NJOF-TON SE KANDIDATUREN PËR ANËTAR TË KËSHILLIT POPULLOR TË QARKUT DO TA VËRË NË ZONËN ELEKTORALE Nr. 11 TË TIRANËS (2 mars 1954)	256—257
TË MERREN MASA QË KRIPA TË MOS MUNGOJË — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (6 mars 1954)	258—260
MBI DISA ÇËSHTJE TË ADMINISTRIMIT TË DOKUMENTAVE TË PARTISË NË KORÇË — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (22 mars 1954)	261—263
GRUAJA T'I FITOJË VETË TË DREJTAT, ME LUF-TËN E SAJ E ME NDIHMËN E PARTISË — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (22 mars 1954)	264—269
FJALA E MBAJTUR NË KONFERENCËN I KOMBË-TARE TË PUNONJËSVE TË NBSH-ve DHE TË SMT-ve (27 mars 1954)	270—285
LETËR DËRGUAR NXËNËSVE DHE MËSUESVE TË SHKOLLËS SË MESME «ASIM ZENELI» TË GJIRO-KASTRËS ME RASTIN E 31-VJETORIT TË THEME-LIMIT TË SHKOLLËS DHE TË 12-VJETORIT TË	

DEMONSTRATËS SË SAJ KUNDËR FASHIZMIT (3 prill 1954)	286—288
«MBI TË METAT DHE DETYRAT NË DREJTIMIN E ÇËSHTJEVE EKONOMIKE E SHTETËRORE DHE MBI ZHVILLIMIN E DEGËVE KRYESORE TË EKO- NOMISË PËR PERIUDHËN 1954—1957» — Raport i mbajtur në Plenumin X të KQ të PPSH (16 prill 1954)	289—403

I

MBI REALIZIMIN E PLANIT PËR VITET 1951—1953.	289—302
--	---------

II

MBI TË METAT NË DREJTIMIN E ÇËSH- TJEVE EKONOMIKE E SHTETËRORE	302—349
- TË STUDIOHEN ME THELLE E NË PERSPEKTIVE DEGET KRYESORE TË EKONOMISË	302
- TË PËRSOSET MË TEJ METODA E DREJTIMIT NGA OR- GANET SHTETËRORE	325
- TË FORCOHET ME SHUMË PUNA POLITIKE DHE OR- GANIZATIVE E PARTISË PËR ÇËSHTJET EKONOMIKE ..	343

III

MBI ZHVILLIMIN E DEGËVE KRYESORE TË EKONOMISË PËR PERIUDHËN 1954—1957	349—403
- INDUSTRIA	350
- BUJQESIA	361
Disa masa për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë.	368
- TRANSPORTET	392
- TREGETIA	393

FJALA E MBYLLJES NË PLENUMIN X TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH (18 prill 1954)	404—409
FJALA NË MITINGUN E ORGANIZUAR NË TIRANË ME RASTIN E INAUGURIMIT TË MONUMENTIT TË V. I. LENINIT (22 prill 1954)	410—417
MBI DISA DETYRA PËR FORCIMIN E PUNËS NË KOMBINATIN E TEKSTILEVE «STALIN» — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Poltike të KQ të PPSH (3 maj 1954)	418—420
FJALA PARA ZGJEDHËSVE TË ZONËS ELEKTORALE Nr. 107 TË TIRANËS (12 maj 1954)	421—445
MBI DISA ÇËSHTJE ORGANIZATIVE TË PARTISË — Raport i mbajtur në Plenumin XI të KQ të PPSH (12 korrik 1954)	446—456
PA MËSUAR MIRË MARKSIZËM-LENINIZMIN, DETYRAT NUK MUND TË KRYHEN SI DUHET — Diskutim në mbledhjen me kuadrot kryesorë të aparatit të KQ të PPSH (12 korrik 1954)	457—463
DIREKTIVAT ZBËRTHEHEN DHE ZBATOHEN DREJT VETËM ATËHERE KUR ATO KUPTOHEN DREJT — Diskutim në mbledhjen e aktivitetit të Partisë të Tiranës (13 korrik 1954)	464—479
FJALA NË SESIONIN I TË LEGJISLATURËS SË TRETË TË KUVENDIT POPULLOR (20 korrik 1954)	480—487
TË ORGANIZOJMË MË MIRË PUNËN E PARTISË NË FSHAT — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (26 korrik 1954)	488—491

Shtypur NISH shtyp. «M. DURI», Stab. «8 NËNTORI» — Tiranë

